

BIBLIOTEKA

854-31
g 59

SABRI GODO

**Koha
nieriut**
roman

85H-31
g 59

SABRI
GODO

KOHA
E
NJERIUT

Roman



SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

I

Në prillin e vitit 1933 shtatë kalorës qëndruan te porta e teqesë së Markeshit. I pari i tyre ishte dedei plak i Teqesë së Madhe, që vinte aty për të sjellë dervish Merxhanin e ri, 22-vjeçar, me premtimin e qartë për ta bërë baba të teqesë së Markeshit. Pesë të tjerët ishin anëtarë të këshillit të kësaj teqeje, që kishin shkuar në Teqenë e Madhe për të marrë doemos dervish Merxhanin.

Mushkat e lodhura qëndruan pa lëvizur, me kokat lart. Dervish Merxhani ndihmoi dedein plak të zbriste. Ky ishte kapur tërë kohën me të dy duart në gungën e shalës dhe, kur zuri tokë, duhej ta mbanin, se iu drodhën gjunjët. Kalorësit e tjerë shpinë gjymtyrët. Mori fund udhëtimi 12-orësh, i nisur herët në mëngjes, kur ende nuk shquanin mirë fytyrat e njëri-tjetrit. Tani po shiheshin si për herë të parë dhe ndo-

njëri buzëqeshi i kënaqur, duke shprehur me këtë kënaqësinë e të gjithëve.

Prej një viti Markeshi e shihte veten në një udhëkryq. Kishte vdekur babai i vjetër i teqesë dhe nuk po gjendej i riu. Në një vend të largët, të veçuar, i tëri bektashi, personi i babait qëndronte pa dyshim më lart edhe se kryetari i komunës dhe komandanti i postës së xhandarmërisë. Veç kësaj, për shkaqe që i dinte kushdo, zgjedhja e babait të ri mund të gëzonte një pjesë të njerëzve, duke hidhëruar pjesën tjetër. Prandaj zaret u mbajtën në dorë për një kohë të gjatë dhe më në fund u hodhën mbi dervish Merxhanin e ri, me shpresë se secila nga palët do të mundte t'i jepte me kohë drejtimin e duhur. Gjithsesi, ai do të qëndronte disa muaj në provë. Jo vetëm katër lagjet e Markeshit, po edhe katër fshatrat e tjerë të komunës, si edhe disa lugina përtej maleve, do të mbanin sytë mbi këtë dervish, që do të bëhej baba e që mund të sillte ndryshime në jetën dhe zakonet e tyre, që mund të bënte edhe ligjet e veta, po që se do të kishte dëshirë, shtat e zemër për t'i bërë.

U afruan shërbëtorët që kishin pritur prapa dyerve me durim e kureshtje dhe i puthën dorën dedeit plak, kujdestarit të largët, me mendjen të dervishi i ri që rrinte prapa. Vetë dedei u kthye ta shihte edhe një herë këtë dervish, siç shihet dhëndri, të cilit i jepet nuse vajza e madhe. Sytë e dedeit u mbyllën një çast prej mundimit të rrugës, ose nga një kujtim i ditës së hershme kur ai vetë kishte hyrë dhëndër i tillë në një bina më të madhe. Dedei shikonte përpara i hutuar. Dervish Merxhani e ndihmoi të kalonte portën dhe oborrin me pllaka të mëdha guri, duke e mbajtur me kujdes për krahu. Si ngjiten të katër shkallët, e la të çlodhej te sofati i derës. Aty dedei i drobitur mori frymë, ndofta murmuriti një lutje. Era

ia lëvizte fijet e flokëve si mëndafsh i bardhë që i binin te veshët.

Dervish Merxhani lexoi fjalët e gdhendura në harkun prej guri të derës: «Unë jam qyteti i diturisë, Aliu është porta.» Ai e kishte kokën plot me mësim. I dukej se në atë teqe kishte qenë edhe më parë dhe dëshironte të hynte, të shihte nëse simbolet ishin nëpër vende, ndërsa dëgjonte të bridhnin në dhomat lart njerëz të zbathur, hapa të njohur.

Ata të gjithë hynë në dhomën e parë me kube në të djathtë, ku ishin varret e tre baballarëve të fundit, dhe qëndruan te varri në krye i baba Jasharit. Ky ishte më i lartë se dy varret e tjera, i mbuluar me ca qëndisma të zverdhura prej kohës, me shkronja që lëvdonin shpirtin e të vdekurit në qiell. Vizitorët aty mbajtën frymën, pa ditur ç'të mendonin, puthën drurin te këmbët me përukje e pendim dhe dolën me zemrën të lehtësuar. Si e bënë këtë detyrë, filluan të ngjiteshin në shkallët. Prapa dyerve, nga qoshet e fshehta, përgjonin shërbëtorët e shumtë të teqesë, ata që s'e kishin rangun për të pritur vizitorë. Viti më i ëmbël i jetës së tyre kishte mbaruar, por ndofta jeta mund të vazhdonte njëloj edhe me këtë dervish të ri, të pashëm e të butë, me sytë e zez gati të lotuar.

* * *

Dedei i Teqesë së Madhe që larguar prej dhjetë ditësh. Dervish Merxhani rrinte në dhomën e tij të katit lart, duke pritur sekretarin. Dervishi kishte parë të lëviznin hije të dyshimta në ahuret dhe përtej mureve të teqesë. Ai po mendonte se duhej t'i jep-

te fund punës së këtyre hijeve. Me këtë mendim të ngulitur, u afrua te dritarja nga ana e lindjes, prej nga dukej një pjesë e shkëmbit të lartë, dhe pa atë që priste të shihte në atë orë të vapës së pasdrekes: dervish Hasani, gjashtëdhjetëvjeçar, me trupin e bëshëm po me sytë e dobët, hiqej se flinte nën hijen e manit të kuq, në bregun afër Pyllit të Thanëve. Dervish Merxhani vuri buzën në gaz, ndërsa po i prishej gjaku. E ku mund të flinte më mirë një dervish sesa nën një man, druri që solli prej Horasanit Haxhi Bektashi e që mbillet në çdo teqe të dheut? Mani kishte çelur kokrrat e vogla të rrudhura, gjethet e reja gati të tejdukshme dridheshin lehtas prej lëngut e flladit. Një grua me trupin të përkulur kaloi fshehtas nga lajthishta te Pylli i Thanëve dhe humbi rrëzë shkëmbit. Prej andej erdhi shenja, një trokitje e lehtë me gur. Dervish Hasani u çua si i përgjumur dhe hyri në pyllin e shkurtër këmbëzbathur e me duart në brezin e shallvareve, si për të bërë ujët e hollë.

Dervish Merxhani ndenji duke parë faqen e shkëmbit me ngjyrën e murrme të metalit, me damarët e bardhë si kristal. U përkul në dritare dhe pa te dera e furrës në fundin e oborrit dervish Selimin e ri e të fuqishëm, i cili gjithashtu kishte përgjuar hyrjen e dervish Hasanit në pyll. Dervish Selimi buzëqeshi dhe u kthye të stivonte drutë. Dervishët tërë jetën i kthejnë në kurrizin njëri-tjetrit, asnjëherë nuk lidhin miqësi të vërtetë, po ka disa pika në të cilat ndihmohen heshtur.

Dervish Merxhani ndenji te postiqja e vet i turbulluar thellë. Ajo që duhej bërë nuk ishte e lehtë. Të shuash te dervishi egërsinë, dëshirat, të ndryshosh natyrën e tij, me anë të lutjeve të gjata, heshtjes, mendimit, është njëlloj si të zbutësh akrepin duke e

mbajtur nën gur, ndërsa ai aty vazhdon të mbledhë helmin. Këtu duheshin veprime të tjera. Nja tri-katër gra shërbenin çdo ditë në teqe, për shpirt, ose për bukën e gojës. Ca të tjera i qenë qepur teqesë nga jashtë. Hijet e tyre rrëshqisnin ndanë mureve dhe nganjëherë kalonin nga ashefi në oxhak-kafe. Ato sikur e ndienin në lëkurë afrimin e dervish Merxhani kur lëvizte në teqe dhe dilnin papritur prej skutave, me druajtje, po edhe me një mendim të prerë për t'i bërë të ditur dervishit të ri e të pashëm se ato ishin aty. Me kalimin e ditëve gratë po merrnin më tepër guxim dhe njëra prej tyre qëndroi një ditë në fundin e shkallëve, me drithërimën në trup, me ethet në sy.

Pëshpëritje të vjetra, të fshehta, ia skuqën ballin dervish Merxhanit. Një grua del natën nga një teqe duke thirrur me lebeti. Një baba gati i çmendur e ndjek ta kapë duke e mallkuar. Në një teqe tjetër një baba koprac e rrjep të gjallë fshatarin e varfër, ia merr jetimit tokën; një teqe më tej ka zënë ujët e luginës, mbledh misër për ta shitur në dimër. Gjëra këto që s'mund të fliten, as të mendohen dhe që s'do të ngjasin kurrë në Markesh. Kjo teqe mban një erë patriotizmi të vjetër, trazuar me erën e kalbësirës së shtuar vitet e fundit. Kjo duket edhe nga qortimi i heshtur në sytë e vizitorëve. Dervish Merxhani, si mëkëmbës i babait, do t'ia kthejë doemos emrin e mirë teqesë së Markeshit. Do t'i përzërë gratë dhe do t'i ndëshkojë dervishët. Kur e mendoj këtë, ndjeu lehtësim.

Erdhi sekretari që mbante llogaritë. U ul në gju një dhe hapi defterin, i gatshëm të mbrohej. Dukej burrë i ndershëm, po jo dhe aq i zoti të kthente në shifra ato që kishte në mendje. Dervish Merxhani arriti të kuptonte se kishte të bënte me teqenë në Qytezë dhe me teqenë verore në Rallenjë, të cilën s'e kishte

parë ende. Të dyja bashkë ishin prona më e madhe e krahinës me toka buke që jepeshin me një të tretën, me kullota e pyje, me pesëqind dhen e dhi, me nëntë pendë qe, me kuaj e lopë. Pa ishin edhe dhuratat nga populli që mblihdeshin sidomos në teqenë verore, e cila ndodhej në kryqëzimin e rrugëve. Pa ishin të ardhurat nga sharra e drurit, nga shitja e barit... Shpenzimet ishin të regjistruara, po jo të mbledhura, nuk dihej si dilte fundi, aq më tepër sepse llogaritë trazoheshin me ca shitblerje të vitit të shkuar. Sekretari djersinte, rrinte mbi defter me babilin si dem, por e shihte edhe vetë se ndodhej zbuluar nga krahu tjetër, hapte gojën pa mundur të nxirrte fjalën. Dervish Merxhani e ndihmonte. Më në fund mendoi se duhej të gjente një sekretar tjetër që t'i mbante të pastra llogaritë, po për këtë duhej edhe pëlqimi i këshillit të teqesë.

Njerëz të panjohur i hodhën një thes në kokë dervish Hasanit te Pylli i Thanëve dhe e rrahën fort. Një djalë i vogël erdhi më pas në teqe dhe tha fjalë të mësuara përmendsh, tha se demit që harbonte do t'i prisnin nishanet po të dilte prapë te Pylli i Thanëve. Dervish Merxhani e dënoi dervish Hasanin të hapte tokë me shërbëtorët duke thyer gurë deri të burimi rrëzë shkëmbit. Ditën e parë dervish Merxhani kaloi në udhëzën sipër teqesë dhe u hoq se nuk e pa dervish Hasanin tek thyente gurë. Por duhej t'i kalonte pranë dhe u ndal. Hasani uli varenë dhe ndejnisi heshtur, veç sa luajti pak qepallat. Po Merxhani kishte jetuar një kohë të gjatë në mes të dervishëve e myhibëve për t'ia kuptuar tronditjen dhe hidhërimin e thellë. Ditën tjetër Merxhani shkoi e ndejnisi aty afër, si për t'ia lehtësuar dënimin, ndërsa mendonte për fatin e dervishit, i cili është njeri e njeri s'është, se i ngrihen furtuna të mëdha në shpirt, po

dëshirat i ka të ndaluara, është i lirë të lëvizë dhe prapë mbetet i lidhur. Këto dhe të tjera donte t'i shpjegonte Hasanit, po iu lidh fjala në gojë. Hasani ktheu sytë e dobët e u lut pa zë, si një qen në vuajtjen më të madhe dhe në fytyrën e shëndetshme i trazoheshin lotët me djersën. Atëherë zuri të vuante fort edhe vetë dervish Merxhani e shkoi e u mbyll lart në dhomë, u ngulit në postiqe që të mposhtte të nxehët dhe shqetësimin.

Dervish Merxhani i kishte përzënë gratë. Në teqe u ndanë punët ndërmjet dervishëve e shërbëtorëve. Dervish Lala i vjetër do të shërbente në mejdan-evi, dervish Hasani në oxhak-kafe, dervish Selimi te furra e në ashef. Kurse në ahuret mbeteshin barinj të siç ishin. Qehaja i teqesë u caktua Aliu, shërbëtori më i vjetër. Ky ishte i imët, po i fortë, me fytyrë të mprehtë, sy të vegjël e mendje të gatshme. Ai filloi të nxiste njerëzit gjithandej, duke përpjekur pëllëmbët. Dervish Merxhani mund të thoshte se punët do të bëheshin më shpejt e më mirë nga sa i kishte menduar. Teqeja nga brenda ishte si një rrotë që mund të vërtitej ngadalë, duke ia vajosur krismat. Forca e vërtetë me të cilën duhej të matej fillonte te pragu i portës: Markeshi i pjerrët gri, i ndarë në katër lagje, me pyjet e dendura të errëta, një kazan i madh i natyrës me disa çarje, rrethuar me male dy mijë metra të larta që mbajnë dëborë deri në maj. Pa ishin përtej maleve edhe nënprefektura e madhe e Merqanit dhe komuna e Korenës, që të dyja bektashiane, të cilat teqeja e Markeshit i kishte gjithashtu nën kujdesin e saj. Kjo teqe e veçuar nga bota shtrinte hijen e vet në malësinë ndërmjet dy lumenjve. Dervishi i ri ndiente tërheqjen e kësaj hapësire madhështore, po edhe druajtjen që i jep njeriut e panjohura.

Një njeri që vjen nga larg për të kryesuar diçka në një vend të mbyllur, ngre rreth vetes nxitje e kurreshtje, si guri që bie në pellg, duke përhapur valët tej. Ndryshimi është ky: njeriu mbetet në sipërfaqe, nën sytë e të gjithëve. Vinin pareshtur njerëz në teqe, pinin një kafe, nuhasnin dervish Merxhanin dhe shkonin. Fshatarët që vinin nga larg dervishi i mban-te për darkë.

Atë ditën e parë, kur dervish Merxhani hyri në teqe dhe u zhduk pas portës, puna e tij ishte folur në çdo ahur, edhe në stanet më të largëta. Në ditët që pasuan, prej teqesë u përhapën disa lajme, që shtuan hamendjet rreth babait të ardhshëm. Prandaj secili kërkonte të shihte me sytë e tij. Disa myhibë kishin dalë prej teqesë duke tundur kokat, duke buzëqeshur në hënëz. Ky dervish tregohej i mësuar, fliste me një ëmbëlsi që të merrte zemrën, dinte me themel nurrat dhe shenjat. Sadi Pejza, kryeplaku dinak i Ballit, e kishte pyetur se nga e mori fuqinë Haxhi Bek-tashi. Merxhani që përgjigjur pa ngurrim, duke treguar rrugën e mësuesit prej Horasanit në Anadoll, i prirë nga zëri që i kishte dhënë të fshehtë për ta ruajtur gjashtëqind vjet.

Këto, dhe të tjera, po i tregonte mirë e bukur dervish Merxhani dhe myhibët e dëgjonin me gojën gjysmëhapët. Po ai shihte nga ana e tij se, ndërsa kënaqeshin prej përgjigjeve dhe i jepnin zemër të ecte më tej, ata sikur kërkonin përtej fjalëve diçka tjetër, një si shteg të fshehtë që do të zbulohet më pas. Dervishi e ndiente këtë me forcë, këpuste fjalën dhe kthehej e shihte Sadi Pejzën. Ky nënqeshte i kërrusur. Ai kishte qënë, i pari që bindi këshillin të kërkonte

për baba këtë dervish të ri. Pastaj Sadiu u kishte thënë myhibëve: ky dervish është si guri i bukur i përmbajtjes, ku e keqja nuk gjen të çarë ngado të vërtitet. Ndonjërit Sadiu i kujtoi fjalët e fundit të baba Jasharit, i cili paskësh thënë në kohën e shpirtit se do të kthehej në jetë me babanë e katërt. Gjithkush i dinte në Markesh ato fjalët e baba Jasharit të shenjtë, dhe ja tek ishte dervishi, që do të bëhej babai i katërt. Pëshpëritja si pa të keq e Sadi Pejzës ndezi edhe më fort mendjet e njerëzve, kjo gjë ishte tepër e madhe për t'u besuar, por as në dyshim nuk mund ta vije. Gjithsesi, myhibët do të kërkonin disa prova rreth profecisë, duke parë, duke pritur. Sadi Pejza, të cilit asnjëherë nuk i kuptohej mendimi, dukej se dinte edhe më rreth djaloshit, po nuk tha më tepër.

Kishin ardhur për vizitë kryetari e sekretari i komunës, komandanti i postës së xhandarmërisë, kryepleqtë. Pastaj erdhi togeri rezervist, Bedri Mëdyshi, që merrte rrogë prej mbretit, me Ratin, të vëllanë. Me një bujari të përmbajtur e sjellje të mirë i priti të gjithë këta dervishi i ri, duke i lënë të menduar.

II

Dervish Merxhani ndiente rreth vetes shtrëngimin, dëgjonte pëshpëritje me dy kuptime, i bënin shenja për afrim, i ngjante se merrte pickime të fshehta, brinjët ia fërkonin duar të padukshme; duhej të rrotulloheshin muajt që ai të kuptonte shkakun e një nxitjeje kaq të madhe, të pasionit dhe të kujdesit.

Puna paskësh qenë fare e thjeshtë, po edhe disi e jashtëzakonshme. Kjo kishte të bënte me luftën plot mëri e gjak të «dy paqëve» luftë për zgjaste prej

tridhjetë vjetësh. Se dikur këtu sundonte partia e Aqif pashës, ai hapi shkollën shqip në lagjen «Qytezë» në vitin 1909, ai ishte këtu edhe diell edhe hënë.

Në vitet e turbullirave të mëdha që shkuan, gjith-saherë shfaqej me trup armiku, Aqif pasha kishte thirrur nën armë Markeshin. Çdo herë kishin shkuar markeshasit me çetën, njëqind, njëqind e pesëdhjetë veta, dhe qenë kthyer të veshur e të armatosur, pleqtë, gratë e fëmijët u qenë sjellë luftëtarëve rrotull, duke prekur armët e veshjet e reja, një shpërblim i tillë e vlente shërbimin e gjatë, kur luftëtari i gjendet atdheut e në sytë e tij ndrit fitorja. Markeshi, shkonte në rrugët e Aqif pashës, duke parë «malokët» në të një patriot të urtë e babë të largët. Po më në fund plaku vdiq dhe Markeshi u mbyll me malet e veta, i rrethuar prej mërisë së atyre që qeverisnin në prefekturë e në Tiranë. Pyete një plak në Markesh përse është bërë filan vrasje në filan vit. Ai nuk do të flasë, ose do të flasë gjatë, me atë kokëfortësinë e patundur të pleqve, duke treguar se viktima kishte qenë kryeplak osë komandant në kohën e Aqif pashës, ndërsa vrasësi ishte i lidhur me dikë në prefekturë dhe me feudalin Vac. Pa e shtjellë tërë lëmshin me mendjen e tij, plaku nuk do të arrijë te dita e vrasjes, sepse pothuaj asnjë vrasje, djegie, grabitje e hapët, vjedhje, fyerje e rrahje, nuk ishin bërë gjatë tridhjetë vjetëve në Markesh, pa qenë e lidhur kjo tërthor me armiqtësinë e vjetër e të fortë të dy «partive».

«Partia» e vogël e mbretit kishte zënë prej vitit 1925 komunën dhe xhandarmërinë. Kryepleqtë anonin nga «partia» e Aqif pashës, prej kohës së të cilit trashëgonin pushtetin. Këta hiqeshin gjysmëfjetur-gjysmëzgjuar, mjaft të shkathët për t'u zhdukur kur i duheshin qeverisë dhe duke treguar një zell e gjallëri të dyshimtë kur arrinte komuna t'i vinte në dorë. Mbetej

teqeja. Ai që do ta hidhte nga ana e vet, mund t'i hapte telashe të rënda palës tjetër.

* * *

Dervish Merxhani nisi udhëtimet e para për provë e për ushtrim, u ktheu vizitat fiseve në lagjet «Qytezë», «Gjin» e «Denë», duke lënë mënjanë kryetarin e komunës dhe komandantin e postës së xhandarmërisë. Kjo u fol në kafën e Temës dhe u bisedua në çdo vatër. Njerëzit zunë të shihnin edhe më me kujdes lëvizjet e dervishit.

Në sjelljen e tij dervishi shihte përsëritjen e sjelljeve të dedeit të Teqesë së Madhe, kur Merxhani i ri i hiqte mushkën për kapistalli dhe dilnin në fshatra. Po shumë shpejt dervishi pa se në Markesh sjellje të tilla nuk ujdin dhe aq me vendin e me njerëzit dhe as me pozitën e tij si dervish. Atëherë i la rrugë të lirë natyrës së tij fshatare. Kjo liri që po merrte njëherësh, zuri t'ia sillte mendjen si një djaloshi që pi verë për herë të parë. E ndjeu shpejt se po e shihnin shumë më tepër njerëz nga sa shihte ai dhe u përmbajt. «Me ngadalë, o babë, — i tha vetes. — Lëvdatat, përkëdheljet e përuljet e të tjerëve, janë armiku më i keq, sidomos për njeriun që merr përsipër një punë.» Ai duhej të mendohej, të parashihte gabimet e rreziqet. Zuri të kufizonte pijen dhe këngët kur e thërrisnin për darkë dhe u ndie më mirë e më i sigurt.

Dervish Merxhani po nisej për në Bal, lagjja e katërt e Markeshit. Prej dy muajsh rrinte me mendjen ngritur për këtë vizitë. Bali ishte i padukshëm e i largët, përtej malit shkëmbor. Në mëngjes faqja e hatashme e shkëmbit merrte shkëlqim gri e të kuq, kurse

afër mbrëmjes dukej si qiriç i derdhur blu. Kur përmendnin Balin, njerëzit vinin buzën në gaz. Dervishit të ri i nxitej përfytyrimi edhe më tepër tek mendonte se aty do të shihte në shtëpinë e tij Sadi Pejzën, kryeplakun, me rrethin e fortë të myhibëve. Dervishi i zbriti mushkës poshtë në lumë dhe filloi të ngjiste ato tetëdhjetë e dy shkallët e qafës, shtegu i vetëm përmes malit shkëmbor, që ngjanin nga larg si një qepje e stërgjatë e një plage. Sa më lart ngjitej dervishi, aq më tepër duhej të bënte kujdes, sepse poshtë rritet humnera e frikshme, ku shpesh ishin zhdukur njerëz. Ai po gulçonte e djersinte dhe habitej se kur e qysh e patën hapur njerëzit këtë shkallë në gur, njëmijë metra të lartë, të barabartë në çdo kthesë, të matur me pëllëmbë. Lart, në qafë, u hap befaz shkëmbi, si nga një prerje e rëndë sëpate, dhe pak më tej u shfaq lugina e fshehtë e Balit, me ca të fshehta të tjera që do të zbuloheshin më pas. Dervishi zuri të kthente kokën nga të gjitha anët. Në jetën e tij s'kishte parë vend të tillë. Kjo ishte një grykë e butë, e freskët, dy-mbëdhjetë kilometra e gjatë, në trajtë kupe, ku ujë kish e ujë s'kish, sepse aty uji nuk ecën më tepër se dy hapa pa e pirë toka. Kurrkund s'mund të gjeje një burim, një rrëke, një pellg në atë grykën e çuditshme të Balit, pusët e rralla e të thella mbaheshin në kyç, ishin po aq të shtrenjta sa edhe oazet në shkretëtirë. Në juglindje lartësohet mali i Mërdhetës. Në korrik gratë e Balit ngjiteshin aty në mesnatë, në të përpjetën thikë, kërkonin gropat e dëborës. Në majat e shkëmbinjve diku shfaqeshin dhitë e egra, duke shikuar me dyshim të zgjatur prej kafshe bredhjet në gjysmerrësirë të grave tek mblidhnin dëborën, 40 kg dëborë, e mbështillnin me bar, e futnin në thasë. Në agim ktheheshin në fshat. Ajo dëborë do t'i mjaftonte secilës grua katër ditë, për t'u dhënë njerëzve të shtëpisë dy gisht ujë

të pastër. Buka kërkonte një rrugë pesë herë më të gjatë e më të vështirë. Sikur një mendje djallëzore të donte të shpikte një stërmundim për njeriun, do të krijonte Balin me atë blerimin e vazhduar, si një lojë tekanjoze të natyrës, si një parajsë të dhisë së kuqe.

Fshati ishte i hapur në anën e djathtë të luginës, ahurë prej guri, me çati të gjata të hirta bredhi, rrethuar me pemë. Shquhej shtëpia e madhe e kryeplakut, me katin e dytë prej dërrase e me ballkon. Në faqen tjetër të luginës dhe në shpatet e maleve ishin stanet e shumta.

Kryeplaku, Sadi Pejza, dyzet e pesë vjeç, me trup mesatar të thatë e të përkulur, me shikimin e njeriut të rritur në pritë, ishte veshur me rrobat e mira, me xhamadanin e bardhë të qëndisur me përdredhje. Në xhepin e vogël mbante sahatin me qostek argjendi. Me gajtanë anash i kishte edhe shallvaret e zeza. Këto zbukurime që do të dukeshin të tepërta te ndonjë tjetër shkonin më së miri me sjelljet e tij të ngadalta si të një zotnie bujar. Nguli këmbë që dervish Merxhani të ndërronte fanellat, duke thënë se djersa që thahet në trup është armik i shëndetit, dhe në zërin e tij të bukur ndihej tingulli i këngës. Ai e vuri dervish Merxhanin të rrinte në një karrige të rehatshme prej druri lisi të vjetër, si froni i ndonjë sundimtari. Dervishi hodhi sytë rreth dhomës. Sa herë hynte në shtëpinë e një fshatari, përpiqej të kapte atë bukurinë e fshehtë të banesës familjare. Secila shtëpi kishte shpirtin e saj. Në shtëpinë e kryeplakut, çdo gjë ishte ndryshe. Në mure ishin varur orendi druri dhe zbukurime, mbi dërrasat e dyshemesë, të latuara e të puthitura, ishte hedhur një qilim me ngjyra vjollcë e të kuqe. Në qoshe të dhomës ishin disa vegla me dru të verdhë, pjesë të ndonjë tezgjahu a të ndonjë shpikjeje

tjetër, të zbërthyera. Aty çdo gjë ishte vendosur dhe sajuar në mënyrë të tillë që të dëshmonte karakterin e veçantë dhe pushtetin e qetë të kryeplakut. Kjo vijonte edhe më tej, në bahçe. Nga dritarja dukeshin bari i njomë, pemët e harlisura, të mbjella me një rregull që nuk kuptohej. Gardhet, dy kasollet e bagëti-ve, udhëzat, edhe këto ishin bërë sipas ndonjë plani të ndërlikuar e të fshehtë.

Dervishi po buzëqeshte dhe kryeplaku e la të sodiste, pastaj e ftoi të uleshin mbi velenxat anës vatrës, i vuri përpara një faqore prej qelqi jeshil si pillakë të gdhendur anash, kurse për vete faqoren e kishte të bardhë. Këto duhej të ishin faqoret më të bukura në Markesh dhe rakia e thanës ishte e fortë e me erë të mirë. Hyri si pa u ndier një grua e re, që solli mezetë. Ishte truphedhur dhe e shëndetshme, me lëkurën të bardhë, me hundën të kërcyer, me sytë e zez tepër të mëdhenj, me shikimin e qetë të njerëzve që kanë një jetë të veçantë. Kur pa mysafirin, vetullat e forta iu ngritën hark, ra në gjunjë dhe i puthi dorën, me frymën e ngrohtë që i shkoi dervishit në gjak. Ky iu përgjigj mirëseardhjes i hutuar. Gruaja mund të ishte mbesa e kryeplakut, ndofta e ndarë prej burrit. Disa anë të jetës së tij kryeplaku beqar i mban-te mbuluar, në masën që i dukej e arsyeshme.

Si mbaruan drekë dhe pinë duhan, kryeplaku uli sytë, nënqeshi e tha:

— Njerëzit kujtojnë me dëshirë fjalët e baba Jasharit se do të kthehet me babanë e katërt.

Dervishit ia kishte zënë veshi një pëshpëritje të tillë, u turbullua dhe u përkul, që të shihte sytë e kryeplakut, të kapte diçka nga ato që thurte mendja e tij e fshehtë. A mos dinte ky ta shtynte në ndonjë punë të fandaksur?

— Besimtarët duhet të shohin se ka ardhur njeriu i ri i punëve të mira, — tha prapë kryeplaku.

— Punët e mira do t'i bëjmë bashkë, — tha dervishi, me një druajtje në zë. E kishte njohur kryeplakun vite më parë, në Teqenë e Madhe. Ky kishte treguar interesim të gjallë për të, që kur Merxhani ishte ende shërbëtor. Ndofta që atëherë e kishte menduar ta sillte baba në Markesh. Disa njerëz ndjekin në jetë qëllime të largëta. Dervishi donte të zbulonte qëllimet e vërteta të kryeplakut.

— Nazari, nuk u ktheve vizitat komunës dhe xhandarmërisë. Këto dhe ca punë të tjera të teqesë i ka pëlqyer populli, — tha kryeplaku.

Dervishi u skuq e u turbullua edhe më fort. Kryeplaku po e thërriste «nazari». Lëthe ajo gruaja e habitshme i kishte puthur dorën së bëhet me një baba teqeje. Kurse ai priste prej dy muajsh që ta thërriste kryegjyshata për ta veshur baba, po thirrja nuk vinte. Me kalimin e javëve fytyrat rreth tij ishin bërë dyshuese, pëshpëritjet prapa dyerve për këtë vonesë po ia lodhnin nervat. Tani ky Sadi Pejza po e quante punën të kryer. Dhe çfarë do të dëshironte ai të bënte më tej dervishi?

Kryeplaku e pa gjatë, si për t'ia forcuar zemrën, po edhe si për ta qetësuar. Kapsiti sytë, si për të thënë se hëpërhë nuk do të fliste më tepër. Ndenji prapë i përkulur, u duk sikur rënkoj dhe fytyra i mori më tepër dritë. Gëzimi që ndiente se me këtë dervish-baba do ta kishte teqenë pas vetes, ishte i madh. Po kënaqësia për hidhërimin që do t'u sillte kjo atyre të «partisë» tjetër ishte edhe më e madhe, një hakmarrje e gjatë dhe e ëmbël do të ishte, diçka që do t'u lindte befaz, që do t'u rrinte nën hundë për vite me radhë.

— A ia marrim një kënge, o babë? — pyeti kryeplaku.

- Si të duash.
- Vecse, çdo këngë këndohet ndryshe.
- Si ndryshe?
- Sipas kohës kur ka ngjarë. Po ia marrim Këngës së Togerit.

Fytyra e kryeplakut ngriu, si para një riti. Kërkonte në kujtesën e vet melodinë e një kohe të shkuar, të një ngjarjeje që i përkiste tokës së tij dhe që kishte vulosur diçka. Në fjalët dhe zërin e bukur, të pastër të kryeplakut kënga brodhi prapa, duke kapërcyer vitet me shpejtësi, nëpër shtigje të panjohura, e përcjellë nga tinguj që mund ta rrëfenin më mirë historinë. Dervishi pati dëshirë të bëhej një me kryeplakun dhe i ndenji gati në pritë, ia mbajti po aq bukur, duke e habitur, ia shtroi këngën me zërin e fuqishëm, drejt kohës së shkuar, kur erdhi togeri të merrte armët e Markeshit.

«Hysen bej Kocenska, togeri i Zogut, kishte ardhur në Markesh në vitin 1925 të kërkonte dorëzimin e treqind pushkëve. Ai u ndal te sheshi «Belik». Në fshat dhe në luginë nuk lëvizte njeri. Nga ndonjë anë lihte në tym një qen. I përgjigjej me maraz një qen në krahun tjetër. Po të mos lihnin këta qen, mund të thoshe se jeta në atë vend ishte shuar.

Togeri dërgoi xhandarë të thërriste kryepleqtë dhe të tjerët u ulën rreth sheshit, një kompani me xhandarë, me fytyrat e hutuara e në pritje. Ndonjëri tundte kokën me qortim për togerin, që e futi kompaninë në atë kazan të madh ku kishin vluar turbullirat. Ndërsa mund të kishte vepruar nga jashtë, me mend e me zgjuarsia. Ajo ishte koha kur zgjuarsia nderohej si një

virtyt i rrallë i prijësit, po togeri kishte ecur tërë rru-
gës si dem, duke thënë se do ta shtronte Markeshin
me kamxhik, duke mbledhur treqind belgjikët.

Togeri ecte poshtë e lart me duar prapa, ndërsa
nuk po dukeshin kryepleqtë, as xhandarët që shkuan
për t'i thirrur. Asnjë qen nuk po lihte më, u kishin
shkuar pranë të zotët. Koha ndërmjet pushimit të leh-
jes së qenit dhe shfaqjes së njeriut është e shkur-
tër. Tani njerëzit duhej të dilnin. Po s'kishte asnjë
shenjë se po vinin. Kompania rrinte rreth sheshit me
togerin përpara, me ndjenjën se një forcë e paduk-
shme armike përgjonte përmes gardheve e dritareve të
errëta. Shpresa e togerit që të shihte kryepleqtë para
tij me mushkat ngarkuar me armë, t'i shtronin mish
e raki, t'i bënë urime për Zogun, ta çlodhnin me çdo
mënyrë prej rrugës së gjatë e mundimit, t'i thurnin lav-
de të përlura trimërisë së personit të tij, kjo shpresë,
pra, bëhej përherë më e paqenë dhe qesharake, ndër-
sa ndihej afrimi i rrezikut.

«Zoti toger! Zoti toger!»

Hysen bej Kocenska ngriti kokën të dëgjonte këtë
thirrje të mprehtë që erdhi nga lart si tehu i një thike.

«Kush më thërret?» — u përgjigj fort, me një dri-
dhje në zë.

Ai dëgjoi tri krisma dhe ndjeu flakët e tyre në
trup, u praps dhe ra me fytyrë në pluhur.

Një aspirant i ri shkoi te togeri, ia ktheu fytyrën
duke ia marrë kokën në duar dhe e lëshoi ngadalë me
pikëllim. Ajo nuk ishte treguar një kokë e zgjuar.

Aspiranti shikoi shkëmbin që lëshonte një hije të
gjatë mbi shesh, prej nga erdhën tri krismat, dhe thi-
rri:

«Cilët jeni ju, çfarë kërkoni?»

«Hidhni armët! Mos u prishni, jeni të rrethuar», —
u përgjigj i njëjti zë i mprehtë.

Buzë kanalit që shkonte rreth lagjes «Qytezë», u shfaqën ngadalë burrat e Markeshit, treqind burra, fytyrat dhe armët e tyre të vjetra. Ky ishte një rrethim pa dalje dhe aspiranti hodhi armën. Ishte fitorja dhe festa e fundit e Markeshit.»

Ajo ishte edhe kënga e fundit për trimëritë e shkua-
ra. Sepse ky vend s'mund të jetonte i veçuar nga bo-
ta, se vjen dimri e duhen çuar bagëtia në kullotat e
ngrohta, duhet shitur e blerë në tregje të largëta dhe
atëherë fillon Zogu t'i thyejë brinjët Markeshit, duke
përçarë lagjet e fiset, nëpër rrugë të ngadalta po të si-
gurta dhe askush nuk dī të tregojë si erdhi çarma-
timi i popullit dhe zgjedha e xhandarit, si një e keqe
që punon në heshtje brenda trupit të njeriut, derisa
ta mposhtë duke i vënë kthëtrat.

* * *

Kishte rënë mbrëmja dhe kryeplaku shikoi ndër sy
dervishin, si për të thënë se tani ishte koha e tij. Edhe
pak dhe në dhomën e errësuar do të mblidheshin my-
hibët e Balit. Dervishi mendoi se kryeplaku ishte një
bektashi i fortë i besimit të vjetër, mund të ecje me
të në këtë rrugë, po ai edhe mund të kthehej me leh-
tësi, për gjëra të reja, që do të ujdinjin me qëllimin
e tij. Dervishi po bënte rojë nga kjo anë, me kure-
shtjen të ngritur, i gatshëm t'ia falte dredhitë. Ende
nuk po kuptonte se nga vinte fuqia tërheqëse e krye-
plakut.

Myhibët erdhën njëri pas tjetrit, nja njëzet veta, duke radhitur opingat e rënda te pragu i derës, pa ditur qysh të sillëshin me mikun në krye të dhomës. Ky ishte më tepër se dervish, më pak se baba, në një gjendje që u sillte shqetësim atij vetë dhe të tjerëve.

Kryeplaku foli me zë të ulët, po të qartë, me fjalë të menduara e të zgjedhura me kujdes:

— Ka ardhur ai që pritej prej kohe, duke sjellë të vetmin besim që mund të ketë njeriu. Lavdia e mësuesit i ndriti shtegun që e solli te ne. Do të na tregojë përse rrojmë, nga kemi ardhur e ku shkojmë.

Dervishi Merxhani tha:

— Ashkolsun erenler, — që kuptohej kështu: shpërblimi yt goftë dashuria hyjnore.

Myhibët morën niaz para dervishit, i puthën dorën, gjurin dhe zemrën, siç do të kishin bërë me babanë e teqesë dhe folën po ashtu, duke e quajtur «nazari im», u ulën të druajtur, pa guxuar të ngrinin sytë dyshues mbi të. Kryeplaku u përkul te dritarja, pa se nata po rrëshqiste heshtur mbi bahçet e shtëpitë, kjo gjë e kënaqi fort dhe mbylli kanatet, ndezi llambën me vajguri, çirakun që do t'u bënte dritë shpitrave të tyre, dhe e vuri me kujdes në qoshe. Ishte llamba e vetme në Bal dhe kryeplaku e huante për raste dasme. Ai e ngriti pak fitilin, duke e lënë dhomën e madhe në gjysmerrësirë. Drita u luhat mbi kryeplakun e kërrusur dhe u shqua buzëqeshja e tij. Dukej se ky njeri, që i kurdiste të gjitha, shikonte i sigurt në të ardhmen. Në çastin tjetër, pamja shlyhej, kryeplaku ndërronte, zvogëlohej, duke fshehur gjurmët e asaj që bënte aty më parë.

Dervishi duhej të fliste, u përkund mbi gjunjët dhe foli sipas asaj që donte kryeplaku:

— Njeriu ka ardhur në jetë me pëlqimin e zotit e për të qenë shëmbëlltyra e tij dhe do të kalojë në

jetën tjetër sipas punëve që do të bëjë në këtë botë, duke e pasur vetë në dorë të mirën e të keqen.

Sadi Pejza, që i rrinte në krah, tundi kokën me pëlqim, si për të thënë se aty e prapa do të shpjegohej po aq qartë e saktë çdo dyshim që kishte munduar shpirtin e myhibit. Këta pritën si të ngurosur të dëgjonin edhe më tej, si për herë të parë, mësimet që i kishin dëgjuar gjithnjë. Po, për habi, dervishi u kthye nga njeriu që i rrinte në krahun tjetër, një burrë dyzet vjeç, me trupin e rëndë të fuqishëm, me duart gjithë nyja mbi gjunjë. Ky dukej më tepër shkëmb se njeri, në fytyrë i shquhej karakteri i patundur dhe mendja e ngadaltë dhe, kur bënte çfarëdo lëvizje, kur të ngulte sytë që duhet t'i kishte të kaltër, ndieje urtësinë dhe shpirtin e tij të madh.

— Ty të quajnë Rahman, — i tha këtij dervishi, — që do të thotë njeri i mirë. Emri i një njeriu duhet të tregojë të kaluarën e tij, gjendjen e sotme dhe ato që do të bëjë paskëtaj.

Rahmani u rrëqeth, nënqeshi me zor, si për të kërkuar ndjesë që mbante një emër të tillë. Të tjerët pritën se mos dervishi po shpjegonte kuptimin e emrit të secilit. Që të gjithë ata ndodheshin aty me bindjen se i takonin një rrethi që ngrihet më lart se mendjet dhe punët e njerëzve, se mbi ta shtrihet një krah mbrojtës i panjohur, por që kërkon në të njëjtën kohë nënshtrim e bindje pa kushte dhe që duhet t'ia kesh frikën. Po dervishi nuk foli më tej për emrat. Rrinte kryeulur. Mendonte se njerëzit ishin kapur pas bektashizmit me shpresë të ndryshonin jetën e tyre të humbur, çfarëdo ndryshimi. Mendjet u nxitëshin edhe nga tregimet për përpjekjet fetare e atdhetare, nga heroizmat dhe mizoritë e shkuara. Si shoqëri e fshehtë, e mekur, këta prisnin një përtëritje, ngjarje të reja. Dervishi duhej t'u ngjallte shpresat, se jeta e çdo

dite, me rrjedhën e saj të fuqishme, e gërryente besimin, e bënte apatik myhibin. Po dervishi nuk dinte për cilat shpresa t'u flistë. Gjithsesi nuk do të niste me lutjet.

— Sonte, o shokët e mi, nuk do të bëjmë yqraqim, por do të flasim për shpirtrat tona, sepse ne jemi kopshiti dhe brenda nesh gjendet trëndafili.

Në fillim zëri i tij u duk i pasigurt, po shpejt mori kumbim, a thua se nisi një ligjëratë që buronte nga thellësitë e kohëve, duke përhapur mallëngjim. Foli për të katër portat që të çonin në qytetin e dijes, duke treguar lartësinë që arrin shpirti nga njëra te tjetra, për t'u takuar me vetë zotin. Aty vëllai myhib bëhet pluhur, arrin përsosmërinë.

Fytyrat e myhibëve po bëheshin përherë e më të ngurta, kalitëshin nën dritën e vakët. Mund të thoshe se brenda tyre ishte ndezur zjarri që përpinte në gjuhët e flakëve hijet e dyshimit. Shpirti dhe mishi i tyre po bëheshin një, nën shtypjen e besimit, bindjes dhe përljes. Dervishi shkoi përpara, duke folur për jetën që rikthehet pas vdekjes, duke hyrë shpirti i njeriut në kafshët, sipas punëve që ka bërë në të gjallë, dhe tregoi për Ali el Myrtezanë, që mbarti veten e vet pas vdekjes.

Dervishi kishte dalldisur pas tregimit që e kishte dëgjuar disa herë, por që për herë të parë e tregonte ai vetë. Befas zëri i vet iu duk si i huaj, një tjetër po fliste për të, duke thënë përralla të zgjatura. Ai pa rreth vetes fytyrat e zeshkëta të etura për besim, po në fundin e shpirtit të tyre gjithnjë do të mbetej dyshimi. Dervishi nuk e dinte se qysh i erdhi kjo goditje nga brenda dhe heshti, më mirë të mos hynte më tej. Në dritën e verdhë të llambës në heshtjen e thellë, myhibët po i dukeshin si njerëz që flinin ndenjurr. Ndonjëri lëvizi dhe ata u dukën siç ishin,

të shqetësuar e disi të hutuar dhe po aq të varfër sa çdo markeshas.

Kryeplaku po e shihte dervishin me vëmendje. Kroi zërin dhe tha:

— Destur nazari, leje të sjellin sherbetin.

* * *

«Njeriu vjen në jetë të bëjë diçka dhe del duke lënë diçka.» Kur u nis prej Balit për të shkuar në teqenë verore në Rrallenjë, dervish Merxhanit i dukej se ky mësim i shkonte pas shtatit. Hutimi në mbrëmjen e parë me myhibët e kishte munduar gjatë natës. Po në tri ditët që pasuan iu rikthye besimi se do t'u bënte njerëzve dritë. Tek udhëtonte nëpër lëndinat e në pyjet ku drurët mbulonin qiellin, dervishi krenohej me ato që kishte bërë e që do të bënte në të ardhmen. Shërbëtori që hiqte mushkën, ia forconte këtë bindje, me zellin e tij në shërbimet, me buzëqeshjen e vazhduar.

Dervishit të ri po i dukej se ngado që të shkonte, toka hapej para tij. Shërbëtori, që i dinte rrugët symbyllur, gjente vendet më të bukura të pushimit, prozimet e cektinat, ku uji buronte drejt nga bari dhe mund të pije duke u kthyer në brinjë. Dhe ishte qetësi si në kreun e botës. Pak më tej mund të ndeshje në një stan veror me kasollen majë gurit ose edhe lart në pemët, prej nga zbriste i veshur me lëkurë dashi bariu dhe fëmijët, për t'i puthur dorën dervishit, për t'i dhënë një enë me dhallë. Këtij i regëtinte zemra, ai do të kërkonte te bektashizmi e te njerëzit dashurinë dhe gëzimin që nuk e pati në fëmijëri. Shpirti i tij kishte banuar mbyllur, i stërvitur të mbrohej prej

çdo ngacmimi të jashtëm, me fytyrën në mur. Tani gjendej befasisht pranë tokës, drurëve dhe qiellit, që i shihte me mall të shtuar. Kishte zbuluar malësinë, më të gjallë e të vërtetë nga sa e kishte përfytyruar në tregimet dhe këngët. Kjo malësi, me ngjyrat e kaltra e të blerta, shtrihej në një hapësirë që s'njihte kufij. Dervishi ishte si njeriu që e gjen jetën me vonesë, një fëmijë 22 vjeç dhe porsi një fëmijë rrinte i menduar e i habitur para asaj që i shihnin sytë.

III

Bedri Mëdyshi, togeri rezervë, fliste dokrra, duke mbajtur si mjeshtër i hilesë, me atë nënqeshjen foddulle të njeriut të ngopur. Ta kishte ënda ta shihje tek bënte përpjekje për të qenë i zgjuar e i mençur. Në të vërtetë drejtohej prej interesit të tij si derri në krunde, dhe mund të bëje lojë me të, sikur të mos ishte Rati, i vëllai. Këtë dervish Merxhani e kishte kuptuar që në vizitat e tyre të para, ndiente se atë natë biseda e tyre do të merrte një fund të keq dhe sytë i mbante mbi Ratin, ndërsa fliste dokrra togeri.

— Ç'kuptim ka fjala dervish dhe hirka e tij si germa «A»? — pyeti togeri.

— Fjala dervish do të thotë pragu i derës prej nga shkohet në qytetin e diturisë, — u përgjigj qetë Merxhani. — Sa për kuptimin e hirkës, e the zotrote me gojën tënde, «a», Aliu.

Togeri e peshoi përgjigjen me sytë e rrudhur dhe mbeti fort i kënaqur. Rati nënqeshte. Sytë e tij të shkruar ruanin dervishin, të gatshëm të kapnin çdo lëvizje. Dervishi po bridhte prej disa muajsh si mëzi

i ri në lëndina. Rati kishte pritur, duke e lënë të bridhte. Po tani ishte koha që dervishi të merrte një drejtim. Rati foli ngadalë, tha se teqeja është kërthiza e vendit, kurse babai duhet të jetë mbi popullin e malësisë si markeshasi mbi delet e veta. Si tha këto, priti. Në fytyrë i lëvizi diçka, buza e sipërme, vetullat e trasha, dhe kjo ishte buzëqeshja. Për këtë njeri dhe vëllezërit e tij, për kullën e tyre të madhe të fshehur prapa shkëmbit lart në Gjini, pëshpëriteshin gjëra të rënda, fajde, vjedhje e vrasje të pazbuluara.

Dervishi zuri të fliste për punët që mund të bënte teqeja. Duheshin pajtuar gjakësitë, të ndaheshin davar-të ndërmjet lagjeve, të ndërtohej mulli, të hapej dër-stilë për larjen e shajakëve.

Rati e dëgjoi me kureshtje. Dervishi e mbante kokën mbi gjoks, nga e djathta, si një fetar i përvuajtur. Por sytë kërkonin diçka përtej gjendjes së tij. Kur fliste, buzët e kuqe i dukeshin si plagë gjaku në mjekrën e zezë. Ky dervish, ende pa u bërë baba, po tregonte se nuk do të merrej vetëm me rregullimin e lutjeve të myhibëve në teqe, po edhe me jetën e tyre jashtë. Rati ëmbëlsoi fytyrën, donte të kuptonte më tej, tha se punët e mira që kishte ndër mend dervishi duhej t'i kripte e t'i trazonte me leverdinë e teqesë dhe foli me durim për lidhjet që duhej të mbante e miqësitë që duhej të forconte. Hera-hërës ndalej, për të kuptuar se deri ku kishte arritur të nxiste përfytyrimin e dervishit, me sytë të ngulur në ballin e tij. Togeri rezervë hante meze me dorë, kthente gotën e rakisë, ngrinte gishtin mbi dervishin si për t'i thënë se pikërisht ashtu duhej të bënte. Rati e shihte vëllanë e madh me bezdi, me respekt të shtirë, vijonte t'i tregonte dervishit rrugët e teqesë, e përcillte bisedën me she-mbuj nga e kaluara dhe e bazonte në llogaritë e së tashmes, me gojëtarin, me dëshirën e fortë për ta sjellë

mendjen e tij në drejtimin e duhur, duke u hequr se po e miratonte. Ishte e treta herë që Rati bënte biseda të gjata me dervishin.

Dervishi ishte ngurtësuar. Gjërat në të cilat besonte Rat Mëdyshi ishin dredhia e mashtrimi. Ky dinte se qysh vërtitet e bëhet e keqja dhe e njihte si të vetmin ligj që drejton jetën. Rati e quante teveqel njeriun që e çmonte botën ndryshe.

Dervishi ndiente të nxehtë. Shikimi zotërues i Rati i ngacmonte nervat, ashtu si edhe të folurit e tij ledhatues, gati tallës. Nganjëherë e ulte zërin aq tepër, sa duhej ta pyesje çfarë tha dhe atëherë ai mund të thoshte një gjë tjetër në vend të asaj që kishte thënë dhe të kënaqej tek shihte hutimin e njeriut. Prapa kësaj fshihej kujdesi, ajo që bisedohej kishte për Ratin një rëndësi të madhe dhe aty-këtu sytë i bëheshin të ftohtë dhe të egër. Dervishi kërkoi me mendje një shteg për ta ndërprerë bisedën, i bëri shenjë shërbëtorit të sillte darkën, lagu duart me peshqir dhe zuri të thoshte lutjen, ibadetin: «Në emër të trashëgimtarit!... Sofra e Aliut ka ardhur... Lejë, o trashëgimtar... Le ta japë trashëgimtari... Le të hamë ne... Hu!» Lutjen e tha si një të drejtë që i jepej vetëm atij dhe që të tjerët duhej ta dëgjonin në heshtje, ta përsërisnin fjalë për fjalë në mendjet e tyre. Futi lugën në tasin e çorbës dhe zuri të hante ngadalë, pa ngritur kokë.

Rati e shikoi buzagaz, u hoq se ia pëlqeu sjelljen, ndërsa përgatiste me mendje hakmarrjen, foli me zë të lartë, tha se një baba i vërtetë, me një të rrotulluar të syve duhet t'i bëjë gratë të dridhen, të vërë burrat në zap, kurse fëmijët të bien në gjunjë e t'i puthin dorën nga larg.

Dervishi mënjanoi trupin, që drita e llambës të binte mbi fytyrën e Rati. Ky fshiu buzët, i shkeli syrin pa turp dhe tha:

— Dervishi i bën hasha gratë, nuk martohet, nuk lind fëmijë.

Dervish Merxhani hoqi duart nga sofrë dhe i mbajti në prehër. Për një çast mendoi se duhej ta përzinte Ratin. Po ai dhe vëllai i tij kryeneç e budalla ishin mysafirë të teqesë atë darkë dhe kishin sjellë cjamin dhe dervish Merxhani u përgjigj qetë, i habitur me veten, i kënaqur që mund të përgjigjej qetë.

— Haxhi Bektash Veliu, themeluesi, ka qenë i martuar. Djali i tij ishte Çelebi Ahmet Xheladini i shenjtë. Martesën e bëri haram Ballëm sulltani, që tha: Ne s'kemi fëmijë të veçantë, fëmijët tanë janë rrugët e botës.

Toger Bedriu kishte drejtuar trupin e gjatë me sytë në sofër, si një cjan që sheh të lëvizë para tij diçka e dyshimtë. Rati ia plasi gazit me zhurmë, pastaj ndenji si i menduar dhe tha:

— Jetë të rëndë bën dervishi. — Ai vetë e kishte çuar në teqe atë nusen nga Merqani që s'lindte fëmijë. Ishte e pashme dhe me zjarrin në gjak. Dervish Merxhani i mbajti tri ditë në teqe, atë dhe të ëmën, siç mbahen hallexhinjtë, u soll sikur ta ndiente kurthin. Ditën e tretë i kishte përcjellë duke i thënë së ëmës: «Kryegjyshi botëror mban një dorë grurë nga trasta e Haxhi Bektashit. Me një kokërr nga ky grurë vajza mbase edhe mund të lindë. Do ta lyp për shtëpinë tuaj kur të vete në Tiranë.» Rati po shihte me habi të vërtetë kokën rrumbullake të dervishit. Ky edhe në të ngrënë ishte i përkorë. Kur s'kishte miq, hante me dervishët e shërbëtorët në ashef. Dhe punët e teqesë i kishte treguar mirë e bukur në këshillë, pa lënë shteg për kundërshtime. Rati kërkoi sytë e dervishit dhe shikimi i tij iu duk armiqtësor.

— Jo ashtu, or babë, — tha Rati si me vete, duke lëvizur buzët, duke tundur kokën. Po e kërcënonte der-

vishin fshehtas, një kërcënim që duhej të mbetej ndër-
mjet tyre.

Dervishi lëvizi vendit. Iu duk se po shihte hum-
nerën e thellë të shpirtit të këtij burri, me shikimin
e zi në të verdhë, me një hije ndërmjet ballit dhe
mjekrës.

— Zoti jua shtoftë, — tha dervishi, duke lënë copën
e mishit në tepsi. E kishte nuhatur, e ndiente në
lëkurë se, për të ecur teqeja në rrugën e saj, në Mar-
kesh do t'i duhej të kalonte pengesa të vështira, po
nuk i kishte shkuar ndër mend se do të ndeshte me
njerëz të tillë.

Rati prapë ëmbëlsoi fytyrën me buzëqeshjen e uj-
kut. Ai kishte ndenjur me dy mendje për dervishin,
deri në ditën kur i thanë se u këndonte vjersha my-
hibëve, deri kur u bind se ky po bënte në çdo gjë
pas mendjes së vet. Po edhe atëherë prapë e ruajti
shpresën, se njeriu është pus i thellë, nuk dihet nga
cila ferrë të kërcen lepuri, dhe priti të shihte më tej.
Se ky ende s'i kishte mbushur 23 vjetët, një djalosh
i rritur ishte ky dervish, i tërhequr nga partia që
e kishte sjellë. Po nuk ishte e thënë që të mbetej i
tillë kur t'u hynte më thellë punëve të teqesë. Kjo
ishte ana e shpresës. Në anën tjetër rritej dyshimi.
Vërtet, tani dervishi i ngjante një demi të butë, po,
kur të vishej baba, mund të bëhej një ka i egër, duke e
drejtuar popullin bektashi në rrugë me telashe. Atë-
herë duheshin larë duart prej teqesë, gjë që s'mund
të bëhej kurrë.

Rati tha me vete se ky dervish nuk duhej të bëhej
baba, gjithsesi jo në teqenë e Markeshit. Këtej anon-
te mendimi. Po më mirë të pyetej për të me themel.
Nga hetimet asnjëherë nuk humbet njeriu.

IV

Ky vend ushtronte mbi të huajin një tërheqje të fortë, me ashpërsinë e vet, me diçka të fshehtë që ka të thotë e nuk kuptohet. Mjafton të shihje si ecnin njerëzit në të përpjetat ku të dilte shpirti, pleqtë, gratë, fëmijët: me hap të matur e të shpejtë, me trupin drejt, duke synuar majat, me shqetësimin e përherëshëm se ndërkohë mund të humbasin diçka nga ajo që duan të arrijnë. Udhëtimi ishte kushti i parë, nëpër rrugët e gjata që kishte hapur koha, sipas një trashëgimi që s'mund të ndryshohej: dhjetë orë për të shkuar në qytetin më të afërt në veri, dymbëdhjetë orë për në qytetin nga lindja, dymbëdhjetë orë për qytetet në jug e perëndim, a thua se Markeshi ishte qendra e dheut, matur me kut të barabartë nga të katër anët. Udhëtonin ngarkuar, burra e gra, me dyzet kilogramë në kurriz, shpinin pishë, lesh, bulmetra, sillnin drithë e kripë, me një durim të pafund, sikur të mbartnin një të fshehtë që e dinin vetëm ata, të mbuluar nën shitjen dhe blerjen. Ndonjëri e ndalte ecjen papritur, binte si i goditur nga një plumb i padukshëm. Ç'pāti? Dergjet njeriu. Është sëmure. Sëmundjes secili i bën ballë si të mundet. Po të ketë fuqi, do të dalë nga rasa që e ka zënë, në mos po... Është më keq kur i bie gëlbaza deles, zgjebja dhisë dhe, morri i madh i Markeshit s'i ndahet njeriut nga djepi në varr... Dhe gratë vishen si burrat, me «xhedik» (shallvare), me «muros» (xhakëtë), me xhamadan, po në vend të qeleshes vënë në kokë një shami të kuqe vajzat, shami të bardhë gratë, mbathin të njëjtat opinga, duart i kanë gjithnjë zënë, thurin diçka me shpejtësi, në rrugët e gjata me ngarkesën në kurriz, duke nxituar të arrij-

në banesat prej guri, me çatitë e gjata pa tavan, të ndezin pishën për ndriçim. Aty gruaja gjen pleqtë e pafuqishëm dhe fëmijët e zeshkët nga tymi e dëborra, ende me ndonjë pikë qumësht rreth gojës, aty ajo ndihet e zonja e vatrës, po prapë është burri ai që shtrëngon grykën e qeses si edhe jetën e familjes. Dhe në prill, kur markeshasi i çel syri me një dritë të re, një pjesë e burrave do të nisen argatë për kosë e bel, në Shijak, Fier, e deri në Janinë e Stamboll, dhe pjesa tjetër do të kthehet nga kullotat dimërore që të ngjitet në bjeshkë. Dhe kështu dy herë në vit, për shëngjergj më 5 maj dhe për shënmitër më 15 nëntor, zë e lëviz me furi jeta në Markesh, baticë e zbaticë, duke prodhuar me këtë lëvizje thasët e drithit, që janë qëllimi i vetëm, sepse familja më e fortë mezi arrin të nxjerrë pesë muaj bukë në rrepirat ngjyrë kafe veshur me gurë, «mërdhit misri» dhe në dimrin e gjatë fëmijët gdhihen pa bukë, duke pritur prillin tjetër, duke qenë jeta një histori e vjetër që përsëritet.

Zoti i madh e pati shikuar vëngër këtë vend dhe, kur ndau vuajtjet sipas viseve, ia mbushi Markeshit kupën plot. Vërtet i dha mundimin e përjetshëm, po edhe forcën e zgjuarsinë për t'i bërë ballë. Duket sikur këtyre gjaku u ecën më me vrull se njerëzve të tjerë, një racë e mirë që lindin aq sa vdesin, mbi ta vepron ligji i natyrës që zgjedh e ndryshon, të cilit i nënshtrohen bimësia dhe çdo gjë e gjallë në faqe të dheut, duke i shikuar ata këto ligje qetësisht, ashtu si edhe tokën e ashpër pas së cilës janë lidhur.

Dervishi i ri hapte sytë prej një viti për të kup-tuar këtë jetë të çuditshme të Markeshit, që rregullohej sipas diellit dhe lëvizte sipas stinëve të motit, në vetë gjirin e natyrës.

Ai zuri të mendonte se ajo që shihte në sipërfaqe

ishite diçka e paparë, por nën të lëvizte një Markesh i dytë, i drejtuar nga shkaqe të vjetra dhe që duhej zbuluar. Ai përpqej të shihte rreth tij me gjakftohtësi, të kuptonte ndërlikimet e jetës dhe kërkonte afrim me njerëzit. Këta, Markeshasi, janë njerëz të mbyllur. Gjendjen e tyre mund ta kuptosh deri diku nga sytë, që u bëhen të errët kur zemërohen, si ngjyra e tokës, ndërsa u bëhen të gjelbër në gri, si ujët e lumit Dron, kur qeshin e kanë gëzim. Dervishit i dukej gjithnjë më tepër se diku i kishte parë këta njerëz, që e shihnin nga ana e tyre përzemërsisht e me kurreshtje, duke i thënë se ia kuptonin hallin, sado i veshur dervish, ai qenkej në shpirt fshatar, ai ishte njeriu i tyre që kishte qenë larg, por që ende nuk ua dinte gjuhën. «Ani, or babë, do të mësoh.» Njeriu fliste vetëm me sytë, një gjuhë të vështirë për t'u kuptuar, që kishte të bënte me një krenari të lashtë të shtypur. Po kjo lidhej edhe me të tashmen dhe me një dëshirë për të parë në të ardhmen. Dervishi zinte e pyeste ngadalë e me kujdes, por në vitin 1934 njerëzit përgjigjeshin me gjysma frazash, ndofta prej lodhjes, mërzi së e druajtjes, që sjellin harresën. Nganjëherë dhe pa ndonjë shkak të dukshëm, njerëzit kalonin anash, si të egërsuar. Atëherë dervishi vriste mendjen, duke i thënë vetes se, që të zbutet njeriu e të afrohesh me të, duhet të dish përse është zemëruar.

Ai mbyllej në teqe, shikonte luginën e gjerë e të thellë nga dritarja me një shpresë të pacaktuar. Jashtë ishte një qetësi e thellë mbytëse dhe në teqe nuk hynte asgjë e vërtetë. Edhe vapa e korrikut ndalej te dritarja me mure të trasha. Ai nuk dinte nëse ishte rojtar, apo i burgosur. Nuk dinte t'i përgjigjej një pyetjeje të tillë, sepse, sado i lirë të bridhte, liria e tij do të mbetej jashtë jetës së njeriut.

Kishte ditë kur dervishi nuk bënte asgjë. Rrinte i plogësht, i zbrazët, i kohtë. Hapte sytë, a thua se çdo lëvizje rreth tij të qe ndalur befas. Kalonte koha që ha mishin dhe mendjen e dervishit. Por ai qëndronte aty e do të vazhdonte të qëndronte, me etjen e madhe për të parë e dëgjuar, sepse porsa kishte dalë në jetë. Mbase mërzia që e pllakoste hera-herës vinte edhe nga gjendja e tij e varur. Prej një viti ndodhej aty si dervish në këmbë të babait, punët që mund të bënte ishin të kufizuara dhe nuk i mbetej veç të mendonte për ato që duheshin bërë.

* * *

Fuqinë teqeja e ka në fshehtësinë. Ndonjëri hyn-te, të tjerë do të bënëin përpjekje për të hyrë dhe kështu ajo mbetej në sytë e në mendjet e të gjithëve, «saksia» rrëzë shkëmbit, ku mund të mbështeste kokën për lehtësim fshatari.

Dervish Merxhani kishte pranuar gjashtë talipë (kandidatë) dhe kishte afruar me teqenë një numër njerëzish, sidomos nga komuna e Korenës. Po lëvizte bektashizmi në Markesh, aty ku ishte ndalur ca vite më parë. Po edhe ekonomia kishte ecur më mirë gjatë vitit. Duke hequr dhuratat për kryegjyshatën, mbeteshin në arkë nja një mijë franga ari. Në këshillin e teqesë, Sadi Pejza, kryeplaku i Balit, i quajti këto punë fort të lëvduara dhe nguli këmbë që t'i bëheshin të ditura me anë të një letre kryegjyshit në Tiranë.

Të nesërmen e mbledhjes së këshillit, Galip Nuri, sekretari i ri, i vuri dervish Merxhanit përpara letrën për kryegjyshatën.

— Sadi Pejza ka të drejtë që ngutet, — tha sekretari. — Dua t'i çoj vetë dhuratat në Tiranë.

Dervishi lexoi letrën me shkrimin e bukur, aty-këtu me fjali të urta arabe, dhe ndenji duke menduar për sekretarin. Kishte pasur fat me këtë njeri. Që ditën e parë ky i ishte dukur burrë i rrallë, i këndshëm në bisedë, me vullnet, po edhe i matur, nga ata që mund të bëjnë çdo punë dhe rreth të cilëve do të dish gjithnjë më shumë. Kishte edhe një të kaluar me plot historira, për të cilat nuk fliste, ose fliste nga pak, me rast. Kishte bërë dy vjet shkollë fetare në Egjipt dhe qe marrë me punë tregtie në Turqi. Përse kishte ardhur ky në teqenë e Markeshit? Mbase kishte bredhur mjaft në jetë dhe tani donte të çlodhej, të mendohej.

— Përse ngutet Sadiu? — pyeti dervishi.

Sekretari po rrinte te dritarja, zinte dritën me trupin e madh, shikonte me vëmendje diçka në oborr dhe nënqeshte me anën e buzës për atë që shikonte. Ktheu fytyrën ndaj dervishit, me shikimin e qartë dhe hundën e kërcyer, u mendua një çast dhe tha:

— Po lëviz ajo ana tjetër. Sadiu i ndien me qimen e kurrizit.

Ndërsa dervishi nënshkruante letrën, erdhi Habidi, vëllai i vogël i Rat Mëdyshit, dhe ndenji në fund të dhomës, me trupin e ngjeshur, me këmbët e forta, duke parë qetësisht sipër kokës së dervishit. Më në fund foli, tha se vëllai i madh, Bedriu, e ftonte për darkë dervish Merxhanin.

— A do të shkosh, nazari? — pyeti sekretari, kur doli djaloshi.

— Doemos, — u përgjigj dervishi.

Galipi u zbeh lehtas, nënqeshi dhe tha:

— Veç hap sytë në gjellën që do të të vënë përpara.

Afër mbrëmjes dervishi u ngjit në të përtpjetën e vështirë të lagjes «Gjin» dhe pa nga afër kullën e madhe të Mëdyshajve, që rrinte mbi Markeshin si një gur mulliri. Kulla e gjerë dhe e lartë, si e mbështetur në shkëmbin e madh, i kishte muret të trasha, të hirta dhe rreth e qark ishin ahuret, mullarët me bar. Pësëqind dhi i mbanin në kullota, po bagëti të ndryshme kishin edhe aty afër. Dhe kishin toka buke në pllaja e pjesë në pyjet. Të gjitha këto ishin nën sytë e të gjithëve dhe prapë askush s'mund të thoshte se e dinte pasurinë e tyre. Se këta nuk shkonin kurrë dy herë në të njëjtën rrugë dhe dukej sikur edhe nga barku i nënës dilnin fshehtas. Këta e shikonin fatin e tyre të mirë si të rrethuar nga rreziqe të qena e të paqena dhe rrinin të lidhur fort brenda tyre. Dhe ishin të pangopur. Sado i varfër fqinji, gjithnjë do të kishte diçka që u duhej Mëdyshajve. Tej kullës, prapa majës, shquheshin muret e rrënuara të kalasë së vjetër, ku kalonin burrat e Mëdyshajve në kohë armiqësie e rreziku. Po në vitin 1934 ata nuk i kërcënonte asgjë. Ata vetë, katër vëllezërit, kushërinjtë dhe miqtë e tyre, ishin një kërcënim i heshtur e i vazhduar jo vetëm për Markeshin. Këto tashmë i kishte mësuar dervish Merxhani, e dinte se ku shkonte, po ai e kapërceu pragun e kullës duke i thënë vetes se një dervish duhet të jetë zemërçelur edhe për njeriun e prapë dhe të ketë në mendje paqësimin dhe mbarëvajtjen e popullit. Në të njëjtën kohë një zë i dytë i thoshte se po shkonte aty edhe për t'i parë si ishin nga brenda dhe për t'u treguar se nuk ua kishte frikën. Tek ngjiste shkallët, pati ndjesinë e çuditshme se rreth asaj kulle lëpiheshin gjuhë të fshehta zjarri.

Në krye të sofrës zuri të ndante mishin me duar togeri rezervë, Bedriu, duke i dhënë kohë Rati të sodiste buzagaz dervishin. Rati u bind në pak minuta se

ditët e fundit s'kishte ndodhur në teqe ndonjë gjë që të mos e dinte dhe vazhdoi bisedën. Dy vëllezërit e tjerë, më të rinj, Esadi dhe Habidi, rrinin si të mër-zitur, po edhe të gatshëm të argëtoheshin ndopak me dervishin. Ky nisi të pinte faqoren e vet, duke rrahur të kuptonte shkakun e thirrjes për darkë, sjelljen e butë e lajkatare të Rati. Në sytë e këtij lëvizte heraherës ajo drita e ftohtë e syve të gjarprit që i ndjell viktjmës gjumë, dervishi tha fjalët që duhej të thoshte dhe ndenji duke pritur, me duart shtrënguar në prehër.

— U rrotullua viti dhe sytë tanë nuk po gëzohen duke të parë baba të teqesë, — tha Rati dhe fshiu syrin sikur të ndalte një lot. Togerit shikoi në sofër, si me kokën bosh. Dy vëllezërit më të rinj hëngrën mish dhe vunë buzën në gaz.

Dervishi ndjeu të nxehtë, shikoi Ratin dhe tha:

— Kur të bëjë ymër këshilli i lartë.

Rati psherëtiu si i merakosur. Po lozte haptas një lojë të pështirë, u duk i shqetësuar dhe tha se dikush duhet t'i shtynte punët në Tiranë. Si tha këtë, ndenji në përgjim. Dervishi ndjeu atë fërkimin në brinjët. Në tre muajt e fundit Sadi Pejza kishte shkuar dy herë në Tiranë. Po edhe Rati nuk duhej të kishte ndenjor duarlidhur. Armiqtë e vjetër bënin një luftë të mbuluar me thika prapa krahëve të dervishit. Kishin ardhur ditët e rrezikut.

— Shëndeti i lartmadhërisë, Zogut të Parë, — tha Rati nëpër dhëmbë, duke ngritur faqoren. Dervishi hëngri mish, pa e luajtur faqoren e vet. Rati nënqeshi, duke menduar se miku e urrente fshehtas mbretërinë, mbase pa e ditur as vetë. Se kjo vinte nga fëmijëria e dervishit, nga koha kur u nda prej vatrës së shtëpisë, gjë që një fëmijë s'ta fal kurrë, as kur rritet, edhe po të dojë. Rati gëzonte nga brenda. Tani dinte çdo

gjë për të kaluarën e dervishit. Do ta rrëzonte, do ta bënte pluhur këtë dervish mendjemadh. Po le të hante aty darkën e fundit dhe të ikte në paqe, që as të mos dyshonte se nga i erdhi goditja.

Njëqind e tetë vjet më parë, sulltan Mahmudi II, gjakësori i madh dinak, po lëkundej buzë fronit. Sa kohë të qëndronin rreth tij jeniçerët, pushteti i sulltanit do t'i ngjante një tyrbeje me shkëlqim të rremë, ku udhëtari mund të hedhë një pare, po të dojë. As financat, as ushtria e re nuk do të rregulloheshin kurrë dhe çdo pasha i largët mund të shpallej mbret më vete porsa të gjente rast për ta bërë. Kështu do të vinte perandoria, derisa të shembej krejt, sa kohë të qëndronin rreth fronit jeniçerët. Erdhi çasti që sulltani të shfarosë të pesë mijë jeniçerët në Eitmejdan me një të ulur të krahut. Po ata kishin dalë nga mënga e Haxhi Bektashit, ata do të mëkëmbeshin prapë, po të mos shkatërrohej bektashizmi, shtrati dhe shpirti i tyre. Baballarët bektashinj i kishin prishur mendjen Mehmetit II, që ishte më i ndrituri i sulltanëve, i kishin mbajtur krahun Sulejmanit të Mrekullueshëm, i kishin prerë kokën Selimit III me jataganin e pjellës së tyre, jeniçerëve. Punët e tyre s'kishin të sosur. Tani sulltani do të merrte hak për pesë shekujt e shkuar dhe do të shpëtonte veten.

Ai lëshoi një fetva që të viheshin në hunj kokat e njëzet mijë baballarëve e dervishëve, duke gëzuar së tepërmi ulematë suni. Për shtatë vjet vazhdoi gjue-tia e egër në tërë perandorinë. Disa pashallarë ranë në hall, nuk po plotësonin numrin e kokave dhe ndonjëri e çau më dysh e më tresh gurin e varrit të

një dervishi, duke e vënë secilën pjesë të gurit në një hu të veçantë. Një pashai mund t'i ndriste fati, sikur të vinte në hu kokën e një babai me taçin jeshil. Po, në mungesë, bënte punë edhe një dervish, një bektashi i thjeshtë, e një strehues i kokave që kërkoreshin.

Një natë dimri, në ato vite kur vënia e kokave në hu s'kishte të sosur, një dervish i ardhur nga larg, përgjysmë i vdekur, trokiti në derën e familjes Dalipi në fshatin Buz i Madh. I pari i asaj shtëpie pa se rreziku i erdhi nga një anë që nuk ia priste mendja, kur dervishi, i ndjekur prej qeverisë, kërkoi strehë e besë.

Dervishi qëndroi aty një muaj dhe tha se në natën e errët plot gjak e tmerr që kishte rënë mbi bektashizmin, gjendeshin mbi tokë kështjella të padukshme që do ta shpëtonin. Këto ishin si gurët e çmuar në rërën e Arabisë dhe nëpërmjet tyre do të rikthehej bektashizmi, më i fortë se ç'kishte qenë. Ai ishte një folës i urtë dhe tregoi se nga vinte e ku shkonte njerëzimi, foli me mallëngjim, net me radhë, me atë zërin e dervishit të ushtruar që në fëmijëri, që turbullon shpirtat me forcën e magjisë e të misterit, duke lënë për në fund zbulimin e së fshehtës, që ishte si parja e bardhë në gjirin e lakrorit. Dhe erdhi nata kur tre vëllezërit dolën para dervishit me litarin në qafë dhe ky u dha «dorë», sipas rrethanave e duke sajuar mjetet që i mungonin dhe, në netët që pasuan, morën «dorë» djemtë, nipat, gratë dhe ajo shtëpi e madhe u kthye në një faltore të Aliut. Dervishi u përcoll për të rrahur rrugën e botës, kurse burrat e asaj shtëpie ende s'po e merrnin veten prej habitës. Ishin si të dalë prej një ëndrre të zgjatur, kishin rënë në gjunjë para një dervishi të fandaksur dhe qenë ndryshuar, qenë bërë edhe një herë të huaj në mes të fshatit Buz, si pesëdhjetë vjet të shkuar, kur erdhën aty prej Kruje të shpërngulur për punë gjaku.

Deri këtu hetimet ishin të mira për dervishin e ri. Ky rridhte prej një familjeje të vjetër bektashiane, që hynte në radhën e faltoreve të para. Kjo anë e jetes së tij as që duhej përmendur në letër. Lënda për letrën vinte më pas. Një letër është e fortë sa kohë nuk e ke lëshuar nga dora. Rati gëzohej që nuk ishte shpejtuar. Tani mund të shkruhej se në vegjëli dervish Merxhani kishte qenë një jetim rrugaç, kushëri i parë i kapitenit rebel të varur prej mbretit. Shtëpia e tyre ishte djegur në vitin 1924. Pra, që këtu fillonte jetëshkrimi, historia. Rrugaci i strehuar në Teqenë e Madhe s'kishte pasur besë myhibi në djalëri. Të dyshimta mbeteshin edhe miqësitë e tij të asaj kohe në qytet. Le të pyeteshin dy dervishët e Teqesë së Madhe, Faiku e Mevlani. Sa për këtu në Markesh, ky u këndonte myhibëve vjersha kundër mbretërve e sulltanëve. Nuk e pinte dollinë për Zogun e Parë (ka dëshmitarë). Pijanec, këngëtar, qejfli, idhnak. Këto besohen lehtë. Po t'i jepej kohë, do ta bënte rrush e kumbulla pasurinë e teqesë, nga e cila kishte flakur në rrugë shërbëtorët besnikë. Myhibë nga Merqani (mund të përmenden emrat) ankoheshin se nuk u jepte rrugë halleve të tyre, as ujë trazuar me dheun e teqesë nuk u jepte të pinin. Me këto e me ca shtojca të tjera, me një lëndë të tillë, pra mund të thurej një ankim e një qarje aq e gjatë, sa për të rrëzuar tre dervishë. Rati e piu gotën me fund, i qeshi gjithë fytyra, përveç syve, tek tha se kishte ardhur koha, një kohë e gjatë kishte kaluar, që dervishi të vishej baba, ndërsa me mendje sajonte letrat, njërën për te miku i madh në prefekturë dhe tjetrën për në Tiranë.

V

Kryegjyshi botëror, Sali Niazi Dedei, fjalëmbël e i përlulët, me atë përkuljen e zotit të teqeve të pasura e të shumta, ati i dyqindmijë bektashinjve në Shqipëri dhe i shtatë milion bektashinjve në botë, e dëgjoi në heshtje Sadi Pejzën, kryeplakun e Balit, dhe tha:

— Është shumë i ri.

— Prandaj mund të jetë i mirë, — tha kryeplaku.

U duk sikur kryegjyshi nënqeshi lehtë, ndërsa shih-te me një kureshtje që vinte si nga larg këmbënguljen e malësorit. Ky kishte ardhur edhe dy herë të tjera, duke pritur me durim të gjatë prapa dyerve. Kësaj here kishte sjellë edhe dy cjep të kuq, si kuaj të vegjël, me të cilët ishin habitur të gjithë.

— S'ka ngjarë ndonjëherë që populli të zgjedhë, e ca më tepër të caktojë babanë e teqesë dhe as parashikohet në ligjet e vjetra një leje e tillë, — tha kryegjyshi.

— Pse të mos gëzohet zemra e një populli që ka vërë kokën te dera e teqesë? — tha kryeplaku.

Kryegjyshi mendoi se këta malësorë të largët kishin një kokë më vete. Këta mund të ishin besnikë të vërtetë, po mund të bëheshin edhe kundërshtarë që hapnin telashe. Kryegjyshi ndenji me sytë ulur, si i shkëputur, ndofta duke menduar për gjëra të tjera. Për një kohë, në heshtjen e thellë, u dëgjua vetëm tespiku që kalonte në dorë, me tingullin e një guraleci që bie në ujë. Kryegjyshi ngriti sytë dhe u duk si i argëtuar me këmbënguljen dhe përluljen dinake të kryeplakut tha:

— E si ta dimë mendjen e popullit? Dhe veç asaj është shumë i ri.

Kryeplaku mendoi se erdhi ujë në mullirin e tij. Po

ruk lëvizi. I ndjeu si të gjalla letrat që mbante në gji. Ai kishte bredhur në fshatrat, duke fshehur gjurmët e bredhjeve të veta, që të bindte kryepleqtë të vinin vulat. Po lutjet me vulat do t'i nxirrte më pas, si armë të fundit.

— Le të jetë i ri, — tha prapë kryeplaku buzagaz. — Pa qenë i ri nuk bëhesh i vjetër. Ai zuri të tregon-te edhe një herë, ngadalë e me mallëngjim, punët e mira të dervish Merxhanit. Ishte folës i zoti dhe fjalës së tij i jepte edhe më tepër forcë dëshira për të arritur doemos qëllimin. Kryegjyshi u zgjat të shihte më mirë fytyrën e malësorit, që dukej e fshehtë dhe e pakapshme, ndofta ngaqë e mbante kokën mbi kraharor dhe kishte një mënyrë të tijën për të treguar vetëm sytë e mprehtë. Në atë që kërkonte kishte vënë shpirtin. Ç'illoj njeriu ishte ky kryeplak? Dhe sa ditë rrugë kishte bërë me ata cjeptë në male?

— E besoj se nisësh nga qëllime më të mira, — tha kryegjyshi duke hedhur lart kokën e ditur, madhështore, me mjekrën dhe mustaqet e bardha. — Po puna duhet të peshohet në këshillin e shenjtë të baballarëve, që mblidhet në fund të muajit tjetër. — Ngriti duart, si për të treguar se ç'ishin për të thënë, u thanë, i habitur që e la veten të tërhiqej aq gjatë në bisedë.

Po Sadi Pejza nuk luajti vendit, veçse fërgëllloi trupin e tij i paktë. Mati kohën me mendje dhe foli me një zë ku ndihej nevoja e ngutshme:

— I qofshim falë këshillit të shenjtë. Po nazari le të dijë më parë mendjen e popullit. Kemi prova për dëshirën dhe vullnetin e patundur të popullit.

Kryegjyshi hapi sytë. Ndofta kishte edhe një notë kërcënimi në lutjen dhe mallëngjimin e kryeplakut. Po ky nuk i la kohë të mendohej. Nxori nga gjiri një tog me letra, eci gjunjazi dhe ia shpalosi përpara me kujdesin e njeriut që mbart një amanet të rëndë.

Kryegjyshi i pa letrat me dyshim. Ishin tetë lutje të kryepleqve të Markeshit, Merqanit e Korenës, me vulat, firmat ose shenjat e gishtërinjve, duke kërkuar të njëjtën gjë. Kryegjyshi ngriti sytë mbi kryeplakun. Po ajo që e habiste edhe më shumë ishin vetë letrat, secila me të tjera fjalë e tjetër shkrim, po vepër e së njëjtës penë. Kryegjyshi lidhi duart në prehër dhe shqiptoi atë frazën që u përhap në gjithë teqetë.

— Atëherë paçi veten më qafë.

Kryeplaku i puthi dorën dhe të dy gjunjët, po nuk i ngriti sytë më lart. E kishte pritur me vite këtë ditë. Kënaqësia që ndiente se më në fund ia hoqi rrogzin nën këmbë asaj palës tjetër, ia mbante frymën të zënë. Padashur kryegjyshi i vuri dorën mbi kokë.

Për Sadi Pejzën tani fillonin ditët e ethshme. U kthye në Markesh dhe hapi fjalë se dikush po nisej për në veri, ndërsa përgatiste dervish Merxhanin për në jug. Në Tiranë u bënë gati rrobat dhe pas dy javëve kryeplaku kthehej përsëri në Markesh, duke ecur prapa mushkës së baba Merxhanit, prind i teqesë në lagjen «Qytezë» dhe i teqesë verore në Rrallenjë, duke i zënë me këtë pamje bashkëfshatarët në befasi të plotë. «Paçi veten më qafë.» Kryeplaku i nënqeshte vetes. Ky baba ishte shpresa, fat i mirë për partinë e vjetër e për Markeshin. Veçse, tek ecte tani prapa tij, kryeplaku zuri të ndiente një ndikim të ri. Trupi i babait në mushkë po i dukej si i rritur befas, si një njeri që ecën drejt një të panjohure të largët. Gjatë dy vjetëve, kryeplaku kishte qenë gati të shkrihej për ta bërë këtë djalosh baba. Tani që ia arriti po i dukej vështirë ta brumoste sipas shijes së vet. Kishte vënë re prej kohe se Merxhani të dëgjonte me kujdes dhe pastaj bënte si dinte. A do të mundte të drejtohej mendja e tij aty e prapa duke i fryrë lehtas në mjekër, aq lehtë sa këtë të mos e ndiente as vetë?



* * *

Taçi me rrethin e gjerë jeshil, sikur aty të kishte mbirë një bar i imët, mbulonte kokën e babait të ri, hir-ka e bardhë i arrinte gjer në fund të këmbëve; në brez shkëlqente guri i kaltër, si një yll i gjithësisë. Kjo veshje e dalë nga duart e usta Qamilit, terzi i kryegjy-shatës, kishte ndryshuar sjelljen e të tjerëve ndaj baba Merxhanit. Pa dyshim rrobat i rrinin mirë, një baba i pashëm, po njeriut i mbetej diçka në sy, dukej sikur trupi i tij i shëndoshë bënte një jetë tjetër brenda veshjes së re. Këtë gjë e që shihte në sytë e fshatarëve e ndiente edhe vetë dhe i sillte shqetësim. «Eh, nuk është e lehtë të ndërrosh lëkurën», — tha dervish Hasani i vjetër, që preku rrobën e babait, e shikoi nga afër me sytë e dobët dhe u tërhoq i trembur për guximin e tij të tepërt. Kjo ndodhte në ditët e javët e para. Pastaj myhibët zunë të shihnin se me këtë veshje plot bujë babai kishte dalë vërtet nga lëkura e dervishit, ama kishte mbetur po ai njeri. Dhe, nëse kishte ngjarë një ndryshim, kjo lidhej me atë dritën e re në sytë e zez, me pushtetin që mori, të cilin do ta përdorte për punët e veta më fort se më parë. Dukej se ai do të bënte si baba disa ndryshime të rënda që i kishte menduar gjatë si dervish.

— Të bëjmë një ligj, që nusja të blihet njëzet napolona dhe një napolon për shkuesin, — tha në mble-dhjen e myhibëve.

Burrat u menduan. Ky ishte një ligj i mirë. Dikujt s'i kishte mjaftuar as gjysma e katandisë për të blerë nusen, që paguhej 30, 50 e deri 80 napolona, sipas fi-sit, bukurisë e shëndetit. Burrat po habiteshin që nuk e kishin menduar këtë më parë. Buzëqeshën.

— Kush ta blejë më shumë, mos e gëzofte, — tha babai.

Për atë grindjen e vjetër ndërmjet lagjeve «Qytezë» e «Denë» babai tha:

— Luadhet që kositen t'i mbajnë ata që i kanë, Varoshin ta kullosë gjithkush.

Ndërsa shqiptonte këto vendime, myhibët mbanin fyrmën, në mejdan-evi nuk zukaste mizë, rritej babai i ri, me hirkën që e mbante në supe si një send të tepërt, me taçin mbi kokë, simbol i pushtetit të tij... «Se nderimi që më bëni mua është për atë prej Horasani që mungon. Ditën që do të pushojë ky nderim, pushon së qeni besimi ynë, shpresa dhe shpëtimi.» Dhe kështu, në prani të tij nuk do të lëvizë më as miza dhe fjala e tij do të jetë ligji, duke dhënë myhibët për secilin ligj pëlqimin.

Pas Shëngjergjit babai foli për gjakësitë.

— Një qetësi e rreme sundon në Markesh, — tha. E nisi me vrasjet e mëdha të shkuara, ngriti gishtin mbi vrasësit e padukshëm, po nuk përmendi emra. Tregonte ngjarje që i dinte gjithkush, veçse këto vrasje s'qenë dukur ndonjëherë aq të dëmshme sa po i tregonte ai. Tha se për çdo njeri diku përgjon një grykë pushke, teqeja duhet ta lironte njeriun prej frikës dhe të shuante gjakësitë, kësaj pune do t'i hynte ai vetë, duke trokitur në derën e secilit.

Myhibët ndenjën kokulur, në shenjë pranimi, siç bën ai që nuk do dhe nuk mundet të kundërshtojë, me një peshë të zemër, sepse babai i ri po merrte mbi vete një punë pa krye. A mund t'u hidhje burrave ujë në gjak? A mund të shuaje varret nga mendja e tyre?

Babai shkoi në Korenë dhe ndenji dyzet ditë. E nisi duke pyetur të zotin e shtëpisë për shëndetin e tij e të bijve të tij, për secilin e të gjithë bashkë, për

dhitë e për kafshët e punës, për motin e për rrugët, duke mbetur larg qëllimit të vizitës, duke i hapur një-ri-tjetrit zemrat, për punë që u përkasin miqve të afërt dhe që vetëm këta duhet t'i dinë. Pastaj vijonte biseda për ndodhitë në fshatra e qytete, duke u afruar si padashur te çështja për të cilën qe therur dashi. Po kau prapë nuk zihet nga brirët, dikujt më parë duhet t'i marrësh mendjen krejt dhe pas darke babai do të këndonte këngë të vjetra bektashiane e do të lulezonte më tej biseda me histori nga e kaluara, duke u ngushtuar rrethi përherë më tepër, duke u bërë i pamundur kundërshtimi. Në mbarim të dyzet ditëve s'kishte mbetur gjak a mëri e pafalur në Korenë. Baba Merxhani kishte fituar. Kishte ndodhur një mrekulli, duke mbetur e habitur vetë Korena dhe fshatrat rreth e qark.

«A kishte bërë babai i ri lutje, hajmali e falje të fshehta? A kishte kënduar magji me gojë e me shkrim?»

«Jo, ky veç hapte bisedë, me fjalë që nuk çmohen, dhe as që mund t'i tregojë njeriu, gojëmbël e i ditur, i këngës e i rakisë, asnjë burrë nuk mundi dhe as deshi t'ia thyente zemrën, ai ka lënë veç miq për kokë në Korenë.»

Ndonjëri nënqeshi hollë, duke e pyetur fqinjin nëse i takonte babait të teqesë t'i hiqte njeriut të drejtën e shpagimit. A do të rrinte ky baba në vendin e vet, apo do të bridhte nëpër ahengje, duke shuar shërrët e pulave e duke ndrequr hunjtë e gardhit të secilit?

«Paçi veten më qafë!»

Kryeplaku i Balit pëshpëriti edhe një herë në kafe të Tomës ato fjalët e shpirtit të baba Jasharit se do të kthehej në jetë me babanë e katërt. Të tjerët mbetën të menduar. Nuk u kujtohej që baba Jashari të qe përmendur për gjakësitë.

Babá Merxhani qe nisur prej Korenës me mendimin se pajtimi i gjakësive do të qëndronte. Ai kishte fituar në këtë pikë. Po veç gjakësive ishin edhe grindjet që silleshin e përdridheshin rreth lagjeve, kullotave e gardheve, me ecjen të mbuluar dhe që asnjë baba nuk do të mundte t'i fshinte kurrë. Ai parashihte vështirësi për pajtimin e disa gjakësive në Merqan e sidomos në vetë Markeshin.

VI

Bota sillej rreth Markeshit, duke e lënë këtë krahinë të largët të ecte me hapin e heshtur të opingës, në rrugët e veta që nuk arrinin në asnjë vend. Njerëzit ngrinin sytë nga toka e tyre e fortë dhe dëgjonin tingujt e pëshpëritjet që vinin nëpër të katër grykat e luginës. E rëndësishme për ta nuk ishte vetëm buka.

Pritej viti i ri 1936, por, kur erdhi, as që u vu re. Gazeta thoshte se qeveria kishte lejuar bixhozin në lokale, duke shkaktuar një gëzim të madh të popullsisë. Në rrugët e Tiranës lejohej ecja vetëm në krahun e djathtë, që të mos përplaseshin qytetarët. Italia përparonte në Abisini, nën brohoritjen e shtypit shqiptar. Dukej sikur disa gazetarë ishin gati të niseshin me bomba në duar e t'i bënin fërtele abisinin që i qëndronin me egërsi qytetërimit fashist. Sekretari i komunës, tuberkuloz dhe që po nisej prapë me leje të gjatë, tha në kafën e Tomës, duke lexuar gazetën, se për shkak të aviacionit, nëndetëseve, tankeve, topave 420 milimetër dhe sidomos të gazrave helmuese, në një luftë botërore nuk do të mbetej njeri i gjallë kudo që të fshihej. Ata që e dëgjonin, më fort për mirësjellje

ndaj të sëmurit, kërkuan disa shpjegime rreth këtyre mjeteve ushtarake. Pasi i dëgjuan, menduan se kjo lloj lufte ishte e largët, pothuaj e pamundur, si një re që vërtitej në skajet e botës. Sekretari i shpenzoi më kot dituritë e tij në teknikën e re dhe politikën e shteteve dhe doli të pështynte gjak te pragu i kafes.

Këto dhe lajme të tjera të këtij lloji kalonin rreth pyjeve të Markeshit si frymë e një bote të huaj të fandaksur dhe përcilleshin me habi, duke buzëqeshur. Njerëzit edhe mund të besonin në mrekullitë, si fëmijët, me një etje të vjetër. Gjithsesi këto ndodhnin larg dhe njerëzve u dilnin nga mendja në çastin tjetër. Po nganjëherë lajmet ishin të tilla që të ndalnin lëvizjen edhe këtu, dhe të niste për pak kohë biseda e zjarrtë, duke u kujtuar pastaj se edhe kjo paskësh qenë fare e kotë.

Në mesin e janarit po shkrinte dëbora e paktë. Në sheshin e vogël të lagjes «Qytezë» rridhnin ujërat, duke kërcyer mbi gurët e bardhë. Kryetari i komunës, Sefer Tasi, po ecte përmes këtij sheshi për t'u ngjitur në zyrë. Si burrë i shkurtër që ishte, u jepte thembrave lart. Zemra i thoshte se atë ditë në zyrë do të gjente diçka të bukur dhe u ndal të shihte, me sytë gri, të kuptonte se nga i vinte një ndjenjë e tillë. Fëmijët në shkollë po thoshin mësimin, duke thirrur njëherësh. Disa burra që u ndodhën para dyqanit të Tomës, prënë bisedën. Kryetari u foli, tha mirëmëngjesi nga larg. Fshatarët u habitën, sepse ai kalonte duke i shikuar të gjitha e nuk shihte asgjë, nuk i fliste askujt, kur shkonte në mëngjes në zyrë. Aty mbyllej disa orë, duke bërë sikur lexonte shkresa që s'kishin ardhur, sikur shkruante shkresa që nuk do të dërgoheshin askund, duke pasur sipër ato fjalët e zjarra «urxhent» dhe «tepër sekret». Në të vërtetë ëndërronte pranë stufës, hidhej përpjetë e i nxehej trupi valë kur binte zilja

e telefonit, thërriste fort sikur të kishte kapur më në fund fillin e shpëtimit të hedhur nga larg. Po më tepër rrinte duke parë me mallëngjim atë gruan qiellore të zhveshur, të shtrirë mbi një sapun vigan të markës «Venus», që botonte në çdo numër gazeta «Besa». Çfarëdo që të ngjiste në botë, beteja ushtrish, përmbysje shtetesh, tërmete të mëdha, ajo grua do të ruante të njëjtin lakim të trupit, të njëjtën buzëqeshje të ëmbël që ndillte një lumturi të paarritshme. Kryetari hapte sytë, ia prekte pjesët e trupit me majën e gishtit, po ajo nuk ndërronte, për të jeta ecte po njëlloj. Në dyqanin e Tomës polici i kishte pëshpëritur dikujt se kryetari fliste me vete. Pëshpëritja u hap dhe njerëzit e shihnin kryetarin me kureshtje, duke pritur çastin kur do t'i ikte mendja krejt, si një zog që do të dilte prej radakës së tij nën kapelën e madhe të butë.

Kryetari urdhëroi policin të mos e shqetësonte njeri, megjithëse kjo që një porosi e kotë, mbylli derën me çelës dhe hapi gazetën. Lajmi i parë i madh ishte se martohet princesha Sanie me princin Abid, bir i sulltan Hamidit të Turqisë. Fotografitë e çiftit zinin krejt faqen e parë. «Gëzimi na u trashëgoftë.» Populli kishte kaluar në mallëngjim, ministrat dhe deputetët nuk i fshihnin lotët. Nusja, kjo heroinë e veshur në ar, që kishte shpëtuar kombin me shërbimet e veta në Kryqin e Kuq, po gatitej për t'u bërë amvisë. Letër lamtumire Gruas Shqiptare dhe Kryqit të Kuq, që të shkrinte zemrën.

Kryetarit të Komunës iu nxeh gjaku, i fërgëlloi trupi, iu veshën sytë, duke përfytyruar atë jetën e madhe të kryeqytetit. Por ai luajti vendit kur pa lajmin se qytetarët fisnikë, komunat, nënprefekturat, prefekturat, po zgjidhnin me kujdes peshqeshet për dasmën e parë të kombit. Ai foli në telefon me prefek-

turën nëpërmjet postës së Çernikës. I thanë se dhuratat mbeteshin në dëshirën e gjithkujt.

Kryetari iu rrit edhe më fort shqetësimi. Ai thirri togerin rezervë, Bedri Mëdyshin, komandantin e postës së xhandarmërisë dhe kryepleqtë. Çfarë dhurate mund të çonte Markeshi?

Në këtë vend nuk gjendej asgjë e denjë. E vranë mendjen më kot një orë, pastaj ai budallai, Bedriu, hapte gojën e tha:

— Mor burra, për dasmë çohen mishra!

Kjo ishte sa e thjeshtë aq edhe e ndritshme. Një cjap në Bal kishte peshuar 94 kilogramë. Asnjë komunë a nënprefekturë s'mund të hahej me dhuratën që do të çonte Markeshi.

Kryetari zuri të dalldiste. Ai do t'i printe vetë tufës, me ata cjeptë e kuq, me leshin e gjatë në kërcinj të këmbëve, me zilet me tri palë gjuhë. Prapa do t'i grahte tufës togeri rezervist me uniformë. Ndofta në pallat mund t'i priste vetë lartmadhëria që martonte motrën e parë. Kryetari do t'i binte në gjunjë, do t'i puthte dorën me lotët ndër sy. Po të mos ishte lartmadhëria, patjetër do të qe kryetari i parlamentit, që drejtonte ballot e ceremonitë, ose shkëlqesia e tij, ministri i Brendshëm, që mbante rendin. Por duheshin caktuar cjeptë, duheshin gjetur paratë. Paratë do të mbledheshin në popull, me anë të një takse vullnetare. Mirëpo këtu filluan vështirësitë, sepse burrat e Markeshit u bënë lepuj, nuk kapeshin në asnjë vend. Kalonin ditët. U zunë edhe rrugët nga dëborat. Kur erdhën gazetatat pas dy javësh, dasma e madhe kishte mbaruar.

Pastaj nisi një dimër i ashpër me stuhi, që e mbajti Markeshin të groposur. Në pyjet sundonte ariu dhe ujqit dolën kope, sulmuan njerëzit. Alush Demirit prej Gjini i kapi ujku këmbën brenda në oborr dhe nuk ia lëshoi derisa e vranë me sëpatë. Kjo shkaktoi habi dhe u bisedua në lagjet. Paskësh ardhur koha që egërsira të mos i trembej njeriut, i cili gjithnjë ka pasur në dorë armët dhe zjarrin.

Në ditët e qeta, kur dielli shndriste mbi dëborën e madhe, duke sjellë një dhimbje të ëmbël në sy, njerëzit dilnin të hapnin rrugët, të shkarkonin çatitë, të merrnin dushk dhe krund ahu në zabel për bagëtitë që blegërinin në ahur. Në njëerën nga këto ditë doli në krye të arës së vet Qerim Kasa prej Denc. Çiften e kishte mbushur me plumb të rëndë derdhur për merak, në trastë mbante fishekët rezervë dhe në brez kishte ngjeshur nagaçen e mprehtë. Arën e vjetër me misër ia kishte prishur ariu krejt, një ari me zakonc njeriu, që e shkulte misrin, e zhvishte kallirin dhe e flakte kashtën tej. Ata u takuan pak më sipër arës, në një çeltnë pylli, a thua se po kërkonin njëri-tjetrin. Ariu ktheu sytë e trishtuar e të përlulur, jo si një hajdut, po si një pijanec i zyrtë që mund të bëhet i rrezikshëm po t'i presin rrugën. Pastaj eci më tej me mospërfillje, sikur të qe kuptuar me njeriun, duke çapitur në dëborë me hap të matur, me trupin e zi të madh. Kjo ia prishi gjakun Qerimit. «Ke ngrënë e ke pirë mjaft», — tha ai dhe ngriti çiften me urrojtje kundër armikut që ia kishte shkelur arën tre vjet me radhë. Ai shënoi mbi shpatullën e kafshës, që ngrihej e ulej me forcë, e ndoqi me tytën dhe e shkrehu këmbëzën e parë në çastin kur egërsira po hynte pas ko-

kojkës me ferra. Ariu u kthye, u praps dhe u ngrit në tërë gjatësinë e trupit, i madh sa një kalë. Qerimi shkrehu këmbëzën e dytë, me zemrën që i gufoi prej gëzimit, krejt i sigurt se e goditi të dy herët në gjoks. Kafsha ra dhe Qerimi priti gjatë. Si nuk dëgjoji lëvizje a rënkim, i doli kokojkës nga shtegu i sipërm. Aty po e priste ariu, më Këmbë, dhe hungëroi, me qime përpjetë, gati foli fjalë, si stërgjyshi i njeriut, ia kapi kokën Qerimit me të dy putrat dhe ia afroi te goja. Në sytë e kafshës ishte ndezur një egërsi e ftohtë misterioze, prej së cilës s'ka shpëtim. Sytë u hapën edhe më tepër, me një dritë të gjelbër me rreze të kuqe në mes, nga goja si zgavër doli fryma valë, me dëshirën e madhe për t'u hakmarrë. Qerimi e pa veten të mbaruar, po kafsha kishte humbur tepër gjak duke pritur më këmbë te shtegu, ishte mbajtur aty me fuqitë e fundit, iu lëshuan gjymtyrët dhe ra, duke ia shëmtuar fytyrën njeriut përjetë. Ky njeri mori ngadalë fizionominë e ariut dhe i trembte keq ata që e shihnin për herë të parë, nuk fliste dhe hera-herës sillej andej nga ara e madhe. Puna e tij u fol për shumë kohë në lagje, derisa vendin e bisedave për egërsirat e zunë ngjarje të tjera edhe më të rënda.

Fryu jug i ngrohtë dhe shkriu dëbora. Kishin mbaruar njëqind përrallëzat e netëve të gjata, si edhe misri në hambar. Ra një shkëmb prej malit në shtëpinë e Elam Thanës dhe vrau një grua e një fëmijë. Te Sadiq Lama shkëmbi vrau një grua dhe një vajzë. Dy gra të Gërvishtajve që kishin shkuar për dushk rrëshqitën në faqe të malit dhe u copëtuan. Gruaja e Met Alhasës u mbyt në Dron. Vërshonin ujërat, rrokulliseshin shkëmbinjtë. Dukej sikur po lëvizte bota nga themelet. Ishin gratë që e pësonin. Të shumtët e burrave ndodheshin në kullotat e ngrohta në fushë.

* * *

Teqeja rrëzë malit, si një saksi në vend të thatë, ku rriteshin në hije mjekrat e dervishëve, e mbyllur dhe e qetë, sillte një buçitje të ulët në veshët e baba Merxhanit.

Ai rrinte mbyllur prej tre muajsh, që kur rrugët u bënë të vështira, pothuaj të pakalueshme prej dëborës dhe ujërave. Vetmia të bën të dyshosh në botën. Në vetveten, rritet si një sëmundje që bren shpirtin. Mendja e njeriut të vetmuar së pari zë e mjegullohet, pastaj do të tërhiqet gjithnjë më poshtë, drejt humnerave pakthim. Ky njeri do të bjerë në një heshtje të thellë, ose do të marroset, ose do të bëjë të pamundurën për të thyer rrethin. Vetmia në një teqe nuk është e plotë, po e vazhduar, ditët në hije lidhen me njëra-tjetrën nga errësira e natës.

Ai, baba Merxhani e kishte njohur këtë ankth të zgjatur në veten dhe e kishte parë te të tjerët. Fytyrat e dervishëve marrin atë trishtimin e thellë e të heshtur të njeriut të ndarë përgjithmonë nga jeta, përkulen nga brenda, ulin kokat ngadalë, si bimët, humbasin fjalët. Ata janë të teqesë, pjesa e saj që lëviz. Se krimbi merr ngjyrën e drurit ku ha... Kur rrinte duke menduar këto, bota në sytë e baba Merxhanit merrte ngjyrën e plumbit, zbrazëtira dhe heshtja brenda tij bëhej një hon pa fund. Pastaj vinte ajo dhimbja e kokës. Një ditë e një natë përmbys. Në teqe nuk lëviznin as hijet. Nxirrte tym të hollë furra e dervish Selimit. Kurse dervish Hasani e mbante ndonjë vizitor në oxhak-kafe, duke i treguar me zë të ulët për sëmundjen e babait. Në ditë të tilla vetëm Galip Nuri, sekretari i ri, diku ngjitej lart, mbante vesh prapa derës, hynte e rrinte pa folur, derisa babai i kërrusur

mbi veten ngrinte sytë. «Nuk mund të bëhet asgjë», — thoshin sytë e tij. Galipi nuk mundej t'ia duronte shikimin e ngulët që kërkonte thellë brenda shpirtit dhe dilte duke mbyllur derën me kujdes.

Të nesërmen babai zbriste poshtë dhe ishte prapë babai i çdo dite. Rikthehej jeta në teqe. Ai i thoshte vetes se, falë kokëngjeshjes, eshtrave të forta dhe fatit, kishte dalë pothuaj i paprekur nga vetmia e dervishit në Teqenë e Madhe. Kurse tani ndodhej baba në këtë teqenë e largët të Markeshit ku kishte punë me njerëzit, ndaj të cilëve ndihej i tërhequr përherë më shumë dhe ku punët mund t'i drejtonte sipas dëshirës së vet.

Përveç dimrit dhe atyre stuhive në shpirt, që i ktheheshin me të pabesë e më shpesh.

VII

Galip Nuri, sekretari, kishte dalë në kopshtin e teqesë, rrinte ngrohtë brenda palltos prej meshini të veshur në gëzof, shikonte diçka të këndshme poshtë, në udhëzën që zbriste në fshat. Ali Çela, qehajai, eci me kujdes mbi dëborën që po shkrinte dhe u ndal pak më tej, të shihte gjënë e bukur që vërente Galipi në udhëzë. Galipi rrinte gati ndaj dredhive, i bindur se rralle mund të presësh ndonjë gjë të mirë nga i afërti, i shikonte njerëzit buzagaz, po të donte ua zinte duart që në fillim të hilesë, veshëve dhe syve të tij nuk u shpëtonte zhurmë a lëvizje, kur ia kishte ënda të zbulonte një të fshehtë. Po nganjëherë linte të kalonte diçka e vogël, e padëmshme, për hir të lojës. Ky pëlqente gotën dhe shakanë; po aq i fortë ishte edhe me gratë. Me një të hedhur të syve ia ngrehte gruas

rrethimin, me dy fjalë të vetme ia ndizte dëshirat, e bënte të lëvizte, të kërcente. Rregullohej dhe prapë mbetej në të thatë. Këto as që mund t'ia përfllisje, po të mos doje që përfolja të të binte në kokë. Qehajai zuri të afrohej, se nuk po diktonte ndonjë gjë në udhëz, dhe eci pa u ndier, po Galipi ktheu kokën dhe e pa që sipër kërcellit të hundës së madhe me atë shikimin e shpejtë, tallës e të mprehtë që i hidhte gjithkujt. Qehajait i kaloi rrëqethja në kurriz, siç i ndodhte kur gjëndeja para sekretarit. Se veç të tjerave këtij duhej t'i flisje hakën, ishte i zoti sa s'bëhej më dhe i ndershëm në punë të lekut deri në qindarkë.

— Ç'është? — pyeti Galipi me zë të ulët.

Kishte një hije trishtimi, një si qetësi të thellë në fytyrën e tij. Qehajai mendoi i turbulluar se ky njeri kishte në zemër më pak hare nga sa tregonte nga jashtë, ose aspak.

— Të kërkon babai tek ahuri i lopëve, — tha qehajai, me atë të folurën e tij të prirë ndaj punëve të fshehta. Çdo punë, sado të vogël, gjithnjë ashtu do ta thoshte, si fëshfërimë të fshehtë.

Galipi e gjeti babanë duke folur me bariun. Natën kishin lindur dy viça. Babai dukej i gëzuar, po edhe i tronditur, sikur t'i kishte ngjarë atij vetë diçka në trup.

— Si të hamë drekën, do të shkojmë në Rrallenjë, — tha babai.

Ata të dy u ngjitën te kopshti dhe pushuan të merrnin frymë. Nga ana e Balit vinte një erë e ngrohtë, që sillte shqetësim, shtynte drejt Bjeshkëve të Shatit retë e bardha. Poshtë nga sheshi «Belik» i lagjes «Qytezë» erdhi gjëmimi i qartë i daulles së jevgut. Ky ishte i vetmi farkëtar i Markeshit, në njëfarë mënyre ishte edhe zëdhënës qeveritar, sepse ai lajmëronte me daullen ngjarjet e mëdha. Në ditë të tilla, personi

i tij i fryrë sillej rreth sheshit, rrihte daullen duke e përcjellë ritmin me lëvizjen e kokës, pastaj ndalej të thërriste lajmin. Bashkë me gjëmimin e daulles, era solli edhe një zhurmë, si një grindje të largët. Zhurma u kthjellua. Po këndonin fëmijët e shkollës. Krisi tri herë një kobure.

— Ditëlindja e lartmadhërisë, Zogut të Parë, — tha Galipi. Fytyra e tij e ngjallur, vetullat e puqura përmbanin një shaka të madhe.

— Çfarë? — pyeti babai.

Galipi thithi cigaren, nxori tymin e lëvizi flegrat i kënaqur dhe recitoi shkoqur e me seriozitet:

*Këndo, shqipe, si kaposhi,
edhe lutiu perëndisë,
se si sot lindi kodoshi,
kurvar, bir i orospisë.*

Babai hapi sytë dhe ia plasi të qeshurit.

— Shkojmë brenda, — tha babai. Aty e detyroi Galipin t'ia përsëriste vjershën dhe prapë qeshi fort.

— Bëke edhe vjersha, — i tha, i habitur.

— Me rast.

Babai zuri të pinte duhan me cigarishten e gjatë prej qelibari me gojëzë argjendi, që e mbante gjithnjë në brez. Vinte mbytur gjëmimi i daulles së jevgut. U shkrehën tri pushkë edhe në faqen e tejme, në lagjen «Gjin».

— Vetëm një budalla i lig mund të gëzohet në një botë të tillë, — tha babai dhe ndenji me bërrylat mbi gjunjë.

Galipi fërkoj duart dhe ndenji i heshtur.

— Dua të shes misër pesë lekë barra më lirë, — tha prapë babai. — Populli po vuan për bukë.

Sekretari e pa ndër sy. Akaparuesit e misrit kishin

pritur tërë dimrin me durim dhe e ngritën çmimin një lek e gjysmë oka. Teqeja do të humbiste dhe do të tërhiqte mbi vete mërinë e tregtarëve.

Babai nënqeshi me vrerin në sytë e errët e tha:

— Në pazarin e drithit një të pestën e merr peshuesi. Këtë e di edhe parlamenti, është bërë ligj. E rrjepin fshatarin nga çdo anë. Në Korçë xhandarët qëlluan me armë mbi punëtorët që kërkonin bukë. Tani në parlament çuditen, se paska ligje për çdo gjë, edhe për çibukët, po s'ka ligj për punëtorët.

Babai kishte hequr taçin dhe rrinte si i hutuar, duke dashur të shihte me mendje ato që ndodhnin në Korçë.

Sekretari po vërente shqetësimin e thellë të babait. Ky baba djalosh kishte një përfytyrim të zjarrtë. Shpirti i tij, ngado të kthehej, goditej prej ngjarjeve të afërta e të largëta, që trazonin në të sotmen jehona të kaluara dhe që kishin njëfarë lidhjeje me diçka që do të vinte. Kjo ishte vuajtja e babait, po edhe kënaqësia e tij, kënaqësia që të jep trazimi i një plage të thellë e të fshehtë.

— Mund të shesim njëzet barrë, — tha sekretari qetë.

— Shite. Kjo s'është kurrgjë, po prapë shite.

* * *

Në Qafën e Pishës kuajt rrëshqisnin dhe babai e Galipi e bënë një copë rrugë në këmbë. Luginat dhe shpatet rrinin nën dëborë si nën një mbulesë kristaline që të merr sytë. Përtej Qafës u shfaq fusha e madhe e Rrallenjës, e fryrë si një brumë i ardhur, po, kur hynë në të, panë se shtresa e dëborës ishte e fortë, e ngrirë dhe mund të ecej lehtë. Sundonte qetësi e

thellë, ajri i freskët të hynte drejt në mushkëri. Kjo bukuri e bardhë, e gjerë, ndjenja se po ecte në një tokë të pashkelur, i kthyen babait gjallërinë. Ai hapi gjoksin, në fytyrë i vërshonte gjaku dhe pak më tej zuri të këndonte nëpër dhëmbë. Sekretari kishte pyetur veten përse po shkonin në Rrallenjë nëpër dëborë. Babai kishte ndier nevojën të ecte.

Teqeja verore ishte në krye të luadheve të gjera, rrzëzë Pyjeve të Kreut të Vogël, prej nga buronin në verë ujërat e ftohtë. Tani krojet ishin ngrirë ose rrëshqisnin ngadalë nën dëborë, për të humbur më tej në thellësi të tokës. Me ndërtesën trikatëshe, ahuret e shumta dhe muret rrethuese, teqeja dukej nga larg si një shpend i madh krahëhapët në përgjim. Galip Nuri mbajti këmbët, i goditur prej pamjes së befasishme, dhe nënqeshi. Teqetë ngriheshin në pika prej nga zotërohej pamje e lirë, majë kodrave të bukura, duke pasur prapa pyje e shkëmbinj të thepisur, që të ishin larg syve kureshtarë, të mbaheshin mbuluar ato që bëheshin atje, ceremonitë e fshehta, dehjet, hyrja e grave. Po ka edhe një qëllim të dytë: që banorët e teqesë ta shohin botën nga lart, të ndihen zotër mbi tokë dhe ai që ndodhet poshtë të provojë të kundërtën e kësaj. Galip Nuri e dinte ç'ishin teqetë. Po ai nuk njihte ende mirë babanë e këtyre dy teqeve të Markeshit.

Ky babai i bënte punët në rregull, me zell po jo me gëzim, i fliste tarikatit me imtësi, po jo me bindje. Galipin e turbullonte sidomos ajo nënqeshja e hollë, e fshehtë sa mezi dallohej, që po vijoste kohët e fundit buzët dhe cepat e syve të babait. Galipi ecte prapa, dëgjonte kërcitjen e hapave mbi dëborën e ngrirë, shikonte zverkun e shëndoshë të babait, trupin e fuqishëm dhe ndiente tërheqjen që ushtronte mbi të ky djalosh, deri aty më parë i panjohur.

Para teqesë ishte një ah i madh i vetmuar, babai u ndal aty, shikoi rrotull dhe priti të afrohej Galipin. — Në verë këtu kundërmojnë lulet. S'ka vend si këtu në verë, — tha babai. Shikonte rrotull me një dritë në fytyrë, a thua se kërkonte me sy lulet dhe bari nën shtresën e dëborës. — Përse vjen njeriu në teqe? — pyeti duke shikuar Galipin.

— Për derman, për strehë, për miqësi.

— Këtu do të ngremë një shtëpi për ata që vijin për derman, për të sëmurët që duan ajër të freskët.

Ca ditë më parë babai kishte thënë se do të ndërtonte një shtëpi të vogël të teqesë në lagjen «Qytezë» që ta jepnin me qira të lirë për dy mësuesit dhe infermierin. Dukej se ky baba do të bënte gjëra që s'ishin bërë në asnjë teqe. Kjo e gëzonte sekretarin, po edhe do të mbante sytë hapët, që ta ruante prej smirës prej hapit të gabuar.

Zuri të frynte erë e lehtë dhe tej në fushë u ngrit pluhuri i imët i dëborës. Era kaloi lart në pyjet, duke i lënë të patrazuara pishat me degët e ngarkuara.

— Në Xhabel-el-Tarik, — tha sekretari, si me shikimin nga viset e largëta ku kishte bredhur, — qëndroi një vapor që çonte ca majmunë në Angli. Një grua i vari një kurorë me lule shqerre një majmuni të ri të bukur. Majmunët e tjerë hapën sytë. Në mëngjes majmunin e ri e gjetën të mbytur.

Babai u mendua për një çast dhe qeshi.

— Pra majmunët e tjerë nuk e duruan dot kurorën e majmunit të vogël, e mbytën natën, — tha. Prapë ajo nënqeshja e hollë, e pakapshme.

Dervishi shurdhmemec që rrinte gjatë dimrit në teqe, hapi portën dhe i puthi dorën babait, ndërsa i kalonte një drithërimë në trup. Ishte njeri pa njeri, i mësuar me teqenë si fëmija me gjirin e nënës dhe babanë e shihte si vetë zotin. Ky po i mbante dorën

te supi dhe dervishit iu përlotën sytë. Ali Çela, qehajai, që kishte ardhur aty dy orë më parë, po rripote qengjin te druri i mollës. Dy shërbëtorët punonin në ashef. Babai u erdhi rrotull ahureve dhe kthinave të teqesë, pa dëmet nga dimri dhe tha se ustallarët do t'i dërgonin bashkë me dervish Lalën. Duhej të shpejtonin. Edhe pak e do të nisnin të kalonin karvanët e Grykës së Madhe dhe krejt malësisë, që ndalonin aty për strehë, e që sillnin me vete delen a viçin. Ajo teqe ishte si një han, ku nuk paguhej asgjë, po ku lihej diçka: lëkura e bagëtisë, mishi që tepronte, një okë miell, një okë lesh.

Lart, në dhomën e zjarrit, babai ngrohu duart, ngri-ti faqoren dhe tha:

— Deri në vjeshtë ia ngremë muret spitalit. E bëjmë me dhjetë dhoma për të fjetur. Kurse ushqimin ta hanë në teqe. Ka boll. Po sa do të kushtojë vallë?

Sekretari ndjeu erën e mëlcive të fërguara, ishte i uritur dhe mendoi se do të kalonin një mbrëmje të mirë dhe tha një çmim të ulët për spitalin. Babai e pa një çast me dyshim dhe tha:

— Atëherë shtojmë dhomat.

VIII

Në mëngjes, kur ngjyrat e luginës duken të for-ta e të paqëndrueshme dhe shtëpitë e vogla me çatitë prej dërrase bredhi ngjajnë më të gëzuara, kur lagjet duken si të sjella afër, kur toka e çliruar prej dëborës thith ajër, kur i gjithë Markeshi duket si një qelq i madh i natyrës me pyjet dhe shkëmbinjtë e lartë, në këtë orë të mëngjesit babai pi kafënë me dritaren ha-

pët, shpirti i tij i pezmatuar dremmit nën një shtypje të lehtë, mjaft të lehtë, po të pandarë. Për të koha jashtë është një gjë dhe koha brenda një gjë tjetër. Lëvizja e botës jashtë është si e fshehtë dhe e padukshme, po ajo prapë lëviz, në një drejtim pa cak. Kurse brenda në teqe duket sikur je pezull, lëvizja e dervishëve i ngjan punës së merimangave që përtypin e thurin një pezhishkë të kotë, vetëm që të ecin nëpër të.

Kjo dremitje e shpirtit të babait tek pi kafënë, nuk do të zgjatë shumë. Do të ecë një grua në rrugë, do të thërresë një fëmijë që çon dhinë, do të lehë diku një qen dhe atëherë babai zë e dëgjon brenda vetes fjalë të folura në kohë e vende të tjera e me të tjera qëllime. Ai ndehet që t'i kapë këto fjalë dhe prapë shikon jashtë dhe bota për të mbetet si një det i tejdukshëm, në të cilin s'mund të kridhesh më poshtë, po as të dalësh prej tij nuk mundesh. Çaste të një dremitjeje të tillë të zgjatur i kthehen gjithnjë më shpesh babait, tek pi kafënë në dritare, kur pi faqoren në darkë, kur bisedon me myhibët në divan. Krejt papritur var kokën mbi kraharor e rri pa folur dhe të tjerët rrinë duke bërë si ai.

Por ky mëngjes ndryshon nga të tjerët. Jeta në rruge ecën me një vrazhdësi edhe më të fortë. Po kthehen kopetë nga kullotat dimërore. Për pesë muaj markeshasi ka shkuar në shtegtim, duke ndier pas deles ngrohtësinë e gjallë të jetës, duke mposhtur dhimbjen e varfërinë. Tani burrat do të ndalen nja dy net në shtëpi duke sjellë drithë e lajme, duke treguar për miqësitë e reja të lidhura poshtë në fushat, për grindjet e merave, për shitblerjet, për punët e mbetura gjysmë. Zbrit e ngjitu, nga vjeshta në prill, nga prilli në vjeshtë. Po ngado që të shkojë markeshasi, gjithnjë do të kthehet në shtëpinë e tij prej guri, që s'ka parë gël-

qere, me atë çatinë e gjatë trekëndëshe, siç i bëjnë çatitë në çdo vend të dëborës. Këto ditë do të ngrihen tymra nga gjithë oborret dhe në lagjet e Markeshit nuk do të pushojnë bredhjet e zhurmat gjer vonë në darkë. Dimri kaloi si një ëndërr duke qenë zgjuar dhe tani po rikthehej jeta njëherësh.

* * *

Babai u tërhoq në shilten e tij në krye të dhomës dhe ndezi çibukun prej qelibari me pipëz argjendi. Atë ditë do të vinte togeri rezervist, Bedri Mëdyshi, për punën e fajdeve. Togerit edhe mund të mos vinte dhe atëherë do të ishte më keq, se babai duhej të ngjitej vetë në kullën e tyre në Gjirin. Kjo punë tashmë kishte arritur një kufi të rrezikshëm, fjalët ishin thënë. Ai do të përpiqej ta zgjidhte qetë, siç bën një baba teqeje i urtë e zemërgjerë, jo po në mos...

U çua dhe erdhi rrotull në dhomë. I dukej vetja si njeriu që ka dalë për shëtitje në pyll dhe befasi e sheh rrugën të zënë nga një shkëmb i errët. Ngriti kokën, se iu bë sikur dëgjoi në largësi hapin e rëndë e tinëzar të togerit. Fytyra e gjatë dhe kryeneçe e Bedriut po zgërdhihej. «Prit kur të vish këtu», — tha me vete babai. Ai u nis të dilte në kopsht. Nuk dihej kur vinte togeri. Ishte në dorën e tij të vinte kur të donte.

Erdhi zoti Sefer Tasi, kryetari i komunës. S'kishte ardhur në teqe prej dy muajsh dhe babai e pa me kureshtje, ndenjën në ballkonin e vogël që dukej nga larg si kafaz. Që nga kopshti vinte kundërmimi i luleve dhe i barit të njomë.

Ndërsa kryetari pinte kafënë dhe tundte filxhanin si për të kërkuar aty një mendim, në fytyrën e tij dukej një trishtim i madh, si edhe diçka tjetër e fsheh-

të, për të cilën s'mund të mendoje asgjë. Këtë babai e kishte parë edhe kur kryetari kaloi portën, duke shikuar hart me dyshim e me shpresë, ndërsa gulçonte prej lodhjes. Kryetari la filxhanin dhe ngriti kokën, sytë e tij gri lëvizën me shpejtësi dhe prej andej vinte një thirrje sikur ky njeri të jetonte buzë greminës. «A nuk je edhe ti si unë, i mbyllur në mes të maleve të larta?» — pyesnin sytë e trembur gri. Kjo e habiti edhe më fort babanë dhe për disa çaste ndjeu keqardhje për të. Një njeri i egër, i paditur, pothuaj mizor, mund të jetë i butë e i ëmbël në një anë tjetër të jetës së tij. S'ka gjë të keqe që të mos përmbajë një të mirë dhe, anasjelltas. Mbase kryetari vuante për shkak të familjes, mbase kishte rënë ngushtë në ndonjë pikë me atë palën tjetër, Mëdyshajt, dhe xhandarmërinë dhe kërkonte marrëveshje me teqenë. Babai priti, duke e parë me vëmendje, po, kur hapi gojën të fliste, kryetari u bë prapë një njeri kaba e mendjemadh.

— Traktatet që nënshkroi lartmadhëria me Italinë do t'i japin vendit begati, — tha dhe ndenji në përgjim.

Më 20 mars ishin nënshkruar marrëveshjet për vajgurin, duhanin, bankën, portin e Durrësit. Ndonjë gazetë e huaj kishte shkruar se Zogu po e shiste Shqipërinë. Disa deputetë në parlament qëllonin me grushte në ajër kundër këtyre gazetave.

— Markeshi s'ka as duhan, as vajguri, as det, — tha babai.

Kryetari uli kokën që i dridhej lehtas në zverk nga kureshtja, duke i ngjarë një qeni gjuetie turishtypur e të ndezur që nuhat në barëra, ndërsa mendohej me ngut. Ky baba nuk ishte mik i qeverisë. Për këtë kryetari kishte dyshuar edhe më parë. Ai ndjeu gëzim që po dëgjonte tani diçka me veshët e tij. Gjithnjë ndien gëzim kur mund të ngrësh gishtin mbi një njeri të dy-

shimtë, t'i raportosh për të nënprefektit, ndofta vetë shkëlqesisë së tij, ministrit të Brendshëm. Dhe nuk bëhej fjalë për ndonjë cjap të vjedhur, për një rrahje a plagosje në pritë, po për mjekrën e babait të teqesë.

— Nazari, ke filluar të ndërtosh mullirin dhe dërstilën. Këto do të jenë një përfitim i mirë për teqenë. — tha kryetari dhe lëpiu buzën e çoi kokën lart për t'u treguar i qetë, ndërsa në sy i mbetej dyshimi për atë që kishte nuhatur pak më parë.

— Përfitimi do të jetë për popullin e Markeshit. Në mulli dhe në dërstilë do të mbajmë vetëm hakun e punëtorit, — tha babai. Ai prapë dyshoi se kryetari mund të mos e kishte me të keq, se ndofta brenda tij vepronte një ligësi pa mendime.

Kryetari ia kishte ngulur sytë në mjekrën e zezë. Shumë shpejt ishte rritur ky baba, që të shtypte me mospërfilljen e lehtë. Veç për të flitej tani në fshatra. Pajtonte gjaqet, bënte ndërtime, hapte punë, u shiste misër të lirë fshatarëve. Sikur ta raportoje, këto do të ishin lavdërime. Dhe ndonjë gjë të hapët kundër qeverisë s'kishte thënë. Trupi i bëshëm i babait rritej në sytë e kryetarit. I kaloi gëzimi që ndjeu aty më parë. Tani ndiente zagushi, aq më tepër sepse i dukej që ai vetë po zvogëlohej, po humbiste peshën dhe kjo ndodhte në një mënyrë që s'mund të kuptohej.

Babai kishte zgjatur kokën, sikur të shihte poshtë diçka të këndshme. Kryetari ndoqi shikimin e tij dhe pa në lëndinën anës rrugës Selman Gërrvishtën që rrinte këmbëkryq. Ishte komshi i teqesë, me kullën e madhe prapa krahëve, ku jetonin dyzet shpirt. Përgjatë bregut po ngjitej sakati, si një insekt i madh i plagosur. U duk sikur humbi te shkëmbi, pastaj doli lart, duke lëvizur krahët, duke e hedhur këmbën anash. Selmani e pyeti për diçka, i uroi udhën e mbarë, vijoi të rrinte kërrusur, si i përgjumur. Selmani ruante te-

genë, ruante babanë, duke ndenjur te shtegu. Po të zbriste babai në Qytezë, zbriste edhe ai, hetonte njerëzit dhe vendin, me sytë mbi shpatullat e babait. Edhe disa të tjerë kishin filluar të silleshin rreth babait, t'i mbulonin krahët. Kryetari mendoi se diçka po lëvizte në Markesh, në çastin kur e mendoi këtë, u zbeh e zmadhoi sytë. Mbrojtja dhe qetësia qeveritare sikur kishin krisur nga brenda që kur erdhi ky baba. Kjo kishte ngjarë ngapak e pa u kuptuar. Po sikur tani njerëzit të çmendeshin papritur nën nxitjen e këtij babai të egër e të dyshimtë, siç kishte ngjarë me nja dy kryengritje në kohë e prefektura të ndryshme? Kryetarit po i jehonin në kokë ca pëshpëritje të dëgjua rrëshqitas dhe u kthye të shihte me ngulm në mjekrën dhe ballin e babait. U mundua të nënqeshte me zemrën të dredhur, dhe prapë e hodhi fjalën nga larg:

— Ky popull lëviz pareshtur, shtegton, hyn e del në anë të ndryshme, po ligji qëndron sipër. Le të jetojnë kështu, si uji në pjatë, mjafton të mos hapin telashe. — Kishte tundur dorën me pëllëmbën të hapur lart, për të treguar lëvizjen e ujit në pjatë. Babai u habit me mendimin e hollë të kryetarit, vuri buzën në gaz dhe tha:

— Zotrote e ke emrin Sefer, që do të thotë libër e takëme për të shkruar. Ky emër të detyron të mësosh, se emrat na jepen me frymëzim nga lart, dhe i mësuar je zotrote, ndryshe s'bëheshe kryetar në Markesh.

Kryetari kishte hequr kapelën e butë dhe filladi ia lëvizte flokët e rrallë në kokën e shogët. U skuq e u zbeh. Nuk dinte në duhej të quhej i përkëdhelur apo i fyer. Në zërin e babait ndihej tallja e lehtë, po sytë e tij ishin hapur e mbyllur, si për të veçuar veten nga fjalët që e detyroi rasti të thoshte. Ky veçim që i bënte nganjëherë vetes babai, të detyronte të rrije i heshtur, të mbaje frymën duke e parë. Nga kjo mendja e mby-

llur e babait buronte të folurit me fjalë të zgjedhura, kurse zëri i tij të ngjallte në shpirt jehona tronditëse, nga të cilat s'dije si të mbroheshë.

Babai mblodhi buzët e kuqe që u zhdukën nën mjekrën e zezë. Kryetari s'kishte ardhur për ndihmë a për-krahje, as për thirrjen e togerit. Sytë përgjues e të hutuar të zotit Sefer flisnin për qëllime të tjera. Babai u rikthye tek ajo që dëgjoi nga kryetari dhe tha:

— Se po të lëvizin ndopak njerëzit, zë e lëviz ligji, apo jo, zoti Sefer? — Po fliste ftohtë dhe shkurt. Kryetari tundi kokën, duke dashur të thoshte se ata e kuptonin njëri-tjetrin. Dhe ai do të ishte një kryetar i arsyeshëm, sikur jeta në Markesh të lëvizte si uji brenda pjatës. Ai, kryetari, nuk do të shtonte aty diçka, as do të hiqte. Ç'mund të bënte tjetër një njeri me mendjen në kokë?

— Ky është një popull i zgjuar, që bredh, dhe nga kjo i vjen zgjuarsia, — tha kryetari, si duke gri-shur babanë të shihnin bashkë këtë anë të rrezikut. Ndërsa thoshte kështu, mendoi se po shkonte në anën e kundërt të asaj që duhej, nuk po i ngrinte çarqe babait, po i shfaqte atij mendimet e veta të fshehta. Kjo e la të hutuar e me gojën të hidhur.

«Ky është një popull që bredh». Mendimi puqej me mendimin e babait dhe ai ndenji i heshtur. Pleqtë dinin prej pleqve të tyre se ky vend i quajtur «derbent», vend që ruan grykat, nuk i qe nënshtruar haraçit të turkut. Ky vend quhej më parë Shmëtrinë. Jetonin me bagëti dhe veshjet i bënin gratë, me valanica për shkeljen e shajakut dhe me milar për të endur pëlhurat. Punohet edhe druri me anë të dy sharrave. Për jetën e tyre mund të bëje në vitin 1936 të njëjtin përshkrim të treqind vjetëve më parë. Asgjë s'kishte ndryshuar në Markesh me sa mbanin mend pleqtë e pleqve, veç lindjeve dhe vdekjeve, luftërave, një popull i mbajtur gja-

llë nga shpresa e dëshpërimi. Ah, po, dyqind vjet më parë ngjau ai ndryshimi i madh. Erdhi dervishi endacak që ngriti tyrben, e cila u bë pastaj teqe dhe Shmëtrina u quajt Markesh. Këto janë gjurmë të sakta, se brezat që erdhën shkelën në to pa i shtrembëruar dhe të çojnë mirë deri dyqind vjet më parë. Për më tutje, fillon njëfarë mjegulle e përrallëze, se asgjë e shkruar nuk gjendet, dhe sa për shenjat në shkëmbinjtë, s'mund të thuash në i ka gërryer koha apo i ka bërë njeriu. Sa për punët dyqind vjet e këndeje, i tregon edhe bariu gjysmak i kuajve, me ato këngët e tij si një vajtim i zgjatur, nëpër të cilat flet njeriu, duke të zënë mallëngjimi në fyt. Këto gjëra të Markeshit i dinte babai dhe zemra e tij që ngrohur përherë më tepër ndaj popullit që «bredh e lëviz». Këtë histori të Markeshit e ndiente në lëkurën e tij edhe ky kryetar tuhaf, ashtu si ndiejnë kafshët rrezikun.

Babai trokiste me çibukun të shuar në pëllëmbën e dorës. Tashmë nuk i mbetej pikë dyshimi se kryetari kishte ardhur aty për hetime, i shtyrë prej ankthit të vetmisë, prej mendjes së tij të fandaksur, ose i nxitur prej të tjerëve. Babai lëvizi duart mbi bark. Donte t'i thoshte se ai po lodhej kot dhe më mirë të çohet e të ikte. Po kryetari kishte mbështetur shpatullat në karrige, në sy kishte hutimin si edhe dëshirën për t'u hakmarrë kundër diçkaje të papërcaktuar.

— Ligji sheh përtej mureve, dëgjon në thellësi të dheut, — tha, me një dridhje në zërin e ulët e duke ndier krenari për ligjin dhe për veten. Ai besonte se shihte në Markesh gjëra që nuk i kapte syri i njeriut, atë lëvizjen e dytë të sendeve e të njerëzve që bëhet fshehur. I shihte këto falë xhandarëve, njerëzve që përgjonin dhe dinte ato që bëheshin sot, parashihte ato që do të ndodhnin nesër. Ai kishte qenë një burrë me pushtet e të drejta të qarta, me vetëdijen e plotë të

fuqisë së tij, dhe vetëm kjo mund t'i jepte qetësinë e shpirtit. Kështu kishte qenë para se të vinte në Markesh ky baba i egër, i çuditshëm. — Apo jo, nazari? — pyeti.

Babai tundi kokën. Fshatarët pëshpërisnin se kryetarit po i loznin vidhat. Por ky dukej se e kishte mendjen në rregull, një mendje të vockël dhe një shpirt të lig. Ky do të gëzohej me të tepërt të padiste popullin dhe sidomos babanë, i shtyrë nga një ambicie që mezi e përtypte në dhëmbët e vënë. Ky do të mban-te sytë hapët mbi babanë, duke u bërë përherë më i bezdisur.

— Folëm gjatë, — tha babai dhe vuri duart mbi gjunjë si për t'u çuar. Ai po e përzinte haptas. Kryetari u hoq se nuk e vuri re dhe u çua; bëri një marifet, përshëndeti me dorën në zemër, me dy gishtërinjtë e mëdhenj të mbyllur, kroi mjekrën me gisht. Babai i pa rrëshqitas këto shenja të fshehta të bektashinjve dhe vuri buzën në gaz.

* * *

Selman Gërvishta kishte lëvizur pas diellit duke mbajtur pranë pushkën me dru të kuq, që ngjitur më lart në bregore dhe prej andej shihte më nge lëndinat e bukura, shtegun e teqesë, si edhe plakun e vjetër, Arif Hasallën, që po vinte dushk në kopshtin prapa shtëpisë së vet. Plaku mund të ishte tetëdhjetë vjeç, ose edhe nëntëdhjetë. Në këtë vend mosha nuk matej dhe aq, se vitet nuk janë para që t'i numërojë njeriu. Ishte me trup të paktë e të thatë, markeshas sa s'mund të bëhej më tepër, me emër e me zakone, që ka në kokë vetëm ngjyrën e gjelbër të barit dhe gjethes së pyllit, e kërkon këtë ngjyrë edhe nën dëborë, di të

çmojë po ashtu kripën dhe ujin e, po t'i ketë këto tri gjëra që i duhen bagëtisë, plaku e di se prej tyre do të rrjedhin të tjerat, buka, shtroja dhe streha për njeriun... Plaku ishte gojëkyçur me njerëzit, po llapte me vete, bënte pyetje dhe po vetë përgjigjej, duke u rrekur të gënjente vdekjen edhe ca kohë. Po ama trurin e kishte ende të fortë dhe mendimet të fshehta, siç i kanë pleqtë. Vërtet, tani ka mbetur si një mulli i shkretë, i ka thënë të gjitha prej kohe, po, sikur të ngacmohet, prapë mund të thotë diçka.

Plaku u lodh, mezi e ngrinte sfurkun, i merreshin këmbët si një fëmije dhe zuri të kollej, duke zgjatur trupin përpara, a thua se i kishte ngecur një kockë në grykë. Kur u qetësua, u ul mbi gur dhe fshiu sytë.

Tani plaku dhe Selmani do të shiheshin së largu, me fytyrat si në mjegull dhe do të nisin bisedën pa zë, siç u ndodhte hera-herës. I pari murmuriti Selmani, duke buzëqeshur miqësisht me plakun:

Jeta s'mund të jetë kurrë aq e thjeshtë sa e sheh ti, o plak i vjetër i Hasallajve, që i sillesh mullarit, duke e pasur mendjen të zënë vetëm me ngjyrën e gjelbër, pa ditur përse e deri kur do të vazhdosh të vësh dushk, dhe prandaj nuk do të kuptosh kurrë se nga i vijnë prapësitë shtëpisë sate të shtrembër.

Plaku tundi kokën me qortim, shikoi gjetiu, sikur t'i murmuriste një të treti:

Ky Selmani premtion gjëra të mira që do të vijnë më pas. Veçse ato që dërdëllis ai s'kanë një emër dhe, sado të përpiqen bashkëfshatarët e tij, një emër nuk do të mundin t'u vënë. Ky njeri, Selman Gërvishta, hiqet se nuhat diçka, se ruan në veten një të fshehtë të dyshimtë duke ndryshuar nga fshatarët e tjerë. Dhe ka ca kohë që kjo ndjenjë i është bërë më e fortë. Me atë qëndrimin e tij të ngurtë i ngjan një langoi që e di se gjahu ndodhet fare pranë. Rri e prit si këlyshi në

diell, tha plaku dhe u kthye në brinjë. Mirëpo s'mund të rrish i qetë kur fqinji mendon diçka që ti vetë nuk arrin t'i vësh një emër, dhe plaku u kthye prapë ngadalë, të shihte Selmanin lart në kodër.

Selmani po i jepte vetes pushim, ndiqte disa mendime që e shqetësonin prej kohe për një pjesë të fshatarëve të tij, që nuk donin ose nuk mundnin të shihnin disa të vërteta të jetës. Hera-herës ngrinte sytë nga teqeja dhe shihte udhëzën që zbriste deri te Shkëmbi i Plakës, duke pritur atë ose ata që duhej të vinin. Kur të shihte sa dhe si do të vinin, do të mernte një vendim për çka duhej bërë. Por pas kryetarit të komunës s'kishte lëvizur më njeri dhe Selmani u kthye prapë në bisedën e largët me plakun e Hasallajve:

Njeriu gjithmonë pret diçka në jetë, nisi Selmani, ndryshe s'ka si ta jetojë. Dhe do të vijë dita që gjërat të thuhën me emrin e tyre dhe kjo do të ngjasë në jetën time. Sepse unë jam mjaft i ri dhe, megjithëse bota sipër nuk ndryshon, ujërat rrjedhin poshtë, si gjaku nën lëkurën e një njeriu të inatosur e të duruar. Po ti, o plak, me vrullin tënd të dushkut, nuk do ta arrish atë ditë. Në të vërtetë mua më vjen keq për ty, se në të ritë e tu ke bredhur në rrugët e gjata të Markeshit, i ndjekur nga mendimi se do të arrish lumturinë. Pak lumturi mund të kishe pasur në rininë tënde, po ti i ke shkuar pranë pa e parë, pa e kapur, ke gënjyer veten se mund ta gjesh pas bregut tjetër. Më në fund të zuri pleqëria, e pe edhe vetë se lumturia nuk mbin nga këto anë dhe as bie befasisht prej këtij qielli dhe kjo ndjenjë t'u mpi dhe vendin e saj ta zuri makutëria për dushkun.

S'kam nge unë të përrallis, tha plaku. Dhe lumturia s'ka ç'më duhet, se jam tepër plak, s'kam ku ta vë edhe po të ma japin. Ai u skërmit, pastaj u mendua me dyshim. Kushedi, pak lumturi mbase do t'u bënte mirë fë-

mijëve. Zemra e vjetër e plakut filloi të lëvizte. Po ky mendim iku nëpër mendjen e tij si një zog nëpër një hapësirë pylli, dielli i pranverës ishte i fortë dhe ai u ngrit, vuri dorën mbi vetulla. U duk sikur po qeshte dhe Selmani hapi sytë fort. Mbase plaku gëzohej, kërcente fshehtas sa në një këmbë në tjetrën tek shihte sa rrokullimë shkonin punët e botës. Hej, drej plak, tha Selmani.

Po plaku s'kishte nge të qeshte, eci ngadalë dhe doli si me hile prapa shtëpisë. Aty zuri të kthente dërrasat e bredhit që i ruante nën strehë për varrin e vet dhe i shihte herë-herës nëse thaheshin mirë. Kohë më parë i qe shfaqur vdekja, si një hije e rëndë, e fandaksur, i kishte bërë shenjë, pa i thënë asgjë, as orën, as mënyrat dhe mjetet dhe as i kishte dhënë kohë për një pyetje, qe tretur në mjegullën e trurit prej nga kishte dalë. Të nesërmen plaku kishte zënë të çante bredhin. Në dru lindim dhe në dru vdesim, kishte thënë, duke e parë bredhin me dashuri, duke e mbajtur punën të fshehtë. Ai ktheu kokën nga bregu, i trembur se mos e kishte parë Selmani, po ky qe i zënë në bisedë me sakatin.

* * *

Sakati qe kthyer poshtë duke zënë rrugën me lëvizjet e tij, me ato rrotullimet e trupit sikur të bënte gjysma rrrathësh dhe tani rrinte para Selmanit me fytyrën e zbehtë të djersitur.

— E shpëtova dhinë, — tha.

— Të lumshin ato duar. Ulu e çlodhu, — tha Selmani.

Nxori qesen dhe mbushi çibukun. Duhani ishte me kursim në Markesh dhe, sa më pak gjendej, aq më

shumë ishin burrat të dhënë pas tij. E futi qesen në gji, por, kur pa fytyrën e munduar të sakatit, i erdhi turp.

— Na ndize, — tha, duke i hedhur qesen. — Ilaçet e tua janë të mira. Po pse dreqin u dashka t'i mbledhësh në dritën e hënës?

Sakati ndenji si i kredhur në mendime për fatin e tij, me kokën mënjanë. Selmani zuri të mendonte për të me dashamirësi, duke e peshuar për aq sa ishte, një gjysmë njeriu. Në këtë botë mezi jeton me këmbë e duar të forta. Ky i gjori përpiqej të ishte i dobishëm, bënte sikur mjekonte ndonjë bagëti të sëmurë dhe të tjerët bënin sikur e besonin. Po kishte ngjarë edhe ta rrihnin kur i ngordhte. Ishte si i lindur plak, si përherë i uritur prej diçkaje pa emër. Mbase donte të kuptonte përse i kishte rënë tamam atij sakatllëku sipër dhe, meqë nuk arrinte të kuptonte, bridhte tërë kohën, me frymën të zënë, për t'i ikur këtij mendimi. Veçse, kohët e fundit, dukej sikur shpresonte në diçka. Kjo nuk e habiste Selmanin. Shpresat e vërteta për njeriun fillojnë kur arrin në fund të mjerimit, kur punët venë rrokullimë e s'ka ku të shkojë më keq.

Sakati e ndezi. Shikonte se sa mirë ujdiste çibuku me fytyrën e pjekur të Selman Gërvishtës, me mustaqet e shpupurishura rreth gojës dhe donte t'i rrinte sa më afër. Këtij Selmanit i bënin një përshtypje të thellë gjërat që shihte e dëgjonte, dukej sikur i gëlltiste brenda vetes për t'i bluar gjatë dhe gëzohej ose hidhërohej sipas rastit. Këtë mund ta kuptoje nga ngjyra e verdhë ose të kuqtë që i hipte në fytyrë. Ky njeri të jepte mbrojtje, po edhe të shtinte frikën. Gjuhës së tij të mprehtë i ruheshin burrat, se pastaj ai mund të kalonte befasisht nga fjalët në punë.

Sakati donte fort të tërhiqte vëmendjen e Selmanit. Po atë ditë Selmani merrej brenda vetes me mendime plot rëndësi, e tregonte çiltas fytyra e tij dhe kjo do të

vërtetohej më pas, kur të hapte gojën prapë. Sakati po shtrëngonte kokën të thoshte nga ana e vet diçka të denjë, po Selmani i bëri shenjë të rrinte urtë, ai kishte zgjatur trupin e shihte poshtë me sytë gri si të ngjyrosura në tym e që dukej sikur nuk i lëvizte kurrë, as kur përpiqte qepallat, as kur shihte thellë brenda teje si macja në të errët. Selmani shikonte toger Bedri Mëdyshin që kishte dalë me trupin e gjatë te Shkëmbi i Plakës, që ndalur e rregullonte koburen në brez duke parë nga teqeja si me gojën hapët. Selmani u çua si me përtim dhe pa se askush tjetër nuk vinte pas Bedriut, gjithandej vendi ishte i qetë. Selmani u ul dhe piu çibukun, duke menduar për babanë.

Baba Merxhani, që i kishte marrë zemrën Selmanit prej ditës së parë, po ngacmonte disa gjarpërinj, duke dashur të shihte brenda në vrimat e tyre. Po babai nuk ua njihte karakterin, llojin e helmit dhe mënyrën e goditjes. Kjo mund të dilte keq. Dhe ishte e kotë t'i thoshe babait të hapte sytë, se ishte i butë, po me zjarrin në zemër dhe, po t'ia hynte një pune, nuk prapsej kurrë. Këtë e kishte kuptuar Selmani, si edhe prirjet dhe qëllimet e baba Merxhanit për t'i dalë zot popullit të Markeshit, i kishte menduar në fshehtësi dhe i dilte gjumi natën, duke pirë duhan, duke menduar se ky baba i kishte dhënë jetës së vet një drejtim të ri po edhe të panjohur. Ky drejtim shkonte kundër qeverisë dhe hëpërhë kjo i mjaftonte Selmanit, për t'ia gëzuar zemrën dhe për t'i bërë t'i pohonte vetes se për një baba të tillë mund të jepje edhe gjakun.

Sakati, i zbehur, ndiqte me sy ngjitjen e togerit në teqe. Gjithkush e dinte në Qytezë, Gjin e Denë, se baba Merxhani kishte thirrur atë ditë Bedri Mëdyshin. Ndofta lajmi kishte arritur edhe në Bal. A do të shkonte togeri në thirrjen e babait? Ja tek po shkonte dhe fill i vetëm.

Selmani foli ngadalë, duke shikuar nga afër fytyrën e ndryshuar të sakatit:

— Po të mos kishte në botë njerëz si baba Merxhani, qysh do të mbahej jeta gjallë?

Ai s'kishte shpresë të kuptonte sakati, po njerëzit duhej ta kuptonin në njëfarë mënyre. Se fshatari në Markesh qe i rrethuar nga çdo anë prej partisë qeveritare dhe, me ardhjen e këtij babai, teqeja ishte dera ku mund të trokiste gjithkush për një hall a një këshillë. Ky besim duhej forcuar te njerëzit. Selmani po vërente qetësisht fytyrën e sakatit dhe foli prapë me gjuhën që mund të kuptonte ai. Tha:

— Ky baba vjen prej kohëve të lashta për të na treguar si të jetojmë me të drejtën dhe të vërtetën. Këtë baba nuk e duan armiqtë e popullit të Markeshit. Ai duhet mbrojtur.

Këto sakati i dëgjoi në heshtje, si një mendim e porosi të një autoriteti të lartë. Ai po shihte fytyrën e Selmanit të mallëngjyer e si të mbushur me lot, gjë që s'kishte ngjarë kurrë. Sakatit iu zvogëlua fytyra, i lëvizën sytë me shpejtësi. «I kanoset një rrezik», — kishte thënë Selmani. Këtë sakati e kuptoi mirë, zuri t'i dridhej trupi, u çua në këmbë dhe tha:

— Ngjitemi në teqe.

Selmani nënqeshi, kapsiti sytë e mëdhenj dhe tha:

— Rri e dridh cigare. Mendimet i ke të mira dhe gjakun prej burri. Këto e tregojnë njeriun e jo shtati. Po s'është nevoja e ndihmës sonë. Bedriu i vetëm aty s'pi ujë. Kurse ne të dy do të ruajmë se mos po vjen prapa ndokush.

Si tha kështu, Selmani u ul, me duart e forta mbërthyer në pushkën që e mbajti mbi gjunjë. Dukej sikur prej gjoksit të hapët i dilte një gërhimë e lehtë, në sytë e mëdhenj i ndizeshin shkëndija të verdha e të kuqe dhe po i ngjante gjithnjë më fort një maceje me

trup njeriu, me thonjtë të fshehur. Sakati ndenji pranë tij duke u përpjekur të mposhtte drithërimën e trupit.

* * *

— Ju, — i tha babai Bedriut, — e morët livadhin e Musa Allës, duke ia tërhequr me litarin e fajdesë. Me të njëjtin litar po i tërhiqni arën Dullë Cevanit.

— Kanë dashur vetë, — tha Bedriu. E rufiti kafënë dhe përpoqi gjuhën. Që të dy ishin të pushtuar nga një si dridhje e brendshme. Biseda bëhej me ndërprerje të rënda.

— Buka e gojës i çoi të trokisnin në derën tuaj. Kthejuni arat dhe të mbyllet kjo punë, — tha babai.

— Po paratë? Borxhi është borxh, — tha Bedriu. — Dikush shet e dikush ble. Kështu rregullohet kjo botë. — Ai hodhi sytë gjetkë. Nuk donte të ndeshte në shikimin e tjetrit, se i ngatërroheshin fjalët.

— Sheriati e ka pranuar tregtinë, po jo fajdenë, — tha babai. — Zotrote je anëtar i këshillit të teqesë.

— Pare me fajde jep edhe banka e shtetit. A mos vallë ato paratë e bankës kanë tjetër bojë e tjetër tringëllimë? — Kishte ndier se po i bëhej parasë një kërcënim. Kur e mendoi këtë, mori zemër, se paraja ishte e patundur, themeli i jetës, dhe ai vetë toger rezervist, duke pasur nën urdhër postën e xhandarmërisë. Drejtoi trupin e gjatë dhe e pa baba Merxhanin si nga lart.

— Po të mos u kthehen tokat Musait dhe Dullës, teqeja do të bëjë të sajën. Ata po vdesin për bukë, — tha ngadalë babai.

— Allahile, çfarë do të bëjë teqeja? Veç në pagoftë paratë, — tha Bedriu. — Eh, or babë. Frangat e arit nuk mblidhen si thanat në pyll. — Ai qeshi me zë të

lartë me nervozitet, fytyra e plasaritur e me rremba të kuqe iu mavijos prej kënaqësisë që i jepte mendja e vet.

Babai e pa me kureshtje. Toger i ishte i përgatitur, i mbushur me fjalë të zgjedhura, që do t'i perdoorte dendur me ëndje, derisa t'i futnin në kokë fjalë të tjera për ndonjë punë tjetër; ishte budalla dhe kryeneç si budallenjtë. Babai nenqeshi me miler, me fytyrën të errësuar. E kishte vëshirë të fshinte zemerunin, përpiquej të fliste sa më ulët. Po mendonte se tani muna të kalohej papritur caku i asaj që ndodhej në mes të të dyve, si një kërcënim pa lormë e pa emër.

— Teqeja do të bëjë diçka, — tha, duke fërkuar duart në prehër.

— Teqeja le të shohë punën e vet, — tha Bedriu. Lëvizti trupin, rripi i trashë prej meshini me pulla të vogla bakri që mbante në mes kërcëti. Kaloi uoren si me marifet në ijen e majtë, afroi nagantin e mbretit dhe priti me vetullat lart.

Baba Merxhani hoqi taçin dhe e la në postiqe. Të mos ishte ai të pirët e katesë me përçmim dhe të folurit me përçmim të Bedriut, që po ia prishnin gjakun që prej fillimit, babai do të kishte bërë me të një bisede të qetë. Të mos ishte ajo lëvizje për të rregulluar koburen në brez! Kaluan disa çaste, gjatë të cilave dhoma u përkund në sytë e tij. Babai po shihte gjak. Po u përmbajt, kaloi dorën mbi flokët e rrallë dhe prapë foli me zë të ulët:

— Do të presim një përgjigje në tri ditë e sipër.

Të folurit e babait, kalimi i dorës mbi flokë, gjaku që i vërshoi në fytyrë, e turbulluan togerin më shumë se ç'do të bënte gryka e një kobureje. Ai ndodhej para një force të panjohur dhe po e shinte babanë me sytë e zmadhuar.

— Si thua, zoti Bedri? — pyeti babai me zë të ulët,

të huaj. Shikonte para tij njeriun e padrejtë që duhej të nënshtronte ose t'i thyente kokën dhe bënte çmos të mos i lëvizte duart.

Togeri pati një ndjesi të çuditshme, sikur dhoma të përmbytej ngadalë prej një uji të zi në trajtë avulli që ngjitej gjithnjë më lart. Ky ujë nuk të lagte, por të merrte frymën. Këtë ndjesi e kishte provuar në fëmijëri, ose e kishte parë në ëndërr. Tani shihte vetëm sytë e ngulitur të babait.

— Nazari, ke ngrënë bukë në kullën tonë, — tha dhe fshiu djersën.

Babai tundi kokën e nuk foli, mori frymë i lehtësuar. Po mendonte se ajo që duhej bërë ishte shtyrë për më vonë, në një kohë të pacaktuar.

Togeri foli si me grykën të zënë e duke shikuar që poshtë vetullave, ndërsa skuqej i tëri.

— Të këshillohemi edhe me vëllezërit, o babë.

Babai pa mjerimin e tij. Togeri mbahej si i pari i shtëpisë. Po fuqinë në kullën e tyre e kishte Rati.

— Gëzuar pra, — tha babai. — Të vini në teqe me lajme të mira, duke ngritur lart nderin tuaj. Mos harroni, për tri ditë.

Sekretari, Galip Nuri, po e shihte babanë nga dera e prapme paksa e hapur. Që kur doli Bedri Mëdyshi, babai kishte ndenjtur pa lëvizur, në gjysmëerrësirë, me hijen në mur, me taçin përpara. Mendohej thellë, si i veçuar nga bota, dhe prapë me vetëdijen e plotë të botës. Në çaste të tilla fytyra i merrte forcë e bukuri të madhe. Babai lëvizi krahun dhe nxori që poshtë postiqes koburen «Golt», e mbajti në dorë, ia pa tytën dhe zuri t'i rrotullonte mullirin. Në qetësinë e thellë të dhomës kërcitja e mullirit dridhte ajrin dhe e qetësonte babanë. Tanimë ai ia kishte hyrë një rrugë pa kthim. Edhe tri ditë... Sekretari deshi të tër-

hiqej pa u ndier, po krisi dera ngadalë dhe babai ktheu kokën, me shikimin të qetë, me vetullat të puçura. Sekretari mendoi se ky ishte baba Merxhani i vërtetë, një baba me fuqi të tmerrshme; po në të njëjtën kohë mendonte se po aq i vërtetë ishte ai baba Merxhani tjetër, që pinte e këndonte, me zemrën shend e verë dhe që e pëlqente fort shakanë. Sekretari po rrinte i përkulur e duke mbajtur frymën. Babai vuri koburen nën postiqe dhe i bëri shenjë me kokë të afrohej, të ulej.

Galipi zuri të fliste anash për ato që mendonte se mund t'i duheshin babait. Kishin dalë në punë katër pendët e qeve dhe kishte ardhur mjeshtri nga Çernika për dërstilën. Vija e ujit do të përfundohej në të hyrë të korrikut. Vitin tjetër teqesë do t'i tepronte misër... Babai e dëgjonte me mendjen larg, por, kur sekretari foli për vijën e ujit, ngriti kokën dhe tha:

— Tri ditë në javë do t'ua japim ujin falas fshatarëve të Qytezës.

Sekretarit iu duk se dhoma gjysmë e errët po kri-dhej më poshtë, në mënyrë të rrezikshme. Sekretari i dinte sherret për ujin. Provoi edhe një herë ta tërhiqte babanë në shtigje më të qeta. Tha se sharra punonte mirë dhe dërrasat do të çoheshin me kuaj në Fushë-Lizë.

— Bedri Mëdyshi do të përjashtohet nga këshilli i teqesë, — tha babai, me kokën përpara, me fytyrën të mavijosur.

Sekretarit i rrinte ndër veshë kërcëllima e thatë e mullirit të kobures. I bëhej sikur dëgjonte kërcitjen e lehtë të trarëve të teqesë.

IX

Tri ditë më pas togeri rezervist, Bedri Mëdyshi, pinte raki te dyqani i Tomës. Në fytyrën e gjatë, me vetullat dhe mustaqet e zbardhura, kishte atë hijen e errët të Mëdyshajve, që nuk u ndahej as kur qeshnin. Ai po thoshte se, në kishte ndokush punë me të, le të vente te kulla në Gjin dhe, po qe se ndonjëri shpejtohej, mund ta gjente edhe aty te dyqani, duke pirë raki deri në drekë. Ai, togeri i mbretit, e zinte për bishiti cilindo që trazohej në punët e tij, siç kapet një zhapi i ngjitur për muri. Si tha këto dhe qeshi me zhurmë, ndenji e priti. Që të ishte barazi me gjatësinë e trupit të vet dhe me gradën, i duhej një faqore raki; këtë e kishte pirë para se të hynte te Toma dhe tani po e kalonte masën me atë shishen e dyqanit dhe, me këtë shishe të dytë, një tjetër Bedri mund të vepronte për të. Por prapë mendjen e kishte, ktheu sytë e skuqur nga dera dhe mati kohën. Kohë mbetej pak. E dinte se ato që tha po udhëtonin nëpër lagje drejt teqesë. Një fjalë e thënë aty te Toma i binte lagjes rrotull dhe kthehej te thënësi e ndryshuar dhe e ujdísur para se ky të mbaronte gotën e dytë. Tani pritej vetë njeriu, të cilit i qe drejtuar fjala.

Pra ftesa e hapët për baba Merxhanin ishte dërguar që të zbriste te dyqani i Tomës, për të marrë faqe njerëzve atë përgjigjen për Musa Allën e Dullë Cavanin, të cilët e kishin rreth fytit litarin e fajdesë. Kjo punë ishte bërë tashmë, me dëshirën e vetë babait, një grindje e hapët ndërmjet dy partive të vjetra armike të Markeshit. Disa fshatarë dolën nga shtëpitë duke i krijuar vetes një shkak dhe zunë të sillëshin me marifet rreth sheshit «Belik». Të tjerë përgjonin nga dritaret ose dilnin për ndonjë punë në oborr, me

sytë herë nga rruga e teqesë, herë nga dyqani i Tomës, ku pinte raki togeri me nja dy miq. Kjo ishte një kurdisje e Ratit, që kishte nxjerrë në kafe atë cjapin e vjetër, vëllanë e madh dhe kjo kurdisje mbetej për t'u parë, në kohën kur komuna dhe postëkomanda rrinin si të mbyllura, ashtu si di të rrijë qeveria, në ditët kur duket se harron veten, gjë që nuk ngjan asnjëherë, sepse qeveria të lë të bësh dhe pastaj del befas e të kap për veshi, siç bën i zoti i shtëpisë me çunakun që ka hyrë në bostane. Po edhe kjo mbetej për t'u parë.

Pak më vonë, kur pritja u bë e gjatë, ata që kishin ndenjur brenda, zunë të dilnin deri te shtigjet e të ktheheshin prapë. Çdonjëri do të donte të ngjitej në teqe, të ndalte babanë, ose të paktën ta vononte. Po sikur ta bënëin këtë, e dinin se babai do të humbiste diçka nga bukuria e madhështia e tij, nuk do të ishte më ai i pari. Kështu si erdhën punët babai duhej të shkonte te Toma dhe nuk mbetej veç të thurnin urime në zemrat që ai të ndahej mirë, në emër të fshatarëve që mbronte, të teqesë e të besimit. Po pse nuk vinte babai?

Ai po zbriste me shërbëtorin nga Shkëmbi i Plakës dhe atëherë gjithkush mendoi se babai nuk ishte vonuar aspak. Ai veçse kishte ecur ngadalë, siç i kishte hije, i veshur me rrobën e bardhë, si një njeri prej dëbore. Kur arriti në krye të sheshit, eci me duart prapa, duke mbajtur në to çibukun e gjatë. Ai zbriste fort rrallë në sheshin «Belik», kur i bënte shkollës vizitë, kur e hiqte rruga dhe ndalej për t'i këmbyer dy fjalë me fshatarët. Babai zbriti me nge në sheshin e vogël të pjerrët dhe u drejtua te dyqani, si një blerës. Para se të hynte, u ndal të fliste me dikë, si njeriu që pyet për çmimet e pjacës. Kjo sjellje e babait, ardhja aty pa armë, sikur përhapën qetësinë, po në të vërtetë kësaj nuk i besonte njeri dhe, thellë në zemër, nuk donte kush që ai të kishte ardhur aty pa armë.

Selman Gërvishta pinte duhan në kullë me mikun e tij, Rahman Denën prej Bali, kur mori vesh se baba Merxhani po zbriste te dyqani i Tomës. Kulla e Selmanit ishte te Qafa e Gurit përtej teqesë, lajmi aty kishte shkuar me vonesë. Selmani nxiti mikun të mbathte opingat dhe vetë mori pushkën e doli te lajthia të mbante vesh.

— Po vjen koha e Aqif pashës me plot gjëra të reja, — i tha mikut Selmani tek zbrisnin me hap të zgjatur.

Rahmani mendoi se ky Selmani, që ecte me hapin e butë, të fshehtë, gjithnjë fliste gjëra të habitshme. Po kësaj here kishte diçka të veçantë në fjalët e tij. Rahmani u turbullua, drejtoi trupin, shtrëngoi pushkën në sup dhe tha:

— Ajo kohë do të vijë, veç të ndizet diku në Shqipëri.

Selmani e shikoi me habi, pa e ndalur hapin. Rahmani po i dukej si një kafshë e madhe e zënë në kurth: Ky e shihte botën si të mbështjellë në një mjegull gënjeshitare dhe hapte sytë e shtrëngonte mjekrën për të kuptuar. Kjo ia turbullonte edhe shpirtin, se nuk arrinte të kthente në fjalë atë që mendonte. Kokën e rëndë e mbante drejt mbi trupin e madh e të fuqishëm. Mbase ishte vërtet pak i vonshëm në të kuptuar, po atë që kuptonte e ndiqte pastaj deri në fund. Të tillë e njihte Selmani, që në djalëri. Kurse kohët e fundit miku kishte ndryshuar, kishte zënë të fliste lirshëm e me fraza të gjata. Prej dy vjetësh Rahmani vinte gati çdo javë në teqe, rrinte pa folur, shikonte babanë me qetësi, vrojtonte sendet me atë kureshtjen e përmbajtur e me një çiltërsi që e pëlqente aq fort babai. Dhe niste biseda e tyre rreth punëve të bagëtisë e të Markeshit. Dituria e Rahmanit buronte nga shpirti, shfaqej aty-këtu me ndonjë fjalë, gjithnjë në kohën e duhur. Babai e nxiste të pinte ngapak, të fliste dhe do të gjente

një porosi a një shkak, që t'ia lehtësonte Rahmanit vizitën tjetër. Ky priste në stanin e tij në Bal të mbushëj java, merrte pushkën e kuqe të ndritur dhe për dy orë arrinte në teqe, me hapin e gjatë ritmik, me mendjen te gjërat që kishte për të pyetur.

— Babai sot do t'i thyejë Mëdyshajt, — tha Rahmani. — Veç të arrijmë. — Në ballin e gjerë e të dalë i qenë mbledhur rrudhat nga dhimbja e shpresa. Fuqia e tij e madhe e gëzoi Selmanin, fërkoj mustaqet dhe tha:

— Do të arrijmë, mos ki merak, — këtë ia thoshte zemra, ishte fare i bindur se asgjë nuk do të ngjante pa arritur ata. Prej shumë kohësh Selmani kishte pritur te shtegu i teqesë dhe në kullën e vet i pushtuar nga një dëshirë që i bëhej përherë më e fortë, për të marrë prej babait një urdhër çfarëdo, në një natë e në një vend ku askujt tjetër s'mund t'i jepej ky urdhër dhe tani i dukej se çasti kishte ardhur.

— S'kemi pse ngutemi, se ta dish që edhe babai nuk ngutet kur inatoset thellë, — tha Selmani. Rahmani e shikoi pa folur, me një qortim të egër në sy.

Te shtëpia që ndërtonte teqeja për mësuesit dhe inxhinjierin, së cilës po i hidhnin çatinë, Selmanit zuri t'i ngrihej njëfarë dyshimi. Se një punë e keqe mund të ngjajë më shpejt nga sa e mendon, asnjëherë nuk i dihet. Selmani zuri të qortonte veten, u hodh te gardhi dhe pa babanë të ndalur te sheshi. Aty ishin pak njerëz, po dukej sikur mbushnin vendin. Ishin myhibë të vjetër dhe ca të tjerë. Do të prisnin aty dhe do të bënin atë që duhej. Selmani shikoi ndërtesat qeveritare dhe rrotull lagjes dhe ndjeu heshtjen, përgjimin e rëndë. Markeshi po mbante frymën, me zemër të dredhur, që baba Merxhani të mbaronte punë. Selmanin e pushtoi një valë dashurie për bashkëfshatarët, po kërceu vendit e zuri të zbriste duke u hedhur majë gu-

rëve, kur pa se babai hyri te dera e shtrembër e kafenesë dhe u zhduk si në një grykë të errët.

Kur hyri babai, burrat u çuan, ishte mbajtur e lirë për te tryeza në krye. Në tryezën përballë pinin raki togër Bedriu me vëllanë e vogël, Habidin dhe me dajën, Said Peshkun. Edhe ata u çuan, duke lënë të dukeshin koburet.

Babai zuri të fliste me fshatarët, të bënte shaka, duke menduar se, kur je një baba teqeje, duhet të dish në çdo kohë atë që bën. Ndërsa ai tani nuk dinte se ç'do të bënte më tej. I trembej vetes. E kishin ndjellë aty për ta fyer dhe ai kishte ardhur. E dinte që kur u nis nga teqeja se do të ngjante një gjë e rëndë, një vrasje dhe kishte hyrë në kafene me dëshirën e fshehtë e të verbër t'i jepte fund, të bënte diçka me duar. Ndërsa ai zëri nga brenda ngrinte krye duke i thënë se duhej të kërkonte ndonjë rrugë tjetër. Po çfarë?

Bedriu nga tryeza tjetër qeshi fort duke hedhur trupin lart, me diçka që i tha daja. Kjo e qeshur i erdhi babait pas kokës si një hingëllimë kali. Po qeshnin me të. Babait iu nxeh balli. Kurse mendimi i rridhte qartë e ftohtë, si në një xham. Dukej se ajo që ishte për t'u bërë nuk do të shtyhej. Ai hodhi sytë rreth fshatarëve dhe u nënqeshi fytyrave të tyre të hutuara. Pastaj i tundi kokën Tomës.

Toma rrinte me dorën në zemër pas banakut, tregtar esnaf e i përmbajtur, i hedhur prej fatit në këtë vend të thellë e të largët, ku çdo blerës qahet për shëndetin, sikur aty të ishte farmacia ku jepen ilaçe falas, dhe pastaj ky blerës zë e sheh qindarkën nga të dy anët dhe i bën vetes një varg me pyetje para se ta he-

dhë mbi banak. Në mëngjes Tomës i kishte hipur një gëzim i shqetësuar, sepse dita i qe dukur më e mbarë nga çdo ditë, po pastaj kishte vënë re fytyrat përgjuese e të dyshimta, i kapi veshi pëshpëritjet, dhe ai zogthi i zi filloi të rrihte krahët fort ndërmjet gjoksit të tij dhe stomakut. Kur erdhi toger Bedriu dhe tha ato fjalët, Toma pa se tregtinë do ta merrte lumi, zuri të lëkundej bota, pas pak një dorë e madhe do t'i hiqte çatinë dyqanit, ai do të mbetej në mes të sheshit e në mëshirën e gjithkujt, me raftet, thasët, arkat, teneqetë dhe damixhanët prej qelqi. Ai ulte qafën tërë kohën dhe shihte me ankth përtej xhamit dy ndërtesat qeveritare, si të mbyllura, që ndillnin vetëm ogur të zi. Të mbyllura ishin edhe shkolla e zyra e postë-telegrafës, e cila në të vërtetë hapej rrallë. Në xhamin e dritares shfaqej hera-herës fytyra e ndonjë fshatari që rrotullonte sytë e tërhiqej prapë. Tomës po i ngrinin gjymtyrët.

Kurse tani Toma po shihte baba Merxhanin të bisedonte qetësisht me fshatarët dhe këta qeshnin si me druajtje. Nuk po ngjante asgjë. Toma fërkoj mustaqet spic, i ndritën sytë e vegjël të shpejtë dhe zuri të lëvizte pas banakut, si një mi i madh, i gatshëm t'u shërbente të gjithëve pa fitim, mjafton që klientët të dilnin sa më parë dhe t'i vinte shulin derës për atë ditë. Por atij iu kthye shpresa, kur baba Merxhani porositi nga një raki për gjithë sa ndodheshin në kafene, duke përfshirë edhe Tomën vetë. Toma filloi të mbushte gotat, hijet që shiheshin aty më parë u zhdukën, po thoshte me vete se nuk dihet nga vjen e keqja dhe e mira dhe zgjaste qafën të dëgjonte bisedat, në gjendjen e një njeriu që porsa ka hedhur një hendek të rrezikshëm... deri në çastin kur Bedri Mëdyshi tha nëpër dhëmbë:

— Po bëhet rrush e kumbulla pasuria e teqesë.

Kishte qëlluar një çast qetësie, siç ndodh nganjëherë në kafenetë, dhe ato fjalët të thëna nëpër dhembë i dëgjuan të gjithë, dhe mbajtën vesh, me frymën pezull.

Baba Merxhani shikonte ngultas togerin. Në sytë e tij mbeti vetëm togeri. Aty më parë ishte nisur ta pyeste me zë të lartë nëse do t'i lironin fshatarët prej fajdesë, po me atë që tha togeri ia mori fjalën nga goja. Tani babai donte t'i dëgjonte fjalët përsëri, të bëhej më e qartë fyerja.

— Pa thuaje edhe një herë! — tha.

Bedriu drejtoi trupin dhe tha:

— Mua më quajnë Bedri Mëdyshi dhe i dal për zot fjalës sime kurdoherë.

Babai hoqi taçin dhe e la mbi tryezë. Me këtë lëvizje ai shkarkonte një pjesë të inatit, zinte e freskohej koka e tij me flokët e rrallë. Ai po mendohej në qetësinë e thellë të dyqanit, ndërsa një gëzim i thellë i vlonte në zemër. Armiqësia e tij me Mëdyshajt kishte filluar nga dita kur vuri këmbë në teqe, po ishte mbuluar me kujdes nga të dy palët, duke shkelur anëve, duke i ndenjtur sa më larg njëri-tjetrit. Kjo armiqësi ishte fryrë nga pak në vite. «Ajo që do të bëhet ka për t'u bërë më pas», — i kishte thënë vetes herë pas here. Tani koha erdhi. Ai shtyu taçin më tej, si për të treguar se s'kishte punë me këtë simbol, dhe këtë e vërtetoi me atë që bëri më tej dhe me fjalët që tha.

U çua në këmbë, xhybja e tij e bardhë u fry, u duk se mbuloi kreun e dyqanit dhe brenda kësaj xhybeje qëndronte burri, si duke thënë se po dilte nga rroba që mbante veshur, për të qenë si çdo burrë tjetër, të paktën një herë të vetme në jetë. Këtë e kuptoi gjithkush, duke i dhënë të drejtë, duke harruar për një çast se kjo e drejtë s'mund t'i jepej. Ai lëvizi krahët si një kafshë e madhe që do të çlirohet me mundim prej lëkurës së vet, po nuk e hoqi xhyben, nxori me vërtik koburen,

nuk u pa se nga e nxori, veç ajo shkëlqeu me dritë të zezë në dorën e tij. Ai uli kokën, me «Goltin» drejtuar mbi kokën e Bedriut, foli shkoqur me zërin e rëndë që s'linte shteg:

— Para se të jem baba teqeje, unë jam Merxhan Dalipi prej Buzit të Madh. Dil jashtë, ose t'i ngjita trutë në mur. — Kishte gjakun në sy kur ngriti çarkun me gishtin e madh, dinte vetëm një gjë: se kishte ardhur çasti i hekurit, plumbit dhe tehut të thikës dhe këtë çast ai e kishte pritur. Bedriu ishte çuar përgjysmë, me gojën hapët, do të hidhte këmbën prapa, dhe ky ishte shpëtimi, apo do të vinte dorën në kobure, dhe kjo ishte vdekja.

— Puthi dorën babait, dil jashtë! — i thirri daja, Said Peshku.

Rahman Dena, që zuri dritën e derës me trupin e madh, mbeti i shtangur në vend, por që prapa tij doli Selman Gërvishta, rrëshqiti si pa u parë dhe mbuloi me trup babanë.

— Jo ashtu, o babë, na i lër neve këto punë, — tha ai.

U përmendën të tjerët dhe hynë në mes, nxorën jashtë Bedri Mëdyshin. Babai u ul dhe zuri të pinte rakinë, duke marrë frymë me zor, duke murmuritur sharje që s'duhej të dilnin nga goja e një babai. Pastaj ndenji i zyrtë, si gur. Ndërsa vijonte të pinte rakinë e të fliste më tym me fshatarët, duart i lageshin prej djersës. Po i thoshte vetes se inati, tërbimi, janë punë e njeriut të dobët. Një baba me koburen në dorë në kafene! Si e la veten të binte në këtë grackë? Këtë do ta paguante me pendimin e rëndë të natës, kur do të sillej rrotull në dhomë derisa të mpinte gjymtyrët, duke e kthyer inatin kundër vetvetes.

Ai ngriti kokën dhe pa me habi fytyrat e kënaqura të fshatarëve, që donin t'i rrinin sa më afër, e shikonin

me një krenari e gëzim të përmbajtur, por të nxhtë. Selmani, që i rrinte përballë, qeshte si me vete, me këmbëngulje, me fytyrën të skuqur, sikur të kishte dalë papritur në një breg të gëzuar. Babai deshi të fshihte buzëqeshjen, të kthente kryet gjetikë, po sytë e hapur e si të përlotur të Selmanit e nxitën të qeshte me të madhe.

X

Më 21 mars të vitit 1937, në mëngjes, babai hapi një faqe të re në regjistrin e madh. Numri i myhibëve në Markesh arrinte njëqind e njëzet. Tctëdhjetë të tjerë ishin nga fshatrat përtej maleve. Po rritej fuqia e teqesë, pushtonte shtëpitë njërën pas tjetrës.

Në janar qe përjashtuar për vjedhje Shaqir Kora prej Dene. Ishte i dyti emër që shuhej në regjistër. Thoshte myhibi duke vënë përpara babait qeleshen dhe litarin e dorëzimit:

«Zot, o zot, fytyra ime në dhe..., shpirti im theror, mishi im lutje. Përkthyes! Dikush është dëmtuar nga dora ose gjuha e fakirit? Në pastë një shpirt vëllai që të jetë dëmtuar, le të vijë, le të flasë.»

Kishin folur myhibët, kishte treguar secili punët dhe mëkatet e veta, sidomos ato të fqinjit, duke ia prishur gjakun, duke i bërë të tjerët të ndrisnin sytë. Kjo shoqëri bazohej në kallëzimin. Shaqiri qe paditur për vjedhjet e përsëritura dhe babai kishte shqiptuar vendimin. Atë ditë s'mund ta mbyllte punën me tregime për bëmat e imamëve dhe kalifëve në shkretëtirë.

Babai bëri shënime të tjera në regjistër, duke nxjerrë nga pena geramat e pastra si rruaza blu. Kur mbaroi,

zuri të shfletonte faqet e trasha e të verdha nga e para. Secili baba kishte shtuar ose hequr diçka në mbarëvajtjen e teqesë, duke lënë në fletët gjurmët e punëve të tij. Ai e mbylli regjistrin, që ishte i udhur me kapakë kartoni me late-lule bektashiane, dhe nxori nga sënduku i vjetër një defter të vogël të lidhur me lëkurë. Këtë e kishte parë edhe herë tjetër dhe qe habitur me frazat e lëna përgjysmë. Në krye ishin shënimet arabisht të baba Jasnarit, me punët e hershme të teqesë. Në fletën e fundit ishte palosur poema e Kaigasuz sulltanit:

*Me një fije floku urën krijove mbi brigje,
le të vij në sklleverit, — the, — ta kalojnë lumin
ujëplot,
po hero në qofsh i pari hidhe hapin
dhe na lër të jetojmë këtu ku jemi, o zot!*

Cili nga baballarët e shkuar pati kënaqur shpirtin me këtë poemë që tallej me zotin? Babai i fryu pluhurit të letrës, i mbylli defterët në sënduk dhe futi çelësin në brez, zbriti poshtë të shihte përgatitjet e hashures, që festohej pas dy ditësh, më 25 të marsit. Kishin kaluar dhjetë ditët e matemit, gjatë të cilave myhibët lagin gojën me lëngje të tjera, po nuk pinë ujë, në kujtim të imam Hysenit.

Dervish Selimi piqte bukët te furra, çdo ditë shtatë tepsi, bukë misri të ardhur, të bardhë. Atë ditë duhej të piqte dyfishin. Ishte i ri, i fuqishëm, djersa i shkonte çurg, po nuk prapsej nga goja e furrës që kthente flakët. I fliste shërbëtorit me zë të lartë që t'i jepte dru të trasha. Prapa oborrit po ndreqeshin vendet për tre kazanët e mëdhenj të hashures, që do të viheshin në zjarr në darkë e do të zienin tërë natën. Ali Çela, qehajai, me sytë dhe hundën e një harabeli të shpejtë e

të gëzuar, nxiste shërbëtorët, duke u folur fshehtas, duke përpjekur pëllëmbët. Babai u kthye të hynte në oxhak-kafe dhe vuri buzën në gaz. Njerëzit ecnin me kujdes e si në përgjim, sikur nga bota e vdekjes do të vinin me të vërtetë mysafirët e lartë, ata që nisi në fillim Haxhi Bektash Veliu për në viset e Rumelisë.

Dervish Lala i vjetër, me trupin e thatë si hark, po vinte në kamare duhanin e grirë për vizitorët, si dhe letrën. Rreth e qark dhomës së madhe ishin shtruar velenxa të reja, që nga ashefi vinte era e fortë e kafesë së pjekur. Dervishi u kthye duke dredhur kokën lehtas dhe mbeti si pa frymë.

«Zogu i vogël që re nga dega, Haxhi Bektashi të dha strehën e tij...»

Sytë e bardhë të dervish Lalës po kërkonin diçka me ngulm, duke e kthyer baba Merxhanin pesëmbëdhjetë vjet prapa, kur rendte në Teqenë e Madhe, që të ishte i dobishëm për të gjithë.

Djaloshit i ngrohej trupi kur ndonjë dervish i vinte dorën në kokë. Po mund edhe ta kapnin fshehtas për veshi, duke e peshuar aq sa të çohet prej tokës, ose t'ia ngjeshnin befaz me pëllëmbë pas zverkut. Këto ngjishnin në ahuret, në ashef, në oxhak-kafe. Të njëjtët dervishë inatçinj kishin një fytyrë të përvuajtur, asnjë muskul nuk u lëvizte në ato fytyra, kur ngjiteshin lart te dedei. Djali habitej fort dhe i ndiqte këto ndryshime të fizionomive me kujdes, duke marrë largësinë sipas rastit. Ai kishte arritur aty si ndenji tri ditë në ullishtat pa bukë, i arratisur prej shtëpisë ku kishte

shkuar shërbëtor. Ishte dhjetë vjeç, këlysh i egër, dhe trokiti në derën e teqesë me fuqitë e fundit. I kishte rënë të fikët kur i hapën derën, që do të mbyllej pas tij përjetë. Në teqe kishte bukë e strehë dhe ai nuk do të arratisej andej një herë të dytë edhe sikur t'i rripnin lëkurën. Po asnjëri s'kishte ndër mend ta rripte dhe ai bridhte tërë kohën, për t'iu bindur gjithkujt.

Në ato vitet e fëmijërisë djali s'kishte dhe aq kohë të merrej me veten, se në teqe hynin e dilnin njerëz të ndryshëm, mjafton të shihje këta njerëz që ta mbahe mendjen të zënë, duke dëgjuar ndodhitë e hallet e secilit. Dhe kishte ditë kur dervishëve të plogët u hipnin ethet, gjithkush në teqe mbante frymën, niste përgjimi, kalonin pëshpëritje të fshehta; lëviznin dritat e çirakëve. Ishin netët kur lart në mejdan-evi mblidheshin myhibët të këndonin, të pinin shërbetin, të merrte dorë një talip. Këto djali mund t'i shihte me fantazinë e tij të ndezur, duke ndenjmur poshtë, pranë dervishit të vjetër, i cili ishte qor dhe i dinte punët. Ky dervish rrinte në postiqen e tij si bretkosa në pellg, ushqehet me ato që murmuriste, s'hante asgjë, ose hante fshehtas, nga frika e zolit. Dukej sikur në çastin tjetër do të kërcente jashtë postiqes me të thirrur, po nuk kërcente kurrë, e shumta sillej nëpër dhomën e vogël të errët, merrej me gjëra që s'mund t'i kuptoje; ndalej befas, dëgjonte zhurma të nëndheshme që askush s'i ka dëgjuar, me trupin si hark, a thua se priste të thyhej boshti i tokës. Në çaste të tilla dukej sikur i kthehej drita dhe zinte të shihte vërtet, thoshte fjalë pa thënë asgjë, duke e bërë Merxhanin dhjetëvjeçar t'i dridhej zemra. «A je aty, or bir?» Dervishi qorr shtrinte dorën, ia gjente kokën, përpiqte buzët e rrjepura, i thoshte si me të qarë: «Zogu i vogël që ke rënë prej folesë! Haxhi Bektashi të dha strehë në shtëpinë e tij.»

— Urdhërove gjë, nazari? — pyeti me zë të ulët dervish Lala, duke fërkuar sytë e bardhë. Ky zbriste në oxhak-kafe në ditët e shënuara. E mbante në rregull dhomën e madhe, ziente kafe pa pushim, çonte te babai vetëm ata që duheshin çuar. Shërbimet e këtij dervishi ishin të mira.

Po një dervish është gjithnjë i fshehtë, i heshtur, i avashëm, i budallepsur. Baba Merxhani po e shihte me kujdes. Ai qe përpjekur t'i afronte dervishët e shërbëtorët, t'u hiqte druajtjen. Ua dinte prirjet, dëshirat, zakonet. Kujdesej për ushqimin e veshjet e tyre. Po ama duhej të shpejtonin në punë. Tani ata kishin mësuar të shpejtonin. «Për cilat punë?» — pyesnin sytë e bardhë të dervish Lalës.

XI

Kapter Kadri Ibrahimi po kalonte urën e Dronit. Ishte i ngopur me gjumë dhe në xhepin e vogël të jekut mbante frangën e bardhë që ia fitoi në mbrëmje rreshter Dedës, duke luajtur me zare. Ai filloi të ngjishte të përpjetën zigzage me hapin e lehtë të gjuetarit që del të shohë leqet dhe grackat e tij. Prapa ecnin në largësi të matur dy xhandarë, me pushkët shtrënguar, duke imituar hapin tinëzar të ustait, duke përpirë me sytë e zgjuar të zanatit shtëpitë, gardhet, pritac e mundshme prej nga mund të sulmohej rendi publik.

Atë ditë kapter Kadriu kishte ndër sy një pre të lehtë, një varfanjak prej Gjini, që vodhi dhinë. Do të gjente gjurmë e prova, në mos mishin e zier, lëkurën ose eshtrat, vendin ku mund të ishin groposur. Po të

mos i gjente këto, aq më mirë, se do t'i shtronte në dajak me hunj thane, me këmbët në rrip të dyfekut, dy vëllezërit dhe atë plakun e tyre rrjepacak. Se kur ia vë njeriut këmbët në rrip të dyfekut e ia shtrëngon paq, dhe goditja në tabanin e ashpër i shkon në bosh-tin e kurrizit e drejt në kokë, atëherë do të thotë se e hëngri dhinë edhe në mos e pastë ngrënë; e do të shtojë edhe si e kishte mishin e si i kullonte dhjamët, do të flasë për çdo gjë që i pëlqen xhandarit të dë-gjojë. Ai, kapteri, do të mbante edhe procesverbal, që do ta dërgonte në rrethkomandë. Le ta dinte zoti major se ç'mbante posta e Markeshit, as gjarpri në tokë, as zogu në ajër s'mund të kalonin pa lejen dhe pëlqimin e kapter Kadriut. Se ky zell ka treguar gjithnjë në punën e tij, përtej zellit të çdo kapteri, ndryshe si do të mbaheshin në zap këta fshatarë, që mund të vjedhin goftë edhe për inat të xhandarmërisë?

Kapteri hyri në shtëpinë e të paditurit dhe i mjaftoi të rrotullonte sytë për t'u bindur se në atë ahur të varfër e të zhveshur s'kishte gjurmë dhie. Dy vëllezërit, plaku, daja i tyre prej Korene i ardhur mik, pinin raki me gota si gishtëza. Sado i varfër të jetë markeshasi, do ta ruajë për mikun një gotë raki kumbulle, ose thane, ose kumbull e thanë trazuar. Ata nuk luajtën vendit. As folën. Foli plaku kryeneç: «Dikush i hipën kalit qorr.»

Kapteri kontrolloi pa zemër «burgun» e bagëtive, bahçen dhe mullarët e dushkut. S'ishte rasti të shtro-hej dikush në hu aty brenda. Katër burrat që kishin vazhduar të pinin raki pa luajtur vendit, sikur e ki-shin nuhatur vizitën dhe qenë përgatitur. Dukej nga kokat që i mbanin futur në supe se do të kundërshto-nin rrahjen. Sidomos plaku kryeneç me sytë e kuq. Po diçka duhej bërë. Të paktën të merrej për një «pyetje» në postë ai Dulla, djali i madh. Kapteri e nisi Dullën

me dy xhandarët dhe vetë ia mbajti lart nga kulla e Mëdyshajve prapa shkëmbit.

Kur dolën jashtë lagjes, xhandarët i hodhën prangat Dullës. Ky u habit, po nuk tha gjë. Xhandarët e vunë në mes dhe shpejtuan hapin. Kur po kalonin urën për t'u kthyer në Qytezë, u gjetën befas para baba Merxhanit.

Ky kishte qenë në lumë për të parë valanicën e teqesë që po ndërtonte ustai i vjetër prej Shijani. Babai kishte ndenjur një copë herë të shihte ustanë. Dukej sikur ai punonte jo vetëm me dorën që mbante veglën, po me çdo pjesë të trupit. Me sy ndiqte lëvizjen e gishtërinjve, të përpiktë, të saktë e të fortë dhe i përgjigjej babait pa e ngritur kokën. Po ndërsa punonte i tëri, brenda tij ustai merrej me diçka tjetër. Babai po kthehej, duke menduar fort për atë gjënë brenda vetes me të cilën merrej ustai dhe ngriti kokën si pa kuptuar kur Selman Gërvishta që ecte prapa i tha:

— Po na vjen dikush.

Xhandarët me të arrestuarin kishin qëndruar në anën tjetër të urës, pa ditur nëse duhej të ndalnin, apo të ecnin në rrugën e detyrës. Babai u bëri shenjë me kokë të vazhdonin dhe ata shtrënguan pushkët në sup, kaluan urën e drunjtë që krisi e u lëkund nën hapat e tyre.

— Pse e keni lidhur këtë njeri? — pyeti babai.

— Ka vjedhur dhinë, — u përgjigj xhandari i parë.

Babai u afrua dhe pa fshatarin. Ky nuk i uli sytë, as hapi gojë.

— Nuk e ka vjedhur. Hiqjani prangat. Le të vejë në shtëpi, — tha babai.

Xhandari i parë deshi të thoshte diçka dhe mbeti me gojën gjysmë të hapur. I dukej se bota zuri të rrotullohej në krahun e kundërt, ndërsa Droni me ujin e dëborës bënte zhurmë për dreq.

— Po të provohet faji, dhinë e paguan teqeja. Hiqjani prangat, — tha babai.

Ai ishte veshur me petkun fetar që nderohej prej shtetit. Ai dukej tepër i madh, askush s'kishte guxuar në Markesh t'i kthente fjalën. Ai i kishte vënë koburen në gojë toger Bedriut. Atij i puthte dorën vetë kapter Kadriu dhe kryetari i komunës. Dhe zëri i tij ishte i qetë, po urdhërues. Po priste më këmbë me sytë mbërthyer mbi xhandarët, kurse prapa tij rrinte Selman Gërvishta, me kokën lart, me tytën e pushkës poshtë, me duart të lidhura prapa, a thua se flinte në këmbë. Po nën atë pamjen e tij të qetë e të lëmuar regëtinte shpirti i gatshëm i maces, që pret të kalojnë zogj të pjekur në ajër.

Xhandarët i hoqën prangat fshatarit dhe ikën duke i puthur dorën babait. Ky e mori veç fshatarin dhe i tha:

— Vjedhja është haram, poshtëron burrin.

Fshatarit i erdhën lotët në sy, ktheu kokën dhe tha:

— Që prej Novruzit s'kemi vënë mish në gojë.

— Atëherë pse nuk fole para xhandarëve?

— Është e kotë, o babë, se ata nuk besojnë kurrë.
I ka shtyrë dikush.

XII

Erdhi darka dhe në oborrin e teqesë flakërinë zjarret e mëdha të kuqe, që shpërndanë errësirën, duke nisur festën, dhe u vunë mbi ta kazanët e hashures. Tej tymit dhe zjarrit vërtiteshin shërbëtorët, ngjanin sikur po digjeshin dhe aty-këtu lëshonin thirrje të mbytura. Si i pa këto për disa çaste, babai u ngjit në mejdan-evi,

në dhomën e mbledhjeve, ku nuk hynin veç myhibët dhe aty u ndez çiragu i ligjit. Lëvizën dhe pastaj u fiksan shkrimet e figurat në mure, koka të prera mbështjellë me shami të zezë, me mjekra e sy të zez të habitur, armë të vjetra si cfurqe rrëqethëse, luanë me fytyrë njeriu, të gatshëm për të kërcyer sikur të mos pengoheshin prej këmbëve të rënda, egërsira të panjohura mbuluar me shkrime, taçe, hajmali në trajtë darthe e kandili...

Drita e çiragut hidhte hijet mbi tavanin e gdhendur me yllin me dymbëdhjetë cepat, në altarin me katër shkallët dhe shtatë kandilët, mbi gurin e mejdanit. Aty brenda çdo gjë ishte një simbol, një numër. Ai që di t'i lexojë kënaqet se i kupton dhe sheh se s'ka kuptuar asgjë. Myhibët s'dinë të lexojnë. Një baba e nxjer forcën prej figurave, shkrimeve e simboleve, si edhe prej atyre që thotë. «Deri kur dhe përse?» — pyeti veten baba Merxhani.

Komisioni, myhibët më të vjetër e më të zgjedhur, hoqën opingat, puthën pragun e derës së «Aliut» nga të tri anët dhe zunë të hynin varg. Puthën dyshtemenë, bënë lutje para postiqes bosh «të atij prej Horasanit që mungon», morën niaz para babait, i puthën dorën, gjurin e djathtë, të majtin, zemrën, u sollën në gjunjë nëpër dhomën gjysmë të errët duke murmuritur lutje, sipas numrave e simboleve, si ca buburrecë të mëdhenj që kërkojnë shpirtin dhe mendjen. Më në fund u rresh-tën në gjunjë anës mureve dhe pritën fjalën e babait.

Në dhomën e madhe dëgjohej vetëm kërcitja e dritës së çiragut. Te shkallët, rreth oborrit, përgjonin rojat. Teqeja po shkëputej prej kësaj bote. Babai zuri të fliste, figura e tij humbi në të kaluarën, në kohën e heronjve bektashinj.

Ai tha se u mbushën 600 vjet nga vdekja e kryezotit, Haxhi Bektash Veliut, që nuk pranoi të bëhej mbret

i Horasanit. Ai erdhi në Ah-Sehir dhe aty i doli përpara Seid Hajruni i hipur mbi një luan, duke mbajtur për kamxhik një gjarpër dhe treqind mullahë ngrinin pluhur prapa tij. Haxhi Bektashi i hipi shkëmbit dhe i doli përpara Seidit hipur në këtë shkëmb, duke treguar fuqinë e tij dhe që atë ditë u përhap më tej fara e besimit.

Si tregoi për mrekullitë e tjera, të treguara treqind herë, babai zuri të këndonte nefeset, poezitë e Edip Harabit dhe Riza Teufikut. Atëherë myhibët u gjallëruan e u habitën, se babai zuri të nënqeshte, erdhi e u bë njeriu i çdo dite, i njohur e i afërt, për të cilin e kaluara heroike bektashiane as që ekzistonte. Pastaj babai heshti, me fytyrën nga dera. Myhibët lëvizën mbi gjunjë dhe ngritën kokat. Cilit talip do t'i hidhte litarin baba Merxhani në atë natë të shënuar?

Që prapa derës një zë thirri tri herë:

— O hapës i derës! O hapës i derës! O hapës i derës!

Myhibët pritën, me mendjet të veshura. Sipër tyre, fytyrat si prej allçie të shenjtorëve në kornizat me xham u duk sikur morën jetë e lëvizën sytë.

Babai u koll dhe u përgjigj:

— Mos hajde, mos hajde, mos hajde. Po erdhe, mos ik, mos ik, mos ik.

U ndie pëshpëritje, fërkimi i një trupi pas derës. Babai tha:

— Në të vërtetë ne të hapim ty një fitore të shkëlqyer.

U hap dera ngadalë dhe hyri një grua me një dolloma të gjerë të bardhë, këmbëzbathur, me flokët lëshuar. Tigjbendi, litari i pagëzimit me tri nyja, që e kishte thurur vetë, që i lidh myhibit gjuhën, dorën dhe belin, i përdridhej rreth qafës dhe trupit. Bishtin e litarit e mbante dervish Lala i vjetër që bënte shërbimet në divan-evi. Gruaja ishte 30 vjeçe dhe trupi i saj dri-

dhej lehtë nën dolloma. Dervish Lala kishte kënduar lutje për çdo gjymtyrë të gruas në të ndarën e fshehtë prapa dhomës, kjo duhej ta kishte tronditur thellë dervishin se tani rrinte me kokën prapa, jashtë rrethit të dritës së çiragut.

Babai i foli gruas:

— O kërkues, që do të hysh në rrugën e Muhamed Aliut, në karvanin e zotërve tanë...

Myhibët i dinin fjalët që vinin pas, shikonin gruan dhe dervish Lalën, një valë turpi kishte rënë mbi ta, po kjo ishte e përzier me nderimin dhe frikën, me forcën që vinte nga lart, e cila e kthente të keqen në të mirë, sipas një mendimi që njihej vetëm prej kësaj force, që kërkonte bindje, përluje e heshtje deri në varr.

Gruaja e bardhë dhe e hollë po sillej rreth dhomës, duke kryer ritet ngadalë, me lëvizje të thella, me shpirtin që i dridhej. Më në fund u ul në gjunjë në vargun e myhibëve. Këta i bënë vend dhe u përkundën, sikur në mejdan-evi të kalonte një erë e vakët, e largët, e fryrë prej gojës së «atij prej Horasanit që mungon». Dervishi u spërkati duart me lëng trëndafil me erë të mirë, njëherë babait pastaj myhibëve. Babai i foli gruas:

— O talip, fytyrë e zotit... ki besim të dish se feja jote është e vërteta...

Babai fliste me zë të ulët, me shpirtin të vvarë, duke i dhënë gruas «telknin», mësimin e fshehtë.

— Mos shtrëngo atë që dora jote s'mund ta mbajë... sillu me kujdes, fol me përlësi...

Në dhomë dëgjohej vetëm frymëmarrja e rëndë e myhibëve. Dukej se gruaja nuk kuptonte asgjë. Po edhe në i harroftë fjalët bektashiu, gjurmët e tyre do t'i mbeten në mendje, si të parat gjëra që mësoi në jetën e tij të re e të fshehtë. Gruaja ngriti fytyrën përmes flokëve të lëshuar. Fjalët e lashta magjiplote të

babait kërkonin diçka prej saj, mbase shpirtin, dhe ajo ishte gati ta jepte, por s'dinte ç'të bënte për ta treguar këtë. Në krah të saj rrinin burra që i kishte njohur. Tani ata i dukeshin të huaj, hijerëndë. Shihnte me bish-tin e syrit lëvizjet e duarve të tyre, pa ditur nëse duhet t'i imitonte, mësimet e dervish Lalës i kishin dalë prej mendjes krejt dhe i shkuan lot prej tronditjes, ose nga mendimi se po humbiste përgjithnjë lidhjet me jetën e saj të parë. Këtë e vuri re Sadi Pejza dhe tha nën zë: «Lotët janë tespihet e grave.» Ishte i vetmi që mernte guximin të murmuriste fjalë në prani të babait.

* * *

Në mesnatë, kur në dhomën e miqve kishte shkuar përpara rakia dhe mishi i pjekur, filluan këngët. Myhibët zunë të deheshin, duke qenë akoma esëll, të harronin, të hapnin me këngën e tyre rrugën, duke synuar hakikatin, mposhtjen e fuqisë së mishit dhe lirimimin e shpirtit, bashkimin me zotin dhe ishin të gjithë shokë të udhëtimit të largët të panjohur që nuk do të ndaheshin kurrë.

Afër mëngjesit vrulli bektashian kishte rënë. Disa myhibë qenë përmbysur. Nja dy qanin me lotët çurg, belbëzonin fjalë të ngatërruara për shehitët në mure ose për ndonjë brengë të thellë të vetën. Qëndronte mirë babai, që mund të pinte tri ditë rresht dhe të rrinte një javë pa pirë, si edhe disa të tjerë. Rahman Dena rrinte me trupin drejt. Ky njeri ishte pjekur ngadalë, gjatë tërë jetës, ishte bërë një kockë që s'mund të thyhej. Ai lëvizi dhe doli në dritë fytyra e tij e zbardhur. Dukej sikur ballin ia shtrengonte një rreth i nxehtë dhe kërkonte sytë e babait, si për ta pyetur rreth atyre që ndodhën dhe gjërave që do të bëheshin

më tej. Në fytyrën e tij, si një vare e rëndë që mund të flasë, lëvizën muskujt, u duk sikur tha diçka. Po nuk foli. Në cepat e buzëve të tij u duk një nënqeshje, fytyra iu ndryshua krejt dhe tani dukej si një baba-xhan me sytë e ndritur që fal gabimet e gjithkujt. As mundej, as guxonte të qortonte babanë, më parë vdiste siç ishte ndenjtur, se të bënte një gjë të tillë; ai vetëm donte ta pyeste, me një lutje që i qe mbledhur në shpirt.

Babai mori frymë thellë dhe shikoi gjctiu. Pak më lart ishte Galip Nuri, që shikonte rrotull, tallej lehtë me të gjithë e me gjithçka. Në krye rrinte Sadi Pejza, me fytyrën të mprehtë, me hundën si sqep, si një shqiponjë e vogël majë gurit, krahëmbledhur e me pamje të qetë, por e gatshme t'i turren viktimës në çastin tjetër. Ai i fliste dikujt, sipas zakonit të tij, si kryeplak i ditur, me fjalë të zgjedhura, ngadalë e me lehtësi. Ky burrë ngrihej mbi mjegullën e pijes, shihte rrotull me syrin e vëzhguesit që nuk harron as veten, as të tjerët, edhe kur e ka trurin të turbulluar.

— Rëndësi ka fjala, — po thoshte.

Babai nënqeshi. Fjalët e bektashiut nuk thonë asgjë. Fjalët janë diçka dhe gjërat diçka tjetër, njëlloj si shkronjat e varura në mure.

Babai ktheu kokën nga dritarja, me zemërën plumb, me syrin të qartë. I kishte kaluar gjumi krejt. E mban-te zgjuar mendimi i kotësisë, që e sulmonte si qen i pabesë e i përhapej në trup si helm dhe atëherë zinte e i rritej ngadalë neveria, që ia kthente pijen në ujë. Kjo mund të vazhdonte gjatë, nga mëngjesi në darkë, nga darka në mëngjes.

Poshtë trazuan zjarret dhe pruset u ngritën sikur të qe hapur një grykë furre. Në lindje ngjyroste agimi. Edhe tri orë dhe teqeja do të mbushej me njerëz. Babai do të fliste para kazanëve me zërin e lartë mallën-

gjyes. Siç kishte bërë edhe vitin e kaluar. Njëlloj si vitin e kaluar gëzimi e fanatizmi fetar do të përshkonin turmën. Do të rridhnin lotët. Po, ndërsa njerëzit do të thitheshin nga fjalët e largëta e të vështira për t'u kuptuar, mendjet do t'i kishin te gjëja e mirë që avullonte nën kapakët e bardhë të kazanëve, të renditur për bukuri nën drurët e mollëve. Do të hante gjithkush, deri në ngopje. Më në fund fëmijëve do t'u mbushnin tasat për pleqtë, të sëmurët e të miturit.

Babai nuk dinte se ç'do të fliste pas tri orëve. Asnjë zë nuk i vinte nga brenda. I dukej se çdo gjë që bëhej, ecte nën shtytjen e forcave të fshehta e të vjetra dhe ai, veç do të përtypte ca fjalë, si çdo vit në atë ditën e shënuar të hashures. Ai ngriti kokën dhe ndeshi prapë në sytë e Rahmanit, që pinte raki ngadalë, me fytyrën si në lutje. Rahmani lëvizi buzët, si për të thënë diçka që ndofta nuk e kuptonte as vetë. Pastaj babai dëgjoi, ishte i sigurt se kësaj here dëgjoi zërin e mekur të Rahmanit: «A bën kështu, or babë?»

XIII

Hamdi Qafës, burrë i ndershëm e i varfër, i lindi djalë, pas shtatë vjetësh martesë. Ishte lutur që nun i fëmijës të bëhej vetë baba Merxhani.

Nusja u ul në gjunjë me foshnjën në duar dhe babai nuhati erën e qumështit të nënës, që nuk ngjan me asnjë erë tjetër. Babai bëri zakonin, i preu fëmijës flokun, i fryu në fytyrë, i vuri mbi gjoks një nuskë dhe një napolon flori, që ndriti si yll në sytë e njerëzve të shtëpisë. Babai mori doçkën e fëmijës, ia pa i menduar dhe tha:

— Lind fëmija me pëllëmbën e dorës të shkruar. Po kush di të këndojë në pëllëmbën si tul i njomë punët që do të bëjë e që do të lërë mangët? Le të quhet djali Flamur dhe ky emër i priftë në jetë.

Babai ndenji pa lëvizur, duke parë fëmijën që flinte, u gëlltit e qeshi, ndërsa një trishtim i mprehtë po i hynte në shpirt. Mbase edhe atij i kishte fryrë ndonjë dervish, njëzet e gjashtë vjet të shkuar, dhe kishte ndenjor ta shihte po ashtu. Veçse nuk arrinte ta përfytyronte veten fëmijë, me një gisht ballë, dhe duke fjetur, me atë pikëzën e qumështit në buzën si qershshi e hapur. Vetëm nënën kujtonte, gjithnjë te pusi, buzagaz e me lotët në sy, të thatë e të drobitur, tek përpiqet të thotë diçka, që nuk do të arrijë ta thotë kurrë. Pastaj, shtëpinë e madhe e përpiu zjarri.

Në skajin tjetër të lagjes po vdiste plaku i moçëm i Hasallajve. Vdekja fillon të vijë kur të mërzhitet jeta. Plaku kishte zënë prej kohe të afrohej me vdekjen, të përkulte kokën ngadalë si për t'ia dëgjuar erën, hapin e fshehtë prej hajduteje, për t'ia kuptuar kohën dhe qëllimin. Këto ishin punë të tij dhe ai kishte qëndruar në këmbë, duke u sjellë rreth bahçes së mullarëve, deri në fillim të marsit, kur zuri shtrojën e nuk u çua më. Dy herë kishin thirrur hoxhë Stanin që ta lante. Atë ditë plaku kishte kërkuar baba Merxhanin.

Babai ecte përmes lagjes me një ndjenjë të lehtë humori. Hasallajt ishin nga familjet e pakta jobektashiane në Markesh. Plakun e njihte, ishte i sjellë dhe i mirë, si pleqtë, po shikimi i tij i ngulur të ndiqte pas. Ndofta ishte pak tuhaf. Kur kaloi sheshin «Belik», babai zuri të ndiente shqetësim. Sigurisht ky plak do të bënte e do të thoshte diçka para vdekjes, duke besuar se e kishte parë atë. Po njeriu nuk di gjë për vdekjen, ashtu si nuk di për lindjen. Babai mbajti këmbët në oborr. Nga prapa shtëpisë, që dukej sikur rrinte shtrem-

bër, vinte era e vakët e dhive të kthyera nga kullota, ndërsa në të dy kthinat duhej të ishte e gjithë familja.

Djali i madh i plakut, Fekriu, gjashtëdhjet vjeç, e pa babanë nga dritarja dhe mbeti i habitur. Po vinte vërtet ai, me kurorën e babait rreth kokës, me fytyrën e pashme të ndritur, me sytë si thëngjij, me një zemër trimi, duke ecur me hapin e rëndë të qetë. Në dhomë ishte gati errët. Djali i madh, Fekriu, po luante duart të ndizte kandilin, që tymosi dhe përhapri erën e vajgurit, trazoi hijet. Kur u kthye nga babai, Fekriu e kishte fytyrën të djersitur, buzëqeshte me mundim, zuri të vinte rrotull pa ditur ku ta vinte mikun. Njerëzit e tjerë të shtëpisë rrinin më këmbë anës mureve, në pritje, me shikimet të humbura. I sëmuri ishte mbuluar në krye të dhomës, drita e mekur që vinte përmes xhamit të vogël të dritares binte mbi të, një vajzë pesë vjeçe i largonte mizat, sikur i bënte fresk.

Fekriu e gostiti babanë me gotën e rakisë, buzëqeshi si për të kërkuar ndjesë dhe tha:

— Do të na marrë malli gjithmonë më fort për plakun. — Ai priti me kureshtje, me trupin të përkulur, me atë buzëqeshjen që s'i ndahej, të shihte atë që do të ndodhte ndërmjet babait dhe plakut.

Plaku dëgjoi bisedën, largoi plafin dhe u ngrit ndënjur me mundim, fshiu fytyrën e zbehtë me pece. «Dëgjoni si macet», — mendoi babai dhe u ul pranë ta dëgjonte, të shihte nëpërmjet syve të plakut, për të kuptuar se si qëndron njeriu para vdekjes. Këtë kishte dashur ta zbulonte edhe më parë, kur i sillnin njerëz të sëmurë në teqe dhe ai u kishte lehtësuar vuajtjet, u kishte hequr tmerrin, me një fjalë, me një prekje të dorës.

Ky plaku i Hasallajve i hidhte sytë në botën tjetër. Shpresa, frika e vdekjes, kishin mbetur prapa. Plaku që nënshtruar, e kishte pranuar vdekjen si diçka që i

përkiste, me të cilën do të rrinte gjatë, dhe kjo nuk i sillte ndonjë shqetësim. Rënkonte e psherëtinte, jo nga shpirti, që e kishte të zënë me punë të tjera po vetëm nga mundimi i trupit. Babai nënqeshi e u afrua ndaj tij edhe më kur pa se plaku po mblidhte fuqitë, u çel dhe zuri të fliste. Djali i madh i rregulloi plafin prapa krahëve, që plaku të fliste sa më mirë. Plaku e pa me fëlënderim, po në të njëjtën kohë donte të mos i ndërhynte më tej. Plaku ngutej, se bota po ngushtohej rreth tij dhe në sytë e turbullt i lëvizte shpresa, si për të arritur diçka të madhe që donte ta merrte me vete. Babait po i shtohej habia.

Plaku paskësh hallin e botës. Tha se punët e njerëzisë shkonin keq e më keq, si edhe punët e shtëpisë së tij. Fliste ngadalë, duke heshtur nga njëra fjalë në tjetrën, a thua se e mendonte veç secilën fjalë, duke u përpjekur ta mbante gjallë deri në fund mendimin. Ankohej pa inat, si për diçka të pashmangshme që vjen nga një fuqi e errët, e cila do të prapset kur t'i mbushë ditët. Po a mund të bënin njerëzit diçka me mendjet dhe krahët e tyre, që kjo fuqi t'i mbushte ditët? Ai u lodh së shpjeguari mendimin e tij të ndërlikuar, tundi kokën mbi zverkun lëkurë dhe foli shkurt:

— A ka si të jetë ndryshe kjo botë, o babë?

Plaku priste me gojën gjysmë të hapur prej nga dilte fryma e hollë. Dëshpërimi i tij ishte i thellë e i qetë, një punë e trurit e bluar prej kohe. Kishte besim te babai i ri dhe tek e drejta e vet për të marrë një përgjigje. Kësaj po i rrinte në pritë e në përgjim, po në çastin tjetër mund të binte në dremitje të thellë duke humbur atë që mendja e tij e vjetër kishte kapur më parë dhe prandaj kapsiste sytë me shqetësim, që babai të ngutej.

Babait po i shtrëngohej zemra. Iu duk se gjendej i vetëm me plakun në fund të dheut dhe duhej ta ndih-

monte. Po të mos e ndihmonte, ky do të ishte një rast i humbur, nga ata që rëndojnë përjetë mbi njeriun. Po ky plak tuhaf e gjeti në befasi, askush s'kishte kërkuar ndonjëherë një përgjigje të tillë në pragun e shpirtit. Babai u përkul dhe e pyeti nën zë:

— Si ndryshe, or gugash?

Plaku hapi sytë, u duk sikur iu frynë damarët blu, tek nënqeshi si me përçmim. Tani dukej dinak, sikur kënaqej me veten që e bëri babanë të djersinte. Po nuk nënqeshte. Qe rrudhur edhe më fort prej dhimbjes. Ajo kishte qenë shpresa e fundit të merzte vesh për fatin e njerëzve, të gjente atë që kërkonte, shtegun që dinte vetëm ai, dhe ngrinte kokën me mundim. Po mendja e tij filloi të kridhej edhe më thellë, po shkëputej nga bota, dukej sikur në damarët po i kalonte një lëng i bardhë, po kalonte vdekja, si era e lehtë që shuan kandilin. Babai ngriti dorën si për të ndaluar këtë erë, dhe i foli plakut me gjuhën bektashiane, me shpresë ta rikthente, i tha një frazë të gjatë për kuptimin e jetës.

Plaku ktheu kokën nga muri, si me mërzi, sikur të kërkonte nga ajo anë derën e vdekjes. Baba Merxhani ndjeu zagushi, iu duk se vdekja po shrinte edhe më tej hijen e vet në atë dhomë gjysmë të errët. Ndërsa ai s'mund të bënte asgjë për të ndalur këtë të keqe dhe rrinte aty me duart mbi gjunjë, si një fëmijë i madh i zemëruar.

U duk sikur plakut po i kthehej për të fundit herë inati i vjetër pa emër, që s'e kishte lëshuar kurrë, se i kaloi mbi fytyrën e verdhë një si valë gjaku dhe vetullat iu puqën me kërcënim. Babait filloi t'i rrihte zemra, mbase tani mund të merrej vesh me plakun. Po plaku tundi kokën lehtë, si për të ndaluar fjalët.

— Njerëzit s'kanë faj, janë të vegjël, — tha. Po gatitej ta dorëzonte shpirtin pa e gjetur atë që kërkonte, fjalët që tha erdhën si nga humnerat e brendshme të

tij, ku po shembej diçka me rëndësi. Babai fshiu djer-sët e veta dhe zuri të inatosej. Ç'donte më në fund ky plak kokëshkëmb? Përse nuk vdiste rehat e të linte të gjallët në punën e tyre? Më shumë se plaku, babanë po e shqetësonte ajo buzëqeshja e djalit të madh. Dukej sikur djali i gëzohej plakut, si një stolie të vyer të çuditshme që duhej hapur për ta parë. «Shihe edhe vetë si është. Askush s'mund ta kuptojë atë», — thoshin sytë e djalit të madh.

Babai u zgjat edhe një herë nga plaku, që rrinte me kokën mbi gjoks, si një i vdekur ndenjtur, e kapi lehtë nga krahu dhe tha:

— Jeta mund të jetë edhe ndryshe, or gugash.

Plakut i kërceu trupi, po kjo vinte nga ajo që ngjiste brenda tij, s'kishte lidhje me atë që tha babai.

— Lind në mes të njerëzve dhe vdes i vetëm, — tha ngadalë e me dhimbsuri djali i madh.

Jashtë drita në qiell ishte ende e gjallë. Babait i qe dukur se kishte kaluar te plaku një kohë e gjatë, ndër-sa kishte ndenjtur më pak se gjysmë ore. Kur u ngjit «te shtëpia e teqesë», u ndal të shihte se nga përhapej mbi tokë drita e kuqërreme. Në muzgun e rëndë, perëndimi ngjante me reflekset e një zjarri madhështor, që digjet në thellësi të panjohura, përtej murit të jetës, duke rrethuar dheun në gjysmën e lëmshit. Në pak çaste zjarri i madh erdhi e u mblodh, mori ngjyrën e gjakut. Babai ndezi çibukun, priti që zjarri i padukshëm të humbiste dhe bota të binte në errësi, si në një katastrofë. Pastaj zuri të ngjiste të përpjetën e vështirë të shkëmbit duke gulçuar, me zemrën të rëndë. Kur doli te shtegu, u ndal, si i goditur befas nga një valë ajri e rrahur prej flatrave të një shpendi të madh. Në atë çast duhej të kishte dhënë frymën plaku i Hasallajve. Ky mendim e bëri të buzëqeshte. Gjithnjë kishte folur për vdekjen, si për një vizitor që ndodhej në

dhomën tjetër, po asnjëherë s'e kishte ndier vdekjen kaq afër e të mendonte se ajo i përkiste edhe atij, si njeri i gjallë. Po nuk ishte puna aty. Puna ishte te plakuri, tek ajo që kërkonte të dinte para se të shkonte. Ai plak do të ngrihej edhe nga varri për ta pyetur. Babai eci më tej. Në bregun e shkretë jehonin vetëm hapat e tij, po e pushtonte njëfarë ankthi. Duhej të shkonte në teqe, ku ndihej zot i vetes. Aty do ta shtypte ankthin me shishen e rakisë, që do ta ngrohte nga brenda si një zjarr i mirë. «S'ka tjetër», — tha me vete. Më lart u ndal të merrte frymë, dhe u ndie jashtë kohës, krejt i vetmuar, ndërsa bota rrëshqiste në errësirë.

XIV

Te dyqani i Tomës hyri Rat Mëdyshi, me atë përbuzjen, urrejtjen dhe egërsinë, që i fshihte aq bukur. Kaloi përmes tryezave me lëvizjet e ngadalta e të rënda, me të njëjtën lehtësi që dredhon ujku në pyll, a thua se në rrugën e tij nuk gjenden as drurë, as shkurre. Atë mëngjes ishte më i sjellë, më i afruar, i gatshëm të pinte një raki me cilindro fshatar, duke folur fjalë të urta, si mbrojtës i zakonit, i nderit e i të drejtës, duke qenë vrasës, hajdut e gënjeshtar dhe ishte më i pakuptueshëm se çdo herë. Po ai që e njihte nga afër, mund të shihte se atë ditë Rati ishte më i zbehtë e me fytyrën të tërhequr, sikur t'i kishte mbetur në grykë diçka e fortë dhe e dyshimtë. Ai ndenji para banakut me trupin e shëndetshëm dhe vuri aty duart e mëdha leshtore, gjithnjë duke lëvizur me kujdes e masë, që të mos harxhonte kurrë diçka nga fuqia e tij

në punë të padobishme. I shkeli syrin Tomës duke ia bërë akull boshtin e kurrizit, i buzëqeshi, si për të thënë se e kishte edhe me të një fjalë; porositi dy raki dhe shkoi te tryeza afër dritares ku rrinte fshatari i vetëm që u ndodh në kafe, duke bërë qejf të lehtë me një teke.

Rati e përqafoi fshatarin, një herë nga e majta, pastaj nga e djathta, duke puthur erën prapa zverkut të tij, u ul përballë dhe nisi bisedën duke e nxitur të fliste. Fshatari u mbështet në karrige dhe fshehu shqetësimin e kënaqësinë. Rati, i tërë fisi i Mëdyshajve, kishte rënë me baba Merxhanin si trangu i drurit me sëpatën.

Duke thënë ndonjë fjalë, Rati i mbyllte njërën sy fshatarit dhe këtij i dukej se ai e shihte me syrin e mbyllur më fort se me syrin e hapur. Se ky, Rati, e shtonte gjënë dhe fuqinë me ndihmën e natës e të hënës. Tjetër fliste, tjetër do të dilte; në çdo byrek donte të kishte një gisht. Sytë e gjelbra në të hirtë të Rati, me atë dritën që të mpin, qeshën sipër gotës së rakisë; ai u afrua me bërrylat në tryezë, nga zëri i ulët dukej sikur donte ta bënte fshatarin pjesëtar të një halli a të një të fshehte, ndërsa fliste për gjëra pa rëndësi. Fshatari qëndroi i patundur në karrige dhe foli për gjëra që flet gjithkush, duke u rrekur të kuptonte se nga ç'anë po ia ngreh kurthin miku.

Se Rati, kur ia vë syrin dikujt për ta zgjedhur ortak, rri dhe e shikon gjatë, si me keqardhje, sikur të kishte gjetur aty vëllanë e humbur, dhe e mbështjell me atë buzëqeshjen e madhe, ndërsa e heton me sytë e fortë, ia lexon mendjen sikur të shohë brenda radakes së tij, ose në shpatullën e tij të pjekur; kupton ato që mund të bëjë ky fshatar tani dhe në të ardhmen. Atëherë zë e i shfaq atij një miqësi aq të madhe, sa ia bën të pamundur kundërshtimin, ia hedh rrjetën nga të gjitha

anët. Dhe njeriu, që ka dalë nga shtëpia e vet dhe për punët e veta, pa e ditur se aty te qoshja po e pret Rati, s'ka rrugë tjetër veç të lidhet ortak, me shpresë e bindje se fati i tij do të jetë i ndryshëm nga ortakët e mëparshëm, të vjedhur natën prej Ratit dhe të paditur në mëngjes prej tij për vjedhje, duke nxjerrë Rati dy lekure prej të njëjtit berr, duke gëzuar ai jo vetëm fitimin, po edhe shakanë e hollë të mendjes; ha mishin e pjekur e pi shëndetin e ortakut, bën festë brenda vetes, duke menduar ortakun tjetër a punën tjetër që do të bëjë më tej, meqë asnjëherë nuk mbetet bosh, në çdo kohë do të thurë dy a tri kurthe njëherësh. Kësaj ia kishte më tepër frikën njeriu, përqeshjes që vinte pas dëmit. Kurse Rati s'të mbante inat dhe çuditej me inatin tënd, meqë jeta është e tëra një lojë dhe lum kush di të nxjerrë përfitimin.

Fshatari shikonte gojën gënjeshtare të Ratit, tek lëpihej e thoshte se punë të mira po bëhen në Markesh, në përshtatje me bujarinë dhe zakonin. Dhe shtonte pastaj, si me mendjen gjetkë, se çdo gjë në botë ka dy anë, të parën dhe të prapmen, puna është se cilën anë shikon çdo njeri. Si thoshte kështu, ia mbërthente sytë fshatarit, i buzëqeshte si për ta grishur që burra të zgjedhur si ai të shihnin atë anën e prapme, të fshehtë e të vërtetë të gjërave. Sytë e fshatarit lëvizën me shpejtësi. Rati nuk po i fliste për ndonjë lloj ortakërie. Halli qenkësh gjetiu.

Kishte kaluar java nga dita kur togër Bedriun e nxorën jashtë nga ajo kafene nën grykën e kobures së baba Merxhanit. Prej një jave Rati s'ishte parë në lagjen «Qytezë», duke pranuar thyerjen e Mëdyshajve. Kurse sot kishte dalë, më fort të shihte fytyrat, sesa të dëgjonte fjalët, qe sjellë në lagje prej mëngjesit dhe kishte parë e dëgjuar mjaft duke pirë duhan me njerëzit, duke u dhënë kutinë e vet. Baba Merxhani ishte

mbrojtja ndaj shpifjes e gënjeshtres, askush s'do të burgosej më kot aty e prapa dhe as do t'i merrej ara kujt me litarin e fajdesë; nuk do të ndodhte më që njëri të hante dhinë e vjedhur dhe tjetri dajakët; po dilte sheshit partia e vjetër. Këto dhe ca më tepër thöshin fshatarët, jo me fjalë të thëna, po me qesëndisjen në sytë e errët.

Rati po mendonte diçka të rëndë e të thellë, i mbyllur i tëri në atë që mendonte.

— Askush s'e di atë anën e prapme të gjërave. Askush s'mund të rrijë këtu e të shohë ç'bëhet prapa Bjeshkëve të Shatit, — tha fshatari me shpresë të dëgjonte diçka më tepër.

Rati u përmend. Lëshoi krahët e gjatë dhe qeshi. Pastaj zuri të trokiste mbi tryezë me gisht, duke treguar me këtë se sa të fortë e kishte kokën fshatari, duke i bërë atij një fyerje të rëndë, pa i dhënë të drejtën e ankimit. Bëri edhe diçka tjetër, i pagoi fshatarit rakinë, për t'i lënë një detyrim. Rati deshi të çohet, po që përtej xhamit pa dikë dhe priti me buzët mbledhur.

• • •

Kryetari i komunës po rrinte në bregun para zyrës me duart prapa dhe trupin të përkulur, sikur të shihte të lëviznin në lagje e në sheshin «Belik» gjëra të vockla. Kur mendoi se ndenji aq sa të vihej re dalja e tij, zbriti nëpër udhëzën e shtrembër me atë hapin qeveritar, administrativ dhe qëndroi në mesin e sheshit, duke shikuar rrotull. Në lindje, poshtë shkëmbit të zi të vetmuar, ishte xhandarmëria, me hekurat në dritare dhe oborrin me tel me gjemba, në jug shkolla me një kthinë e një mësues të vetëm, në perëndim një ndërtesë si me një kat e gjysmë, me shkallët e drunjta nga ja-

shtë, ku banonte me bagëti e me familjen e shumtë fillrojtësi, që shërbente edhe si postier. Këto ndërtesa, që të tëra me mur guri të palyer e me çati tjegulle, ishin pjesa shtetërore e Markeshit, të varura nga ndërtesa e komunës, me dy kate të plota me katër dhoma e me qepenat në dritare, që hapeshin nga polic Arifi çdo mëngjes dhe mbylleshin pasdite. Komuna zotëronte mbi sheshin «Belik» nga veriu. Nga kjo anë, pak më poshtë e në mbyllje të sheshit, ishte edhe dyqani i gjatë përdhes i Tomës, të cilin kryetari e mbante nën mbikëqyrje, si pjesë të tërthortë të pushtetit të vet.

Kryetari drejtoi hapin nga dyqani. Prej fytyrës së skuqur dhe nga lëvizja e supeve dukej se ishte i mbushur me lajme që do t'i tregonte duke pirë kafënë, me atë bindjen dhe entuziazmin e tij, si një pronar i ngjarjeve, si një pjesëmarrës në to, duke lëshuar thirrje aty-këtu. Po të shihte dyshim në fytyrat e dëgjuesve, më në fund do të hapte gazetën mbi tryezë, duke i lënë ata të habitur.

Kryetari u ul në tryezën në krye dhe Rat Mëdyshi shkoi e ndenji me të. Kryetari e pa si nga larg dhe e pyeti për shëndetin nëpër dhëmbë. Rati tundi kokën e nënqeshi. Erdhën në kafe edhe polici e fillrojtësi, që kishte sjellë të djeshmen gazetë e javës. Kur hynte kryetari në kafe, gjithnjë do të gjendej ndonjë i ngeshëm, që shkonte pas tij të dëgjonte diçka. Pas pak, dy fshatarë prej Bali, që do të blinin kripë te Toma, u ulën edhe ata të çlodheshin nga rruga e gjatë dhe pinë nga një gllënjë raki prej faqoreve të veta.

— Ç'kemi nga kryeqyteti, zoti Sefer? — pyeti Rati.

Në kafene zotëronte heshtja. Kryetari nënqeshi si një prej kryeqyteti i hedhur në këtë krahinë të largët që sheh rreth vetes shkretëtirën. Këtë nënqeshje e kapte gjithnjë në kohë dhe e përcillte Toma që prapa banakut. Kryetari zuri të tregonte, duke vënë hera-herës

pëllëmbën mbi filxhanin e kafesë, si për t'i mbajtur në zep lajmet e çuditshme:

Në Tiranë kishte ardhur konti Çiano me tre ministra të tjerë, me bustina e çizme të zeza, burra shumë të pashëm. Pritje e ballo në pallat. Shkëmbim dekoratash. Konti e kishte pilotuar vetë aeroplanin për në Berat, i veshur me uniformën e nënkolonelit të aviaçionit. Banka kombëtare, me drejtorin italian, me rastin e 9-vjetorit të monarkisë, i dhuron mbretit njëqind mijë franga ar dhe ai denjon t'i pranojë fisnikërisht. Të shkëlqyera janë edhe lajmet nga bota. Ra Madridi i kuq, u mposht Abisinia e egër, Japonia po i shtypte me milionë kinezët e veckël të verdhë. Duçja, Hitleri dhe Hiro Hitoja shpallën paktin antikomintern. Krahu i larmadhërisë forcohej brenda e jashtë Shqipërisë. Kryetarit po i dridhej trupi si një këlyshi të rënë në Dron dhe që spërkat njerëzit duke dalë në breg. Rati nënqeshte. Lajmet që përhapte kryetari mund të ishin të mira, po tani Rati nuk ua kishte ngenë.

— Na urdhëro për darkë, zoti Sefer, — tha ai dhe u çua.

Kryetari e ndoqi me sy, i habitur e i zemëruar. Ngjiste gjithnjë kështu në këtë vend të dyshimtë. Le të thoshe ç'të doje, le t'u thërrisje se u hapën qiejt. Ata të dëgjonin, rrinin duke pirë me kursim gotën e rakisë pa thënë asgjë, ose çoheshin e iknin më tej. Veçse, kjo ftesë e Ratit kishte një nënkuptim të rëndë. Kryetari ndenji duke menduar me shqetësim se nuk bëri mirë që i foli Ratit me fodullëk aty më parë.

* * *

Në dhjetor u hapën qiejt vërtet. U prenë rrugët nga Shkodra në Përmet dhe më lart në Korçë. U mbytën

bagëti, mijëra njerëz mbetën pa strehë, u kthye në një pellg të madh pjesa e ulët e Shqipërisë. Për këtë fatkeqësi Italia i dhuroi Zogut një milion e gjysmë lireta. Morën vrull të ri ballot në oborr dhe paradat e batalioneve me kolonelët në krye.

Markeshi ishte shtruar nën dëborën, që dukej sikur do t'i mbulonte përjetë të katër lagjet. Po, për çudi, jeta prapë lëviz. Në mbrëmje, ndërsa ujku ulërin deri te gardhi i shtëpisë, burri rri ndanë zjarrit me trurin si në zbrazëtirë, kthehet e shikon gruan e tij që nuk reshtet kurrë. Ajo ka në sy atë dritën që lëviz vetëm në sytë e grave të Markeshit, duke kërkuar diçka përtej atij dimri të ngrirë. «A po tregojmë edhe një përrallëz tjetër?» Mund të jenë edhe histori të vërteta barinjsh, që ngjajnë si përrallëza. domethënë «përrallëza» që ndodhin vazhdimisht gjatë kohës; nga dy ose tri përrallëza në natë, derisa të meken prej gjumit; janë «një-qind përrallëza», që njaftojnë deri në të dalë të dimrit.

Ky dimër në Markesh duket i ashpër, po sipër në teqe baba Merxhani rri ngrohtë në dhomën e shtruar me velenxa e postiqe, në vatër digjet zjarri me dru si kërcunj, e ngrohtësi vjen edhe nga ashefi në katin poshtë, kurse dervishi i vë përpara faqoren dhe mezenë.

Dervishi rri e shikon me habi babanë. Se këtij i ndodh një ndryshim, po bëhet përherë më i heshtur e më i vetmuar. Kjo nuk është një heshtje e vetmi prej babai, po diçka tjetër, më e rëndë. Babai ngre sytë dhe i bën shenjë dervishit të ikë, të marrë edhe mezenë.

Babai lexon gazetën. Mbi krahinat ia behin fatkeqësitë njëra pas tjetrës; shemben familjet, pëlçet toka, zotërojnë urrejtja e varfëria, jeta vërtitet me përtim si nën dhëmbëzat e një guri të madh, prej të cilit s'mund

të shpëtojë askush e asgjë. Dhe në mbylltë sytë njeriu për të mos parë këtë mjerim të dheut, do t'ia dëgjojë me veshë rënkimet.

Babai kthehet e sheh brenda vetes dhe nënqesh me lojën që bëhet aty. Gjithsaherë dëshiron të jetë thjesht baba, një baba i mirë që digjet në shpirt ngadalë, ai njeriu tjetër, Merxhani, i rri në pritë, nuk i fal më tepër se disa minuta qetësi. Ky dyfishim nuk mund të shtypet, as të mbulohet, se dëshira për jetën kthehet prapë me mall të shtuar. Po përse u dashka të shtypë çdo dëshirë e nevojë, të tradhtojë veten, t'i bëjë vetes një lojë të madhe? Që të fitojë epërsi e pushtet mbi njerëzit me dëshira, të sundojë mbi të gjallët, mbi ata që gjenden nën dhëmbëzat e gurit të madh. Ai rri gjysmën e natës me bërnylat nën gjunjë e me dimrin në zemër dhe në mëngjes prapë i thotë vetes se si kaba teqeja edhe ai duhet të jetojë, se jeta është si një lindje e zgjatur e njeriut sa kohë ai bën diçka. Babai prapë mund të bëjë diçka për Markeshin e për njerëzit. Veç kësaj, ajo që ia shton gjallërinë e kureshtjen është ndjesia se rreth tij po lëviz diçka e pakapshme dhe e rrezikshme. Po çdo gjë që mund të ngjasë përtej plogështisë e mörzities është e mirëpritur prej tij, qoftë edhe një lojë me vetë jetën.

XV

Kryetari i komunës, Sefer Tasi, e zgjati lejen, ndenji dy muaj pranë familjes në Lushnjë te gruaja e fëmijët dhe muajin e tretë e kaloi në Tiranë, që të merrte rrogat, për vete dhe për policin. Prej nëntë muajsh financa nuk u paguante rrogat. Duhej rregulluar edhe

emërimi i sekretarit, vendi i të cilit mbahej zbrazët për arsye të ngatërruara. Po mbi të gjitha Sefer Tasi u përkujdes për transferimin e tij, që nuk po vinte prej tetë vjetësh. Harxhoi një tok me para me një ankth të shtuar. Kishte ditë që e quante punën të kryer dhe nuk i zinin këmbët dhë prej gëzimit, për të rënë të nesërmen në dëshpërim të thellë. Dikush shtrinte dorën në çastin e fundit për t'i shembur të gjitha, si një ëndërr e ngritur në erë. Në mbarim të prillit u nis për në Markesh, me premtimin se miqtë do të bënin punën e tyre, po edhe ai duhej të bënte diçka, të gjuante rastin për t'u shfaqur në ndonjë mënyrë.

Sefer Tasi po mendonte me keqardhje për veten, se shpërblimi nuk vjen sipas zotësive e përpjekjeve të sëqilit, po sipas tekave të një fati të çuditshëm. Rrugës kishte rënë në një mërzi të thellë, duke menduar se s'kishte arritur të plotë asnjë nga dëshirat në jetë, edhe në kohët e para, kur e pati ndihur fati. Po, me të arritur në komunë, s'deshi ta jepte veten dhe nisi punën me zell, për të vënë në vend gjërat që ishin prishur në mungesë të tij dhe kokën e mbante më lart se më parë, duke dhënë të kuptohej se prapa qëndronte një e fshehtë me rëndësi që do të zbulohej në kohën e duhur. Po s'kishte asgjë për të ndrequr dhe ai zuri të ndihej përherë e më i vetmuar. Në Markesh qeveriste teqeja. Kjo teqe, që ishte prerë në fillim sipas masave të Markeshit, ishte rritur përherë më tepër, duke i zënë rrugën qeverisë nga çdo anë. Kjo s'kishte ngjarë kurrë; në asnjë vend, me asnjë teqe dhe as që i dukej fundi kësaj pune.

Dëshira për të mos dalë prej zyre iu bë kryetarit edhe më këmbëngulëse, filloi të humbiste shijen e të ngrënit dhe përfytyrimin për kohën, duke u bërë këto të qarta në fytyrën e tij dhe në sjelljet. Këtë ndryshim të thellë e pikasi sidomos polic Arifi, që i shërbente edhe

si gjellëbërës. Ky tani s'kishte asnjë dyshim se kryetari po lajthiste krejt prej vetmisë shumëvjeçare, prej teqesë me të fshehtën e saj, prej karakterit të bano-rëve të Markeshit, osë ngaqë i tillë ishte gatuar kryetari vetë. Polici e pa të udhës që këto t'ia tregonte kap-ter Kadriut, si i vetmi autoritet që mund të bënte diç-ka. Polici pa me habi se në fytyrën e kuqe të kapterit u end një buzëqeshje e gjatë. «Mos e bëj fjalë me as-njeri — tha kapteri. Pastaj tha: — Ne jemi fuqia e pa-tundur. Të tjerët venë e vijnë.»

Mirëpo ngjau diçka që e nxori kryetarin papritur prej këllëfit ku e kishte futur veten. Në mendjen e tij zuri të rritej një ide, që u bë në çdo çast më e ndritur. Kjo erdhi nga një pëshpëritje e rastit e kapter Kadriut për ato që ndodhnin në teqe, ndërsa kryetari mbante në dorë telegramin-shifër të ministrit të Brendshëm. Në vitet e fundit kishin ndodhur dy kryengritje në Jug, që u shuan para se të vinte lajmi i tyre në Mar-kesh. Po diku, fshehur e nën zë, gjithnjë përgatitej diç-ka. Pra të shtrëngoheshin rripat, me të butë e pa zhur-më, po ama duke i shtrënguar, dhe të shtohet vëzhgimi, të raportoheshin lëvizjet e dyshimta. Kryetari u rrë-qeth prej kënaqësisë e shpresës dhe i tha kapterit:

— Dua raport me shkrim për teqenë.

Kapteri mbeti gojë hapët, tha se nuk po mundte të shihte më tepër përtej mureve të teqesë. Megjithatë diç-ka kishte parë. Babai këndonte vjersha kundër sull-tanit. E dinte gjithkush se në teqe hynte si në shtëpi të vet Sadi Pejza i Balit, dy herë i burgosur, që rrinte i kërrusur, si guri që fsheh gjarprin. Hynin Rahman Dena e Selman Gërvishta, një tog me burra, që të gjithë të armatosur, të njohur për trimëri. Këta i kishe çdo javë në teqe... fshatarë të dyshimtë, duke qenë baba Merxhani vetë i dyshimti më i madh, kushëri i

rebelit të varur prej mbretit. Pa ishte dhe ai Galip Nuri...

Kryetari habitej me vete se ku e kishte pasur mendjen, ndërsa fare pranë tij sigurisht përgatitej një komplot i armatosur. Porsa e mendoi këtë, iu nxeh trupi, nuk e mbante vendi. Ndofta erdhi ora e tij të shpëronte shtetin.

— Po ç'ke bërë ti deri më sot? — pyeti kryetari.

— Këto punë i di rrethkomanda, — u përgjigj kapleri, duke u mbështetur në karrige.

Kapteri po shihte se punët nuk qëndronin ashtu si i tregonte polici, megjithatë nuk ia ndante sytë fytyrës së kryetarit, shenja e lajthitjes mund të shfaqej papritur, këta lloj njerëzish nuk i dallon dot në bisedë.

Kryetarit i rritej marazi. Ndofta të tjerë njerëz kishin shpejtuar para tij, duke çuar raportet në Tiranë.

— Duhet gjetur ndonjë grua prej atyre që hyjnë në teqe, — tha ai.

— Gratë që hyjnë në teqe janë të pakta dhe s'flasin kurrë, — tha kapteri.

— Disave edhe mund t'u hiqen pushkët.

— Veçse i kanë me leje bariu, për t'u ruajtur prej ujkut, duke qenë ujç ata vetë.

— Po çfarë do të bëhet atëherë? — Kryetari ishte zbardhur prej ankthit, në zërin e tij ndihej lutja.

Kapteri mendoi se kryetari nuk ishte i krisur. Gjithsesi, tani e kishte në dorë këtë burrë fodull, ngriti kokën dhe tha:

— Babai ka popullin me vete dhe s'mund të preket. Është trim i çartur dhe s'mund të frikësohet.

Kryetari u hodh nga karrigia dhe tha:

— Mund të bëhet ankim se deshi të vriste toger Bedriun, se liron fshatarët e burgosur.

— Puna e dhisë nuk doli gjë, — tha kapteri. Dhinë e kishte pjekur në pyll nipi i Mëdyshajve, kurse fsha-

tarin e kishte paditur Rati gojarisht, jo se i donte prishjen fqinjët të varfër, po vetëm që ai me djemtë të hanin ca dajakë. Këto kapteri s'mund t'ia thoshte kryetarit. U koll prej kënaqësisë që po hidhte në erë çdo mendim të tij dhe i tha: — Sa për çështjen e zotit toger, kemi biseduar me kohë, nuk del gjë me gjyq nga ajo anë.

— Si e keni biseduar, kush?

— Në rrethkomandë.

— Atëherë si i bëhet?

Kapteri po e shihte ngultas me sytë e hirtë që nuk ndryshonin kurrë, i paturp e tepër guximtar. Kryetari nxori një dosje dhe u hoq se shënoi diçka. «Po shkruaj këtu drejt për shkëlqesinë se shpirtin e ke përtac dhe mendjen krejt të ngadaltë», — thoshin sytë e tij. Kapteri lëvizi në karrige, mendoi se ndoshta po i hapte vetes një telash dhe u gëlltit.

— Është edhe dikush që mban prej kohe një vesh në teqe, — tha duke bërë me kokë për nga lagjja «Gjin».

Në sytë e kryetarit u përkund kulla e madhe dhe e rëndë e Mëdyshajve. Ishte vonuar tepër. Këtë s'mund t'ia falte vetes, ndodhej aty si njeriu që duhet t'i hipë një kali të egër në vrap e sipër. U çua për të dalë dhe pyeti kapterin se ku ndodhej tani baba Merxhani.

— Në teqenë verore në Rralenjë.

XVI

Baba Merxhani pi kafënë në postiqe, nën ahun e vetmuar në kodrën para teqesë verore. «Ahu i baba Merxhanit», thonë kalimtarët.

Sot është dita e verës e vitit 1938. Fëmijët dalin

derë më derë. U japin vezë, kalli misri të zier, një lugë sheqer në gojë. Fëmijët bredhin më tej, me sytë të ndezur. Pa kaluar oborrin flasin me zë të lartë për dhuratën bujare ose kopracinë e të zotit të shtëpisë, matin fitimin me njëri-tjetrin.

Ai, babai, duhej t'u gëzohej fëmijëve nga larg. Në botë s'kishte asgjë tjetër veç duarve të tij, së djathtës dhe së majtës. Fëmijët e tij duhej të ishin njerëzit, por ata nuk do ta shihnin kurrë me dashurinë që sheh fëmija prindin dhe as ai s'mund të ndiente për ta dhembshurinë e atit për krijesën, mish i mishit të vet, gjak i gjakut. Dhe kur njerëzit të lodheshin me babanë, ai do të mbetej me muret e teqesë, me pishat dhe ahun e vet.

Ai zë e nënqesh me këtë fat të shpikur të baballarëve. Çdo gjë në natyrë, njerëzit, kafshët, bimët, përtërijnë veten, që jeta të vazhdojë. Kurse një baba teqeje duhet t'i kalojë jetës anash, si në një tokë të ndaluar, dhe të ngulë hunj, për të thurur gardhin që e ndan nga jeta. Ky është çarku, prej të cilit mund të dalë veç i vdekur.

«Shumë shpejt për të vdekur, shumë shpejt», — thotë duke lëvizur buzët. Ai është njëzet e tetë vjeç. Mendimi i tij zë e rrjedh i qetë në shtegun ku ka dëshirë të kalojë sa herë ulet në lëkurën e dashit tek ahu, në vetmi të plotë.

Një trumcak sikur ndalet një çast në ajër për të parë me sytë e shpejtë njeriun tek ahu, pastaj kalon në pyll. Një dritë e vrullshme dhe e kthjellët i bën pyjet gati të tejdukshme, gjethet murmurisin lehtas. Babait i duket se bota zë e ftohet ngadalë, duke thënë një lutje pa zë.

Baba Merxhani ka humbur besimin. Ai paskësh qëndruar mbi tokë si një dru rrënjëprerë. Po këtë ia thotë vetes të qartë e të plotë vetëm tani, në ditën e verës e nën ah dhe kjo e lë të habitur e me sytë të zmadhuar.

Ai kishte menduar prej kohe se po i tërhiqte një rëzit në një besim të verbër, që do të vinte duke rënë, sepse njeriu s'mund të shesë shpirtin dhe ta pranojë këtë përjetë. Ky mendim kishte bërë rrugë të mbuluar gati prej dy vjetësh. Po dyshimi i mjegullt ishte edhe më i vjetër, që nga koha e fëmijërisë.

Tani fëmijëria i duket si një përrallëz e luajtur prej tjetërkujt, si prej një vëllai të vogël me kokën të mbushur me erë, që u nis për në perëndim, ndërsa bota shkante në lindje dhe kjo s'pati më të ndrequr. A ishte ai rasti i trokitjes në derën e teqesë që vendosi drejtimin e jetës së tij? A kishte kjo lidhje me një fat të caktuar, apo ishte thjesht një rast? Këtë s'e ka zgjidhur kurrë me mendje. Di vetëm të thotë se ai vëllaçoja dhjetë vjeç e kishte ushqyer veten me erë edhe kur u bë dervish, tamam si një fëmijë i rritur që fshihet në fund të kopshtit dhe i tregon vetes gjëra të bukura. Po mendja e tij që përpinte mësimet ka-pej aty-këtu në leqe. Ja një pyetje që të turbullon mendjen: njeriu qenka hedhur në botën plot tundime me vullnetin e zotit, prandaj s'mund të ndëshkohet për mëkatet. S'mund të hedhësh fëmijën në det dhe pastaj ta rrahësh se lagu rrobat. Këtë thotë mësimi. Atëherë përse duhet t'u përmbahet myhibi dhjetë porosive e të dënohet po t'i shkelë? Dervishi i ri zgjajtej të kapte mësimin, të arrinte të vërtetën, po ajo rrëshqiste më tej, si drita në një natë të errët.

Megjithatë ai u bë baba, duke i pranuar mësimet me njëri-një të mendjes. Jo vetëm i pranoi, po edhe u shërbeu gjallërisht, për synimet e tij prej babai. Zë u tregon burrave të moshuar përrallëza të stisura për fëmijët pesë vjeç... «se kur Muhameti u ngjit në qiell te zoti për të mësuar nëntëdhjetë e nëntë të fshehtat, zoti ngriti perden dhe i tregoi Ali El Myrtezanë, që kishte arritur aty më parë.» Në këtë pikë të tregimit babai i shkel syrin vetes. Aliu i shkathët, kalifi i katërt, hante e pinte me huritë e qiellit në kohën që profeti gulçonte duke ngjitur të përpjetën.

Babai dëgjon krismën e qeshjes që jehon brenda tij si në shkretëtirë. Gënjeshtër e madhe e shpikur prej Haxhi Bektash Veliut, mëkohej në burimin e farkëtuesit të gjithë gënjeshtërve, Muhametit. Po as ai s'mund të ishte i vetmi. Të tjerë para tij, në kohë e në vende të ndryshme, kanë thënë e bërë të njëjtat gjëra. Ai, Muhameti, i gjeti ndihmësat shpejt, që e përhapën dhe e bënë gënjeshtërën përherë më të pasur e më të bukur. Me mijëra mendje të vëna në këtë punë në gjysmën e dheut. Në taborrët prej dhjetëra mijë vetash ecën edhe ai, Merxhan Ahmet Dalipi prej Buzit të Madh, duke u treguar njerëzve të njëjtat gënjeshtër, si me fjalë të shkruara në dëborë e që duhen shkruar pareshtur për t'i mbajtur gjallë.

Si baba, mbase ka bërë edhe diçka të mirë. Ka ndihur fshatarët në nevojë, ka bërë ndërtime. Mirëpo çfarë ndryshimesh kanë sjellë këto? Kjo është si një luftë me erën. Në një botë të tillë mund të bredhësh me vite pas një qëllimi të bukur, po mendimet dhe punët e mira thahen si lulet në acar. Askush s'mund ta kuptojë dhe as t'i japë një zgjidhje, të ndryshojë

diçka në themel në jetën që vërtitet si guri i madh me dhëmbëza. Pra, e vetmja punë që paska bërë baba Merxhani, është të lulëzojë teqenë, «saksinë e bukur» rrëzë shkëmbit që mahet me djersën e fukarasë, të mbajë të zëna e të veshura mendjet e tyre. Baba Merxhani paska bërë të njëjtën punë të çdo babai, duke përkëdhelur veten me mendimin se po bën ndryshe! Një ankth i zi derdhet brenda tij, i helmon gjakun e i errëson shikimin.

Si çdo gënjeshtër edhe kjo duhet prishur, mendimi se bektashizmi çliron e ngre njeriun. Po nga kush dhe si?

Kjo mund të jetë një punë e kohës dhe e vetë njerëzve. Kurse ai, baba Merxhani, sheh të qartë vetëm këtë, që kjo nuk është jeta e tij. Puna më e rëndë është të jetosh një jetë të huaj. Zemra e tij e sëmurë s'kishte dashur t'i shihte punët siç ishin dhe kishte vuajtur pa zë, në kllapi e mundim të gjatë që nuk tregohet. Po tani s'mund të mos i flasë vetes, sepse ai ka humbur besimin.

Rri duke parë lëndinat e bukura të Rrallenjës dhe provon një ndjesi të çuditshme. I duket se sheh një ditë dhe dëgjon një zë. I duket se hirka po i bie nga supet dhe se po del në shtegun që të çon te jeta e tij. Kjo e gëzon fort dhe ul qafën që të shohë më mirë, me zemrën në shtrëngatë. E kishte ditur që kur ishte dervish, kur merrte mësimet me fytyrën në mur, se ndonjë ditë mund të kthehej jeta, me egërsi, duke kërkuar shpagë të rëndë për orët, ditët, vitet e humbura në errësirë. I qe trembur vetes se kjo mund të ngjiste befaz, kishte kaluar si në tehun e thikës. Tani kjo ditë kishte ardhur. Mjaftonte të çohet prej lëkurës së dashit.

Veçse ç'do të bënte kur të dilte prej hirkës që e mbante mbyllur? Duhej të niste një jetë tjetër nga e para, si lakëriq ndërmjet njerëzve, punë e vështirë për një njeri të mësuar që fëmijë t'i sillet botës nga jashtë. Dhe nëse ai vetë e mposhte këtë frikë, si do ta shihnin punën të tjerët, Rahمان Dena, Selman Gërvishta, Galip Nuri, Sadi Pejza, dervishët e shërbëtorët e teqesë, dhjetëra, qindra njerëz? Po sikur t'u hapet këtyre ngadalë, t'u thotë se nuk beson më, se nuk ka besuar kurrë, dhe bashkë me ta të nisë besimin e ri të mosbesimit?

Ky mendim zë e bie, qëndron aq sa ai të rrotullojë sytë mbi fushën e Rrallenjës e mbi pyjet. Njerëzit nuk do ta pranonin këtë, mosbesimin. Do ta quanin të çmendur, sëmundje mjaft e përhapur në teqetë. Dhe sikur ta dëgjonin dëri në fund, do ta pyesnin pastaj se në ç'gjë tjetër duhej të besonin. Ndërsa ai nuk di ç't'u japë në këmbim, nuk di kurrëgjë. Ç'mund të bëjë ai tani? Nga ta marrë vesh njeriu cila është rruga për t'u ndjekur?

Atij i duket se mbi të fryn një erë e ftohtë dhe mbështillet më mirë me hirkën. Sado t'i bredhë sytë, nuk sheh shteg gjëkund. Atëherë zë e nënqesh. Ato që ka në kokë do t'i mbajë mbuluar përjetë, si një njeri i vetmuar, hallin e zi të të cilit nuk e di askush. Kështu do të bëjë. Do të vazhdojë të jetë një baba që bën detyrën, që përhap gënjeshtren. Ai zë të marrë frymë ngadalë, të qetësohet, shikon rrotull e mban vesh.

Po a do të mundë të mbahet më këmbë? Dhe sikur të mbahet, si do të bëhet në çastin e vdekjes kur

bien fjalët dhe njeriu mbetet me vetveten? I bëhet se dëgjon të gjallë e të qartë atë grahmën e plakut të Hasallajve të fshirë nga bota e të gjallëve, por që ka zënë vend në mendjen e tij për të mos u shkullur më: «A ka si të jetë ndryshe kjo botë, or babë?» «Bota nuk është, or gugash. Mendo për hakikatin.» Babait i ngrihet qimja e kokës përpjetë. E gënjeu plakun në çastin e shpirtit.

Për një kohë tepër të gjatë, ai qe mësuar ta shihte jetën si nëpërmjet një qelqi të shtrembër. Tani i dukej se, sido që të bënte, nuk do të mundej kurrë të hynte në jetë, te njerëzit. Kur hyri në teqe, shihte errët dhe në veshë ndiente atë buçitjen e shurdhër që prodhon qetësia e thellë e teqesë.

XVII

Sefer Tasi u ul në krye të sofrës së Mëdyshajve dhe nuhati ajrin e ndenjor, ndofta ngaqë dritaret e vogla mbaheshin mbyllur, ose për shkak të shtrojave të rënda prej shajaku me lagështi të vjetër mjegulle. Këtë erë mbanin edhe kurmet e njerëzve të shtëpisë, trazuar me erën e mushkës e të cjamin, si edhe me erën e ujkut në pranverë, kur nis stina e gjuetisë. Kryetari nuk dinte si ishte kjo erë e ujkut, po sigurisht do të qe një erë e egër gjaku, që përhapej në luginat, në pyjet me pishë dhe në përrenjtë ku derdhej uji i dëborës. Këta ishin mësuar me erëra të tilla dhe as që dinin se njeriu mund të ketë edhe erë tjetër.

Njeriu urren atë që ka frikë, po s'mund të mos mendojë për të. Kryetari gjithnjë kishte pasur njëfarë frike nga Mëdyshajt, kishte menduar për ta, për fuqinë e tyre. Tani i duhej të hynte me këta në një

punë të fshehtë, për këtë kishte ardhur, ndërsa shihte me habi se s'kishte ndonjë gjë për të thënë. Komploti dhe dyshimet e mëdha qenë bërë avull. Kjo vinte për shkak të Ratit që e shihte ngultas e buzagaz. Ky të shtronte sofrën e ta zinte kafshatën në grykë. Sa herë bisedonte me të, kryetari ikte i hutuar, si njeriu që s'di nga të hedhë këmbët. Kryetari filloi të fliste për teqenë, ajo që tregonte ishte pa rëndësi, po lehte më tym e po bëhej qesharak, si një nxënës që s'di mësimin. Rati e nxiste të pinte, i zgjidhte mishin e ia hidhte përpara, e ndihte me ndonjë fjalë pa thënë vetë asgjë. Kurse togeri dukej i ngopur e i qetë, po prapë bënte një zhurmë të vazhduar me nofullat, a thua se nuk pushonte së ngrëni kurrë, ose pushonte sa për të hequr ndonjë fije mishi nga dhëmbët e fortë, të verdhë. Më në fund kryetari tha fjalën «komplot», që i doli prej gojës si një e shtënë kobureje.

Kjo nuk i bëri përshtypje Rati, që nënqeshte, me sytë të ngulitur në ballin e mikut, dhe përkulte herë-herës trupin, si për të nuhatur erën e tij të mirë. Kjo ishte një erë alkooli a kolonje, trazuar me erën e naftalinës, dhe Rati iu duk se nëpër të ndjeu erën e vdekjes. Toger Bedriu hodhi trupin lart, mendja e tij kapi diçka në fluturim dhe po e shihte mikun që sipër kërcellit të hundës.

Kryetari, i mbushur me maraz me veten dhe të tjerët, u kthye nga Bedriu dhe foli përçart tha se në teqe përgatitej kryengritje dhe kjo kishte lidhje me bolshevikët.

Bedriu me sytë e budallepsur dhe gojën gjysmë të hapur kuptoi.

— Duhet të bëjmë gati çetën, — tha dhe shikoi rrotull, uli qafën të shihte vëllanë, Ratin.

Kryetari dinte se togeri rezervë merrte nga rrethkomanda një rrogë të dytë të fshehtë, për llogari të

një çete që nuk ishte parë ndonjëherë, por që duhej të qe diku, dhe iu ngroh trupi, ndjeu miqësi të thellë për togerin.

— Zotni Sefer, — tha Rati, — disa punë t'i kam treguar para se të shkoje me leje.

Kryetari mbeti gojëhapur. Rati qeshi me buzët, si ujku, dhe tha prapë:

— Zotnia jote nuk ma vure veshin, ke qenë me punë të mëdha. Po njeriu që ngjitet lart me zor, do të zvarritet prapë poshtë. — Ai u çua dhe doli nga dhoma. Kur u kthye, ndenji në këmbë të shihte nëse kryetari ishte trullosur krejt, pa fytyrën e tij të prishur dhe tha: — Po bie dëborë, — e tha këtë duke tundur kokën, si për një gjë të gëzuar që ndodhte jashtë.

— Për çfarë më ke folur? — pyeti kryetari.

— Për ato që ndodhin në teqe, — tha me të butë Rati. Ai vijoi me të njëjtën gjuhë të thoshte diçka e të mos thoshte asgjë, sikur sillej rreth kryetarit, duke ia hequr fjalën nga goja. Me atë respektin e trashë e të shtirë, ai po thoshte se komuna duhet të vëzhgojë, dikush duhet ta bëjë detyrën më mirë, të hapë sytë. Në fytyrën e kryetarit ndërroreshin ngjyrat.

Rati heshti, i rëndë e i padepërtueshëm, a thua se nuk merrte frymë. Pastaj foli si me vete, kokulur:

— Ai është bërë zot i këtij vendi, cakton kullotat e ndërton zakonet, dasmat e vdekjet, fal gjakrat e ndalon fajdetë, i merr qeverisë prej duarve të burgosur-in; ai na nxori nga këshilli i teqesë, na vuri koburen te dhëmbët... — Dukej sikur kjo ligjëratë që vinte nga brenda i silte kënaqësi, se nënqeshi, me bllangat e errëta që tregonin zbehjen e fytyrës së zeshkët. U përmend, ngriti kokën dhe tha: — Ti mos fli, mor burrë. Ka ardhur koha, një kohë e gjatë ka kaluar. Tashmë mund t'i nxirren lakrat teqesë.

Kryetari ishte më i zgjuar se kurrë, bëhej fjalë,

ndofta, për ngjarjen më të madhe të jetës së tij, u hodh e tha:

— Ka apo s'ka komplot? — Ai priti krejt i hutuar. Shikoi një herë Ratin, pastaj togerin, që rrinte me trupin drejt, me kokën si të shpuar nga një plumb.

Rati e la të priste, pastaj tha:

— Diçka mund të ketë, dikush duhet ta shohë. Veç duhen prova të forta, se, po e hodhe këtë gur, të bie mbi krye. Kemi komunën, kemi xhandarmërinë.

Kryetari mbajti frymën. Se ajo që thoshte Rati ishte gjithnjë si një parathënie e asaj që do të vinte më pas e mund të mos vinte kurrë dhe me këtë e mbante njeriun varur. Po Rati nuk foli. Dukej se po zbehej prapë, rrinte si në vetmi dhe mbylli syrin. Atëherë kryetari kuptoi se diku përgjonte një grykë pushke për baba Merxhanin, u rrëqeth dhe iu ftoh kurrizi. Rati hapi syrin e nënqeshi, si për të fshirë atë që mund të kishte menduar miku aty më parë. Këtij iu duk se në dhomë u përhap edhe më fort ajo era e ujkut në pranverë, trazuar me erën e gjakut.

* * *

Baba Merxhani e piu faqoren krejt dhe priti. Po ndiqte rrugën e alkoolit me mendje, ia ndiente ngjitjen. Më parë do t'i nxehej trupi ngadalë, brenda tij do të rritej flaka e mirë e lëngut të thanës që do të shkonte drejt trurit nga të gjitha rrugët, duke e pushtuar, duke e veçuar. Me faqoret e tjera aty do të bëhej kërdua, do të mbretëronte rrëmuja, me ditë e me net. Sado të pinte, ai qëndronte këmbëkryq, i patundur. Vetëm ai që e njihte mund të thoshte se nuk ishte esëll.

Ali Çela, qehajai, solli shishen për të mbushur faqoren prapë. Babai i tha të hiqte shishen dhe të ulej.

Aliu u ul në gjunjë i skuqur prej kureshtjes e kënaqësisë.

Babai kishte qenë dy ditë sëmurë. Prej dy vjetësh Aliu vinte re se babai sëmurej pa qenë sëmurë, as prej barkut, as prej kokës. Rrinte në dhomën e tij duke pirë duhan me bërrylat mbi gjunjë. Po në teqe ishin mësuar me gjallërinë e babait, me zërin e fuqishëm, me shakatë dhe sidomos me pijen e këngët e tij. Kur këndonte ai, qanin dervishët e shërbëtorët në korridor. Ishin mësuar edhe me inatin e rrezikshëm që i hipte në të rrallë. Prandaj, ky ndryshim i karakterit të babait dy vjet e këtej, i kishte lënë të gjithë të hutuar. Në ditët e «sëmundjeve» të tij, që ishin bërë përherë më të shpeshta, njerëzit ecnin si hije, flisnin nën zë, u dridhej zemra kur ai trokiste në dysheme, ose shfaqej në krye të shkallëve. Në gjashtë muajt e fundit kishte ndodhur një tjetër ndryshim që nuk ngjante as me vitet e para plot gjallëri e zhurmë, as me dy vjetët e «sëmundjeve të shpeshta». Po dilte në shesh një baba i ndërmjetmë, gjithsesi më i butë. Qenë shtuar miqtë dhe qe pakësuar rakia. Qehajai rrinte në gjunjë, i përrpirë prej kureshtjes. Nga mënyra si po e shihte babai, dukej se do t'i thoshte një të fshehtë.

— Po ia marrim një këngë, — tha babai. Priti që Aliu të bëhej gati dhe ia mori me zë të shtruar këngës së shehut të Bulqizës, që shkoi në luftë kundër turkut me shtatë çunat. Babai nënqeshte, a thua se u gëzohej shtatë çunave, dhe përmbante dufin që derdhej me valë në zërin e tij të fuqishëm e të butë. Në dhomën gjysmë të errët u përhap trishtimi, vetmia. U end një histori e hidhur, një fat i keq që të zë në grykë, po me një notë shprese që ndrit si pika e vesës në fijen e barit. Po të mos ishte kjo notë e shpresës, këngët e Markeshit do t'i këndonin vetëm të dehurit ose njerëzit e përzishëm. Aliu nuk po e merrte veten

prej kësaj kënge, filloi të ngrinte zërin ngapak, duke u ndihmuar me dorë, dhe, kur arriti te «Elmaz i vogël s'vojt ke nana», zuri të lëshonte klithma të mprehta. Babai tundi kokën, e qortoi me sy, zëri i tij u forcua si një gjëzim i ulët dhe Aliu shtroi zërin e vet, mori frymë i lehtësuar. Po duket se në mbarim babai prapë s'kishte mbetur i kënaqur. Ngriti gishtin mbi Aliun e i tha ato fjalët që kishte dëgjuar dikur prej kryeplakut të Balit:

— Çdo këngë këndohet sipas kohës kur ka ngjarë.

Me këtë paralajmërim, Aliu, këngëtari më i mirë i teqesë pas babait, u gatit të priste këngën tjetër, provën e dytë.

Babai nisi «Kalanë e Prizrenit», si qëmoti, pa e kursyer zërin. Kalaja e Prizrenit solli nga larg erën e gjakut të derdhur bujarisht mbi muret, jehonën e egërsisë, shpirtit të madh që ngrihet lart si shqiponjë. Aliut po i shtrëngohej fyti gjithnjë më fort, qe afruar edhe më tepër në gjunjë para babait dhe, në mbarim të këngës, i shkonin lotët çurg për Kalanë e Prizrenit që s'jepej kurrë.

Pak më vonë, kur Markeshi po shuante pishtarët për të rënë në gjumin e gjatë të natës së vjeshtës, trokiti porta e teqesë. Erdhi «doktori», infermieri i vjetër, që mungonte prej pesë muajsh. Babait i qeshi fytyra, se ky ishte burrë i rrallë, i ndershëm e i papërtuar në detyrë. Kishte edhe një gjallëri të shpirtit që ia bënte të këndshme bisedën. Si hëngri darkë, «doktori» tha se Zogu po ia shiste Shqipërinë Duçes dhe se pritej zbar-kimi i shpejtë i Italisë.

Babai kundërshtoi, tha se Italia s'kishte pse të pushtonte një vend që e kishte blerë.

Natën tjetër «doktori» tha se shpëtimi i botës do të vinte prej Stalinit dhe bolshevizmit.

Babai e pa me habi. Ja tek po vinin prapë fjalë të nxehta për komunizmin, kësaj here nga një anë e papritur. Babai nënqeshi, zuri të mendohej.

Njerëzit në Rusi duhej të ishin si me gjak të ndërruar, me tjetër mendje e me një bujari të çiltër. Jeta e tyre duhej të qe ndryshe nga çdo jetë në faqe të dheut. Këtë mendim ai e ruante prej kohe me një gëzim të fshehtë. «Doktori» po thoshte se bolshevizmi sillte drejtësi, duke ua hequr paren tregtarëve, fëmijët aty rriteshin prej shtetit dhe njerëzit ishin të lirë. «Doktorit» i merrej fryma tek tregonte mrekullitë e jetës në Rusi. Trupi i paktë i tij mezi i mbante të fshehtat që kishte mësuar prej çunave të normales. Babai deshi ta ndihmonte dhe tha:

— Çdo pikë e bolshevizmit është e mirë, me përjashtim të fëmijëve që i rrit shteti. Fëmija do gjirin e nënës dhe këshillën e të atit.

«Doktori» ndenji i hutuar. Pastaj foli nën zë:

— Bëhet grurë sa për të ushqyer gjysmën e njerëzisë, me makina.

Babai qe përpjekur edhe më parë të përfytyronte tokën e Ruisë, po ishte si në viset e një ëndrre e të një përralle ku endet mjegulla e trurit. «Doktorit» po i thahej goja, piu pak raki, u ngroh dhe tha se komunizmi do të mbulonte botën. Babai mendoi për Spanjën që u zhurit për të arritur komunizmin. Tani mbi Spanjë kishte rënë heshtja, po ndërkaq asnjëherë gazetatat nuk e harronin komunizmin. Babai uli qafën ndaj këtij mendimi. Ai ndjeu keqardhje të thellë për Rusinë e pafund, të kredhur në dëborë, vend i largët dhe i vetmuar, me ato përpjekjet fisnike të padëgjjuara, kundër të cilit dukej se do të ngriheshin shtetet e botës.

Më 5 prill të vitit 1939 kryetari i komunës doli te pragu i zyrës dhe dogji në erë shtatë fishekë të «nagantit». Pas tij shtiu me patllake kapter Kadriu nga posta dhe secili xhandar doli në shesh dhe shtiu me pushkë në erë.

Fëmijët e shkollës u hutuan krejt prej krismave që po shembnin çatinë. Nga dritaret e shtrembra filloi të hynte në klasë era e athët e barutit. Mësuesi që kishte dalë jashtë me marifet, duke rrëshqitur anës së muveve, u kthye e u dha liri fëmijëve, që zunë të bridhnin rreth sheshit «Belik» e të thërrisnin si të egër. Egërsia e tyre u ngrit në kulm kur mësuesi filloi t'u ndante peta sheqeri që nga dera e dyqanit të Tomës. Paguante një petë sheqeri për çdo fëmijë kryetari i komunës. Kishte lindur mbreti djalë, kishte ardhur trashëgimtari i fronit.

U ngritën flamurët në komunë e xhandarmëri. Polici solli jevgun, që u ngjit te sheshi duke gulçuar dhe aty filloi t'i binte daulles me gjëmim. I nxitur prej fëmijëve, jevgu filloi të sillej rreth sheshit, të hidhej valle. I donte fëmijët, ose ishte pak i dehur, se ra në gjunjë, me flokët prishur e gjoksin hapur dhe tha «do ta çaj daullen», dhe zuri t'i binte me rrëmbim. Toma doli te dera e dyqanit dhe i thirri jevgut nën zë:

— Hej, mor gomar, do ta çash daullen!

Jevgu dëgjoi dhe u ndal.

— E ç'mund të bëjë një jevg me daullen të çarë? — i pëshpëriti Toma. U frikësua prej heshtjes që krijoi ndërhyrja e vet, hodhi sytë nga komuna dhe zuri të përpiqte pëllëmbët, të tundte shaminë lart. — Këndo, bjeri ngadalë, — i tha jevgut. Fëmijët, që ishin qetësuar krejt, po shihnin jevgun me fytyrat e zvogëluara prej

ankthit: «Ç'mund të bëjë një jevg po t'i çahet daullja?»

Jevgu ndenji rrëzë murit i menduar, me kokën mbi kraharor. I kishte kaluar furia befás. Tani po dukej si në atë birucën e vet, ku punonte hekurin me vëmendje e dashuri dhe caktonte që më parë një çmim të vogël, nga i cili nuk bënte zbritje kurrë. La topuzin dhe filloi t'i binte daulles ngadalë, me pëllëmbën e dorës, lëvizti buzët e nisi një këngë në gjuhën e vet, që lidhej me një të kaluar të lashtë të kredhur në errësirë e në harresë, në një mërzi të pafund. Kur pushoi, shpirti i tij i mallëngjyer mbeti si i ngjitur pas këngës, buzëqeshi, duke parë fëmijët që u ishin zvogëluar edhe më tepër fytyrat.

Ndërkohë kryetari i komunës i jepte mësuesit këngën që mori në telefon nëpërmjet Çernikës. Mësuesi u kthye në sheshin «Belik» të mblidhte fëmijët, i habitur me veten se sa shpejt qe thurur vjersha. Ndonjë poet zyrtar duhej të kishte gatitur me kohë dy këngë, një për djalë, një për vajzë. E lexoi këngën prapë dhe pa se ajo mund të përdorej njëlloj po t'u ndërroje dy fjallëve gjininë. Kur më në fund arriti të gjetiste fëmijët, u kujtua se kishte marrë vjershën, po jo melodinë. Mendimi i tij i parë ishte të kthehej shpejt te kryetari. Po a mund t'ia kishin dhënë melodinë me telefon kryetarit?

Ngjarja po përhapej me thirrje në Qytezë e Denë. Nga këto lagje erdhën me vonesë e si me përtim dy shkrehje pushkësh të kryepleqve. Kur lajmi arriti në Gjinin përballë, që andej krisën pushkët e rënda të Mëdyshajve. Ndërkohë fëmijët e shkollës, të rreshtuar me thupër prej mësuesit, po thërrisnin vjershën të gjithë bashkë, duke zgjatur zërat, që të ishte edhe vjershë edhe këngë:

*Gëzoni, fush e male,
lumenjtë e Arbërisë,
se ka lindur djalë,
princi i Shqipërisë.*

Kryetari, që po i mbikëqyrte të gjitha nga pragu i derës, mbeti fort i kënaqur dhe i tha sekretarit se, disa shpenzime që do të bëheshin me rastin e këtij gëzimi, duhej të kalonin në llogari të komunës. Sekretari, që kishte nisur punën një muaj më parë, i ngathët po i përpiktë, u përgjigj i hutuar se në arkë nuk tingëllinte asnjë para dhe, gjithsesi, për shpenzime të tilla duhej pyetur nënprefektura.

— Pyete pra, kërko në telefon vetë nënprefektin, — tha kryetari dhe hyri në zyrë. Aty mori edhe një herë në duar gazetën e dy javëve të shkuara, me fotografinë e madhe të Geraldinës me fytyrën si hënëz e plotë, me gjoksin e bardhë të hapur. Gazeta linte të kuptohej se nusja kishte dalë pjellore, siç pritej prej popullit dhe parlamentit, dhe shumë shpejt do t'u jepte fund hamendjeve ogurzeza për trashëgimin e fronit. Tani kjo kishte ngjarë. Kryetari pa për disa çaste në faqen tjetër atë gruan e sapunit «Venus». Vite më parë i qe dukur se kjo grua mund të ishte nusja e kombit. Kurse tani ajo ishte disi e mekur, e mbetur në qiell. Kryetari u kthye prapë te Geraldina, me mirënjohje e gëzim të thellë. Kryetari qe kapur pas lindjes së trashëgimitarit me mendjen të fiksuar e me shpresë të madhe. Keqkuptimi i tij lidhej me një «person» në Tiranë, që e mbante kryetarin disi të internuar në Markesh. Kryetari gjithnjë e kishte ndarë këtë «person» prej regjimit, duke pritur që atij t'i ndodhte diçka, t'i zbulohej fytyra e vërtetë prej vetë mbretit, ose t'i ndodhte një fatkeqësi, nga ato që i bën aq papritur natyra. Dhe tani, në mendjen e tij, trazohej ky lajm i gëzimit të madh

me shkatërrimin moral e fizik të «personit», si gjëra që duhej të ndodhnin në të njëjtën kohë e për të njëjtin shkak. Sado e çuditshme të ishte kjo ide, kryetari e kishte mendjen top se ashtu do të ngjiste.

• • •

Nënprefekti, që duhej të autorizonte shpenzimet, nuk u gjet në telefon atë ditë, as të nesërmen më 6 prill, deri në orën dhjetë paradite, kur kryetarin e thirri «urxhent» në telefon Çernika. Duhej bërë mobilizimi se po zbarkonte Italia.

U lajmëruan kryepleqtë të dërgonin burrat në she-shin «Belik». Kur burrat u bënë shumicë, kryetari doli te dera e zyrës me kostumin kafe, kokëjashtë, me qimet e rralla në erë, me njërën dorë në qostekun e sahatit. Ishte i skuqur sikur do të merrte flakë, kërcënoi me gishtin lart Italinë dhe tha:

— Lartmadhëria ka mbathur opingat, ka marrë armët e stërgjyshërve dhe po e pret armikun në Durrës. Rrini gati se do të nisemi për t'u armatosur.

Pas kësaj u kthye në zyrë, duke lënë të kuptohet se ishte tepër i zënë me punë dhe rrinte pas tryezës me duart në kokë, ndërsa në sytë e tij silleshin malet dhe po i krijohesh ndërmjet gjoksit dhe barkut një humnerë që i merrte frymën. Kjo lidhej me kapërcimin në regjimin tjetër, ku njeriu do të shpërblehej sipas provave e zotësisë, sepse Zogu kishte marrë fund, që në çastin kur erdhi telegrami se qeveria transferohej në Korçë. Kryetari mbylli sytë dhe shtrëngoi tëmthat. Do të ishte një kërcim në errësirë, po ai do të gjendej në këmbë më parë se të tjerët. Atëherë prej tij do të dilte njeriu tjetër, me rangun dhe detyrën e mohuar prej mbretit të poshtër, dhe ai, Sefer Tasi, do të merrte shpagim të

ëmbël e të gjatë, që do të shtrihej mbi tërë njerëzit, atje, në botën e grave të bukura e burrave të ditur, që flasin në gjuhë të lartë. Kur arriti në këtë pikë, ai ngriti sytë e përlotur, dëgjoji zhurmën jashtë dhe u afrua te dritarja. Në sheshin «Belik,» po mblidheshin më tepër burra. Në Qytezë lihnin qentë dhe ngriheshin thirrje të larta. Burrat po përgatiteshin me gjithë mend për luftë, me fytyrat e mprehta, të errëta, të prirë nga një thirrje e vjetër.

Të nesërmen erdhi një gjëzim nga ana e Balit. Ishte gjëzimi më i madh që pati njohur Markeshi. Menjëherë u dalluan në qiellin e pastër treshet e aeroplanëve, që vinin varg, gjashtë treshë, krijesa të rënda metalike, që çanë lart, duke synuar retë e bardha të Kreshtës, duke e parë fshatarët këtë çudi në heshtje të thellë e gojëhapët, sepse, deri në atë ditë në qiellin e luginës kishin fluturuar vetëm shpendët. Kjo forconte mendimin se ia behu një kohë tjetër, me pamje të qetë në dukje, po që të turbullon e të kall të ftohtë në zemër, me atë kërcënimin e fshehtë që sillte me vete dhe që askush nuk dinte të thoshte se si dhe kur do të shfaqej më tej dhe caqet që mund të arrinte.

Selman Gërvishta rrinte te shtegu i teqesë, kthente andej-këndej fytyrën e qetë, me mustaqet varur, duke qeshur me vete e me njerëzit. «Ne nga këto anë jemi milet budalla», — tha me zë. Pritej që ushtria e huaj, e tëra në çelik, të vinte lart, me makina që rrokulliseshin në faqe të dheut e që mund t'i ngjiteshin edhe Kreshtës së Madhe. Këto dhe lajme të tjera të ushqyera prej paditurisë, kishin ardhur në Markesh si kafshime të fshehta duke bërë kërdrinë në mendjet e fshatarëve. Në të vërtetë nuk ngjau asgjë. Ushtria e madhe armike qëndroi rreth qyteteve, duke hapur themelet e kazermave. Gjatë kësaj kohe të shkurtër qe ndërruar regjimi. Ama habia s'do të kishte qenë më e madhe sikur të qe mbuluar dheu me dëborë në zhegun e vapës. Pastaj erdhën karabinierët me puplat, uniformat dhe zakonet e tyre.

Po në Markesh asnjëherë nuk habiten gjatë. Sado e çuditshme të jetë një ngjarje, e futin në mendje dhe kalojnë më tej. Më në fund shikojnë se çfarë përfitimimi sado të vogël mund të nxjerrin prej një fatkeqësie të re, gjithnjë në largësi e duke iu ruajtur asaj si delja gërshërës.

Selmani priti te shtegu gjatë se mos dilte baba Merxhani. Afër drekës u mërzit dhe zbriti në sheshin «Belik». Aty filloi të këmbente ndonjë fjalë me njerëzit, të hetonte. Postëkomanda ishte bërë laramane. Ndërtesa e fortë prej guri, me dritaret me hekura, nuk e nxinte «personelin». Xhandarët rrinin të shumtën e kohës jashtë. Kishin hequr nga kapelat germën «Z». Në pritje të stemës tjetër, bënëin përpjekje të shtrembra për të mësuar ecjen e re, madhështore e të qetë të karabinierit. Këta dhanë të kuptohej se do të përkraheshin njerëzit që patën vuajtur nën Zogun, po në asnjë mënyrë nuk do të vuanin zogistët.

Kishte ikur kryetari i komunës dhe që ndërruar sekretari. Sekretari i ri ishte tridhjetë vjeç, flokëverdhe e me sy të bardhë, të hutuar. Po nganjëherë e gjente gojën befas dhe thoshte se regjimi i ri do të sillte punën, ngopjen dhe veshmbathjen. Ndërsa fliste, sekretari lironte këmishën në zverk, sikur aty ta shtrëngonte një kular, hidhte sytë me shqetësim në hapësirën e Qafës së Murlanit, prej nga do të vinin gjërat e mira, që po bënëin një udhëtim të ngadaltë. Njerëzit e shihnin me dyshim këtë sekretar, i cili merrte përsipër gjëra që askush s'ia kishte kërkuar.

Këto ishin provat e qarta të ndërrimit të pushtetit, që u krye më në fund edhe në Markesh dhe që Selman Gërvishta i kishte parë e dëgjuar nga bregu i tij duke ruajtur të njëjtën pamje të qetë të fytyrës. Tani po i shihte nga afër dhe prapë nuk i bënëin ndonjë përshtypje, sepse ai gjithnjë mendonte më vete dhe

njerëzit e rinj që sollën këtë ndryshim i ngjanin si udhëtarë në kalim, të ardhur kushedi nga e që do të iknin me karvanin tjetër. Po ai u ndal e u mendua gjatë rreth një gjëje të vogël që pa në dyqanin e Tomës. Pa lretën, një pare të bardhë prej metali të lehtë. Kjo ishte pare lufte, po aq e përkohshme sa edhe ata që e sollën. Toma tha se lireta ndërrohej dhjetë me shtatë dhe buzëqeshi si për të thënë se ishte rasti të punohej para me paranë me përfitim. Dukej se vetë nuk besonte dhe aq në këtë përfitim, sa ngacmues, aq edhe të pasigurt. Selmani e pa ftohtësisht, hodhi sytë rrotull dyqanit. Më parë aty mbante erë vajguri, raki e miell. Tani ndiheshin aroma të tjera, si në dyqanet e qyteteve. Fshatari që hynte nuhaste me ëndje, për të kuptuar se çfarë tjetër po nxirrte ky Toma i dreqit, të cilit i kishin hipur ethet si nuses natën e parë. Selmani zuri të shihte me ngulm lekun dhe lretën, si në pragun e një zbulimi të papritur, dhe u rrëqeth, iu duk se leku qe brejtur nga brenda dhe e kishte humbur shkëlqimin nga jashtë. Selmani ngriti sytë mbi Tomën, duke e bërë të skuqej. Toma fshiu diçka dhe ndenji me grushtet mbi banak, përpoqi qerpikët e mblodhi buzët, si për të thënë se nuk dinte, s'kishte dorë në ato që mund t'i ndodhnin lekut.

Selmani doli jashtë dhe u vu të shihte malet shkëmbore të Balit, pa parë asgjë. Po i rritej një ankth pa shkak, një turbullim i fortë. Për herë të parë mendoi se mbi fshatrat e mbi malet kishte rënë pesha e madhe e robërisë së huaj, si një mynxyrë që depërton gjithnjë më thellë. Kishte ngjarë një tradhti e një turp në sy të njerëzve. Kjo e keqe do ta dërrmonte vendin ngadalë, duke ia ndryshuar pamjen, ashtu si ia kishte ndryshuar ariu fytyrën atij Qerim Kasës prej Dene. Selmani po ndihej i huaj e i tepërt në sheshin «Belik» në vendin e tij. Këtë s'mund ta duronte, sepse aty ishte i njohur

e i lidhur me çdo gjë e me çdo tingull. Duke u ngjitur prapë lart, zuri të mendonte se edhe ky hall duhej të kishte një shteg, meqë njeriu gjithnjë e gjen një shteg, përveç vdekjes.

* * *

Babai pinte duhan në dhomën e tij me çibukun e gjatë prej qelibari, me gazetën pranë, që e shihte Pjerrtas, dhe ende i lëvizte buza e poshtme, sikur të kishte ndërprerë një bisedë me të.

— Si është puna, nazari? — pyeti Selmani.

— Po rrimë, — tha babai, me grushtet në prehër. Mbante në zap trupin dhe shpirtin e vet, si zot i strehës ende të paprekur nga turbullirat e jashtme. Për sa kohë? Dhe a do të ishte ai edhe aty e prapa i njëjti baba i Markeshit?

Babai ruajti heshtjen e rëndë, siç rrinte kur kishte errësirën në shpirt, ose kur e zinte dhimbja e kokës. U mbështet në mur dhe ngriti kokën ngadalë. Në sy kishte dritën e njeriut që ka parë të kryhet një mëkat i madh i pafalshëm, duke e prekur edhe atë vetë. Selmani u rrëqeth. Një hidhërim kaq i thellë e i vërtetë i shkonte për bukuri fytyrës së babait, vuajtja i kthehej në pikëllim, për shkak të urrejtjes dhe inatit pa fuqi. Selmani nuk po kuptonte përse të vuante aq fort babai, përse të merrte mbi vete barrën e gjithkujt, aq më tepër kur si baba e kishte bërë detyrën. Kur komuna thirri burrat për në luftë dhe myhibët pyetën babanë, ky u qe përgjigjur me zërin e rëndë: «Të marrim armët. Pa atdhe, s'ka fe, s'ka kurgjë.» Fjalë të tilla mund t'i kishte folur edhe tjetërkush, po nga goja e një tjetri ato s'do të kishin dalë po ashtu. Ato fjalë kishin ndezur zemrat e myhibëve dhe shumëkujt i

rrodhën lot për faqesh, atë çast myhibët e jepnin gjakun krejt dhe nisën në teqe këngët atdhetare dhe këngët e Naimit, kurse babai nxori maliherin e shkurtër që i vinte pas shtatit. Mbase ky ishte edhe shkaku i fyerjes dhe ftohtësisë, ndihej keq për fjalët që tha në mbremje, për gëzimin që e pushtoi se do të shkonte në luftë, e cila kishte për të rëndësi më tepër se për çdo burrë tjetër, kurse në mëngjes kishte mbetur me pushkën në prehër.

— Ani, nazari, se do të kalojë, — tha Selmani dhe lëvizti me bërrylat, duke kërkuar afrim. — Kjo e keqe e re erdhi nga jashtë, prandaj kurrresi s'mund të hedhë rrënjë; i huaji s'mund të rrijë gjatë kurrë. — Selmani po buzëqeshte, me sytë e mëdhenj si të përlotur.

Babai e pa me qortim të rëndë dhe foli me zemërim, me gojën të tharë:

— Mund të rrijë edhe qindra vjet. Kur ka ngjarë që armiku të vijë për të ikur? Mos fol marrëzira.

Një copë herë ndenjen në heshtje. Selmanit po i dukej se babai nuk ishte në rrobat e veta, gjithsesi nuk ishte aty me mendje, në teqe e në Markesh. Edhe më parë dukej shpesh i tillë, po tani ngjante edhe më keq, dukej sikur Selmani po i sillte atij bezdi. Kjo i kalli një hidhërim të thellë dhe gati po zemërohej. Veçse ai mund të zemërohej me tërë botën, po jo me babanë, dhe ndjenji gati përmbys e pa lëvizur. Babai i hodhi kutinë e duhanit, e pa me pendim e me keqardhje. Selmani i qe bërë si hije prej fillimit, burrë i besës e i zgjuar. Po nganjëherë fliste edhe lehtë, nga dëshira për të ngacmuar.

— Ndize, — tha babai.

Selmani fshiu syrin, e pa babanë sikur të mos kishte ndodhur asgjë, buzëqeshi dhe pyeti:

— Po ç'thonë këto gazeta vallë?

Babai hapi sytë. Selmani ishte i ngashëryer dhe hiqej se po qeshte.

— U bë kryeministër Shefqet Vërlaci, — tha babai.

— Pra tani Markeshi do t'ia paguajë meratë e dimrit vetë kryetarit të qeverisë, — tha Selmani.

Babai vuri buzën në gaz. Selmani dinte të qeshte me anën e hidhur të gjërave.

— Kjo qeveri do t'i ardhka hakut Markeshit më fort se më parë, — foli prapë Selmani.

— S'është puna aty.

— Jo, s'është aspak. Nazari tha se duhet të mendo-hemi. Po, që të mendohej, duhet të kuptojmë.

— Mbase koha do të na tregojë, — tha babai, ndër-sa ndihej i pafuqishëm, nuk arrinte të sajonte një men-dim, të shihte diçka, lidhur me kohën.

II

Kaluan katër muaj, gjatë të cilëve u duk se Mar-keshi i kishte dhënë vetes tepër rëndësi, duke pritur që, për shkak të kullotave dimërore, të merrej me këtë krahinë të humbur një kryeministër, që po krem-tonte në Tiranë ditën e fashizmit, duke mbajtur fja-lime, duke i dhënë gjeneral Agostinuçit komandën e përgjithshme të xhandarmërisë. Pastaj shpalli bashki-min e dy ushtrive dhe u nis për në Romë, të merrte nga duart e mbretit statutin që do të qeveriste Shqi-përinë. Si iu betua mbretit për besnikëri të përjetshme, shkoi te Duçja, që e priti me të njëjtat ceremoni dhe e bëri senator të Italisë. Që prapa krahëve të Duçes, kont Çianoja shihte lëvizjet e mangëta të krijesës së tij. E kishte zgjedhur vetë për kryeministër dhe shkruan-te në ditar se e dinte që s'vlente kurrgjë, po s'kishte kë të vinte tjetër... «Ky nuk dinte të ecte, të hynte

në një sallë, të mbante një fjalim të shkurtër, një bej provincial i shkollës Mylkije të Stambollit, gjashtëdhjetë e dy vjeç, gjysmë-tullac, me mustaqet si të ngjitura, një shërbëtor i aftë për poshtërsi të vogla, pak budalla e ndofta ca më shumë maskara, që nuk do të mësonte kurrë diçka më tepër. Ai duhej hequr porsa ta lejonin rrethanat.»

Ndërkohë kryeministri merr pjesë në paradat që bëhen gati çdo javë në Tiranë, duke u kujdesur të tregojë hidhërimin më të thellë e gëzimin më të lartë për çdo ngjarje të familjes mbretërore, të Duçes dhe Çianos, shkon në panairot e Italisë dhe bën me zell çdo punë të kotë që i thonë të bëjë. E megjithatë ai e shihte veten si prapa derës, duke ia pakësuar çdo javë kujdesin dhe nderimet, gjë që e linte të habitur, po më në fund prej kësaj mund të nxirrte disa përfitime, sepse i mbetej kohë të merrej me çifçinjte e tij, me miqtë dhe armiqtë e familjes.

* * *

Në Markesh u pëshpërit me këmbëngulje se kishte ardhur lista, e pëlqyer prej vetë kryeministrit, jo vetëm për kryepleqtë, po edhe për pleqtë e tetë fshatrave të krahinës. Filluan të dilnin emrat, duke shkaktuar habi e çoroditje, sepse nuk ishte e mundur që disa nga bashkëfshatarët në listë të ishin të njohur deri në qeveri. Atëherë njerëzit zunë të shtrëngonin sekretarin, për të parë se mos ky po sajonte emra nga mendja. Më në fund dikush u kujtua të merrej jo me emrat e veçantë, po me listën të tërë dhe atëherë doli

se kryepleqtë e rinj ishin të gjithë të «partisë» së Zogut dhe anëtarët e pleqësive miq, fis e gjak i tyre. Këtë mund ta kishte sajuar vetëm një njeri: Rat Mëdyshi, i cili qe dukur rrallë te dyqani i Tomës, i afruar me gjithkënd, me një dritë të re në sytë që të mpinin, me një merak të vazhduar për bashkëfshatarët, a thua se qante nga brenda për secilin, sidomos kur kthehej prej Tiranës, ku e çonin shpesh disa halle të familjes.

Në mesin e gushtit sekretari i komunës zuri të shkonte një herë në lagjet e Markeshit, pastaj në fshatrat përtej maleve, që të zgjidheshin pleqësitë. Sekretari u gjend papritur në mes të një telashi, sepse fshatarët me shumicë nuk pranonin ndërrimin e kryepleqve, ky ishte një rebelim, sekretari u përpoq të mbyllej puna, po më në fund u detyrua t'u bënte raport autoriteteve, të cilat i dhanë kësaj pune një rëndësi më të madhe nga sa besonte sekretari, po kjo do të dukej më pas, se qeveria asnjëherë nuk ngutet sa individ. Në mbarim të muajit ia behën në sheshin «Belik» hipur në kuaj të mëdhenj vetë federali i qarkut me një gjerark italian me dhjetë roja. Markeshi kishte rënë papritur në kundërshtim me «rendin e ri», për shkak të një historie të vjetër.

Federali dhe italianii shkëlqenin me veshjet e zeza verore dhe po aq të shkëlqyer e të zinj ishin rojat. Fëmijët dhe pleqtë rrinin duke i parë nga larg me habi të thellë. Të huajt qeshnin me zhurmë, po pa gëzim, rojat hynin gjithandej duke kërkuar tagji për kuajt, a thua se për ta do të çelej vetë çdo derë dhe sikur tërë bota duhej t'i priste buzgaz.

Gjerarkët lanë kuajt te sheshi dhe u nisën varg në të përpjetën që çonte në teqe. Kishin parë mjaft për të kuptuar egërsimin e fshatarëve, për të mos thënë armiqësinë. Po «rendi i ri» kërkonte duartrokitje e hare

dhe federali qe porositur ta mbyllte me përqafime punën e kryepleqve. Prapa federalit ecte sekretari i komunës, i hutuar, po edhe i kënaqur, shihte trupin prej atleti të njeriut që e qortoi rëndë aty më parë. Po do ta shihte më mirë kur të arrinin te baba Merxhani. Sekretari kishte qenë aty në fillim me mare-shalin e karabinierisë për t'i dhuruar babait në emër të «rendit» njëqind napolona. Sekretari nuk do t'i harronte çastet kur mareshali rrinte me tufën e napolonave në dorë dhe babai shikonte mareshalin njëlloj sikur t'ia kishte grisur paratë nën hundë e t'ia kishte hedhur copërat mbi kokë. Tani do të ngjante, ndofta, edhe më keq. Sekretari gëzohej tek hidhej mbi gurët, duke mposhtur frikën, lironte këmishën në zverk.

Ngjau edhe më keq. Po sekretari u gabua në fillim prej pamjes së qetë të baba Merxhanit. Ky po i pyeste miqtë nëse ishin lodhur, nëse dëshironin një kafshatë bukë. Miqtë e pëlqyen rakinë e fortë të thanës dhe çdo gjë po ecte shtruar, deri në çastin kur babai tha: «Unë, or zotërinj, jam shqiptar, nuk bëhem tellall i fashizmit.» Edhe këto i tha qetë, se zemërimi i tij ishte përtej inatit dhe rrinte duke parë herë federalin, herë italianin, sikur të shihte ca dobiçë të vegjël e të bukur që s'kanë pikën e nderit. Kjo u kuptua edhe më mirë kur fërkoi buzët ngadalë e me përçmim dhe foli duke kthyer fytyrën mënjanë, se ishte më mirë të bëhej ajo që donte populli për kryepleqtë, po gjithsesi teqeja s'kishte punë.

Federali filloi të merrte frymë rëndë, të errësohej krejt, ndërsa i ndrisnin për dreq stema e bardhë e liktorit në bustinë, sumbullat dhe nishanet e xhaketës së zezë mbërthyer fort me rripin e verdhë. Ai ishte një burrë trim, askush s'mund t'i bënte një poshtërim të tillë të hapët.

— Pse, ne s'jemi shqiptarë? — pyeti ai.

— Secili pyet veten, — u përgjigj me të njëjtën qetësi babai.

— Ndodhemi nën një çati të shenjtë, — tha federali, duke lëvizur pak në ije këllëfin e kobures e duke ngritur sytë në tavan.

— Ashtu vërtet, — tha babai.

Federali po djersinte. Babai e ndihmoi, duke nënqeshur lehtë, duke e ftuar të ngrinte gotën e rakisë, mbasi e kishte lënë të djersinte.

III

Prej katër muajsh në Markesh qëndronin dy palë kryepleq: ata të vjetrit që mbanin vulat, por që nuk i njihnte komuna, dhe ata të komunës që nuk i njihnin fshatarët.

Kjo luftë e Markeshit me «rendin e ri» ishte disi për të qeshur. Po ama ashtu si ishin punët nuk kalonte asnjë aktmartesë, çertifikatë lindjeje, tapi shitblerjeje a tjetër veprim. Fshatarët e pranonin këtë ndalje të punëve civile, le të ecte kështu pa mbarim, po «rendin e ri», që s'mund të prapsej, dhe aq më tepër të pranonte humbjen, e mendonte ndryshe. Pas një ndjekjeje këmbëngulëse, kapter Kadriu arriti t'u merrte vulat me forcë kryepleqve të vjetër, që ndien për vete të tyre lehtësim, sepse prej katër muajsh po jetonin duke u fshehur, gati të arratisur. Në Markesh u prish ndarja e vjetër, duke shtuar acarimin. «Partia» zogiste kishte pasur komunën e xhandarmërinë, por jo pleqësitë dhe vulat e fshatit. Tani që futi në dorë edhe këto, krahut tjetër i mbetej vetëm teqeja, me një baba të zemëruar, që rrinte mbyllur aty lart, po nuk e fshih-

te zemërimit aspak, ecte kundër në çdo gjë. Ky baba nuk ia vinte shenjat e reja flamurit, nuk la asnjë fëmijë nga tetë fshatrat e komunës të shkonte në kolonitë verore në Itali. Pastaj bëri diçka që rrëqethi njerëzit e që do të përmendej edhe më pas.

Në mëngjesin e 28 Nëntorit krisi pushka tri herë në teqe. Prej andej zbriti babai me veshjen dëborë. Frapa tij vinin Selman Gërvishta me flamurin e vjetër, Rahman Dena i Balit, sekretari, Galip Nuri, dhe qehajai, Ali Çela, me një trastë. Rrugës u bashkuan me ta edhe burra të tjerë, kaluan nëpër sheshin «Belik» dhe qëndruan para shkollës. Që andej dolën fëmijët në rresht, me fytyrat të lumturuara për veshjen e çuditshme, bluzat e kuqe e pantallonat e zeza që u kishin veshur në shkollë, të blera e të qepura fshehtas nga teqeja. Mësuesi i puthi dorën babait dhe fëmijët kënduan himnin, pastaj këngën «O Shqipëri, e mjera Shqipëri». Qehajai u ndau llokume fëmijëve, që pluhrosën fytyrat dhe bluzat, u ndau edhe burrave. Babai rrinte me duart lidhur mbi bark, me kokën varur nga e djathta e kraharorit, siç rrinte kur shikonte fëmijët. Ai u mbyll prapë në teqe, sikur të ishte betuar të mos e shihte botën me sy. U përhap me këmbëngulje fjala se për pak ditë babai do të hante plumbin ose burgun, do të hante kokën e vet. Babai nënqeshi. Në fisin e tij të shumtët e burrave nga plumbi kishin vdekur, po në moshën 35 vjeç. Kishte ende kohë për të vdekur.

• • •

Në mbarim të vitit prapë ngjau një ndryshim në ndarjen e fuqisë në Markesh, që nuk u kuptua shpejt, se depërtoi si pa u ndier dhe erdhi nga një anë e papritur, nëpërmjet personit të kryetarit të ri të komunës.

Ky ishte një burrë i shëndetshëm, dyzet vjeç, pothuaj i shkurtër, me ballin të gjerë, me sytë gri kureshtarë. Ai përpoqi buzët si i bezdisur dhe shtrembëroi trupin kur i zbriti mushkës para komunës. Në zyrën e tij kryetari dëgjoi ato që i thoshte sekretari, duke tundur kokën e madhe, sikur t'i dinte punët prej kohe. Njërin sy e mbante mbyllur dhe lëvizte pa pushim në karrige. Bëri nja dy shaka të lehta për nënprefekturën dhe u ngrit, me vetullat mbledhur, si të donte të thoshte se i kishte dhënë fund bisedës me sekretarin.

Kryetari shkoi të nesërmen në teqe dhe ndenji vonë. Pas dy ditësh shkoi prapë. Brenda javës shkoi tri herë dhe zuri të hante e të flinte aty. Në dyqanin e Tomës u stërhollua kjo punë, si edhe zakonet e tjera të këtij kryetari. Zyrën e hapte rrallë dhe i falte fshatarët që çcheshin aty për gjobë a procedim. Porsa vinte ndonjë tetar për ato punët që lidhnin postën me komunën, kryetari thoshte: «Obobo», dhe e përzinte shpejt. «Obobo», — kishte thirrur edhe rrugës për malet, për viset e egra të vështira. Gjuhën e tij mezi e kuptonin fshatarët, po ai zgjaste qafën e trashë që të kuptonte gjuhën e tyre, të folurit e qetë e të ngadaltë; çonte sytë dhe kërkonte gjërat e bukura që shihte vetëm ai dhe ia plaste gazit me vërshëllimë; kokën e madhe e kishte plot me historira, që njeriu i mbante mend, se tregoheshin prej kryetarit në kohën e vendin e duhur.

Ky ishte nga një krahinë rreth Beratit dhe s'duhej t'i kishte punët mirë me qeverinë. Këtë s'e kishte thënë njeri, po e kuptonte kushdo, meqë ai vetë s'bënte asnjë mundim për të fshehur gjendjen e tij. Mjaftonte ta shihje kur dilte para komunës me njërin sy mbyllur, me buzët mbledhur, për të kuptuar se s'kishte të bënte fare me binanë dykatëshe prapa krahëve. Dukej se «partia» e vjetër që humbi aty më parë pleqësitë, kishte fituar papritur vetë komunën. Sy të shumtë po

e vëzhgonin. Porsa ta vendosnin një herë punën e tij, fshatarët nuk do të shkuleshin më nga ai mendim. Dukej se kryetari e dinte këtë, po nuk shpejtohej, nuk bënte asgjë. I vetmi merak i tij ishte mezja e mirë, pa qenë grykës aspak, dhe të shtrohej në një bisedë të këndshme. Fshatarët vunë re se kryetari ishte dorëleshuar, gjë që nuk shihej me sy të mirë në Markesh. Përveç Tomës, që i qeshte fytyra porsa hynte kryetari në dyqan. Deri atë ditë Toma s'kishte parë myshteri, as dehur, as esëll, që ta çmonte paranë më pak se kryetari. Se këtu paraja gjithnjë kishte pasur një fuqi e rëndësi tepër të madhe, duke filluar nga pjesët më të vogla, ajo kalonte fshehtas, rrallë dilte në sytë e njerëzve. Ndërsa kryetari e hidhte dollarin mbi banak dhe nuk e shihte kusurin, po nga mënyra se si qeshte, dukej se në të vërtetë ishte ngushtë. Shkurt fjalët, ky njeri nuk e kishte mendjen aspak te paraja.

Kryetari i kishte thënë natën e parë babait se që dërguar në Markesh të lante gjynahet dhe le ta ndihmonte në këtë punë teqeja me shenjtërinë e saj. «Cilat gjynahe?» — kishte pyetur babai. «E di qeveria», — që përgjigjur kryetari. Ai kishte filluar ta ngacmonte babanë për rakinë e për mishin e pjekur, për bektashinjtë për gratë e Markeshit, që kryetarit i qenë dukur të pashme e me një mallëngjim në sytë kureshtarë. Ai e bënte babanë të skuqej dhe pastaj ndërronte bisedën aty për aty.

IV

Babai ishte nisur për në Rrallenjë në dëborë. Gjëja tjetër që e habiti Galip Nurin ishte se prej andej babai

qe hedhur në Korenë dhe kishte ndenjtur aty dy javë «i sëmurë.» Kur u kthye, tha si nëpër dhëmbë se ajo goça e Demir Sheshit nuk donte të martohej me burrin e vjetër që e kishin fejuar. Galipi pa turbullimin e babait e nuk foli. Zuri të radhiste shenjat. Shenjat dhe punët lidheshin. Shqetësimi i vazhduar i babait kohët e fundit, hutimi, heshtja. Në tre muaj e sipër atij sikur i qenë thelluar sytë, sikur i qe dobësuar shikimi. Edhe në peshë duhej të kishte rënë, kishte edhe etje të madhe dhe kërkonte vetminë. «Ku e kam pasur mendjen.» — pyeti veten Galipi.

Galip Nuri mendoi për fshatin Korenë, në krye të Zallit. Ky përrua ndan në mes luginën me rrëpira, ku ishin përhapur shtëpitë e ulëta me çatitë në ngjyrën e tokës. Buzë dimrit lugina dukej si një vend i djegur, i tëri i hirtë, po në dimër zbardhte prej dëborës. Në të vërtetë dëbora e madhe fillonte pak më lart përroit, në kodrat e staneve verore, sipër të cilave fillojnë pyjet me pishë e ah të Kreshtës së Vogël. Galipi e dinte Korenën, po jo vajzën e Demir Sheshit. Nuk e njihte këtë vajzë. Galipi i dinte dhe i çmonte punët e zemrës, megjithëse zemrën e tij nuk e vinte në lak veç për një kohë të shkurtër. Ai mendoi me nderim për vajzën e panjohur që nuk donte të martohej me burrin e vjetër, mendoi gjithnjë më mirë për këtë vajzë, i prirë nga një dëshirë bujare për ta njohur, për t'i thënë një fjalë. Po kureshtjen e tij nuk e nxiste dhe aq vajza saba vetë babai. Galipi nënqeshte si djall i mirë, i gatshëm ta ndihnte babanë në çdo punë, pa e zënë vajzën në gojë. Në mbarim të janarit i tha babait se moti ishte i bukur, ecej lehtë në dëborën e ngrirë dhe nuk do të ishte keq të bënin një vizitë te miqtë në Korenë. Babai e pa një çast me dyshim, po zuri të bëhej gati për udhë, pa folur.

Nabija hyri me tabakanë dhe ndenji te dera me sytë ulur. Ishte me trup mesatar, me fytyrën si prej fëmije, të rrumbullakët e të bardhë. Babai rrinte në krye të vatrës, i madh, i shndritshëm e i vagullt, diçka që s'mund të arrihej. Po vajza do të ndihej si në prehrin e jetës vetëm në krahët e tij dhe do të ecte në largësinë që e ndante nga ai edhe sikur të linte kokën. Këto Galipi i pa mirë, në dridhjen që përshkoi trupin e brishtë të vajzës nën rrobat prej shajaku, në përpëlitjen e qepallave të zeza. Galipi po mbante frymën me një ndrydhje të zemrës dhe foli ç'i erdhi për goje, që të fërhiqte mbi vete vëmendjen e të tjerëve, të ndihmonte vajzën, që po rrinte me tabakanë te dera. Ajo kaloi shpejt përmes dhomës së madhe me dyshtemenë e shtrembër, ra në gjunjë para babait, i puthi dorën, ndërsa ky ishte prirë me trupin përpara. Vajza nuk po çohet, dukej si e zënë nga krahët, merrte frymë me ngut. I ati e qortoi dy herë duke u kollur. Galipi mendoi se gjithë gratë mund të dridheshin ashtu para babait, i pashëm, tridhjetë vjeç, me atë të fshehtën magjiplotë.

— Qenka dobësuar vajza, o Demir, — tha Galipi.

Demir Sheshi tundi kokën me hidhërim e psherëtiu. Po hiqte keq me atë vajzë. Ajo ndjeu zërin miqësor të Galipit, i hodhi një shikim të shpejtë, si mbi të vetmin njeri prej nga mund t'i vinte ndihmë, dhe ndenji kollur, priti të merrte filxhanët.

Me syrin e qeshur që depërtonte në çdo skutë, Galipi përpinte lëvizjet në dhomë, shihte si ndërroreshin ngjyrat në fytyrën e babait. Para buke babai këndoi lutjen «sofra e Aliut ka ardhur...» duke ia bërë qejfin fort të zotit të shtëpisë, burrë i mirë e besnik, që shihte me merak nëse gjellët i bënë nder mikut të lartë,

ndërsa babai hante pa vënë re atë që hante, këndoi dhe vjershën e Naimit «Falja» dhe biseda e tij rrodhi me një gojëtarë që Galipi s'e kishte dëgjuar prej kohe. Aty nga mesnata, duke parë se miqtë kishin bërë qejf, i zoti i shtëpisë qau hallin e gocës, që kishte prerë ushqimin, dhe u lut që babai ta pranonte ca kohë në teqe, për miqësi e për derman, duke shkuar goca aty me gjithë t'ëmën. Galip Nuri hodhi trupin lart dhe priti. «Kur një punë si kjo nis të bëhet, atëherë s'ka të ndalur», — mendoi ai. Ai kishte vënë re edhe më parë, me një turbullim të shpirtit, se qysh vërtiten gjërat në raste të tilla, a thua se dikush i rregullon me dorë në anë të ndryshme, për t'u takuar në vendin e duhur. Galipi pa një çast me keqardhje të zotit e shtëpisë, se ky ishte i vetmi që mbetej jashtë së vërtetës e së fshehtës, këtij as i shkonte mendja se vajza mund të ushqente ndjenjë tjetër ndaj babait veç adhurimit dhe po priste përgjigjen me fytyrën të çiltër e në lutje. Babai tundi kokën me pëlqim dhe Galipi u hodh e tha se dera e teqesë ishte e hapur për atë familje në të dy kanatet, se nëna e goca mund të rrinin aty jo me ditë, po me muaj e bile me vite, ai do të kishte thënë edhe më, sikur të mos ndeshte sytë e hapur të babait.

Galipi e kishte pritur me kënaqësi «rëniën brenda» të babait, kishte dashur prej kohe të takohej me të edhe në këtë pikë. Po gjatë ditëve të qëndrimit në Koronë ai pa se sa keq ishte mbërthyer shpirti i fuqishëm i babait. Këtij i qe zbutur shikimi e i ndriçonin sytë, si njeriut që ka pirë në sasi të madhe raki, qumësht e mjaltë, megjithëse Galipi s'kishte parë ndonjëherë t'i merrte kush këto tri gjëra bashkë. Babai nuk ishte i kallëpit që të jetonte disa çaste me një grua dhe të kalonte tej. Dashuria e tij ishte njëfarë sëmundjeje që e ka shërimin në vetveten, po ai që vuan nga kjo sëmundje nuk do të shërohet, pëlqen të kridhet

në të gjithnjë më poshtë. Njëfarë paniku po e push-
tonte Galipin. Ai u bind se puna ishte shumë e rëndë,
sidomos kur morën rrugën e kthimit, kur kaluan she-
shin e quajtur «Drita e teqesë» dhe ndaluan të pu-
shonin te Shkëmbi i Ariut. E kuptoi qartë prej fytyrës
së zbehur të babait dhe shikimit të ngulitur, tek rrinte
në një trung, me kokën të varur në anën e djathtë të
kraharorit. Nuk lëvizte asgjë në pyllin me pisha të
larta. Në dëborën si sheqer i ngrirë dukeshin gjurmët
e ndonjë shpendi me folenë diku në kaçubat. Babai
mendonte për vajzën, për lëvizjet, të folurit, dhe za-
konet, i dukej se po i dridhej në duar zemra e saj
dhe, që të bënte diçka, nxori biçakun dhe zuri të
pastronte një purtekë. Nuk i mjaftonin forcat për të
nposhtur shqetësimin e vrullshëm që i kishte hyrë në
trup. Ai preu gishtin dhe këtë e kuptoi vetëm kur pa
gjakun e mbledhur në pëllëmbën e dorës, nënqeshi i
lutuar dhe e shkundi mbi dëborë. Galipit i mbetën sytë
mbi njollat e kuqe, iu rrëqeth trupi, sepse gjaku mbi
dëborë është ngjyra më e fortë. Në atë gjak të dendur
e të ngrohtë banonin ëndrra e dëshira të ndaluara.

Ra dëborë nga degët e pishës, Galipi shikoi rrotull,
sikur të kishte dëgjuar vërshëllimën e fshehtë të një
nepërke. Malet dhe pyjet tejndanë ishin kredhur në
dëborë. Ai vetë kishte bërë në ato vende dashuri ka-
limtare me gratë, gjithnjë shëndoshë e mirë. Tani, për
herë të parë, po i dukej se këto nuk ishin vise të
mbara për dashuri, sidomos për një burrë, me hirkën
e me taçin, gjithmonë nën mbikëqyrjen e njerëzve,
dhe që e ka të ndaluar martesën. Galipit zuri t'i me-
hej fryma. Rreziqeve që kanosnin mikun, u shtojte pa-
pritur ky rrezik i madh. Nga shikimi dhe ashtu si po
rrinte, dukej se babai do të nisej ndonjë ditë për te
vajza me atë hapin e tij të rëndë, pa pyetur më tej,
dhe kjo do ta çonte drejt e në humbje.

Galipi eci përpara të çante dëborën, me një ndry-

dhje në zemër e me shqetësim të thellë. Po, kur dolën në majë dhe tej u duk teqeja verore e Rrallenjës, zuri të mendonte se kurdoherë gjendet një rrugëdalje, sado e vështirë të jetë puna e njeriut.

V

Baba Merxhani duhej të fliste. Shtrëngimi për të folur vinte nga larg dhe ishte ende i butë, një si ndjellje e gjithanshme. Njerëzit që zinin një vend në krahinë a në qytet duhej të shfaqnin veten. Këta kishin zënë të flisnin, të nxirrnin nga goja katran që botohej menjëherë në gazetë. Njeriu që donte përfitime ose që kishte një të fshehtë në shpirt, njeriu që trembej lehtë, shkruhej fashist. Të shumtët ishin oficerë, nëpunës të lartë, bejlerë, tregtarë të pasur. Në mungesë, gazeta pranonte edhe deklaratën pro «rendit të ri» të një kamrieri. Italia i ra Greqisë, lufta erdhi te dera, u shtuan turbullirat e brendshme. Nga lart u shtua këmbëngulja që të flisnin patjetër ata që kishin ndenjur heshtur.

Baba Merxhanit i erdhi thirrja nga një anë e papritur, nga Dibra e largët. E thërriste për miqësi prefekti. Babai u mendua pesë ditë dhe shkoi drejt e në prefekturë. Dontë të shihte se ç'kërkonin prej tij, si do ta kërkonin dhe ç'do të bëhej më tej. Në prefekturë po e prisnin, e shihnin me kureshtje, duke e nderuar me të tepër. Vetë prefekti doli në korridor, përcolli me ngut disa njerëz, i puthi dorën babait, e futi në zyrë, urdhëroi të mos hynte askush.

Prefekti ishte një burrë i stilit turk që po qytetërohej, duke bërë përpjekje shembullore për të dalë nga vetja. Kjo përpjekje e fortë ia pengonte lëvizjet, si një kali të vënë në qingla. Kjo ishte njëfarë epidemie që bënte kërdrinë në funksionarët e lartë në vitin

1940. Secili prej tyre ngutej të ndërronte sjelljet kundrejt superiorëve e vartësve në zyrë, në shoqëri e në familje, sipas modelit roman. Këta burra ecnin si në një ëndërr të bukur që do të zgjaste pa mbarim. Dukej sikur në kokat e tyre s'kishte gjë tjetër, veç përfitimit që u hap papritur. Po duhej shpejtuar, sepse gjithçka shpejtonte, të arrije vonë në ofiqet zyrtare, në privilegjet tregtare, ishte si të mbeteshe natën jashtë. Dhe duhej ndërruar çdo gjë nga rrënjët. Atë vit u shtuan kërkesat për veshmbathje e mobilje, për pasqyrat me korniza. «Rendi i ri» i doli kërkesës përpara, duke hapur entet e nozullimit për nëpunësit. Po në këtë vrull që të merrte mendjen, këta edhe ndaleshin, shikonin rrotull të hutuar, mjaftonte një ngjarje e vogël, një shkrehje pushke, që ta bënte të ardhmen të dyshimtë e të pasigurt.

Kurse prefekti dukej aty në zyrë si në shtëpinë e vet. Ai u ul përballë babait, duke e parë ndër sy me gëzim, dhe nisi të shqetësohej kur e pyeti për shëndetin e për teqenë. Si pinë kafënë, prefekti shkoi te tryeza dhe foli në telefon. Përpiqej të tregonte qetësi, bindje, siguri. Ai tjetri që kishte ndenjtur në atë tryezë dhe që vrarë një muaj më parë, ishte i kotë. Njeriu i vërtetë që ky i tanishmi, këshilltar i mëkëmbësit. Babai mendoi se ndofta për këtë e kishin thirrur, ta pyesnin për «dorën», për njeriun që ia numëroi atij tjetrit në kokë tek shëtiste me miqtë në bulevard. Ishte e para vrasje e madhe. Po mbase nuk e kishin thirrur për këtë. Tani do të shihte se ç'kërkohej.

Prefekti po i thoshte dikujt në telefon ta priste në zyrë, se do t'i bënte vizitë me një mik. «Në zyrë, pra, me një mik», duke i mëshuar fjalës, që ai tjetri të kuptonte se miku ishte me rëndësi. I përsëriti fjalët edhe me një zyrë tjetër. Erdhi prapë te kolltuku dhe zuri të qortonte veten për vonesën e gjatë, për ftesën

që nuk e kishte bërë që kur erdhi në Dibër dhe të mësonte gjendjen e mikut, ta merrte nën mbrojtje me fuqitë që i kishin dhënë. Po tani kjo u kalua dhe do të bisedonin të dy në zyrë duke hapur zemrat, duke i bredhur këto zemra në ca lëndina ku nuk shkelnin dot të tjerët, dhe ky do të ishte vetëm fillimi. Të gjitha këto i tregonte më së miri fizionomia e tij dhe babai priste që më në fund të shkruhej çarku, të bëhej befasisht pyetja.

Prefekti tha se duhej të shkonin në nja dy vizita, t'i hiqnin qafe, që pastaj të rrinin vetëm e rehat. Së pari e çoi babanë te kryetari i bashkisë dhe pinë konjak e kafe. Pastaj kafe te kryetari i gjykatës, pastaj konjak, çokollata e biskota te drejtori italian i bankës, më në fund raki me mëlçi te çarkkomandanti i xhandarmërisë. Në të katër këto zyra prefekti kishte qeshur, duke bërë ndonjë vërejtje për punën dhe lëshonte aty-këtu ndonjë fjalë për gjërat sekrete të shtetit, për të futur në burg një maskara, për t'i dhënë ndihmë një fukarai, për t'i hapur kredi një tregtari. Të gjitha këto pa druajtje nga prania e babait, që ishte i shtëpisë e ndofta edhe më tepër.

Prefekti dhe babai ecnin nëpër mesin e qytetit. Prefekti e mbante babanë për krahu fort, përshëndeste gjithandej, thërriste ndonjërin t'i puthte dorën babait, ndërsa rojat i ndiqnin në largësinë e duhur. Shumë njerëz ulnin sytë e kthenin kokat gjetkë tek i shihnin duke zbritur qafën e pazarit, sikur mbanin njëri-tjetrin për të mos u rrokullisur.

Kur u kthyen në prefekturë, babai ndenji në kolltuk i lodhur, po i vendosur të shihte fundin e kësaj pune. Veçse prefekti prapë nuk po kërkonte gjë. Ai vetëm sa e kishte çuar babanë nëpër zyra, e kishte shëtitur në rrugë, që qytetarët të shihnin se ky ishte mik i dashur i «rendit të ri» dhe baba Merxhani të

shihte se populli e pa këtë gjë. Kjo ishte e tëra. Babai po inatosej ngadalë, po i prishej gjaku. Prefekti e kishte zvarritur pas vetes, e kishte tërhequr për hunde, duke ia rrjepur një pjesë të lëkurës. Sa më tepër e mendonte, aq më e qartë bëhej kjo dhe habitej fort me veten ku e kishte pasur mendjen.

— Duket sikur po lëvizin edhe ca komunistë të ardhur nga jashtë, — tha prefekti si rastësisht e buzagaz, ndërsa i zbardhej fytyra lehtas sikur të ndiente një rrezik që mund të bënte befaz përpara. — Si e mendon nazari?

Babai heshti, duke e parë me kujdes.

Prefekti mblodhi buzët e tha:

— Komunizma është si veza e mushkonjës që rritet fshehtas në kënetat. — Ai qeshi me mendimin e vet, po, kur pa se babai vijonte të rrinte heshtur, kryeneç, ndërroi bisedë, ndërsa vërente babanë me sytë e thellë dinakë. U bë befaz serioz e si i shqetësuar dhe tha: — Nazari, duhet të na ndihmohet të ngremë ushtarë. Bëhet Shqipëria e Madhe.

— Cila Shqipëri?

— Atdheu, pra.

— Zotrote di t'i lidhësh fjalët si më i zoti tregtar, po kuptim ato prapë s'të kanë. Ku është atdheu?

Prefekti ndenji me duart mbi gjunjë, si një plakë e vuajtur, dhe foli si gati duke u lutur, si ndërmjet njiqve që merren vesh në çdo pikë dhe s'mund të prisohen për një gjë të vogël:

— Gjithsesi, kur ta kesh mbarë, thuaje, nazari, ndonjë fjalë ... për Shqipërinë.

Babai u kthye në Markesh, duke udhëtuar gjatë dy ditëve pa pushuar. E kishin nxjerë në treg si ariun.

«Baba Merxhani u bë me fashizmin, e leu mjekrën.» I bëhej se këto fjalë e ndiqnin prapa. Kur zbriti në lagjen «Qytezë», u ndie më i lehtësuar. Deshi t'i bënte vizitë kryetarit të komunës. Po atij i kishin hedhur të djeshmen prangat. Babai ndenji duke parë zyrën lart, me qepenin e dritares të mbyllur. «Po i bëj një padi kryeministrit», — kishte thënë herën e fundit kryetari, tek shkruante në tryezë me kokën e madhe të ulur. «Obobo», — kishte qeshur, duke ngritur sytë me dritën gri. Do të hidhte në gjyq kryeministrin, në emër të komunës së Markeshit, për prishjen e kontratës së marrave. Kishte shkruar në padi edhe ca shakara të rënda për regjimin, që kuptoheshin haptas, dhe përpiqte buzët nga kënaqësia, «Obobo.» Kurse tani po udhëtonte për në burgjet e Italisë.

VII

Babai zuri dhomë në hotel «Elbasani». Ky hotel i vjetër kishte përpara kullën e sahatit dhe në krah xhaminë e madhe. Në katin poshtë ishte kafeneja, që përdorej edhe si restorant. Babai mezi i kishte njohur rrugët e Tiranës që jetonte nën bombardimet. E kishte ndier qytetin nga larg, që prapa maleve, dhe dora-dorës që afrohej i qe shtuar nxitja për të hyrë e për të parë se ç'gjëra të reja kishin ndodhur në të. Tani që ishte brenda, ende s'i kishte parë të gjitha ndryshimet, po ato kishin ndodhur, të thella e të gjalla, dhe mund t'i vije re në fytyrat e njerëzve, me ato shikimet sikur kërkonin te të tjerët përgjigjen e diçkaje, me rëndësi e të përgjithshme, pra një hutim e shqetësim që s'mund të mbulohej nga zhurmat në rrugët dhe sheshet e qy-

tetit. Katër muaj më parë, në shkurt-mars, grekët kishin arritur Vjosën dhe në Afrikë sundonte disfata. Hutimi e paniku e kishin mbërthyer perandorinë, që përkundej buzë humnerës, si prej një kocke të mbetur në grykë. Telegramet e bujshme në gazetat: «Duçe! Njëzet milionë tonë hekur në Pogradec, pesëqind mijë tonë krom në malësi, naftë në Berat, pesë milionë bujq italianë në fushat e Shqipërisë.» Këto, si edhe paradat e shkëlqyera të fillimit, ishin zhdukur katër muaj më parë. Në muret shikoje vetëm pllakatat me veshin e madh në përgjim: «Hesht! Armiku dëgjon!» Kështu kishte qenë në shkurt-mars. Kurse tani, në qershor, kur, falë divizioneve gjermane, kishin marrë fund Greqia e Jugosllavia, fashistët në Tiranë ishin bërë prapë fashistë. Që nga kuadratet e tyre thërrisnin në sheshin «Skënderbej» si njerëz me emocione të forta të nxitura nga shkaqe të paqena dhe në darkë shkonin në kafenetë dhe lulishtet të vallëzonin, të gëzonin jetën e begatë, si të dehur prej fitores së ardhur nga jashtë. Megjithatë, dyshimi e pasiguria rrinin strukur. Nuk ishte e këshilluar të shëtisje natën vonë.

Baba Merxhani po hante darkë në tryezën e fundit, duke marrë frymë me zor prej vapës dhe ajrit të ndenjtur.

— Të bëftë mirë.

Dedei i ri i Teqesë së Madhe i dha dorën duke puqur pëllëmbën me gishtin lart dhe u ul përballë. Baba Merxhanit ky iu duk si njeri i njohur, ndërsa s'e kishte parë kurrë. Fytyrën e kishte të zeshkët e të madhe, sytë të kaltër e me xixa të verdha dhe trupin të fortë. S'kishte mjekër. Nga lëkura rreth qafës dukej se edhe kokën e kishte të rrjepur. Flokët dhe qimet duhej t'i kishin rënë nga ndonjë sëmundje. Baba Merxhani u soll me respekt, për hir të moshës e të rangut të dedeit dhe ca më tepër për Teqenë e Madhe ku ishte rritur.

Po dukej se dedei nuk u jepte rëndësi gjërave të tilla. Rrinte duke e shikuar baba Merxhanit me kureshtje, foli për Këshillin e Shenjtë që mbliidhej të nesërmen dhe për ligjin bektashian, tha edhe një frazë të gjatë arabisht. Zërin e kishte gurgullues, po si me ndryshk, dhe rrinte i kërrusur, si duke dëgjuar ato që thoshte. Kur rrinte ashtu, sytë i errësoheshin gati në blu, a thua se shikonte diçka brenda një pusi të errët. Ato që thoshte ai, baba Merxhanit i tingëlluan si jashtë kohës e vendit; ky dede nuk donte, ose nuk mundej të fliste për gjëra të jetës. Për një çast babait iu duk se këtë e bënte me qëllim dhe se, ndërsa fliste për profetin, mendohej për punë të tjera. Babai vijonte të hante darkën heshtur, duke menduar se ky njeri që e turbullonte thellë me pamjen dhe zërin, do t'i qepej gjatë tërë mbrëmjes. Dedei shikoi orën e xhepit me kapak argjendi, murmuriti diçka dhe u çua, tha se më nëntë pa një çerek bëhej errësimi i qytetit. Te dera ktheu kokën të shihte babanë edhe një herë, si për t'i thënë diçka, dhe doli me supet mbledhur.

Babai po priste në shtrat errësimin e qytetit, duke shikuar në tavan vezullimin e dritave, dëgjonte zhurmat e çoroditura, sikur qyteti të ngutej për të mbyllur dyert e kanatet. Edhe pak dhe njerëzit do të zhdukeshin, në rrugët e shkreta do të qarkullonin patrullat. Bëheshin bastisje, burgosje, internime. Po nga qoshet e errëta mund të shkiste papritur një hije dhe të kërciste koburja. Kujt i përkisnin këto hije? Babai mbajti vesh me shpresë. Ishte i lodhur dhe e kapiti gjumi. «Qeveria ka frikë», — murmuriti dhe mbylli sytë duke buzëqeshur. Po tek binte në gjumë të thellë, iu shfaq dedei i Teqesë së Madhe, duke thënë diçka që ishte edhe arabisht edhe shqip, ndërsa rrinte duke shikuar si në fundin e një honi të errët, pastaj u zhduk në mjegull.

• • •

Në mëngjes, tek pinte kafënë në restorant, babai vuri re nxitimin e njerëzve. Duhej të kishte ngjarë diçka e rëndë. Në rrugën përtej xhamit, kalimtarët këmbenin ndonjë fjalë dhe iknin më tej. Një burrë me borsalinë po ngërdheshej, i fliste një tjetri si për diçka të gëzueshme, po dukej se në atë që thoshte nuk besonte as vetë.

— Ç'ka bërë vaki? — pyeti babai kamerierin.

— Hitleri sulmoi Rusinë, — tha kamerieri. Edhe ky ishte nervoz dhe buzëqeshi sikur të kërkonte ndjesë për një çrregullim.

Babai u ngrit padashur dhe doli te dera. Burri me borsalinë qe zhdukur. Por te kalimtarët mund të shihje nga afër të njëjtin nxitim që vinte duke u shtuar, a thua se në qytet po përhapej një ethe që ecte me dritën e diellit. Babai ndjeu t'i ngjitej ankthi trazuar me gëzimin. Në sytë e tij bota e ndarë më dysh u fry, u çua lart dhe qëndroi pezull me kërcënim, sikur gjysma e saj do të përplasej me gjysmën tjetër në kataklizmë.

Ai eci në rrugë i ndjekur nga dëshira për të parë nëse edhe të tjerët ndienin të njëjtën gjë. Duke ecur, bota zuri vend, mori trajtat e saj. Ndashja me gjëmime të thella që do të vinin, duhej të kishte filluar në fushat e pamata të Rusisë, në Vollgë e deri në malet Ural. «Rusia do t'u bjerë me kopaçe të madhe», — tha me vete ai. Gëzimi i fshehtë i rritej edhe më tepër tek shihte fytyrën e trembur të ndonjë polici a nëpunësi, që qeshte me gjallëri të tepërt, ngërdheshej. Këtë mund ta shihje nga një rrugë në tjetrën, a thua se ngërdheshja e atij burrit me borsalinë para hotel «Elbasanit» të qe hapur mbi qytet si një spërkatje me ngjyrë të verdhë.

Mbledhja e Këshillit të Shenjtë qe shtyrë për të

nesërmen, më 23 qershor, dhe babai e kaloi kohën me vizita te disa bektashinj të vjetër e duke blerë harxhet për teqenë. Këto i mbartnin Selman Gërvishta e qehaja Aliu dhe i çonin te shtëpia në Kodrën e Kuqe ku ishin kuajt.

Selmani dukej më qejf. Ecte i kërrusur, me mustaqet varur, po aq lirshëm sa edhe në Markesh, a thua se në ato rrugë me kallaballëk ai dhe babai të ishin krejt të vetëm. Hera-herës çonte kokën për të parë me mospërfillje dyqanet e kafenetë ku këndonin radiot marshe ushtarake.

— Tani filloi lufta, — tha Selmani.

— Pse, s'ka pasur luftë deri tani? — tha babai.

— Kjo është punë tjetër, — tha me bindje Selmani.

Babai po e shihte me bishtin e syrit. Selmani duhej të kishte thënë një të vërtetë.

— Tregtarët nuk po dinë, ta kthejnë mallin në pare, apo ta mbyllin në bodrume, — tha Selmani. Ecte me kokën mënjanë, i ngjante një dashi që ka rënë në kullotë të mirë. Para tyre po kalonin dy gra me fytyrat të lyera si të mbyllura brenda një koreje të bardhë, kërcenin mbi takat e larta, me byzylykët në llërët e zhveshura deri te supet. Selmani i pa vrerët, jo për vete, po për babanë.

— Tregtarët nuk dinë ç'të bëjnë as me shtëpitë, me paratë në bankë, me tapitë. Si një bletë që i ka hyrë tymi, — tha prapë Selmani i argëtuar. Jetën e këtyre tregtarëve e shihte si një lojë të lehtë, të cilës ata vetë i jepnin një rëndësi të madhe.

Duke vërejtur më mirë, babai i dha të drejtë Selmanit. Në vitrinat malli nxirrej si me druajtje. Pasuria, thesaret, duhej të ishin në thellësi. Tregtarët s'kishin më atë dritën e shitblerjes në fytyrë, kishte dyshim e frikë në sytë e tyre. Njëri rufit kafenë pas banakut dhe duket sikur fshin një lot; një tjetër shet diçka

pa e pasur mendjen, punë në të cilën më parë do të kishte vënë shpirtin; një tjetër ul qepenin dhe shkund duart si për të thënë: «U pa puna.» Në xhamat dhe në tendat binte dielli si nga afër. Çatitë kishin një ngjyrë të fortë të ndryshkut. Dukej sikur do të dilte sheshit çdo hile e dredhi që përmbante qyteti.

— Kjo që ndodh s'ka të bëjë vetëm me tregtarët, — tha si me qortim babai.

— Ani, ani, — tha Selmani. Tregtarët gjithnjë i qenë dukur si ca ndërmjetës të ferrit.

VIII

Të nesërmen më 23 qeshor, ndërsa babai po zinte pajtonin për në kryegjyshatë, dy civilë i dolën në krah dhe e ftuan të hipte në një «Mileçento» të zezë, që po priste me motorin ndezur ndanë xhamisë. Civilët ishin të heshtur e nervozë, lëviznin si pa parë asgjë rreth tyre, a thua se kishin të bënë me krijesa të padukshme. Brenda në makinë babai kuptoi se ky ishte një arrestim. Ndaluan fare pranë, në ndërtesën ngjyrë hiri trekatëshe e me kangjella hekuri të rrugës «Mbretëresha Helenë».

Babai me dy civilët që s'i ndaheshin, pritën gjatë para zyrës së gjeneral Agostinuçit, komandant i përgjithshëm i xhandarmërisë. Kur hynë, gjenerali, pa luajtur nga froni, i bëri shenjë babait të ulej. Në cepin e tryezës së gjatë rrinte një nënkolonel shqiptar, si ndihmës e si përkthyes. Te dritarja me hekura rrinte sikur të mos ishte një nënoficer me makinën e shkrimit.

Ashtu si rrinte gjenerali, nga fytyra e tij dhe e nënkolonelit, nga dosja mbi tryezë, dukej se e kishin pri-

tur dhe se aty do të bëhej një hetim me rëndësi. Babai ndjeu mbi vete shtypjen e një krahu të gjatë, që qenkësh shtrirë mbi të qysh kur e thirrën në Dibër, e ndofta edhe më parë, qysh kur shkoi federali në Markesh. Dhe kishin pritur të thirrej në Këshillin e Shenjtë për ta arrestuar. Babai u ndie si i përkëdhelur nga një vrojtim e kujdes kaq i madh.

— Më duket se jeni i kënaqur, pothuaj i gëzuar, që takohemi, — tha gjenerali, duke u përkulur përpara.

— Ashtu si më sollën këtu s'mund të jem dhe aq i gëzuar, — tha babai. Gjenerali shihte thellë, ia kuptonte gjendjen dhe kjo e turbulloi babanë, po prapë u mbajt i qetë.

Gjenerali buzëqeshi. Do të bënte pyetjet e do të studionte përgjigjet, me ngadalë. Kurse tensioni që do të krijohet tek i arrestuari do të rritej përherë më shumë, derisa të ndihej si në hekura të nxehtë. Atëherë do të përpëlitej, do të fliste, si një mekanizëm i shkrehur nga brenda dhe që punon jashtë kontrollit të trurit.

— A e pranoni bashkimin e Shqipërisë me Italinë?

— Këto janë punë të atyre që merren me politikë.

Te dritarja rrihte me ngut makina e shkrimit. Gjenerali mbledhi buzët i pakënaqur, ndërsa hetonte me kureshtje babanë, burrë i pashëm, i shëndetshëm e i fortë. Dukej se ky e kishte marrë veten prej arrestimit të befashëm, rrinte brenda petkut fetar si në një këllëf që i jep mbrojtje dhe e ndihmonte të fshihte gjendjen e tij prej rebeli. Ama, si rebel dukej vetëm nga sytë. Në raportet për të flitej si «njeri me parime absurde». Dukej se të tilla i kishte parimet. Gjenerali po ndiente një si ngacmim të lëkurës, gjë që i ndodhte sa herë shihte se nuk e kishte të qartë ku ta përdorte fuqinë e tij të madhe. Kjo ngjante si në një ëndërr, kur ke të bësh me një kundërshtim rrëshqitës, të pa-

njohur, që është i pranishëm kudo dhe nuk ngulitet në asnjë vend.

Gjenerali i dha cigare dhe babai e ndezi, me çibukun e gjatë prej qelibari. Gjenerali filloi ta pyeste për teqenë e për malësinë, si në një bisedë miqësore, pastaj pyeti befas;

— Kur kanë ardhur komitët për herë të parë në teqe?

Babai hapi sytë dhe ndenji i heshtur, si i argëtuar.

— Këtu baba nazarin mund ta bëjmë më të arsyeshëm, — tha gjenerali.

— Bëni si të doni. Veçse jeni në rrugë të gabuar.

— Babai mendoi se këta po vërtiteshin në të errët, i kërkonin komitët atje tek s'qenë dhe kjo e kënaqi, ndenji me fytyrën të nxehtë i kapur pas këtij mendimi.

Gjeneralit po i krijohej një dyshim. «Njeriu me parime absurde» rrinte i patundur, si një gur i errët i rënë që nga malësia. Tani ngrinte sytë me mospërfillje, pothuaj pa turp. Mbase s'kishte ndonjë lidhje kushedi me komitët. Po teqeja e tij në mes të pyjeve mund të bëhej gracka më e mirë për t'i zënë këta. Ky duhej të bashkëpunonte, me dashje ose me të keq. Gjenerali pa orën me kornizë argjendi mbi tryezë, me lavjerrësin e vogël. Vioi me pyetje edhe dhjetë minuta, duke u nxehur me përkthyesin që përdorte aq shpesh atë fjalën «nazari». Më në fund nënshkroi një shkresë, ia zgjati nënkolonelit dhe i tha:

— Të futet në qeli baba nazari. Merruni me të personalisht.

* * *

Në qeli ishin dy të burgosur të tjerë. Babai u ul mbi shtratin prej dërrase që ishte i lirë. Në murin

prapa derës ishte harta e madhe e detit Mesdhe, i zotëruar prej Duçes, «Mare nostrum». Në korridor ecnin njerëz me hap të rëndë. E gjithë ndërtesa trekatëshe, me kolonat në hyrje si fortesë, ishte e gjallë e në tension. Babai e kishte parë këtë ndërtesë në kalim, po tani që ndodhej në bodrumet e saj, filloi ta studionte me mendje. Më tepër donte të kuptonte njerëzit që ndeshi duke hyrë. Ishin me uniformë ose civilë, thërrisnin fort ose pëshpërisnin, mbanin mustaqe të dukshme ose ishin krejt të rruar, ishin të gjatë e të bëshëm, ose të shkurtër e të vegjël e prapë ngjanin si të bërë nga e njëjta lëndë. Babai mendoi se të gjithë këta, rojat, hetuesit, kishin më frikë se të burgosurit. Ai deshë të lidhej me botën jashtë dhe mbajti vesh. Nga dritarja me hekura e me perde errësi, vinte zhurma e mbytur e qytetit, trokitja e potkonjve të një kali në asfalt, thirrja e një shitësi, kalimi i një motoçiklete. Për disa çaste babai dëgjoji këto zhurma, me duart lidhur pas kokës. Dy banorët e tjerë të qelisë rrinin me fytyrat drejt tij. Provokatori ishte një burrë i shëndoshë, me fytyrën e kuqe si të mbushur me lot. Murmuriste fjalë, qeshte me vete dhe ishte i mjerë e i rrënuar. Tjetri, burrë i gjatë e me kokën e vogël, e dinte provokatorin dhe rrinte sa më urtë, as që hapte gojë.

Për pesë ditë asnjëri nuk u mor me babanë. Muret e qelisë po ngushtoheshin për të. Po si dervish ai mund ta duronte burgun gjatë. Ditët e netët aty brenda dukeshin si pa mbarim, po edhe kalonin shpejt, si pa u kuptuar. Kjo është e fshehta e madhe e kohës, për të cilën s'di ç'të thotë njeriu. Ditën e pestë në mbrëmje, kur u bë errësi i qytetit, karabinierët e çuan babanë në katin e tretë, në zyrën e nënkolonelit, e ulën në karrigen e hekurt, me dritën e llambës në fytyrë.

Para se të fliste nënkoloneli shfletoi dosjen, duke

shikuar hera-herës babanë, si për të thënë se kishte aty letra të shumta për punën e tij. Babai po mendonte se aty duhej të kishte disa letra e raporte, të sajuara në Markesh e në prefekturë, ndofta edhe në Tiranë. Nënkoloneli brodhi shikimin mbi fytyrën e babait si zanatçi dhe ia mbërtheu sytë te mjekra. «Do ta mbaj mend fytyrën tënde, s'ke për t'i shpëtuar kurrë syrit tim», — thoshte shikimi i tij. Në të njëjtën kohë ky shikim e ftonte të përulej, të fliste, për të mirën e tij; i thoshte se aty gjithkush kishte folur me anë të mjetëve që mund të merreshin me mend, po që më mirë të mos njiheshin, të mos provoheshin. Nënkoloneli po e zgjaste heshtjen tepër, duke pritur të shihte frikën në fytyrën e tjetrit, punën që duhej të kishte bërë në të qelia. Babai vijonte të rrinte i sigurt e i qetë në zemërimin e tij.

— Nazari mendon se je i mbrojtur nga xhybja dhe mjekra, — tha më në fund nënkoloneli dhe qeshi me paturpësi.

Babai nuk u përgjigj, nuk lëvizi. Kishte dëgjuar për vrasje të fshehta në qelitë, po qe i bindur se pikërisht ato e mbronin, xhybja dhe mjekra.

— Askush nuk del i larë nga hetimi. Edhe po të kesh ndenjtur tërë jetën mbyllur në dhomën e teqesë, ne dimë ç'ke bërë e ç'ke thënë, — tha nënkoloneli buzagaz. U duk sikur nga kënaqësia iu drodh trupi e iu hollua më tepër hunda e kërcyer. — Këtu të bëjmë të përgjigjesh ashtu si duam ne.

— Atëherë pse më pyesni?

— Se mund ta bëjmë me bashkëpunim, ose edhe pa pëlqimin tënd. Zgjidh e merr.

— Zgjidhni ju. S'kam për çfarë të bashkëpunoj.

Nënkoloneli u mendua. S'kishte shpresë të merrej vesh me babanë në asnjë pikë. Aty e tutje procesi do

të ecte duke shkuar secili në rrugën dhe mendimet e veta. Do të donte shumë ta kishte nja dy net në duar trupin e dhjamur të babait, po këtë nuk ia lejonin.

— Po, po, nazari, nuk bëhesh tellall i fashizmit, — tha nënkoloneli. U përkul përpara sikur ta fshikullonte me frymën në fytyrë dhe pyeti: — Kush e vrau prefektin e Dibrës, të ndjerin Neki Starova?

«Ah, më i lumtë dora, se qëroi një krimb nga faqja e dheut.»

— Nga ta di unë këtë gjë?

— Çeta e Myslym Pezës është strehuar në teqe.

«Ah, sikur të kishte ardhur vërtet në teqe ai burrë! Tani baba Merxhani nuk do të dergjej në qeli duke iu përgjigjur një të poshtri.»

— S'ka ardhur kurrë.

— Trego, nazari, se do të kesh lehtësi.

«Do të të tregoj ndonjë ditë, mor qen i ndyrë, dhe do të kem një lehtësim të madh.»

— Zoti nënkolonel, jeni nxituar tepër. Mblidhni mendjen se nuk ju del mirë kjo punë.

IX

Majori dhe dy karabinierë po e çonin baba Merxhanin në kryegjyshatë me të njëjtën «Mileçento» të zezë. Babai pa së largu kubënë e madhe prej plumbi në mes të qiparisave, që thithte e shpërndante rrezet e diellit, dhe gati u gëzua. Do të gjente në atë strehë prehje, fjetje e ushqim të mirë. Te porta e rëndë me dru arre po i priste një dervish i vjetër.

«Zogu i vogël që ke rënë nga dega! Haxhi Bektashi, zoti ynë, të dha strehë shtëpinë e tij...»

Babai mbeti i përhumbur.

Njëzet vjet më parë, kur bridhte në Teqenë e Madhe për t'i shërbyer gjithkujt, ai futej hera-herës në një qoshe, rrinte në përgjim, duke e menduar teqenë si një bina të fuqishme me rrënjët në tokë, që ruan e drejton njerëzit, u kthen atyre shëndetin e u ndriçon mendjen. Pastaj shkonte për të fjetur me dervishin qorr, mbrohej nën dritën e kandilit, duke ndier rreth vetes errësirën, prej nga gjuhët e shehitëve bektashinj i murmurisnin fjalë, e shikonin me sytë e ndezur, për t'i kujtuar se do ta pësonte keq po të mos ecte në rrugën e duhur. Po cila qe kjo rrugë, ai nuk do ta dinte kurrë, sepse ajo kalonte nëpër shtigje të mbuluara, ai ndiente t'i ftohej kurrizi e t'i ndrydhej zemra, e kapiste gjumi me ëndrra të turbullta e të frikshme, që e bënin nganjëherë të hidhej përpjetë, të fliste përçart, për të dëgjuar të nesërmen shakatë e përqeshjet e ndonjë shërbëtori. Djalit ia ndrydhte edhe më fort shpirtin dyshimi, kur një dervish i punonte dervishit tjetër një rreng dhe pastaj turrej ta padiste, kur një rreng ia punonin edhe vetë djalit. Se një natë e lanë në ahur të ruante lopën barsë, t'i bënte dritë me qiri viçit të artë që do të vinte, dhe djali ndenji në të ftohtë në mes të bajgave deri në agim, duke djegur qiri pas qiriri e prapë lopa s'polli dhe në mëngjes dervishët e kapën për veshi, se nuk i kishte ndriçuar viçit mirë.

* * *

Thoshin shkrimet në mure: «Në përlësi, si dheu», «Në dituri, si dielli»; «Në bujari, si lumi», «Në sekret, si nata», «Në amanet, si vdekja».

Prej një muaji baba Merxhani lexonte këto shkri-

me në dhomën e kryegjyshit ku mbahej mbyllur, i veçuar, «me besë e premtim, në pamundësi të ketë takim me njeri të gjallë». Këtu zotëronte heshtja e rëndë shtypëse e teqeve. Veçse kryegjyshata, teqeja e teqeve, kishte më tepër dritë e ngjyra në tavanet, në xhamat e dritareve. Këtu çdo zhurmë, çdo tingull, qoftë edhe një pëshpëritje, jehonte deri poshtë shkallëve të mermerta. Po sado ta mbanin me fytyrë nga shkrimet në mure, ai nuk do t'i bënte më dritë vëçit të tyre, që nuk do të lindte kurrë.

Në sytë e dervishëve që i sillnin për të ngrënë, ai shihte keqardhjen. Për ta ai ishte një baba me një plagë të fshehtë. Ata donin ta ndihmonin, që ai të shërohej, por më parë donin të shihnin se e ç'lloji ishte kjo plagë. Habinë dhe smirën e tyre s'mund ta fshihnin. Ky baba që hesht, ende djalosh, kishte nisur shkëputjen prej teqeve, ai do të fluturonte i lirë, ose do të binte i vdekur. Dervishët donin të shihnin cila prej të dyjave do të ngjante. Vinte çdo javë edhe majori për të parë nëse kryegjyshata u përmbahej kushteve. Njeriu i dorëzuar «me premtim e besë» s'kishte takuar njeri të gjallë. Vinin fshatarë të shumtë, po qenë penguar kryekëput të flisnin me të. Fshatarët, në grupe, u kishin bërë telegrame kryeministrisë dhe mëkëmbësit të mbretit.

Babai zuri të këndonte nën zë, në dhomëzën-qeli. Ai ishte prapë babai i vërtetë i atyre anëve, iu lirua shpirti prej fyerjes së rëndë, e pushtoi malli i madh për Markeshin, zuri të fliste me dervishin që i çonte darkën. Ky përgjigjej me ndonjë fjalë. Babai kënaqej kur e dëgjonte, e dinte mirë se në të folurit e dervishit rëndojnë gjëra të pathëna.

Nganjëherë, kur s'kishte miq, kryegjyshi hante darkë me baba Merxhanin. Në zërin e kryegjyshit, me tingullin dashamir atëror, mbështillej qortimi, për pu-

në që s'duheshin zënë më gojë, së atëherë do të vinte një prishje e rëndë. Kryegjyshi, i veshur me atë rrobën e bardhë që duhej të mbështillte vetëm trupin e tij, kishte në sytë dhe në buzët e thara vetëdijen e fuqisë. Megjithëse kishte humbur shkëlqimin e parë, papërpëqiej t'i qëndronte kohës, duke u përkundur. Vitet e gjata të ndenjjes në postiqen e kryegjyshit, mendimi i ngulitur për përtëritjen e bektashizmit në botë pas goditjes që i dha Ataturku, bindja se ai vetë, Sali Niazi Dedei, do ta çonte përpara këtë përtëritje, duke u vënë emri i tij pranë emrit të Haxhi Bektash Veliut, ky mendim e kjo ngulitje ia kishin holluar e zbardhur lëkurën. Por disa telashe që i kishin dalë së fundi ia brenin shpirtin edhe më fort dhe, tek fliste, ndalej hera-herës të merrte frymë, hetonte me kujdes baba Merxhanin, shihte atë nënqeshjen e tij të hollë e të pakapshme që ia prishte gjakun. Ky ia bëri pyetjen me mllef të përmbajtur:

— A ka ngjarë ndonjëherë në histori të bëhen teqetë shërbëtores të zaptuesit? — U afrua ta shihte kryegjyshin nga afër, pa mëshirë, dhe tha: — Në sofrat e teqesë nazari ke mbledhur tërë dituritë bektashiane... — Tundi kokën dhe e la fjalën përgjysmë.

Fytyra e vjetër e kryegjyshit u zbardh edhe më tepër, u duk sikur po i dilnin sumbulla djerse dhe ndenji kokulur. Mësimet e mbledhura në vetmi, që prej rinisë e derisa u plak, po i nxirrte tani me djersën. Dy herë kishin botuar gazetat bekimet e tij për Duçen dhe mbretin. Kishin botuar letrën e falënderimit për Xhiron, kishin botuar fotografinë e kryegjyshit në mes të qeverisë, gjeneralëve italianë dhe grave të tyre në ditën e hashures. Atë ditë, duke u shtruar në gosti, kryegjyshi kishte bekuar bashkimin e Shqipërisë me Italinë. Ai hapi gojën, me sytë e mbushur me lot. Mbase deshi të hapte zemrën, t'i thoshte baba Merxhanit se

atë, themeluesin, e kishin tërhequr si cjapin në baltë, duke ia zhveshur shenjtërinë; t'i shpjegonte se të gjitha i kishte bërë si një haraç për të shpëtuar besimin, për të ndërtuar me ndihmën e italianëve kryegjyshatën e bukur, po ndërroi mendje, nga ajo që pa në sytë e babait, iu duk e rrezikshme dhe e pamundur t'i fliste; shtriu dorën në drejtim të babait si për të ndaluar fjalët dhe ndenji me sytë mbyllur e buzët mbledhur, si në lidhje me fuqitë e qiellit. Ndenji ashtu disa çaste të gjata, i hapi sytë e përpoqi qepallat e rena, si për të thënë se çdo pyetje tjetër do të ishte një mëkat i rëndë.

* * *

Në dhomën e babait zuri të bënte vizita të shpeshta sekretari i kryegjyshatës. Me flokët dhe mustaqet e forta të zbardhura, me fytyrën rrumbullake të kuqe, me sytë e skuqur të vegjël e të shpejtë, me lëpirjen e buzëve, me zërin e ulët, sekretari i ngjante për çudi një urithi të gëzuar që porsa del nga vrima. Ishte i zgjuar e dinak dhe i lidhur fort pas gotës së rakisë. Në mërzinë dhe këmbënguljen e tij babai e shikonte me dyshim sekretarin. Po ndofta ky mund të ishte një mik. I çonte babait çdo ditë gazetën, këmbente ndonjë mendim për politikën.

Sekretari i tha babait se do t'i tregonte tyrben ku s'hynte njeri, me të fshehtat e shenjta, të ëmbla e plot tmerr të besimit. Babai mendoj se sekretari ishte i dehur. Ata ecën zbatshur në korridor, sekretari i bëri shenjë me gisht, i tregoi shkallët, i pëshpëriti të mos bënte zë. Në frymën e tij s'kishte gjurmë rakie. Në fundin e korridorit të katit poshtë, që ndriçohet nga një dritare e gjatë dhe e ngushtë me xhamat me ngjy-

ra, ishte një kthesë dhe në fund të kthesës një derë e madhe. Sekretari nxori çelësin dhe e futi në bravën automatike. Ishte zbehur dhe dukej sikur i lëviznin qimet e mustaqeve, i bëri shenjë me kokë babait si për t'i thënë se përtej asaj dore ishte errësira e dendur, në mes të së cilës shkëlqente misteri.

Tyrbja ishte një dhomë pa dritare, me dyshtemenë të zhveshur, me tavanin si kube e lartë, ku hapeshin disa vrima prej nga vinte një dritë e paktë e tërthortë. Në gjysmerrësirë shquheshin në mure figura e luanit të ndërkrayer me gjarprin e madh, e mira dhe e keqja, dhe figurat e kafshëve me fytyrë njeriu. Krisi diçka, sikur të ngrehej çarku i një kobureje, dhe në tyrben ku s'depërtonte asnjë zhurmë, nisi një vërshëllimë që mori forcë ngadalë dhe u ngrit si një erë e shkretëtirës, përmes së cilës zunë të shquheshin ulërime të dhimbshme grash, angullima të zgjatura qeni, klithma të skëterrës, të njerëzve që u copëtohej zemra, ca tinguj e gërvishtje nga vise të largëta të panjohura. Sekretari i foli baba Merxhanit duke i përcjellë fjalët me duar, po nuk dëgjohej ç'thoshte, prej zhurmës që vinte duke u rritur. Babai u afrua. Fytyra rrumbullake e sekretarit ishte si e mbushur me gjak, qimet e trasha të mustaqeve e vetullave i qenë ngritur përpjetë, sytë e vegjël i lëviznin andej-këndeje si një njeri i dalldisur që pret gjëmën.

— Këtu besimtari duhet të hapë zemrën, të hapë zemrën. Kjo është e fshehta e Haxhi Bektashit, — po thoshte fort sekretari.

Baba Merxhani fshiu djersën. Zhurma filloi të bin-te, të thithej prej kubesë së tavanit me vrima, po aq ngadalë sa edhe kur erdhi. Më në fund krisi diçka dhe zhurma e tingujt po shuheshin si pëshpëritje që humbasin në një pafundësi.

Sekretari shikonte babanë ndërsa rrinte me kokën

mënjatë duke pritur diçka. Babai erdhi rrotull. Nuk po shihte në muret me figura asnjë të çarë, asnjë vegël nuk shihej në dhomën e zhveshur. Ajo që ngjiste aty lidhej me vrimat si hinka në kube. Krisi prapë ngritja e një çarku dhe filloi ajo era e mprehtë e shkretëtirës, po kësaj here zëri i krijesave të gjalla erdhi më i çiltër dhe në të njëjtën kohë kërciti lehtë e zuri të rrotullohej dysHEMEJA, ndërsa dukej sikur po vërtiteshin muret. U duk sikur djaj të zinj e çakaj me mendjen e njeriut që lëshonin nga goja lëng të kuq e mbartnin mbi vete çdo gjë të ligë e të pështirë që ka në botë, zunë të silleshin në mure, të ngjiteshin në kube pa u dukur, ashtu si i kishte njohur babai në vegjëli, nëpërmjet gojës së errët të dervishit qorr. I kishte harruar këto prej kohe, po ja tek i shfaqeshin si të gjalla nëpër zhurmën që vinte e rritej, duke i rrëqethur boshtin e kurrizit, duke e trullosur. Sekretari prapë po thoshte diçka, me krahët lart, duke e përgjerruar babanë të bindej, të fliste, ndërsa po binte zhurma dhe kriste metali me një rënkim të fundit.

Në kubënë e qetë jehoi qeshja e egër e babait, ha-ha-ha. Erdhi e ndenji para sekretarit dhe lëvizi krahët si për ta rrahur, fshiu djersën dhe i tha:

— Marifeti është poshtë dyshemesë dhe te hinkat lart, apo jo. Lart apo poshtë është shpirti i Haxhi Bek-tashit?

Në mbrëmje sekretari pinte e qante. Tha se mekanizmin e tyrbes e kishin ndërtuar italianët. Aty çohet «njeriu i sëmurë», dervishi që humbiste shpirtin, që mund të fliste jashtë tarikut. Aty njeriu i trembur duhej të çmendej, po ta kishte zemrën të dobët, duhej të vdiste.

— Përse më çove? — pyeti babai.

— Për të të treguar një të fshehtë, për miqësi.

Babai nënqeshi me përçmim. S'kishte besuar se

mund t'i punonin tani të njëjtat lojëra e poshtërime si në fëmijëri. Po mbase kjo kishte qenë vetëm një dëshirë e sekretarit. Këlij po i skuqeshin sytë e vegjël si prushe, fshinte lotët me pëllëmbën e dorës dhe lutej si qen që babai të betohej për të mos e treguar kurrë vizitën në tyrbe. Babai u betua. Neveria po i kthehej në një si ethe të ftohtë. Në dhomat dhe në korridoret ishte qetësi e thellë, si në një bina të vdekur. Po kjo bina ishte vendi i dhomave të fshehta, kurtheve e punëve të dyshimta. Në djalëri kishte dashur me zjarr t'u afrohej të fshehtave të tarikut. Tani donte të ikte prej tyre sa më shpejt dhe sa më larg. Po mbase ata mund ta mbanin aty me vite, sa të çmendej, sa të vdiste.

X

Dervish Hasani ngjiti shkallët, duke u përpjekur të mbahej i qetë. Hapi derën e babait pa u ndier, pa asnjë krismë dhe u ndal të merrte frymë, i dridhej koka lehtë, picërronte sytë të shquante njeriun që rrinte këmbëkryq. Dervishit gjithnjë i mehej fryma kur babai rrinte ndanë oxhakut, me çibukun të shuar, me fytyrën të zhytur në mjekër, sikur dëgjonte me përqendrim zëra të brendshëm të panjohur, ose të mbante vesh zhurmat e dheut. Kjo i këlliste të ftohtët në zemër dervishit, ai lëvizte me druajtje dhe priste që babai të ngrinte sytë mbi të, pastaj të hapte gojë. Po sonte dervishi kishte ngut. Megjithatë, ndenji heshtur të sodiste edhe për pak çaste babanë, me parandjenjën ogurzezë se kjo ishte hera e fundit që e shihte aty tek oxhaku. Si kishte ndenjur pesë muaj i mbyllur në krye-

gjyshatë, babai që kthyer më në fund dhe dimrin e kaloi pothuaj në teqe. Hareja, netët e pijeve të gjata, i përkisnin një të kaluarë të largët. Babai rrinte aty si një i huaj, i pandjeshëm ndaj jetës së teqesë, të cilën e njihte prej vitesh në çdo hollësi, në çdo tingull, që kur fillonte lëvizja në mëngjes me të njëjtën ngathësi, derisa mbyllej natën vonë. Dervish Hasani shihte prej kohe se babai nuk e donte më këtë jetë. Dervishi besonte se mundimi i babait, që po zgjatej me muaj, pritja e tij përmbys, me zemrën si në varr, do të nxirrnin në një shteg të papritur. Dervishi ia kishte frikën këtij fundi të panjohur. Ndjenja se babai po ecte buzë rrezikut, duke marrë me vete edhe teqenë, i tërhequr prej një force që s'mund të përballlohej, si në ëndërr, kjo ndjenjë, pra, e mbante dervishin në shqetësim e në ankth të vazhduar. Ai shkoi tek oxhaku, rregulloi urët e zjarrit, me lëvizjet e pasakta të duarve, dhe tha:

— Kanë ardhur komitët.

Babai u mendua. Këta duhej të ishin njerëz guximtarë, që vinin në teqenë e lagjes «Qytezë», ndërsa njëzet minuta më poshtë ishte posta e xhandarmërisë.

— Të lënë armët dhe të vijnë, — tha babai.

Dervishi e dinte se ashtu do të ndodhte, komitët do të shkonin te babai. Po nuk arrinte të shihte si do të bëhej më tej dhe prapë u rrëqeth. I dukej se hijet e komitëve rrëshqisnin prapa tij e ngjiteshin lart. Mund të ishin edhe keqbërës, hajdutë. Aty më parë, njerëz të panjohur kishin therur me thika kryegjyshin botëror, e kishin grirë krejt, brenda në kryegjyshatë. Dervishi po rrinte në gjunjë me qafën të ngrirë, si një muaj më parë kur i hodhën shushunjat, shihte me trurin të mjegulluar teqenë të përmbytur në gjak, flakët që përpiçnin shkallët, dëgjonte krisma armësh, rënkime njerëzish.

— A nuk po lëviz? — i tha babai, ndërsa rregullonte «Goltin» poshtë postiqes.

Pas pak dervishi ngjiti prapë shkallët që kërcisnin, në hapin e tij të rëndë ndihej nxitimi. Prapa vinte një njeri i vetëm, që ecte me kujdes. Babai buzëqeshi duke dëgjuar atë të ecur të druajtur e plot kujdes.

Hyri një burrë tridhjetë vjeç, që u duk i gjatë, por që ishte me trup mesatar. Kokën e mbante pak të pjerrët. Ishte i veshur me rroba meshini të zeza, me dollakë ushtari, me këpucë me qafa. Në brez kishte këllëfin e revolverit bosh. Nënqeshi si për të kërkuar ndjesë.

Baba Merxhani ishte çuar më këmbë dhe pyeti veten: «A keni parë njerëz të tillë?» dhe po vetë u përgjigj: «Kemi parë sipas rastit.» Pastaj mendoi se kjo s'ishte e vërtetë. Njerëz të tillë ende s'kishte parë. Ky ishte Met Leka, i arratisur prej kohës së Zogut. Shpesh babai kishte ndjekur me mendje bredhjet e tij në male. Ky komit diku kishte bërë ndonjë përpjekje të lehtë me xhandarët, po s'qe dëgjuar kurrë për vrasje e plaçkitje.

—Le të vijnë lart edhe shokët e zotërisë sate, — tha babai.

— Më mirë po rrimë pak vetëm, — tha komiti.

Ai e përqafoi babanë si një mik dhe ndenji në anën tjetër të vatrës. Lëvizjet e tij të qeta rrezatonin sjellje të mirë e thjeshtësi. I lotonte syri i majtë, pak i shpërvjelë, sikur ta kishte fshikulluar një plumb nën vetull. Babai donte ta shihte më mirë, donte ta çonte fitilin e llambës, po këtë s'mund ta bënte. E pyeti mikun për jetën e vështirë.

Met Leka nisi të tregonte ngadalë e bujarisht, a thua se baba Merxhani kishte qenë në bredhjet e çetës së vogël një pjesëmarrës i largët. Tregonte me zërin e butë e të ulët, duke bërë kujdes nga çdo anë, që të

mos i shpëtonte mburrje për veten, aty-këtu kapërdinte ndonjë fjalë, për të qenë me të tjerët i drejtë deri në fund, me mikun dhe armikun.

— Ke të fala prej Myslym Pezës, — tha.

— I bëj shumë të fala prej meje, — tha babai.

— Si me gojën tënde, — e siguroi Meti.

Babai ndenji heshtur. Për çetën e Myslym Pezës dhe për komitet si ky Met Leka që përgjigjur në zyrat e karabinierisë. Thellë në shpirt kishte dashur që këta të trokisnin ndonjë natë në portën e teqesë. Po kush qëndronte prapa tyre? Dhe çfarë do të kërkonin nga teqeja?

Met Leka vuri në buzë gotën e rakisë dhe nisi të fliste për atdheun e për armikun e huaj. Kjo për të ishte një bisedë e vështirë, që nisi si një llambë me ndriçim të dobët, duke u këputur e me kalime të errëta. Babai po e dëgjonte pa bërë pyetje, duke e ndihur me shikimin dhe heshtjen që të fliste. Komiti filloi të ndihej më mirë; po ujdiste fjalët e dëgjuaara gjetiu me mendimin e vet dhe biseda u derdh si në shtigje të gjera, u ngroh dhoma. Befas Meti u zbeh e u ndal, po pyeste babanë me sy nëse mund të shkonte edhe më tej, të fliste për gjënë e rëndësishme që ende s'kishte thënë.

— Fol si në shtëpinë tënde, — tha babai. Po mendonte me zemrën lart se komiti ishte vetëm një lajmëtar dhe se kjo ishte një nga ato netët që vijjnë vetëm një herë në jetën e njeriut dhe që sjellin ndryshime të mëdha, ndofta përmbysje.

— Më ka çuar te nazari Partia Komuniste e Shqipërisë, — tha Meti.

Babai ndenji gati përmbys, me bërrylat mbërthyer fort te gjunjët. E kishte ndier praninë e kësaj Partie kur zbriste në qytet, kishte dëshiruar afrim me të, pa ia pohuar këtë as vetes, pa guxuar të vente më tej,

duke kaluar anash me hapin e babait dhe kthehej në teqe me zemrën të rënduar.

— Zotrote qenke me këtë Parti? — pyeti.

— S'ka rrugë tjetër, — tha Meti.

Babai mendoi për yllin e kuq, draprin e çekanin, siç i kishte parë në gazetatat. Poshtë, nga ashefi, nuk vinte asnjë zhurmë dhe as dëgjohej ndonjë blegërimë në ahuret. Teqeja ishte kredhur në një qetësi që të mpinte.

— Çfarë kërkon kjo Parti? — pyeti babai.

— Të çohet populli në luftë, të bëhet Shqipëri e lirë.

— Vetëm kaq? Kush e udhëheq Partinë, a lidhet me ndokënd jashtë?

— As vetë nuk di më tepër. Më erdhën dy komunistë në qetë. Kam folë edhe me Myslimin.

Babai e pa me mirënjohje që iu përgjigj drejt. Për disa çaste ai e mendoi Partinë si një lidhje njerëzish të fshehtë që përhapej mbi vendin në grupe. Ai ishte një baba teqeje, ndërsa idetë e kësaj Partie shtriheshin në zona të tjera të panjohura. Deri ku dhe si? Nuk deshë të mendonte më gjatë për këtë.

— Rruga e kësaj Partie duket e drejtë, — tha, më tepër si duke pyetur.

— Pra nazari je i zoti të rrokësh armën? — pyeti Meti.

Babai buzëqeshi. Tërë jetën e kishte munduar ankthi se mos po bën dikur një hap të gabuar. Ky ankth i ruan njeriut nderin. Asnjëherë s'i kishte dhënë kësaj një përgjigje të fundit në gjendjen e tij prej babai. Tani ankthi i qe rikthyer me forcë, po me të qetë. Hera-herës ngrinte sytë mbi mikun për të parë se deri ku besonte ai vetë në ato që tha. Dukej se ai s'kishte dyshime. Ishte endur në male me vite duke kërkuar një shteg dhe tani qe kapur fort pas Partisë Komuniste.

— Pasi t'i derdhësh fjalët nuk i mbledh dot më, si arrat në trastë, — tha babai.

Metit i vërshoi gjaku lehtas, po vuri buzën në gaz e ndenji heshtur, se babai kishte folur për veten.

Babait i dukej se po i merrej fryma. Kishte pritur gjatë që t'i trokiste rasti në derë, një rast pa trajtë, një pështjellim i mbinatyrshëm që do t'i përmbyste të gjitha. Tani dukej se rasti erdhi, me trajtë të qartë, në rrugë të ndershme. Mund t'i përgjigjej ankthit të tërë jetës së tij duke ndjekur shtegun që i hapej nga ky komit i ardhur natën. Por kjo mund të çonte në ngjarje të rënda të panjohura. Mëndja e babait prapë mbyllej si në çark dhe ai rrinte aty me bërrylat në gjunjë, i ngurtësuar e duke dëgjuar rrahjet e zemrës së vet. «Pyet zemrën, se ajo s'të gabon kurrë, pyete mirë», i tha vetes. Befas drejtoi trupin dhe qeshi, bëri diçka që as i shkonte në mendje aty më parë. Mënjanoi postiqen në mur dhe mori maliherin, e mbajti mbi gjunjë. Ishte i modelit të shkurtër me veshë, krejt i ri, i paguar shtrenjtë, pushkë për qejf, por edhe e rrezikshme. E lëmoi me dorë dhe ndenji me fytyrën të kthyer mënjanë, sikur t'ia mbante vesh krismën e bukur me dy kohë.

— Gëzuar, — tha babai dhe çoi gotën. — Ti s'ke pirë fare. — I mbushi gotën mikut dhe trokiti në dysheme për t'i sjellë darkën. Lëvizjet i bënte të ngadalta, sikur të trembej se mos thyente diçka, ndërsa në fytyrën me mjekër i endej një buzëqeshje e lidhur me një punë që do ta mendonte më pas.

XI

Në mëngjes, si uli tabakanë me filxhanin e kafesë, dervish Hasani tha se dy tregtarë drithi kishin fjetur në oxhak-kafe dhe donin të flisnin me babanë për një kontratë. Ata i sillnin të fala prej një miku.

— Le të presin, — tha babai. U mendua me filxhanin në dorë. Dy tregtarë drithi! Prej një muaji, që nga nata kur kishte ardhur Met Leka, asnjë i huaj s'kishte shkelur në teqe. — Cilët janë? — pyeti.

Hasani eci drejt dritares, me atë hapin e pandjeshëm të dervishit, mënjanoi perden dhe tha:

— Po presin te mani, thonë se nguten.

— Thirri të vijnë.

Ata ishin me veshje gjysmëfshatare, me koburet në brez. Njëri quhej Xhajë dhe tjetri Zambak. Xhaja dukej burrë i mirë, i zeshkët, e me mustaqet të prera shkurt. Brenda tij ziente një fuqi e madhe e mbajtur në çdo kohë nën kontroll. Kjo dukej në të folurit e qetë, në shikimin e çiltër dhe sidomos kur vinte buzën në gaz. Ishte mjaft i kënaqur që po takohej me babanë. Tjetri, Zambaku, ishte truplastar, me fytyrën e pashme të zbehtë, një zbehtësi e ndritur që bëhej edhe më e theksuar nga sytë e kaltër, të mëdhenj e depërtues dhe nga mustaqet e verdha me majat lart. Dukej si i etur, se lëpinte shpesh buzët e trasha.

— A kini qenë këtu për drithë... në dhjetor? — qeshi babai.

— Jo, besa, është e para herë, — u përgjigj Xhaja.

— Për t'u takuar me nazarin qenka e vështirë. As sot nuk po na linte dervishi, — tha Zambaku.

— Dervishi nuk di gjë. Ai është dervish, — tha me të butë babai. — Po ju sikur më sillnit të fala prej një miku.

— Po, — tha Xhaja. — Ke shumë të fala prej dervish Rustemit të Teqesë së Madhe.

Babai e pa me habi. Ky Rustemi ishte një dervish i mykur, qose, i përlur e dinak, nga soji i dervishëve që nuk zënë miqësi.

— Të fala paç, veç nuk e prisja nga ajo anë, — tha babai.

Xhaja i hodhi Zambakut një shikim të shpejtë, u koll e nënqeshi, si konspirator i pafat. Tha:

— Nuk e kam njohur këtë dervish dhe ne s'jemi tregtarë. Jemi të dërguar të Partisë. Shokët e qarkorit na folën gjatë për ty. As emrat nuk i kemi Xhajë e Zambak.

Zambaku hodhi trupin lart e shikoi rrotull, sikur spiunët do të kërcenin befaz nga kamaret dhe dollapët. Dhe jo se trembej prej tyre, po për hir të konspiracionit.

Babai mendoi se shokët e Partisë mund të ishin edhe të tillë, si ky Zambaku. Po cili ishte ky qarkor që paskësh folur gjatë për të? Babai i kishte pritur njerëzit e Partisë prej një muaji, ndofta edhe më parë, dhe ja tek kishin ardhur, befaz.

— Cilatdo punë dhe çfarëdo emra të keni, të dy teqetë janë si shtëpitë tuaja, — tha.

Xhajës i qeshën sytë, i vërshoi gjaku nën lëkurën e zeshkët, po prapë foli me të qetë:

— Së pari duhet të gjejmë në këto anë një bazë të sigurt për teknikën, si edhe për gjëra të tjera me rëndësi që do të bëhen më pas.

Babai prapë u rrëqeth e u habit. Xhaja po i drejtohej pa pikën e ngurrimit, si një shoku të Partisë, sikur tashmë çdo gjë të ishte folur e vendosur. Kurse ai tjetri, me emrin e një luleje, lëvizte sytë e kaltër si në një pusi të vazhduar dhe u koll nja dy herë.

— Ky vend i lartë është një pikë kalimi, — tha

Xhaja, duke shikuar rrethi mureve si për të parë Markeshin. Në zërin e tij ndihej gëzim e ngrohtësi tek foli për rrugët e Markeshit që kalonin nga të katër anët. Në të njëjtën kohë pyeste me sy babanë, se mos po bënte ndonjë gabim për rrugët. Babai e miratonte me kokë dhe Xhaja mori zemër. Tha se në Markesh tërhiqej një pjesë e ushtrisë së Skënderbeut në kohën e rrethimeve të mëdha. Babanë po e pushtonte njëfarë mallëngjimi. S'kishte dëgjuar ndonjëherë të flitej kështu për Markeshin e varfër e të largët, që tashmë ishte bërë si vendlindja e tij.

— Po ç'thotë populli, vallë? — pyeti Xhaja.

Babai tregoi për myhibët, për miqtë besnikë që mund të merrnin armët. Ndihej si i tërhequr brenda një rryme të nxehtë e të shpejtë, mendoi se po fliste tepër dhe u ndal.

— Po, po, s'ka pikë dyshimi, o baba Merxhan, se çetën e keni krijuar me kohë në mendjen e në shpirtin tuaj, — tha Xhaja. — Këtë e kuptova ca më mirë kur po rrija mbrëmë, me dervishët në oxhak-kafe.

Babai uli kokën, i turpëruar që miqtë kishin fjetur në oxhak-kafe. Po shqetësimi e tronditja e tij s'kishin të bënin me këtë, po me befasinë e bisedës, me Xhajën që s'linte shteg për ngurrime dhe që i donte të gjitha njëherësh, duke qenë ai vetë i ngadaltë, i fortë e i qetë, si një dervish i kredhur i tëri në fenë e vet dhe që do të mbetet i tillë deri në fund të jetës.

Xhaja shkoi përpara dhe tha:

— Në këto male duhet të gjejmë edhe ndonjë bazë rezervë për udhëheqjen. Se lufta do të jetë e ashpër, e vështirë dhe udhëheqja duhet të jetë në vende të sigurta prej nga mund të drejtojmë.

— Disa gjëra do t'i bisedojmë më pas, — tha Zambaku nëpër dhëmbë e duke lëvizur me shqetësim.

— Pse? — iu kthye Xhaja si i habitur. — Çdo gjë

mund ta bësojmë. A bën teqeja verore si bazë e teknikës? — pyeti babanë.

— Çfarë teknike?

— Një shtypshkronjë.

— Vetëm për pak kohë. Aty kalojnë udhëtarë të shumtë.

— Po Guri i Mustafës?

— Ai po.

Xhaja ndenji heshtur, me sytë përdhe. Kishte kërkuar me ngulm, kishte vrarë mendjen natë e ditë për bazat, duke parë çdo hollësi, po ishte gati t'i shqyrtonte edhe një herë, t'i rrëzonte e të kërkonte të tjera, duke e bërë babanë përherë e më tepër pjesëtar të planeve të fshehta.

— U vonuam tepër, — tha Zambaku.

Babai u kthye dhe e pa gjatë. Nga biseda kishte kuptuar se «lidhjet» do t'i mbante nëpërmjet Zambakut, që do të vendosej diku, në krahinat buzë lumit. Kurse Xhaja do të shtegtonte më larg. Dukej sikur fytyra e Zambakut të qe larë me ujë të verdhë. Ai kishte ndenjtur tërë kohën më tepër si dëshmitar se si pjesëmarrës, i gatshëm të çohet e të ikte, të ankohej, po qe se punët nuk do të dilnin mirë. Babait nuk po i pëlqente që të kishte këtë njeri si mbikëqyrës.

XII

Selman Gërvishta trokiti në portën e teqesë që nuk mbyllej ditën kurrë. Porta me dru të vjetër u hap ngadalë, pa atë krismën çjerrëse. E kishin vajosur. E gjithë teqeja dukej si e puthitur dhe e vajosur, që të mos nxirrte jashtë asnjë tingull. Shërbëtori me fytyrën

e shqetësuar tha se Selmanin e priste babai sa të mbaronte punë me Galipin.

Selmani ndenji galiç pas murit. Prapa krahëve ishte varri i baba Jasharit, ku Selmani kishte hyrë gjithnjë me druajtjen në zemër. Tani po i dukej se s'kishte asgjë aty brenda. Nga porta depërtonte ndonjë rreze drite si tel i hollë dhe Selmani mësonte sytë në korridorin gjysmë të errët, ndërsa ndihej i fyer e i pakënaqur në çdo pjesë të trupit. Prej dy ditësh kishte vuajtur në kullën e tij, duke pritur ta thërriste babai. Kjo ndjenjë iu bë Selmanit edhe më e fortë, kur pa dervish Hasanin të ecte me trupin e bëshëm si në majë të këmbëve e duke pëshpëritur me vete. Prej dy ditësh dervishët e shërbëtorët silleshin rrotull të heshtur, si të zënë në kurth, ndërsa lopët e kuajt hanin dushk në ahure. Askush s'mund të dilte jashtë pa lejen e babait. Teqeja ishte shkëputur prej botës, kishte nisur jetën e fshehtë si në kohën e ndjekjeve të mëdha, njëqind vjet më parë. Nga jashtë ruante pamjen e saj, kurse nga brenda kryhej ndryshimi i rëndë. Në mejdan-evi, ku deri dy ditë më parë kishin hyrë vetëm myhibët, tani banonin dy tregtarë të drithit. Për ta thërritur çdo mëngjes një dash dhe po hanin që të gjithë, me dervishë e shërbëtorë, ishin hapur qilarët, kishte marrë fund kursimi, nuk bëheshin më lutjet në sofër, kishte nisur prishja, përmbysja e teqesë. Selmani i kishte menduar të gjitha këto nga jashtë, kurse tani i shihte e i ndiente nga brenda, duke pirë duhan rrëzë murit, dhe i rritej fyerja, sepse deri atë ditë babai nuk e kishte veçuar ndonjëherë në punët e mëdha e të vogla. Po në të njëjtën kohë zuri të mendonte se prej vitesh kishte pritur një ndryshim të jetës në Markesh, që do të vinte nëpërmjet baba Merxhanit. Tani ndryshimi kishte nisur. Selmani s'kishte menduar se kjo do të ndodhte nëpërmjet përmbysjes së jetës në teqe,

po prapë tha me vete se teqeja s'mund të mbetej jash-të Markeshit e jashtë ndryshimit. Hidhërimi e fyerja e tij po i dukeshin një ndjenjë e vockël, aq më tepër kur mendoi se ajo që ndodhte aty shtrihej tej Mar-keshit në malësi e në tërë vendin.

Selmani ngjiti shkallët dhe ndenji te dera e dho-mës së babait. Përballë, në mejdan-evi, dëgjoheshin të qeshura nën zë të njerëzve të gëzuar. Selmani mendoi se s'mund të rrinte aty më gjatë dhe hyri pa u ndier te babai. Ky ishte më këmbë, me dritën e një hakmarr-jeje të vjetër në sy. Galip Nuri rrinte para tij me tru-pin e madh, me hundën të kërcyer, i skuqur lehtas. Pa Selmanin sikur të mos e kishte parë dhe vijoi bi-sedën me babanë:

— Nazari, do të vazhdosh të jesh prind i teqesë?

Babai ndenji disa çaste i hutuar, me hijen e një brengje në ballë.

— Si e mendon ti? — pyeti.

— Në këtë pikë nuk mendoj kurrgjë. Mua më ke prapa sido që të bëhet, — u përgjigj Galipi. Ishte mirënjohës për shumë gjëra ndaj babait dhe mirënjohja të çon te miqësia e dashuria e vërtetë.

— Mbase do të mbetem në teqe ca kohë... për të mirën e luftës, — tha babai.

Më fort se me babanë Selmani po çuditej me Ga-lipin. Ky i shtriu dorën babait, nuk ia puthi, ia shtrën-goi fort, për të parën herë. Dorën tjetër e kishte te gjoksi, që u duk më i zmadhuar. Tek po dilte, lëvizi shpatullat, ktheu kokën të shihte edhe një herë babanë. Kishte ende pyetje, po këto nuk lidheshin me veten e tij. Buzëqeshi që sipër supit si për të thënë se aty e tutje gjërat do të shpjegoheshin vetë. Ky e paskësh pritur këtë ditë me një dëshirë më të fortë nga sa mund të kujtonin të tjerët. Ishte sikur prej Galipit të vjetër, hokatar, të ditur e poterexhi, të kishte dalë

një mik i një lloji të ri, i cili po ikte duke marrë me vete pjesën e gëzimit që i takonte.

Babait nuk po i dilte nga sytë ai shpërfytyrim i bukur i Galipit aty te dera. Po ndofta kishte ndryshuar edhe ai vetë, babai, dhe këtë e kuptoi më mirë kur foli Selmani.

— Nazari, je njeri i lartë. Fytyra të ka marrë dritë të shkëlqyer, — tha ai, me atë shikimin e butë, që kërkonte thellë.

— Mos më thirr më ashtu. Tani jemi shokë të së njëjtës rrugë, — tha babai.

— Pra, tani, nazari, ke për fe luftën dhe për mjet armën, — nguli këmbë Selmani.

Kjo ishte fjalë e vërtetë. Babai po linte dritën e çiragut për të marrë në dorë armën e zjarrit, për të kaluar në një besim të ri. Kjo kishte ndodhur brenda dy netëve. Veçse vendimi që sajuar më herët. Tani fjalët ishin thënë, puna që bërë dhe ai nuk do të ndalej me dyshim e frikë para vështirësive. Do të ecte në këtë rrugë të re duke shkelur mbi çdo gjë nga të cilat druhet një baba. Do të bëhej luftëtar, siç kishte dashur prej kohe shpirti i tij.

— Njerëzit do të kthehen ndaj teje duke të parë ndryshe, — tha Selmani. Në zërin e tij premtues e të gëzuar ndihej krenari, po edhe shqetësim për atë që do t'i ndodhte babait. Ky e pa me dhimbsuri. Ndërmjet tyre qëndronin tetë vjetët e shkuar të miqësisë, gjatë të cilëve Selmani i kishte ndenjor prapa, me durimin e hijes, me atë krenarinë e paepur të njeriut të varfër.

— Se, që të përmbysset e të shkulet një besim, duhet

të vijë një besim i ri, apo jo, nazari? — pyeti Selmani.

Babai hapi sytë. Gjithnjë do të çuditej me mendimet e holla të Selmanit. Gjatë dy ditëve babai as që e kishte vrarë mendjen për atë që do të ndodhte ndërmjet tij dhe njerëzve. Po mendohej tani, me fjalët e këtij Selmanit. Se një natë më parë dervish Lala i vjetër i kishte kthyer me fytyrë nga muret figurat dhe shkrimet e shenjta. «Pse?» — e kishte pyetur babai. Dervishi e kishte shikuar përlësisht, pa zë. «Neve s'na prishin punë», — kishte thënë Xhaja, që gëlltitur, e kishte parë babanë me mallëngjim dhe i kishte thënë: «Këtë s'do ta pëlqenin myhibët.» Disa gjëra s'mund të kapërceheshin aq lehtë. Babai rrinte para Selmanit si ndërmjet dy besimeve, ndiente t'i shtohet turbullimi dhe tha:

— Edhe më parë ka pasur baballarë që dhanë jetën për Shqipërinë... si edhe tradhtarë.

Babai nuk e vuri re Selmanin që u afrua gjunjazi, uli kokën dhe i puthi dorën, duke e gudulisur me mustaqet e forta. Babai e kishte thirrur që të bisedonte me të dhe po e shihte gojëhapët, s'kishte asgjë për t'i thënë.

* * *

Prej pesë ditësh myhibët vinin në grupe e në fshehtësi. Dëgjonin për orë me radhë miqtë e babait, duke ruajtur për vete dyshimet. Hera-herës hidhnin sytë rreth mureve. Figurat e njohura ishin aty, po sytë e shenjtorëve ishin bërë edhe më të largët, sikur vuanin prej një sëmundjeje të lashtë që s'mund të tregohet. Edhe kafshët dukeshin më të urtësuar, shkrimet si të veshura në mjegull. Babai u thoshte myhibëve të rrinin lirë, po një liri të tillë ata s'mund ta merrnin

në prani të tij dhe rrinin tërë kohën në gjunjë. Deri në njëfarë vendi myhibët e ndiqnin me dëshirë fjalën e të huajve, se gjithnjë Markeshi ka rrokur armët. Po markeshasi gjithnjë ishte ruajtur nga ndonjë gjë e re e ardhur nga jashtë, që mund ta bënte edhe më të rëndë jetën e tyre të varfër. Dhe fjala «komunist», ndofta, kishte kaluar edhe më parë në Markesh, si diçka që mbart një kërcënim të panjohur. Tani komunizmi kishte hyrë papritur në teqe.

Kryeplaku i Balit, Sadi Pejza, tha se ishte gati të bashkohej me këtë Parti, po me pyetjet që bëri e me urtësinë që tregoi, hynte brenda, po edhe linte një shteg prapa vetes, sepse ato që thoshin mysafirët e babait, ishin të lehta për t'u kuptuar, po të vështira për t'u gëlltitur. Se këtu duhej shkuar vetëm përpara, kryeplaku i Balit asnjëherë s'kishte bërë kapërcime të mëdha në errësi. Po ai s'mund të fliste për këtë dhe foli me dyshim për gratë e vajzat që duhej të thirreshin në luftë...

— Kjo është koha e gjithkujt, — tha rëndë babai, duke ndërprerë ligjëratën e kryeplakut. — Edhe më parë gratë kanë luftuar në krah të burrave.

Në mbrëmje, në mejdan-evi këndonin me çifteli këngë mëmëdhetare. Ia niste babai me zërin si bubullimë. «Duhet sqaruar njerëzit», — i thoshte Xhaja me zë të ulët e buzagaz. Babai varte kryet mbi kraharor. E shihte edhe vetë se nxitohej. Kjo nuk pajtohej me gjendjen e tij prej babai, as me kushtet. Ngutja e tij i hutonte e i habiste myhibët. «Njerëzit do të kthehen ndaj teje duke të parë ndryshe!»

XIII

Nën dritën e pishtarëve, fshatarët po ngarkonin në tetëmbëdhjetë mushka pjesët e shtypshkronjës «Gutenberg», që do të çohet prej teqesë verore te Guri i Mustafës. Fshatarët përshpërisnin nën zë, ndihnin njëri-tjetrin. Shtypshkronja, e nxjerrë prej Tirane me mundime e rreziqe, sundonte mendjet e tyre. Donin fort ta shihnin të ngrehur, të merrnin në duar fletët që do të nxirrte. Kjo ishte si të ngrehje në malet e Markeshit një pjesë të kryeqytetit. Baba Merxhani ndiqte me dhimbje përpjekjet e dervishit shurdhmemec. Ky jepte të kuptohej me anë të shenjave se shihte dhe ndiente frymën e punëve të fshehta që po bëheshin. Lëshonte britma të mbytura, i vërshonte gjaku e i shtrembërohej fytyra. Në kohën që kapi njërën anë të platformës njëqindkilëshe iu ngrit nga gjoksi një thirrje e thellë, u duk se më në fund prej gojës së tij do të dilte fjala. Kur shtypshkronja u ngarkua e tëra, dervishi shurdhmemec qëndroi para babait, duke gulçuar e gjithë djersë. Babai i vuri dorën në sup dhe ndjeu nën pëllëmbë se qysh fërgëlloi trupi i dervishit. Krijesa e gjorë s'mund të ndihmohej. Babai i bëri shenjë të çlodhej, të fshinte djersën. Sytë e dervishit u mbushën me lot, kapi me të dy duart dorën e babait dhe e puthi. Ishte nata e parë në jetën e tij që nuk bëri një punë prej dervishi.

Të nesërmen në drekë, babai, i përcjellë nga Selman Gërvishta, arriti te Guri i Mustafës, një shkëmb i madh që ndante Markeshin nga Çernika. Babai u ul dhe priti. Kishin ardhur në teqe korrierë dhe shokë në kalim, me letra e trakte, po prej dy muajsh nuk qenë dukur as Xhaja, as Zambaku. Para tri ditëve Zambaku i kishte caktuar këtë takim te Guri i Mustafës.

Babai shihte shqiponjat që fluturonin ultas. Do të fliste me Zambakun, duke i hapur zemrën. Ai, babai, siç biseduan me Xhajën, kishte çuar njerëzit më të mirë në fiset e stanet më të largëta, duke i lidhur të gjithë me çështjen e luftës. Këto ishin bërë shpejt e lehtë, dhe tani ishte koha që fshatarëve t'u jepej diçka për të bërë, se markeshasi është i patundur në durimin e vet, po edhe mërzitet shpejt dhe pëlqen më fort punët se fjalët. Veç kësaj, në lagjet kishte dalë djalli, ose vetë baba i djallit, nën lëkurën e atij Rat Mëdyshit, duke u helmuar mendjet disave. Kurse komuna dhe posta me xhandarët e karabinierët rrinin si në ikje e sipër. A s'mund të flakeshin këta jashtë Markeshit përgjithnjë?

Zambaku po vinte me ca veprime kaçaku në rrethim, me shoqërues para e prapa, që imitonin hutin, lëshonin vërshëllima të lehta, trokisnin ndonjë gur. Këto babait iu dukën krejt të tepërta në atë majë të lartë e të vetmuar dhe i shtuan kureshtjen. Pastaj mendoi se ndofta shoku Zambak stërviste me atë rast njerëzit për kalime të rrezikshme në prapavijat armike.

Zambaku u shfaq befas rrëzë shkëmbit, me trupin të drejtuar në tërë gjatësinë, i armatosur rëndë, me dylbinë në qafë dhe një çantë lëkure. U përqaftuan me babanë dhe u hoqën mënjanë. Zambaku tha se më parë le të hanin një kafshatë dhe thirri me vërshëllimë njërin nga shoqëruesit. Filloi të përtypte bukën e të kafshonte mishin, sikur të kërkonte në të kocka të vogla të thërrmuara dhe shtrembëronte mjekrën si nga një shije e hidhur, po prapë hëngri mjaft. Këtë të ngrënë të tij babai e kishte vënë re edhe në teqe, duke menduar se Zambaku ishte si ca njerëz të cilëve çdo lloj gjelle që t'u japësh, po njëlloj do t'u shijojë. Pamja e petritit rrëzë shkëmbit ishte zhdukur, Zambaku erdhi e u bë njeri që nuk kuptohej, me diçka fyese

e shtypëse në sjelljen e tij. Babai jo vetëm nuk ndiente mall për të, siç kishte kujtuar tek e priste, por tani i kaloi edhe dëshira për të folur e ca më tepër për të hapur zemrën. Po zuri të pyeste vetë Zambaku duke dëgjuar në heshtje tregimin e babait, aty-këtu me një buzëqeshje pakënaqësie, me shikimin e ustait që ka përpara një çirak të zgjuar e të fortë, por që mund të bëjë disa dëme po të mos vëzhgohet. Më në fund foli, dha këshilla, me zërin e ulët që shuhej si pëshpërimë, gati pa tinguj. Tha se mbi të gjitha duhej konspiracion dhe verifikim, rëndësi kishin krerët, figurat, dhe në përgjithësi duhej pritur, që njerëzit të vinin vetë. Ndërsa thoshte këto, i shkelte syrin babait.

Babai u skuq, mendoi se kishte folur tepër, që nxituar, veçse nuk po kuptonte se si duhej t'i kishte bërë punët. Zambaku e kapi këtë gjendje të babait, i vuri dorën në sup dhe foli prapë, me durim e me shikimin e njeriut që i kupton në themel vështirësitë e tjetrit dhe mund ta nxjerrë me dy fjalë nga belaja. I shpjegoi se e tillë ishte gjendja në verën e vitit 1942, duke lënë të kuptohej se aq mund t'i thoshte babait. Ky duhej të priste udhëzime dhe të dërgonte çdo muaj një raport. Së shpejti do të ndodhte diçka me rëndësi. Kur tha kështu, u zverdh edhe më fort, ndenji si i lënduar nga kujtimi i diçkaje të keqe.

Bënte fresk aty rrëzë shkëmbit. Prapa ishin malet dhe poshtë shtrihej pellgu i kodrave e përrenjve me gjelbërim të errët, prej nga kishte ardhur Zambaku. Në qiellin e lartë qenë ndalur aty-këtu re të bardha. Ata s'kishin më asgjë për të thënë dhe po zgjatej një heshitje e bezdisur. Më në fund u ndanë, Zambaku për të shkuar në drejtim të kundërt nga erdhi dhe babai për t'u kthyer në Rrallenjë, i turbulluar dhe i inatosur.

Atij po i dukej se ky shoku Zambak ngrohej në një tjetër zjarr dhe ushqehej me tjetër bukë. Fjalët e tij

avullonin, mbetej ajo ngërdheshja e verdhë si dhembje koke. Ai s'kishte pëlqyer asgjë nga punët e babait në Markesh dhe as ishte i interesuar të dinte. Raportin mujor e donte vetëm që të ishte i mbrojtur nga telashet që mund t'i hapte ky vend. Kjo bëhej përherë më e qartë, sa më tepër ta mendoje. Baba Merxhani tha me vete se do të ruante për këtë njeri mendimin e vet dhe do të përpiqej të kishte të bënte sa më pak me të, ose aspak.

XIV

Në javën e parë të tetorit në Arëz bënte nxehtë. Ky ishte një fshat i madh, në pllajën e kodrave të larta, prej nga dukej qyteti dhe xhadeja që shkonte buzë lumit. Afër mbrëmjes, pemët e fshatit me hardhi merrnin ngjyrën e arit, kodrat e plasura, të hirta e të gjelbra tërhiqeshin ngadalë në hije, duke mbartur luftën. Në këtë orë të mbrëmjes, baba Merxhani shëtiste me Shaqir Laçin në bahçet e bukura të freskëta, duke biseduar për lidhjet e hershme të teqeve të Arëzës dhe Markeshit.

Babai mendonte se, ngado të shkonte, prapë do të binte në ndonjë pusi teqeje. Kishte ardhur në Arëz i thirrur për punë të tjera dhe prapë i duhej të hiqej se kujdesej për teqetë. Shaqiri ia kuptonte turbullimin e thellë, ndalej dhe e shihte. «Gjeje vetë, or mik, si do rregullohesh», — thoshte shikimi i tij.

Shaqiri, kujdestar i teqesë në Arëzës, ishte i ngë-

shëm, i dashur, politikan i vjetër. Shallvaret e tregonin edhe më të madh dhe ecte lehtë, a thua se nuk e ndiente peshën e trupit. Po ndërtonte shtëpi të re. Njerëz të rrallë si ai jetonin sikur lufta të mos qe, sikur jeta të vazhdonte në çdo rrethanë, e ndarë prej telasheve që vijnë nga jashtë. Baba Merxhani e shihte ndryshe. Lufta kishte ardhur dhe ajo do të ndryshonte jetën e gjithkujt. Në shtëpinë e dajë Lymit, aty përballë, të nesërmen do të mbahej konferenca e qarkut për të zgjedhur këshillin nacionalçlirimtar. Do të votohej për luftën. Kjo ishte një shtëpi dykatëshe me gurë, që nuk dukej dhe aq e madhe, po, kur hyje brenda, habitesh me dhomat e të ndarat e shumta, me shkallët që ngjiteshin e zbrisnin, dhe të pushtonte një ndjenjë gëzimi, prej ajrit të mikpritjes, të besës dhe të rehatisë. Aty po përgatitej dhoma e madhe.

Babai po shihte se kishte hyrë në rrymën e ngjarjeve, në vetë qendrat prej nga drejtohej lufta dhe ndihej fare mirë. Veçse duhej të përmbahej, të vrojtonte me kujdes, në përshtatje me gjendjen e tij.

— Do të bëhet dasmë, — tha Shaqiri, duke shikuar si me mall shtëpitë dhe bahçet.

Dukej se ai e shihte luftën tejندانë, ardhjen e krushqve, dollitë, marrjen e nuses. Kjo e shtiu për disa çaste në mendime, po pak më tej balli iu kthjellua, sikur retë e mbledhura aty më parë në mendjen e tij t'i kishte marrë era. Ndofta ai vetë do të linte kokën gjatë kësaj dasme, po një burrë si ai nuk mërzitej për atë që do të vinte. Do t'i bënte ballë qetësisht, sipas rastit e kohës, asaj që ishte e pashmangshme. Babai e shihte me habi. Ky njeri, i vështirë për t'u kuptuar, mund të bënte punë me kurajën dhe forcën e madhe, sikur të mos e ndante veten nga njerëzit. Ishte ndalur dhe shikonte i menduar një shtëpi për-dhese me pemë e me hardhi.

Babai kishte qenë në atë shtëpi një natë më parë. Sekretari politik i qarkorit e kishte përqaftuar, si një mik që erdhi më në fund, po edhe duke e parë me vëmendje. Sekretari ishte njëzet e pesë vjeç, me pamje mësuesi, me sjellje të çiltër, që kërkonte po atë çiltërsi nga ana jote. Ishte i veshur me xhakëtë të lehtë gjue-tari e me kilota. Hidhte befasisht kokën lart dhe atëherë fytyra e tij e këndshme merrte një shprehje serioziteti të butë. «Po, po», — kishte thënë, — çuditëm që nuk e kemi ngritur çetën në Markesh. Kurse tani kemi këtë konferencë. «Mezi e përmbante gëzimin për konferencën dhe për babanë. «Mbledhjen do ta kryesosh vetë, — kishte thënë, duke lënë të kuptohej se do të ndodhte edhe diçka tjetër me rëndësi». Lexo këtë, rezolutën e Konferencës së Pezës, pastaj fol si di ti.»

— Germat me bojën e shaptilografit kishin qartësi e dritë. Cilët ishin këta? — kishte pyetur veten babai. Ku e kishte qendrën qarkori? Se, kur jepesh pas një partie, siç po bënte ai, si të kesh sqaruar thelbin e ideve të saj, ndien nevojën të shohësh drejtuesit, të gjallë e të përsosur. Kjo nevojë ishte bërë për babanë, që nga fillimi, njëfarë ankthi, një problem me peshë. Drejtuesit e kësaj Partie ja tek ishin, sekretari me pamje mësuesi, ajo vajza me flokët mbi supë të krehur me kujdes, e pastër në tërë qenien e saj. Nga mënyra si i drejtoheshin të tjerët dukej se ishte e dyta në qarkor. Këta bënë në qytet një punë e një jetë ilegali, të cilën babai nuk arrinte ta shihte mirë. Ishin mjaft të rinj, po trima e të mençur, me bindje të thella, njerëz që të merrnin zemrën. Kurse më lart, në qendër, ishin të tjerë, si Xhaja. Ama edhe vetë Xhaja thoshte për dikë «udhëheqja». Rreth kësaj «udhëheqjeje», ende të ranjohur, kalonin fjalë të fshehta.

«Më mirë të mos e dëgjosh, se ai të mbush mendjen», — kishte thënë për sekretarin Shaqir Laçi.

Sekretari të mbushte mendjen vërtet, jo me hirin e bukurinë e fjalës, me dhunën që të nënshton, siç bën një baba teqeje, po me përputhjen ndaj së vërtetës. Një krenari e nxehtë e panjohur e kishte pushtuar babanë.

— Ai do të kërkojë të bëhet ashtu si do Partia Komuniste, — tha Shaqir Laçi.

— Dikush duhet t'i dalë për zot këtij vendi, o Shaqir, — tha babai.

— Edhe të tjerët duhet të dëgjohen, — tha Shaqiri. I qe kthyer prapë ajo vala e mërziisë dhe e dyshimit. Eci më tej, me duart prapa, me supet si të rëna, nënqeshi dhe tha: — Më në fund të gjithë do t'i binden. Ai të mbush mendjen.

Në shtëpitë e vogla rreth e qark, të fshehura nga pemët, banonin delegatët, njerëz me emër dhe të tjerë që duhej të ishin po aq me emër, po që babai s'i kishte dëgjuar kurrë. Ishte parë me ta të djeshmen tek shëtisnin e bisedonin në bahçet: ndonjëri i qeshur e i gëzuar, sikur ta dinte që më parë si do të bëheshin punët, ndonjëri me pamjen e njeriut që pyet se ç'drejqin do në atë vend, një i tretë me fytyrë të inatosur, i gatshëm t'u japë mësim të tjerëve. Tani që po rikujtonte ato që kishte parë, babait i hipi shqetësimi. Disa prej tyre ngjanin më fort si miq të Shaqirit.

Shaqiri përshëndeti me dorë e me buzëqeshje të largët një delegat të porsaardhur, një burrë të shkurtër me republikë që ecte në fund të bahçes.

— Gjallë qenka ky! — tha Shaqiri, si kaluan më tej. — Pata dëgjuar se kishte vdekur. Ka njerëz me nam që humbasin me kohën dhe askush s'kujtohet të pyesë për ta.

Në mesin e rrugës kishin qëndruar e po bisedonin katër delegatë. Babai deshi të kthehej, po Shaqiri e tërhoqi nga krahu si i argëtuar. Njëri nga ata ishte

drejtori i financave të prefekturës, delegat me rëndësi dhe që nuk dihej nga e merrte rëndësinë. Përshëndeti me kokë babanë e Shaqirin dhe vijoi të fliste. «Luftë», — po thoshte. Fjalën luftë e shqiptonte lehtë, me pasiguri. Nuk kuptohej nëse e mendonte si diçka prej së cilës do të rridhte gjak e shkatërrim, apo si një lojë që do të bëhej fshehtas e brenda disa caqeve. «Luftë doemos», — përsëriti, me kryeneçësi të qetë, i bezdisur nga takimi me babanë e Shaqirin, të cilit dukej se ia kishte frikën. Tundi radaken e thatë sikur aty t'i kishte hyrë diçka që duhej shoshitur mirë dhe vijoi të fliste për luftën larg rrugëve «rrotabile». Aty për aty mori një pamje prej strategu. «Si do të bëhet?» — pyeti, duke shikuar të tjerët, dhe heshti, thua se vërtet priste një përgjigje prej tyre, ndërsa shpjegimet i jepte po vetë, duke thënë se në çdo rast lufta duhej të mbetej jashtë qendrave me popullatë.

Shaqir Laçi vuri dorën pas veshit, si për të treguar se e zuri halli të dëgjonte. Pastaj i ra veshit me gishtërinj, si për të thënë se nuk kuptonte, ose kuptoi mjaft. Kjo nuk i shpëtoi syrit të drejtorit të financave. Po shihte se edhe tre shokët e tij e kishin dëgjuar si me dyshim e mërzi. Mbërtheu xhaketën e kostumit kafe dhe kaloi dorën në flokët e thinjur. Trupi i paktë iu ngurtësua. Babai, që ishte në krah, po i shihte me neveri puçrrenë e bardhë rrëzë veshit dhe qimet e hundës, hidhte sytë gjetkë dhe prapë kthehej t'ia shihte.

— Nesër, — tha drejtori, — nesër do të shpjegojmë përse nuk duhet ylli i kuq, megjithëse nuk përmban gjë të keqe. Do të shpjegojmë edhe të tjera. — I ngjante edhe më fort njeriut që është nisur të arrijë diku, por që pengohet të arrijë, për ca shkaqe që i di vetë, por që s'mund t'i zbulojë.

— Yllin e kuq duhej ta kundërshtoja unë si klerik, — u hodh e tha babai me mllef. — Por ja që s'e kun-

dërshtoj. Se ai tregon bashkimin e popujve të botës dhe ne duhet ta mbajmë me nder.

Drejtori i financës e pa ngultas. «A nuk të duket se pikërisht kjo s'të përshtatet!» — thoshte shikimi i tij. Po foli ndryshe:

— Parashtroni nesër pikëpamjen tuaj. — Përshëndeti duke tundur pëllëmbën kllëç dhe u kthye të ikte.

Babai vijoi të ecte me Shaqirin, me shpirtin të turbulluar nga ndeshja e papritur. Sekretari politik kishte thënë se në kryesinë e konferencës do të ishte edhe drejtori i financave, si edhe ai majori me qimet përpjetë, me pamjen e një urithi të hirtë, për të cilin Shaqiri kishte thënë se e dinte të vdekur. Pas okupacionit majori kishte ndenjur në fshat, duke ia rritur rëndësinë vetes.

— Majori do të kërkojë në konferencë që të kthehet Zogu në çlirim, po ta dojë populli, — tha Shaqiri.

Babai mbeti gojëhapët. Po përmendej në rrugët e Arzës së lirë emri i kodoshit të urryer. Iu duk se në bahçet e në shtëpitë po depërtonte ftohtësi e rëndë, hije të liga zunë të bridhnin nën diellin e mbrëmjes. Nuk kuptonte se ç'duheshin në konferencë njerëz si drejtori i financave dhe majori. «Ne po i thërrasim ndershmërisht», — kishte thënë sekretari politik. Aty për aty babai nuk ishte menduar gjatë. Po mendohej tani, me zemrën të shtrënguar.

XV

Më 27 gusht kishte rënë tërmet në Peshkopi, me 43 të vrarë e fshatra të rrafshuara. Kryeministri i ri, Merlika, porsa ishte kthyer nga një udhëtim në viset

e dëmtuara, ku u kishte dhënë viktimave me duart e tij «bukën e Duçes», disa pako me ushqime. Gazeta «Tomori» botonte fotografitë e fshatarëve të mbetur pa strehë që qenë përdëllyer duke marrë dhuratat, kishin rënë në gjunjë, qanin me lot gëzimi për fatin e madh që i gjeti. Aty më parë ishte dyfishuar çmimi i bukës. Ishte e drejtë që tani të dyfishohej çmimi i makaronave, orizit, fasuleve. Ndalohej qarkullimi në grupe më shumë se tre veta.

Babai e la gazetën mbi stol. Ajo e kishte çuar disa minuta në një botë tjetër, irreale. Por ajo botë ekzistonte, përtej mureve të oborrit, në rrugët ku patrullonte karabinieri i rëndë, në kafenetë e reja, në pallatet e ministrive. Ai kishte ardhur atë mëngjes nga Arëza në këtë lagje të Tiranës, që mbaronte në bahçet e zarzavateve dhe tani do të dilte në treg për harxhet e dimrit, pastaj do të mbaronte punë në kryegjyshatë.

— Sa më fort bërtasin, aq më shumë e kanë marrë tatëpjetën, — tha i zoti i shtëpisë, duke treguar gazetën mbi stol:

Babai doli në oborr. Një djalosh i skuqur prej kënaqësisë po u hidhte kuajve bar. Më pas Elami do t'u vinte tagji, që kuajt të ishin të ushqyer për udhëtim të gjatë. Elami me Selmanin po pastronin në kuzhinë armët e lagura prej shiut, që i kishin sjellë fshehur në hasra. Kuajt filluan të hanin barin me shije, ndërsa ngrinin kokat të dëgjonin kalimin e një pajtoni në rrugën përtej murit, lehjen e një qeni, tringëllimën e ziles së një biçiklete. Disa fëmijë loznin me top, një shitës reklamonte me thirrje të zgjatur «dule stambolli», Baba Merxhanin e tërhoqën këto zhurma të këndshme dhe u nis të dilte, i përcjellë prej zotit të shtëpisë, që e shihte me një habi të ëmbël, sepse babai vinte nga një anë e ndaluar me armë e me trakte dhe po shkonte

qetësisht drejt rrezikut. Selman Gërvishta doli nga kuzhina dhe u vu pas babait.

Në rrugën me asfalt dielli të merrte sytë. Kalimtarët ktheheshin të shihnin babanë, ndonjë burrë i vjetër vinte dorën në zemër, murmuriste fjalë. «Më duhet të kaloj nga Tirana. Do t'u them dy fjalë edhe atyre të kryegjyshitës. Kushedi!» — i kishte thënë babai Xhajës. Ky qe menduar. Një gjysmë ore më pas i kishte thënë: «Meqë ta do puna, shko.» Në sytë e mikut fshihej shqetësimi, ndofta një qortim i lehtë.

Në rrugën e ngushtë që të çonte te kafja e Demës nuk dëgjoheshin më zhurmat e makinave. Këtu ishin rrobaqepës, jorganxhinj, dyqane gjysmë të mbyllura, që nuk kuptohej ç'loj tregtie bënin. Nuk shiheshin gjëkundi gjurmët e demonstratave të fuqishme, atentateve. Këto sikur kishin kaluar në rrugët pa i prekur muret. Veçse strehët e qepenat dukeshin më të rëndë, të zgjatur drejt tokës. Vite më parë, kur s'kishin ardhur të huajt, këto rrugë jetonin në plogështinë e tyre prej qerpici, fytyrat e njerëzve ishin të kyçura e mospërfillëse. Kurse tani fytyrat rrinin si në pritje, sikur në çastin tjetër do të niste një zallamahi e një shpërngulje e rrezikshme. Më tej, sa më afër qendrës së qytetit, aq më shumë rralloheshin njerëzit, sikur të qëndronin larg një rrethi, kufijtë e të cilit i kishin shënuar me mendje. Vetëm çunat e vegjël prireshin nga ana e bulevardit, të gatshëm të vërsheleinin, të thyenin. Babait po i dukej se pas çdo qosheje do të zbuloheshin diçka dhe zuri të mendonte se s'bëri mirë që hyri në ato rrugë, zuri të mbante hapin tek shihte së largu patrullat karabiniere.

Në rrugën e kryegjyshitës babai po çlodhej në ndenjësën e butë të pajtonit që mbante erë meshini, me Selmanin pranë. Ky nuk hapte gojë, rrinte si gjysmë-fjetur, po në të vërtetë shihte me vëmendjen në të dy anët e rrugës, i ngjante një maceje që di se nën hirin

e vatrës ka thëngjij të ndezur. Kjo gjendje e tij vazhonte që kur morën rrugën për të hyrë në Tiranë. Babai nënqeshi. Edhe pak e do të shfaqej kryegjyshata. «Në përulësi si dheu, në dituri si dielli...»

Anash kaluan njëra pas tjetrës figurat e hijshme të tre oficerëve italianë në kuaj. I treti hapi sytë, nderoi babanë dhe buzëqeshi. Karrocieri fshikulloi kamxhikun në ajër dhe tha diçka nëpër dhëmbë. Prapa vinte një veturë, duke i rënë borisë me ngulm. Karrocieri hapi rrugë. Vetura kaloi dhe u ndal pak më tej. Zbritën një civil dhe një nënoficer i policisë. Ky i bëri shenjë karrocierit të ndalej me një lëvizje të krahut, si për të kërkuar ndjesë. Pastaj ata u afruan, me të ecurën e njeriut që vjen për mirë, po që se edhe ti do të duash të bëhet mirë.

Civili shikoi brenda karrocës, me dorën në zemër, tha se babanë e priste prefekti në zyrë. Nënoficeri prapa lëvizi krahët, buzëqeshi, si për të thënë se, sa më shpejt të pranohej ftesa, aq më mirë.

Civili që u ul prapa në makinë me babanë vijonte të ishte i hutuar e i sjellë. Nënoficeri, i ulur pranë shoferit, rrinte me fytyrën e rëndë e të kënaqur afër xhamit, po edhe duke hapur sytë jashtë. Babai mendoi se rruga do të mbaronte te qelia, prej nga nuk do të dilte më. Kishte hyrë në këtë tunel me këmbët e tij, me një mendjehhtësi që nuk shpjegohej. U nguros dhe padashur preku koburen në brez. Civili e pa lëvizjen, mbështeti krahët dhe tërhoqi kokën lart, tha nëpër dhëmbë diçka për zotin prefekt që do të gëzohej shumë.

Prefekti ngutej. Kureshtja e fshehur keq dukej si domos kur ulte zërin, kur tërhoqte kokën prapa, kur rrufiste kafënë me zhurmë. U çua dhe foli me dikë në telefon, me takt e me druajtje, sikur t'i lutej të pranonte një dhuratë të bukur. Erdhi e ndenji më

këmbë para babait, me fytyrën të skuqur dhe tha:

— Nazarin e pret vetë shkëlqesia e tij, Jakomoni.
— Tha se ky ishte një ndcr që u bëhçj vetëm personaliteteve, ndiente një kënaqësi trupore, buzëqeshi dhe për një çast ndenji pezull, duke e shikuar babanë me sytë e ndritur, për të parë nëse e kuptonte rëndësinë e kësaj ngjarjeje, dhe tundi kokën e mblodhi buzët me njëfarë hidhërimi, sikur diku të ishte bërë diçka e keqe, që s'kishte lidhje me ata të dy dhe që tani do të ndreqej në ndonjë mënyrë. Mori pardësynë dhe hapi derën me kapelën në dorë. Babai eci përpara i djersitur nëpër korridorët dhe shkallët, me ndjenjën se po shkiste në një rrugë të rrezikshme, në kreun e së cilës rrinte mëkëmbësi i mbretit, duke rrezatuar madhështi, siç e tregonin fotografitë. Prefekti doli në krah të tij, siç kishte bërë një vit më parë në Dibër, kur e nxori në zyrat dhe në tregun e qytetit. Policët kërcisnin takat, nëpunësit rrinin me shpatullat në mure. Prefekti zbriste shkallët pa i vënë re, si një pronar i vjetër i gjithçkaje.

Kur hipën në makinë, prefekti tha:

— Shkëlqesia na pret në shtëpi, si miq të familjes.
Babai mbështeti krahët. Habitej me veten, sikur të kishte qenë në kllapi. Dhe sa shpejt e kishin diktuar hyrjen e tij në Tiranë. Po ndofta e gjitha kjo do të mbaronte me një bisedë. U ndie më i qetë, po i thahej djersa, «të dalë ku të dalë» tha me vete dhe u vu të shikonte qytetin përtej xhamit, që i dukej tani si një botë nën ujë.

* * *

Makina u ndal para portës me kangjella të larta hekuri, veshur me trëndafila të egër. Pallati me kullën

me xhamllëk ishte i hirtë. Si kaluan rojat dhe shka-llët e mermerta, sallonin me sixhadetë e buta e pasqyra të mëdha të praruara, hynë në një dhomë me kolltukë e mobilje dru arc, që ngjante edhe si zyrë. Njeriu që i shoqëronte tha:

— Uluni, ju lutem. Shkëlqesia do të hyjë nga kjo derë.

Prefekti zuri t'i bënte shenja baba Merxhanit, për të admiruar së bashku madhësitinë e dhomës të krehur në hije e qetësi. Hyri përsëri civil, kërkoi ndjesë dhe ndezi dritat. Llampadarët e mëdhenj ndriçuan perdet dhe mobiljet e rënda që thithnin zhurmat. Nga parketi shpërndahej një ngjyrë si e mjaltit dhe endej ai parfum i lehtë, i njëjti që ndieje porsa ngjitje shka-llët e pallatit.

Jakomoni hyri befasisht, me hap të shpejtë, i shtrëngo-i dorën baba Merxhanit dhe iu përgjigj me kokë përsëritjes së prefektit. Lëvizjet i bënte të sakta, të kursyera.

Ai ishte një burrë me moshë mesatare. Koka tullace me flokët rreth tëmthave ia tregonin edhe më të gjatë fytyrën e vrazhdë. Ishte gjeneral i lartë, po në shtëpi vishej civil, me kostumin e zi, që vinte në dukje anën tjetër të karakterit të tij si burrë shteti. Nuk mbante stoli në duart e bardha, veç orës dhe unazës. Dukej i thjeshtë, një thjeshtësi që buron nga vetëdija e fuqisë së pakufizuar dhe që kërkon çarmatim të plotë. Kjo dukej sidomos në ballin e lartë e të qetë, në sytë e ftohtë që shikonin ngultas, pa shprehur asgjë, që mund të fshehin dëshira të zjarra, ose edhe t'i shfaqin këto dëshira sheshit, sipas rastit. Në karrigen prapa qe ulur pa u ndier përkthyesi. Në qoshe ishte busti i rëndë i Duçes dhe në murin sipër një shqiponjë perandorake në ebanoz.

Mëkëmbësi tha se regjimi ishte përkrahës i feve të

lira dhe se dëshironte të jepte një ndihmë për teqenë e Markeshit. Ndërsa përkthente njeriu në karrige, mëkëmbësi bënte shenja miratimi me kokë. Ai u përkul dhe i zgjati babait kutinë e purove. Kamerieri me frak ia ndezi. Sollën konjak dhe çokollata. Njerëzit aty lëviznin pa u ndier, si në teqe. Babait i pëlqyen puroja dhe konjaku që s'i kishte provuar kurrë. Era e tyre u trazua me atë parfumin e lehtë që mbante dhoma. Mëkëmbësi tha një markë për konjakun. «Francez», — shpjegoi prefekti tepër i kënaqur. Babai ndjeu se po i vëzhgonin çdo lëvizje, po kërkonin anët e mendjes së tij, donin t'ia kthenin xhepat mbrapsht. Në xhepa kishte gjëra që s'mund t'i tregonte.

Mëkëmbësi zuri të fliste për disa njerëz të papërcaktuar që donin të futnin ide të huaja në Shqipëri. Ata po shkaktonin turbullira. Ai heshti dhe priti. Në fytyrë iu end një mërzi e lehtë. Ndërsa vijonte të mbante atë sjelljen e mirë, dukej se mendjen e kishte te dhomat prapa, ku duhej të qe ndërprerë diçka me rëndësi.

Këta ndiheshin zotër të Evropës. Lufta rrokullisej nga një skaj i kontinentit në tjetrin, qëndronte pak kohë në një vend, sa për ta kthyer në një tokë të hirtë e të shuar, dhe shpërngulej verbërisht gjetiu. Qe pushuar Austria, Çekosllovakia, Polonia, Danimarka, Norvegjia, Holanda, Belgjika, Franca. Kishin rënë tri shtete të Ballkanit, ndërsa Rumania e Bullgaria ishin nën diktaturën fashiste, si Spanja, Portugalia, Finlanda, Hungaria. Përveç Zvicrës piktoreske nuk mbetej në kontinent asnjë pëllëmbë tokë e pashkelur prej tyre. Po ama qenë ndalur për herë të parë në Moskë dhe tani në Stalingrad. Po çohëj bota.

Mëkëmbësi fliste me dashmirësi e durim. Përkthyesi i rrinte gati te veshi, me atë zërin e ulët të njëllajtë. Babait i dukej se qe kredhur në këtë botë të

huaj, të panjohur dhe hera-herës çonte kokën për të kërkuar ajrin që i mungonte. Mëkëmbësi kishte heshtur befaz dhe u përkul të shihte më mirë njeriun e ngurosur. Ky s'kishte gjak kleriku në damarë. «Ndofta kështu janë këta baballarët e malësisë», — mendoi ai. Pastaj u kujtua se për të kishin raportuar që po formonte çeta. Mëkëmbësi hapi sytë mbi të. Tamam i tillë duhej të ishte ai, kryetar i një çete banditësh. Babai mendoi se mëkëmbësi nuk i kishte bërë ende asnjë pyetje.

— Durimi im ka një kufi, — tha mëkëmbësi.

Përkthyesi mbeti i hutuar, nuk dinte se kujt i drejtoheshin ato fjalë. Mëkëmbësi përsëriti frazën me nervozitet të përmbajtur, me rrudhat në ballë, duke shikuar këpucët e tij të buta lustrafin.

Në të vërtetë ky njeri duhet të mbante ngritur një çadër ku frynin erërat nga të katër anët. Këtë po shih-te tani baba Merxhani. Po këtë gjendje të tij mëkëmbësi e mbulonte me një qetësi të rreme, me të cilën qe ushtruar prej kohe. Këta janë njerëz që tërë shpresën e kanë varur në një lojë të kotë, të duken të qetë, padronë të përjetshëm. Po vjen një çast kur duhet ta lënë lojën, të kundërveprojnë. Ja, tani kanë ngut. Duhet të shuajnë doemos lëvizjen në qytete, të zhdukin çetat në malësi, të godasin Pezën. Sidomos kjo është tepër e ngutshme. Veçse s'mund të kacavaren në errësirë. Më parë duhet të dinë. Sa më tepër zgjateshin minutat, aq më e qartë bëhej kjo për babanë. Ai ndiente ngazëllim. Tani mëkëmbësi do ta bënte atë pyetjen për Pezën. Ose ai mund të jepte befasisht urdhrin për ta internuar babanë në Itali.

Prefekti po thoshte se baba Merxhani i Markeshit i pëlqente mendimet e shkëlqesisë. Në zërin e prefektit ndihej ankthi, një thirrje e ngutshme drejtuar babait që ky të hapte gojën, të thoshte diçka të mirë.

— Kam një besim të madh te njerëzit trima e të urtë të malësisë, — tha mëkëmbësi. — Zakonet tuaja të besës e bujarisë janë të bukura deri në mallëngjim. — Këto i tha shqip, si fjalë të mësuara jo me veshë, po në letër, si një nder që i bënte kësaj gjuhe me shtrembërimet dhe thëksin e huaj. Mori frymë dhe buzëqeshi i kënaqur. Pastaj ndenji i menduar, me shikimin përtej kokës së babait.

Mëkëmbësi i mbretit dukej tani një njeri i vetmuar, në një klimë të huaj dhe hera-herës përkulej përpara, sikur të nuhaste këtë klimë me dyshim e neveri, ndërsa vinte buzën në gaz. «A e shihni? Unë po jetoj në mesin tuaj. Ç'kërkoni më tepër nga unë.» Ndofta, i nxitur edhe prej kësaj ndjesie, i firmonte aq lehtë ata urdhrat për varjen e djemve në tregjet e qyteteve, për të hapur zjarr me tanket kundër turmave, për internimin e qindra njerëzve.

Babai vuri duart mbi gjunjë dhe tha:

— Disa prej zakoneve nuk ecin me kohën.

Mëkëmbësi as që e dëgjoi, u përkul përpara me trupin e madh dhe tha:

— Në Pezë qenka bërë një mbledhje e drejtuar prej disa komunistëve. Më duket një profesor. Fytyra e tij e vrazhdë ishte zgjatur edhe më tepër. Një ngjyrë e lehtë gjaku i kishte vërshuar edhe në lëkurën e kokës së shogët, duart e bardha të gjata i kishte mbërthyer në fron. Babai u gjet në befasi dhe tha atë frazën që e kishte përsëritur edhe herë të tjera:

— Ne fetarët nuk trazohemi në politikë. — Nxori çibukun dhe zuri ta vërtiste në duar.

Mëkëmbësi i ofroi prapë puro, duke e mbështjellë me shikimin kureshtar, ngriti trupin, hodhi sytë tej dritares dhe tha:

— Populli fisnik shqiptar nuk do të merret me ide absurde që rrjedhin prej sllavëve dhe çifutëve.

Për disa çaste në dhomë sundoi qetësia. Mëkëmbësi u përkul prapë përpara, me buzët si të thara prej mër-zisë e padurimit, dhe tha:

— Midis nesh duhet të qëndrojë mirëkuptimi i vërtetë prej burri. — Ndërsa thoshte kështu, dukej se nuk besonte në asnjë mirëkuptim. Ktheu sytë nga prefekti duke e ftuar të fliste.

Prefekti u trondit, u mblodh dhe qeshi, tha diçka që nuk kuptohej, ndërsa shihte me maraz babanë. Babai ishte i tij. Ai e kishte sjellë te mëkëmbësi, me shpresë se do të fliste, shkëlqesia do të kalonte një orë të këndshme, dhe më në fund do të merrnin vesh për Pezën. Por ky baba i urryer rrinte aty si një trung i errët. Për më tepër tani dukej edhe mendjemadh, nënqeshte me ata sytë e zez prej komiti. Prefektit po i mavijosej fytyra, u gëlltit dhe tha:

— Baba Merxhani do të jetë sonte mysafiri im.

Mëkëmbësi buzëqeshi. Nëse nuk do të hapte gojë ky baba, që ndofta ishte i lidhur kokë e këmbë me komunistët, i strehonte e i ushqente, nëse nuk do të hapte gojë, atëherë duhej plasur në burg. Veçse duhej të fliste sa më shpejt.

— Gjithnjë kam pasur dëshirë të vizitoj Markeshin. A mund ta quaj veten të ftuar prej teqesë? — tha mëkëmbësi.

— Do të na bëhet nder i madh, — tha babai dhe zuri të fliste për bukurinë e ashpër të vendit, për cjeptë e Balit, për lëndinat e Rrallenjës. — E pres shkëlqesinë në maj-qershor, — tha, duke hapur duart. I kishte ardhur befaz goja, nga kjo anë mund të lëshonte litar sa të donte dhe foli për maj-qershorin, kur hapen rrugët dhe vendi mbulohet nga lulet.

Mëkëmbësi e dëgjonte me ëndje, i joshur prej idesë për të vizituar ato vende të bukura, gjë që do të bënte jehonë edhe në Romë. Për disa çaste në fytyrën e tij

ra hija e një mallëngjimi të lashtë. Pastaj kapsiti sytë dhe u përmend. Prej kohe s'mund të bënte atë që dëshironte. Sa më lart të ngjitet njeriu, aq më e kufizuar është liria e tij. Dhe, në çdo rast, as që mund të bëhej fjalë tani për një vizitë në malësinë e thellë. Kur e mendoi këtë, zuri të trokiste prapë me gishtërinjtë në fron, ndërsa shihte me përqendrim babanë. Ky baba dinak kishte bërë tërë kohën lojën e vet. Asgjë nuk do të dilte prej tij pa e vënë në shtrëngime.

XVI

Aeroplani erdhi nga qielli i Balit, u soll rreth Kreshtës së Madhe dhe prej aty shtiu dy drita të gjelbra. Babai doli në ballkon dhe pa se aeroplani po kalonte mbi Qafën e Murlanit. Nganjëherë i kërciste motori, sikur i ndalej fryma, vijonte rrugën me gjëmim të mbytur. Më tej shtiu me fishekë të kuq që çanë qiellin si meteorë, ndërsa krismat jehuan në luginë, të përcjella nga thirrjet e fëmijëve të shkollës në she-shin «Belik». Ky aeroplan u dukej fëmijëve si një këlysh që zbardh e vezullon e nxihet prapë dhe bën lojëra të bukura në ajër, duke lëshuar ato flluskat me ngjyra për festë, dhe fëmijët bridhnin si të egër, të gatshëm të ngjiteshin deri në qiell. Babai mendoi se aeroplani po bënte stërvitje dhe u kthye në dhomë. Priste njerëzit në teqenë e lagjes «Qytezë» për të ngri-tur këshillat.

Një orë më pas, në lëndinën këtej shkëmbit, vra-poi një çupë me trupin e bukur, si yll, i ndrisnin pul-pat e bardha të vogla dhe flokët e verdhë i fluturonin prapa. Babai afroi fytyrën te xhami dhe buzëqeshi si-

kur të kishte parë një vegim. Vajza ndaloi tek e përpjeta të merrte frymë dhe u turr qorrazi drejt shtegut të teqesë. Pak më pas rendi në lëndinë një djalë me kalë pa samar, jo për ta ndjekur çupën, po si për ta ndihur që ajo të arrinte sa më parë aty ku duhej. Djali i zbriti kalit në vrap e sipër dhe filloi edhe ai të ngjitej. Babai mendoi se diku kishte ngjarë një fatkeqësi. Në shkallët po ngjitej një njeri me hap të rëndë, të nxituar. Ky ishte dervish Hasani, që ndaloi pas derës, duke shtuar padurimin e babait. Dervishi trokiti ngadalë, sikur të kishte frikë të prekte derën.

— Po vijnë milicët për të kapur nazarin.

— Kush tha se vijnë për mua?

— Erdhi Fatimja, goca e Kamberit. Ka çuar fjalë dhe Aliu prej Gjini me çunin.

Babai doli te dera e teqesë me maliherin në sup. Kishte mbështjellë disa letra me shpejtësi, që i futi në xhepin e brendshëm të hirkës, dhe po shihte poshtë nga lagjja «Qytezë». Që nga Qafa e Gurit po vinte Selman Gërvishta me atë heshtjen dhe të ecurën e fshehtë, që sillte diçka të lashtë, si prej pylli. Pak më lart figura e tij ndryshoi, zuri të kërcente mbi gurët, me nxitje, me egërsi. Kishte ndier afrimin e rrezikut. Babai mbajti vesh të kuptonte se nga cila anë e kishte ndier Selmani të afërt rrezikun. Po lihnin qentë dhe më fort dhe u duk sikur u ngrit zhurmë në lagje. Babai, i ndjekur nga dy shërbëtorë, filloi të ngjiste bregun e vështirë të Kocorrit. Në majë u ndal të merrte frymë, të shihte. Në të majtë, në lëndinat e bukura që u thoshin Kocajt e Balit, shtegu tjetër prej nga mund të vinte armiku, nuk lëvizte asgjë dhe në tërë Marke-shin sundonte një heshtje e rreme. Erdhi Selmani, ndenji pranë babait me pushkën në dorë duke marrë frymë rëndë dhe tha si me zërin të gëzuar se karabi-

nierët vinin me shumicë nga fusha e Lizës, po ishin ende larg.

Poshtë, në lagjen «Qytezë», krisi një kobure, u ndie një trazim. Pastaj u bë heshtje. Milicët e parë u ngjitën varg te Shkëmbi i Plakës, u hapën dhe u turrën drejt së përpjetës së teqesë. Dukeshin të vegjël, po shquheshin mirë, me xhufkat në festet e zeza, me rripat kryq mbi kapotat, me pantallonat sport shtrënguar me dollakë, me armët në duar.

Po afrohej mbrëmja. Malet shtrinin hijet mbi Markesh si për t'i zënë frymën. Te Shkëmbi i Plakës vijonin të dilnin varg milicë të tjerë. E gjithë kjo forcë armike që vinte nga para e prapa, s'mund të ishte për arrestimin e një njeriu të vetëm. Pas Kurveleshit dhe Pezës, i paskësh ardhur radha Markeshit, i cili ende s'kishte zbrazur një pushkë. Në sytë e babait zunë të ndizeshin lagjet me një zjarr të kuq, që lëshonte gjuhët rrafsh me tokën, duke u zgjatur rreth gardheve, mureve, çatime me dërrasë bredhi. Babai u kthye dhe hyri në pyllin që çonte te Kreshta e Vogël me zemrën plumb, duke u munduar të kapte mendime të turbullta të fshehta. Pak më tej filloi të ndicnte lehtësim, si njeriu që ecën nëpër një shteg të ri, me një të ardhme tjetër. «Jam duke shkuar në një anë që ka të bëjë me ndryshimin e jetës», — tha me vete. Veçse kjo kishte ardhur nëpër një rrugë të befasishme.

* * *

Major Tati po ngjitej në rrugën e vështirë të teqesë duke pushuar në kthesat dhe shihte me mlllef lagjen poshtë, që dukej e groposur. Baba Merxhani kishte ikur. Ky lajm që çoi toger Sabahu i kompanisë së pararojës, nuk e gjeti në befasi majorin. E kishte paran-

dier se ashtu do të ndodhte. «Urdhër operacioni N. 22. Komandave të ndryshme ushtarake... Më 15 tetor 1942 të fillojë operacioni për arrestimin e baba Markeshit... Kompania e parë e milicisë fashiste të niset në mëngjes herët për në... të zbarkojë në... në orën 8... Dy kompani të karabinierisë të nisen në orën 6 të mëngjesit me kamion deri në... komanda e aviacionit të veriut të jetë gati për të bombarduar në rast se zgjat rezistenca...» Pthu. Këto janë pesë me hiç, dëshira për të treguar aftësi, art të madh ushtarak, a thua se po sulmohej një kështjellë përmes viseve të egra, një operacion brilant, i thurur natën, mbi hartën e Shqipërisë së Mesme. Hajde pyete tani gjeneral Xaninin, komandant i përgjithshëm i xhandarmërisë, se ç'kartë duhet hedhur.

Majori arriti në teqe i zyrtë, i rraskapitur prej lodhjes. Tani do të bënte diçka sipas prirjeve të tij. Këmbët në rrip të dyfekut të gjithëve, bastisje me themel. Këto toger Sabahu i kishte bërë vetë, pa kursyer as dervish Lalën e vjetër. Atëherë majori jep urdhër që rrahjet e bastisjet të shtrihen edhe në lagjet dhe bie për të fjetur.

Në mëngjes majori i dërgon një letër baba Merxhanit, duke e ftuar të zbresë në teqe për bisedime. «Hajde të bisedojmë këtu», — përgjigjet babai që nga pyjet. Majori vazhdon tri ditë rrahjet, bastisjet, burgosjet, ndërsa bie shi sa të mos lehin as qentë. Më në fund majori merr rrugën e kthimit, duke tërhequr prapa pesëmbëdhjetë njerëz të vënë në pranga, dervishë, shërbëtorë, barinj të trashë, që s'hapnin gojë edhe po t'u rripje lëkurën. «...Të arrestuarit të dërgohen në Tiranë, të cilët, në rast se do të ketë goditje nga të huajt për t'i çliruar, në këtë kohë e në këtë goditje, të arrestuarit të pushkatohen në vend...» Të paktën kjo ishte një gjë e qartë që majori do ta bënte me dëshirë.

Si lë prapa tokën e rrahur e të bastisur paq, të gërryer nga ujërat, dhe bie në xhadenë e madhe, majori zë të mendojë me qetësi hollësitë e raportit që duhet të bëjë. Ishin gjetur në teqe një radio e markës «Filips» dhe ca libra me vjersha dervishësh. Në raportin epror që priste Luogotenenca, këto mund të quheshin «radio transmetuese dhe material propogandistik» e mund të shtohet diçka edhe për çeta të shpërndara. Kurrsesi s'mund të dilte pa gjë ky operacion...

Majori po kthehej i hipur në kalë, i pritur në «pikat e rrezikut» prej komandave ushtarake, i përcjellë më tej prej këtyre komandave me patrulla të përforcuara, a thua se po çonte në Tiranë një trofe të çmuar. Shpresonte vetëm një gjë, e dëshironte këtë marrëzisht, të shkreheshin ca pushkë në ndonjë anë dhe «në këtë goditje e në këtë kundërshtim», të vinte në plumb dervishët, shërbëtorët dhe barinjët, të flakte diku radion dhe ata librat me bejte. Një bëmë e tillë do të ishte si dehja, që të liron aty për aty nga vuajtja. Do të ishte edhe një shfajësim i plotë, me jehonë.

XVII

Shiu kishte nisur në mëngjes, në një agim të errët, aq sa të mos shquheshin malet. Baba Luli rrinte në kasollen që sajuan gjatë natës për të, mbështjellë kutullaç me hirkën, dhe mund të rrinte gjatë, se ulur kishte jetuar. Po tani kishte ardhur koha të ngrihej më këmbë përgjithnjë. Kullonin degët e kasolles, duke ia shtuar padurimin; ujërat rridhnin nga çdo anë, me një mërmërimë të butë sikur po përmytej dheu ngadalë, ndërsa nga toka dilte afshi i nxehtë i plehut të pyllit.

Babait po i lageshin kurrizi dhe këmbët. Edhe sa shi do të hidhte qielli që të zbrazej krejt?

Babai i kishte çuar përgjigje majorit të vinte në pyll të merrej vesh me pushkët e Markeshit. Kjo ishte një mburrje me pishat. Pushkë kishte vetëm dy, «maiiherin» e tij dhe «belgjikun» e Selmanit. Po pak më vonë erdhën tre markeshas të armatosur, që ishin endur natën në pyll duke e kërkuar. Këta thanë se do të rrinin me të. Afër drekës erdhi Rahman Dena prej Balit, i lagur deri në eshtrat dhe ndenji në gjunjë para babait, duke mbuluar me cepin e gunës pushkën me dru të kuq.

— Erdhe për të ndenjtur? — e pyeti babai.

Rahmani drejtoi trupin, fshiu ujin nga balli. Qe nisur me mendimin të gjendej pranë babait në rrezik. Asgjë tjetër s'kishte menduar. Zuri të mendohej tani dhe tëmthat iu dukën më të zbardhur, ndërsa trupi i madh iu nguros. Sytë e tij të mençur gjithnjë e kishin ndjekur babanë, në punë, në raki e në këngë, me një sjellje që nuk ndryshonte kurrë. Ky e sodiste botën me qetësi, ashtu si po shikonte babanë tani. Veçse, nganjëherë sytë e mëdhenj të hirtë i merrnin më tepër dritë, i bëheshin më të egër. Dukej sikur kjo lidhej me një fyerje të vjetër, me një ngjarje që kishte parë e jetuar vetëm ai. Për disa çaste rrudhat në ballë iu bënë më të thella, u zbeh dhe shikoi rrotull, mbajti frymën si njeriu që do të hidhet nga një majë dhe s'di në ç'tokë do të bjerë. Dhe jo se bëhej merak për vete, po për fshatarët, për gjashtë fëmijët, pleqtë dhe gruan që po linte në Bal në ahurin rrzëzë malit.

— Me ty, o babë, përjetë, — tha.

— E dija fort mirë se do të vije, — tha babai.

Selman Gërvishta, që ishte ulur mbi ca degë ahu, po nënqeshte dhe tha:

— Të gjithë do të vijnë. Tani për ne s'ka jetë tje-

tër. — Dukej i kënaqur që kishte ngjarë ashtu, që s'mbetej jetë tjetër. Lëvizi vendit ngadalë, duke ngritur shpatullat. I ndrisnin sytë në errësirën e kasolles.

— A po lagesh, Selman? — pyeti Rahmani duke i buzëqeshur me dhembshuri. Selmani dinte të rrinte në shi e të mos lagej.

Selmani shkoi për ushqim dhe pas dy orësh solli një cjamin. Rahmani e nderoi zjarrin nga maja, që të bënte sa më pak tym, megjithëse tymi shpërndahej me retë e ulëta. Rahmani e poqi cjamin nën pikat e shiut të rralluar dhe ndërkohë erdhën dymbëdhjetë markeshas të tjerë të armatosur që kishin shpëtuar nga rrahjet dhe shtrëngimet e major Tatit. Babai pinte raki me faqoren, terte rrobat ndanë zjarrit. Të nesërmen, afër drekës, erdhi nipi i kryeplakut të Balit, Sadi Pejzës, dhe tha se i ungji do të vinte porsa ta thërriste babai. Ky nënqeshi, mendoi se Sadi Pejza me të nipin ishin nga lloji i njerëzve që marrin vrap të kundërt nga çdo anë që të fryjë era. Atë ditën e dytë erdhën edhe tetë markeshas të tjerë dhe u bënë në pyllin e Kreshtës së Vogël njëzet e tre pushkë, duke ndenjtur nën guvat dhe trungjet e drurëve. Babai mendoi se erdhi koha të krijoheshin çeta. Po këtë s'mund ta bënte në pyll. Rrebeshet e shiut shpërthenin nga një qiell i marrë, njerëzit u lodhën tërë kohën të lagur. Për të themeluar çetën, i duhej një vend i hapët e i thatë, sheshi i Rrallenjës.

Natën u ngritën reflekse flakësh të largëta që u pasqyruan në majat e pishave të lagura. Babai doli nga kasollja të shihte. Një kujtim i largët rrodhi me valë të forta. Zjarri që përpiu shtëpinë e madhe në Buz kishte vazhduar edhe natën, me xhandarët e Zogut rrotull. Pastaj erdhën vdekjet me radhë. Pastaj Merxhani dhjetëvjeçar që nisur në rrugët e jetës. Që atëherë nuk mund të shihte të digjej diçka pa i rrahur zemra.

Në mëngjes sollën dervishin shurdhmemec. Ishte djegur teqeja verore në Rrallenjë me gjithsej. Dervishi dridhej, qante pa gojë, i përzhitur. Kishte dalë nëpër flakë si gjyle dhe kishte rendur rrotull duke parë të shkrinte teqeja nga zjarri i vënë në tri anë. «Rat Mëdyshi, — tha Selmani. Babait i theri zemra për teqenë dhe për shtëpinë e të sëmureve që e kishte ndërtuar vetë. — Hajde gjeje Ratin, më sa gjenden gjurmët e gjarprit në gur», — murmuriti.

Hapi moti e shkëlqeu dielli në pishat. Babai mendohej duke pirë faqoren. Kohët e fundit po i ndodhnin gjëra të papritura. Kjo filloi që atë ditë kur hyri në Tiranë, kryetar i këshillit të qarkut, me rezolucionin e Konferencës së Pezës në gji, me pushkët në hasra. Kur kishte dalë prej mëkëmbësit, prefekti e kishte mbajtur për krahu, duke puqur trupin me të. «Pra në orën tetë, në shtëpinë time.» Prefekti e shihte me përgjërime, e luste të qe i përpiktë, donte t'i jepte makinën e vet. «Mirë, në orën tetë.» Babai prapë e kishte marrë me qetësi. Deri në çastin kur takoi Selmanin. Selmani kishte shkuar te Shaqir Laçi në hotel. Shaqiri kishte dalë te dera e dhomës, i veshur me pizhame, një qytetar paqësor, që nuk di asgjë. «Këtu qenkeni ju! Babait do t'i djegin edhe qimen e mjekrës. Peza është në flakë, mbaroi. Zhdukuni sa më parë.» Kishte rënë mbrëmja dhe babai qe nisur me hapin e rëndë e të ngutur drejt lagjes «Kodra e kuqe», te kuajt dhe pushkët. «Këtej, shoku Merxhan.» Ky ishte një djalosh që i qe vënë prapa, me pardësynë ngritur te veshët, si spiunët. Po në zërin e tij kishte një thirrje të ngutshme që vinte nga shpirti. Në rrugën pranë gjëmonte një varg me kamionë ushtarakë. Në dritat e forta që lëshonin në kthesë babai pa sytë e djaloshit. I besoi në çast dhe eci pas tij në rrugicën me baltë. A do t'ia mësonte emrin ndonjëherë? Po as kur arriti në Markesh

nuk e mblodhi mendjen. Ndenji në teqe dhjetë ditë, sikur të mos kishte ngjarë asgjë, sikur të mos u kishte ikur nëpër duar. Dhe, po të mos ishte për atë vajzën me flokët në erë dhe për djalin që vraponte prapa me kalë, tani baba Merxhani do të udhëtonte për në Tiranë, i vënë në pranga, dhe trupi i tij i bëshëm do të provonte hekurat e nxehtë të torturës. Teqeja dhe rroba e babait nuk i jepnin më asnjë mbrojtje. Ata do të varnin gjithë baballarët e do t'u vinin zjarrin gjithë teqeve, po qe se kjo do t'u ndihmonte të shuanin luftën. Babai habitej fort dhe turpërohej me mendjehetësinë e vet.

Pjesa e tretë

Kamioni me ushtarë italianë ndaloi te pengesa me trungje në rrugë. Oficeri afroi fytyrën te xhami i kabinës, pa lëndinën e vogël të blertë dhe pyllin me pisha përballë. Në të majtë ishte humnera. Kjo qafë e malit dukej një vend prite i rrezikshëm, po në atë rrugë s'kishte ngjarë ndonjëherë të shkrehej pushkë, a të ndalte kush makinat. Ushtarët, të ngjeshur në karrocerinë e mbuluar, ndenjën heshtur. Oficeri hapi derën e kabinës dhe i thirri rreshterit të zbriste e të hiqte trungjet. Që nga pylli krisën katër-pesë pushkë. Plumbat vërsëllyen mbi kamionin, jo si për ta goditur, po për ta fshikulluar. Një zë i fortë thirri që andej për dorëzim. Oficeri u hodh në hendekun ndanë rrugës, u thirri ushtarëve të zbrisnin, të zinin pozicion. Ky ishte një urdhër i kotë, sepse pozicion aty s'mund të zihej në asnjë anë. Zbritën rreshteri dhe disa ushtarë,

ranë edhe ata në vijën ndanë rrugës. Oficeri nxori pistoletën, shtiu në tym nga ana e pyllit disa hcrë. Zunë të shtinin edhe ushtarët. Prej andej, që nga pylli, filluan të shtinin pa mëshirë. Dy nga ushtarët që kishin zënë vend te vija u plagosën. Oficeri u ngrit në gjunjë të shihte ç'bëhej, u godit në ballë, u duk sikur i kërceu kafka lart dhe ra me fytyrën përdhe. Pas kësaj u bë heshtje. Rreshteri pa me zemër të ngrirë oficerin dhe pyllin. «Nuk godit! — thirri shqip. — Sinjori banditi, nuk godit, daremo tuto.» U çua me duart lart dhe pas tij u çuan ushtarët.

Fshatarët me yjet e kuqe që dolën nga pylli, filluan të mblidhnin armët shpejt, kurse ushtarët i shtynë drejt lëndinës. Aty rrinte i mbështetur me të dy duart në tytën e pushkës një njeri tepër i shëndoshë, me mjekër e me çallmë, i mbështjellë me një si qyrk, dukej sikur ende nxirrte tym. Sollën aty edhe tre të plagosurit, njeriu me çallmë i pa këta nga afër, u bëri shenjë të uleshin t'u lidhnin plagët. Ndërkohë disa nga fshatarët po i silleshin kamionit, nxorën andej çantat e shpinës dhe i flakën në rrugë, detyruan shoferin të hapte serbatorin e naftës dhe i vunë zjarrin kamionit.

Njeriu me çallmë u foli ushtarëve me zë të lartë siç bëhet me një të shurdhër, aty-këtu me ndonjë fjalë italisht «kondatin», «soldati». Dukej sikur u qante hallin, ngrinte krahun dhe bënte në ajër gjysma harqesh, si për të treguar madhësinë e botës e të luftës, tregoi yllin e kuq që mbante në anën e majtë të gjoksit. «Andare Italia», tha më në fund, duke ngritur gishtin me kërcënim mbi fytyrat e tyre të habitura, «andare via».

Para babait ecte Nabija, në natën e errët me qiell të ulët. Dy vjet më parë kur e pa vajzën, ajo i hyri në zemër, duke hapur aty një plagë, prej së cilës nuk rridhte gjak, por që nuk do të mbyllej kurrë. Prej dy vjetësh ai ndalej në mes të bisedës, zgjohej natën, tek i bëhej se ja dëgjonte thirrjen e humbur të largët. Kur erdhi ajo në teqe me të ëmën për «miqësi» e për «shërim», Galip Nuri kishte bërë çmos t'ia lehtësonte punën. Galipi besonte se, po të rrinte ca kohë me vajzën, babai do të lirohej nga meraku i rëndë. Fundja kjo i dukej Galipit si një nevojë e ngutshme e babait, e moshës dhe e shëndetit. Tani ai mik i mençur e gazmor, poterexhi, ishte në Kosovë dhe kushedi ç'bëhej. Kurse Nabija kishte ardhur në çetë, baba Merxhani e kishte gjetur më në fund pjesën e vet, që i pati munguar tërë jetën dhe nuk do t'i ndahej më. Ajo shkonte përpara, e rritur në trup, tetëmbëdhjetë vjeçe, e gjente lehtë rrugën. Ecte në errësirë si duke u përhedhur dhe babai e ndiqte me hapin e rëndë, donte t'i rrinte pranë, t'i tregonte për gëzimin e tij, si edhe për shqetësimin e thellë. Afër agimit, ai do të hidhte çetën në karakollin me tela e mitralozë. Aty-këtu Nabija ndalet, si njeriu që nuk sheh rrugën, sikur të donte të mbështeste kokën në gjoksin e njeriut prapa, vetëm për një çast. Po sa afrohet ai, vajza kërcen prapë përpara, sikur t'i merren mendtë dhe ai bëhet merak për të, se mos po rrëzohet diku, se mos po zhduket në errësirë.

Te hani ndanë rrugës priste Rahmani. Kishte filluar sqotë e hollë e mprehtë dhe çeta ndenji nën strehet të çlodhej. Babai hyri brenda, të fliste me Rahmanin.

— Kanë dy mitralozë nga gryka e lumit, kurse në anën e xhadesë një pushkë antitank, — tha Rahmani.

— Sa janë? — pyeti babai.

— Njëzet veta, i komandon një marshall.

— Si e mendon?

Rahmani ndenji si me shikimin mbi karakollin e lartë. Kishte ndenjor tërë ditën në pyllin përballë masytë mbi sheshin e vogël, ku lëvisnin nganjëherë ushtarët, duke i bërë secilit vend në mendje, sipas trupit, sipas ecjes.

— Mund të sulmohen vetëm natën, — tha, — së rreth sheshit kanë hapur hendeqe të gurta me tela.

Babait iu bë se pa në errësirë atë dritën e qetë e të patundur në sytë e mëdhenj të kaltër të Rahmanit. Babai mendoi me kënaqësi të thellë se këtë njeri natyral e kishte pajisur me zgjuarsinë e vjetër fshatare, me trup të fortë e me zemër të madhe. Ishte fat të ecje pas tij në kohë luftime e sulmi.

U hap dera e kazermës me dritare të errësuar dhe në shesh u derdh një rrymë e fortë drite. Nëpër këtë rrymë ecën dy ushtarë. Pas pak u kthyen dy të tjerë dhe dera u mbyll. Ishin ndërruar rojat. Sundoi prapë errësira, ndërsa kishte filluar një shi i imët. Babai shikoi qiellin për të kuptuar kohën. Ndihej si i penguar në pyllin me dushk, u mbështoll me qyrk dhe prit, duke mbajtur frymën.

Një zë i mprehtë e dyshues thirri aty ku duhej të ishte hyrja e karakollit. Thirrja u përsërit me forcën e alarmit dhe kësaj here u dëgjuan qartë fjalët italisht: «Ki va la!» U shkreh një pushkë që gjëmoi e çau errësirën me flakë të kuqe e të verdhë. Vazhduan disa çaste qetësie të paduruar, gjatë të cilave babai kërkoi me mendje në errësirë Rahmanin dhe grupin e tij, që do

të sulmonin hyrjen e karakollit. Këta i pa befaz, ose iu duk se i pa, nën flakën përvëluese të dy bombave që shpërthyen ndanë telave. U hap dera e kazermës dhe u derdh drita në shesh. Krisi gjatë e me tërbim njëri nga mitralozët dhe fishkëllima e plumbave u ndie nga afër. Babai doli në lëndinë dhe pa hijen e Selmanit dhe të të tjerëve që po rendnin para tij. Zuri t'i ngjitej pllajës, nga ana jugore e karakollit. Prej andej erdhën flakët dhe krismat e disa pushkëve. Ushtarët kishin dalë edhe nga kjo anë te hendeku. Babai shtiu me «malisherin» tri herë në drejtim të flakëve, në këmbë, siç ishte. Zuri të ngjiste pllajën duke gulçuar, të arrinte armikun. Nëse Rahmani dhe grupi i tij ishin vrarë te hyrja me tela, babait nuk i mbetej veç të vritej edhe vetë. Befaz shqoi nga afër, ose iu duk se shqoi, murin laraman të kazermës, kurse para fytyrës kishte telat e hendekut. Ushtarët armiq ishin zhdukur. Babai u ndal të gjente drejtimin, të mbushej me frymë. Atëherë shpërthyen flakët dhe gjëmuan dy bomba në anën tjetër të kazermës, që u duk sikur u godit në themelet dhe u lëkund. U dëgjua britma therëse e një njeriu, po bëhej trazirë në sheshin e kazermës dhe brenda saj. Baba Merxhanit i ndriti në sy diçka e pabesuar, fitorja. Në mes të trazirës u ngrit zëri kërcënues i Rahmanit: «Duart lart! Te muri!»

Në shesh po shtynin robërit brenda kazermës. Në trazirën e hijeve babai gjeti Rahmanin. Ky i foli me gojë të tharë: që vrarë partizani Hamdi Sala, ishte vrarë marëshali dhe katër ushtarë, ishin zënë dy mitralozët dhe pushka antitank, municion i shumtë. Babai e dëgjoi i hutuar. Nuk po kuptonte se si i kishte parë këto në errësirë Rahmani. Hamdi Salën po e shtrinin në batanije, në rrymën e dritës. Ishte prej lagjes «Dënë», njëzet vjeç. Kishte marrë atë pamjen e gjumit të të vdekurit, veçse mollëzat e faqeve i kishte më të

dala, nofullat të shtrënguara dhe buzën e sipërme pak të ngritur. Babai i puthi ballin dhe ndenji në gjunjë.

III

Në mesin e dhjetorit erdhën në çetë pesë djem nga qyteti, të veshur mirë e të armatosur. Katër ishin gjimnazistë, i pesti punëtor. Ky ishte më i gjati, me trupin e hollë, me një zverk si prej fëmije, me rrudha të gjata në fytyrën e re, që i thelloheshin edhe më tepër anës së gojës. Kur fliste, dukej sikur tallej lehtas. Po këto vija të gojës dhe shikimi i tij i ngulitur lidheshin me një zgjuarsis të këndshme, që mund të anonte nga rreptësia në çastin e duhur. Ky djalosh, me emrin Petro, i pëlqeu baba Merxhanit më fort. Lexoi letrën e sekretarit politik të qarkorit dhe i tha:

— Pra, ti qenke caktuar komisar i çetës?

Djaloshi nënqeshi, me rudhat e thella, si për të kërkuar ndjesë. Dukej se do të vepronte sipas porosive që kishte marrë dhe shikonte rrotull si për të gjetur shtigjet, po edhe duke i lënë këto për më pas.

Megjithëse djaloshi po i pëlqente, kjo puna e komisarit i dukej babait si diçka e re. Nuk dinte nëse duhej të gëzohej. U vu të lexonte prapë letrën e sekretarit. Ndër të tjera ky shkruante se duhej të bënin lidhjet me çetat e krijuara në Çernikë e Lat. «Po çlirimin e Markeshit si e mendon ti, shoku Merxhan», shkruante në fund.

Djemtë u treguan të fortë ndaj lodhjes e mundimit, bënin çmos të përvetësonin pamjen dhe zakonet e fshatarit dhe mbanin konspiracion. Dukej se donin të hapnin një degë të Partisë në Markesh. Bisedonin me ba-

banë që u dukej i thjeshtë e gazmor, po në të njëjtën kohë donin të gjenin se deri ku shtrihej kufiri i kësaj thjeshtësie dhe ruanin për vete disa pyetje.

— Djemtë flasin për nazarin, — i pëshpëriti babait Korb Leti. Ky partizan ishte prej lagjes «Qytezë», inatçi e me fytyrë të errët, si emri që mbante.

— Ç'thonë? — pyeti babai.

Djemtë kishin biseduar për jetën e babait. Këtij në çetë i silleshin me druajtje. Për të gatitej ushqim i mirë, i rregullohej me shtrojë e me strehë vendi i fjetjes. Një partizan, ish-qehaja i teqesë, Ali Çela, i mbante mushkën, se babai ecte kaluar. Ajo, shoqja, Nabia, i lante teshat. Babai mund të urdhëronte njerëzit me një të rrotulluar të syve. Kishin thënë edhe për meritat e mëdha, po kjo të mos pengonte punën e Partisë. U përmend edhe faqorja, fshatarët që turren të puthin dorën...

— Kush i tha këto? — pyeti babai, i skuqur deri në errësim.

— Nikoja, ai i shëndoshi, ai foli më tepër. Tha edhe për disiplinën. Njerëzit hyjnë e dalin, venë në shtëpi kur t'u teket.

— Po Petroja, komisari?

Korb Leti u gëlltit. Pa si u zmadhua e bardha e syve të babait. Ishte e rrezikshme të mos thoshe në çdo gjë të vërtetën, se inati i babait shpërthente keqas para gënjeshtërisë. Korbi po mendohej me shpejtësi. Ndofta kishte futur veten në një ngatërresë të rëndë. Po fjalët, aty sipër zgavrës, ashtu ishin thënë. Veçse, në zërin e tyre kishte keqardhje, një dëshirë të madhe që të mos ndodhte ashtu. Korbi mendoi se tani ishte vonë të shtonte këto, nuk i mbetej veç të tregonte fjalët, ato që dëgjoji.

— Komisari kundërshtoi. Tha se me trupin e rëndë s'mund të ecësh në këmbë, je edhe kryetar i këshillit

të qarkut. Tha se nuk pranoje puthjen e dorës, zemëroheshe. Kundërshtoi në çdo pikë, tha se më pas do ndryshoje vetë...

— Ti pse përgjon njerëzit?

— Po flija në zgavër. Erdhën e bënë mbledhje sipër meje.

— Të mos sjellësh më fjalë. — Babai tundi kokën me kërcënim. — Të mos dëgjoj se hape gojë për këto, ndryshe, ta bëj gjyqin.

IV

Në mëngjes qielli ishte me re të rënda. Pak më vonë mbi Qafën e Pishës e mbi pyjet rrotull shndriti dielli. Kështu ngjet nganjëherë në ato vende të larta, duke qenë në fillim të dimrit, se nga vjen befasisht një ditë pranvere, që po aq befasisht mund të shkojë. Këtu, për shkak të ajrit të thatë, bën edhe më ngrohtë se në luginat e ulëta.

Murat Poda, komisar i çetës së Latit, e hante mishin e pjekur me thikë, duke e prerë me mjeshtëri, me lëvizje të qeta, pa lënë asgjë në kockat, me ndjenjën e kursimit për një qëllim që e dinte vetë. Po në çastin tjetër, ky njeri mund të jepte çdo gjë që kishte kursyer tërë jetës. Ky burrë e bënte çdo gjë sipas një mënyre të tij dhe me këtë ushtronte te të tjerët një ndikim të fortë. Ndërsa përtypej, shihte si me lakmi dy mitralozët, pushkën antitank dhe arkat me municione. Kishte ardhur me një skuadër të çetës së vet.

— U ngjite te telat aty në karakoll, — i tha baba Merxhanit.

— Mos beso çdo gjë që dëgjon, sidomos në kohë lufte, — u përgjigj babai.

— Ta kam frikën, se je i rëndë dhe i dukshëm në trup, — qeshi Murati.

Ai binte si në ëndërrime duke parë tymrat e zjarreve të çetës nën pishat e rreth çeltnës. Sytë e tij të mprehtë e të shpejtë humbisnin si dy zogj ngjyrë kafe që ikin në qiell. Pastaj kthehej e bëhej i vëmendshëm si dhëlpër, qeshte me anën e buzës. Ishte trim, dhe dinte të shihte në shpirtin e njeriut, i shkolluar, i zoti i gojës, bir i një familjeje të njohur të internuar prej Zogut. Ia kishte dalë të krijonte çetën e të ngrinte këshillat në Lat, ku gjithnjë kishin sunduar bajraktarët e rrezikshëm e të fortë.

Me një mik të tillë në krah, babai po ndihej më i qetë për punën e rëndë të çlirimit të Markeshit. Se xhandarmëria ishte forcuar në lagjen «Qytezë» dhe nuk dihej ç'do të bënin Mëdyshajt dhe ca të tjerë kur çeta të niste sulmin. Një vëllavrasje e pandreqshme mund të hapej në Markesh, kurse Partia kërkonte bashkimin e popullit, ashtu si ia donte zemra edhe vetë babait. Ai do të sulmonte Qytezën, kurse Murati me çetën e tij do të priste rrugën te Qafa e Murlanit, prej nga mund të vinin forca armike. Edhe pak e Murati do të shkonte, po babai donte ta mbante edhe ca. Që të dy ndiheshin ngrohtë e mirë dhe me dëshirën të flisnin hapët.

— Si keni bërë me taksidarët? — pyeti babai.

— I kemi përzënë, me paralajmërim, — tha Murati, duke ngritur thikën.

— Edhe ne, — tha babai. — Po të kthehen prapë, i vëmë në plumb.

Fshatarët e kishin pëlqyer përzëniën e taksidarëve. Kishin ngritur veshin, me ndjesinë e lashtë të dyshi-

mit, që ka arsye të jetë, sepse s'kishte ngjarë kurrë që fshatari të mos paguante taksa.

— Këshillat punojnë mirë, — tha babai. Nuk ishte dhe aq i sigurt në atë që tha.

Murati zuri të fliste për këshillat në Lat me për-zemërsi, po sytë e tij të qeshur tërë kohën ishin në hetim, nuk u besonte dhe aq gjërave nga jashtë, dinte të priste me durim, gjersa t'i shihte në lëvizje. Kishte mbaruar së ngrëni dhe po pastrohej, me ca lëvizje të sakta të njeriut që ka jetuar në natyrë dhe ka përve-tësuar shpejt.

Babai ndenji i menduar. Në Pezë ishte thënë se do të qeverisnin këshillat. Mirëpo kush do të jepte leje për martesat, të regjistronte lindjet, vdekjet? Kush dhe si? Ligji i të dhjetave u prish, po a do të mblidheshin këto si fonde për luftën? Pyetje të tilla duhej të merrnin një përgjigje në pragun e çlirimit të Markeshit, po babait i erdhi zor të fliste për këto dhe pyeti nëse vinin njerëz në çetë në Lat.

— Me vështirësi, po do të vijnë edhe më tepër, — tha Murati.

Në Markesh vinin më tepër njerëz. Ai që kishte një armë të vjetër e nxirrte prej strehës, e pastronte me kujdes, dhe prapë e vinte në vendin e fshehtë, mbështjellë me leckë. Fshatari rrinte me dy mendje, sepse, ai që ngre armën, duhet të presë goditjen. Nuk dihej se ç'mund të bënte fuqia e madhe e huaj po t'i sulmoje kazermat, t'i digjje kamionët, t'i prisje rrugët. Pastaj ia behte baba Merxhani me çetën. Myhibi i vjetër shihte yllin e kuq në anën e majtë të gjoksit të babait, armët, ndërsa mbante ende qyrkun dhe taçin në kokë, një njeri i shartuar prej të cilit dalin mendime e fjalë të reja. «A jeni gati të rrokni armët?» «Jemi, or babë.» «Edhe me djemtë, apo vetë?» «Si të urdhërosh, nazari, po qejf kam vetë.» Babai çonte faqoren me

zembrën valë dhe kalonte në shtëpinë tjetër. Këtë lloj «agjitacioni» nuk e pëlqenin djemtë e ardhur nga qyteti. Hera-herës edhe vetë babait i dukej se prapa mbetej pa bërë diçka me rëndësi. Çfarë pikërisht? Ky shqetësim i kthehej edhe në gjumë, i bëhej sikur pas krahëve të kishte vazhdimisht një si hije, dashamirëse e qortuese në të njëjtën kohë.

— Paskeni tri shoqe në çetë, — tha Murati. Qe mbështetur te pisha, që të çlodhej sa më mirë, me kapotën italiane krahëve. Babai ndjeu të nxehtë. Murati u hoq se nuk e vuri re dhe foli me seriozitet:

— Kjo është puna më e vështirë. Dalja nga shtëpia e grave në malësi, dua të them.

Një fshatar me mushkë po bisedonte te shtegu me Ali Çelën. Dukej se Aliu donte ta përzinte.

— Ai fshatari e ka një punë me ty, — i tha Murati babait. Ky u çua dhe shkoi te fshatari.

— Të më shkruash një nuskë, babë, s'kam mide fare, po tretem, — tha ai. Në sytë e përlotur kishte lutje, shpresë e frikë. Ishte prej lagjes «Gjin», dembel, me gostek e çibuk të gjatë, një burrë me mendjen e një fëmije, që merrej vetëm me ushqimin e trupit të tij të butë e të squllët. Nuk dinte të shihte gjë tjetër në botë. I mungonin vetëm nuskat.

Babai shkoi andej-këndej dhe i foli nëpër dhembë, fare afër fytyrës:

— Or gugash, nuska s'bën fajde.

— Ani, or babë, shkruaje. Veç ta shkruash ashtu si e di ti. Eca shumë gjersa të gjeta.

Syri i stërvitur i babait lëvizi mbi gjymtyrët dhe fytyrën e fshatarit. Ky ishte kërrusur dhe ndofta ndiente dhimbje në stomak. Duke pritur përgjigjen, po i thaheshin edhe sytë e përlotur prej ankthit. Babai po inatosej.

Ai kishte shkruar nuska, me ato germa të mëdha

rrumbullake. Kërkoreshin nuska për fëmijët që nuk rronin, për pleqtë ulokë, për gratë që nuk lindnin, për burrat që dilnin në bjeshkë, për vathët e bagëtive e për shtëpitë. Sikur t'i kishte bërë të gjitha sa kërkoreshin, Markeshi dhe fshatrat e Grykës do të lulëzonin me nuska. Ai i thoshte ndonjërit që e kishte pësuar nga rrufeja: «Mos rri nën pishë me dhinë e me njerëzit. Ja, u bë nuska me fjalë.» I thoshte ndonjërit që ruhej prej hasmit: «Plumbi është më i shpejtë. Sa të këndoje nuska, ti ke marrë fund tri herë. Duhet pajtuar gjaku.» Po kishte shkruar kur besonte se i sëmuri duhej të ndihmonte vetveten, gjatë tetë vjetëve, rrallë, po prapë kishte shkruar, duke u kënduar njerëzve fjalë arabisht, që nuk i dinte as vetë, duke u mbajtur dorën mbi kokë, ndërsa pinin ujët e teqesë përzier me dheun e teqesë. Po që nga prilli, prej shtatë muajsh, s'kishte shkruar asnjë nuskë. Ndërsa ja tek del ky fshatar, për t'i kujtuar se ai, baba Merxhani i vjetër, vijonte të ecte përkrah të riut dhe duhej të bënte detyrën ndaj besimtarëve.

— E mora vesh punën tënde, — tha babai nën zë. — Shko në shtëpi, kape belin fort dhe pas një muaji hajde tek unë. Asnjë nuskë nuk të shëron para kësaj.

— Si kështu? — pyeti fshatari, i zbehtë e gojëhapët.

— Ja, kështu. Të mos bësh asnjë punë, të rrish në diell, të sjellësh mendjen kot, rrënon shëndetin edhe po të jesh i fortë si kau. Kape belin dhe do të shohësh.

Fytyra e fshatarit u zgjat, një lot budallai i rrëshqiti anës hundës.

— Eh, or babë, na le edhe ti, se ke nisur punë të tjera. — Si tha kështu, shikoi rrotull me frikë dhe fshiu hundën me pëllëmbën e dorës.

— M'u hiq nga sytë, se ta marr shpirtin, — i tha babai me frymën të zënë.

Kur u kthye te Murati, ishte ende i turbulluar. Ky rrinte me strehën e kapelës mbi sy për t'u mbrojtur nga dielli. Pas pak u kthye në bërryl, afroi fytyrën dhe e pyeti nën zë, me vetullat ngritur, se cila fe ishte më e mirë, suni a bektashi.

— Të marrtë dreqi shpirtin. Që të dyja një punë janë, — tha babai.

— Këtë e dija, po më vjen mirë ta dëgjoj edhe prej nazarit, — tha Murati.

— Njeriu i dobët bëhet armiku më i keq i vetvetes, — tha babai.

Murati u çua ndenjur, s'kishte gjurmë shakaje në sytë e tij. Ishte i zbehur lehtas, e pa babanë me vëmendje dhe tha:

— Nuk u vihet faj, shoku Merxhan. Njerëzit kanë ndier nevojën të besojnë në diçka. Po ne do t'u japim një tjetër besim, do ta ndryshojmë çdo gjë nga themeli.

Babait iu shtrëngua zemra. Njerëzve do t'u jepej një tjetër besim. Po si do të bëhej kjo? Se një besim nuk është si këmisha e trupit. Ja, ai vetë do ta flakte bektashizmin tej. Ama thellë në shpirt një perëndi e kishite. Kur hapeshin shtigje të tilla në biseda, babai rrinte duke pritur. I dukej se do të prishej diçka po të pyeste, donte që ata të flisnin vetë, të thoshin më tepër. Po në këtë pikë ata buzëqeshnin me njëfarë hutimi, si njeriu që sheh se ka dalë befas prej lëndinës ku mund të shëtisë, ndaleshin edhe e shihnin babanë me dashuri e me një premtim të vakët. Vetëm Xhaja e kishte pyetur një ditë haptas. «Pra ti je gati t'i flakësh të gjitha?» Babai kishte ndenjur pa folur, me grushtet në prehër. Si nuk e kuptonin këta se prej kohe taçi ia shtrëngonte kokën si me një rreth të nxehtë?

V

Në luginën e madhe e të thellë të Markeshit mbular tejdanë me dëborë, nuk lëviz asgjë, përveç lumit Dron, që rrëshqet si një vijë mellani mbi një letërthithëse të bardhë. Prej disa ditësh xhandarët nuk dalin në sheshin «Belik» dhe prej një muaji nuk brendhin më në lagjet. Tani kalojnë në sheshin «Belik» gratë e fëmijët, si për të parë nëse është çelur dyqani i Tomës. Çdo gjë është e mbyllur, dyqani, shkolla. Dy ndërtesat qeveritare, me ato çatitë e rënda prej pllake, ngjajnë si gracka për të zënë zogj e që mund të bien në çastin tjetër. Teli i telefonit, që u jepte fuqi të padukshme, varet përtokë te stanet. Asnjëri nuk mban hapin dhe të ndiejë atë dridhjen në trup, shkaktuar prej zileve tingëlluese lart në zyra. Komuna dhe xhandarët hanë bukën në heshtje, prapa dritareve, vetëm tymi i oxhakut tregon se aty jetojnë njerëz.

Në mëngjesin e 15 dhjetorit xhandarët nxorën një mitraloz te Shkëmbi i Zi dhe dy prej tyre ndenjën aty, a thua se s'kishin punë tjetër veç të ngroheshin në diellin e zbehtë. Fëmijët u ngjitën deri afër, për të parë grykën si hinkë të këtij mitralozi, që ngjante si një qen i hekurt i ulur në bisht dhe që mund t'i lihte papritur Markeshit. Dy xhandarë të tjerë shkuan për ujë te kroi Mshat, ndërsa mund të kishin shkuar te Kroi i Kishës. Nga karabinierët nuk u pa asnjëri. Doli vetëm marshall Pirasi, i rruar e i freskët, dhe i bëri vizitë kryetarit të komunës. Ndërsa kapter Kadriu bleu një cjaq, që u bë mish në oborrin e postës, ku çanin dru xhandarët. Këto dhe punë të tjera që u bënë gjatë ditës, me dëshirën për të treguar qetësinë e brendshme të qeverisë, për të thënë se jeta vazhonte si çdo ditë, nuk mashtruan njeri.

Pasdite vazhdoi një qetësi e ngrirë, Markeshi nde-nji pezull, secili numëronte orët në zemrën e vet, dukej sikur mjaftonte të shkruhej një pushkë në ndonjë anë që të shembej diçka e madhe, si rënia e një orteku, që do të tërhiqte krejt masën e trashë të dëborës, duke e zhveshur luginën lakuriq.

* * *

Baba Merxhani me një skuadër kaloi në të errët lëndinën e lartë me dëborë, që i thonë Kocajt e Balit, dhe hyri në kullën e Selman Gërvishtës, i lodhur e i uritur. Një gjysmë ore më poshtë ishte armiku, i mbrojtur në katër pika të afërta me njëra-tjetrën: shtëpia e teqesë, Guri i Zi që ngrihej mbi sheshin «Belik» ku kishin vënë mitralozin, postëkomanda me muret e trasha e oborrin me tela dhe komuna me grilat e ulura, gjithsej tridhjetë xhandarë e karabinierë, të armatosur mirë e me municione të shumta. Baba Merxhani donte ta kapte të gjallë këtë armik. Kapter Kadriut do t'i bënte gjyqin, për ta vënë në plumb. Po ashtu edhe marshall Pirasin. Të tjerët do t'i çarmatoste e do t'i lironte.

Pak më vonë, kur fëmijët e Selmanit kishin rënë për të fjetur, erdhën dervish Lala i vjetër dhe dervish Hasani, ranë në gjunjë dhe ndjenjën po ashtu. Ishin të mallëngjyer, po edhe të trembur. Prej dy muajsh, baba Merxhani kishte kaluar disa herë afër teqesë, po s'që kthyer kurrë të hynte. Babai u duk si i kreshpëruar, po u foli me të butë, i pyeti për punët e teqesë.

— Erdhën tre xhandarë. Duan të dorëzohen në besë te nazari, — tha dervish Lala, — Po presin në teqe.

— Shko e sill, o Selman, — tha babai. Hoqi taçin dhe ndenji me grushtin në prehër. Prej ditësh banonin

te Mëdyshajt në Gjin disa «miq» të ardhur nga Lati e gjetiu. Rrethimi nga ajo anë mbetej i hapët. Babai do ta ndiqte armikun poshtë në lumin Dron, do ta godiste edhe më fort në faqen e përpjetë të Gjinit. Atëherë do të shihej nëse Rati me vëllezërit, dajat dhe miqtë e tij, mbi njëzet burra, do të kundërshtonin çetën me armë. Kjo ishte pika e dobët, e paqartë. Kurse tani, me dorëzimin e këtyre tre xhandarëve, babait po i dukej se çdo gjë mund të ndryshonte gjatë natës. Mbaise xhandarët dorëzoheshin të gjithë.

* * *

Në orën gjashtë të mëngjesit, qielli i ulët po shkrinte nga fjollat e dëborës, aq të dendura e të mëdha, sa të kujtoje se do të mbulonin tokën përjetë. Baba Merxhani ndaloi me skuadrën te Shkëmbi i Plakës. Nuk shihej asgjë. Dëborë e ngrirë në tokë dhe ajo që binte nga qielli sajnin një trazim të bardhë, me hije të paqena. Krisën tri pushkë dhe një bombë në Qafën e Murlanit. «Murat Poda», — tha babai me vete, fshiu dëborën nga goja dhe i qeshën sytë. «Ec përpara, shiko punën tënde. Kurse unë po ta ndal çdo armik në këtë qafën e dreqit ku të pret murlani», — thoshte zëri i largët, fytyra e dashur e mikut.

— Nisemi, — tha babai.

Skuadra filloi të zbriste në udhëzën si shkallë poshtë shkëmbit.

Përtej bregut, rreth sheshit «Belik», krisën disa pushkë dhe një mitraloz. Rahmani po i binte postës, që u përgjigj me pushkë të shpejta e me mitralozin nga Guri i Zi. Kjo përpjekje bëhej njëzet minuta më tej, po për shkak të bregut e të dëborës dukej sikur bëhej në thellësi. Babai u nis pas skuadrës, me Selmanin që mbante pushkën antitank. Përtej përroit me

ujë të paktë u shqua fare afër shtëpia e Arif Peshkut, me gardhet e anuara dhe strehën e rëndë. Thirri Arifi vetë: «S'ka njeri te shtëpia, e teqese, o babë. Iken mbrëmë.» Armiku e paskesh braktisur këtë pikë. Babai u nis me skuadren rrezë kodres, në udhëzën që dute te çuka, prej nga shihej snesu «Belik». Skuadra u shpërnda rreth çukës. Katërqind metra më tej ishin posta, komuna dhe sipër tyre Guri i Zi, po për shkak të dritës së paktë e të dëborës mund të dalloje vetëm hijet e tyre.

— I bini postës, — tha babai.

Krisën me zhurmë pushkët e skuadrës. Sipër çukës vërshëllyen plumbat e mitralozit që nga Guri i Zi. Babai vendosi pushkën antitank dhe u shtri drejt në dëborë. I ra dy herë Gurit të Zi me krisma që ushtuan rëndë. Nuk ishte i sigurt nëse kishte goditur mbi Gurin. Përpjekja po bëhej më e nxehtë sipër Gurit të Zi, ku ishte Petroja, dhe nga ana e Çezmës Mshat, ku ishte Rahmani. Babai mendoi me një dridhje gëzimi në zemër se kjo s'mund të shkonte gjatë. Tri pikat e armikut në sheshin «Belik» do të goditeshin, fort e qartë, veç të zbardhte edhe pak, veç të rrallohej ca dëbora. Dhe të mos dëmtohej kush nga fshatarët, që rrinin me fëmijët në shtëpitë e mbyllura të groposura. Plumbat mbi çukën prapë vërshëllyen lart, verbërisht, po sesi u plagos një partizan. Babai shkoi dhe e pa. Ishte një djalosh nga Korena, i ardhur në çetë para dy ditëve. I buzëqeshi babait i hutuar. Ky ia pa plagën te supi i thyer, ndjeu erën e gjakut trazuar me erën e trupit të djaloshit, që rënkoi e vari kokën mënjane. Babai i ra lehtë me shuplakë që ta përmendte dhe tha ta çonin shpejt në teqe. Babai u shtri prapë te pushka antitank, duke menduar se dikush mund të ishte vrarë lart te Petroja dhe përtej te Rahmani. Krisma e mitralozit armik erdhi befasisht nga ana e dyqanit të Tomës me çatinë e gjatë të ulët ngarkuar me dëborë.

Një trazirë po bëhej nga ana e çezmës Mshat. U dëgjuan thirrjet e njerëzve që po ndiqnin diçka me ngut. Babai nuk po kuptonte atë që ngjiste. Dëbora binte më e rrallë dhe për një çast ai shqoi mirë postën me dritaret e hapura, si një ngrehinë e zbrazët.

— Ka ngjarë diçka, kanë dalë prej andej, — tha Selmani me fytyrën e zgjatur të lagur.

Te cepi i komunës shpërtheu një bombë, që ngriti pluhur të bardhë e tym. Kjo u duk si një shpërthim i fundit, i kotë, sepse armiku nuk po bëhej i gjallë në asnjë anë.

* * *

Toma, i dalë nga qilari i vet, kërciste tapat e shisheve, kalonte dorë më dorë rakia. Një grup me fshatarë e partizanë këndonin në sheshin «Belik» me fytyrat e skuqura e duke nxjerrë avull nga goja. Në ballkonin e komunës u ngrit flamuri i vjetër i teqesë me gajtanët e artë. Në zyrën e kryetarit ndërrohej pushteti me procesverbal, merrej arka në dorëzim, dhe... «mbasi iu dhanë Lazin Spahit, sekretar i komunës, Abaz Sharrës, polic, dhe Ahmet Dallës, shërbëtor, shuma në franga 1136.80 për rrogat dhe franga 136.80 si shtesë familjare, mbëti shuma fr. 5388.55 që u mor nga baba Merxhan Dalipi për t'iu dorëzuar Këshillit Nacionalçlirimtar...»

Si nënshkroi procesverbalin sekretari u la i lirë, ndërsa shkresat e regjistrit u nxorrën tog në oborr. Çdo letër e shkruar, si edhe rregulloret, librat e ligjeve, vëllimet e gazetës, zyrtare. Do të digjeshin në zjarr, që të kthehej në hi pushteti i vjetër. Para se t'u vinte shkrepësen, Selmani ndenji galiç duke i parë. Në ato letra kishin kaluar mendimet e këqija të qeverisë, shpifjet, paditë, çdo gjë që lidhej me jetën e njeriut dhe që ishte mbajtur në fshehtësi. Ishin afruar edhe disa fshatarë e

partizanë dhe rrinin heshtur. Selmani e mbrojti me dorë llakën e shkrepëses që u drodh, një vijë e zezë tymi gjarpëroi nga cepat e togut; pastaj zjarri mori vrull. Lart, në zyrë, i ulur në karrigen e kryetarit të komunës, baba Merxhani shkruante me shkrimin e bukur rru- mbullak shkresën e parë të pushtetit të ri:

«Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirim- tar,

Na udhëzoni mënyrën e veprimt mbasi Markeshi u çlirua dhe sa më parë të vijë një përfaqësues.

*Komandant i çetës partizane dhe vullnetare,
Merxhan Dalipi»*

Babai e nisi këtë shkresë për në Çernikë ku kishte shkuar Xhaja dhe ndenji i menduar. Ishin plagosur tre partizanë dhe në rrëpirë u gjet një karabinier trupmadh i vrarë. Babai që turrur me çetën poshtë bregut të lumit Dron me egërsi e me bindje se do ta shfaroste armikun tek ura dhe në faqen tjetër. Kurse armiku që zhdukur, që tretur, si një send pa trup, pa këmbë që të linin gjurmë në dëborë. Qe kthyer Rahmani me sytë e kaltër si të ngrirë, dhe kishte thënë se armiku pas- kësh ndjekur buzën e lumit në të majtë, që çonte rrë- zë malit shkëmbor të Balit, e prej andej në Grykën e Skuterrës. As fshatari markeshas s'do të kishte guxuar ta ndiqte këtë rrugë në një ditë dimri me dëborë. Po tani që e mendonte me sytë hapët, babait kjo i dukej jo vetëm e mundshme, po edhe krejt e natyrshme. Ç'rrugë tjetër mund të zgjidhte një armik dinak i rrethuar në lagjen «Qytezë»? Ky armik kishte luftuar një gjysmë ore pa u tutur, sepse e kishte të siguruar shtegun e daljes, nëpër të cilin do të rrëshqiste, i ndihmuar edhe nga stuhia e dëborës.

Te dera e komunës Rahmani kishte vënë një rojë që po mërddhinte.

"

— Shko lart në zyrë dhe ndiz sobën, — i tha babai. Ai vetë zbriti në sheshin «Belik», ku po mbledheshin më tepër njerëz, me fytyrat të skuqura. Ngriheshin thirrje, vijonin këngët, sikur Markeshi të paskësh dalë befasisht nga nata e turbullt në një lëndinë me dëborë të gëzuar. Sapo kishte ardhur prej Balit Sadi Pejza. Qëndroi para babait dhe tha:

— E flake armikun kokëposhtë në Grykën e Sku-terrës, o babë. — Si zakonisht tha atë që donin të thoshin të gjithë, por që askush s'mund ta thoshte aq bukur, veç tij, me atë zërin e qartë e të këndshëm, duke ngritur dorën plot hijeshi drejt humnerës së Grykës.

— Të gjithë bashkë e flakëm, — u përgjigj babai, ndërsa po shikonte Ratin te dera e dyqanit.

— Sot është dita. Ky nuk duhet lënë në faqe të dheut, — i pëshpëriti Selmani.

Babai e shikoi Selmanin me habi e me qortim dhe eci drejt dyqanit të Tomës, duke u përqaftuar me njerëzit. Ishte ditë gëzimi dhe do t'i gostiste të gjithë. Në të njëjtën kohë po mendonte se kjo kishte ngjarë me njëfarë lehtësie, prapa së cilës duhej të qëndronte një rrezik, siç ndodh gjithmonë kur ke ndjenjën e lehtësisë. Fitorja nuk ngjante e plotë. Apo fitoret nuk vijnë asnjëherë të plota?

VI

Të nesërmen erdhi Xhaja. Dukej se kishte qenë tërë kohën në shtegtime e buzë rrezikut, fytyra i qe tharë e ashpërsuar, po ishte mjaft i kënaqur. Gjatë darkës babai e detyroi të ngrinte faqoren shpesh, ndërsa bisedonin për këshillin-krahinor. Xhaja dëgjonte me

shumë interes, mbante ndonjë shënim, buzëqeshi dhe tha:

— Po qe se kërkon përgjigje për disa gjëra dhe nuk të jepet, kjo është përgjigjja, domethënë vepro vetë. — Ishte i ngrohtë, i çiltër në tërë qenien e vet, shok e vëlla. — Mbase është koha të caktosh një zëvendës në çetë. Kërkohet ndihma jote si kryetar i qarkut edhe në krahina të tjera, — tha, duke parë ngultas babanë. «Ti je i tëri yni, i Partisë, po duhet pritur edhe pak për takimin e plotë», thoshin sytë e tij. Babai ia kuptoi fjalët e pathëna dhe ndjeu shqetësim për kohën dhe mënyrën e këtij «takimi».

Xhaja e mbajti faqoren në dorë, si duke kërkuar që babai e Petroja ta dëgjonin mirë se kishte diçka tjetër me rëndësi për të thënë. U duk sikur qeshi nga brenda, një qeshje e trazuar me tronditje, se iu drodh trupi lehtas, Tha:

— Çlirimin e Markeshit do ta dëgjojë i tërë vendi, po duhet të hapim sytë se këtë s'ka për ta duruar armiku.

* * *

Ai dimër ndryshonte nga çdo dimër tjetër. Nuk i dëgjohej hapi xhandarit në dëborën e ngrirë. Nuk u arrestua, as u procedua njeri. Nuk u bënë vjedhje, nuk krisi asnjë pushkë për gjakmarrje. Në maj nuk do të vinte më tagrambledhësi, ishin shpallur të falura borxhet, fajdetë; askush nuk do t'i paguante dikujt një grosh. Këto ishin në hijen e së kaluarës, që u zhduk me armikun e hedhur në Grykën e Skuterrës. Qeverisnin këshillat, fshatarët kishin më pak pyetje nga sa i bënte vetes baba Merxhani, fshatari qeveriste veten në përshtatje me kushtet e nevojat e luftës dhe i shtrinte dorën fqinjët si vëlla, njeriu kishte marrë tje-

tër rëndësi, secili njeri më vetë, në atë luginën e madhe, të thellë e të lirë të Markeshit. Nganjëherë kjo dukej si një ëndërr. Po mjafton të kapërceje pragun e shtëpisë për t'u bindur se kishte nisur një jetë tjetër. Fshatari pyeste veten si nuk qenë bërë këto më parë dhe të kishte nisur jeta kështu që nga fillimi. Kështu ishte në Markesh atë muajin e parë të çlirimit.

Po me kalimin e ditëve dhe pa u mbushur muaji, në ajrin e ftohtë dhe të pastër kishte filluar të vërtitej pritja e dyshimi. Burri ndalte hapin befas, ngrinte sytë nga malet, priste të ndodhte diçka e panjohur, mbante vesh se mos po dëgjohej marshimi hakmarrës i armikut. Këtë e parathoshte nën zë ndonjëri që vinte nga qytetet e largëta, duke gjetur pëlqimin e ca markeshasve që rrinin mënjanë, duke u bindur këta përherë e më tepër se njeriu me dy pare mend, me familje e bagëti pas krahëve duhej të ndalej e të dëgjonte. Pëshpëritjet ecnin si ujët nën dëborë, duke ia zbehur bukurinë atij dimri të bardhë të Markeshit.

Atëherë fshatari, në shpirtin e të cilit gjithnjë ka ecur dyshimi, kthente kryet për këshillë nga teqeja. Po baba Merxhani kishte dalë nga ajo strehë, ku tani këndonte niaz dervish Lala i vjetër. Baba Merxhani mbante yllin e kuq nga ana e zemrës dhe pushkën pranë, në mot të mirë udhëtonte përtej Markeshit dhe as që mund ti flisje për frikë e për dyshime. Pëshpëritiet morën vrull edhe më tej. Ky baba, që doli nga teqetë, dhe as shkelte nga ato anë, s'paskësh pasur fare një mendie besimtari. Këto dhe të tjera pëshpëriteshin. Më në fund diçka arriti edhe në veshin e babait. E pushtoi hidhërimi e inati, si ç'ndodh me një fajtor të vetëdiishëm kur e kapin në faj e sipër. «Njerëzit do të kthehen ndaj teje duke të parë ndryshe», — kishte thënë Selman Gërvishta. Kjo paskësh pasur dy anë. Se në një pjesë ishin rëzuar kur ai kishte dalë nga teqeja, po në një pjesë e paskësh shikuar punën me zemër të thver: ca të tjerë me

keqdashje. Qortimin e pafolë të disave ai e kishte vërejtur edhe vetë në sytë e tyre dhe prandaj i besoi si krejt të vërteta pëshpëritjet. Babai doli në lagjet, i përcjellë nga Sadi Pejza, dhe u foli fshatarëve. Pëshpëritjet reshtën. Markeshi prapë ra në qetësi, duke gëzuar secili të mirat dhe vështirësitë e jetës nën dëborë, sipas prirjeve e mjeteve të veta.

* * *

Babai po lexonte artikullin e Zërit të Popullit, duke u habitur me magjinë e fjalës. Gazeta ishte njëfletëshe, e shtypur në ndonjë bodrum, shpejt e me ngut, dukej sikur mbante ende erën e bojës e të plumbit, megjithëse kishte ardhur në Markesh me dy javë vonesë. Shkruante njëri me emrin «Sali», duke njoftuar Shqipërinë për çlirimin e Markeshit. Babai e vërtiti në mendje emrin «Sali». I bëhej sikur ia dëgjonte së largu zërin e ngrohtë, se e kishte dëgjuar më parë fare pranë veshit, dhe lëvizte me shqetësim për të kuptuar vendin dhe kohën. Mbase edhe gabohej. «Saliu» mund të ishte një i huaj, i panjohur. Po cilido të qe ai burrë, fjalët e tij vinin nga zemra, ai i njihte dhe i nderonte popullin e Markeshit dhe baba Merxhanin, i bënte edhe një shtesë mbiemrit, duke e quajtur «Baba Merxhan Markeshi», ndër të cilat u takonte në histori njerëzve të shquar. Babai kthehej e lexonte prapë, me syrin e veshur. Sa herë përmendej emri i vet, i dukej sikur kjo shkruhej në një mënyrë të ndryshme, të dashur e të afërt, sikur ky «Saliu» e thërriste të çlironte njerëz e truall të atdheut dhe më tej, derisa ata të dy të takoheshin përballë.

Erdhi Petroja dhe ndenji duke fërkuar duart. Katër shokët e tij ishin çuar nga qarkori në zona të tjera. Dukej se Petroja po përpiquej të krijonte në Markesh

një celulë të Partisë. Mbase edhe e kishte krijuar këtë celulë, të fshehtë e të mbyllur.

— Duhet të tërheqim njerëzit e Markeshit që ndodhen gjetiu, — tha Petroja, me atë të folurit gjoja të lehtë e shoqëror që përdorte gjithnjë me babanë, por që fshihte kujdesin dhe respektin.

— Cilët njerëz?

— Trembëdhjetë ushtarët që janë në batalionin Tomori, — nxori një listë, ia zgjati babait dhe tha: — Ka edhe të tjerë.

— Vetë e mendove këtë? — e ngacmoi babait, duke parë listën.

— Njeriu duhet të thotë atë që mendon vetë e që e mendojnë edhe të tjerët.

— Cilët?

— Kjo s'ka edhe aq rëndësi.

Babai nënqeshi. Djaloshi i kishte rrëshqitur pyetjes. Në dy muaj e sipër dukej sikur ishte holluar edhe më tepër në trup, po në të vërtetë ishte forcuar mjaft, fytyra i qe rreshkur dhe fliste si markeshas, pa u shtirë aspak. Veçse nuk pajtohej dot me pritjen, me mungesën e lëvizjes, me plogështinë që sillnin dimri e dëbora dhe shikonte rrotull me rrudhat në ballë, me vijëzat e thella anës gojës.

— Veç kësaj që the, më duket se ti kërkon edhe gjëra të tjera, për të cilat po vuan, — tha babai.

Petroja mbajti frymën, ndofta u zbeh. tha:

— S'kam gjëra të fshehta ndaj teje. Punën e Partisë e kemi të dobët. Kurse qarkori kërkon.

— Ti ose nuk i fut në Parti ata më të mirët?

— Nuk bëhet njeriu anëtar partie për një muaj. Duhën prova.

— Këta njerëz kanë provë jetën e tyre, që kur kanë lindur.

— Ashtu është. Po duhet pjekuri, duhet të njohësh

politikën dhe disiplinën e Partisë, ndryshe bën gabime.

— Atëherë ka diçka që ti vetë nuk po e kupton, atë që duhet të bësh, dua të them.

— Prandaj kam dëshirë të mendoj e të flas. Ndryshe s'kam si ta gjej pikën e dobët. — Buzëqeshja e tij ishte e pasigurt dhe shikimi i trishtuar.

— Mbase duhet t'i japësh më tepër kohë vetes, — tha babai. Nuk po dinte si ta ndihmonte, sado ta përkulte mendjen ndaj tij. — Sa për këta, — tha duke parë edhe një herë listën, — e ke menduar mirë, janë punë që mund të bëhen.

Babai thirri partizanin Sali Kurti dhe i tha:

— Të shkosh në Tiranë, në kampin e Vorës. Të sjellësh ushtarët markeshas që mbahen në tela.

Djaloshi nuk tha gjë. Shikonte gjetiu sikur të fshihte veten, ndërsa dëgjonte çdo fjalë.

— Ec me mend, se vete shyta për brirë e lë edhe kokën, — tha babai.

Sytë e kaltër të Saliut qeshën. Ky në të parë nuk dukej gjë, i shkurtër, i imët, me lëvizje të ngathëta, me flokë të verdhë e fytyrë të kuqe. Në gjashtëmbëdhjetëvjeç që dënuar me vdekje, se pati marrë gjakun e të atit. U kthye nga Vora pas katër ditëve dhe tha se fshatarët e tij nuk pranonin të bëheshin ushtarë të yllit të kuq. «Ec prapë», — tha babai. Djaloshi shkoi dy herë të tjera, duke u gdhirë anës telave me gunën. Herën e tretë i solli të trembëdhjetë ushtarët drejt e në çetë. Kurse Selman Gërvishta u kthye i mërziur nga Kavaja.

«Çfarë kërkon baba Merxhani prej meje?» — kishte pyetur Nazmiu. Ky markeshas i varfër që bërë në Kavajë nënoficer i xhandarmërisë duke shkruar xhandar edhe nipin.

«Të jesh dhe të digjesh me Markeshin», — qe përgjigjur Selmani.

«Me ju dua të jem. Ju do të fitoni. Ne s'kemi jetë. Po kam dhënë besën», — qe përgjigjur Nazmiu.

Selmani kishte parë sytë e njeriut që dënon veten. Ky kishte hedhur një hap të gabuar, duke u nisur drejt humnerës, si në ëndërr, kur të tërheq fuqia e saj e errët dhe ti dëgjon thirrjen e shpirtit por s'mund të ndalesh. Një ëndërr zgjat e shumta disa minuta, por, ta jetosh këtë ankth me sytë hapët, çdo orë, çdo ditë, duke ditur se po humbet nderin dhe të drejtën e vdekjes si burrë, kjo është një dhimbje që mund të përkulë edhe hekurin.

«Pra s'paska derman?» — e kishte pyetur Selmani.

Nazmiu kishte ngritur kokën që e mbante tërë kohën mbi kraharor, e kishte parë fshatarin e tij me sytë e turbullt, mbushur me mall për Markeshin.

«Selman o vëlla, mirupjekshim përtej varrit.»

* * *

Në mesin e shkurtit dëborë u shpua në vrima, si një sfungjer. Zuri të rridhte e të pikonte ujë, në pyjet e në vende të hapët. Toka me ngjyrën kafe të thellë thithte dëborën, që diku rrokullisej befas, për të liruar fijet e barit dimëror që ngrinte kryet në diell. Mjafton të nuhasje ajrin thellë që të ndieje pranverën. Po kjo mund të ishte edhe një ndjenjë e parakohshme, se papritur mund t'ia behnin ato dëborët e fundit të shkurtit e fillimit të marsit. prandaj duhej pritur edhe ca për të nisur me telasht që lë dimri prapa. gardhet e prishura, strehët e dëmtuara. Markeshasi ndalej me mendje vetëm përkohësisht te këto telashe, duke pasur ndër sy pranverën, kur do të ktheheshin kopetë nga kullotat e ulëta, duke menduar se moti rrotullohet më së miri në përshtatje me nevojat e bagëtisë e të njeriut.

Baba Merxhani po linte prapa fshatrat e nënpre-fekturës së Merqanit, për të shkuar në Korenë, ku do të takohej edhe me Petron. Në lëndinën e lartë të quajtur Drita e Teqesë, dëbora ishte ende e fortë. Ali Çela po tërhiqte mushkën për kapistalli, me pamjen e njeriut që ruan në mendje e në trastë gjëra të fshehta.

— Ma jep kapistallin dhe mos më rri tërë kohën para e prapa, — i foli nën zë babai.

— Ku të rri? — pyeti i habitur Aliu.

— Te shokët.

Përpara ishte Selman Gërvishta vetë i dytë dhe prapa pjesa tjetër e skuadrës. Aliu ndenji duke menduar se me cilët të shkonte. Nuk po i kuptonte disa sjellje të babait kohët e fundit.

Babai dukej sikur kotej në samarin e mushkës, duke menduar punët e veta. Nga dita e çlirimit kishin kaluar vetëm dy muaj, po atij i dukej se kishte kaluar një kohë e gjatë. Sepse kjo kishte qenë një kohë e jetuar çdo ditë, me lëvizje e biseda të vazhduara, me punë nga mëngjesi e deri natën vonë. Këshillat në fshatra dhe përgatitja për batalionin kishin qenë kryesoret. Po edhe një martesë a një vdekje, një ankim a një grindje ndërmjet dy fshatarëve, edhe këto kishin qenë punë me të cilat ishte marrë me gjithë shpirt. Dhe këshillat kishte kaluar koha.

Babai shtrëngonte kapistallin e mushkës, hidhte sytë rreth pyjeve me zemrën e ngrohtë, duke pritur pranverën. Po çdo trëndafil e ka gjembin e vet, siç thoshte me atë gjuhën e hidhur Selman Gërvishta. Se ja tek ka dalë në mesin e rrugës një plak i vogël, me mustaqet të prishura sikur t'ia kishte marrë era e thëllimi, me dorën si strehë mbi sy, me buzët mbledhur.

— Kot e ke lënë rehatinë tënde, or babë, dhe po vuan në këto vende të egra, — tha plaku. Dukej i lodhur e kryeneç, sikur nxitohej të arrinte diku, megjithëse kjo s'kishte ndonjë rëndësi për të.

Babai pa veten e vet. Kohët e fundit kishte ecur mjaft në këmbë. Donte të ulte peshën e trupit, të mundahej njëlloj si çeta. Po këmbët i kishte të holla, gjymtyrë të pazhvilluara nga mungesa e përdorimit dhe lodhej shpejt, nganjëherë edhe dëshpërohej; mbase ishte vonë që ato këmbë të rifitonin fuqinë. Tani që ndodhej para plakut, u turpërua me rraskapitjen e vet. Kishte njolla balte mbi dollomanë e grisur në bërrylat, taçi i qe nxirë në rrethin e ballit. U ul me plakun në një trung dhe zuri t'i fliste, t'i shpjegonte. Mendja e plakut duhej të ishte e zënë nga budallallëku ose nga një dhimbje e thellë e mbajtur mbyllur. Kishte takuar edhe herë të tjera fshatarë të tillë. Nuk duhej të inatosej me të prandaj po i fliste me durim.

Plaku e dëgjonte në heshtje, hera-herës duke ngritur dorën të shtronte mustaqet e bardha, sikur i kruhej ana e djathtë. Fytyra e tij e rrudhur ruante atë shprehjen e njeriut të fyer, të dënuar e pa shpresë. Babai prapë vijoi t'i fliste, duke pritur që plaku të çelej, po sytë e tij të vegjël e të patundur tregonin mosbesim në çdo pikë, ai nuk do ta hapte zemrën ndaj së mirës.

— Ke lënë njerëzit dhe teqetë, — tha plaku, si me qortim, po edhe si duke ia qarë hallin.

Babai vijoi rrugën. Nganjëherë i dukej se do të mbetej brenda kafazit të vjetër, sado të bridhte. Haxhi Bektashi kishte shtrirë krahun mbi të, që në fëmijëri. për të mos e lëshuar kurrë. Ky mendim i zi i qe rikthyer nga takimi me plakun. Pak më tej mendoi se jeta dhe lufta që vërshonin si lumë, do të linin prapa edhe kërcuj si ai plak, të cilin vetëm koha mund ta ndihte në ndonjë mënyrë. Afër Korenës një mendim tjetër po ia trazonte shpirtin. I dukej se ai vetë kishte lënë prapa të pabërë diçka më shumë rëndësi. që nga fillimi. Kjo ndjesi, që i rikthehej shpesh, ishte si një hije që nuk qëndronte në asnjë vend, por që krijonte rreth tij një zbrazëtirë të rrezikshme.

VII

Afër mëngjesit dy korrierë arritën në shtëpinë e teqesë në lagjen «Qytezë». Rahman Dena pa në dritën e kandilit se ata ishin të lagur gjer në kockë e si të dehur nga lodhja. Nuk thanë nga vinin. Thanë se duhej t'i dorëzonin një letër të ngutshme baba Merxhanit. Kishin humbur rrugën të djeshmen në mbrëmje në pyjet me ah të Gurabardhit. Rahmani po ndizte zjarrin në vatër, tha se baba Merxhani me komisarin ndodheshin në Koronë, shokët le të ngroheshin pak, të ndërronin teshat, të hanin e të flinin, kurse letrën po e çonte ai me njeri tjetër.

— Punë që s'bëhet. Letrën duhet ta çojmë në dorë, — tha korrieri i parë.

Rahmani u mendua. Korrierët mezi qëndronin në këmbë, le më të udhëtonin.

— Po gjejmë nja dy mushka, ngrohuni pak, — tha ai.

Korrierët po nxirrnin avull, koteshin ndanë zjarrit. Rahmani i mbuloi me plaf, po korrieri i parë hapi sytë e u hodh përpjetë.

— Shoku Rahman, letra ka të bëjë me jetën e njerëzve, — tha dhe u çua në këmbë me fytyrën të prisur ndërsa i kërcisnin dhëmbët.

— Për çfarë je duke folë? — pyeti Rahmani. — Jeta e kujt?

— Unë s'di më tepër.

Rahmani i përcolli korrierët deri te bregu i Kacorrit. Po hapte mëngjesi. Një erë e ngrohtë që frynte nga ana e Balit i kishte zhveshur malet nga dëbora deri në mes. Shiu kishte pushuar. Rahmani hodhi sytë rreth katër qafave të Markeshit, ku ruanin skuadrat. Nuk ndihej asgjë në këto qafa të largëta prej nga mund të vinte

armiku. Rahmani, zbriti prapë te shtëpia e teqesë. Nuk po kuptonte se çfarë rreziku u kërcënohej njerëzve. E fshehta e kësaj gjendej në zarfin e dyllorës që çonin korrierët. Rahmani ndenji i tulatur ndanë zjarrit, zuri të përtypte një copë bukë që nuk po mundej ta gëlltiste. Doli prapë jashtë dhe pa se mbi Bjeshkën e vogël shndriti dielli, drita e tij u bë më e fortë në pyjet e lagura. Zbriti në sheshin «Belik», me dëshirën e fshehtë të hetonte ndonjë gjë nga fytyrat e njerëzve. Sido që e qetësonte veten me fjalë, prapë punonte brenda tij një dyshim dhe mbajti hapin e ngriti kokën si kali para urës me dru të kalbur. Hyri te dyqani i Tomës të pinte një raki.

Një krismë e largët topi mbushi me jehonën e vet dyqanin. Gota në dorë iu drodh lehtas. Doli te dera dhe dëgjoi vërshëllimën e predhës që po afrohej, kaloi lart dhe shpërtheu me gjënim të rëndë prapa Shkëmbit të Plakës. Ky shpërthim jehoi tej në Malin e Balit dhe poshtë në grykën e Skuterrës, mbejti për një kohë në ajër dhe u zhduk. Njerëzit mbajtën frymën, me sytë nga shkëmbi, po s'patën kohë të mendonin për dëmin që mund të kishte bërë ai shpërthim, se nga përtej Qafës së Murlanit krisën radhas katër topa, mendjet e njerëzve mbetën në një pezull të thellë, predhat po kalonin në qiellin e luginës e sipër lumit Dron me harqe rrëqethëse që erdhën duke u rritur me furi dhe shpërthyen kësaj here aty para, rreth shkollës, postës dhe komunës, së cilës i flakën çatinë. Kjo potere e madhe, shurdhuese, që përhap afshin dhe hodhi gurë deri te dyqani i Tomës, e gjeti Rahmanin me fytyrën përdhe, duke menduar se po copëtoheshin e vriteshin njerëzit. Iu bë se dëgjoi krisma mitralozësh në lëndinat e Luginës dhe u çua duke i thirrur vetes «turp i zotit». Ai ishte nënkomandant i çetës e ushtar i vjetër dhe duhej të bënte detyrën. Do të mblidhte shokët e do të vraponte në ndihmë të Qazimit, të ndalte armikun, cilindo

armik. Po topat krisën prapë, predhat erdhën me një fuqi rrëmbyese edhe më të fortë, si rrafsh me tokën; i kthyen në grumbull të madh me gurë postën, shkollën dhe komunën. Një predhë ra edhe në oborrin e shtëpisë së Alketajve, duke çarë manin e madh. Aty ulëriu një grua sikur po çahet ajo vetë. U ngritën shtëllunga tymi edhe më tej në Qytezë, kurse lagjen «Gjin» e rrihnin mortajat. Kriste e gjëmonte e tërë lugina, po goditej në themel e po prishej Markeshi nga një fuqi hekuri që s'kishte të ndaluar. Kur mbaroi punë me sheshin «Belik», duke lënë, për çudi, të paprekur dyqanin e Tomës dhe shtëpinë e teqesë, artileria e zgjati qitjen drejt shkëmbit të Pylli i Thannëve, po teqeja vetë mbeti e paprekur, se mbrohej prej rrëzës së bregut. Për një copë herë topat nga Ndërfusha rrahën krejt faqen e majtë të lumit Dron, nga rrëza e Bjeshkës së Vogël deri te shkallët e Balit Kurse mortajat që goditnin lagjen «Gjin», u përquendruan me tërbim mbi Denë. Kur pushoi artileria, nga ana e qiellit të Balit erdhën tre aeroplanë që ranë ultas njëri pas tjetrit duke gjuajtur me mitraloz në shpatet e lumit e mbi lagjet, dy herë, tri herë. Sipër lagjes «Gjin» u shfaq me trup armiku që kishte bërë me armët e rënda një paralajmërim aq kërcënues.

Marshimi armik i nisur që të djeshmen në mbrëmje me manovrime për të siguruar befasinë e plotë, vijoi tani i ngadaltë. Ishin llogaritur luftime të ashpra në një zonë malore, kundër së cilës u hodhën dy mijë ushtarë me artileri e aviacion. Luftime të tilla nuk pati, po komandat nuk e pakësuan vëmendjen, kjo ishte një qetësi e dyshimtë dhe repartet derdheshin që nga Qafa e Murlanit, me bajonetat mbërthyer, duke rrethuar çdo shtëpi, merrnin burrat rob, kontrollonin bodrumet. Sulmi i ushtrisë së madhe, i nisur në orën të të mëngjesit, u ndal në orën pesë të mbrëmjes me pushtimin e plotë të Markeshit.

Rrëzë Bjeshkës së Shatit kishte ende dëborë. Sipër pyllit ngjiteshin retë e ulëta, si një masë e zezë, duke u turrur drejt majave që ngriheshin egërsisht në qiell. Zuri të binte shi i imët, që dukej si i hirtë, për shkak të trazimit me fjolla dëbore. Nata e errët, e ftohtë, erdhi njëherësh dhe do të ishte e gjatë. Baba Merxhani rrinte mbi një trung, i shëndoshë e i rëndë. Dëgjonte nga prapa një si murmuritje të thellë e të ngatërruar, sikur ata që flisnin të përtypnin një gjë të hidhur, me ndërprerje që ngjanin si shurdhim.

Ai donte të kuptonte atë që kishte ngjarë. Kur arriti ai te burimet e Bjeshkës dhe gjeti aty tri skuadra të çetës me Rahmanin, pushtimi i Markeshit kishte marrë fund. Letrën e sekretarit politik të qarkorit, që kërkonte të organizohej mbrojtja kundër dy batalioneve armike, e kishte marrë në drekë, në Korenë. Kishte bërë katër orë rrugë, duke dëgjuar nga larg gjëmimin e artilerisë.

Babai ruante ende një shpresë të humbur, të turbullt, se, kur të kthehej Selmani me tre të tjerët nga Dena, do të sillnin lajme që të hapnin shteg në ndonjë anë. Po ato që tha Selmani ishin edhe më të rënda nga sa mund të mendohej. Fuqia e madhe armike kishte pushtuar çdo shtëpi, kishte marrë peng nga një burrë për derë, kishte vendosur rrethimin e plotë. Qenë vvarë nga artileria gruaja e Xhep Alketës dhe djali pesë vjeç. Kishte të plagosur edhe në Gjin e Denë. Tek ura në Dron ishin vvarë dy udhëtarë të panjohur me mushkat. Babai shtriu dorën mbi trungun dhe hëngri pak dëborë. Prapa, nën pemët, ku rrinte çeta duke pritur vendimin e tij, prapë murmuritën. Ishte edhe më keq kur heshtnin. Njëri po thoshte diçka, sikur fliste për të mos u dëgjuar, por që donte ta dëgjonin të gjithë. Thoshte se, po të shtihej një pushkë, do të merrte fund i gjithë Markeshi. Ky ishte Korb Leti. Babait iu bë se po ia shihte hundën e kër-

cyer dhe mustaqet rreth gojës, sytë e zez të shpejtë e kërcënues, që në të vërtetë fshihnin frikën. Kërrusej mbi njeriun dhe i fliste fort, sikur do ta kafshonte në fytyrë. Babai vërtiti trupin e krisi dhëmbët, thirri Rahmanin. Do ta pushkatonte menjëherë atë Korbin. Kënaqësia që ndjeu i ngrohu gjakun. Po, kur erdhi Rahmani dhe ndenji para tij me trupin e madh, pushkatimi i Korbit iu duk marrëzi. Ishte si të shkarkonte mllefin që i ndrydhte zemrën mbi një njeri të kotë.

— Thuaji Korbit të pushojë, — tha babai.

Babai do të priste edhe pak. Mungonin ende pesë partizanë, veç skuadrës së Balit. Nuk dihej ç'kishte ndodhur në Bal. Pak më vonë erdhi Sadi Pejza vetë i tretë u ul ndanë babait dhe ndenji i heshtur. Më në fund foli ngadalë, duke marrë frymë thellë. Tha se ndodheshin para një armiku dinak, që po tregohej këtu më i egër se kudo, kishte shpalluar se do të pushkatonte dhjetë burra për çdo pushkë që do të shtihej dhe do t'i vinte flakën krejt Markeshit.

Me ligjëratën e tij si yshtje Sadiu po i helmonte gjakun. Veçse ai s'mund të kundërshtojë. Babai shikoi rrotull në të errët, duke kërkuar çetën. Rrinin rrëzë drurëve, të heshtur e të ngathët, si të pëndjeshëm ndaj të ftohtit dhe lagështirës, me dëshirën e fshehtë për t'u shpërndarë, të shpëtonte secili familjen dhe gjënë prej stuhisë armike. Kjo ishte në natyrën e markeshiasit. Ai do të hynte në një shpellë po ta zinte rrebeshi në pyll, që të dilte kur të çelej moti. Babai e dinte këtë anë të karakterit të tyre. Ashtu si u dinte edhe shpirtin e paepur. Tani atë po prisnin, të hynin në një «shpellë». Edhe nata bënte punën e saj, duke u ndihur me terrin e thellë të fshihnin mendimet, frikën për atë që mund të ndodhte sikur babai t'i çonte në një sulm kundër një armiku që kishte vënë ndërmjet vetes dhe çetës vetë Markeshin.

— Le të mblidhen, — i tha babai Rahmanit.

Çeta u mblodh të dëgjonte. Babai nuk po ua shquante fytyrat dhe lëvizi pak më tej. Po dyshonte për njëfarë errësire në shpirtin e vet lidhur me punët që sollën në një përfundim të tillë. Ishte i zemëruar me veten dhe me çetën. I dukej se kishte humbur befasisht fuqinë. Foli me një zë të rëndë, që shënonte një si shkëputje, një zë që njerëzit s'ia kishin dëgjuar më parë.

— Mirë pra, meqë nuk u dashka... — tha, duke e lënë frazën përgjysmë. — Një pjesë do të vini me mua, një pjesë do të qëndrojë rreth staneve. Të mbajmë gjallë popullin. Kjo ushtri armike s'mund të qëndrojë veç tri ditë. — Shikoi rrotull në të errët duke menduar se netët dhe ditët që do të vinin do të ishin një vuajtje e një mund që nuk do të shlyhej lehtë dhe kjo s'kishte të bënte dhe aq me bredhjet në pyje, me të ftohtët e me urinë. — Do të mblidhemi prapë, — tha, — do të bëhemi batalion. — Sa e tha këtë, mori frymë, duke menduar se vetë puna që do të mblidheshin prapë, tregonte se Markeshi dhe lufta e popullit s'mund të thyheshin. Veçse sa po përkuleshin pak, për shkak të befasisë, të fuqisë së madhe armike, të dinakërisë së tij. Kur tha këto, iu duk se e gjeti prapë lidhjen me çetën e me Markeshin.

VIII

Ushtarët italianë dyshuan se mos gruaja e re e Osman Baçit fshihte diçka në barkun e fryrë dhe hiqej shtatzënë, ose ata patën dëshirë të preknin Merjemen me duar dhe e afruan te muri për kontroll. Osmani, i shoqi, u verbua krejt, nxori koburen me mu-

lli nga shallvaret dhe shtiu në tym mbi ushtarët, vrau njërin. U pushkatuan Osmani, e shoqja dhe e ëma.

Më poshtë, te Mullterët, u gjetën disa materiale të çetës partizane. U nxorën në oborr dhe u pushkatuan tre burrat e shtëpisë. Afër teqesë u pushkatua Sali Maçi. Kërkohej një provë çfarëdo për të vënë burrat dhe gratë pas murit. Në mbrëmje u pushkatua sakati, prej zellit të vet. Kishte dashur të shëronte mushkën e një ushtari të artilerisë duke e djegur kafshën në bark me hekur të nxehtë. Mushka ngordhi dhe ushtari e paditi sakatin. Kur e morën, ai u tremb, zuri të kundërshtonte, të godiste me grushte. Pastaj u rresht, qëndroi te muri pa hapur gojë, me flokët të zbardhur që në djalëri dhe përpiquej të mbante sa më drejt trupin e gjymtuar, duke mbetur kjo në sytë e fshatarëve si pushkatimi më i keq. Të nesërmen bëheshin dy pushkatime të tjera të rënda.

Flaka përpinte tridhjetë shtëpitë e partizanëve në lagjet «Qytezë», «Denë» e «Gjin». Aty këtu kërciste pushka, vritej ndonjë qen. Ja behën tri herë aeroplanët, hidhnin bomba rreth Kreshtës, mitralonin. Urdhër operacioni i komandantit të divizionit «Firence», gjeneral Aldo Acit.

Oficerët shpejtonin të mbaronin bastisjet, të hakmerreshin për frikën që patën hequr, për mundimet e rënda të marshimit. Në këtë pllajë të lartë e të egër ndëshkimi do të bëhej i plotë, që ajo të mos hapte më telashe të tilla. Instruksion i shefit të shtabit, gjeneral Piçinit.

Oficerët nuk i përgjigjeshin nderimit të ushtarëve. Kishin arritur pa fitore në këtë vend të pjerrët, të ftohtë, ku duhej të bënin një punë polici, e nganjëherë atë të xhelatit. Në mbrëmje në orën 18, raport te çadra e madhe për të rejat e kontrollit, secili për sektorin e tij. Çfarë të raportoje? Në banesat e malësorëve të egër nuk gjeje veç mjerim. Të paktën të

shihnin përuljen trupore, thyerjen e shpirtit, pendimin. Po asgjë nga këto. Fshatarët kthenin kokat gjatë, hiqeshin se s'kuptonin asnjë fjalë. Po nganjëherë qëndronin me këmbët ngulur dhe në sytë e tyre të errët digjej hidhërimi. Atëherë të pushton një ndjenjë turpi si njeriu që zbulon diçka të habitshme. Se je nisur të bësh një gjë të madhe, të hijshme për gradën që mban, dhe sheh se ke goditur një plak me eshtrë të forta që s'do të ta falë kurrë. Në këtë vend s'ka asgjë për të fituar. Pushtimi i këtij vendi është i kotë, ashtu si pushtimet e tjera, e tërë lufta. Kjo mbetet e pafolur, po e rrënjosur në vetëdijen e secilit, që nga dita kur niset nga shtëpia. Ndofta nga kjo disa bëhen edhe më të pamëshirë, më të rrezikshëm, për t'i mohuar vetes kotësinë. Dhe në darkë, te çadra e madhe, secili oficer ngutet të pijë, duke u parë me shokët si të njohur me drejtime të ndryshme, që takohen rastësisht e që duhet të ruajnë përjetë një të fshehtë të përbashkët dhe më mirë të mos ishin takuar. Kështu prej tri ditësh. Veç atij maskarait, toger Tempestës, që del në fotografi me dorën në mjekrën e një dervishi të vjetër të lidhur ndërsa prapa krahëve digjet teqeja.

* * *

Prej tri ditësh toger Bedri Mëdyshi me kryepleqtë e vjetër pranë, thërret burrat në sheshin «Belik», nga një për derë. Çdo mëngjes i bie jevgu daulles. Bëhet itifak, jep besën Markeshi, shpallet i dëbuar baba Merxhani.

Ky baba ia ka hipur vetes pak si tepër, ka lënë rrugën e fesë, dritën e çiragut, për të marrë në dorë armën e shkatërrimit; mbi supet e tij bie barra e rëndë

e mëkatit bektashian, të thuash këtë, është pak. Ai ka futur disa njerëz në rrugën e komunizmit që sjell një mijë të zezat; për shkak të këtij babai u vranë fshatarët dhe u dogjën dy teqetë, si edhe shtëpitë. Bëhet fajë për njerëzit e gabuar dhe babai le të shkojë në Buzin Madh prej nga ka ardhur, asnjëri s'do t'i japë strehë, kush ta gjejë përpara, le t'ia rrëzojë taçin prej kokës, t'i vërë pushkën e ta ndjekë përtej kufijve të Markeshit, ai që shkel këtë besë do ta çojë jetën në burg, atij i merret gjëja, i digjet shtëpia, i vete në internim familja.

Toger Bedriu vë këtë shpallje të itifakut para fshatarit. Ky përkulet, shikon me vëmendje kartën ku lëvrijnë shkronjat, pastaj çon lart kokën kryeneçe që mund ta thyejë vetëm plumbi, thotë se vë gishtin në zjarr, po jo në kartën që dëbon baba Merxhanin. E kështu të tjerët tri ditë me radhë, secili fshatar duke u sprapsur para hartës së itifakut sipas mënyrës e karakterit të tij, me sytë e çakërritur, si para një magjie të djallit, a thua se do të vuloste aty shitjen e shpirtit të tij. Më keq se kështu për itifakun s'mund të bëhej.

Por toger Bedriu ka varur shpresën në këtë itifak, e ardhmja e familjes, shlyerja e poshtëtimeve që ka hequr, të vërteta ose të krijuara prej mendjes së tij, të gjitha prej asaj cope karte varen. Ditën e tretë fytyra e gjatë i është mavijosur. nga sytë e kuq shihet se i ka rrëkëllyer që herët nja dy faqore, po askush s'ka dalë nga halli me anë të faqores. Pak më tej pi duhan Rati, u nënqesh fshatarëve, duke fshehur ftohtësinë, armiqtësinë për vdekje që po sajon në shpirt ndaj tyre. U kishte thënë me kohë bashkëfshatarëve se Italia ishte një pyll i madh që s'mund të digjet nga brenda sado zjarr t'i vësh, po të mos fryjë erë e madhe nga jashtë. Kishte ndenjor duke shikuar buzagaz në të ardhmen, në kohën kur do t'i vihej zjarri Markeshit dhe fshatari do të

thoshte, «e dinte mirë Rat Mëdyshi». Prej tri ditësh dilte në mëngjes në sheshin «Belik», duke pritur të shihte këtë pohim në sytë e fshatarëve. Rrinte larg tryezës së itifakut mbuluar me flamuarin e kuq a thua se nuk po shihte dalldisjet e vëllait.

Ditën e tretë, fshatarët e thirrur prej xhandarëve po rrinin sikur të ishin gjetiu e jo në sheshin «Belik», siç kishin ndenjtur tri ditë radhas. Kishte ardhur koha që «pleqësia» të bënte diçka me itifakun, me letrën e bardhë. Rati u ngjiti te rrënojat e komunës, ndenji para tryezës, i foli të vëllait me zë të lartë të gënjeshtërt, duke e paralajmëruar me anë të shikimit e të zërit se duhej të pranonte pa luajtur vendit ato që do të shihte e do të dëgjonte.

— Ç'je duke kërkuar, mor hajvan! — i tha. — Paske genë gdhë e derr e jo njeri. Ku është parë të bëhet në Markesh itifak me letër?

Me Ratin gjithmonë mund të ndodhnin habira; po s'mund të ndodhte kurrë të shante faqe njerëzve vëllanë e madh, togerin. Sepse, sa herë donte të bënte diçka, ose nuk donte ta bënte, Rati thoshte do Bedriu, ose s'do Bedriu, a thua se çdo gjë në Mëdyshajt lindte e vdiste sipas gjykimit, prirjeve e nevojave të togerit matuf. Kurse tani po e shante, duke e bërë hi e pluhur, njëlloj sikur ta zvarriste përtokë. Bëri edhe më tepër, kapi letrën e itifakut, e grisi dhe ua flaku sipër kokave Bedriut dhe «pleqësisë». U kthye ndaj fshatarëve dhe tha:

— Gjithmonë ka mjaftuar fjala për t'u lidhur me besë fshatari. Po qe se qeveria kërkon itifak me letër, le ta bëjë me duart e saj.

Fshatarët zunë të shpërndaheshin, të gëzuar që shpëtuuan prej itifakut në këtë rrugë të papritur. Ai djalli i zi, Rat Mëdyshi, kishte hërë të vetmen siç që mund të bëhej, dhe kishte ikur duke e lënë vëllanë te sheshi të trullësuar. Togerit u ngrit i hutuar e i nxirë me faqet gro-

pë dhe buzët rrudhur, belbëzoi diçka e pështyu tej dhe iu shkreh jevgut, i ra me shkelm dhe i tha «ta marr shpirtin, qen i qenit».

Jevgu shkoi e ndenji te dera e dyqanit.

— I re daulles mjaft, u lodhe, — i tha Toma, nën zë.

Jevgu ngriti sytë, e shikoi buzagaz. Toma nuk ishte i detyruar të pranonte itifakun, as ta kundështonte. Toma po mblidhte plaçkat në arka e dengje për të ikur përgjithnjë nga ai vend.

— Po ikën? — e pyeti jevgu. — Mirë bën, secili shikon punën e vet.

— Sot nuk është e mundur të shohësh vetëm punën tënde, — tha Toma. Hyri në dyqan dhe i solli jevgut një shishe të vogël raki.

— Unë veç sa i bija nga pak daulles, — tha jevgu.

— E ç'mund të bëje ti, mor i gjorë, — i tha Toma.

Jevgu e ngriti shishen, e firoi përgjysmë dhe nisi t'i binte lehtë daulles; lëvizi buzët si duke kënduar në gjuhën e vet, si i kredhur në atë mërzinë e pafund që ia njihte Toma, kurse sytë i ndriçonin nga një dinakëri e thellë.

IX

Baba Merxhani po habitet me pamjen e vendit, nuk i njihte malet dhe luginën. Kreshta e Madhe që si e varur mënjanë. Qafa e Murlanit i ngjante një muri të prerë, tej të cilit shtrihej një hapësirë e hirtë. Nga ana e Balit shkëlqente me madhësi Mërdheta, po që

andej zuri të hapej një dritë e dhimbshme e përflakur. Mbi pyjet me pishë qëndronin të palëvizshme rripa mjegulle të bardhë. Një qetësi e dendur, e lagësht dhe e pabesë sundonte në qiell e në tokë. Babai kërkonte të gjente ngrohtësinë e dheut, të dëgjonte tingujt e të shihte ngjyrat me të cilat ishte mësuar prej dhjetë vjetësh. Kurse i dukej se çdo gjë paskësh ndërruar në thelbin e vet. Kjo i sillte një gjëndje ankthi e shtrëngimi që ia rëndonte shpirtin përherë më tepër. Prej sa kohësh kishte munguar? Tetë ditë. Dhe dukej sikur kishte kaluar një jetë e tërë. Shtyu taçin lart dhe eci me hapin të qetë e sytë hapët.

Afër Pishtës zunë të lihnin qentë. Ndofta lihnin për të dhe shokët që i vinin prapa. Dukej sikur dikush i nxiste me shkop të lihnin sa më tepër kundër kujtdo që kalonte në rrugë. Italianët kishin ikur, po mbi luginën kishte mbetur hija e ngjyrës së tyre gri-jeshil. Kishin lënë prapa postat e forta të xhandarmërisë në çdo lagje. Kishin lënë një repart përforcimi në Ndër-fushë.

Ai ende s'ishte mësuar të ecte tetë orë si markeshas dhe s'kishte një stomak markeshi që të hapej e të mbyllej sipas rastit dhe as në pyjet me dëborë s'kishte fjetur si ata. Tani po i provonte këto dhe lodhja e mundimi i peshonin rëndë në supe. Qe nisur në agim të Qafa e Luadhit, kishte zbritur në Plan duke u rënë maleve rrotull dhe tani, afër Pishtës, nuk mundej më. U kthye në një shtëpi të veçuar.

Ndërsa hante bukë ngadalë, dëgjonte fshatarin, mendohej me lugën në dorë. Ishte vrarë në pritë Haxhi Mani, me trupin e divit, me zemër trimi. Disa partizanë cenë kthyer në shtëpi, rrinin urtë, si njerëz që s'kanë dalë kurrë nga vatra e tyre. Ndonjëri kishte shkuar në kullotat verore. Nuk dihej ku fshihej edhe ai Sadi Pejza i këshillit krahinor. Flitej se një pjesë e

partizanëve prisnin në stanet e Balit të kthehej baba Merxhani. Patrullat e xhandarëve vëzhgonin lëvizjet e gjithkujt, rrinin në pusi në hyrjet e lagjeve. Këto babai i dinte. Fshatari po thoshte me gojën të tharë se besën e myhibit nuk do ta mohonte kurrë, strehë e bukë do t'i jepte babait edhe po të digjej me gjithë fëmijë. Po ndërsa thoshte kështu, në sytë i lëvizte një lutje që babai të mendohej për atë që mund të bënte. Tha se italianët mbanin peng në Ndërfushë pesëdhjetë markeshas dhe heshti.

Babai u vu prapë në rrugë, duke menduar me dhimbje e urrejtje për Sadi Pejzën, për partizanët e kthyer në shtëpi. Miq të rremë nga ata që i merr era, të lidhur me të shpejt e shpejt, për shkak të teqesë. Dielli ecte me shpejtësi pas reve, si një gur i madh i argjendtë që do të bjerë përtej Skuterrës. U çanë retë dhe ndricuan lagjet «Qytezë» e «Denë» në bregun matanë. Aty-këtu nxinin si zgavra shtëpitë e djegura. Babait po i dukej se thithte hi e jo ajër. Ai e kishte nisur këtë luftë në Markesh, kishte marrë armën e zjarrit dhe armiku me zjarr e pushkatime që përgjigjur. Pak më tej pa binanë e teqesë, pa çati. Zuri të mendonte se kjo luftë në Markesh do të kishte nisur njëloj dhe pa të. Ndjeu lehtësim dhe ndoqi me sy një tufë pëllumbash të egër që fluturuan ultas dhe ranë në rrënojat e kalasë së vjetër të Gjinit. Babai u ndal t'i shihte rrënojat për herë të parë nga afër. Aty kalonin Mëdyshajt në kohë rreziku. Ata sundonin tani në Markesh. Rati!

Rat Mëdyshi dinte ku kullosin dhentë, si edhe priren e tyre për t'u hedhur në shteg pas dashit. Nuk qeveriste hapur. Rrinte në shtëpi, ecte si i patrazuar, me ballin lart, duke shikuar se qysh të zinte në mëkate të tjerët, në mbrojtje të zakonit e të Markeshit. Qe rritur

natën. Po dinte t'ia hidhte lakun fqinjët edhe në dritën e diellit. Dhe kështu jetonte ai, duke stërvitur edhe disa të tjerë, deri aty ku stërvitej çiraku dhe ishte gjithnjë mjaft i kënaqur, i bindur se ia hidhte gjithkujt e deri në fund me shkathtësinë e mendjes e të trupit. Tani gjithë fuqinë e kishte vënë në këtë lojë: të përzinte babë Mërxhanin, si një «të huaj pa emër, që s'dihet si erdhi në Markesh vite më parë e ku shkon». Këtë donte t'u fuste në mend fshatarëve. Pastaj do të godiste me mjetet e tij të shumta disa, ndërsa do të shtronte të tjerët, duke «pajtuar» Markeshin. Ishte i gatshëm t'u jepte një këshillë xhandarëve për të falur një partizan, t'i shkonte këtij natën në shtëpi, t'i ndihmonte me miell e me para, pa i kërkuar në këmbim asgjë. Një gjarpër më i keq s'kishte si bëhej. Babai cuditej me veten si nuk e kishte vënë me kohë në mur. Kishte shpresuar në bashkimin e Markeshit, kurse bashkimi i plotë s'mund të bëhej kurrë.

Ai ecte në një rrip të gjatë toke mbuluar me dëborë të ngrirë, që përhapte një ndriçim të pasigurt. Vetmia e tij bëhej përherë më e thellë. Nga qielli binte errësira. Ai dëgjonte hapin e vet të kërciste në dëborë, zemrën e kishte të rëndë dhe mendimet të errëta. Besonte se gabimi që solli thyerjen e Markeshit ishte pritja gjatë dy muajve, për të thirrur në batalion gjithë ata që mund të vinin. Gabim edhe shpërndarja e skuadrave në qafat, mungesa e lidhjeve më të forta me fqinjët. Dhe, kur erdhi sulmi i befasishëm armik, Markeshi u gjend pothuaj zbuluar. Këto dhe të tjera i kalonte në mendje si një varg gabimesh që ndjekin njëri-tjetrin, duke qëndruar secili më vete. Po edhe të gjitha gabimet bashkë nuk mjaftonin për të shpjeguar atë që ngjau. Ai s'mund ta shtynte më gjatë dyshimin se diçka më shumë rëndësi që lënë pa bërë, gjatë tërë kohës, që në krye,

diçka që lidhej me një të vërtetë tjetër, e cila ndodhej fare pranë dhe prapë mbetej e fshehtë. Sa më tepër ecte, aq më fort vuante nga ky mendim. Mbase mendimi do të kthjellohej kur të arrinte në Bal. Aty do të shihte atë që s'po mundej të kapte. Ngriti sytë dhe pa tetëdhjetë e dy shkallët zigzage. Do të fillonte të ngjitej aty, si herën e parë kur erdhi në Markesh, kur ishte ende një dervish plot shpresa e i gëzuar. Pas dy orëve pa dritat miqësore të Balit, të shpërndara në luginën e habitshme, që vezullonin si yje të rralla në një qiell të varur poshtë. Zuri të mendonte se aty çdo gjë do të ishte po aq mirë sa edhe më parë dhe shpejtoi hapin. Pak më tej pa në dritën e hënës një tufë të dhive të kuqe me brirët përpjetë si të larë në argjend, duke rrotulluar me dyshim sytë si prushe.

* * *

Rahman Dena zuri derën e ahurit me trupin e madh. Në fytyrën e rëndë i kaloi një dritë gëzimi, ndërsa hapte sytë mbi babanë. Zgjati kokën të shihte njerëzit që rrinin grumbull në oborr, duke hetuar në errësirë secilin. Në fytyrë iu kthye hidhërimi, sytë iu bënë akull. Lëvizi nofullat dhe i tha babait:

— A do të vish brenda me gjithë njerëzit?

Ky ishte një Rahman tjetër, i dyshimtë e i ndrydhur. Babait i kaloi një presë në zemër, e tërë lodhja u shkarkua mbi të, iu morën mendtë.

— Cilët nuk duhet të hyjnë? — pyeti.

— E dinë vetë, — tha Rahmani dhe hapi rrugën.

Babai hyri me shokët e çetës në ahurin e ndriçuar prej pishës. Jashtë mbetën kryeplaku i ri i Balit, burrë i gjatë, me fytyrë bataçiu, dhe tre anëtarë të kë-

shillit. Këta biseduan diçka ndërmjet tyre dhe u larguan.

Rahmani vuri dru të thata në zjarrin e mbuluar.

— Nuk deshe t'i pranoje fshatarët e tu, — tha babai.

Ditët e kaluara bënë hije mbi Rahmanin dhe humbi mendjen. Ngriti sytë mbi babanë si për t'u siguruar se ai kishte ardhur dhe vuri re rrobat e tij të ngrëna e diku të shqyera, dhe iu bë se po shihte plagë që kullonin fshehtas. Drejtoi trupin me dhimbje dhe tha:

— Çdo ditë më çonin fjalë të dorëzohesha, të shkruhesha kapter.

Ato që kishte hequr Rahmani i lexoheshin në fytyrën e zbehtë, në rrudhat e thella, në supet e mëdha të lëshuara. Kishte vuajtur pa dëshpërim, si shkëmb që ishte, duke ruajtur shpresën. Baba Merxhani që zhdukur si hëna pas reve, po do të dilte prapë. Rahmani ia dinte udhëtimet. Kishte nderur ditën në pyll me djalin dhe natën me pushkën në dritare, në ahurin e tij në krye të luginës, në shpatin e malit ku rrokulliseshin gurë dhe orteqet e dëborës. Nuk kërkonte shpërblim për ato që kishte hequr, donte vetëm të harronte. Babai ndjeu keqardhje për mikun, po donte të shihetë deri në fund.

— Duhej t'i kishe mbajtur mbledhur shokët e çetës. Ashtu e lamë, — tha.

Rahmani ndenji duke gjykuar veten. Disa nga shokët qenë larguar nga stanet. Dhe ai vetë ishte kapur pas ahurit. I qe dridhur zemra për djalin që donin t'ia vrisnin, për shtëpinë, për tufën e dhive. Këto qenë çdo gjë që kishte në jetë dhe u vunë nën kërcënim.

— Tani nuk na takon të shkojmë pas gjësë dhe familjes, — tha babai, me qortim në zë, pa mëshirë, du-

ke ngritur gishtin. Sa më shumë ndëshkonte mikun, aq më tepër e ndiente këtë ndëshkim mbi veten.

Rahmani e shikoi me sytë si të përbotur, trazoi urët e zjarrit me duart e mëdha gjithë nyja dhe tha.

— Jo, nuk shkon kurrë.

Ata ndenjën heshtur, me shpirtrat të afruara.

— A mendon se mund ta mbledhim çetën këtu? — pyeti babai.

— Më mirë në Fushë-Lizë.

Rahmani shkoi në vathën e vogël prapa ahurit dhe solli një keç, e theri duke ia derdhur gjakun në tenxhere dhe zuri ta rripte. Kurse e shoqja hodhi dru të tjera në zjarr. Këto punë burrë e grua i bënë me të njëjtin kujdes e respekt që ka bërë gjithnjë markeshasi kur ther një bagëti për mikun. Rreth murit ndritën fytyrat e fëmijëve mbuluar me plaf, që hiqeshin se flinin.

Babai uli kokën duke pirë çibukun e gjatë. Prej të ditësh vuante dhimbjen e parë të madhe në moshën e burrisë. Tani i dukej se po shihte ku qëndronte gabimi i vërtetë. Lufta ishte për jetë a për vdekje. Ajo kërkonte nga cilido gjithë fuqinë e trupit e të shpirtit. Kërkonte edhe më tepër. Kurse deri aty më parë, lufta nuk qe dukur e tillë. Pastaj kishte ardhur befasi ndëshkimi i rëndë. Tërë puna këtu ishte, që lufta të shihej ndryshe. Po nuk ishte e lehtë të ktheje njerëzit ta mendonin kështu, të mohanin veten, të mposhtnin çdo frikë, të digjeshin për lirinë. Gjithsesi kjo nuk bëhej me miqësitë bektashiane, me besën e myhibit. Këtu duhej gjuhë tjetër. Ai uli kokën si për të dëgjuar më mirë këtë gjuhë dhe rënkoi brenda vetes. Një dhimbje në trup të kujton sëmundjen, kurse dhimbja e shpirtit ka të bëjë me ndjenjën e fajit. Kjo ndjenjë po i qartësohej për herë të parë pas tetë ditësh. Në të njëjtën kohë filloi t'i çelej ze-

mra nga një ankth gëzimi, se tani do të niste nga e para, duke matur fuqinë e tij me një punë tepër të madhe. Po ama kupën do ta pinte deri në fund.

Një korrier që kishte bredhur tri ditë në male i kishte arritur te shkallët e Balit. Petron e kërkonte sekretari politik i qarkorit. Babai do të shkonte edhe vetë te sekretari. Nuk ishte Petroja që duhej të përgjigjej për Markeshin e vënë nën thundrën e reaksionit. Do të përgjigjej vetë babai. Pastaj do të takohej me çetën në Fushë-Lizë.

* * *

Baba Merxhani nuhati ajrin e vakët, të njohur. Çdo gjë në Teqenë e Madhe ishte në vendin e vet si më parë. Edhe korridorit ishte po ai tunel, ku duhej ecur me kujdes e kokulur. Veçse aty që shtuar frika, duke e bërë heshtjen dhe errësirën edhe më të thellë. Kjo frikë e druajtje dukej sikur nuk vinin dhe aq nga rreziqet e jashtme, po nga një forcë e vullnetit brendshëm. Dy dervishët që e pritën te porta dhe e përcoollën gjatë oborrit, me atë të ecurit e dervishit që nuk ngjan me asnjë të ecur tjetër, qëndruan në vend dhe u hoqën mënjanë sikur të kërkonin vrima për t'u futur në mure, kur në krye të korridorit të gjatë u shfaq Asaf dedei. Ishte i mbështjellë me një dolloma jeshile të ndritur, ndërsa duhej ta kishte të bardhë. Për një çast mbeti si i goditur nga pamja e baba Merxhanit, pastaj eci drejt tij me hapa të mëdhenj, me trupin e fuqishëm si të prirë përpara.

— Hatër, hatër i madh! — tha me një si rreptësi të butë. Ndenji me duart të lidhura në bark e me kokën mënjanë. Ishte më i vëmendshëm e më i ftohtë se një vit të shkuar, kur u njoh për herë të parë me

baba Merxhanin në hotelin «Elbasani» në Tiranë. Mbante mbuluar kokën dhe trupin e rrjepur prej qi-meve, megjithëse kësaj nuk i vinte ndonjë rëndësi. S'kishte gjurmë frike e shqetësimi në fytyrën e zeshkët. Sytë e mëdhenj me xixa, si të maces që shikonin në errësirë, brodhën në veshjen e babait, qëndruan tek armët, tek ylli i kuq në gjoks, te taçi i grisur.

«Zogu i vogël që ke rënë nga dega. Haxhi Bek-tashi...»

Ç'është bota, dajë Hasan? — Bota jashtë rrotullo-
hej në krahun tjetër të teqesë me njerëzit, sendet,
ngjyrat, muzikën. Mendja e dervish Merxhanit të ri
fillonte të lirohej nga avujt sapo dilte në qytet. Po
shkrimet, figurat e shenjtorëve që dinin të fshehtat
e mëdha e tërhiqnin prapa me kërcënim. Ai duhej të
bridhte në jetë si një i dënuar që nuk di pse ndiqet
ahe sa do të zgjatë kjo punë. Dhe kthehej në teqe
te baba Ahmet dedei e vetmja dritë në atë bina të
errët. «Ti, o bir, nuk i fërkon më kot postiqet e te-
qesë, mëso, mëso, or bir», thoshte dedei i vjetër i së-
murë. Në sytë e tij me ethe ndriçonin pusitë e fsheh-
ta, ndofta për ndonjë hakmarrje të vjetër kundër kry-
egjyshit a vetë bektashizmit. E donte dervish Merxhanin
si bir, e stërviste, po edhe i kishte prerë krahët, që
ta mbante gjithnjë pranë vetes. Më në fund erdhi koha
ta lëshonte, ta niste për rrugë dhe dervish Merxhani
kuptoi njëherësh atë që kishte ndier turbull në vite.
Ahmet dedei ishte tepër plak që të synonte për vete
vendin e lartë të kryegjyshit botëror. Po ai kishte
përkëdhelur ëndërrën të çonte aty Merxhanin e ri. Atë-
herë Ahmet dedei do të zbriste në varr me shpirtin të
rehatuar me bindjen se jeta e tij e shuar do të përtë-
rihej plot shkëlqim nëpërmjet këtij djaloshi të men-
çur e të shëndetshëm. I kapur pas kësaj shprese të

fandaksur, plaku përkulej me mundim të shihte më mirë djaloshin, t'ia dëgjonte tingujt e zërit. Ky s'kishte shikimin e përmbajtur të zanatit, kishte një mendje dyshuese. Ky do t'i bënte vetes pyetje të shumta në rruqën e gjatë. Po karakterin e kishte të fortë, do të bënte detyrën në çdo rast, duke i ruajtur për vetë dyshimet. Pastaj erdhi nata e fundit. Ahmet dedeit i dridhej trupi, i thahej goja. Dervish Merxhani e ndihmoi të pinte shurupin me dëborë. Fytyra e dedeit mori dritë, mendja po i shtegtonte e lirë në pragun e vdekjes. E la dervishin të priste, duke paralajmëruar me shikimin dhe heshtjen e tij se do të fliste për mendimin e tërë jetës të mbajtur fshehur. «Nesër do të shkosh në teqenë e Markeshit, të bëhesh baba.» Merxhani i ri i puthi dorën e zbardhur duke menduar për vendin e largët që e njihte vetëm me të dëgjuar. Po i ngjallej një shpresë e turbullt, i rritej gëzimi. Do të dilte prej Teqesë së Madhe ku dervishin e piqte koha ngadalë, deri në eshtra, deri në humbje. Të nesërmen Ahmet dedei u gjet i vdekur. Vdekja e një njeriu të veçantë, në mes të vdekjeve të qindra bektashinjve...

~~—~~
Këto iu përtërinë baba Merxhanit aq të gjalla e të afërta, sa iu duk se po i jetonte për së dyti. Nënqeshi e i erdhi neveri me atë dervishin që puthte me nderim të thellë dorën e Ahmet dedeit. Asaf dedei, që vijonte të shihte me kokën mënjanë, e kuptoi këtë, ngriti vetullën e rrjepur me qortim, nënqeshi me anë të buzës. Baba Merxhani u përkund prej lodhjes, ngriti grushtin ngadalë dhe tha:

— Vdekje fashizmit! — E shikoi dedein nga afër e ngultas dhe i nënqeshi, si për t'i thënë se s'kishte rënë nga dega, kjo kishte ngjarë vetëm një herë, njëzet e dy vjet të shkuara, me një fëmijë dhjetë vjeç dhe më kot do të prisnin ata që të ndodhte prapë.

Asaf dedei e duroi qetësisht shikimin dhe tha:

— Urdhëro, nazari. Këtu je zot po aq sa ç'jemi edhe ne. — Donte të thoshte se baba Merxhani që caktuar nga Ahmet dedei i vjetër trashëgimtar, në mos në Tiranë, së paku këtu; donte të thoshte se e dinte edhe këtë, dinte gjithçka.

Baba Merxhani eci pas Asaf dedeit në korridor me sytë në shpatullat e tij të fuqishme, në pjesën e zverkut të zbuluar të rrjepur. Ky njeri kishte ardhur në vitin 1930 nga Persia ose Egjipti, kishte qëndruar disa vjet pranë kryegjyshitës dhe që dërguar në Teqenë e Madhe kur vdiq dedei i vjetër. Ky të kalte të ftohtët në zemër. Baba Merxhani nuk po kuptonte se si kishte zgjedhur këtë pikë takimi sekretari politik i qarkorit. Po dukej se Teqeja e Madhe mund të ishte vend i sigurt në një kohë kur armiku po bënte ndjekjet më të egra.

X

Në prill majat rreth Markeshit janë ende të mbuluara me dëborë. Po toka zë e ngrohet, bisqet e ahut mbushen me lëng, në lëndinat çelin me druajtje lulekaçet, shpendrat dhe lulet e shqerrës, blerimi i pyjeve merr forcë, ndritin shkëmbinjtë e larë. Kjo përëritje e tokës, që bëhet pa u ndier, u sjell njerëzve gëzimin dhe shpresën.

Në këtë kohë të motit në Markesh zënë e ndreqin gardhet, plugojnë si mundin tokën e shkrifët, shohin me dhimbje gjënë e gjallë që ka dalë përtej dimrit me këmbët e mpira, me sytë e ndritur prej urisë. Fshatari mund të durojë në heshtje urinë e vet, po jo këtë

mundim pa gojë të bagëtisë. Atëherë, si të ishin kujtuar befaz për diçka, njerëzit shkëputen prej plogëshitë së gjatë dhe turren në bjeshkë të gjejnë për bagëtinë ushqim të ri, pak krande majë pishave, që janë për kafshët si gjalpi për njerëzit, të mbledhin bashtrën luleverdhe e ç't'u zërë dora. Bujaria e bjeshkës është e madhe, për atë që di ta kërkojë. Por festa do të vijë nga mesi i majit, kur të kthehen kopetë prej kullotave verore dhe të nisen drejt staneve të larta, në Rrallenjë, në të dy Bjeshkët, në Fushën e Gjerë, në Lugun e Gjatë ku zënë së pari këngën qyqet, deri te Liqeni i Zi e Liqeni i Bardhë, rrethuar me lulet e dheut. Po tani këto lëvizje bëhen të ngathëta e si në fshehtësi. Përtej maleve të Markeshit, në rrugët e hapura prej kohës, trashëgimit e zakonit, janë shtuar pritrat e rreziqet. Asgjë s'është si më parë, as që mund të jetë dhe as do të jetë. Asgjë nuk përsëritet njëllor dy herë, sado e ngjashme të jetë lëvizja. Veçse tani çdo gjë do të ndryshojë për mirë, duke dalë jeta e re prej lëkurës së vjetër, me dhimbje e vështirësi, siç është vetë ligji i lindjes.

Në lagjet pushon batalioni. Në sheshin «Belik» dikush u mëson fëmijëve një këngë të re, si një himn për Markeshin në prill që e rifitoi lirinë duke paguar diçka prej gjakut të vet. Se u vra Elam Thana vetë i tretë në përpjekjen e ashpër të Balit. U derdh gjak edhe në Denë. Pas këtyre armiku u tërhoq nga qyteza e Gjini, si edhe lart nga Ndërfusha.

Baba Merxhani qëndroi para shtëpisë së teqesë, që kishte shpëtuar prej bombardimit. Italianët nuk e dogjën as më pas. Kjo ishte një nga ato gjërat e çuditshme që ndodhnin në luftë, që përmenden gjatë e nuk shpjegohen kurrë. Babai sapo kishte dalë nga një mbledhje e këshillit krahinor. Sadi Pejza që treguar mjaft i zoti. Do të ndihmoheshin familjet me shtë-

pitë e djegura për të pasur një strehë, qeresteja do të pritej në pyjet e teqesë, gëlqerja do të digjej rrëzë Kreshtës. Çdo gjë do të bëhej shpejt e mirë. Baba Merxhani po mendonte për ngutjen e tij në fillim të marsit, kur u zemërua me popullin e Markeshit. Tani po i thoshte vetes se njeriu s'mund të zemërohet me popullin kurrë, veç në qoftë i pushtuar prej marrëzisë së vet.

* * *

Në mbrëmje, nën dritën e çiragut, babai shkruan pikat e rendit të ditës, se do të mbajë një diskutim me rëndësi në mbledhjen e celulës.

Ai po mendohej prej një jave për ndryshimin e ri, të thellë, që kishte ndodhur në jetën e tij. Kishte ardhur vetë Tomori, sekretari i qarkut, për ta futur në Parti. Ia përmendi në celulë meritat me të tepërt. Nuk iu kërkua ndonjë betim, as u zbulua ndonjë e fshehtë. Veç iu kërkua të hynte, të ishte. Babai kishte ndenjtur heshtur. Duhej të bënte disa pyetje, më së pari, si do të rregullohej jeta e tij aty e prapa, meqë ai ndryshonte nga të tjerët. Po i gëlltiti pyetjet. Po e futnin në Parti. Do të ishte në brendësinë e çdo pune që bëhej. Veçse, aty e prapa, duhej të bënte më tepër kujdes, që çdo hap, çdo fjalë, të puqej me atë që kërkonte Partia. Këtë ai e pranonte me dëshirë. Prej një jave ndiente më tepër besim në fuqitë e tij, i dukej se për herë të parë qëndronte mbi tokë pa u munduar nga ndonjë dyshim. Tani besonte se, që të jetë njeriu i lumtur, mjafton t'i kushtohet qëllimit të madh të lirisë, duke thjeshtuar në jetën e vet teprimet. Habia ishte se të gjitha këto kishin ndodhur duke qenë ai, një vit më parë, babai i teqesë së largët të Markeshit.

Po njeriu s'mund t'i ketë të gjitha dhe sidomos në të njëjtën kohë. Sa herë ndriste mbi të një rreze lumturie, sa harronte të kaluarën, për t'u dhënë i tëri pas së sotmes e së ardhmes, djalli bektashian do ta sulmonte nga ndonjë anë. Se përtej celulës ai prapë mbetej siç ishte, duhej të vijonte t'u fliste njerëzve me atë gjuhën e babait që baba nuk është. Po edhe me celulën s'kishte shkuar deri në fund. Si baba ai qe munduar të shpjegonte jetën mbi tokë me amëshimin. Besimi i ri ku kishte hyrë nisej nga e kundërta. Ai ishte gati të bashkohej edhe me këtë shpjegim. Po fshehtas vetes, në atë baba Merxhanin që banonte ende në pjesën e dytë të tij, ai besonte në pavdekësinë e shpirtit. Nuk hiqte dorë edhe nga mësimi i vjetër se vetë njeriu është pasqyrimi i botës e i krijimit. Deri ku pajtohej ajo që pranonte me gjithë qejf me mendje me të tilla ndjesi të thella të shpirtit? Ky ishte një turbullim që prapë do të mbetej mbuluar. Po, më në fund, asnjëri nuk i bënte pyetje të tilla. Çdo gjë ecte drejt jetës së re. Kjo kishte rëndësi. Askush, asnjë fuqi s'mund t'i kthente prapa, jo ditët, po as orët që kalonin. Mbetej për t'u parë vetëm një gjë: ç'do të bëheshin aty e prapa teqetë e baballarët. Babai i nënqeshi vetes, fatit të tij të veçantë. Ai do të priste e do të vrojtonte, duke mbajtur taçin, mjekrën dhe gurin e kaltër. Po do të vinte dita që të shpëtonte prej tyre. Veçse a do të arrijë të jetë një njeri i tëri i ri i dalë prej njeriut të vjetër? Cili ka mundur të lindë dy herë në kuptimin e vërtetë të fjalës? Si mundet njeriu që në një datë të caktuar të fshijë çdo gjë që ka jetuar e të nisë nga e para?

Në qetësinë e thellë të natës, po ngjiste shkallët Leka, komisari i batalionit. Njiheshin hapat e tij prej këmbës së majtë që i mëshonte më fort. Ishte plagosur në Tiranë, në bulevard, duke u ndodhur ndërmjet dy bajraktarëve që qëlloheshin me kobure. Bir qymyrxhiu, kishte mbaruar Liceun e Korçës, duke punuar qymyrxhi edhe vetë. Kockë e fortë, me sytë pishë. Sikur ky komunist të kuptonte më mirë fshatarin, babai do të qe mjaft i kënaqur me të. Ky që ditën e parë u kishte dhënë dorën të gjithëve në batalion duke kaluar me të njëjtin mendim para çdo fytyre. Kurse jeta ata i ka gdhendur njëlloj, po secili qëndron më vete. Ky nuk falte «shkelje të disiplinës proletare». I kishte hequr pushkën një partizani për pije para batalionit. Por një markeshas s'mund të gjykohet nga veset e lehta dhe as të zhvishet prej tyre si kalliri i misrit. Duhet të jesh markeshas që ta dish këtë.

Komisari u ul në qoshen tjetër të oxhakut, i zymtë e i lodhur.

— Reaksionin duhet ta nxjerrim prej çerdheve të veta, — tha.

Babai ndezi çibukun prej qelibari me pipëz argjendi dhe pyeti:

— Ç'të bëjmë me ta pasi t'i nxjerrim?

Komisari ngriti fytyrën e zeshkët. Dukej se qe zemëruar me diçka, që e kishte bluar në mendjen e vet.

— T'i demaskojmë. Të mbledhim popullin, — tha, duke vënë pëllëmbën e dorës kllëç mbi vatër.

Babai mendoj se komisari nuk e dinte punën. Nuk i njihte Rat. Mëdyshin me shokë. Rati ishte gjarpër, më dinaku i kafshëve të pyllit, që del prej errësirës kur ka kohën, me synim të qartë e me një dëshirë të zgjatur dhe vepron sipas tokës. Pastaj, si ta ketë derdhur helmin, kthehet në vrimën prej nga ka dalë, me trupin të ftohtë, me dëshirën të plotësuar, duke mbledhur aty brenda vrerin për daljen tjetër.

— Çfarë do t'u themi? — pyeti babai.

— Si çfarë! T'u hedhim në fytyrë tradhtinë.

— Cilën tradhti?

Komisari po e shihte me gojën gjysmëhapët. Kishte për të thënë shumë dhe asgjë.

— Ata s'kanë dalë hapët, — tha babai. — Nuk lidhet me duart e tij Rat Mëdyshi. E grisi faqe njerëzve kartën e itifakut, bëri fajtor Bedriun, atë cjamin... dhe qeverinë. Dhe armët kundër nesh nuk i kanë marrë.

Komisari merrte frymë me zor, me fytyrën e zeshkët të mprehtë.

— Këtë do ta shtroj në celulë, — tha.

Ata bënin pjesë në të njëjtën dhe të vetmen celulë prej katër vetash dhe që të dy ende vijonin të mbeteshin disi të huaj për njëri-tjetrin. Babai përpiquej të gjente pikat e afrimit, ashtu siç bënte nga ana e tij komisari me durim, me ngulm. Veçse ky nuk e fshih-te dot dyshimin, mllefin që i ngrihej në shpirt, kur babai merrte në mbrojtje ndonjërin që duhej ndëshkuar rëndë.

— Do të vijë dita që t'i thërrasim në mbledhje Rat Mëdyshin me shokë, — tha babai. Tani duhet të shkëputim prej tyre disa njerëz të gabuar. Si thua ti?

Komisari uli kokën dhe tha:

— Më prishi gjakun ai Rat Mëdyshi.

— Paske folur me të?

— I thashë se me të nuk merrem vesh, po dua të flas me njerëzit e tij. Më ftoi për darkë.

Babai nënqeshi dhe tha:

— Kam qenë edhe vetë në atë kullë vite të shkuara. Ki mendjen prej gjellës që do të të vënë përpara, po qe se shkon.

Komisari zuri të hapte çantën, me ato lëvizjet e vëmendshme, sikur aty brenda të mbante gjëra që i takonin vetëm punës së tij. Me të njëjtën vëmendje

shihte hera-herës edhe babanë, ia kishte frikën karakterit të tij.

XI

Leka u fliste fshatarëve që kishin zbritur aty më fort të plaçkisnin ndonjë gjë të lënë nga armiku. Rahmani mblidhte kompanitë. Baba Merxhani ecte përmes sheshit, duke parë dy kazermat dhe komandën me muret e çatitë laramane. Maskoheshin nga aeroplanët, kurse atyre nuk u kishte ardhur ndonjë e keqe nga qielli. Në muret dukeshin shenjat e freskëta të plumbave. Ishin mbrojtur fort që nga dritaret e ngushta e afër shtrehëve dhe në hendeqet e gurta rreth sheshit. Një armik që kishte nxjerrë mësim. Fitorja ishte e bukur, se garnizoni i Qafmollës mbante nën hijen e vet luginën, mbronte rrugën e minierës. Veçse garnizoni shpëtoi në orën e fundit. Babai filloi të ndiente lodhje e njëfarë hidhërimi, eci drejt aspirantit, që rrinte te shtylla e flamurit. Kur pa babanë, aspiranti u çua, i lëvizi njëra anë e mustaqes, i qeshi buza, si njeriut që s'i ka mendtë në rregull. Babai kishte folur me të në mbrëmje, në të errët. Tani po e shihte në dritën e diellit, të veshur e të mbathur.

Aspiranti ishte si i dalë prej kutie. Një javë më parë qe shpallur krijimi i xhandarmërisë shqiptare prej 8 200 vetash. Po uniformat e reja ishin gatitur më parë, me gushën e kuqe dhe stemën e bardhë të Skënderbeut në kapelë. Këto kishin qenë edhe katër vjet të shkuara dhe po dilnin përsëri në shesh në prillin e vitit 1943. E re ishte vetëm grada e aspirantit me yllin me gjashtë cepa. Dhe ky aspirant Sheremeti, që

bëri pushkë natën e shkuar prej shtëpisë ndanë fshatit, ishte krejt i ri në veshje dhe pak i thyer në moshë, i thinjur. Do të ishte një pushkatim i bukur, po Rahmani i kishte premtuar jetën, para se të hidhte armën. Ky gabim ishte bërë në të errët dhe me shpresë të mos përhapej alarmi, se nuk i falej jeta një oficeri të xhandarmërisë. Babai ndenji para tij duke e parë me kujdes, siç shihet në një pus ku duhet të lëvrijë diçka.

Ja, ky goxha aspirant. Meqë ka arritur një moshë të pjekur, është koha të kuptohet ç'lloj njeriu është. Mirëpo, nga fytyra e tij e madhe nuk kuptohet gjë. Kur e sheh anash, duket si fytyra e një burri të mërzi-tur. Pastaj ai pulit sytë, lëviz flegrat e hundës dhe atëherë ngjet si fytyra e një kali budalla. Duket sikur s'ka qenë ndonjëherë më i ri dhe as do të bëhet më i vjetër, një i lindur aspirant, që çon jetë të bukur, ushqehet me gjëra të mira që nuk i takojnë gjithkujt, në sytë gri, të skuqur, ka atë përgjimin e xhandarit, që dremit tërë kohën brenda tij. Tani mendohej si i hutuar, si i goditur në kokë, për diçka rreth tij që nuk ishte bërë mirë, duke ia përgënjeshtruar shpresat. Këtë mendim përpiquej ta fshihte me anë të buzëqeshjes, gjë që e habiste babanë. Se nuk është në natyrën e kujave të qeshin. Asnjë krijesë e gjallë s'mund të qeshë veç njeriut. Druri djersin po të goditet, kafsha ulërin e hingëllin prej dhimbjes e urisë, për të qeshur qesh vetëm njeriu.

Aspiranti u kthye ndaj babait, si për ta mbuluar me trup për një gjë të fshehtë, lëvizi buzët e tha «ejvallah, nazari», vuri dorën në zemër me dy gishtërinjtë e mbyllur. Babai u rrëqeth e u mpi. Aspiranti qenkësh myhib. Prandaj buzëqeshte. Këtë e vërtetoi edhe më tej, kur foli nën zë:

— Në pastë një shpirt vëllai që ankohet... le të vijë... le të flasë...

— Ankohet i gjithë besimi, — u përgjigj babai. Zëri i vet iu duk i vjetër e i shurdhët, ishte ndezur qiriri i Aliut në mes të ditës.

— Secili hyn në gjynah i shtyrë nga diçka. Po ai prej Horasanit që mungon i sheh të gjitha, — tha aspiranti.

Ky nuk qenkësh një kalë budalla. Ky paskësh qenë stolia e teqesë së tij, diku në Jug. Një major i ushtrisë kishte qenë myhib në Teqenë e Madhe. Edhe sekretari i prefekturës. Ashtu si edhe njerëzit e varfër. Dhe secili prej tyre mund të mos u përmbahej dhjetë mësimëve dhe prapë të mbetej në tarik. Se thoshte ai mësimi tjetër, jashtë dhe përtej mësimi: «S'mund ta hedhësh fëmijën në det dhe ta rrahësh se lagu rrobat!» Këtë burrë deti i jetës e kishte nxjerrë aspirant. Kurse atë vetë, Merxhan Dalipin, baba teqeje. Për një kohë babai ndenji heshtur në krah të tij, si shokë të së njëjtës rrugë, të gjatë e të panjohur. Po pak nga pak zuri të kthehej në veten, të dilte nga kllapia. Në mbrëmje Leka e kishte marrë në pyetje aspirantin, kishte nisur t'i fliste për luftën. «Këtij nuk i flitet për gjëra të tilla», — kishte ndërhyrë Rahmani. Babai mendoi se Rahmani kishte të drejtë. S'mund të flasësh për popullin me vend e pa vend dhe me këdo. Dhe sa për këtë aspirant Sheremetin, duket se ky çdo punë që të jetë, do ta bëjë me mendjen e tij prej aspiranti, çdo gjë do ta kullojë e do ta thotë sipas gjuhës së vet që nuk ndryshon kurrë, paçka se mund të jetë edhe myhib. T'i shpjegosh këtij, është si t'i drejtohesh një muri a një kali. Mbetet vetëm një shteg për t'u marrë vesh me të, me anë të plumbit. Tani babait i qe kthyer e plotë urrejtja e mbledhur në vite për graduatët e xhandarmërisë. Megjithatë donte të mendohej. Vërtet s'ka për ta rrugë tjetër? Kjo luftë kishte ndryshuar jetën e shumëkujt. Një baba teqeje bëhet komu-

nist, një student, komisar; Rahmani, një bari e marke-shas i vjetër, del e bëhet komandant batalioni. Shumëkush ndryshon në këtë luftë, kthehet e bëhet diçka që mund t'i shkojë për shtat. Qoftë edhe një xhandar. Ama zor se mund të ndryshojë një aspirant. Ngado që të vejë, ai aspirant do të mbetet brenda vetes. Deri ku është e vërtetë kjo?

Fytyra e gjatë e aspirantit filloi të zbutej e të zbehej. Ai po shihte në sytë e babait të ngulur aty përpara në dëshirë të fortë, një betim, që ai, aspiranti, të mos jetë fare në faqe të dheut e të zhdukej krejt çdo gjë që lidhet me të. Kjo po e hutonte dhe e ligështonte nga brenda. «Vërtet ashtu e mendon nazari? — pyesnin sytë e tij. — Mos vallë ndërroni e nuk e mbani fjalën?» Edhe një çast dhe ai mund të zinte të qante për turp, alamet burri, dukej prej syve të tij të mbushur.

«Hëm, ti nuk di gjë, veç lëkurës sate, uniformës dhe rogës. As besën e myhibit nuk e ke, as atë. A mund të jetë njeriu i tillë?»

Babai iu soll rrotull ngadalë, si për ta parë nga të gjitha anët, zuri të mendonte se njeriu mund të ishte edhe kështu, frikacak, i egër, i poshtër, tradhtar, dhe prapë të merrte frymë, bile të krekosej ose të lutej, sipas rastit. Babait po i rëndonte në trup e tërë jeta e vet e shkuar. Po u ngulit edhe një herë para aspirantit, s'kishte fuqi të shkëputej pa zgjidhur atë çështjen me rëndësi që kishte në mendje. Donte të shihte më tej, të kuptonte, nëse njeriu mund të jetë i tëri i kalbur e pa shpresë.

Aspirantit iu frynë damarët në tëmtha, iu nxi fytyra e iu drodh buza, i shkoi një lot dhe fshiu me pëllëmbën e dorës njëren anë të hundës. Babai e pa me zemrën të ngrirë dhe me neveri. Një fytyrë kali që për lotet edhe mund të pranohet. I foli nën zë e si duke i qarë hallin:

— Kush i shërben armikut, e lan me lot paren dhe rrobën e tij. Loti nuk ta lehtëson shpirtin. Edhe ai prej Horasanit që mungon, nuk të njeh. Nëse ti e njeh atë.

— Çfarë the, nazari? — Aspirantit iu hodh gjoksi, po e përmbajti ngashërimin, se fyerja i depërtoi në kokë, i flakërinë sytë e kërciti dhëmbët, dukej se edhe mund t'ia plaste gazit, ose t'i thoshte një sharje, hapi gojën dhe tha vetëm gjysmë fraze: — Nazari qenke...

Babai ngriti kokën e mbajti frymën, siç bënte kur shihte diçka të beftë e të habitshme. Tani po shihte atë që kishte pasur tërë kohën para syve dhe s'e kishte parë. Jo frika, po turpi e hidhërimi paskëshin qenë ndjenjat që zotëronin aspirantin. Babait iu duk sikur ndriçoi ajo fije që ka lidhur këtë aspirant me jetën e me njerëzit para se të bëhej aspirant. Një kthim i tij në jetën e drejtë, përmes kësaj fijeje të holluar nga koha, mbase ishte ende i mundur. Ky mendim, kjo fije shprese, erdhi u trazua në shpirtin e babait me një thirrje të lashtë. «Çdo njeri e ka një nder. Deri aty e mos ec më tej, — tha me vete, duke lëvizur buzët. — Dhe po të jetë... burrit duhet t'i jepet vdekja më këmbë, pa poshtërim.» Duhej të ndreqte gabimin. Vuri dorën te zemra, po nuk i foli myhibit, i foli njeriut:

— Të kemi premtuar jetën. Përdore me nder tani e prapa, mor burrë. — I ktheu krahët dhe shkoi të përshëndetej me batalionin, që do të nisej për një marshim të largët.

XII

Fshatrat e largëta dukeshin të mbyllura e pa jetë. Nuk dëgjohej tjetër veç heshtjes së thellë të maleve, që ngjanin si të djegura nga një zjarr i madh, duke

lënë prapa një hi të përjetshëm. Kjo ishte Gollërta.

Batalioni hyri në këtë luginë pas një marshimi dy-mbëdhjetorësh. Përpara shkante komiti me trupin e shkurtër të shëndetshshëm dhe pas tij Leka, komisari.

Komiti qëndroi në vend, tregoi luginën dhe tha:

— Këtu sundon itifaku.

— Çfarë? — pyeti komisari.

Komiti ktheu fytyrën rrumbullake ngadalë. Sytë e tij kishin një bardhësi që të sillte shqetësim, të djath-tin pak të mbyllur, si të vëngër. Shpjegoi shkurt, kur dhe si u bë itifaku. Dukej se kjo e kishte hidhëruar, e kishte hedhur atë vetë dhe njerëzit e tij jashtë kra-hinës.

Në mendjen e komisarit itifaku mori formën e një qeni të tërbuar që mund të hidhej papritur mbi ba-talionin.

Komiti nënqeshi dhe tha:

— Këtej kanë kaluar edhe më parë shokët tuaj. Populli u ka dhënë bukë.

Tani ata duhej të bisedonin dhe u hoqën më tej me Rahmanin e u ulën nën hijen e një gorrice.

— A keni ardhur për të hapur luftë? — pyeti ko-miti.

Më parë le të sqarohemi, — tha komisari.

Ai po mendonte se njerëz si komiti duheshin tër-hequr. Po ky ishte një rast i rrallë, i pandeshur më pa-rë, dhe s'dinte nga ta niste bisedën. Komisari po shihte luginën. Gurët e Gollërtës nxeheshin në diell me një shkëlqim të dyshimtë, qielli i lartë ishte i veshur me një napë mjegulle të hollë që shtonte zagushinë. Lugina vijonte të dukej e zbrazët, pa një lëvizje, pa një tin-gull, po aty nga çasti në çast mund të gjëmonin dau-llet e itifakut, duke e kthyer luginën në një kabanë për të ngritur fshatrat kundër forcës së huaj që po hynte.

— Lufta jonë është e gjithë popullit, — tha komisari. Komiti vijoi ta shihte me syrin e vëngër.

— Kabineti i Bushatit ra. Erdhi në fuqi kukulla tjetër, Eqerem Libohova, — tha komisari. — Fejzi Ali-zoti i kohës së Turqisë u bë kryetar i Këshillit Epror Fashist. E shpallën kombin në rrezik.

— Po, tha komiti. — Gazetat.

Komisari 'nënqeshi. Gazetat kishin nisur një fu-shatë kundër arixhinjve që hanin fëmijët. I tërhiqnin me karamete dhe i piqnin. Gjashtë fëmijë në Shkodër, disa fëmijë në Korçë. Nuk jepeshin emrat, gjë që pro-vonte shpifjen. Një hollësi e tillë mund të mos vihej re dhe mbi një pjesë të njerëzve ra rrëqethja, si një grip që zgjat vetëm dy ditë. Javën tjetër u dukën artikujt kundër invazionit çifut në Shqipëri. «Kombi në rrezik.»

— Pse po qesh? — pyeti komiti.

Komisari u përmend. Zëri i ulët dhe i befasishëm i komitetit i jehoi në veshë.

— Duan të çoroditin popullin, — tha.

— E di, — tha komiti.

— Shpërndajnë dekorata, bëjnë 'emërime, shtojnë ballot. Si zbukurimet që i bëhen të sëmurit para vde-kjes, — tha komisari, duke menduar se gjëra të tilla mund të ishin joshëse, për të hedhur një komit nga ana e armikut.

— Kemi dëgjuar, — tha komiti.

Komisari po e shihte me habi. Ky njeri, me fytyrën rumbullake të heshtur, me sytë e bardhë që i shkël-qenin, dinte çdo gjë. Ose hiqej se i dinte. Komisari nuk ishte dhe aq i sigurt nëse duhej të fliste me të për qëllimet e batalionit të dërguar aty prej çarkorit. Ky komit bridhte me çetën prej njëmbëdhjetë vetash në zonën asnjane të luftës. Po a mund të ekzistojë

një zonë e tillë? Veçse baba Merxhani kishte këmbyer letra me komitin. Puna e tij duhej sqaruar.

— Pra këtu ka sunduar reaksioni? — tha komisari.

— Deri në njëfarë vendi, — tha komiti.

Kjo u duk si një frazë tepër e gjatë, komisari ndjeu se s'kishte më gjë për të thënë dhe u kthye nga Rahmani duke e pyetur me sy. Rahmani vijoi të heshte. E kishte ndjekur bisedën me trupin të ndehur, me rrudhat në ballë. Për të parën herë po shkonte me batalionin në vise të largëta e në luftime pa baba Merxhanin. Nuk donte kurrsesi që të ndodhte aty në Gollërtë si në Qafmollë, ku u nda me një fitore të dyshimtë për shkak të aspirantit. Kurse edhe komiti paskësh qenë oficer në ushtrinë e vjetër. Rahmani zuri të merrte frymë ngadalë e me vështirësi, me një shpresë se ky ish-oficer, që njihte vendin, duhej të kishte kuptuar diçka gjatë viteve të arratisë dhe tani anonte nga e mira, duke e ndihur batalionin.

Komiti po mendohej. Nuk qe trazuar me itifakun, as me armikun. Po as me komunistët nuk donte të shkonte, për shkak të bashkëpunimit me partizanët jugosllavë. Se serbët i kishin vrarë gjyshin dhe babanë. Ai vetë mbante në kraharor një plagë prej serbit, nga e cila nuk do të shërohej kurrë. Atë ditë qe çuar herët. Mbi malin e Koritës qe ngritur një çerek hëne e dobët, në kufirin ndërmjet natës dhe agimit. Si bëri një copë rrugë, e kishte ndier zemrën të lehtë. Në turbullirën që përfshinte krahinën dhe tërë vendin, ai ishte mbajtur si një pikë e thatë më vete. Por ishte tepër i vogël që të sajonte një zonë asnjëse. «Kush je ti që ke dalë i vetëm në rrugën time? Hej! Kundër kujt i ke marrë armët!» Kjo pyetje do të vinte prej njëres nga palët dhe ai duhej ta kishte përgjigjen gatë. Ai kishte ardhur aty të lidhte miqësi me baba Merxhanin. Po tani që ndodhej para njerëzve të tij,

që shihte yjet e kuqe dhe komisarët, përsëri e kapi dëshpërimi. Po ndofta tani ishte vonë të tërhiqej.

— Në cilën anë mendon se duhet bërë aksioni? — pyeti komisari.

Komiti u rrëqeth. «Në cilën anë?» Ai u përmend dhe tha:

— Në Urën e Dreçokut.

Batalioni u vu në rrugë, hyri brenda luginës. U afruan fshatrat, ndërtuar me gurë e mbuluar me pllaka. Ishin fshatra të bukura, të mbledhura, dhe në dimër lugina e qethur mbante dëborë, si në Markesh. Po tani bënte tepër nxehtë, për shkak të gurit. Ky vend nxirte muratorë që shkonin deri në Selanik e Stamboll, pa e ndryshuar të folmen e rëndë, që i ngjante ngritjes së murit me gurë e llaç. Gratë punonin arat e pjerrëta të gërryera dhe gatuanin bukën e thekrës.

Duke ecur në tokën e pasigurt, komisari shihte zverkun e komitetit, trupin e tij të shkurtër e të ngjeshur. Ky s'mund të kishte ngritur një kurth. Sidoqoftë komisari do të ecte pas tij dhe duke parë përtej kokës së tij rumbullake. Nga fshati i parë erdhën shenjat e miqësisë. Dolën fëmijët sipër rrugës, duke shikuar që përtej gardheve. Lugina po i buzëqeshte me druajtje batalionit.

* * *

Afër agimit batalioni kaloi fshatin Dreçok, zbriti shkallën e Dreçokut dhe u ndal tek Ura e Dreçokut. Kur u hap drita, markeshasit panë se shkalla që kaluan në errësirë ishte më e frikshme se Shkalla e Balit. Batalioni dhe çeta e komitetit u hapën në rrëpirën me gurë e shkëmbinj, nëpër të cilët rritej mullezë e rralle. Poshtë ishte xhadeja me pluhur dhe më poshtë Dri-

ni i Zi, i thellë, i errët. Tek ura lumi derdhej me zhurmë buçitëse, pastaj vinte e shtrohej dhe sajonte hinka në sipërfaqe. Në breg dridheshin fijet e holla të barit të thatë. Në të djathtë pikonin shkëmbinj të e lartë, të errët, që rrethonin vendin. Pritë më e mirë s'mund të gjendej. Rahmani i vuri dorën në sup me falënderim komitetit. «Kot ke munguar, or vëlla. Ti s'mund të jesh veç me anën e mirë», — thoshin sytë e tij. Komiti shihte me kureshtje këtë burrë trupmadh e të heshtur, që i gjente aq bukur pozicionet dhe ecte pas tij duke u menduar.

Tri orë më pas erdhi autokolona me zhurmë të largët, e mbështjellë në pluhurin e vet, dhe hyri në pritë ngadalë, po pa ngurrim. Ishin dhjetë makina, që udhëtonin pa mbrojtje, sepse ajo rrugë që vinte nga përtej kufirit kishte qenë e sigurt dhe e qetë. Autokolona u ndal dhe mbi të krisi plumbi me vërshëllimë metalike. Kamionët zunë të silleshin në vend në rruqen e ngushtë, që të ktheheshin prapa, ose të hynin pas ndonjë bregu. Po nuk bënë tjetër veç shtonin zallahinë e panikun. Kjo ishte një grackë pa dalje, një përpëlitje. Disa nga ushtarët kërkuan shpëtim në lumë, aty ku uji vërtitej duke sajuar hinka, po as notarët e zotë nuk arritën të dilnin në bregun tjetër, sepse plumbi i kridhte poshtë.

U kapën shtatëdhjetë ushtarë. U mblodhën armët, iu vu zjarri kamionëve. Komisari po i shkruante qarkorrit me ngulm e përqendrim se Gollërta mund të lidhej shpejt me luftën. Veçse aty mungonte puna e Partisë, kurse komiti ndofta e kundërshtonte itifakun për armiqësi fisnore. Rahmani mblidhte frymën, me shpirtin të turbulluar e të mallëngjyer. Batalioni kishte dalë nga gryka e nxehtë vetëm me nja dy të fshikulluara, kurse tek ura kishin mbetur tridhjetë armiq të vrarë. Rahmani shikoi tej në hapësirën e perën-

dimit, si i kujtuar befas për diçka të shtrenjtë e të madhe të lënë në mesin e rrugës. Kërkonte me sy dy kreshtat e Markeshit. Kishte dalë andej para dhjetë ditësh, më përgjegjësinë e batalionit mbi supet e veta.

XIII

Bihane Sallku nga lagjja «Qytezë» punonte në arë kur dëgjoi të vinte prej Balit një gumëzhitje si ë një blete të madhe. Ajo kuptoi se gumëzhitja vinte nga qielli dhe e kërkoi aeroplanin me dorën si strehë mbi sy. Aeroplani po çante me krahët e mprehtë drejt Kreshtës së Madhe, i zi, i rëndë e i fuqishëm, si shpirt i zemëruar i qiellit; u kthye rreth majave dhe erdhi drejt Denës. Bihanes iu bë se aeroplani qëndroi në ajër. Ajo fshiu sytë që i lotonin. Ushtoi një zhurmë sikur do të përmysej dheu. Aeroplani po vinte drejt saj. Mendimi i parë i gruas ishte të vraponte. Po aeroplani u afrua befas, duke kërkuar me turirin e shtypur dhe prej andej lëshoi diçka të kobshme. Tani dukej si një akrep i tmerrshëm që zuri të rrihte tokën me plumb të madh, me saktësi të rrufeshme, sikur ngulte gozhdë që asnjëri nuk do t'i shkulte më prej andej. Ky akrep do t'i prishte shtëpinë e do t'i përmbyste arën. Të gjitha këto po kalonin në mendjen e saj me shpejtësi po edhe qartë, sikur të qe ndalur koha. Në çastin tjetër, kur aeroplani erdhi drejt mbi të, duke folur atë gjuhën e vet me krisma shurdhuese, gruas i gufoi papritur zemra, iu bë se aeroplani do ta merrte me vete, po ai i zuri frymën dhe Bihania nuk pa asgjë, se u fshi dielli, ajo ra në errësi të thellë dhe shkoi po-

shtë si në humnerë, me lopatën në duar, me trupin si lëng i nxehtë.

Fshatarët e gjetën Bihanen të vdekur, me fytyrën në dheun e shkrifët, me një gropë të madhe në bark. Ajo grua e vogël e vjetër, paskësh pasur tërë atë gjak, që i dilte nën trup, mblidhej pellg dhe piksej shpejt me tokën. Nuk duhej prekur, se ishte krejt e dërrmuar dhe, po ta lëvizte, mund t'i shqiteshin gjymtyrët. Fshatarët po rrinin me fytyrat e hidhëruara e të heshtura, si para një mëkati të rëndë, që duhej parë gjatë. Askush s'mund të gjente një shkak sado të vogël që të përlijte në mendjen e njeriut këtë vdekje. Po vdekja e saj solli një dobi, se fshatarët mësuan t'u ruheshin aeroplanëve. Ata vinin tani në çdo dy-tri ditë, duke e mbajtur të hapur luftën me Markeshin nga qielli. Kur largoheshin, pasonte një heshtje e shkurtër. «Hej! A u vra kush!» Nuk ishte vrarë asnjëri. Si erdhën aeroplanët disa herë, fshatarët nuk bëheshin më merak. Mjafton të futeshe diku me gjithë fëmijë, të mos lëvizte, me fytyrën nga dheu.

Baba Merxhani po kthehej në Qytezë me dy skuadra dhe ndaloi te Bregu i Kacorrit duke parë me përmasim sheshin «Belik». Po habitej që aty nuk lëvizte kush prej batalionit, as ndonjë fshatar. Habia e tij zgjati fare pak se dëgjoi gumëzhitjen e njohur që vinte prej qiellit. Aeroplanët ishin dy, shkonin çift dhe u dukën në hapësirën e Qafës së Murlanit. Prej andej u lëshuan njëri pas tjetrit teposhtë, hodhën mbi Gjin bomba që gjëmuan rëndë e ngritën tym të zi, u kthyen sipër Balit dhe bënë të njëjtën rrugë të lumit. Babait iu turbullua gjaku, po i kruhej mjekra fort. Aeroplanët zbritën e u ngritën lart, sikur të laheshin në qiell, duke kërkuar gjahun me ngulm, një lëvizje çfarëdo në brigjet e lumit.

— Silleni antitankun, — tha babai. Mori në dorë fi-

shkët e mëdhenj, të rëndë. E vendosi armën mbi shkëmb dhe e mbushi. Po i thahej goja, si i munduar nga një etje e madhe, shihte me një qartësi të habitshme dhe i bënte lëvizjet të sakta, me një bindje të egër se do t'i digjte aeroplanët njërin pas tjetrit, tamam sipër Qytezës, dhe mati me sy vendin ku do të binin, te mulliri i Balit, me turinj të në lumë. Nga padurimi shtrëngoi nofullat dhe priti të dilnin nga ana e Dënës. Një dëshirë kaq të madhe për të arritur diçka s'e kishte provuar kurrë në jetë, atë çast do të falte njërin krah e njërin sy që të godiste drejt në kabinat e pilotëve. Kur i pa, të hirtë, ushtues e të mëdhenj, i drodh zemra, mendja i punonte me ngut duke kërkuar kohën dhe pikën. U duk sikur prej furisë së tyre po përkuleshin majat e pishave. Ata u zmadhuan edhe më tepër dhe ndritën në diell. Babai shtiu, me një rënkim, me një britmë sikur do t'i shkulej shpirti. Sprapsja e armës i shembi supin, i luajti shpatullën vendit, po ai nuk ndiente asgjë, veç urrejtjes, dhe shtiu dy herë të tjera. Aeroplanët u zvogëluan me shpejtësi, ndoqën rrjedhën e lumit. Babai e shikoi antitankun me hidhërim, e la në vend dhe zbriti në rrugë. Partizanët dolën nga pishat dhe po rrinin heshtur, me fytyrat e mprehta e të humbura, pa ngritur sytë.

— Janë prej alumini, dreji i marrtë, — tha njëri, duke dashur të ndihmonte babanë.

Babai merrte frymë me zor, çoi kokën si për të li-ruar grykën dhe foli me mllef:

— Po ç'është alumini, mor budalla i shkretë? — Shkoi te mushka, nënqeshi me zor dhe tha: — Alumini është teneqe e butë. Ja, si gaveta që ke pas bythës.

Aty e prapa, çdo fshatar që kishte pushkë, do të shtinte kur aeroplanët të fluturonin ultas. Një ditë u duk sikur një aeroplan po nxirrte tym në bisht tek ikte përtej Qafës së Murlanit. Kjo u ndezi gjakun fshata-

rëve dhe ëndërronin rrëzimin e një aeroplani si prenë më të madhe që mund t'u binte në duar.

XIV

Rahmani kishte vënë rojë te shtëpia e teqesë ku banonte baba Merxhani, kryetar i këshillit të Frontit Nacionalçlirimtar dhe komandant i shtabit të qarkut. Rojë po bënte Muharremi, buzë rrugës, këmbëkryq, me tytën e pushkës mbështetur në sup. Vërshëllente një këngë, ndërsa punonte me thikë një lugë druri. Një fshatar hipur në mushkë ndaloi dhe e pyeti diçka, duke treguar me kokë shtëpinë e teqesë, Muharremi shtrembëroi mjekrën dhe i bëri shenjë të prerë me dorë të vijonte rrugën. U çua, eci poshtë-lart, si patrullë, duke menduar se jo çdo njeri i ngeshëm mund të kthehej te baba Merxhani për bisedë.

Ali Çela i çoi babait kafën, që e bënte Nabija në kuzhinë. Aliu u tërhoq pa folur, duke i buzëqeshur vetes. Prapë po i shërbente babait, po me një sjellje që t'i përshtatej gjendjes së re, që kërkonte heshtje, kuptim e veprim të shpejtë. Se tani babai shkruan letra me rëndësi, tek ai vijonë njerëz nga vise të largëta. Kurse nesër do të thërresë në një mbledhje të madhe popullin e Markeshit, për një punë që rri në mendjen e gjithkujt dhe flitet në çdo vatër.

Babai mendohej si në vetmi të thellë. Kafën që po pinte, ia kishte dërguar kohë më parë Tomori, sekretari politik me pamje mësuesi, që u bë luan, u vra me koburen në dorë tek deshi të çante, kur armiku rrethoi lagjen dhe bazën e qarkorit. Sekretar politik ishte bërë Murat Poda. «Partia ka nevojë për

figurën e një kleriku dhe më bën mua kryetar të qarkut, komandant të shtabit të zonës», — kishte thënë babai. Murat Poda e kishte parë me kujdes, duke ia mbajtur duart te supet. «Shtatullat i ke mirë, — i kishte thënë. — Dhe këtë mbaje më drejt. — I kishte rregulluar taçin në kokë. — Dhe shkruaj ato letrat për teqetë, edhe thirrjen», — i kishte thënë, duke e puthur befasisht në buzë.

Prindi i teqesë së Markeshit i shkruan baba Qazimit në Kosovë, duke e lutur që nazari të jetë një nga shokët e Çlirimit Nacional. I shkruan edhe shehut të Prizrenit, i thotë se merr guximin t'i drejtohet, megjithëse nuk njihen, po ata i bashkon feja, sidomos gjaku e gjuha, prandaj i bën thirrje hirësisë së tij që të jetë një nga anëtarët e shquar të luftës. Me të njëjtën gjuhë të butë e të lëmuar i shkruan shehut në Dibër të Madhe. Ai kthehet t'i shohë letrat edhe një herë, me kujdes e përgjërëm, se janë për në vendin e vëllait që ka hequr më keq. Letrat janë në rregull, me fjalë të dala nga zemra. «Me shumë nderim, prindi i teqesë së Markeshit»

Veçse, me dy teqetë e djegura dhe me yllin e kuq në anën e majtë të gjoksit, a mund të jetë ai në sytë e tyre prind i Markeshit?

Ai u lutet pa zë që të kuptojnë, me letrat në duar, dhe në këtë lutje e sipër do t'u tregojë për veten e tij, po tani s'është rasti. Do të vijë koha që t'u tregojë. Tani do të hartojë një thirrje që i drejton ai vetë popullit të Kosovës. Këtë Partia do ta shumëfishojë dhe ajo do të shpërndahet bashkë me komunikata të tjera në qytetet e fshatrat e pllajës së madhe. Ai kapërdihet ndërsa shkruan për popullin martir. Një rreth i nxehët ia shtrëngon zemrën dhe kupton se po qan kur sheh pikën e lotit mbi letër.

Ali Çela hyri fshehtas, solli kafënë e dytë. Këtë

babai e kuptoi vetëm kur pa filxhanin para tij dhe ndjeu avullin e këndshëm. U rrëqeth e ndenji në përgjim, mbajti vesh zërat, zhurmat e lehta që vinin nga dritarja e hapur. I dukej se diçka e rrezikshme sillej në ajrin e nxehtë.

Dervish Lala i vjetër kishte ndërtuar një strehë tek ashefi i teqesë së djegur, Baba Merxhani vendosi ta shih-te më në fund. S'kishte shkelur në teqe nga dita kur doli prej andej përgjithnjë. Mbase teqeja në Qytezë duhej mbajtur hapur në njëfarë mënyre, e djegur siç ishte.

Babai zuri të ngjiste të përpjetën e vështirë të Shkëmbit të Plakës. Në prrallet këndonin me ngulm gjinkallat. Dielli i fortë shkëlqente mbi gurët, babait po i shkonte djersë dhe u ndal te shtegu të merrte frymë. Ngriti kokën dhe një dritë e fortë e detyroi të mbyllte sytë. Kur i hapi, pa pesë metra më tej, ndanë shkëmbit, një dede me hirkën prej leshi të bardhë, me dollomanë me vija mavi. Ishte pa mjekër, me sytë e mëdhenj blu të ftohtë, që mund të ndërronin ngjyrë sipas rastit. Po të kishte mjekër, do t'i ngjante imam Hysenit. Rrinte si i lodhur e mospërfillës. Po në të njëjtën kohë ishte tepër i vëmendshëm dhe aspak i lodhur. Vinte i paprekur që nga kohët e lashta. Shikonte veshjet e armët e baba Merxhanit dhe qëndroi sytë te taçi me rrethin jeshil, te guri në brez dhe lëvizi njërën anë të buzës e ndofta kërciti dhëmbët, si për të thënë me një gëzim ku trazohej edhe hidhërimi i thellë, se këto ishin shenjat e tyre të përbashkëta, që baba Merxhani duhej t'i mbante përjetë, siç mban i vdekuri gurin e varrit. Dedei lëvizi buzët vërtet, nënqeshja e tij e mprehtë, idhnake, u ngulit e u zgje-

rua sikur të pushtonte hapësirën dhe foli, pyeti ku ishin strehët e dëmtuara të Haxhi Bektash Veliut, murmuriti fjalë të tjera të qarta e të sakta, që prapë mbe-teshin të pakuptuara. Këto mund të ishin bekim a mallkim i rëndë, se u folën arabisht a në gjuhë tjetër, një frazë e gjatë që mbeti në avujt e diellit të fortë dhe u zhduk e u tret bashkë me figurën e dedeit.

Në njërën dorë babai mbante taçin dhe me tjetrën fshinte djersën nga zverku. Ky dede i qe shfaqur edhe në disa ëndrra. Tundi kokën dhe qeshi. «Kurse sot m'u shfaq në dritën e diellit ngaqë u shkrova pa pushim dedejeve e baballarëve», tha me vete. Pak më tej ndjeu se kishte diçka të gjallë e të vërtetë në figurën e dedeit, që kërkonte «strehët e dëmtuara», duke thënë atë frazën e gjatë të paralajmërimit.

* * *

Në mëngjes herët baba Merxhani kalonte ngadalë para kompanive me Lekën në krah. Në mbrëmje, në mbledhjen e celulës, Leka kishte thënë se në batalion mungonte kuadri politik dhe, pa u krijuar celulat e Partisë në çdo kompani, ai s'mund të quhej batalion. Fliste duke rrahur dorën kllëç mbi bllok, gati me zemërim. «Nga kush i kërkon ti këto?» — e kishte pyetur babai. Fjalët që këmbyen dukeshin pa faj, po mënyra si u folën i ngjante një grindjeje të keqe. Nikolla kishte mbetur i hutuar. Ky kishte ardhur në batalion me detyrën e zëvendëskomisarit dy javë të shkurara. «Do ta shohësh se ç'është, flori i kulluar», — i kishte thënë Murat Poda babait. Në dy javë e sipër Nikolla formoi një «aktiv» në batalion, propozoi pesë veta për në Parti. Këto dhe punë të tjera i bënte pa u ndier, duke i lënë njerëzit të habitur, sepse ishte

me trup të shkurtër, pothuaj topolak dhe dukej i ngathtët, sikur nuk bënte asgjë, veç të ngrohej në diell, të bisedonte. «Shoku Leka ka të drejtë për disa gjëra. Po vërtet nga kush do t'i kërkojmë këto?» — kishte pyetur Nikolla, buzagaz, i skuqur flakë. I binin djersë po të ndodhte një grindje në celulë.

Disa gjëra ishin të drejta. Tek kalonte para kompanive, babai shihte fytyrat e markeshasve. «Batalioni duhet të rrijë sa më pak në Markesh», — kishte thënë komisari, duke lënë pa thënë pjesën tjetër të mendimit. Ua kishte frikën grave dhe vajzave të pashme të Markeshit, me ata sytë e gjallë si të lotuar, me buzëqeshjen e fshehtë. Pa ishte edhe rakia. «Disiplina proletare!» Po pse të mos kaliteshin këta si punëtorët, dhe sa më parë? Në trup janë të fortë, megjithëse ngopen rrallë. Te shpirti i tyre që nuk i shtrohej dhe aq disiplinës, te mendjet dinake. Këtu ishte puna. Kundër dëshirës së tij babai zuri ta shihte batalionin me sytë e Lekës. Ja, edhe tani batalioni rrinte shtrembër. Po kjo vinte për shkak të pjerrësisë së sheshit. Qazim Sala, që komandonte kompaninë e dytë, burrë i heshtur e me trupin e fortë, që mbante ende mustaqet si furçë nga koha kur kishte qenë rreshter në batalionin «Tomori», u gatit dhe nderoi me grusht. Lëvizi e nderoi me grusht e gjithë kompania. U dëgjjuan të qeshura të mbytura. Prapa Qazimit ishte ajo vajza, Lume Hanku, dhe në krah të saj Meti, djaloshi i imtë me të cilin kishte ardhur nga qyteti. Vajza ishte më e gjatë. Bukurinë e trupit nuk ia fshihnin rrobat prej burri. Sytë i kishte të mëdhenj e me dritë, dukej sikur vazhdimisht habitej me diçka.

— Përse nuk i bëjmë komisarë ata të dy? — pyeti babai nëpër dhëmbë Lekën.

— Kanë ardhur si kandidatë. S'kanë hyrë ende në

Parti. — Kishte edhe diçka tjetër që e pengonte Lekën t'i bënte ata të dy komisarë, po për këtë s'mund të fliste.

— E pse të mos hyjnë në Parti? Vetë the se u treguan trima në Dreçok. — nguli këmbë babai si i argëtuar.

Leka shtrëngoi mjekrën, bëri fytyrën si në gaz, foli si duke pëshpëritur:

— Po na dëgjojnë... batalioni. E bisedojmë më pas.

— Veç ta dish se qarkori prandaj i dërgon. Të njohin luftën, të bëhen edhe komisarë, — tha ngadalë babai, i kënaqur me veten, dhe eci më lart te kompania e tretë, e rreshtuar para rrënojave të komunës. Komandant ishte Galip Nuri, me trupin e madh, me sytë e qeshur. Ky mik i shtrenjtë, mungonte prej shtatë muajsh. Kishte shkuar si sekretar komune në Gostivar i dërguar nga Partia. Aty kishte rënë në sy, se ishte tepër i gjallë, burrë i fjalëve të lehta dhe i punëve të vërteta. Kur e kuptoi se do ta arrestonin, u iku nëpër duar. Kur arriti në Markesh, ende qeshte me zhurmën e madhe që kishte ngritur pas vetes. Ishte ndjekur nga reparte të xhandarmërisë dhe ushtrisë, ishte caktuar një çmim i lartë në franga ari për kapjen e tij, i kishin djegur shtëpinë në Merqan.

Kompanitë rrinin heshtur, me fytyrat në diell. Do të fliste babai. Ai shikonte batalionin, duke menduar se ajo fuqi e armatosur, e kalitur në luftëra, ishte vetë jeta e tij, shoqëria më e mirë e më e lartë që mund të krijohet njeriu. Dhe Leka, komisari, që tregohej i rreptë në mendje e në shpirt, që kalonte para kompanive duke bërë përpjekje për të fshehur atë defektin në këmbën e majtë, donte ende kohë të mësohej me batalionin, ta kuptonte. Mbase edhe mund të mos mësohej kurrë. «Punë për të», — mendoi babai me njëfarë hidhërimi.

U përkund mbi këmbët, ndjeu zagushi, ngriti kokën dhe foli fort:

— Sot do të bëhet këtu mbledhja e popullit të Markeshit. Do t'u bëhet thirrja e fundit atyre që kanë ndenjur mënjane, që s'duan të bashkohen me luftën. Më parë do t'i dëgjojmë, pastaj do të shohim. Markeshas jeni dhe ju, nga më të mirët. Prandaj do të merrni pjesë në këtë mbledhje. Hapni sytë. Burrëri, disiplinë, se sot bëhet njëra nga të dyja.

Batalioni po e dëgjonte duke mbajtur frymën. Pa lëvizur po e dëgjonin dhe gratë e fëmijët që qenë rreth sheshit.

— Duhet t'i përgatisim më mirë, — i pëshpëriti Leka te veshi me gojën të tharë.

— Mos ki merak se e dinë vetë, — u përgjigj babai. E pa si me mllef dhe i tha: — Kohë ke boll, përgatiti. Le të shpërndahen, — i tha Rahmanit.

XV

Fshatarët po vinin nga pak e me vonesë, po asnjëri tepër vonë, se ende s'kishte ardhur baba Merxhani. Kishin ardhur Rahmani e Nikolla, me një kompani që u hap si për të zënë hijet në rrënojat e komunës, postës dhe shkollës, duke e rrethuar sheshin nga tri anë, kurse rrëzë Shkëmbit të Zi vendosën mitralozin e rëndë a thua se ai ishte vendi ku mund ta pastronin, se njëri prej partizanëve zuri t'i kalonte pecen sipër. Edhe fshatarët e paktë ashtu po bënin, zinin vend rreth sheshit të rrahur prej këmbëve në vite dhe që shkëlqente nën diellin e verës, si i shtruar me tulla të nxehta. Aty kalonte ndonjëri, si për provë. Erdhën fshatarët

nga Bali, nja pesëdhjetë veta, pastaj ata të Denës dhe sheshi zuri të mbushej. Fshatarët kishin pamjen e burrit të thirrur në kuvend, duke mbajtur rëndësinë e familjes e të fisit. Po aty të gjithë e njihnin njëri-tjetrin pas e përpara dhe filluan bisedat, duke folur për çdo gjë, me përjashtim të asaj që ishte në mendjen e gjithkujt. Se aty do të zgjidhej këshilli i ri krahinor. Kjo qe pika e parë. Në të vërtetë kjo vinte e dyta. Atë ditë e në atë vend do të zgjidhej një çështje e vjetër, që e solli koha të zgjidhej. Do t'u bëhej një pyetje disa njerëzve se në cilën anë do të qëndronin. Për shumë kohë, që nga fillimi i luftës e më pas, që nga çlirimi i Markeshit, këta njerëz kishin ndenjur mbyllur, të fyer e të zemëruar, si një kërcënim i heshtur, duke ecur nëpër një tel që kërkonte një fund, rikthimin e Markeshit në kushtet e vjetra. Kjo kishte qenë dëshira, e tërë jeta e tyre e fshehtë. Nuk dihej vetëm një gjë, nëse ata do të vinin, se, po të mos vinin, do të prishej e tërë puna.

Ata erdhën në grup, të parët Mëdyshajt, dhe ishin të paturp, ndenjën sikur të mos kishin asgjë për të thënë dhe do të qenë habitur po t'u bëhej ndonjë qortim. Armët i mbanin si ca sende që u kishin mbetur rastësisht në duar. Në qendër rrinte Bedriu ish-togeri, që kishte ndenjur mbyllur që në shkurt, kur i binte daulles për itifakun. Tani i ngjante një cjapi të Balit që e shek veten majë një shkëmbi të thepisur. Fuqinë e kishte Rati, që i rrinte në krah. Ky ishte ligësia dhe shkaku i ligësisë të të tjerët. Këtij veç t'i lidhje një gur të rëndë në qafë dhe ta hidhje të dërstila, ku ishte pika më e thellë e lumit Dron. Buzëqeshte me rrudhat në ballë, si njeriu në merak, jo për veten, po për markeshasit, që mund t'i bënin atë ditë të keqen vetes. Ky njeri do të kishte sajuar diçka, se gjithnjë linte një shteg të dytë pas vetes, po çfarëdo që të kishte sajuar, ai nuk do

të kthehej më në shkëmbin e tij në Gjin ashtu si kishte ardhur. Dy vëllezërit më të vegjël, kushërinjtë dhe nipat shikonin rrotull, duke pritur që gracka të shkruhej mbi ta nga ndonjë anë. Erdhën Sakiqët prej Qyteze dhe Man Leku me të vetët prej Dene dhe ndenjën në krah të Mëdyshajve, në qoshen e dyqanit të mbyllur të Tomës. Tani që u mblodhën tok u dukën sa shumë qenë. Po batalioni dhe burrat e tjerë ishin pesë herë, dhjetë herë më shumë. Këtë matje e bënte secili me sy në atë shesh të pjerrët ku qenë mbajtur në çdo kohë kuvendet e Markeshit dhe ku secili tani e ndiente veten si mbi një vend të minuar. Sepse në pika të ndryshme dhe nga të gjitha anët, ishin bërë disa lëvizje si me dy kuptime, njerëzit ndienin afrimin e shpejtë të asaj që pritej dhe nuk dihej si do të bëhej, pinin duhan dhe, në pikat e takimit, në atë vijën e lakuar që merrej me mend, dikush i rrinte fqinjit me armën e mbushur, si duke biseduar.

Babai po vonohej. Nikolla Topolaku u ngrit në majë të këmbëve, pa turmën e madhe dhe i ndriti fytyra prej gëzimit. Po një mendim i dytë që s'i ndahej ia turbullonte shpirtin. Çfarë do të ngjiste sikur «ata» të mos hidhnin armët me të mirë? Ai pa edhe një herë me mendje lëvizjet që do të bëheshin kur të jepej shenja. Loja iu duk e ndërlikuar e me rreziqe. Se «ata» vërtet qenë detyruar të mblidheshin në skajin e sheshit, duke pasur prapa rrëpirën e lumit, siç ishte vendosur, po nuk ishte e thënë që të mos trazoheshin me popullin në çastin e fundit. Nikollës po i rritej shqetësimi aq sa të shihte turbull, kur erdhi Selman Gërvishta, me sytë ngjyer në të kuq, dhe i pëshpëriti fjalë të rënda, solli ndërmjet gjuhës dhe qiellzës dy emrat që urrente më tepër, Rat Mëdyshit e Mahmut Koçit, tha se dyshonte që, në rrëmujë e sipër, ai i pari do të shtinte me dorën e të dytit mbi baba Merxhanin. Nikolla e shi-

koi se mos miku ishte i dehur. Po Selmani ishte esëll, me fytyrën të mavijosur. Nikolla hodhi sytë te pika në qoshe ku ishte Mahmut Koçi dhe vuri duart në brez si nga një dhimbje e stomakut. «Po shkoj», — pëshpëriti Selmani. Nikolla e mbajti nga bërryli. Selmanit s'kishte nevojë t'ia shtojë nxehtësinë, shpirtin e hakmarrjes. Në të kundërtën duhej ta përmbaje, t'i jepje urdhër, t'i shpjegoje se armiqësia mund të hapej në kohën e duhur dhe si të ishin bërë të gjitha, kohë që mbetej disi e papërcaktuar edhe për vetë Nikollën. Tani ai i trembej asaj që mund të bënte Selmani dhe i foli me të lutur te veshi: «Shko, po mos bëj asgjë të tepërt.» Selmani rrëshqiti nëpër turmë dhe i zgjati kutinë e duhanit Mahmud Koçit, duke i ndenjtur afër fytyrës, duke i tundur kokën. Mahmudi drejtoi trupin dhe nuk foli, zuri të dridhte cigaren. Nuk fliste kurrë, si i pagojë, veç përpiqte buzët për të thënë po ose jo. Tri vrasje të fshehta rëndonin mbi të.

* * *

Baba Merxhani doli në krye të sheshit i ndjekur prej Lekës e Rahmanit dhe qëndroi para komunës së rrënuar, shikoi popullin, ngrii grushtin dhe thirri «vdekje fashizmit». «Liri popullit», u përgjigj turma me të qetë. Sepse me të qetë kishte thirrur edhe babai, me një zë që parathoshte durim e shkoqitje të mirë. Babai ndenji edhe pak duke shikuar njerëzit. Ishte komandant i armatosur fort, siç e donte batalioni dhe baba me taçin në kokë, me fytyrën e pashme rrethuar me mjekër, siç e donin myhibët e vjetër.

— Do të zgjedhim këshillin e ri, — tha babai, me të njëjtin zë të qetë, por që u dëgjua larg, edhe në shtëpitë e rrotull sheshit, ku rrinin në përgjim e duke

mbajtur frymën gratë e fëmijët. — Se e kërkojnë nevojat e luftës të përtërihet këshilli. Por më parë do të flasë për disa çështje komisari.

Leka doli më tej, duke mposhtur atë cenin e këmbës, zgjodhi vendin dhe zuri të fliste me bllokun në dorë, duke përmendur luftërat e hershme të Markeshit, fiset, lagjet dhe komandantët e shkuar. Trupi i tij i paktë po rritej në sytë e fshatarëve, duke pritur secili pjesën e fisit të vet, duke i dëgjuar këto vetëm me njerën anë të mendjes. Më poshtë do të ngushtohet laku. Se komisari po i mëshonte fjalës për dikë kur tha se Markeshi i qe bindur me dëshirë patriotit Aqif pashë Elbasanit, me përjashtim të disave, që kishin dalë nga ana e kundërt, për t'i shërbyer mbretit hajdut e tradhtar.

«Fare mirë», — tha me vete babai. Ai vetë do të kishte folur sa më shkurt. Bisedën në një dhomë të mbyllur mund ta drejtonte duke i lënë dëgjuesit gojëhapët, po fjalimet jashtë në popull i dukeshin një harxh i kotë fjalësh. Kurse tani shihte se fiton më tepër kohë kur flet me njerëzit njëherësh. Veçse duhet të gjesh atë që duan të thonë të gjithë dhe ta thuash ti për ta. Shoku Leka po i thoshte mirë, duke u gjetur zemrat. «Po pse dreqin filloi të marrë zjarr!»

Dielli nxehte gurët. Njerëzit mënjanonin kokat duke kërkuar një hije çfarëdo. Kjo ishte dita e pritur e komisarit. Po fliste për thyerjen e fashizmit në Bashkimin Sovjetik e gjetiu dhe për luftën në Shqipëri, gjatë, me ngulm e me durim. Pastaj prapë kaloi befas në Markesh. Atëherë turma e madhe u ndeh, nuk kollej kush, dhe as lëvizte dorën për të thithur cigaren, sepse, gjithë sa foli komisari, për atë ishte folur, për të dalë te Markeshi sot. Kjo ishte paralajmëruar gjatë tërë fjalimit si një erë që vjen duke u rritur. Si lëvdoi popullin dhe

batalionin, me një zë që po bëhej kërcënues, ia plasi sheshit, ashtu siç duhej e siç pritej. Tha se disa njerëz kërkonin të sabotonin luftën nga brenda. Fjalën «sabotim», që dëgjohej shpesh kohët e fundit, e shqiptoi duke shtrënguar dhëmbët. Dukej se tani nuk do të ndalej para asgjëje, se po fliste sikur t'i zihej fryma, ngriti zërin, ngriti gishtin dhe tha se Bedri Mëdyshi e Rat Mëdyshi deshën të bënë itifak, pastaj e luajtën bishtin. Fjalën «e luajtën bishtin» e tha sikur të ishte fyerja më e rëndë. Ai kishte për të nxjerrë edhe më prej bllokut, se shikoi aty dhe tha se këta njerëz vijonin të nxirrnin nga goja sqfuri e helm për Partinë dhe personin e baba Merxhanit.

— Këto janë shpifje, — thirri Rat Mëdyshi, i çuar befas në këmbë. — E këpus gjuhën time me dhëmbë, para se të nxjerr një fjalë të keqe për Partinë dhe baba Merxhanin. — Rrotullonte gjuhën në gojë, hapte sytë me kërcënim, dukej më djall se çdo herë.

Komisari nënqeshi, u hoq se nuk dëgjoji, vijoi të fliste, me zë të sigurt e të rëndë, ta çonte punën në fund dhe tha:

— Fisi i Mëdyshajve dhe ca të tjerë, duhet të shfaqen sot. Thirrjen ua kemi bërë me kohë. A do të vijnë me luftën këta, apo do të rrinë mënjanë si burracakë, të bëhen vegla të armikut.

— Heh, — thirri Rati me tërbim. — Qymyrxhiu i Korçës po na tregon burrërinë. Ky di si ndizet furra. Ky di edhe si i vihet zjarri Markeshit.

Prej guximit të tij të marrë dhe sharjes së hapët, prej mllefrit që kishte në zë, prej befasisë, askush nuk po lëvizte në shesh. Nuk ishte në zakonin e Ratit të rrëmbehej e të humbiste mendjen. Apo bënte sikur e humbi mendjen? Gjithsesi, dukej se erdhi puna te çarku i armës dhe sekush llogariste lëvizjet që do të

bënte, duke pritur lëvizjen e fqinjit, hapin tjetër të Rati, babait ose komisarit.

Rati shikonte sheshin me njerëz, me fytyrat e zeshkëta, me veshjet e bardha e të zeza si për ditë feste, me qeleshet e lara, pa lëvizur as këmbët, as duart; këta njerëz, pra, bashkëfshatarët e tij, i ngjanin si gurë të gjallë të një varreze të dendur. Po Rati duhej t'u jepte jetë. Ai gjithnjë i kishte pëshpëritur në vesh Markeshit, në vendin e në kohën e duhur, me anë të gjuhëve që zotëronte në katër lagjet dhe në fshatrat e komunës. Tani duhej t'u jepte një drejtim mendjeve të bashkëfshatarëve, një drejtim të papritur, t'i shkëpuste krejt prej asaj që kishin dëgjuar aty më parë dhe që e kishin pranuar. Mirëpo prej kohe këta i kthenin fjalës së Rati veshin tjetër dhe iknin tutje, për shkak të kësaj lufte pa krye e fund dhe atij baba Merxhanit që kishte zënë me trupin e tij sheshin «Belik», duke ndenjur me duart në gjunjë. Prej dhjetë vjetësh e kishte ndjekur ai këtë baba, pa ia ndarë sytë, duke i ngritur leqe të trasha; po ai ishte rritur përherë më tepër, a thua se leqet i bëheshin shëndet, dhe tani të merrte frymën me fuqinë e hijen e tij. «Tani, ose kurrë», — i tha vetes Rati. Një plumb i nxehtë me vërshëllimë të fshehtë do të gjente rrugën në pështjellim e sipër, kur fjalët të çoheshin edhe më lart e të lëviznin njerëzit, kur të bëhej një kacafytje çfarëdo, kur askush të mos e kishte mendjen. Ky plumb i vetëm do t'i ndërronte pamjen Markeshit. Rati iu rrëqeth trupi dhe krisi dhëmbët, u duk sikur theu eshtrat e veta, qëndroi dhe thirri fort:

— Prej të huajve na erdhi e keqja. U dogj Markeshi, u vranë e po vriten gratë e kalamajtë. Ky kuvend duhet ta gjejë vetë atë që duhet. Ende s'kanë vdekur burrat e kësaj lugine.

— Mirë e ke. Të huajt po na quajnë burracakë, —

thirri Man Leku, duke ndenjtur ulur me kurriz në murin e dyqanit të Tomës.

— Pusho, mor ti, — i thirri me mllef një partizan.

— Bukur fort. Të pushojmë. Na thërrasin për dar-kë e na mbyllin derën, — thirri Selman Sakiqi, këmbë-kryq siç ishte.

Turma e katërqind burrave prapë mbeti e palëvizur, si e mbajtur nga një zemërim i nëndheshëm. Rati prapë priti, me sytë hapët. Ajri ishte helm dhe heshtja aq e thellë, sa çdo njeri mund të dëgjonte rrahjen e zemrës së vet. «Më mirë rri në vendin tënd», — i tha dikush aty prapa dikujt. «Me urdhër të cilit?» — pyeti ai tjetri. U dëgjua një krismë e lehtë metalike. «Nuk duhet lëvizur. Të dëgjojmë kuvendin», — tha një zë i ulët, i qetë, nënshtrues. Ky ishte zëri i Rahman Denës. Rati kuptoi. Çasti i pështjellimit e i plumbit kishte kaluar, kishte shpresuar marrëzisht në një gjë krejt të kotë. Rrotulloi mbi turmën sytë e ngjyer me gjak prej urrejtjes, buzëqeshi me mospërfillje dhe tha:

— Ne nuk jemi kundër luftës. Veç një gjë kam thënë, se një pyll i madh nuk digjet nga brenda po të mos fryjë erë nga jashtë.

— Këto i ke thënë edhe herë tjetër, o Rat, — i thirri baba Merxhani duke çuar dorën.

— Atëherë ç'kërkohet prej nesh? — pyeti Rati.

— Po të përgjigjem unë, — tha komisarari.

Njerëzit, që e kishin harruar për disa çaste, panë se komisarit i kishte marrë fytyra ngjyrën e vishnjës. E kishte duruar fyerjen, duke ditur se armiku atë donte, që të tërbohej. Prandaj tundi kokën e foli qetë, me një zë që përmbante marazim e përçmimin, me fjalë që vinin drejt nga shpirti i tij i thellë:

— I huaj këtu jam unë me disa të tjerë. Këtë do të thotë Rati. Të huaj kanë qenë edhe kryetari i komu-nës, komandanti i xhandarmërisë dhe sidomos marsha-

Ili italian. Po këta dikush i ka pritur në shtëpi. Të huaj qenkemi ne, që kemi ardhur këtu të dërguar nga Partia. Dhe qymyrxhi kam qenë. E di si ndizet zjarri. Ama edhe Rati e di si ndizet zjarri në pyll për të pjekur dhinë e huaj. — Kishte frymëzim në fjalët e tij dhe i ndriçonte fytyra e thatë. Po ia thyente eshtrat Ratit, po ia përdridhte qafën, me një gojëtarë që i bënte njerëzit të zgjatnin kokat për ta dëgjuar sa më mirë. Po habitej edhe baba Merxhani. Ditët e fundit kishte dashur t'i shkruante Murat Podës që ta transferonte Lekën. Tani, tek shihte sa fort duronte e vuante ky njeri brenda vetes, ndjeu pendim dhe për të parën herë po i dukej komisari i afërt si vëlla.

Komisari po shihte Ratin, vetëm atë. E kishte vënë për muri dhe dukej sikur nuk dinte ç't'i bënte më tej. Ndërsa ende s'ia kishte bërë pyetjen, një pyetje që t'i përmblydhte të gjitha. Padurimi i turmës, egërsimi i heshtur u shfaq me ndonjë kollitje. Koha e fjalëve kishte kaluar.

— Le t'i lëmë këto, — thirri komisari. — Tani duam një përgjigje. Ti, Rat Mëdyshi me shokë, do të vini në luftë, apo do të dilni kundër? Po të mos vini, duhet të lini armët.

Disa lëvizje të lehta u ndien rreth sheshit, aq të lehta, sa mund të mos i quaje lëvizje. Ndofta u dëgjua edhe ndonjë krisje hekuri, si thyerja e një shkarpe të hollë në pyll, si rënia e një pike uji në një pellg aty pranë. Rat Mëdyshi u çua prapë, si buzagaz. Mund të thoshe se ky njeri po ashtu do të qe ngritur edhe para vdekjes dhe tani në një gjendje të tillë ishte, si i rënë ndërmjet brirëve të një demi të inatosur që i synon barkun; se duhej të thoshte haptas që po shkon me luftën, ose të linte armën.

— Gjithnjë gati kemi qenë, po ju asnjëherë s'na keni pranuar, — tha si i fyer.

Në shesh kaloi një murmurimë. Komisari hapi sytë. Gënjeshtër ishte tepër e madhe. Ai vetë i kishte thirrur, dy herë, tri herë. Vetë kishte shkuar në kullën e Mëdyshajve. Komisari mund t'ia plaste gazit aty para njerëzve ose të ngrinte pushkën mbi Rat Mëdyshin. Komisari i kishte menduar të gjitha fjalët, dredhitë e kryepaqve të itifakut që kërkonin t'i binin së drejtës rrotull. Këta ishin të lidhur me të kaluarën si qeni pas kockës, urrenin të tashmen dhe të ardhmen, asgjë të re e të mirë s'donin të mendonin, njerëz të vdekur po edhe të rrezikshëm. Prandaj komisari kishte menduar ta ngrinte të drejtën si një mur të lartë dhe aty t'i mbërthente të gjithë ata, të ndahej tradhtia nga populli. Tërë ngjarjen e kishte shijuar ai net e ditë, sidomos çastin kur Rahmani do t'u thërriste të hidhnin armët dhe do të ndienin tytat e pushkëve para hundës, ndërsa në fytyrat e tyre do të lëvizte frika e turpshme. Të gjitha këto Leka i kishte paraparë. Veç daljes që gjeti Rati, e cila ishte tepër e thjeshtë, prandaj edhe e vështirë për t'u menduar, po jo krejt jashtë arsyes, derisa e thërret të akuzuarin dhe e vë para një pyetjeje, e cila ka gjithnjë dy anë.

Njerëzit në shesh ndien befasisht nevojën të bënin diçka, të pinin një raki a një gllënjë ujë. Gjatë dy orëve kishin duruar diellin dhe djersën, me mendjen te fundi që pritej. Po tani u ngatërrua puna, lindi njëfarë dyshimi. U qe bërë apo jo një thirrje Rati dhe të tjerëve, ku dhe kur? Domethënë një thirrje e vërtetuar. Apo ajo kishte qenë një armiqësi, ndërmjet njerëzve që nuk shohin, as dëgjojnë, që japin e marrin si prapa një muri. Po ama, nëse Rati dredhon, le të jepet një provë dhe fundja të vihet në plumb si qen. Këto po mendonin një pjesë, ndërsa pjesa tjetër shikonin me hidhërim se Rati prapë e kishte hapur një shteg,

kjo pjesë as që donte fjalë, priste vetëm të çohej Rahmani e të jepte shenjën.

Një korrier i ardhur me nxit i kishte dhënë një letër baba Merxhanit. Ky po e lexonte me fytyrën ulur, mbase për të dytën herë. Njerëzit pritën, si të kujtuar befaz se ende s'e kishte thënë fjalën njeriu që duhej t'i jepte fund punës. Baba Merxhani u çua, tundi letrën dhe thirri fort:

— Musolini e theu qafën. E hodhën me këmbë për-pjetë. Kryeministri tradhtar Libohova ia ka mbathur për në Romë. — Ndenji një çast duke shijuar atë që tha, ndenji të mbushej me frymë, se i qe hedhur kraharori. Shikoi letrën që mbante në dorë dhe tha: — Po lufta s'ka mbaruar. Na thërret detyra të nisemi në çast.

Habia sundoi mbi turmën. Po ishte kohë lufte e sulmi dhe mendja e njerëzve mund të kalonte me shpejtësi nga njëra ngjarje në tjetrën. Disa filluan të çoheshin. Babai zbriti më poshtë dhe u ndal, duke u përkundur mbi këmbët dhe me këtë ndali lëvizjen e të tjerëve, uli qafën si të shihte diçka të largët e të errët dhe thirri me kërcënim:

— Ti, Rat, dhe të tjerët po vini me ne?

Që të gjithë kthyen fytyrat nga Rati. Tani mund të ndodhte pështjellimi, një fjalë çfarëdo dhe njerëzit do të ngrinin armët. Po Rati nuk la kohë. Ishte çuar dhe thirri fort, duke sjellë si dëshmi për çdo të keq që mund t'i bëhej vetë thirrjen e tij, që ushtoi tej:

— Nuk ndahemi prej popullit kurrë. Na hiq rru-gën, o babë.

XVI

Lume Hankut i qenë tharë buzët nga etja. Përpara kokës kishte një gur që nuk e mbronte. Plumbat kalonin anash dhe lart, me vërshëllimë, nguleshin me forcë në tokën e kuqe. Ajo i shihte si diçka të rrezikshme prej së cilës duhej mbrojtur, po nuk i shkonte ndër mend ta lidhte këtë gjë me vdekjen. Mitralozët me krismat e paprera i dukeshin pa të keq, gati si një brohori e armikut, që do të ndalte porsa të merrej vesh përse kishte ardhur aty batalioni. Kureshtjen e saj e tërhiqte sidomos bunkeri, me kupolën me vija, që kishte dalë aty në qoshe si një grua në oborrin e vet, grindavece dhe tepër llafazane, që nuk dëgjon as ato që thotë vetë dhe do të shkojë të flerë porsa të shkarkojë mbi fqinjën ngarkesën e madhe të fjalëve. Lumja qeshi me këtë mendim. Skuadërkomandanti i bëri shenjë të shihte përpara, të ulte kokën. Fytyra e tij ishte e zgjatur, e errët, sikur priste të ndodhte diçka e rëndë. Atëherë Lumja u kujtua për shokët. Gjithë ky zjarr, tërë ai plumb i derdhur mbi ta! Po ja që nuk goditet asnjëri. Plumbat hyjnë në dhe, toka është e madhe, sado plumb të derdhësh, ajo nuk mbushet kurrë. Lumja mbështeti fytyrën sipër dorës duke ndier dheun e madh dhe priti.

Kjo gjendje po zgjatej prej agimit, kur plasi pushka pa u kryer mirë rrethimi. Batalioni që hedhur përpara, duke pushtuar në vrull e sipër barakat e punëtorëve. Pastaj kishte dalë befas i tërë garnizoni pas telave, me transhe e fortino, që u përgjigj me tetëmbëdhjetë mitralozë, duke djegur municion pa kursim, me një shpejtësi që të merrte frymën. Filluan edhe dy mortajat e rënda, që zotëruan mbi krismat e mitralozëve me një jehonë që përsëritej si bubullimë në faqen e pesë

maleve të kuqërreme. Me daljen e diellit, të madhë e të nxehtë, kishte ardhur edhe aeroplani, që u soll me përtesë sipër luginës, mori befasi fuqi, u ul dhe hodhi bomba të vogla të lidhura tufë. Asnjëri nuk u vra, po në atë grykë të hapur mbuluar me gurë të murrme, njeriu ndihej krejt i zbuluar nga lart dhe pa mbrojtje ballas. Kështu që prej agimit.

Prapa bunkerit ishin disa baraka me mure, si konstruksione të gjalla që mund të lëviznin nga një çast në tjetrin. Dukej sikur aty bluheshin gjëra të fshehta, që kishin lidhje me nëntokën. Në të djathtë hidhej në qafat rruga automobilistike, me gurët e bardhë të kilometrazhit, që humbisnin në hapësirë. Nga pamja e asaj cope rruge që sillte erën e shtëpisë, Lumes i rrahu zemra, e pushtoi mallëngjimi. Lëvizi ngadalë shpatullat dhe shënoi, duke mbajtur frymën, në pikën e fortinos, në gojën si trekëndësh.

Krisma e pushkës së saj kaloi përmes krismave të tjera, duke çarë me fuqi rrëmbyese. A thua u përmbys një armik.

Pritja me fytyrë në tokë po kthehej në ankth. Heraherës ankthi i ngrihej vajzës në gjoks. Ajo donte të çohet. Ishte përpjekja e dytë në të cilën merrte pjesë, nuk kuptonte mirë se ç'ndodhte dhe i dukej se bëhej luftë e ashpër gjithandej, përveç pikës ku ndodhej ajo. «Mos lëvizni, kursim fishekët!» Kjo thirrje rrëqethëse që kalonte ultas, gojë më gojë, paralajmëronte diçka. Një lehtësim erdhi kur Rahmani me dy skuadra doli në shpatin e malit, në brinjë të garnizonit. U duk sikur në minierë ngjau një çrregullim, vetëm për disa çaste, pastaj zjarri i armikut vazhdoi i njëjtë. U pasua urdhri të tërhiqeshin skuadrat, të zinin vend prapa kodrave të ulëta.

Aty Lumja shkundi rrobat prej pluhurit të kuq, fshiu djersën dhe qeshi. Një vajzë si ajo nuk e humbis-

te bukurinë në asnjë rrethanë. Këtë e dinte edhe vetë dhe përpiqej të mos i jepte rëndësi, të zhduke çdo ndryshim që e veçonte nga të tjerët. Ajo donte Metin, shokun e saj të vegjëlisë. Dashuria e tyre zhvillohej sheshit, një dashuri që kalonte vetëm nëpërmjet syve e kujdesit, prandaj në punën e këtyre të dyve, e tërë kompania ishte si e lidhur me një buzëqeshje të hollë e të pandjeshme, se këta të dy i kishin shpirtrat aq afër, sa rrallë të shihje gjë të tillë në jetë. Ishte sikur kompania të mbante tërë kohën në mesin e saj një vazo të bukur të padukshme, sidomos në orët e çlodhjes.

Në të majtë u dëgjuan pëshpëritje, sikur të trazonin diçka që kishte të bënte me dheun, rregullimin e një pozicioni. Erdhi skuadërkomandanti duke ecur ngadalë, si i dehur, ose i plagosur rëndë. Po nga fytyra e përhumbur nuk dukej të ishte plagosur. Kërkonte diçka dhe qëndroi kur pa Lumen, mbylli pakëz njërin sy, foli si pa nxjerrë zë, tha se ishte vrarë Meti. Në fillim Lumja nuk kuptoi, veçse hapi sytë, iu morën mendtë. E kishte parë vdekjen herë tjetër, ia dinte rrugët. Megjithatë, mendimi se vdekja kishte prekur Metin, nuk mund të qartësohej. Kjo po i luhatej në mendje. Skuadërkomandantit iu duk se asaj i tretej fytyra me shpejtësi, i mori një dritë tjetër, që ia nxori në shesh mollëzat e faqeve. Ajo kapërdiu një britmë, me të dy duart në gjoks. Ndofta kuptoi diçka, po prapë dyshonte. Skuadërkomandanti e uli ngadalë mbi një gur dhe ajo u bind si fëmijë, një bindje që ishte më e fortë se çdo dhimbje. Ajo lëvizi buzët me mirënjohje, me fytyrë të tretur, dhe zuri të shihte andej-këndeje, gjithnjë duke dyshuar. Tani po i merrej fryma fort dhe bashkë me frymën zuri të nxirrte tinguj të mprehtë të pakapshëm. Në çastin tjetër do të çohet të lëshonte një klithmë të gjatë, që do të përhapej në krejt rrafshin

e mbuluar me gurë të murrme dhe në shpatet e maleve të kuqe, Po vajza qëndroi. Tha se donte të shihete Metin, sikur kjo të ishte e vëtmja punë për t'u bërë. Ajo eci me gjallëri të tepruar e përcjellë nga sytë e heshtur të shokëve. Kur e pa Metin të shtrirë, me fytyrën e imët mënjanë, si në gjumë, hapi sytë, u drodh e tëra, tha «shpirti im» dhe murmuriti diçka tjetër që nuk u kuptua.

Varrimi u bë aty në vend, rrëzë kodrës, ndërsa rreth e qark kërciste lufta. Kishin sjellë kazma e lopata prej barakave dhe skuadra punonte me ngulm e pa zë, sikur do ta ndihmonte shokun për ta nxjerrë e jo për ta futur. Fshinin lotët. Lumja përkulej, shihte me merak nëse bëhej puna mirë. Pastaj ndenji drejt, e ngurtësuar, e tretur. Derisa njëri nga djemtë zuri të kërkonte me ngut në xhepat e Metit. «Ç'po bën?» — pyeti një tjetër. «Kërkoj për nënë Milin.» «Aha, për nënë Milin. Kërko.» «Kemi edhe çantën.» Fjalët kalonin si fëshfërima. Lumja mbuloi fytyrën me duar, me mendjen te nëna e Metit, që ishte baza, nëna e gjithë shokëve të qytetit. «Çojeni! — tha dikush. — Çojeni, pra!» Lumja ktheu kokën mënjanë, prapë murmuriti diçka, ndofta i thirri vetë vdekjes. Që do t'i thërriste edhe më pas, në luftërat që erdhën, duke e kërkuar.

* * *

Baba Merxhani vërente luftën nga barakat e punëtorëve, prapa dritares me xhama të thyer. Ai mendoi se tërbimi i shtuar i armikut vinte ngaqë batalioni po ngulmonte. Ky armik, që ndiente vetminë dhe shkëputjen, do të jepej, jo nga zjarri i madh, as me sulm të hapët, po me diçka tjetër, me frikën që i kallte batalioni, duke i treguar çiltas se s'kishte për t'u shqitur

prej andej pa e çuar punën në fund. Kjo s'kishte nevojë të thuhej, as të tregohej; këtë e di mirë ai që ka në mendje humbjen, si edhe ai që ka në zemër fitoren. Tani armiku do të tregonte pikën e dobët, ose pikat. Prishja do t'i vinte njëherësh, mjafton të rrihej edhe më me plumb, mjafton t'i tregohej ngulmi në rritje i batalionit. Kjo ishte si të mposhtje një kundërshtar vetëm duke e parë në sy, duke i folur, gjithmonë nga më afër, pa përdorur duart. Babai po i gëzohej këtij mendimi aq sa t'i rrihte zemra fort. U lirua prej ankthit të rëndë që i thante gojën aty më parë, kur pritej prej tij të hidhte batalionin në sulm të hapët. Duhej vetëm ngulmuar, deri pasdite, dhe do të ishte një fitore e shkëlqyer, me shumë rëndësi. nga ato që shënojnë kthesa në fatin e luftës dhe përmenden gjatë. Mbajti vesh krismat dhe kuptoi se batalioni, i ngjitur përtokë, ndjente njëllor si ai.

Afër drekës erdhën dy aeroplanë, hodhën bomba e mitraluan. Mortajat e kthyen edhe një herë qitjen ndaj barakave, si duke dashur t'i shembnin krejt. Ishin vrarë tre partizanë. Në orën dy erdhi patrulla nga Qafa e Zallmollës. Batalioni i Çernikës ende s'kishte dalë në qafë. Babai murmuriti një sharje a një mallkim me buzët e thara. Një orë më pas thirri shtabin.

— Jemi në rrezik të sulmohemi nga krahët, — tha. — Komanda e divizionit s'mund të lërë pa ndihmë garnizonin. Batalioni i Çernikës s'do të dalë te Tri Urat. Si thua, Nikollë, se ti e njeh më mirë shokun Zambak. U kthye nga dritarja me fytyrën e prishur dhe tha: — Provojeni t'u bëjmë thirrje për dorëzim. — Nuk besonte as vetë në atë që tha.

Nikolla doli pa hapur gojë. I rrihte zemra rëndë, sikur ajo të jetonte më vete. Nuk ishte i sigurt nëse e njihte Zambakun, megjithëse kishte qenë dy muaj intendent në atë batalion. Zambaku shpesh i qe du-

kur njeri i dyshimtë dhe Nikolla akuzonte veten për këto dyshime. Duke ecur për në kompaninë e dytë, Nikolla u krodh në hidhërim të thellë aq sa të mos dëgjonte zhurmat e luftës. Po pak më tej dhe jashtë asaj zhurme, iu bë se dëgjoi buçitjen e largët të një topi nga ana e Tri Urave dhe gërvishtjen e mbytur të zinxhirëve të tankeve.

Baba Merxhani e hoqi rrethimin e minierës dhe e ndali fuqinë armike prej dy mijë vetash në Tri Urat dhe në faqet e maleve buzë lumit. Kishin ikur fshehtas Mëdyshajt me miqtë e tyre, nja tridhjetë veta, po kishin ardhur çeta e Merqanit dhe fshatarë të shumtë. Ditën e tretë, armiku mundi të çante me tanke e artileri drejt Grykës dhe të arrinte minierën. Pastaj e njëjta fuqi armike nisi lëvizjen e kundërt. Dukej çiltas se pas ngjarjeve të fundit në Itali, ky armik kishte humbur orientimin dhe vetëdijen dhe shpejtohej të mbyllej në vrimën prej dhe nga doli, pa ditur se ç'do të bënte më tej.

Ishte plagosur Leka në ije nga një copë predhë, një plagë e keqe, të futje grushtin në të. Mezi ia ndalën gjakun. «Ku na gjeti edhe kjo bela,» — thoshin sytë e tij në ngjyrën e tymit. Babai e puthi në buzët e tharra dhe e përcolli në spitalin e qarkut, kurse vetë, me forcën e madhe prej katërqind vetash, që rritej në ecje e sipër, u hodh në fshatrat e pllajës përtej lumit, me bindjen se divizioni «Firence» dhe çdo forcë tjetër armike i kishte orët e numëruara.

XVII

Komandant Zambaku shkruante në ditar ngjarjet e largëta e të afërta, duke ndenjtur në kampin e tij ve-ror në Qafëbredh. Tek shkruante, i bëhej se dëgjonte

gjëmimin e detrave në thellësi prej nga ngjiteshin hijet e punëve të mëdha.

«Shtetrrëthim në Tiranë. E tërë Shqipëria shpallet zonë lufte nën komandën e gjeneralit Egidio Levi. Duçja ishte një imitacion i keq i oratorëve të senatit romak. Njerëz të tillë e kanë mendjen në majë të gjuhës, e që andej e deri në katastrofë rruga është tepër e shkurtër. Këshilli i madh fashist e rrëzoi Duçen. Mbreti i vockël plak mori në duart e veta detyrën e komandantit suprem, pa ditur se ç'do të bëjë me këtë detyrë. Fashizmi u prish nga brenda porsa e gërvishtën me zbarkimin në Sicili, sikur të kishte pritur një shkak çfarëdo për t'u prishur...»

Komandant Zambaku shkruante këto ngjarje në faqet e ditarit «8 shtator 1943», duke fërgëlluar prej kënaqësisë, duke u habitur me aftësinë e tij për të analizuar në thellësi situatën e brendshme e botërore, kur e lajmëruan se në kamp kishte ardhur një ushtar italian i arratisur, i përcjellë nga një djalosh.

Ushtari dhe djaloshi ishin ndalur nga roja te shtegu perëndimor. Kishte disa postobloqe rreth atij kampi të bukur, të ngritur në ca lëndina të blerta me ujë të ftohtë, rrethuar me pyje ahu. Dukeshin kapanonet e partizanëve mbuluar me gjethe, ndërsa komandanti dhe shtabi i tij banonin në dy kasolle të veçanta.

— Tani, shok i dashur, do të shohësh cilët jemi ne, — i tha italianit djaloshi, duke i vënë dorën në sup.

Italiani po shihte me habi e gëzim se më në fund ra në një kamp komitësh të vërtetë, ashtu si tregohej në ca filma e libra. Ky mendim iu forcua edhe më tepër kur pa komandant Zambakun. Ky u duk mjaft i gjatë. Mbante pushkë automatike, gjerdani me fishede i shtrëngonte mesin e hollë, koburja turke dhjetëshe i varej në anën e djathtë, mustaqet e verdha i

rrinin përpjetë, kishte llullën në gojë, ecte me zhdërvjelltësi. Komandanti shikoi rrotull, u bind se fjala ishte për një ushtar të vetëm pa armë, u lëpi dhe nënqeshi.

— Nga vini ju? — pyeti.

Djaloshi u habit e u skuq. Shoku Zambak e njih-te, ndërsa po sillej sikur të mos e kishte parë kurrë. Pastaj mendoi se ndofta këtë e kërkonte konspiracioni, për shkak të italianit. Qeshi dhe tha:

— Jam përgjegjës i rinisë në zonën e Zanikës. Ky shoku është komunist italian i arratisur. E solla në batalion me porosi të qarkorit.

Komandanti tundi kokën. Djaloshi kishte bërë pesë dekonspirime porsa hapi gojën: vendin e tij të punës, përgjegjësinë, qenien komunist të italianit, qarkorin, batalionin. «Kur do të mësoni vallë?» — thoshin sytë e kaltër e të menduar të komandantit. Ai pyeti të arratisurin italisht. Ky përsëriti se ishte anëtar i Partisë Komuniste të Italisë. «Këtë do ta sqarojmë», — thanë sytë e shpejtë të komandantit.

Zambaku nuk lejonte asnjëri të hynte në kamp. Fshatarët vinin deri te postbllloqet e caktuara në pyll duke bërë rrugë të gjata dhe aty dorëzonin ushqimet. Porsa kthehej nga lufta, komandanti përpigjej t'i pris-te urat, rrinte aty në kampin e lartë, si kapiten i një anijeje që u ruhet brigjeve, dhe ndihej mirë. Po në dimër kaçaku i fortë e humbiste një pjesë të madhështisë, se qe i detyruar të zbriste në fshatra, të strehohej te bejlerët e vegjël të Çernikës. Atëherë vijonte punën fantazia e tij dimërore, e prirë prej rregullave të një konspiracioni të fandaksur, duke krijuar frikën dhe rrezikun, me prita imagjinare të një armiku të padukshëm, që i kalonte me marifet, nëpër shtigjet e dhive e me plane të stërholluara, jo dy herë në të njëjtën rrugë, në asnjë rast pa «verifikim», pararojë

e praparojë, që kishin ndër sy vetëm personin e tij.

Zambaku vazhdonte prej dy ditësh hetimin e atij ushtari të arratisur, që mund të ishte një komunist i vërtetë italian, po edhe një agjent i rafinuar i SIM-it, kur erdhi lajmi i kapitullimit të Italisë. Korrieri solli edhe urdhrin e prerë, drejt nga Shtabi i Përgjithshëm, që batalioni me dy çeta të tjera, të ndalonte buzë lumit kolonën e madhe të italianëve që venin drejt Jugosllavisë.

Buzë lumit Zambaku u ndodh para një ngatërrese. Kolona e madhe e ushtarëve italianë prej një mijë vetash, që udhëtonte më këmbë, me kamionë e në kuaj, e armatosur mirë, po hynte në Grykën e Rikshit, e prirë nga motoçiklistët gjermanë, që bridhnin poshtë e lart, siç bën bariu që ka ngut me delet. Duheshin goditur këta dhe të merrej në dorëzim kolona, e cila i ngjante një turme që ka humbur shpresën dhe që po e çojnë në vendin e heshtjes dhe harresës. Pra, të thyhej lëvozhga e hollë dhe të hidhej veza në pjatë. Por italianët, të shtyrë nga ndjenja e vetëmbrojtjes, mund t'u ndihnin gjermanëve kur ta shihnin veten nën sulmin e një armiku të beftë e të panjohur. Kjo ishte ngatërresa.

Urdhri i Shtabit të Përgjithshëm fliste qartë. Veç kësaj, ky ishte rasti për të arritur diçka të madhe. Zambaku hapi zjarr mbi motoçiklistët gjermanë. Italianët nuk i prekën armët. Qëndruan si një trupë e paanshme që përpiqet të mbulojë veten dhe që do t'i bindej palës fituese kur të kalonte shiu i nxehtë. Fati i tyre ishte i errët po të fitonin gjermanët. Dihej ç'do të bënin ata kur të kalonin në Strugë. Por edhe me partizanët nuk dihej. Nuk dihej ç'do të bënin këta kur ish-pushtuesi do t'u binte në dorë. Kishin bërë përpara edhe ballistët, po këta ishin të paqëndrueshëm, u digjeshin sytë për plaçkë. Ashtu ecnin në ditët e para të kapitulli-

mit, regjimentet, divizionet, ende të inkuadruara, me ushqimet dhe pajisjet, duke pritur që fatkeqësitë t'u binin sipër nga çdo anë, duke lëvizur ose ndenjor në vend sipas rastit, me dëshirën e vetme t'i flaknin të gjitha, të gjenin rrugën më të shkurtër të shtëpisë. Pas një gjysmë ore, disa nga motoçiklistët ishin vrarë, të tjerët ikën. Kolona italiane, e mbetur zbuluar, iu bind njerëzve që e futën në bigëzimin e minierës dhe hodhi armët: 800 pushkë, 40 mitralozë, 14 mortaja, 20 kamionë me pajisje e municione.

Zambaku pa këtë begati, mbi të cilën s'mund të vinte dorë, për shkak se do t'i kalonte brigadës së re në formim e sipër, dhe mori robërit, u ngjit prapë në kampin e tij veror. Aty pushkatoi togën e milicisë fashiste që udhëtonte e fshehur brenda kolonës. Pas-taj i foli me një italishte të qartë turmës së madhe të robërve që varej e gjitha nga buzët e tij. Edhe këtë e bëri pikë për pikë sipas udhëzimeve, veçse me tonin e tij. U tha se kishte tri rrugë: të hidheshin në luftë, të strehoheshin pranë fshatarëve, të iknin nga të donin me rrezik të binin në duart e gjermanëve. Pothuaj e gjithë turma zgjodhi rrugën e mesit, atë që zgjedh njeriu i hutuar kur ndodhet në mes të tallazit: të rrinin në vend, të punonin për bukën e gojës pranë fshatarëve. Armata «tetëmilionëshe» po merrte fund në një muaj e sipër brenda dhe jashtë Italisë.

Zambaku i shkroi Shtabit të Përgjithshëm për fitoren. Lëshoi thirrjen në pyll dhe priti jehonën.

Pjesa e katërt

111

I

Po rikthehej lufta, me një furi të paparë, në një kohë kur disa besonin se kishte mbaruar.

Invazorët gjermanë nuk i njihte njeri. As natyrën dhe teknikën e tyre. Vinin si të mbështjellë në mjegull, me uniformat gri, me armë që bënë krisma të tjera. Para tyre ecte lajmërimi i tmerrshëm: «Për çdo ushtar të Rajhut, njëqind të pushkatuar.» Diku e kishin zbatuar këtë kërcënim. Nga ana e Kolonjës kishin shfarosur një fshat të tërë, me gra e fëmijë.

Në Markesh rreziku gjerman ishte ende si një ndjenjë e turbullt dhe, sido të flitej për të, ai mbetej një gjëzim përtej maleve, që mund të ecte në rrugën e vet, duke e lënë mënjanë Markeshin e lirë, që po bënte ato lëvizjet e njohura për të kaluar një dimër të qetë nën dëborë. Po aty nga mbarimi i tetorit, pas luftimeve të ashpra në jug, ushtria gjermane kishte

arritur të çante me një vrull e fuqi që s'njihte pengesa. Këtë e ndjeu nga afër Markeshi, sepse në qendrën e qarkut ishte vendosur befasisht «Divizioni 297». Në ditët e para u duk sikur kjo njësi e madhe do të kufizohej në zhurmën metalike, të fortë e të përpiktë që bënte rreth vetes. Mbetej për t'u parë se ç'do të bënte ajo më tej dhe nga cilat anë mund të goditej. Zotëronte njëfarë hutimi, ndërsa arrinte thirrja e Shtabit të Përgjithshëm për t'i bërë ballë këtij armiku të ri, më i tmerrshëm, dhe më i rrezikshëm se çdo armik. Ca ditë më pas zunë të binin nga qielli fletëvolantet, me gjuhën e dyfishtë të premtimit dhe kërcënimit.

* * *

Baba Merxhani i tha Selman Gërvishtës:

— Do të vijnë anglezët këtu, o Selman, S'kam ku t'i çoj. Dy teqetë janë djegur.

Selmani rrinte si i fjetur, me gjerdanët kryq mbi gjoks. Ngriti kokën në erë dhe shikoi lart. Dimri po hidhte ngadalë hijen e vet mbi verën. Frynte era shqetësuese e perëndimit, që u hiqte puplat në ajër trumcakëve të majmë.

— Kushedi i ndërtojmë teqetë pas luftës, — tha Selmani. Nuk besonte se teqetë do të ndërtoheshin prapë. Babai mendoi se Selmani kishte qenë myhib me që s'kishte pasur ç'të bënte tjetër. Po çuditej që s'e kishte menduar këtë më parë.

— Të duhet kulla ime për anglezët? Kot më pyet, — tha Selmani. Në kullën e tij dykatëshe e me «burgjet» poshtë jetonin dyzet shpirt.

— Ku do t'i çosh fëmijët në ballin e dimrit?

— Në kasollen e dhive.

Babai e dinte se asgjëkundi tjetër s'mund t'i çonte.

— Sa të dalë dimri, pastaj e kemi lehtë, — tha Selmani, dhe buzëqeshi ëmbël, me sytë e kaltër. Babai ktheu kokën nga ana tjetër.

Të nesërmen erdhi anglezi i parë, kapiteni Smajëll, zëvendësshef i misionit. Ai tha se gëzohej t'i shtrëngonte dorën baba Merxhanit që e kishte kthyer Mar-keshin në një kala të rezistencës.

— Mirë se të vini, — tha babai dhe e përqafoi anglezin. — Do të gjeni mikpritje, me sa na lejojnë rrethanat e luftës.

— S'kam asnjë dyshim. Në Fushë-Lizë vazhdimisht më ushtojnë veshët prej erës, — tha me gjallëri anglezi. Përkthyesi ngriti dorën, nënqeshi duke rrudhur sytë.

— Era në Lizë nuk njeh mure. Natën fryn nga njëri krah dhe ditën nga krahu tjetër, — tha babai, duke treguar me dorë dy drejtimet e erës. Nënqeshte pa të keq, sikur të argëtohej me kujtimin e erërave të Lizës. Kapiteni e pa me dyshim, nënqeshi, po i pëlqente gjithnjë më tepër gjallëria dhe humori i babait. Shikoi malet dhe tha:

— Duhet gjetur një vend i lartë për radion. Ndërlidhja bëhet me Italinë dhe Kairon.

— Nuk do të hiqni keq për vende të larta, — tha babai.

Një javë më pas erdhi majori Çeshajër me përkthyesin, të shihnin edhe një herë vendin, të linin në Markesh një seri komplet radio transmetuese për t'u ruajtur, po që se misioni sulmohej befasisht në Fushë-Lizë.

Babai e ftoi majorin për drekë. Ky i tha se duhej të kthehej menjëherë. Atë natë do të zbarkonin shefa me rëndësi. Baba Merxhani i ndoqi me sy tek ikën rrëzë shkëmbit të teqesë, nëpër lajthishtë. Anglezi ishte burrë energjik, e drejtonte kalin e madh si vegël të mësuar. Prapa tij shpejtonte përkthyesi. Kur dolën te stanet,

anglezi e ngau kalin revan, përkthyesi u përkund, hap i krahët si për t'u kacavarur në erë dhe u zhdruk poshtë shalës së kalit. U çua, fërkoj trupin me duar, i bëri shenjë babait se ishte mirë, i hipi kalit prapë dhe eci drejt anglezit që e priste kaluar. Ata u zhdrukën prapa qafës, duke rendur nëpër luadhet e bukura të Rrallesnjës, drejt Fushë-Lizës, ku hera-herës vërtiteshin aeroplanët e tyre të ndjellë me radio.

II

Partizani që mbikëqyrte kalimin e urës, Ali Çela, ngacmonte fshatarët me qerre e kuaj, që shkonin më nxit drejt qytetit. Aliu donte të harronte veten. «S'jam bajraktar, që më rrini pas e prapa», — kishte thënë baba Merxhani dhe e kishte dërguar partizantin në kompaninë e dytë. Ndërsa ngacmonte fshatarët, Aliu mendonte gati duke qarë se nganjëherë babai bëhej zemërgur me ata që e donin më tepër. Një fshatar i fali Aliut tre pjepra dimërakë, ai shkoi te shokët përtej hendekut, ndenji këmbëkryq, nxori thikën, që e fshiu pas shallvareve, dhe i çau tre pjeprat në mes, me lëvizje të sakta. Në atë çast mbi skuadrën bëri hije trupi i komandantit të kompanisë, Qazim Salës.

— Nuk më pëlqen kjo gjë, — tha komandanti.
— Pse, mor burrë! — tha Aliu, pa kuptuar cila gjë.
— Si është puna? — pyeti Selman Gërvishta.
Komandanti shikoi urën ku shpejtonin fshatarët me qerre, hunda e tij e shtypur u duk edhe më e shtypur, tha:

— Këta nuk po reshtin që prej mëngjesit. Ç'është gjithë kjo dyndje për në qytet?

— Po është ditë tregu! — tha Aliu.

— Nuk më dukën fytyra të mira. Ku shkojnë gjithë ato lakra e bostane? — tha komandanti. — Kjo është një prej pikave nga dolën bajraktarët. Po edhe shtegu nga mund të kthehen.

Para një jave, batalioni kishte arritur në Dibrën e Madhe me marshim të pandalur. Aty do të mblidheshin edhe reparte të tjera, ndofta për një ndeshje me rëndësi. Prej një jave, kompania e dytë bënte rojë rreth urës së Spilesë. Selman Gërvishta shikoi fushat e pjerrëta të qeta në të dy anët e Drinit dhe tha:

— A ka gjëkund ndonjë portë që të shërbejë vetëm për të dalë?

Aliu qeshi me zhurmë, pastaj u kujtua se kjo pyetje i drejtohej komandantit dhe mblodhi buzët.

Komandanti rrinte i përkuluar mbi veten, mendohej me kokën pjerrtas, nuk ia vuri veshin pyetjes.

— A thua po kthehen me lakra e pjepra ata që ikën me armë! — qeshi prapë Selmani. Po në këtë qeshje të tij kishte një pohim. Ngriti kokën dhe mbajti vesh.

— Na zuri halli vërtet, — tha Aliu, — me gjithë këta fshatarë, — dhe ndenji duke parë urën dhe fshatarët, siç rri njeriu i rënë në hall, me thelën e pjeprit në dorë.

Komandanti vijoi të menohej, sikur poshtë tij të kalonte ujët. U kthye dhe pa qytetin që dukej sikur po fryhej. Aty më parë kishin qenë bajraktarët e mëdhenj në qytetin e Dibrës. «Keni 12 orë afat të niseni me ne në luftë, ose të dilni prej këndeje», — u kishte thënë komandanti partizan bajraktarëve. Prapa fjalëve të tij qëndronte Shtabi i Përgjithshëm komunist në Labinot. Bajraktarët mblodhën forcat, gati dy mijë veta, dhe dolën nga qyteti, kryeneçë e të fyer. Në të vërtetë ndienin gëzim të fshehtë, përgëzonin veten që dolën.

Ç'do të bënin ata kur mbi Dibër të turreshin gjermanët? Rrota e huaj po afrohej, qe vënë në lëvizje dhe do ta shypte që me vërtitjen e parë batalionin komunist.

— Ali, shko te baba Merxhani, lajmëroje se po hyn prej Radikës ky kallaballëk, — tha komandanti.

Prej fytyrës së shqetësuar të komandantit dhe më shumë prej zërit të tij, Ali Çela u bind se mbi urë po kalonte diçka e rrezikshme. U çua duke shikuar andej-këndeje sikur në sytë e tij lëkundej toka dhe tha:

— Po shkoj, për besë. — Ai nuk po lëvizte vendit nga hutimi.

— Hë, pra, se s'pret puna, — i thirri komandanti.

Ali Çela eci me hap të shpejtë në monopat, kaloi varrezat e italianëve, vreshtat, teqenë, bashkinë e vjetër. Po shkonte me detyrë të rëndësishme te baba Merxhani, ndofta duke shpëtuar qytetin. Nga larg Dibra i qe dukur si një ëndërr e bardhë, kurse nga brenda qenkësh ngjyrë kafe, e bardhë dhe e kuqe, me shtëpitë përdhese me qerpiç, ose dykatëshe me gurë, me kullat e vogla sipër. Nën strehët mbanin vargje me qepë, hudhra e specatë të tharë. Në oborre, mollët, dardhët e kumbullat kthenin drejt tokës degët e rënduara nga kokrrat. Në bahçe lulëzonin perimet. Në krahasim me Markeshin, Dibra me dhjetë mijë banorë, i dukej Aliut si një qytet ku njeriu mund të rrinte shtrirë, të zgjaste dorën e të hante ç't'i donte zemra, deri në fund të jetës. Dhe qytetarët, edhe pse shumica të veshur varfër, ishin si të pushtuar nga një lumturi e beftë, ecnin lirisht në rrugët me kalldrëm, të gatshëm të përfaqonin cilindo që kalonte në këto rrugë me një pushkë në krah, me yllin e kuq në ballë. Këtyre u bëhej qejfi fort të ktheheshe në shtëpitë e tyre për një kafe.

Në rrugën e madhe, zhurma u shtua befas. Nga dyqanet, nën hijen e strehëve, dëgjoheshin çekanët e za-

natçinjeve, me tingëllimën e zileve. Ishte sikur të ecje në një lëndinë të ngushtë pylli ku cicëronin zogjtë e dheut. Aliu e harroi krejt shqetësimin e vet, por para tij kishte qëndruar duke murmuritur bekime një plak i vogël me mjekër të bardhë dhe çallmën në kokë dhe Aliu u kujtua për baba Merxhanin. Atëherë shqetësimi iu rikthye me forcë, aq sa filloi t'i rrihte zemra. Qytetit dhe banorëve të tij sigurisht u kërcënohej një rrezik. Ai vuri re se edhe qytetarë të tjerë kishin ndalur anës rrugës dhe shikonin me njëfarë habie numrin e madh të fshatarëve, që nuk interesoheshin dhe aq për shitblerjet. Vargu i tyre sillej e vërtitej rreth tregut dhe kalonte me marifet në rrugën e spitalit, me qerret e mëdha të mbuluara me kujdes.

• • •

Baba Merxhani ishte në shtëpinë e një miku në lagjen «Vormallë», pinte kafën dhe fliste me atë zërin e çiltër autoritar, që të habiste me gjallërinë dhe forcën e vet. Në dhomën e madhe nja tridhjetë burra në gjunjë e dëgjonin buzagaz, gati me përgjërim, duke ndier menduar njëlloj si ai. «Paska pirë pak», tha me vete Ali Çela dhe iu duk gjë e bukur që babai të kishte pirë me ata burra aq të përzemërt. Të shumtët e tyre çuhej të ishin besnikë të tri teqeve të Dibrës, Këllëç-Baba, Shaban-Dede dhe Teqja e Shehit. Ali Çela mendoi me gëzim se të gjithë këta, fundi i fundit, ishin si gjashtë vëllezër, bij të Ali el Myrtezait, që mbarti trupin e tij pas vdekjes.

Babai po thoshte se qe goditur me top asambleja tradhtarë në Tiranë. Nënqeshi, foli për krerët e Ballit. Këta silleshin rreth Drinit me mendje të prishur e pa tokë. Kishin ardhur të gjithë, nga Mitati deri te Tho-

mai. Bajraktarët ishin shpresa e tyre, pesha e rëndë që duhej vërtitur me marifet për ta plasur kundër Partisë, në mos tjetër për t'i ndalur marshimin. Krerët e Ballit, të gjithë koka për të rënë, dhe tek thoshte kë-shtu, babai bënte me dorë shenjën e prerjes së diçkaje, këta krerë, pra, mbaheshin si mundnin pas bajraktarëve, në pritje të fuqisë së huaj të re, që do të mbush-te vendin. Të gjitha këto po i shpjegonte mirë e bukur baba Merxhani, si një profet i bektashizmit e Markeshit, duke ndier Aliu një krenari të madhe, sikur po i thoshte vetë ato gjëra të thella. Babai ktheu fytyrën ende të gjallëruar nga ajo që po thoshte, pa Aliun dhe pyeti:

— Hë, or gugash, pse ke ardhur?

— Më çoi Qazimi, — tha. Edhe vetë po habitej si hyri në atë dhomë dhe pse. Çfarë kishte për të thënë?

— Hë, pra? — pyeti babai. Pa hutimin e tij dhe tha:

— Hajde këtu, shoku Ali.

Aliu kaloi pas njerëzve, duke ndier mbi vete shikimin e të gjithëve. U ul në gjunjë dhe i pëshpëriti babait:

— Në qytet kanë hyrë fshatarë me armë të fshehura. — Armë të fshehura s'kishte parë, po ky mendim, që i ndriçoi atë çast në kokë, iu duk krejt i vërtetë.

Babai qeshi. Në fshatra po ngriheshin këshillat. Nga jashtë, në largësi, u dëgjuan disa krisma armësh. I zoti i shtëpisë që kishte hyrë me tabakanë në duar mbeti te dera.

— Bëhet dasmë diku. Dhe fshatarët le të hyjnë me armë. Hajt, gëzuar në liri, — tha babai.

Po biseda u ndërpre nga pasiguria e dyshimi. Krismat e armëve po afroheshin, duke pushtuar një pjesë të qytetit. Diku gjëmuan fort dy bomba dhe krisi një mitraloz. Kjo tanimë ishte dasmë e një lloji tjetër, babai e piu kafën me fund, u ngrit në këmbë dhe tha:

— Na fal armët, o i zoti i shtëpisë.

Kur bëhej gati të dilte, krismat erdhën drejt nga rruga, Baba Merxhani u hodh pas dritares në ballë. Nga fqinjët u dëgjuan britma. Babai i ra murit me pëllëmbë. Ishte bylme, njëlloj si të mbroheshe prapa një perdeje. Burrat në dhomë mbathën këpucët e opin-gat dhe prisnin të hutuar e të kërrusur.

— Dalim në rrugë. Drejt batalionit! — thirri babai.

* * *

Qyteti i Dibrës po sulmohej nga brenda dhe jashtë. Kjo filloi në orën 12.30 të 31 tetorit. Duke parë kalla-ballëkun e gjatë fshatar, shumëkush kishte dyshuar për diçka, po gëzimi i lirisë, bashkimit e fitores, i kishte pushtuar të gjithë, duke asgjësuar idenë e armikut. Kjo ide e mospranimit të armikut zotëronte ende në qytet, duke shtuar çoroditjen.

Në rrugë, baba Merxhani pa njerëzit të bridhnin drejt shtëpive duke ecur anës mureve. Vërshëllimat e plumbave vinin nga ana e spitalit dhe banjave publike, me ngulm, sikur prej andej të kishte dalë befasisht një armik i tërbuar, që synonte qendrën, ku do të kapte prenë e vet gjysmë të vdekur, për t'i ngulur thikën. Po shtinin edhe në drejtime të tjera. Babai mbajti vesh. Nuk kuptohej kush shtinte dhe kundër kujt, ngjante sikur të ishin xhindosur të gjithë. Kjo ishte një fyerje e rëndë kundër popullit dhe lirisë që e zemëroi keqas babanë.

— Drejt kazermave, — tha ai dhe zbriti poshtë kalldrëmit me hapin e rëndë. U habit dhe iu ngroh zemra kur Met Leka i doli përpara në kryqëzimin e rru-gës së Vakëfit. Edhe ai shpejtonte drejt kazermave, i

ndjekur nga një grup me partizanë. Babai që gëzuar fort një javë më parë kur e gjeti Met Lekën komandant batalioni në Dibër. Ky ishte miku, komiti që i shkoi natën në teqenë e Markeshit në prillin e vitit 1942.

— Kanë futur mercenarët në qytet dhe po sulmojnë nga jashtë, — tha Meti me të folurën e butë, sikur kërkonte ndjesë. — Të arrijmë tek kazermat, — tha dhe kërciti dhëmbët.

Baba Merxhani pa hidhërimin e thellë të mikut, si edhe forcën e tij, që shfaqet në kohën e rrezikut e të përgjegjësisë, sepse Met Leka ndiente mbi vete përgjegjësinë e atyre që po ndodhnin. Shikonte me fytyrën e zbehtë rrugët ku bridhnin njerëz, shtëpitë që po mbylleshin, mbante vesh krismat e armëve dhe thirrjet, një qytet që ra papritur në një pështjellim të madh. Ngadalësoi hapin me mirësjellje dhe tha:

— Do t'i thyejmë patjetër. Veç të arrijmë kazermat.

Rreth teqesë dhe nga kulla e Dacit, në skajin jugor të qytetit, shpërthyen bombat dhe u duk sikur po shembej diçka. Në rrugën e Hudovës u godit dhe u dogj e vetmja autobлиндë partizane. Krismat e luftës erdhën befas edhe nga veriperëndimi. Rrethi i zjarrit po bëhej përsëri më i ngushtë. Baba Merxhani ecte me gulçim në kalldrëm, duke mallkuar peshën e tij të rëndë. Në kohën që po hynin në kazermat, prej sheshit të tyre me dhe të kuq të rrahur, buçitën radhas gjashtë topa. Prapa baterisë rrinte me trupin të nderur e duke thirrur komandanti i artilerisë partizane, burrë i moshuar po i fortë, ish-oficer. Buçitja e topave ra si valë e nxehtë mbi muret, kazermat u drodhën si nga një tërmet. Duke u ngjitur në shkallët, baba Merxhani pa nga dritarja mortajistët në skajin tjetër të oborrit, që u ndalën një çast nga një urdhër, hodhën predhat në gypa dhe u prapsën. Krismat e tyre të thata u ndo-

qën nga vërshëllimat e predhave që u ngjitën lart me vërtik, si shpendë krahëmbledhur. «Qyteti shpëtoi», — i tha vetes babai.

Në katin e sipërm të kazermave Nikolla kishte vënë në punë katër mitralozë të rëndë, që shtinin nga dritaret e gjata, të ngushta, duke mbushur sallën me krisma e me erën e athët të barutit. Gëzhojat e verdha kërcenin në çimenton e dyshemesë, të shpejta, me ndriçimin e arit, me një tingëllimë që shquhej përmes kris-mave. Babai eci drejt mitralozit të tretë, largoi parti-zanin dhe kapi dorëzat e ngrohta, me erën e njohur të vajit. Përmes dritares pa një fashë të gjerë bregu ku lëviznin armiqtë, të vegjël, laroshë. Kur i vuri syrin shqekëzës, pamja u largua, si nëpërmjet një tuneli që zgjatej pa mbarim. Ai shkeli sustën, dridhjet e armës së rëndë i kaluan përmes krahëve në trup. Armiqtë e vegjël në faqen e gërryer të kodrës binin e ngriheshin për t'i shpëtuar plumbit. Babai ndërroi karikatorein dhe pa Nikollën te mitralozi tjetër. I kishte mbajtuar armët të pastra, i kishte drejtuar mitralozët me shkathtësi, pa e humbur mendjen, me gëzim, duke i futur këtë gëzim edhe kompanisë. Atë çast babai donte t'i puthte sytë Topolakut, t'i merrte kokën në gjoks.

Në mbrëmje, kur u thye për të dytën herë armiku, bateria e topave dhe tetë mortajat në sheshin e kazemrës shpërthyen qitjen e fundit. Flakët e tyre u ngjitën në dritaret lart dhe predhat e fuqishme çanë qiellin, duke e lënë ajrin të nxehtë. Baba Merxhani ndenji më gjunjë pas dritares, si një njeri që i falet zjarrit.

* * *

Met Leka fliste në telefon me të butë. Po njeriu në anën tjetër të fillit duhej të kishte mendjen, të

bënte pikë për pikë atë që kërkohet prej zërit të butë, gati lutës. Ai njeriu në anën tjetër të fillit duhej të çonte me çdo kusht përforcime në Kullën e Dacit dhe në ish-federatën, ku armiku po hapte frëngji nga jashtë mureve, që t'i digjte me benzinë. Sekretari politik i Dibrës, një djalosh i hollë e i gjatë, me fytyrën që i dukej edhe më e zvogëluar nën strehën e kapelës, shkruante diçka me ngut dhe hera-herës ndalej të dëgjonte bisedën në telefon. Baba Merxhani shikonte këta të dy duke pirë çibukun në prehje të thellë. Të djeshmen në drekë, kur bajraktarët dhe gjermanët goditën njëherësh nga brenda e jashtë, grupe partizanësh kishin nisur mbrojtjen me shpatullat në mur, nën urdhrat e komandantëve të rastit, siç kishte bërë Nikollë Topolaku te kazermat. Partizanëve u kishin ndihur qytetarët, gratë dhe vajzat, me thirrjen e vetme për të shpëtuar qytetin që u lëkund buzë humnerës dhe aty qëndroi. Kjo ishte mrekullia. Një orë më pas ishte parë se kush sulmonte e kush mbrohej.

Baba Merxhani po i kalonte këto në mendje, duke shikuar agimin e diellit përtej dritares, duke rrotulluar sytë rreth zyrës. Nga tryeza ku po rrinin ata të tre, gjeneral Aci, komandant i divizionit «Firence», kishte urdhëruar operacionin kundër Markeshit. Në mesin e shtatorit komisari i një kompanie partizane që paraqitur te gjenerali. — «Cilët jeni, çfarë kërkoni?» — kishte pyetur gjenerali. «Dorëzimin e divizionit», — që përgjigjur komisari. Tani divizioni prej pesëmbëdhjetë mijë vetash endej rrugëve nga Dibra në Krujë, duke u shpërbërë. Kishte lënë aty armët e rëndë, që filluan prapë qitjen. Artileria po godiste tani në disa drejtime, duke shtypur armikun. Kjo ishte një tjetër vërtitje e rrotës së luftës, se për herë të parë po ndodhte që batalionet partizane të godisnin me artileri një armik të armatosur vetëm me pushkë e mi-

tralozë. Baba Merxhani buzëqeshte, dy herë e pyeti Met Leka për diçka dhe të dy herët babai nuk e dëgjoi. Dëgjonte zemrën e vet.

— Dridhet, nuk dëgjova, — tha.

— Çfarë? — pyeti Meti.

— Dridhet zyra.

— Ah, po, — tha Meti, duke parë dritaret.

— Atëherë po shkoj, — tha sekretari.

Kur doli ai, Met Leka ndenji i menduar, foli me zë të ulët, si me druajtje:

— Gjermanët mund të sjellin përforcime. — Fytyra e tij e pashme, me mustaqet të prera shkurt, u zbardh. Foli me zë edhe më të ulët, gati si murmurimë, sikur t'i drejtohej shpirtit të vet. — Qytetin s'mund ta lëmë, se ata do të merrnin shpagë të rëndë deri te gratë. Po edhe të rrimë si në çark me tri batalione... Ata këtë duan, të asgjësojnë në përpjekje të mëdha forcat tona.

Babait i kaloi hareja që kishte në zemër aty më parë dhe po e shikonte mikun si i dalë prej një ëndrre. Ndërsa pyeste, Met Leka e kishte vendosur punën. Nuk do ta linte qytetin kurrë, se ky ishte një qytet i madh dhe tepër i dhembshur.

— As që duhet menduar të dalim prej këndeje. Edhe Shtabit të Përgjithshëm bashkë i përgjigjemi, — tha babai.

Met Leka ngriti sytë vetëm një çast, sa për të parë nëse fytyra e mikut ujdiste e plotë me ato që tha. Përkuli kokën me duart të lidhura mbi tryezë.

— Rrallëherë më është gjendur kush kështu në jetë, — tha duke buzëqeshur paksa.

Ditën e tretë sulmet e armikut e humbën fuqinë dhe shpresën, po shkoqeshin taboret e tij. Te kisha e Varoshit u dorëzuan mercenarët e parë. Për në Dibrenë e rrethuar ishin nisur forca të tjera partiza-

as gjethja që vërtitet në ajër. Barinjte që vërenin e i dinin këto gjëra të vogla, thoshin se ky dimër që po vinte pa u ndier, do të ishte më i ashpri që mbahej mend një brez njeriu.

Babai preku letrat që mbante në xhep. U çua dhe eci përmes lëndinës së butë si një njeri i ngeshëm, me duart prapa, duke i nënqeshur vetes. Në takimin e parë gjenerali i kishte thënë: «Kam qenë në disa vende të Afrikës dhe Palestinës, po asgjëkundi s'kam parë një komandant të tillë e të fuqishëm me çallmë e me mjekër.» Ndërsa i bënte këtë lavdërim, e shikonte babanë sikur të kishte gjetur në të diçka të gëzueshme, një mik të papritur që ndjell besim, sikur ndërmjet tyre të ishte bërë diku, në një pikë të panjohur, në anën tjetër të dheut, një marrëveshje që e dinin vetëm ata të dy. Në atë takimin e parë kishin bërë edhe fotografimi dhe gjenerali i kishte treguar babait se si zbriti me parashutë në Fushë-Lizë, ndanë përroit të vogël, në një natë me mjegull, duke ardhur drejt prej Kajros. Ndryshe nga anglezët e tjerë, gjenerali ishte me trup mesatar, i mbushur, i shogët, me kurorën e flokëve rreth kokës, me fytyrën të bardhë e me mustaqet të prera shkurt. Pëlqente shakanë, ndërsa mbetej përherë i rëndësishëm, e bënte bisedën me pyetje, duke dalë në shtigje të papritura. Tani ai prapë do ta shikonte babanë si mik të lashtë e të veçantë, ndërsa babai duhej t'i bënte disa njoftime të rënda e të prera, në emër të Shtabit të Përgjithshëm.

* * *

Gjenerali kishte kërkuar kuajt për pasdite. Për ku ky udhëtim? «I dashur baba — shkruante Enver Hoxha, — Miqtë që të erdhën aty po e lozin bishtin. Gjenerali është pjekur me Lumo Skëndon, me Bazin...»

Ky gjeneral kujdesej për atë anën tjetër, ndërsa hante bukë në kullën e Selman Gërvishtës së varfër. Këtë e shihte gjithkush, e ndiente edhe «Balli i vogël» i Markeshit. Rati shtrinte kurrizin prej kënaqësisë, me qimen përperjetë. Jeta e tij ishte ngushtuar, me ujët te gryka, kur i erdhën shenjat e para të shpëtimit. Italia mbaroi, po kishin dalë gjermanët, kurse anglezët ndodheshin brenda në Markesh. Kryepleqtë e vjetër, të lëvizur prej Ratit, shkonin rrugës me hapin e kafshës dinake, si të drejtuar prej një syri të fshehtë, e mbartnin këtë të fshehtë si me vete, duke pritur atë shenjën e madhe, shpërthimin nga një pikë e caktuar, ose nga shumë anë njëherësh dhe atëherë bota do të rrotullohej ndryshe.

Kulla e madhe majë bregut e Selmanit, me dy katet lart dhe «burgjet» poshtë, ruhej nga dymbëdhjetë partizanë të zgjedhur. Ushqimi ecte në rregull: mish, qumësht, vezë, patate, mjaltë, arra. Ishte ndërtuar furra e re dhe gjenerali kishte kërkuar zgjerimin e kullës me ndërtime të tjera, se aty bënte edhe ftohtë. «A thua do të qëndroni disa vjet në Markesh, zoti gjeneral?» «Kjo varet nga rrethanat e luftës. Mbase hapim një konsullatë të përhershme pranë baba Markeshit!»

Në oborr babanë e priti togeri Traihorn. Ky gjithnjë përgjonte diçka, punonte me radiot, ngjitej në majat. Kulla ishte si në heshtje të thellë. Kur rrinte gjenerali brenda, edhe të tjerët rrinin struktur. Që nga dhoma e gjeneralit doli shefi i shtabit, koloneli Nikols, me rrobat kaki të ushtarit të prera sipas masës, me shkabën e argjendtë në bustinë. Ishte dy metra i gjatë. U ndal para babait sikur do t'i thoshte diçka, i ngrirë, i përkulur. Ktheu kokën anash, a thua se kërkonte lidhjen me atë gjë që ishte biseduar në dhomë pak më parë. Po nuk hapi gojë, nderoi lehtas dhe eci drejt korridorit me dërrasa të vjetra, që kërcisnin nën

këpucët e tij me qafa. Mbase vuante nga një plagë e fshehtë në anën e djathtë, se nuk e hidhte këmbën lirshëm.

Gjenerali rrinte ndanë zjarrit në fronin e drunjtë me postiqe, i shogët, i mbushur. Përballë tij ishte për-kthyesi.

Gjenerali nisi bisedën plot gjallëri, por shpesh kruante tëmthin, harronte fjalën, ndër sy kishte diçka që nuk kuptohej, një trishtim të thellë. Babai u habit me këtë ndryshim të shpejtë që kishte pësuar fizionomia e tij, ndërsa dëgjonte pyetjet.

— E kishte njohur baba Markeshi Xhon Kingli Bërzhin?

— Jo.

— Gjynah. Ky ishte një anglez i ditur që botoi në vitin 1937 një libër të bukur për bektashizmin. Kishte qenë në Shqipëri, mik i kryegjyshit.

— Kam dëgjuar diçka.

Një nënoficer vuri mbi tryezë konjakun, solli arra, fiq dhe rrush të thatë.

— Gjithnjë më ka tërhequr bektashizmi, — tha gjenerali. Ngriti dorën, qeshi dhe tha: — Gjashtëdhjetë mijë anglezë janë bërë myslimanë. A e di baba Markeshi këtë?

Dhoma e madhe ishte rënduar nga armët, dylbitë, pajisjet prej lëkure, të varura në mure ose përtokë. Plasaritjet e dritareve ishin zënë me dyllë. Në oxhak bubullinte zjarri. Një qilim me vija mbulonte dyshe-menë me dërrasa të latuara me sëpatë. Kushedi ku e kishte gjetur atë qilim Selmani, poshtë të cilit çoheshin gungat.

— Sikur baba Markeshi të më fliste më çiltër për

misteret bektashiane, mund të bënte myhib një anglez më tepër.

Babai ndjeu t'i hipte gjaku në fytyrë, po fytyrën e kishte të mbuluar me mjekrën e dendur. Koha e kishte larguar gjithnjë më tepër nga teqetë, kurse ky gjeneral ia kripte plagën, e kthente hera-herës aty bisedën, duke e shikuar me vëmendje.

— Teqetë janë djegur, zoti gjeneral, s'kam ku t'ju dorëzohj myhib. Dhe sikur ta bënim këtë, zotrote duhej të më tregoje edhe ato të fshehtat e politikës, tërë jetën tënde... Raportet duhej të m'i bëje mua, mësimet do t'i merrje prej meje.

— Ah, këtu dalin vështirësi. Hyn në mes sekretit ushtarak.

Babai nuhaste padashur erën e këndshme të konservave e të çokollatës. Poshtë në kuzhinë gatuanin patate të thata me mish të grirë, qengj të pjekur.

— Aeroplanët tuaj kanë hedhur materiale në Mat për Abaz Kupin, — tha.

Gjenerali u mbështet në karrige. Rrinte butë në rrobat e trasha kaki, grykën e kishte të mbështjellë me jakën e trikos prej leshdeveje. Trokiti lehtas me grushta në fron dhe tha:

— Këtë muaj do të zbarkojnë materiale 28 aeroplanë, po janë penguar nga koha e keqe.

— Ndihamat duhet të shpërndahen vetëm me urdhrin e Shtabit të Përgjithshëm.

— Ju lutem, merrni diçka nga këto fruta.

Babai ngriti trupin. A përkthente mirë përkthyesi? Ai përkthente në rregull. Dhe gjenerali nuk ishte shurdh. Ishte i paturp.

Gjenerali shikonte zjarrin me ankth, me fytyrën të humbur, e kishte harruar babanë. «Gati po çmendem.

Është e kotë ta fsheh frikën. Natën shoh ëndrra të llahtarshme, sikur po më sulmojnë me thika», — i kishte thënë përkthyesit. Gjenerali sikur qe shembur nga brenda në dhjetë ditët e fundit. Rrinte si një i zënë në kurth, të cilit i fshehin të vërtetën tërë kohën, duke parë me dyshim e me ngulm sytë e njerëzve, ashtu si po shihte zjarrin. Ai vetë e dinte se këto ishin shenja të një neurostenie dhe bënte çmos të mbahej i qetë, po dyshimi e tërhiqte me forcë, i turrej befasisht nga kënde të papritura.

— Lajmëroni të mos hedhin materiale tek Abaz Kupi, — tha babai. — Asnjë punë s'kanë oficerët tuaj aty.

— Zoti Kupi është anëtar i Shtabit të Përgjithshëm.

— Po nuk do të jetë më.

Gjenerali u kthye i tëri me trup ndaj babait dhe tha:

— A mund t'i përsëritë këto fjalë baba Markeshi?

Në oborr binte rëndë sëpata e fshatarit që çante drutë. Babai ndiente siklet prej ajrit të ndenjtur, prej të nxehtit, dhe po shtrëngonte mendjen të gjente një përgjigje me dy anë. Nuk dinte a qe përjashtuar ato ditë Bazi nga Shtabi. Gjenerali i rrinte në pritë, me kokën rrumbullake të zgjatur. Babai e shikoi drejt në sy dhe tha:

— Bazi do të lidhet në vendin e qenit, aty ku e ka hak. Kështu e mendoj unë. Po ta takoni, ia thoni nga ana ime.

Gjenerali hapi sytë, u mendua dhe tha:

— S'kam si ta takoj. Këtu nuk hyn njeri pa lejen tuaj. Veç po të shkoj vetë.

— Për hir të sigurisë suaj, asnjeri nuk do të hyjë këtu pa leje, zoti gjeneral. Po edhe për të dalë duhet leja ime, se mund të bini në fshatra balliste.

Sytë e gjeneralit u ndezën prej mërisë. Ngriti zërin dhe tha:

— Kudo që shkoj unë është nën përgjegjësinë time.

— Po në Mat, te Bazi, e vranë dhe e plaçkitën një oficerin tuaj.

Gjenerali ndenji i menduar. Nuk i kishte pëlqyer as Bazi, as krerët e ballit. Duhet t'i raportonte qendrës në Kajro për bashkëpunimin e tyre të hapët me gjermanët. S'kishte më shpresë për ta.

— Gjenerali ju ka ftuar për drekë, — tha përkthyesi.

— Faleminderit, po kam një punë me ngut, — tha babai dhe u çua.

Gjenerali u ngrit, ndenji në këmbë dhe bëri diçka të habitshme. E kapi babanë lehtë te bërryli. Nëpërmjet gishtërinjve të tij komunikoheshin lutja këmbëngulëse që babai të rrinte për drekë, sikur kjo të kishte një rëndësi tepër të madhe.

— Tjetër herë, — tha babai.

Koloneli Nikols rrinte në krye të shkallëve me trupin të përkulur, sikur të shihte aty poshtë diçka që i prishte gjakun. Ndjeu babanë pas krahëve, u kthye dhe tha:

—Të shporren fëmijët. Na sillen nëpër këmbë.

Babai filloi të merrte frymë rëndë. Nënoficeri kishte dalë nga dhoma përdhese ku mbanin çadrat, arkat, parashutat. Togeri Traihorn rrinte në dritaren e tij, para diçkaje, si një njeri që falet. Babai mblodhi pështymën në grykë dhe e hodhi tej gurëve. Në të djathtë të oborrit, te korita, dy djem të vegjël të Gërvishtajve, po i ndihnin fshatarit të stivonte drutë. Kur panë baba Merxhanin, ndenjën pa lëvizur. Më i vogli

fshehu këmbët e zbathura prapa të madhit. Shndrisnin kokat e tyre të verdha.

— Hajde këtu, Kujtim, — i tha babai djalit të madh.

Djali deshi t'i puthte dorën. Babai i vuri dorën në kokë, ia pa fytyrën duke i ngritur mjekrën. I ngjante një këlyshi të egër. Po, duke e parë më mirë, mund të shihje në sytë e tij gjurmët e dritës ngjyrëkaltër, të qetë ngulmuese të Gërvishtajve dhe në ballin e vogël kryeneçësinë e tyre. Ishte i tretur e i uritur, po nuk do të ankohej kurrë. Djalë Markeshi. Kishte parë shumë gjëra te qiraxhinjtë e huaj, tepër urrejtje e habi qe mbledhur në shpirtin e tij, po edhe këto do t'i mbante për vete. Babai ktheu kokën gjatë prej mallëngjimit që zuri t'i rritej, siç i ngjiste shpesh kur mbante në duar fytyrën e një fëmije.

— Këta, — i tha kolonelit, — ju liruan shtëpinë, jetojnë në kasollen e dhive. Vjen dimër i ashpër, por më keq do të jetë për ta kur t'ia behë armiku, se do t'i djegë edhe gurët e kësaj shtëpie.

— A është i sigurt baba Markeshi se këtu do të vijë së shpejti armiku? A mund ta përsëritë këtë?

Babai nuk u përgjigj. Nënqeshi. I foli djalit:

— Mos u sillni në oborr, o Kujtim. Mbaroni drutë dhe shkoni. Të fala në shtëpi.

IV

Babai po ecte në Lugjet e Hasallajve, ca lëndina me blerim ku tretej bryma, rrethuar me kodra rrubullake me pishë, ndërsa përballë nxinte pylli i madh

i Kreshtës dhe përtej shtrihej qielli me dritë të kaltër të ëmbël. Në qoshet e mbrojtura të lugjeve duke-shin lulet e vona, si kopshte të mbjella prej njeriut, që nën motin e butë po ngrinin krye për herë të fundit, duke i kthyer farat tokës. Përmes një vendi të tillë ta ka ënda të ecësh pa pushim. Këtë e ndiente edhe mushka, që ulte kokën për të nxjerrë avullin dhe nuhaste me veshët bigë. Prapa vinin Nikolla dhe Rahmani.

Nikolla mund të ndizte zjarr edhe në shkëmb, të rrinte natën në shi e të ecte në mëngjes si një këlysh i gëzuar. Zbërthente e përdorte saktë çdo armë. Një fat i mirë kishte qenë ky djalë për batalionin dhe për Markeshin. I ndershëm, trim e gjakftohtë. Po ajo që i jepte më tepër rëndësi Topolakut ishte të folurit e tij të qartë dhe sidomos të shikuarit, gjithnjë si duke të pyetur nëse i ke punët mirë brenda teje, i gatshëm të të ndihmojë në çdo vogëlsi. Në dy muaj ia kishte dalë të krijonte celulat e Partisë në çdo kompani dhe byronë në batalion. Tashmë secili e dinte se çdo punë e mirë a e keqe që të ndodhte, do të shoshitej në ato mbledhjet e tyre të fshehta, që do të shfaqej pastaj në mbledhjet e kompanive, e folur me një gjuhë të kulluar. E gjithë kjo zinte fill te Nikollë Topolaku dhe, meqë kur je në një batalion secili synon për veten të bëhet më i mirë dhe, meqë për këtë çdo njeriu i duhet një shembull, ja tek ishte shembulli. «Hej, në pastë njeri që mund të hyjë në komunizëm, ky është Topolaku ynë», — kishte thënë Galip Nuri. Veçse Nikolla do të donte të merrte në komunizëm edhe Rahman Denën e Selman Gërvishtën, si edhe një pjesë të Markeshit, duke menduar tërë kohën për pjesën që mbetej.

Nikolla po i fliste Rahmanit. Ky e dëgjonte duke

ecur si me nge, me trupin e madh eshtak, me kapelën drejt mbi sy, siç ndodhte gjithnjë kur i fliste Nikolla. Pastaj Rahmani do t'i bënte një pyetje më tej për ta ngacmuar dhe po vetë do ta ndihmonte me urtësinë e tij të thellë për ta zgjidhur këtë pyetje. Babai ngau mushkën, duke thithur ajër, duke menduar se me shokë të tillë njeriu mund të ecë deri në fund duke luftuar çdo të keqe që ka sunduar botën. Si dervish, kishte pasur të ngulitur mendimin se e keqja që ndodhte brenda secilit dhe që arrin deri buzë fronit të zotit në kupën qiellore, do të mposhte prej besimtarit ngadalë, gjatë tërë jetës dhe do të arrihej vetëm në çastin kur ky besimtar do të bëhej pluhur, një me zotin. Kjo s'mund të ishte ndryshe, s'mund të ngrihej fija e barit kundër lumit. Ky mendim i errët e i marrë ishte bërë si një bosht i jetës së tij të vogël. Ai nuk dinte si e kishte duruar atë jetë, habitej se jo vetëm e kishte duruar, po nganjëherë edhe e kishte pëlqyer duke u mburrur me veten. Tani të gjitha këto ishin zhdukur, si në një përrua të rrëmbyer. Tani çdo e keqe do të shkulej shpejt, e tërë jeta do të sillej rreth një boshti tjetër. Ndryshimi që po u ndodhte njerëzve dhe atij vetë ishte aq i madh, sa nganjëherë shikon-te andej-këndej, i bëhej se diçka e ndiqte prapa.

Babai i shtrëngoi frerin mushkës dhe i ra lehtë në bark, si i kujtuar befas për ankthin që e mundonte prej një jave. Qetësia e rreme që sundonte rreth Markeshit dhe krahinave fqinje do të prishej, do të ngjiste diçka e paparë dhe e padëgjuar. Prej një jave babai ishte përpjekur të pajiste batalionin me municione e veshmbathje për dimër, kishte ngritur dy çetat territoriale. Në mesnatë kishte ardhur korrieri me letrën e Murat Podës, që thërriste shtabin e batalio-

nit në Korenë. Përse nuk vinte vetë në Markesh Murati? Kjo do të kishte lidhje me paralajmërimin e Enver Hoxhës. Babai zuri ta ngiste mushkën më shpejt, toka rrëshqiste nën këmbët e kafshës. U kthye t'u bënte shenjë atyre të dyve prapa. Nikolla gati po vraponte për ta ndjekur, i habitur me këtë nxitim të papritur të babait. Rahmani shtrinte sa më gjatë hapin e rëndë fshatar.

Tërë kohën duke kënduar nën zë këngë të gjata nga koha e teqesë, Ali Çela kishte bredhur përpara, me atë pamjen e lumtur e dinake të njeriut që ecën në rrugën e duhur e ku mund ta presin zbulime të papritura. Ishte kthyer prapë si shoqërues i babait. Shpesh i hapte zemrën vetes për ato vitet kur ishte qehaja dhe ia merrte në darkë me babanë. Po babai do ta dërgonte në shtëpi, sikur ta dëgjonte tani të këndonte për Qerbelanë. Me trupin e imët e fytyrën e mprehtë, me sytë e shpejtë të një trumcaku që nuk zë vend në asnjë degë, Aliu shtrëngonte pushkën në sup si ushtar dhe, ndërsa këndonte nën zë, shpejtonte hapin e shikonte kodrat e bukura, duke i thënë vetes se kujdesi i tij qe i kotë, askush në faqe të dheut s'mund të ngrinte pushkën kundër baba Merxhanit të shenjtit, megjithatë, kujdesi i ushtarit s'është asnjëherë i tepërt. Aliu kishte arritur me të ecurën e shpejtë në vendin ku zgjerohej lugina dhe nisnin bredhat. Zuri të djersinte në të përpjetën. «Ani, — po thoshte, — burri sa më tepër të vuajë e të lodhet, aq më i mirë bëhet.» Edhe pak e do të dilnin në Qafën e Pishës, shteg i pritave të vjetra, Aliu vijoi të këndonte, duke menduar se me këtë pamje të dëlirë të tij do të gabohej armiku i mundshëm rreth detyrës së Ali Çelës si pararojë dhe do të shfaqte veten. Atëherë Aliu do t'i shpëtonte jetën baba Merxhanit, duke, rë-

në vetë i grirë nga plumbat dhe, në netët dimërore në Markesh, do të këndonin për të me tamër, si për therorët e vjetër të bektashizmit. Kjo lidhej me dashurinë e tij të pafund për babanë e për shokët prapa, po edhe me njëfarë dëshire për një hakmarrje të mirë e të ëmbël, të mbledhur në shpirtin e tij, se nganjëherë i dukej që nuk i njiheshin shërbimet, nuk i çmohej sa duhej tërë ajo që bënte, natë ditë. Me zemrën vaj, aq sa t'i visheshin sytë, Aliu u ndal si para një vegimi, kur pa të vinin përballë pesë kalorës të hijshëm me trok të lehtë, ndryshe nga kalorësit që kishte parë gjer atë ditë. Dy të parët ecnin në krah duke folur. «Hej, sa bukur!» — tha Aliu gojëhapët. — «Miq të babait», — murmuriti kur u shqoi yjet e kuqe, kur pa se njëri nga dy të parët ishte Murat Poda.

Babai i kishte lënë mushkën Rahmanit dhe erdhi me hap të madh, me kapotën të mbërthyer, me fytyrën të skuqur e të qeshur, ngriti grushtin dhe thirri:

— Shoku Taras... Vdekje fashizmit!

Zbritën edhe kalorësit. Tarasi u puth me babanë duke u përkulur mbi të me trupin e hijshëm të madh, ia mbajti duart te supet, i foli me një zë të bukur e të thellë. Aliu pa se Rahmani e Nikolla kishin qëndruar më tej, sikur të donin të mos e tregonin veten. Aliu u kthye të shihte babanë me habi të shtuar. Prej nëntë vjetësh i kishte ndenjtur pranë si qehaja, pastaj si shoqërues dhe asnjëherë s'e kishte parë t'i merrej goja e t'i vërshonte ashtu gjaku në fytyrë. Aliu u kapërdi, zuri të shihte veshjet, armët, kuajt e miqve. Nga kureshtja po i kruhej trupi dhe hyri në mes t'i shihte nga afër, t'u dëgjonte fjalët. Ai ishte markeshas i vërtetë dhe do të qe afruar të shihte në

fytyrë edhe vetë Haxhi Bektashin. Dalldisë së tij i dha fund babai, që e kapi për krahu sikur ta zinte për veshi dhe i foli nën zë:

— Nga vrap te shtëpia. Të bëjnë konak e darkë për miq me rëndësi. — U kthye prapë nga Tarasi dhe tha se ishte i nderuar t'i uronte mirëseardhjen në Markesh.

Aliu u vu me gëzim edhe më të madh në rrugën e kthimit. Prapa u dëgjuan këmbët e kuajve mbi bargin e butë. Tarasi po thoshte diçka për luginën me atë zërin e thellë, të fuqishëm. Aliu nxitoi hapin. S'kishte asnjë dyshim se ndodhej në mesin e ngjarjeve të mëdha, po këtyre nuk dinte t'u jepte me mendje një trajtë, veçse ato do të ishin ngjarje të mira.

V

Babai dhe dy anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm shkuan për drekë tek anglezët. Gjenerali nuk e fshehu pezmatimin kur pa se nuk i erdhi vetë Enver Hoxha, po u çel i tëri kur i thanë se misioni ftohej të nisej për në jug me Shtabin. Ndenji duke menduar ato qytetet e vogla të çliruara në jugun e ngrohtë, si edhe Greqinë e afërt.

Kur doli prej andej, babait iu kthye lodhja njëherësh. Natën e shkuar s'kishte fjetur pothuaj fare. Vuri dorën para gojës dhe ndjeu erën e pijes së huaj. U nda nga shokët dhe u kthye te shtëpia e Hamdi Salës të flinte. U zgjua një orë më pas dhe ndenji shtrirë të mbante vesh, të kuptonte vendin dhe kohën. I

zoti i shtëpisë i thoshte diçka së shoqes nën strehën e shkallës së drunjtë, hyri në hajat me lëvizje të lehta dhe kërkoi një enë a një vegël. I ndihej frymëmarrja si gërhimë. Nga dritarja e vogël ra një rreze e verdhë drite mbi dyshtemenë prej balte, që u duk e lëvizshme dhe e butë, si toka e një kënete. Babai lëvizi si i sëmuri që kthehet në dyshek, duke besuar se po lehtëson dhimbjet. «Punët këtej nuk duken aq të lulëzuara sa në raportet tuaja», kishte thënë në mbrëmjen e kaluar Enver Hoxha. Kishte folur pak, po kuptohej se më pas do të fliste më shumë. Kishte thënë se divizioni gjerman «297» i përqendruar në qark do të niste lëvizjen. Ky numër i qe ngulitur babait në tru, sikur të kishte një domethënie të veçantë. Ku e mbanin ata të shkruar këtë numër dhe si e shkruanin?

Hyri i zoti i shtëpisë me faqoren dhe sahanin e djathit. Babai ndenji këmbëkryq, i bëri shenjë t'i merrte mbrapsht. I zoti i shtëpisë e pa me habi. E la tabakanë në stol, tundi plloskën e varur të shihte nëse kishte ujë dhe doli pa zë.

Babai shihte dritaren e vogël. Markeshi po kalonte në muzgun e natës që do të ishte e thellë dhe e ftohtë. Iu bë se jashtë zuri të frynte erë, duke përhapur në tokë një hije gri me ndriçim metal. Kërcënimi armik po merrte formë dhe zemër. Ata ishin ndalur rrëzë maleve duke thithur mjegullën e Veriut që sillnin me vete. Por do të ngjiteshin, porsa të thithnin mjegull të mjaftë, duke prodhuar me armët e tyre një zjarr të shpejtë, të saktë, të pamëshirë.

Babai zuri të merrte frymë rëndë. Markeshi ende nuk dinte gjë, as qarku. Nuk ishin përgatitur mirë për këtë armik. Kjo mungesë e gatitjes i takonte si-

domos atij, baba Merxhanit. Po i dukej vetja si një ka i zënë në dëborë që s'di nga cila anë të shfryjë. Po në orën tetë do të shkonte tek Enver Hoxha. Aty do të kuptonte se çfarë ishte lënë pa bërë. «Gjithsesi edhe helmetat e tyre i shpon plumbi», murmuriti. U çua, ndenji në mesin e dyshemesë së shtrembër, piu ujë prej plloskës së varur dhe ndjeu erën e mirë të drurit të lisit dhe erën e pyllit. Në sheshin «Belik» takoi Murat Podën, sekretarin politik të qarkorit.

— Po të kërkoja, — tha Murati. — Do të hidhem në Ndërfushë. — Dukej se zotëronte të fshehtën e diçkaje që do të ndodhte së shpejti. Po sqarimin e dha aty për aty. — Duhet të pres brigadën, — tha.

Babai u vu ta përcillte në shtegun e errët që çonte sipër lumit.

Po binte nata me shpejtësi. Në qiellin e Veriut vizatoheshin ende majat e mëdha të Kreshtës. Nga çatia e shtëpisë pranë u ngrit një shpend, ndofta një lakuriq nate që kaloi e u vërtit në errësirë si pëllëmbë dore. Murati e ndoqi me sy, qeshi dhe tha:

— Kishe kënduar në drekë te gjenerali për t'i rrëfyer krenarinë. Mbase shkaku ishte tjetër.

— Çfarë shkaku? — pyeti babai.

— Nga mallëngjimi që do ndahesh prej tij.

Murati mbulonte shqetësimin e thellë duke ngacnuar babanë, apo ai kishte vërtet një shpirt që s'e njihte tronditjen? Ato fjalët për «raportet e lulëzuara» dhe të tjera, Muratit ia kishte drejtuar Enver Hoxha. «Në qarkun tuaj po silleni sikur të kishim arritur fitoren», i kishte thënë. Këto duhej ta kishin përvëlur Muratin, po ai tretej nga brenda, kurse jashtë mbetej i njëjtë.

— Vërtet s'paskemi qenë kurrkund, — tha befas.

Babai pa profilin e tij në t'errët dhe iu ndrydh zemra. Murat Poda e mbante qortimin për vete, po nuk ngurronte ta përmendte dhe, njeriu që e dëgjonte, ndiente se një pjesë e këtij qortimi rëndonte edhe mbi të. Sa më tepër e njihte dhe e donte babai, aq më i vështirë për t'u kuptuar i bëhej nganjëherë ky burrë.

Babai qëndroi në vend dhe tha:

— Shoku Enver do të më pyesë për shtabin e Qarkut.

Murati ktheu kokën ngadalë nga shtëpia e teqesë, prej nga kishte dalë vetë pak më parë, dhe tha:

— S'ke rrugë tjetër, veç t'ia tregosh të gjitha siç janë.

— Përse i mbajmë në shtab Zambakun dhe majorin?

— Majori ka influencë dhe zotësi ushtarake. Zambaku është shoku ynë. — Nga mënyra si e tha, nuk besonte që «Zambaku është shoku ynë».

— Përse na duhen? — nguli këmbë babai.

— Në shtab jemi edhe ne të tjerët. Të kemi ty.

— Zambaku më pengon. Majorin do ta vija në plumb me gjithë qejf.

Murati qeshi, u mendua dhe tha:

— Në kohë lufte vënia e njeriut në plumb duket një fjalë goje. — E përqafoi babanë dhe shkoi pas dy partizanëve që do ta përcillnin.

Babai ndoqi me sy hijen e tij, trupin e thatë e të fortë që u tret në errësirë. Ishte rritur në internim e në arrati. Babai mendoi se ai gjithnjë ashtu do të ecte në rrugët e malësisë, pa iu ndarë qëllimit kurrë.

Markeshi ishte bërë papritur qendra e drejtimit të luftës. Baba Merxhani po ngjitej në udhëzën e shtëpisë së teqesë duke i bërë dritë vetes me fenerin. Në breg, prapa pemëve, doli roja dhe u duk sikur ngriti armën. Ishte me trup të shkurtër e të fortë, si i prirë nga streha e kasketës së vet. Babai ngriti fenerin afër fytyres. Roja tundi kokën me përqim. Babai u ngjit dhe i ndenji në krah, pa dhe një herë orën dhe snoi fenerin. Markeshi gatitej të fiinte. Ky gjumë u bënte njerëzve mirë, se ndoita nga nesër e prapa do t'u mbetej fare pak kohë për të ijetur. Babai po shikonte dritaren e nriçuar në katin sipër të shtëpisë së teqesë. Prapa asaj aritareje punonte njeriu që baba Merxhani kishte dashur ta njinte qyshkur i ra në dorë komunikata për krijimin e Partisë. Me kalimin e kohës, kjo dëshirë ishte bërë më e fortë, kishte marrë më tepër rëndësi. Në heshtjen e thellë të mbrëmjes dëgjohej tiktaku i makines së shkrimit. Enver Hoxha ngriti fitulin e llambës. Gjethet e pemëve e përcoollën këtë rritje të dritës në breg dhe tej mbi përrua. Vendi mbeti i qetë, i palëvizshëm, i rrethuar nga errësira e dendur. Babait iu bë se dëgjoji hapat e njeriut që ecte mbi qilimin e dhomës. Makina e shkrimit rifilloi me goditje më të qarta.

Ai e kishte takuar Enver Hoxhën edhe në Labinot, katër muaj më parë. Rrinte lart, te shtëpia e madhe, që dukej si e hapur për të gjithë. Në rrugët e Labinotit kalonin partizanë të Shtabit, korrierë me veshje të njëjtë, me armë të ndryshme, por që të gjithë me një drejtim të ngulitur në mendje. Kalonin edhe anëtarë të shtabit. Bisedonin nën zë. Aty zo-

tëronte fryma e lirisë me një konspiracion të mirë. Aty mund të kapje diçka nga e ardhmja e afërt, qoftë edhe në të folurën e të ecurit e njerëzve. Kështu do të ishte qeveria, kështu do të sillleshin të gjithë. Babai i kishte parë këto me një hare të zgjatur në zemër, si një pjesëmarrës i plotë i gjithçkaje.

Aty Enver Hoxha kishte folur për gjendjen. Ishte më i madh në trup e në shpirt, me dituri më të thellë nga sa e kishte menduar babai gjatë dy vjetëve. Babait i qe dukur se sikur të ishte ndalur edhe vetë në kuptimin e secilës ngjarje, mbase ashtu do të kishite menduar, siç po i dëgjonte. Po kjo e shquan prijësin, aftësia për të thënë atë që duan të thonë të gjithë, duke e folur ai për ta. Kurse më tej Enver Hoxha kishte folur për problemet e mëdha të luftës e të pushtetit, të cilat ngriheshin në lartësira që të merrnin frymën.

Të nesërmen kishin dalë në fotografi. Enver Hoxha i ndenjtur ulur, i mbështetur te babai, që ia mbante duart në supet e gjera, me dëshirën për ta zgjatur çastin sa më tepër. Ndërsa partizani kërcente andej-këndej me aparatën, Enver Hoxha e kishte pyetur babanë nëse i dinte të gjitha vjershat e Naimit, nëse e kishite lexuar librin e Samiut «Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet». Kur babai i tha se këto i lexonte prej vitesh, Enver Hoxha kishte thënë se ashtu kishte besuar që baba Merxhani i lexonte këto prej vitesh. Ashtu si të djeshmen babai qe përpjekur të kapte çdo fjalë, çdo tingull të zërit të qeshur e të thellë. «Zëri ka të bëjë me vetë njeriun», i kishte thënë vetes. Zemra e tij ia shpërndante gjakun me vrull. Në ato çaste askush nuk ishte më afër se ai tek ajo që ndodhte në Shqipëri dhe që përmbliedej te njeriu, të cilit baba Merxhani i rrinte prapa, duke e mbajtur lehtësisht nga supet.

U hap dera e ashefit poshtë dhe babai u gjend në rrymën e dritës. Aty doli një hije e butë, e njohur, që u përkund dhe qëndroi, kërkoi me sy në errësirë.

— Hë Nabije, — tha babai nën zë.

— Qyqja, pse po rri aty? — pyeti ajo.

Babai hyri pas saj në ashefin e ngrohtë.

— Mos na turpëro, Nabije, — tha.

Me fytyrën e skuqur flakë ajo tregoi mishin e varur në çengel që nxirrte ende avull. Ngriti gishtin nga dhoma lart dhe tha:

— Ka pirë dy kafe pasdreke. Po ti ç'ke kështu?

— S'kam gjë, jo, — tha babai. U soll rrotull ashefit me shpirtin të zënë dhe shkoi e u ul te kërcuri afër dritares, me pëllëmbët e duarve mbi gjunjë. Nabija ngriti fitilin e llambës, duke kafshuar buzën e me vetullat puqur. Aty më parë ndriste nga lumturia. Për disa çaste babai ndjeu ngrohtësinë e vatrës familjare ku s'mund të hynte por që duhej ta arrinte doemos në të ardhmen.

— Aq fort të mundon vërtitja e asaj rrotëze të vogël? — tha ai.

— Po mbarohet fitili, — tha Nabija. U kthye e nde-nji me duart prapa e tha: — Ti ke hall se do të shkosh te shoku Taras. Po prej tij del veç fjalë e mirë, e bukur. Zbriti këtu, bisedoi me mua dhe Aliun.

Babai e pa me habi të thellë. Fytyra rrumbullake e Nabijes ishte zbardhur. Edhe zëri i saj ishte tjetër zë. Vajza dukej grua e fortë, luftëtare, për veten, babanë dhe të tjerët, për çdo gjë të mirë që ka në botë. Babai nënqeshi, s'e kishte parë të tillë kurrë.

Nga dera e prapme hyri Ali Çela, lëshoi një krah me dru te vatra ku ziente një tenxhere dhe shkundi duart pas shallvareve. Nga fytyra e mprehtë, nga

sytë e shpejtë dukej se po e digjte kureshtja. U afrua dhe pyeti me atë zërin e ëmbël hileqar:

— Amanet, o babë, kush është shoku Taras? — I mehu fryma prej guximit të vet. Një natë më parë kishte pritur më kot në fund të shkallëve që babai t'ia merrte këngës me miqtë, duke e ftuar edhe atë t'ia mbante. Babai s'kishte kënduar, as i kishte bërë gjatë darkës ndonjë nga ato shenjat e njohura, s'qe shtruar fare raki. Ata veç kishin biseduar deri vonë.

Babai pa orën, u çua dhe mënjanoi Aliun. Pa lutjen e druajtur në sytë e tij dhe ndjeu pendim. E kapri te bërryli dhe i tha:

— Është udhëheqësi ynë. Më parë të të dalë shpirti se të hapësh gojën për të folur.

Enver Hoxha ishte në këmbë në mesin e dhomës. Përshëndetjes së babait iu përgjigj me kokë, me buzëqeshjen e qëndrueshme, me atë dritën në shikim që kërkonte thellë, së cilës s'mund t'i shmangie asgjë. Ata u ulën në minderet ndanë vatrës. Ishte hera e parë që babai ndodhej vetëm për vetëm me Enver Hoxhën.

Babai filloi të fliste për Markeshin, duke e shkëputur bisedën në copa. Enver Hoxha e ndihte me ndonjë fjalë dhe nga këto babai kuptoi se ai, megjithëse s'kishte qenë kurrë në Markesh, kishte një njohje të përpiktë të krahinës, po kjo nuk e pengonte të dëgjonte me dëshirë e kujdes, me interesim të thellë. Babai po shihte se, ndërsa vinte buzën në gaz, Enver Hoxhës nuk i ndahej nga sytë shqetësimi për diçka të rëndë. Babait iu kthye me forcë në mendje biseda e mbrëmjes

së kaluar, ato që po thoshte iu dukën pa rëndësi dhe heshti. Enver Hoxha priti:

— Ne këtej e kemi vështirë, shoku Enver, — tha babai.

— Në ç'kuptim?

— Më fort si shtab, si qark, dua të them.

— Nga ai shtab duhet të largohen menjëherë disa gjumashë, që janë ose hiqen të tillë.

— Komandant i shtabit jam unë, — tha babai, me duart grusht në prehër.

— Ti duhet ta ushtrosh më mirë fuqinë si komandant i atij shtabi, — tha Enver Hoxha. Kishte qortim në zërin e tij të thellë, po në të njëjtën kohë zëri ishte mbrojtës, bindës e paralajmërues. Babai pati dëshirën e çuditshme të dëgjonte qortime edhe më tej, tha:

— Shtabi është mbledhur vetëm një herë dhe jo i tëri. Na kanë dështuar edhe dy aksione të përbashkëta.

— Kjo është sikur shtabi të mos qe fare, — tha Enver Hoxha. — Kurse neve na duhet organizim ushtarak i vërtetë. — Ndenji disa çaste i menduar, me një dritë tjetër në fytyrë dhe foli si për veten, po edhe për babanë, tha: — Sa më të ashpra ndeshjet, aq më e afërt fitorja.

Babai hapi sytë. Besoi se pjesa më e vështirë e bisedës kishte kaluar dhe mori frymë.

— Armiku e sheh se ne kemi mundësi të krijojmë edhe Qeverinë pas Shtabit të Përgjithshëm, të çlirojmë tërë vendin, si i pari shtet në Evropë që çlirohet vetë, — tha Enver Hoxha. Kumbonte zëri i fuqishëm e i ngrohtë, që rridhte lirshëm. Babai u përmblodh. Nuk duhej të humbiste mendjen pas zërit. Du-

hej të kapte çdo fjalë, sepse ato ishin të një rëndësie shumë të madhe.

— Armiku s'mund ta pranojë këtë, — tha Enver Hoxha, — qoftë edhe thjesht si strategji ushtarake. Shqipëria ndodhet në prapavijën e gruparmatës gjermane me qendër në Selanik. Shqipëria është kyç në Ballkanin Perëndimor. Prandaj përgatiten kundër nesh me divizione të posaçme. Armiku ka vërshuar me energjinë e vet ushtarake dhe mbi reaksionin e çoroditur, duke e inkuadruar. Mbaroi druajtja, qëndrimi i dyshimtë i këtij reaksioni.

Babai shikoi padashur nga dritarja me kornizat prej druri të bardhë. Po i dukej se në errësirën dhe hesh-tjen e thellë mbledhesh një shtrëngatë që do t'i kri-dhte malet më poshtë. Në zërin e Enver Hoxhës u ndie hidhërimi, u përkul paksa përpara dhe tha:

— U kam shkruar shokëve me kohë për këtë rre-zik të madh. Po duket se disa shokë e vërejnë ar-mikun me më pak kujdes nga sa na vëren ne ai.

Babai mendoi se në këtë kishte pjesën e vet dhe ndenji me kokën mbi kraharor, i hutuar.

Enver Hoxha tregoi në hartën e vogël vijën e mbrojtjes që duhej krijuar rreth malësisë. Foli për të si duke kërkuar mendimin e babait.

— Këtu mund t'i ndalim gjatë, — tha babai.

— Duhet t'i japim kohë popullit të tërhiqet, — tha Enver Hoxha, — të tregojmë se diku edhe mund ta thyejmë këtë armik. Kam thirrur në këtë vijë dy bri-gadat e reja dhe gjithë forcat territoriale.

Babai ngriti kokën. Tani po kuptonte se ç'kishte bërë Enver Hoxha duke rrahur makinën e shkrimit natën e kaluar dhe gjatë ditës. Çdo njësit të vihej në lëvizje, çdo përgjegjës politik e ushtarak të ecte në drejtimin e duhur, sipas tokës, sipas kohës që mbetej. Kohë mbetej fare pak. Aeroplanët prapë kishin hedhur fletëvolante me atë gjuhën e dyfishtë të premtimit dhe kërcënimit, kurse pasdite, përtej maleve nga lindja, qe dëgjuar një buçitje e thellë topi të rëndë sikur të hapte gropa në qiellin e mavijosur.

— Kurse ti me forcat e tua të dalësh këtu, te Guri i Muzhaqit, — tha Enver Hoxha. Buzëqeshi dhe tha: — E pashë se aty të mbetën sytë, të pëlqejnë ato maja të larta. Në të vërtetë janë pika kyçe.

Enver Hoxha foli për fqinjët e babait në vijën e mbrojtjes duke e ndërtuar të qartë këtë vijë, përmendi disa emra të komisarëve dhe komandantëve. Babai habitej me besimin e pakufi që tregonte ndaj njerëzve; edhe pse u njihte dobësitë. Tregonte një besim e zemër të madhe sidomos ndaj atij vetë, baba Merxhan Dalipit. Dhe jo vetëm kjo. Enver Hoxha po i jepte babait shumë më tepër rëndësi nga sa kishte menduar ndonjëherë ai për veten.

Enver Hoxha ndenji në mesin e dhomës, jo si për t'i dhënë fund bisedës, po si për të kërkuar me mendje diçka tjetër të rëndësishme. Po rrinte me duart në xhepat e xhakëtës, me trupin e madh të lartësuar, me kokën paksa të ulur. Babai mallkoi veten që e kishte bërë atë dhomë të ngushtë e të ulët.

— Mund të vijë puna të shpërndahemi në njësi të vogla në prapavijat armike, — tha Enver Hoxha. — Po ky armik s'mund të qëndrojë gjatë në male, sado i përgatitur të jetë. Atëherë do të nisë kundër-

ofensiva jonë, do të vijë fitorja, që kërkon gjak dhe ky gjak duhet të jepet.

Në zërin e tij ndihej një dhimbje e krenari që e mbështolli babanë si me valë të nxehtë. U çua pada-shur dhe shkoi e i ndenji përpara. Kraharori i Enver Hoxhës iu duk më i zgjeruar. Babai i ngriti sytë më lart, në fytyrën e pashme, në ballin e qetë. Për herë të parë po e shikonte aq afër drejt në sy. Qe hequr pak në fytyrë dhe rreth syve me atë dritën e përhershme i qenë bërë rrudha të lehta. Ky ishte njeriu që mund të zotëronte shtrëngatën armike. Brenda tij kishte diçka që s'mund të thyhej, as të goditej. Nga kjo buronin të gjitha.

Drutë e lisit digjeshin ngadalë në vatër, me prush të madh.

— Prej tri ditësh s'kam lajme për lëvizjen e forcave në Jug, — tha Enver Hoxha, duke kaluar dorën në flokët e dendur të qethur shkurt. Nënqeshi dhe tha: — Një shtab i shkëputur, qoftë edhe një ditë, i ngjet një koke të prerë që jeton më vete. — Ngrohu duart në zjarr dhe tha: — Duhet të kaloj patjetër në Jug. Aty na presin punë të mëdha.

Zëri i Enver Hoxhës ishte miqësor deri në fund, një ftesë e hapur për t'i ndarë të gjitha bashkë. Babait iu ndrydh zemra. Po shihte se, falë trupit të fuqishëm, ai mund t'i bënte ballë çdo mundimi, po nuk e duronte kurrsesi shkëputjen.

— Kalimi do të jetë i vështirë në Shkumbin dhe përtej, — tha babai.

— Ti këtu mund ta kesh edhe më vështirë se ne,
— tha Enver Hoxha duke ngritur gishtin. — Po edhe ti do ta kalosh se populli të njeh e të do.

Enver Hoxha foli për udhëtimin e shtabit në Jug. E kishte bërë disa herë me mendje atë rrugë, përmendi fshatrat, stanet, vatë e lumenjve. Lëvizte pëllëmbët e duarve rreth zjarrit, a thua se po lëmonte me dashuri ato shtigje nga do të kalonte. Babai u përhumb dhe për çudi i shkoi mendja te fëmijëria e vet, pa atë djalin nëntë vjeç të lënë në kryqëzimin e një rrugë me baltë, me shpirtin në furtunë, që kishte në sytë e zez vrasjet, vdekjet, flakët e zjarrit dhe një urrejtje të madhe të vazhduar.

Drutë në vatër ranë më poshtë, u ngritën shkëndija.

— Nuk më fole për gjeneralin, — tha Enver Hoxha.

— Ka ndryshuar. Rri si në vetmi, zemërohet lehtë.

— Këto i vijnë nga tronditja shpirtërore. Nuk po mundet të bëjë atë për të cilën ka ardhur.

Babai prapë po shikonte duart e mëdha të Enver Hoxhës. Si çunak e si dervish kishte puthur duart e thata të baballarëve e dedenjve me një thyerje të shpirtit që i kishin kallur neverinë e përjetshme. Më pas, të tjerët i kishin puthur dorën atij, duke ia marrë në duart e veta, çdo ditë, çdo orë. E tërë jeta e tij kishte qenë një puthje duarsh, si numërimi i parave për tregtarin. Nëpërmjet duarve që i shihte edhe në gjumë, kishte mësuar të kuptonte gjendjen e vetë njeriut. Tani po shihte duart e hijshme të njeriut për të cilin kishte pasur aq shumë nevojë. U kthye dhe pa makinën e shkrimit mbi tryezën e vogël. Mbase me atë makinë kishte shkruar artikullin për çlirimin e Markeshit me emrin «Sali», si dhe letrat e babait. «I dashur baba!» Fjala baba nuk ishte vetëm një emër.

Biseda kaloi te fshatari markeshas dhe babai tregoi ndonjë gjë për veten. Në sytë e Enver Hoxhës u rrit drita sikur t'i shihte të gjalla ato që dëgjonte.

Babai mbajti vesh qetësinë e thellë të natës. Iu bë se në atë heshtje që të sillte ndër sy qelqin dhe ujin po dëgjonte kalimin e reve, që shpejtonin drejt Kreshtave. Zemra e babait ishte kapur në një lak të fortë. Ngriti sytë dhe e pa Enver Hoxhën ngultas. Ky ishte burri i madh që e kthente njeriun në një bisedë në mik për kokë, se e kishte gjithnjë të mbushur kupën e dashurisë për tjetrin. Enver Hoxha ishte shok e mik dhe në të njëjtën kohë udhëheqës i plotë. Kjo ishte një ndjenjë tepër e madhe edhe për një zemër si ajo e baba Merxhanit. Për të qetësuar veten hodhi sytë rreth dhomës. Në murin afër derës ishin kapota, çanta, armët e Enver Hoxhës të pastruara me kujdes. Nesër ai do të shkonte, po miqësia do të mbetet, me pamje të qetë nga jashtë, me diçka që dukej si e pakapshme, dhe që do të shkonte deri në fund të jetës.

VI

Tri kompani të batalionit u gjendën të ngulitura ndërmjet Shkëmbit të Teqesë dhe Shëmtrinë. Kompania e katërt me Rahmanin mbronte Grykën e Mërdhetës. Batalioni duhej të qëndronte në këtë vijë të fundit. Prapa ishte Lumi Dron dhe tej, në Qafën e Murlanit, po grumbulloheshin mercenarët.

Prej gjashtë ditësh, dy brigadat, batalionet dhe çetat vendëse e kishin ndalur armikun në vijën e shë-

nuar nga Enver Hoxha. Nganjëherë qe dukur se pyje e pllaja po digjeshin krejt nga zjarri i përqendruar i artilerisë armike, asgjë e gjallë s'mund të kishte mbetur aty. Pastaj dilyn batalionet, duke mbartur të plagosurit, për të kaluar në grykat dhe majat prapa. Ditën e gjashtë operacioni armik, që po i bënte rrethimin e madh malësisë shpалosi tërë fuqinë prej 6000 vetash. Brigadat dhe batalionet u gjendën të shkëputura, të shpërndara. Armiku kishte hapur rrugët e veta. Veçse, nga gjëmimet e largëta të artilerisë dhe nga raketat natën, dukej që reparte të veçuara, ndofta kompani, vijonin luftën në rrethim, në prapavijën e armikut.

Baba Merxhani po mendonte gjendjen e tij. Kishte ardhur ora të merrte një vendim, të shpërndante batalionin, ose të qëndronte në vijën e prapme e të fundit. Mendimi i shpërndarjes i kalte të ftohtët në zemër. Shkurti i kaluar s'mund të përsëritej. Po i dukej se në batalion zotëronte hutimi dhe njëfarë ngathtësie. Ai eci nëpër shiun e hollë të mëngjesit që po kthehej në dëborë për të dalë te Shkëmbi i Plakës dhe foli me disa nga partizanët. Atëherë pa se ngathtësia e tyre nuk vinte nga hutimi. Me një javë luftime të ashpra e të paprera, nga të cilat dolën për mrekulli vetëm me tre të vrarë dhe disa të plagosur, kishin arritur cakun e fundit, pragjet e shtëpive të tyre. Duke vënë re më mirë fytyrat e qeta, të ngurta e të vëmendshme, babai kuptoi se batalioni as që e mendonte shpërndarjen. Secili kishte rregulluar një pozicion shkel e shko dhe fuste kokën diku për t'u mbrojtur nga shiu i imët, këmbente ndonjë fjalë me fqinjin. Babai mendoi se kishte ardhur çasti kur njeriu vendos të përballojë çfarëdo rreziku. Kur arriti te Shkëmbi, ishte liruar nga çdo dyshim, kurse aty më parë i qe dukur se po i thinjej mjekra e lagur. Do ta prisnin armikun

dhe do ta thyenin, dhe, po të ndodhte më e keqja, kompanitë do të tërhiqeshin në grupe drejt Kreshtës së Vogël e Kreshtës së Madhe për të vazhduar luftën. Këtë ai e kishte menduar edhe në mbrëmje, edhe dy ditë më parë dhe e pushtoi një lumturi e beftë tek shihte me qartësi se ashtu do të ndodhte.

Erdhën fshatarë me kafshë për të sjellë bukën dhe babai mbajti vesh zërat. Që nga e djeshmja familjet po tërhiqeshin në stanet malore, në gryka e shpella. Prapa krijohesh zbrazëtira. Në sytë e babait u lëkund toka kur mendoi se çdo të ndodhte po të hynte armiku në Markesh. Prej një jave shihte zjarret në fshatrat. Që nga vegjësia i dridhej zemra tek digjej një strehë, kurse tani zjarri përpinte krejt malësinë.

* * *

Kompania armike e pararojës u shfaros përgjysmë në lëndinat e quajtura Kocajt e Balit. Gjysma tjetër u tërhoq me shpejtësi. Kjo ngjau në dhjetë minuta e sipër. Heshtja kërcënuese vazhdoi një orë dhe filloi qitja e fortë e topave dhe e mortajave të padukshme. Batalioni u krodh në shpërthimet që çonin lart dheun e lagët dhe gurët. Predhat shpërthyen befasisht rreth Shkëmbit të Plakës. Babait po i zihej fryma nga këto shpërthime, që nuk i linin kohë të mendonte diçka. I hipi dëshira të çohesh, t'i thërriste batalionit për t'u hedhur në sulm, ta shkulte armikun. Pastaj mendoi se duhej të qetësohej. Armiku mund të thyhej nga i gjithë batalioni, kur të shfaqej vetë me trup dhe atëherë të ndiqej këmba-këmbës. Veçse, duhej të gjente mënyrën që këtë t'ua thoshte të gjithëve. Një predhë topi u vërvit drejt tij me shungullimë, një dritë e bardhë verbuese dhe një krismë e rëndë e trullësën

krejt. Ai e pa veten përtokë, me një dhimbje të nxehtë në boshtin e kurrizit që i përhapej në tërë trupin. I dukej sikur merrte frymë në zbrazëti. Çdo gjë përflakej e nxehej rreth e qark, ndërsa dëgjonte me sytë mbyllur thirrje të forta e të shkëputura, i bëhej se toka po njomej me gjakun e kuq të markeshasve. Kur i hapi sytë, pa sipër vetes fytyrën e zbehur e të djersitur të Selman Gërvishtës. Të njëjtën djersë të luftës pa edhe në fytyrat e tjera, kur u çua, kur zuri të ecte. Selmani e çoi babanë prapa shkëmbit, në vend të mbrojtur. Kishte pasur vetëm një trulllosje, ndërsa dhimbja që i solli goditja e gurit në shpinë po i kalonte.

Pushoi artileria dhe krisën nga afër mitralozët dhe automatikët e armikut, me një ngut e dendësi që s'qe parë kurrë. Ky armik qe habitur dhe egërsuar me qëndrësën e papritur që po haste në fundin e udhëtimit. Kompania e dytë u mbajt fort rreth Shkëmbit të Plakës, e prapsi armikun, që dukej se po thyhej edhe në dy krahët e tjerë, sipër Shkëmbit të Teqesë dhe poshtë në Shmëtrinë. Babai pa një partizan të vranë te vija e ujit ndanë Shkëmbit dhe qëndroi më këmbë për ta njohur. Dukej si i flakur nga lart. Dukej të shihte doemos kush ishte ai partizan, po edhe të shkonte aty nuk mundej. Pak më lart ishte Lume Hanku, e çuar në gjunjë. Ai qëndrim i vajzës në gjunjë ishte i frikshëm, s'kishte të bënte me lëvizjen e një njeriu të gjallë. Babai hapi gojën t'i thërriste, po vajza u përkul mbi veten dhe ra me fytyrën përtokë. Babai u habit, se tani dëgjoheshin vetëm krisma të rralla, nuk kuptohej se ç'i ndodhi vajzës dhe eci drejt saj i ftohtë e i ngrirë. Qazim Sala arriti aty më parë dhe e ktheu Lumen në shpinë. Trupi i saj dridhej lehtë nga brenda, ujërën vetull e kishte të ngritur më lart, nënqeshte me sytë hapur ku po shuhej jeta. Që nga gushti, kur u vra Meti, Lumja e kishte kërkuar vdekjen në çdo

përpjekje, si për ta njohur, si për ta pyetur. Jo duke i dalë vdekjes haptas, po prapë duke e kërkuar, me një këmbëngulje të qetë, që i bënte shokët të kthenin kokën gjetiu, me turbullim të thellë. Qazimi u ul, ia provoi ballin, duke i vënë buzët, dukej sikur ai po mbytej prej hidhërimit, ngriti ndaj babait fytyrën e mbufatur dhe foli me një zë çuditërisht të hollë:

— Më në fund e gjeti vdekjen, më trimja dhe më e bukura vajzë.

Kishte filluar sulmi i dytë, me gjësimet e bombave me bisht dhe krismat e automatikëve. Ky armik do të çante pa llogaritur humbjet. Babai mbajti vesh, me mendjen te partizani i vrarë në vijën e ujit. Zbriti rrëzë gurëve që po mbuloheshin nga dëbora e hollë dhe pa se ishte Ali Çela. Dukej sikur që zgjatur sipër vijës të shihte diçka, me atë kureshtjen që s'i ndahej. Mund ta merrje për të gjallë sikur në fytyrën e imët e të mprehtë të mos i kishte rënë ngjyra e hirtë. Poshhtë tij po squllej dëbora në të verdhë. Babai ndenji duke e shikuar, ndërsa i ushtonin veshët nga krismat e afërta. Po mendonte se ishte duke parë një gjë që do ta shihte të gjallë përjetë.

Afër drekës gjermanët dolën sipër shkallëve të Balit. Në të njëjtën kohë dolën sipër Shkëmbit të Teqesë. Që andej një «Shars» filloi të shtinte me shpejtësi e me alarm mbi kompaninë e Qazimit. Kompania filloi të tërhiqej rrëzë malit, drejt Denës, po edhe nga ajo anë kishte dalë më parë armiku.

VII

Dëbora e trazuar me shi që ra në mëngjes kishte pushuar. Retë ishin ngritur më lart, të shtyra nga era, shpejtonin si për të shkuar në viset e tyre dimërore. Baba Merxhani e pa këtë qiell me dyshim. Duhej të binte një dëborë e paprerë që të shkarkohej ai qiell, po shenjë dëbore të afërt s'kishte. Poshtë digjej Markeshi, ngadalë, pa zë, shfrynin tymra të holla nga shumë anë, në një tokë që dukej sikur kishte zënë një kore të bardhë, të ngrirë. Zjarri, si një sëmundje e keqe, treste në fshehtësi çdo gjë, deri poshtë në rrënjët. Ashtu dukej nga larg. Sado ta shtrëngonte kokën babai, nuk arrinte të shihte me mendje atë që kishte ngjarë aty dhe që vijonte ende.

Ata po ecnin në pyllin që fëshfërinte, ndërsa shtohesh errësira, dhe drejtimi bëhej i pasigurt. Pak më tej retë kërcënuese u ulën më poshtë, si një masë e squllët ngjyrë plumbi. Në net të tilla çdo gjë mund të ngjasë, para se të arrish nën një strehë, të ndezësh një zjarr, të hash darkë, të hysh në një dyshek. Po as që bëhej fjalë për gjëra të tilla aty në Kreshtën e Madhe. Babai u ndal të merrte frymë, të mendohej. Një njeri i frikësuar mund të vrapojë në çdo drejtim dhe të përplasat diku. Frika s'të lë të zgjedhësh rrugën, as t'u marrësh gjërave masën e vërtetë.

— Mos shpejto, — i thirri babai Jashar Haxhiut që hiqte rrugën. Duhet gjetur një strehë para se të erret krejt.

— Veç po të gjejmë mullarët e dushkut, — tha Jashari.

— Gjeji, pra, — tha babai duke fshirë sytë dhe mjekrën e lagur.

Më në fund filloi të binte dëborë e butë, si më kot,

me ca flokë si insekte të mëdha, që kalonin poshtë për t'u zhdukur me shpejtësi. Po brenda një kohe të shkurtër, kjo dëborë do t'ia ndërronte pamjen tokës. Jashari i gjeti mullarët në çelthinë, u ndal i gëzuar me pushkën pranë këmbës dhe tha se mund të ndiznin një zjarr të vogël.

— Jo, — tha babai. — Do të flemë brenda mullarëve.

Në agim dëborë kishte arritur në gjurin e njeriut. Baba Merxhani doli prej mullarit që i kishte shpëtuar jetën dhe bardhësia që mbulonte pyllin i mori sytë. Dëborë do të ngrinte së shpejti, se që nga shpati i Kreshtës vinte si frymë e ftohtë, gati e pandjeshme, era e veriut. Po dilnin nga mullarët edhe të tjerët. Babai eci më tej buzë çelthinës, duke kërkuar një hapësirë përmes drurëve prej nga mund të shihte luginën. Që andej erdhi krisma e largët e një mitralozi «Shars». Babai mbeti në vend, si i zgjuar befas nga ëndrra e lemerishme që kishte filluar të djeshmen në mëngjes dhe që ndërprerë vetëm nga orët e gjumit të thellë e të lagësht të natës. U deshën disa çaste që e vërteta të kthehej e plotë.

Babai u mbajt në degën e pishës dhe u zgjat të shihte më tepër. Po nuk shihej asgjë, gjermanët ishin poshtë, nën tymin e nën mjegullën e lehtë. Prania e tyre ndihej vetëm prej krismave që shquheshin mirë. Pushka e tyre ushtonte rëndë, mitralozi «Shars» jehonte me dy zëra, si një turtull plak i rënë në hall, automatiku kriste befasisht, si britma e mëllenjës kur rraset në ferra. Edhe qitjet me topa e mortaja i bënin të shpejta e të sakta, a thua se edhe këto ishin automatike. Divizioni 297. Kundër kujt shtinin hera-herës? Kur u kthye te mullarët, të tjerët po e prisnin, fërkonin duart me dëborë.

— Nisemi, — tha babai. — Zbresim në Kreshtën e Vogël.

Jashari s'bëri zë. U nis përpara me pushkën në dorë, duke kërkuar shtigjet që do të hapte. Pas tij u nis Qazimi, edhe ky me pushkën në dorë. Në shpatullat e gjera kishte mbërthyer kasetën me municionin e mitralozit, hapin e kishte të sigurt, fytyrën e zeshkët të çelur, dukej sikur do të qeshte me hundën e shtypur. I treti ishte Selman Gërvishta, me rripat e fishekëve kryq në gjoks, me ato lëvizjet e ngathëta të qeta dhe si i përgatitur për të duruar një mundim të gjatë. Prapa tij do të ecte babai. E pesta ishte Nabija, me një kuresh-tje të vazhduar në sytë e zez, po edhe duke shikuar me merak. I fundit ishte Feridi me mitralozin e lehtë «Breda». Në këtë rreshtim ata do të ecnin rreth pyjeve shumë ditë e net. Këtë nuk e tha kush, po secili e dinte se ky ishte rreshtimi për t'u ndjekur, me babai Merxhanin në mes, duke menduar secili se e mira dhe e keqja prej tij do të vinte. Ai, babai, ende s'kishte folur se ç'do të bënin. Mbase bluante diçka në mendje, ose nuk dinte as vetë ku po shkonin. Gjithsesi, çdonjëri prej tyre e kishte vendosur të pranonte çdo lloj fati, me babanë në mes. Në kreshtën e Vogël nuk lëvizte asgjë. U ulën të çlodheshin. Filloi të errësohej qielli dhe të binte dëborë mbi dëborën e vjetër, në heshtje, duke ndjellë gjumë, nga i cili nuk do të çoheshin më.

— Zbresim në Rrallenjën e Madhe, — tha babai. Të tjerët e shikuan me dyshim. Çfarë shpresonte të gjente ai në Rrallenjën e Madhe.

Jashari po kërkonte shtigjet në pyllin me bredh e pishë, ngarkuar me dëborë. Kur të zbrisnin në Rrallenjë, do ta pyeste babanë nëse do të ecnin përmes Rrallenjës së Vogël për të dalë në Bal, apo do të dredhonin drejt Korenës, ashtu si ia donte zemra Jasharit, si edhe Qazimit që vinte prapa.

Predha e parë e mortajës kaloi në qiell, u ngjiti

lart duke udhëtuar me erën e dëborës dhe shpërtheu diku prapa, në faqen me pisha, një qitje e gjatë, që u shtri si krah i madh. Pastaj kaluan pesë predha të tjera, me ndërprerje aq sa të mbushej e të zbrazej gypi i thellë i asaj mortaje të vetme.

— Çfarë gjuajnë? — pyeti me druajtje e me gëzim Nabija.

— Gjuajnë më tym, rrahin pyjet, — tha babai.

Ata vijuan të zrisnin, me ndjenjën se po afroheshin gjithnjë më tepër drejt vendit prej nga niseshin predhat. Pak më tej hija e rëndë e pyllit çonte si në një hon të thellë. Aty Jashari qëndroi e mbajti vesh, u kthye te babai dhe foli me zë të ulët.

— Në rrugë kalojnë gjermanët.

— Hyjnë apo dalin?

— Hyjnë.

Që poshtë pyllit, fare pranë, erdhi zhurma e këmbëve të kafshëve dhe njerëzve, e mbytur dhe e vazhduar, si procesion i një varrimi, që do të kalonte nëpër lëndinat me dëborë për t'u derdhur mbi lagjen «Qytezë».

— Kthehemi lart, — tha babai.

Ata u kthyen në gjurmët e tyre, kaluan pyllin e errët, dolën në bregun me pamje të lirë dhe u ulën në trungjet, duke pritur të kthehej Jashari që do të këqyrte nga afër kalimin e gjermanëve. Nuk dëgjohej më zhurma e tyre. Dëbora binte e imët dhe e ftohtë.

Babai zuri të fërkonte gjurin, me maliherin në prehër, dhe shihte rreth maleve të Markeshit, sikur t'u maste largësinë dhe peshën. Nuk i ulte sytë më poshtë, në pellgun e djegur. Markeshi kishte qenë ashtu siç qe, i varfër e i fortë, i dalë prej pyllit e prej gurit, i mbajtur për qindra vjet me djersë e durim dhe, sa më shumë djersë e durim kishte kërkuar për t'u mbajtur, aq më shumë qenë lidhur njerëzit me të. Po

tani Markeshi nuk ishte më. Sa për njerëzit, babai nuk guxonte ta mendonte. Po i ftohej djersa dhe prapë shikoi rreth maleve. Iu duk sikur mbi pyjet e mbi fshatrat larg, deri ku shtrihej syri, përparonte një hije gri, që ndryshonte ngjyrën e tokës, pa kursyer asgjë, duke mbështjellë edhe grykën e Skuterrës dhe shkëmbin e madh të Balit. Kjo ishte vdekja me kryqin e thyer sipër. «Jam lodhur tepër», — tha me vete. Gojën e kishte të tharë dhe në kurriz ndiente shembjen që pësoi të djeshmen kur e flaku praptazi predha e topit.

— Për ne fillon lufta në prapavijat e armikut, — tha ngadalë. — Këtë e ka parashikuar Shtabi i Përgjithshëm. — Që nga e djeshmja s'kishte thënë veç ndonjë fjalë, kishte qenë tërë kohën si një njeri i gurtë, i pandjeshëm ndaj lodhjes e të ftohtit. Të tjerët e dëgjuan në heshtje, duke ndier vetminë e thellë, duke menduar tokën e tyre, të kthyer në prapavijë të armikut. Asnjeri nuk dinte nga kalonin rrugët në këtë prapavijë, ku fillonte e mbaronte armiku. Kuptohej vetëm kjo: do të bëhej një lojë që tani nuk kuptohej dhe aq, një arratisje e vazhduar nëpër dimër e dëborë, me rreziqe nga çdo anë.

Jashari kaloi në të majtë, nëpër një koriye me pisha të shkurtra, ndryshe nga çdo pyll tjetër pisha, se në të ishin ngjitur kulpra të shumta si një rrjetë damarësh që nuk i linin drurët të shkonin përpjetë, diçka që të merrte frymën. Aty dilte një burim, që nuk ngrinte as në dimër, se menjëherë varej poshtë shkëmbit, me buçitje të njëjtë, ku trazoheshin vërshëllima e tinguj të fortë. Për shkak të kësaj ujëvare ai nuk i dëgjoi gjermanët dhe u shtang kur i pa aq afër. Merr-

nin ujë me bidona poshtë shkëmbit. Jashari kaloi burimin, eci ultas në bregoren prej nga mund të shihte lëndinën. Edhe këtu u gjend fare afër tyre, aq sa mund t'u shihte edhe sytë. Ull fytyrën në dëborë dhe dëgjoi rrahjen e zemrës së vet. Duhej të tërhiqej, të rrëshqiste prapa, po e mbajti mbërthyer në vend një dëshirë e këndshme, e fortë për t'i parë e dëgjuar nga afër, i bindur se një rast i tillë nuk i takonte gjithkujt. Ata mbushnin lëndinën, bënin punët që duhej të bënte një ushtri në pushimin e drekës. I bënin si me përtim, po me ca lëvizje të kursyera e të sakta, të fituara nga praktika e gjatë, ose ngaqë të tillë ishin ata vetë dhe kjo të kënaqte syrin e të linte të habitur. Ishin të fryrë, si të ushqyer me grurë e me gjalpë, me fytyrat gati të bardha, me kapota të gjata të hirta. Në fund të lëndinave ishin renditur kuajt, të mëdhenj e me bishtat të prerë, të qetë, duke pritur tagjinë. Ishte sajuar si vetiu i tërë fushimi i tyre i shkurtër dhe rrinin më këmbë ose ulur. Jashari zgjati qafën të shihte se nga buronte fuqia e tyre e fshehtë. Po nuk arrinte të kuptonte. Këta ishin si një kallaballëk binjakësh, të heshur, si të lindur nga e njëjta nënë dhe prej tyre dilte një si afsh i vdekjes. Jashari fshiu fytyrën me pëllëmbë. Ndofta i dukeshin të tillë nëpërmjet dëborës së imët, që kalonte pareshtur. U thirrën disa urdhra, në një gjuhë me fjalë të shpejta, të thata e të forta, të cilave s'mund të mos u bindeshe në çast. Atëherë u bë një si trazirë, disa ushtarë u drejtuan nga pylli me sëpata të shkurtra. Jashari kuptoi se ata kishin mërdhirë, po ngrinin dhe do të ndiznin zjarre, në pritje të drekës. Nuk kuptonte përse kishin bërë këta një rrugë kaq të gjatë me mundime. Apo këta s'mund të jetonin ndryshe, veç duke munduar veten e duke shkatërruar të tjerët. Mendja e tij nuk arrinte më tej dhe rrinte i habitur, duke i thënë vetes së këtë ndofta do ta kuptonte më

pas. I mbetën sytë te diçka që nuk e kishte vënë re më parë. Në të djathtë të lëndinës, aty ku binte uji prej shkëmbit, disa ushtarë të trashë, të ngathët e mjekëroshë, që nuk dukej të ishin gjermanë, po silleshin rreth kazanëve që filluan të nxirrnin tym. Aty po thernin dy lopë që i goditën pas zverkut me thikë dhe kafshët u shtrinë duke nxjerrë ca pëllitje si me dhëmbët shtrënguar. Jasharit iu bë se pa në largësi gjakun në dëborë. Ishte tepër i zënë me atë që po shihte dhe me urinë e vet që iu rikthye duke e gërryer krejt dhe nuk i ndjeu dy gjermanët që po vinin drejt bregores me sëpata në duar. I dëgjoi të flisnin shkoqur dhe iu duk sikur po i kuptonte fjalët. Po i ngjiste si në gjumë, kur të duket se të hyjnë në kokë fraza të padëgjua dhe ti i zgjidh ato me ëndje e me lehtësi, sado të huaja e të vështira të jenë. Për një çast pati dëshirë të çohet në gjunjë e t'u fliste, të bisedonte me ta, t'i pyeste se çfarë mendonin nën helmetat që nuk i hiqnin nga koka, për ç'gjë kishin nevojë. Pas atyre të dyve po vinin edhe të tjerë me sëpata, me hapin e rëndë, sikur dëborë të mos i pengonte fare. Dy të parët qëndruan, duke shikuar pyllin sikur të ndienin praninë e një kafshe. Jashari pa në sytë e tyre një si hije frike e shqetësimi. E pa këtë aq të gjallë, sa doli krejt prej kapitjes dhe u kujtua befaz për rrezikun vdekjeprurës. Njëri nga gjermanët liroi rripin e helmetës dhe i foli shokut, u duk sikur i tha: «S'ka ku të shkojë, tani do ta kapim.» Ndërsa thoshte kështu, hoqi automatikun nga supi, gjithnjë duke shikuar brenda pyllit. «Po, po,» — u duk se u përgjigj tjetri. Jashari u dha duarve, rrëshqiti me trupin poshtë, duke tërhequr edhe dëborën. U çua dhe eci ultas pa u ndier. Pak më tej ishte pylli me pishat e shkurtra e me kulpra. Kur hyri aty, dëgjoi nga prapa disa thirrje të egra të

vrazhda dhe menjëherë krisi një automatik, duke vërshëlyer plumbat nëpër degët ku frynte erë që shkundte dëborën.

* * *

Po afrohej mbrëmja kur babai me skuadrën arriti përsëri te mullarët prej nga u nisën në mëngjes. Babai u ul dhe zuri të fërkonte gjurin, duke shikuar rrotull në hapësirë.

— Duhet gjetur ushqim, — tha Qazimi.

— Vërtet s'ka mbetur asgjë në trastë, o babë, — tha Selmani. Ai po shihte fytyrën mavi të babait të futur në mjekrën e lagur. Selmani mendoi se babai nuk do të kapërcente majat për të kaluar në fshatrat ku mund të gjenin strehë. Do të sillej rreth pyjeve, duke mbajtur në sy vendin e djegur, duke fërkuar gjurin.

Ata ndenjën në heshtje, me mullarët prapa, ndërsa në qiellin e ulët pakësohej drita. Asnjëri s'kishte dëshirë të fliste, nga rraskapitja. Po erdhi koha të shihnin njëri-tjetrin ndër sy, të gjenin atë që duhej bërë më tej dhe që dukej e vështirë për t'u gjetur. Frynte era e veriut që do të pastronte qiellin nga retë.

— Shko në Korenë, o Qazim, — tha babai. — Mund të arrish tek Guri i Ariut pa rënë nata. Dhe ti, Selman, zbrit në Denë. Ju pres këtu deri në mëngjes.

Ata të dy u çuan, duke menduar se kjo ishte puna për t'u bërë, të rivendoseshin lidhjet me jetën. Kur ikën ata, Feridi ndezi zjarrin në rrëkenë e thellë. Babai u ngroh dhe thau rrobat. Pastaj shkoi të flinte te mullarët. Po as aty s'mund të flije. Nga lugina poshtë u ngrit në qiell një dritë që të merrte sytë, u hap në majë dhe u kthye poshtë, duke përhapur dritën e ftohtë mbi brigjet dhe deri ndanë pyjeve. Ishte një

raketë që ndriste për herë të parë në Markesh, për t'u kallur frikën njerëzve të fshehur kudo që qenë, për të ndalur çdo lëvizje. «Ne shohim në çdo anë, në çdo skutë.» Zunë të hidhnin raketa edhe nga pika të tjera. Babai mbuloi fytyrën me jakën e kapotës së verdhë me gëzof nga brenda që i kishte çuar Shtabi i Përgjithshëm dhe mbylli sytë, ra në gjumë të thellë, duke menduar me njëfarë gëzimi se ishin gjermanët që i trembeshin errësirës.

Pas mesit të natës u kthye Selman Gërvishta dhe tha se gjermanët ishin me fuqi të mëdha. Në Markesh qe djegur çdo gjë dhe gjithçka. Një djegie më e plotë s'mund të bëhej. Kishin mbetur në këmbë vetëm disa kulla të armikut. Tha se vendi rreth e qark vinte erë mishi, lëkure e leshi të djegur. Gjermanët kishin marrë bagëtinë, po, duke mos i ditur ata «burgjet», hyrjet e fshehta, në disa shtëpi kishin djegur bagëtitë e mbyllura dhe era e tyre të shtinte të vjellët.

— Bariu s'mund të durojë erën e bagëtisë së djegur, — tha Jashari, duke dashur të ndihmonte Selmanin.

— Vazhdo më tej, — tha babai. Ai po shihte tani me pamje të gjallë vetë gjermanët, përmes flakëve që hidheshin lart pullazeve të shembura, shihte lëvizjet e tyre, po jo fytyrat. Kryenin një punë që duhej ta bënin brenda një kohe të shkurtër, pa lënë pas dore asgjë, që asgjë të mos gjenin më këmbë pleqtë, gratë e fëmijët, kur të ktheheshin, po të ktheheshin. Babai rënkonte lehtë, kishte shtyrë kohën duke pritur më të keqen.

— Çfarë të vazhdoj! — pyeti Selmani me të butë e me shqetësim. Pa si i dridheshin duart babait që ngrohte te zjarri.

Babai kërkoi me ngulm në errësirë sytë e Selmanit dhe i foli me grykën të zënë:

— A je marrosur. Trego për njerëzit.

Selmanit i qeshi fytyra, foli duke drejtuar trupin. Njerëzit kishin shpëtuar. Një pjesë e madhe ndodheshin në Gurëzat e Thata e në shpellat e Skuterrës, ku zor se shkelte këmba e armikut. Kurse dy kompanitë që u hodhën nga ana e Balit duhej të ishin me Rahmanin e Nikollën rreth malit të Mërdhetës. Gjermanët sundonin në lagjet. Xhandarët dhe ballistët ruanin shtigjet, vërtiteshin në baltën e gjermanëve. Babait i pëlqeu fjala, tundi kokën dhe tha:

— Vërtiten në baltën e gjermanëve! Po ç'do të bëjnë kur të mbeten vetë, o Selman? Po tjetër ç'dëgjove?

— Kërkohet baba Merxhani i gjallë ose i vdekur.

Babai mendoi se Selmani kishte dëgjuar çdo gjë që mund të dëgjojë njeriu dhe kishte sjellë një gjysmë buke misri.

Selmani trazoi zjarrin dhe nënqeshi, sikur të shihete në prushet diçka të madhe, të gëzuar, që nuk i përkiste atij vetë, as atyre që e dëgjonin. Tha:

— Markeshit, o babë, armiku s'i ka munguar kurrë. Ka qenë prishur prej turkut e sidomos prej serbit, i munduar prej Zogut e i djegur prej Italisë. Kështu qenka jeta, digju e bëhu. Po unë them se një prishje kaq të madhe ky vend s'ka njohur kurrë, më të fortë dhe se tërmeti i natyrës. Për hair. Baltën dhe gurët askush s'mund t'i djegë. — I ndriste fytyra, si e pjekur në zjarr, për këtë fat të rëndë e të çuditshëm të Markeshit.

— Për hajër, — u përgjigj babai.

Të tjerët u shikuan në heshtje dhe zunë të hanin bukën e thekur.

Doli hëna për pak kohë, në një qiell të largët mbushur me yje të ftohta, duke i dhënë dëborës një ndriçim pa ngjyrë, afër argjendit. Jashari do të bënte rojë, ndërsa Feridi me Nabijen po hapnin vendin te

mullarët. Babai u ngjit më lart, të shpinte trupin, të qetësohej. Gjatë tridhjetë orëve kishte pasur zemrën në varr dhe mendjen në luftë me ca hije të turbullta plot tmerr, qe vërtitur nëpër dëborë, duke tërhequr një barrë që s'mund ta mbajë shpirti i njeriut. Kishte kujtuar, pa arritur ta besojë, se aty poshtë gjermanët s'kishin lënë frymë njeriu të gjallë, si në Borovë të Kolonjës, si në ca fshatra të Jugut. Po shpresa e turbullt që s'e lë kurrë njeriun e kishte shtyrë përpara. Dhe ja tek dilte se populli i Markeshit kishte shpëtuar me katër-pesë të vrarë. Për hajër. Babai po lotonte nga brenda si nga një lumturi e beftë. Populli prapë ndodhej në rrezik e në nevojë të madhe, po markeshasi di si t'i bëjë ballë çdo të keqeje mjafton që kishte kaluar dallga e parë.

Babai u gjend i vetëm me zemrën që po i lirohej në mes të bredhave të bukur, të lartë. Nga ana e Rrallenjës pamja ishte e lirë, hëna qëndronte sipër e lodhur, e vetmuar, duke e mbështjellë botën në një ngri-rje të pastër, të qetë e të palëvizshme, si në një ëndërr. Sheshet e largëta e të ndritura të Rrallenjës u dukën si të gjalla me pyjet e errëta të pishave, që rrinin anash si grumbuj të dendur njerëzish të ndarë në lagje, duke sunduar dëborën. Po këto i bënte hëna në ecje, me dritën e saj të ftohtë, të gënjeshtërt. Kaloj një re duke e fikur kandilin e madh dhe u trazuan pyjet e malet sikur të mos kishte dritë në qiell, as hije mbi tokë. Duhej të qëndronte babai në vend që të qëndronte bota. Ai zbriti më poshtë, që të dilte prej kësaj turbullire. Nuk mbante mend sa net pa gjumë kishin kaluar, po ndjesitë e tij ishin rritur, ndiente edhe me lëkurën, dëgjonte së largu edhe krismën e një shkarpe, rënien e dëborës nga dega, që bënin jehonë në heshtjen fëshfëritëse, të thellë e të njëjtë të pyllit. «Si ujk i ndjekur», — mendoj.

Hëna ra pastaj mbi anën e bredhave të Fushë-Lizës dhe ai zuri të merrte frymë thellë, ngadalë, të pinte dritën e ftohtë. Dukej sikur edhe drurët kishin ngrirë dhe nën lëkurën e tyre të qe ndalur kullimi i rrëshirës. «Kam mbetur si zot i këtyre pyjeve», — mendoj prapë dhe nënqeshi. Zbriti te zjarri. Ngrohu duart duke ndier afrimin e gjërave të mira dhe hodhi dru të tjera. Përballë kotej Selmani. Te mullarët Feridi tregonte diçka nën zë. «Qyqja, kalamanët e shkretë», — thoshte Nabija.

VIII

Babai ngriti kokën me mjekrën dhe vetullat të zbardhura prej hirit dhe pa Yllin e Mëngjesit tek ndriste me pulsime të fortë në kufirin e natës dhe për një çast iu gëzua syri. Qazimi s'ishte kthyer ende, po kishite kohë të kthehej. Mendoj se mund të flinte edhe pak, u mbështoll me kapotën, me këmbët anës zjarrit, dhe zuri të kotej si i vënë në gjumë prej erës së kërcurrit të madh të pishës, që digjej duke u shkrirë, duke kënduar. Kur i hapi sytë prapë, u habit me agimin, që kishte dalë nga nata me një dritë që vinte si prej tokës e jo prej qiellit, me ngjyrën e qumështit të prerë, si agimi i parë i gjithësisë. Babai mendoj me një ndjenjë gëzimi se net e ditë të tilla njeriu i jeton vetëm një herë. Zuri të fërkonte ngadalë e me durim këmbët e krahët që s'po i bindeshin dhe u çua, zbriti te Jashari që bënte rojë ndërmjet dy pishave dhe dukej si i ngrirë. Babai u kollit dhe Jashari u kthye, erdhi lart, me trupin e gjatë të bukur, duke u përkundur në dëborë.

— Kanë ndezur zjarre nën Thekën, — tha.

Babai po shihte mustaqet e lagura të Jasharit. I kishte fërkuar vazhdimisht mustaqet dhe fytyrën. Ata ishin të dy rreth të dyzetepesave, Jashari dhe Qazimi. Ndërsa Feridi ishte ndofta pesë vjet më i ri, i shëndetshëm, me mustaqet furçë. Babai e dinte se ç'do të thoshte Jashari me zjarret poshtë Theknës. Shikoi nga ajo anë dhe lugina nën dëborë iu duk si e mavisosur.

Erdhi Qazimi prej Korenc. Në trastat e mëdha kishin te tri bukë misri, djathë, qepë, arra dhe dy pagurë raki. Tha se në Korenë armiku kishte zënë tërë shtigjet. Kërkohej Shtabi i Përgjithshëm, misioni anglez dhe babai Merxhani. Duke kërkuar, armiku bëhej përherë më i egër.

— Shtabi i Përgjithshëm ka kaluar prej ditësh në Jug prej nga drejton tërë luftën, — tha babai. Në këtë pohim të tij ngrihej një pyetje. Këtë e ndien edhe të tjerët dhe pritën të fliste Qazimi. Ky ngriti sytë e skuqur, tundi kokën si për të kthjelluar mendimin, me fytyrën e tharë e të zgjatur prej të flohtit dhe kapitjes.

Diku nga kodrat sipër lumit, krisi një mitraloz i rëndë «Breda», që jehoi në hapësirën e mjegullt e në heshtjen e thellë. Në të njëjtën kohë u dëgjuan fëshfëritjet e plumbave që kalonin lart mbi pishat si fjalë të fshehta.

— Ky mitraloz gjuan prej Majës së Gjatë, — tha Selmani.

— Ngrohu, fli pak, — i tha babai Qazimit. Ky u përkul me mundim mbi zjarr dhe fjeti ndenjor.

Më vonë, kur po niseshin, që lart nga pylli u dëgjua zhurmë, zbrisnin qenie të gjalla. Nga ajo anë, nga majat me tre metra dëborë, s'mund të vinte askush dhe asgjë. Ata pritën pas pishave, me armët në

duar. Zhurmat u bënë edhe më të qarta. Mbase zbrisnin kafshë të egra, po me mendjen dhe ecjen e njeriut, duke lëvizur dëborën me forcë. Pastaj u shfaq njeriu i parë, si i veshur me lesh të bardhë, me këmbët të zëna.

Këta ishin shtatë veta, bektashinjte e vjetër të Merqanit. Në këmbë kishin thurur rrjeta me thupra për të mos u kredhur në dëborë dhe ishin veshur me shajakë të bardhë. Po shkonin poshtë, në pyjet e Rrallenjës, të gjenin e të merrnin baba Merxhanin dhe u gëzuan fort, që po e gjenin shëndoshë e mirë, u ulën të heshtur rreth zjarrit të shuar.

Më i vjetri prej tyre, Çupi i fortë gjashtëdhjetëvjeçar, tha se dy ditë më parë kishte kaluar nga Merqani Galip Nuri me njëzet veta dhe kishte ikur tutje Grykës së Vogël për shkak të armikut. Babai nënqeshi, duke ndjekur me mendje Galipin që ikte drejt Grykës së Vogël. Batalioni kishte shpëtuar. Mbase jo i gjithi, po ky batalion do të mblidhej së shpejti.

Baba Merxhani u mendua ndanë zjarrit të shuar dhe tha se nuk do të shkonte në Merqan. Do të ngjitej lart në stanet verore të liqeneve. Parandjenja e diçkaje me shumë rëndësi e tërhiqte në ato lëndina malore. U përçafua dhe u nda me merqanasit. Çupi i vjetër tha se do të shkonte me baba Merxhanin dhe si të ishte fati.

Gjatë dy orëve baba Merxhani me të vetët ecën rrzë Kreshtës së Vogël duke u kredhur në dëborë. Nga larg u shfaq fusha e Rrallenjës me teqenë e djegur. Muret e saj dukej sikur thithnin mjegull. Prej andej zuri të shkëputej një si vijë e zezë që rrëshqiti ngadalë dhe erdhi duke u rritur e gjallëruar. Kjo ishte një kolonë balliste, që synonte Kroin e Niçit për të zënë qafën. Ecnin aq ngadalë, sa dukej sikur shpinin këmbët në vend, si një zvarranik që ka rënë në një çarçaf të bardhë.

Ai sillej në të njëjtat pyje me dëborë prej tri ditësh, si njeriu i lashtë, i ndjekur prej stuhisë armike që shfrynte nga çdo anë, që e ndiqte edhe aty lart në malet e akullta e që dukej se s'do t'i ndahej edhe sikur të ngrihej lart në qiell. Ky mendim e bëri të qeshte me vete. Edhe për sa kohë do të shfrynte stuhia armike?

Babait i dukej se po ecte në drejtimin e mirë, se i gjeti fijet që do ta lidhnin me jetën. Të ngjiturit u bë më i lehtë, se dëbora në faqe të malit kishte ngrirë dhe mbi të binte dëborë e imët, shkiste në gropa si miell dhe mbulonte gjurmët. Pak më lart, në ngjijtjen thikë, babait i duk se krahët dhe këmbët, i tërë trupi i tij, kishin ndryshuar peshë dhe ai duhej të mblidhte frymën për ta shtyrë më lart këtë trup. Lodhjen e kishte njohur edhe më parë, po ky mendim ishte tej lodhjes. I dhimbte gjoksi e i buçisnin veshët. Ngriti kokën dhe pa se retë u dyndën shpejt mbi Kreshtën e Vogël. Pas pak erdhi andej një stuhia aq e dendur, sa u duk se po mbështillte qiellin e dheun. Kjo nuk ishte më një rënie dëbore, po një trazirë, një errësirë e bardhë, nëpër të cilën nuk shikoje më tej se dhjetë hapa, nganjëherë edhe më pak, sipas shtëllungave të dëborës. Babai vijoi të ngjitej me kokën ulur. Fjolla dëbore i hynin me forcë në gojë, i shkrynin në dhëmbët, i binin në sytë duke ia zënë pamjen. Hera-herës duhej t'i kthente kurrizin stuhisë që të merrte frymë. Nuk dinte nëse po shkonin në drejtimin e duhur dhe ishte e kotë t'i fliste Qazimit që ecte para tij. Hapi sytë kur pa se kishin dalë në qafë. Aty dëbora u pre, po filloi të kalonte një mjegull therëse. Ata u strehuan nën shkëmbinj të dhe pritën të hapej pamja. Po mjegulla kalonte paprerë, frynin erë-

ra të holla si prej gjuhës së një qeni dhe shkonin poshtë në honet e dëborës, tej sheshit të quajtur «Drita e teqesë». Prej andej erdhi një krismë e largët mitralozizi. Krisma të mbytura pushkësh u dëgjuan edhe prapa, nga Kroi i Niçit. Rrugët ishin zënë nga çdo anë. Kaloi një kohë tepër e gjatë dhe babait zuri t'i ngrinte kapota kallkan. Iu bë mjekra shkorsë, i ngrinë qepallat. Shikoi lart strehën ku kishte futur kokën. Ndonjë tërmet a shembje e madhe e tokës i kishte çarë ata shkëmbinj të mprehtë, të hirtë, me damarë të bardhë. Prej tyre vareshin akuj të hollë që dukej se po zgjateshin përherë e më tepër. Babait i kalonin drithma, i dukej se trupi po i njësohej me mjegullën, kurse kokën e kishte të nxehtë, i digjej fytyra afsh. Zuri të mpihej, të mos i ndiente duart, po binte ngadalë në një kllapi të ëmbël që e tërhiqte poshtë dhe iu duk sikur fjeti në këmbë, me kurrizin të shkëmbi. Po ndihej i lirë dhe nga çdo përgjegjësi njerëzore. Këtë gjendje rehatie e mendoi disa çaste me dyshim, si diçka që e provonte për herë të parë.

— Çfarë ke? — e pyeti Nabija.

Babai e pa me sytë si prej qelqi, pa luajtur qepallat, e nuk foli. Nabijes i ngriu zemra, iu duk se babai nuk do të fliste më, se ai e kishte marrë me veten e tij këtë vendim për të mos folur më kurrë, meqë e pa luftën të humbur, ose ai po thahej ngadalë, po bëhej i tëri kallkan prej acarit. Nabija shikoi rrotull për ndihmë.

Po babai s'kishte ngrirë. I kalonte në mendje një kujtim i çuditshëm. Vite të shkuara, në fëmijëri, kishte parë një gjarpër në trupin e një të vdekuri në pyll. E kishte parë gjarprin me qetësi, tek zvarritej, i gjatë e i shndritshëm pa mbarim. E kishte mendjen të zënë me fytyrën e të vdekurit të huaj. Babai po i thoshte vetes se ashtu i ndodhte edhe tani. Nuk ndiente më të ftohët, se po e digjte nga brenda mendimi që arriti

fundi. Do ta gjenin aty me taçin si gur varri e me sytë e çelur, të ngrirë. Fjalët ndofta i tha duke lëvizur buzët dhe në të njëjtën kohë mendoi se kjo e folur me vete i ndodhte njeriut që ngrinte në dëborë. Kurse ai nuk duhej të ngrinte kurrsesi dhe as ta gjenin aty armiqtë me taçin në kokë. Fjalë të tilla bile as që duhej t'i dëgjonte kush, deshi të pështynte prej neverisë dhe lëvizi kokën ngadalë për të parë shokët. Iu duk se këta nuk mblidheshin më brenda vetes, rrinin zbuluar ndaj të ftohtit, siç bën njeriu kur trupi nuk ndien, mendjen e ka të topitur dhe fillon të ëndërrojë. Babai prapë i foli vetes, tha se shokët s'mund të liheshin aty dhe as populli i djegur i Markeshit s'mund të lihej rrugëve. Këto s'do të ndodhnin kurrë. Si ia tha vetes këto, zemra po i lirohej prej ankthit e shtrëngimit. Megjithëse gjymtyrët prapë i kishte të ngrira, filloi të ndihej sikur të kishte rrëkëllyer faqoren me rakinë më të mirë të thanës ndanë një oxhaku dhe i hipi dëshira të këndonte këngën e shtatë nipave të Shehut. Nabija hapi sytë mbi të me lemeri kur pa se diçka i lëvizi në fytyrë, në qimet e mjekrës. Ajo deshi të klithte, të hidhej mbi të për ta tundur. Po lëvizja në fytyrën e babait u kthye ngadalë në buzëqeshje dhe doli kënga, një herë e ngjirur, pastaj erdhi zëri i plotë, i njohur.

— Do të na dëgjojë armiku, — tha Qazimi. Deshi të vinte në provë veten dhe babanë. S'ishte puna tek armiku.

Babai e kuptoi, megjithatë i tha:

— Or gugash. Zëri nuk përhapet në mjegull... As tymi. Ecim më tej ku mund të ndezim zjarr. — Ndër-sa po fliste, lëvizi mbi këmbët. Kur e pa se mund të shqitej prej shkëmbit, doli me fytyrën në acar dhe tha: — S'kemi ardhur të strukemi si ujçit, as të flasim me drurët e pyllit. Na hiq rrugën ti, Jashar.

Ata zbritën njëri pas tjetrit dhe babai eci pas Qa-

zimit. Nuk ndiente më as lodhje, as të ftohtë, as dëshpërim. As që pyeste se ç'do të ndodhte më tej, mund të ngrinte në acar, ose të binte në pusitë armike, në zemër kishte vetëm një gjë, të ecte dhe të mbante pushkën gati.

IX

Ata po theknin në zjarr bukën e ngrirë. Mjegulla sillej me përtim rrafsh me dëborën. Nuk dëgjoheshin pushkë në asnjë anë.

— Armiku është gëposur prej të ftohtit, — tha babai, me fytyrën të skuqur e të qeshur, duke kaluar dorën mbi sytë e mbi mjekrën. Përmes avullit që nxirrte kapota e tij, filloi të dilte baba Merxhani i vjetër, ai i javës së kaluar, po ndryshe nga ç'e kishin njohur njerëzit. Trupi i tij i bëshëm e i rëndë paskësh qenë çuditërisht i fortë e i shkathët. Kërçelli i hundës i qe holluar, po sytë e zez i kishte më të ndritur. Kur Jashari solli një krah me degë bredhi dhe ia shtroi, babai u ul këmbëkryq. Ai hodhi sytë rreth grykës me mjegull, mbi katër ditët e shkuara. Dëborë kishte mbuluar gjithandej gjurmët e bredhjeve të tyre. Aty më parë i qe dukur se s'kishte qenë në asnjë vend dhe nuk do të arrinte asgjëkundi. Po tani e shihte ndryshe, kishte arritur në vend. Ky mendim po ia ngrohte trupin gjithnjë më shumë, ishte si i dalë prej një kllapie të madhe të ftohtë dhe foli me zërin e tij të vërtetë:

— Njeriu që e ka besën te populli kalon çdo rrethim.

Të tjerët ndenjën pa zë, duke pritur që babai të fliste më tej për gjëra të një rëndësie të madhe. Ai po shikonte rreth mjegullës, si për të kthjelluar një mendim, shikoi Çupin e vjetër prej Merqani dhe i tha:

— A e ke parë ndonjëherë veten më keq, o plak?

Plaku ishte mavijosur më fort se të tjerët, po s'e kishte humbur rëndësinë e vet. Rrinte brenda shajakëve të bardhë këmbëkryq. Lëvizi që t'i bënte vend Nabijes ndanë zjarrit, nënqeshi dhe foli si një orakull i dëborës:

— Më keq është vetëm vdekja, po ajo s'ka punë me burra si ju... as edhe me një plak si unë.

— Shoqja Nabije, na e nxirr atë pagurin, — tha babai.

Nabija u hodh në gjunjë dhe zuri të zgjidhte rripat e çantës, duke u fryrë duarve, duke i shtrënguar në sqetulla. I qe kthyer gjaku në fytyrë dhe ishte e lumtur.

— Po na vjen dikush, — tha Qazimi dhe u kthye me pushkën.

Nëpër mjegullën e dendur u dukën tre njerëz, që kishin ndalur më tej, te shtegu i sheshit «Drita e teqesë», dhe po shihnin zjarrin si të përkulur ndaj dëborës. Feridi qe hedhur te mitralozi. Babai u kthye me trupin në vend dhe ngriti maliherin.

Ata ishin tre partizanë të Shtabit të Përgjithshëm.

— Pra ai qenka kthyer te ne, — tha babai. Ndenji me bërryla mbi gjunjë dhe shikoi tre partizanët.

Ata ishin si të përcëlluar prej urisë dhe acarit, po dukej se këto nuk i ndienin, ndër sy kishin një që-

llim të ngulitur, të ecnin, të gjenin baba Merxhanin, të çanin rrethimin.

— Hë, pra, Nabije, tani duhet ai paguri, — tha babai. Nabija eci gjunjas dhe ia zgjati.

— Për shëndetin e Komisarit të Përgjithshëm, — tha babai. — Pini të gjithë, o çuna. — Kaloj pagurin rrotull, nënqeshi dhe tha: — Or gugashët e babës, ky operacion është si zjarri i kashtës... si ajo reja e vetmuar që shpejton sipër Kaptinës plot me shi e breshër. Po del dielli dhe prapë ndriçon bota. — Ai fshiu me pëllëmbën e dorës mjekrën e lagur, hovi i shpirtit të tij s'mund të ndalej, në zërin e fuqishëm derdhej me valë urrejtja dhe gëzimi: — Gjermanët e ballistët na janë hedhur në grykë, po ku do të jenë nesër? Maskarenjtë e tradhtarët. Ha-ha-ha!

Të qeshurit e tij të fortë mbushi mjegullën. Qeshën edhe shokët e tij. Tre partizanët e shtabit shikonin të habitur, pastaj qeshën edhe ata, duke kaluar pagurin rrotull.

— Ne erdhëm të vendoset lidhja me ju dhe të kthehemi shpejt, se Shtabi do të vazhdojë rrugën e vet, — tha partizani i parë.

— Si është ai... shoku Komisar? — pyeti baba Merxhani, duke u gëlltitur.

Partizani i parë tha:

— Vazhdon jetën si në çdo ditë të luftës... — Ndër-
sa fliste, zëri dhe shikimi i tij ishin gjetiu, andej nga kishte ardhur, sytë i ndritnin si prej një kujtimi të bukur. Kjo ndihej edhe më fort kur luante pëllëmbët rreth flakës, sikur do t'i piqte, mërddhinte nga jashtë dhe ishte i ngrohtë nga brenda, çonte lart mjekrën e fortë të parruar, sikur donte të dëgjohej në brigje. «Ka qenë bari», mendoi babai.

— Pra tërë këto ditë keni qenë rreth maleve me dëborë? — pyeti me druajtje ai.

Partizani e shikoi si nga lart, për ato fjalët «keni qenë rreth maleve». U mendua, nënqeshi me kokën mënjane, si nën sqetull. Në ballin e tij ende të lagur u mblodhën rrudhat. U duk sikur do të fliste për ato që kishte parë e jetuar, po ndërroi mendje, shtrëngoi telin me të cilin kishte lidhur këpucën me qafë me taban të djegur dhe foli si i turpëruar:

— E dini vetë se, kur je në mal, me trupin kallkan, i lodhur e i uritur sa më s'bëhet, era e dëborës zë e përvëlton më keq se zjarri, njeriu dremit e djeg në zjarr pjesë të trupit, sidomos këmbët. Atëherë harron edhe urinë. — Hodhi trupin lart, qeshi dhe tha: — Mishi i kalit të jep fuqi. Pak i athët, po pa erë, sikur të jesh më nge e ta pjekësh mirë.

Të tjerët e dëgjuan me habi duke parë me mendje ndodhitë e këtij njeriu dhe shokëve të tij. Ai hëngri copën e bukës, duke i mbajtur thërrimet me kujdes në pëllëmbë, ngriti edhe një herë pagurin, shikoi rrotull mjaft i kënaqur dhe tha:

— Tani, o shoku baba Merxhan, duhet të kthehem, se nga mosditja bëmë rrugë të gjatë.

— Çlodhuni edhe pak, — tha babai. I duhej kohë të mendohej. I qe rritur shqetësimi duke marrë me mendje ato që kishte hequr Shtabi, gjëra që s'duhej të ndodhnin në tokën e malësisë, edhe pse këto vise ishin të zëna prej armikut. Por tani ai do të bënte diçka për ta ndrequr këtë punë. Ngrohu duart në zjarr, sikur po e zinin ethet befas, dhe tha:

— Ti, Jashar, shko me shokët. Mos u nda më prej Shtabit. Kurse ne, o Qazim, një dash me disa bukë na duhet t'i çojmë sot në pyjet e Okshtunit.

Ditët e Jasharit dhe të Qazimit

Dëborë e ngrirë kërciste nën këmbë. Trupi i Jasharit ishte i hekurt. Ai ecte me një ndjenjë falënderimi për trupin e vet. Asnjëherë nuk i ishte dashur një trup aq i fortë sa aty në ngjitjen e malit. Më pas njerëzit do të thoshin, ja burri që i hoqi udhën Shtabit të Përgjithshëm, në rrethim e në tufan. Ai çante përpara dhe nuhaste në erë. Mund të thithte këtë erë e të ecte ditë e net, sikur të mos i rrinte mendja te kolona prapa, që shkelte në gjurmët e tij.

Po në cilin mal ngjitej Jashari?

Tani duhej t'i pohonte vetes se po ecte në tym. Viset e njohura kishin marrë befaz trajtë të paqenë, ai pinte mjegull dhe ecte me shpresë se do të diktonte diku ndonjë shenjë, por çdo gjë dilte e huaj, armiqësore. S'mund të ecte më tej me nuhatjen e tij, duke tërhequr njerëzit prapa, dhe qëndroi të shihte rrotull, me ankth të shtuar, si para një humnere pa fund. Ngriti kokën lart, sikur të kishte lakun në fyt. Ai ishte njeriu që po çonte Shtabin e Përgjithshëm në humbje. Ktheu sytë ngadalë prapa dhe priti.

— Humba rrugën, — tha.

— Si kështu, o Jashar! — tha Enver Hoxha. Pa pikëllimin e madh të Jasharit dhe tha: — Do ta gjejmë rrugën.

Enver Hoxha u kthye dhe foli me njeriun që mashte në hartë dhe që kishte thënë në mbrëmje: «Jemi në lartësitë 1837 metra.» Si kishte thënë këtë, ata ishin ndalur të ndiznin zjarre, të flinin në dëborë mbuluar me çadra, sikur kjo lartësi prej 1837 metrash të kishte qenë pika ku mund të flihej. Jashari kishte besuar se mund të ngrinin krejt, po në mëngjes kolo-

na qe vënë në rrugë për të arritur Okshtunin. Enver Hoxha po mbronte hartën me trup, shikonte busullën. Jashari u lut në heshtje që puna të dilte mirë, po ajo gjilpëra që lëvizte si në zemrën e tij foli ndryshe, tregoi drejtimin e gabuar, mundimin e kotë.

— Ec në të majtë, nga ana e Zabzunit, — tha Enver Hoxha.

Jashari u vu prapë në krye. Nga ajo anë vinte një si dëborë e shurdhër, e njëjtë dhe e ftohtë që ndryshonte tokën pareshtur. Nuk ishte e lehtë të mbaje vijën e drejtë nga e majta që shënonte gjilpëra, se kishte përrenj, kodra e pyje. Po Jashari do të hapte sytë që të binte me doemos në ujudi me busullën dhe çante përpara, me zemrën e ngrohtë. Pak më tej e njohu vendin dhe dy orë më pas ishin në majën e malit mbi Okshtun, nga ana e Zabzunit. Zbritën më poshtë dhe u ndalën.

Kishin humbur kohë, duke bredhur në stuhi, ishin rraskapitur. Jashari rrinte ulur rrëzë shkëmbit dhe tani shihte qartë, si një njeri që i del pija njëherësh dhe zë e sjell në mendje dëmet e pandreqshme që ka bërë. Disa përpiqeshin të ndiznin zjarr, me shkrepëse e qiri. Zjarri ishte shpëtimi. Jasharit i dukej vetja i huaj e i tepërt, i lënë jashtë, i mbuluar me turp. Ai rrotulloi kokën me dhimbje. Te shkëmbinjtë mbi krye kishte myshk. Jashari u çua, zhvati myshkun trazuar me akull, e hapi në vendet e thata dhe e ndezi me uror. Mblodhi shkarpa e gjethe në rrëzat dhe bëri zjarr. U afruan njerëzit dhe Jashari kërkoi sytë e tyre, donte të lidhej përsëri me ta.

— Ma trego si bëre, — tha një zë miqësor sipër tij.

— Ja, shoku Enver, me myshk.

— Të lumtë, — tha Enveri. Shkoi më tej dhe foli me «Plakun». — Tani është koha e rezervës sate, — i tha.

Njeriu që kishte vënë rutinë e qumështit mbi zjarr që mbathur me opinga lope dhe, kur i shtohet dhimbja në këmbët e ngrira, lëvizte sa në një anë në tjetrën, me mendjen të puna që bënte, t'i jepte çdonjërit tre gisht qumësht me ujë. Mbërthente sytë të vija e kutisë, me përqendrim, me ndjenjën e njeriut që ka caktuar masën. Megjithatë fytyra e tij mbetej e ndehur, si mbi një provë që edhe mund të mos dalë. Nuk i ngrinte sytë mbi njeriun në radhë që merrte rutinë, ndiente praninë e tij dhe vijonte i patrazuar ato matjet deri në gramë.

Partizanët dhe anëtarët e Shtabit merrnin secili pjesën e vet, tre gisht qumësht me ujë, dhe ktheheshin ndanë zjarreve, pinin ngadalë dhe në heshtje, si të ngopur, pastaj ia jepnin fqinjët rutinë bosh. Hanin pa ngrënë dhe bindnin veten se as që u duhej më tepër.

Jashari i buzëqeshte vetes. Në çastin tjetër i dukej se qante nga brenda. Prej dy ditësh po shihte gjëra të habitshme që nuk ndodhnin te njerëzit dhe prapë mendonte se këta kështu duhej të ishin. Kur i erdhi radha të merrte rutinë e qumështit, bëri të njëjtat lëvizjet që kishte parë të bënin ata.

Njeriu me opinga lope që ndante qumështin i çoi racionin Komisarit të Përgjithshëm, Enver Hoxhës.

— A janë të gjithë në rregull? — pyeti ai.

— Në rregull, — u përgjigj ai me opinga lope. U mendua dhe tha: — I vogli, ai gjashtëmbëdhjetëvjeçari. I priten gjunjët, i djegin sytë.

— Thirre, — tha Enver Hoxha.

Djali i vogël kishte parë turbull kur kapi rutinë, kishte kafshuar teneqenë. Po fshinte gjakun në anën e buzës kur dëgjoi emrin e vet. U çua dhe shkoi me hap të drejtë tek Enver Hoxha, u përkund dhe nderoi me grusht.

— Pije këtë, — tha Enver Hoxha, duke i zgjatur kutinë e tij.

Djali u lëpi, tundi kokën. Një gjë të tillë s'do ta bënte kurrë.

Komisari i Shtabit të Përgjithshëm pa fytyrën e vogël të djalit, lëkurën e verdhë, sytë e mbushur me ethe. Në trupin e paktë të djalit bëhej përpjekje në tehun e thikës. Vdekja do ta shuante jetën e tij e shumta pas një dite e një nate tjetër.

— Ulu këtu, — tha Komisari.

Djali u ul, me një bindje prej fëmije, dhe buzëqeshi, sikur të kishte dalë papritur në një breg të ngrohtë e me dritë. Pastaj u kujtua se prej tij mund të kërkohej një gjë që s'bëhej dhe hapi sytë.

— Tani pije, — tha Komisari i Shtabit të Përgjithshëm.

Në qetësinë e thellë të pyllit djali dëgjoi veten e tij që tha:

— Jo, kurrë. — Uli kokën mbi gjoks, lëvizi duart në dëborë që të çohesh, pastaj fshiu buzën me fytyrën e frikësuar.

Enver Hoxha u mendua, i foli me zë të butë, qortues:

— Kjo dënohet. Në Ushtrinë Nacionalçlirimtare ka disiplinë të hekurt. Urdhri i komandantit është ligj. Ti e di këtë. E di mirë. Unë jam komandanti yt. Pije qumështin të gjithë.

Enver Hoxha kishte folur gati nën zë. Po gjithkush mbante frymën, siç ndodhte sa herë fliste, dhe ato që tha u dëgjuan të qarta. Jashari u lut me mendje me ngut që djali të kapte kutinë, të pinte, t'i bindej në çast zërit të thellë, një zë që Jashari s'e kishte dëgjuar kurrë më parë. Djali po shihte në zbrazëtim, si njeriu që ka buçitje në veshë, dhe dukej se po merrte frymë me ankth e me ngut, duke ndier fajin e rën-

dë, shkeljen e disiplinës, që s'mund të ngjante. Kapi kutinë me të dy duart dhe e piu krejt, pa e ndier në trupin e tij lëngun jetëdhënës që po i hynte në gjak.

— Tani ti mund të udhëtosh edhe tri ditë të tjera, i tha Komisari i Përgjithshëm.

Kolona ishte çuar dhe djali hyri në rresht, duke shikuar rrotull. Kërkonte medoemos prej fytyrave të shokëve një përgjigje. Brenda vetes kishte atë lëngun që i takonte tjetërkujt, njeriut me trupin më të lartë që mbante në këmbë kolonën. Djali iu nguros fytyra. Njëri prej shokëve i hodhi dorën në sup dhe eci bashkë me të, duke i thënë diçka, duke e mbajtur me kujdes. Enver Hoxha po mbërthente kapotën. Jashari priti te rruga, me një shtrëngim rreth grykës, duke parë shpatullat e tij të qeta. «Si kështu, o Jashar», kishte thënë. Jashari mendoi se ndodhej në një ditë kur një fjalë e vetme rëndonte më shumë se jeta. Enver Hoxha e pa tek priste, i tundi kokën, vuri buzën në gaz, duke i thënë në heshtje se kishte besim, që Jashari të nisej, të provonte për herë të dytë. Jashari filloi të ecte në zbritjen e rrezikshme të malit, duke çuar me opingat e mëdha një si pluhur dëbore, që ia ndiente afshin. Doli dielli dhe shndriti dëbora, u bënë të afërta malet e qeta, ndërsa frynte një erë e mprehtë. Kjo dritë i hyri Jasharit në shpirt, po ecte si në një botë tjetër e megjithatë të njohur. Kjo ishte dita për të vdekur e për të jetuar, ai do t'i priste të dyja njëlloj, mjafton të bëhej «kalimi». Tani e dinte se asgjë nuk do ta mënjanonte nga drejtimi i duhur edhe sikur të kthehej një mjegull më e errët se nata. «Ja, kështu, shoku Enver.» Në kalimin e përroit pa kolonën që vinte prapa, pa atë djalin e vogël me pushkën në sup. Dukej sikur kotej, po në të vërtetë ecte mirë. Djali kishte zbatuar urdhrin dhe kishte pirë qumështin e Komisarit të Përgjithshëm. Dukej se ende nuk arrinte

të pajtonte këto dy gjëra në shpirtin e tij dhe prandaj ecte duke u kotur. Më pas kaluan përruan anglezët dhe në fund vinte Qazimi. Jashari donte ta zgjaste hapin, po duhej edhe të ujdiste me fuqitë e kolonës që në dy ditët e fundit ishte ushqyer vetëm me kokrra misri të thatë dhe me ata tre gisht qumësht. Befas qëndroi, bëri diçka që as e kishte ndër mend. Priti të kalonin tre partizanët. I katërti ishte Enver Hoxha. «Dal të ta shkund pak kapotën, se të rëndon prej akullit», — i tha Jashari dhe i shkundi me duar supet, gjoksin, fundin e kapotës. Enver Hoxha i vuri dorën te supi dhe e pa në fytyrë nga afër. I foli me zë të ulët, i tha se nuk bënte dobi, kapota do të ngrinte prapë pak më tej, duhej ecur që të qarkullonte gjaku. Kjo e folur ishte si një këshillë, po edhe si duke i kërkuar Jasharit një mendim prej miku. «Po, po, shoku Enver», — tha Jashari. Doli prapë në krye, zuri të ngjitej në pyllin me gropa për të dalë në Qafën e Dushkut. Gropat aty ishin si hinka ku mund të mbytej njeriu dhe Jashari hapte sytë, kalonte rreth tyre si gjahtari ndanë leqeve. Pa se Enver Hoxha po kalonte me hap të njëjtë rreth hinkave, me trupin e madh, të drejtë. Jashari donte të ndalej prapë, t'i thoshte se ndiente njëfarë rreziku për Qafën e Dushkut. Po ndofta kjo ishte vetëm një dëshirë e tij për t'i folur prapë dhe Jashari u turpërua me veten, zuri të ngjitej më shpejt. Atëherë dëgjoi kriçmat e largëta të armëve, që i erdhën si prapa veshit dhe ia ngrinë zemrën. Ndenji në përgjim dhe erdhi gjëmimi i mbytur ogurzi i një daulleje që mbeti pezull mbi dëborën e mbi drurët. U kthye tek Enver Hoxha, me hap të gjatë, ndenji para tij, duke marrë frymë me zor, me kokën mbi gjoks.

— Qafa është e zënë? — pyeti Enver Hoxha.

— Po, — tha Jashari dhe ktheu kryet nga ajo anë sikur të kishte plasur toka.

— Të kalojmë nga Qarishta, — tha Enver Hoxha.
— Ecim. Më lart ndahemi në grupe.

Jashari mori drejtimin e Qarishtës. Nga e dinte Enver Hoxha Qarishtën? Këtë Jashari do ta mendonte më pas, ashtu si gjithë gjërat e tjera që po i ndodhnin prej dy ditësh. Nuk ndiente të ftohtë, «i qarkullonte gjaku», veçse i lotonin sytë prej thëllimit. Po lutej që armiku të mos e kishte zënë Qarishtën, sa të kalonte Enver Hoxha, dhe qeshi me vete, duke menduar se njeriu s'mund t'i lutet armikut dhe djallit.

Në Qarishtë nuk kalohet. Armiku ka zënë fshatin, çdo shtëpi, shtigjet dhe qafat. Presin t'u bjerë në dorë Shtabi i Përgjithshëm.

Përsëri një natë në dëborë, kësaj here pa një kokërr misër në xhep. Në cilën lartësi? Hijet e njerëzve nën drurët lëvizin rreth vetes, mbështeten, ulen të flenë. Kapitja e gjumi i tërheqin poshtë, në një prehje të thellë, pa fund. «Çohuni!» Çohuni! Urdhër i Komisarit të Përgjithshëm, asnjëri të mos shtrihet.» Jashari rri pas një druri pak më tej, duke pritur se ç'urdhër do t'i japë Enver Hoxha.

* * *

Në kthim ishte radha e Qazimit të humbiste rrugën.

Sa kohë kolona ecte përpara, Qazimi vinte prapa me anglezët. Tani Qazimi ecte në ballë, me trupin e shkurtër, po me këmbët hekur, me hundën të shtypur që në vegjëli. Ai i priu kolonës dy orë, nëpër faqet e malit me gropa konike, në një stuhi të rëndë. Pas dy orëve kolona u gjend përsëri në pikën e nisjes, te vendi ku kishin kaluar natën. Qazimi nuk kuptonte se kush ia kishte marrë mendjen, në cilën pikë i mbeti mendja prapa, duke u tretur në stuhinë e dëborës.

Jashari që i rrinte në krah, i tha se ashtu i kishte ngjarë edhe atij. Nuk ishin të zotët të gjenin rrugën në vetë malet e tyre.

Busulla e Komisarit të Përgjithshëm tregoi se duhej zbritur në Fushë-Studën, për të ngjitur edhe një herë Zabzunin. Kolona dha e mori me dëborën e re në fushën që ngjante si një kënetë e bardhë. Qazimi u kthye dhe pa anglezët, gjeneralin. Mbase tani gjenerali kuiste nga brenda si dhelpira, duke e parë kolonën të zënë në lak. Në faqen e malit të Zabzunit Qazimi gjeti ahurin e bariut, ndaloi aty që të çlodhej kolona, të ndiznin zjarr. «Ec pa u ndalur», — tha Komisari i Përgjithshëm.

Më në fund Qazimi pa përtej Qafës fshatin Okshtun. Tymra të holla mikpritëse ngriheshin prej çatave të zëna me dëborë. Mund të ishin edhe tymra të pabesa. Asnjëherë s'mund të gjykosh nga ngjyra e tymit.

Kolona po pushonte, sa të kthehej patrulla. Moti ishte zbutur dhe Qazimit i hipi dëshira të bisedonte me dikë të afërt, të ndiente gjallërinë e njeriut. Shkoi e u ul në shkurret përballë «Plakut», që rrinte mbi një trung të rrëzuar, duke fshirë syzet.

— Sa vjeç je? — pyeti Qazimi.

«Plaku» vuri syzet duke marrë frymë ngadalë. Hoqi kapelën dhe fshiu qafën e lagur. Ndriti sheshi i kokës së tij të shogët. U duk si i zhveshur e i pambrojtur dhe buzëqeshi si një fëmijë i vjetër. Qazimi u habit me këtë shpërftyrim.

— Jam tridhjetë vjeç, — tha duke afruar gojën te veshi i Qazimit, si për t'i besuar një të fshehtë.

— Çfarë ke në atë çantën e madhe?

— Shkresa, — tha «Plaku», me dorën te goja, si për të ndaluar përhapjen e kësaj fjale.

Qazimi deshi të pyeste çfarë shkresa, po u përmbajt. «Plaku» e kishte mbështjellë me buzëqeshjen e ma-

dhe të mirë, po bebëzat e syve të tij të zez lëviznin prapa xhamave, kërkonin diçka në ballin e Qazimit.

«Plaku» mendonte se Qazimi ishte disi dinak. Kurse ai tjetri, Jashari, me trupin e gjatë të hijshëm, ishte i kthjellët nga çdo anë. «Plaku» zuri t'i fliste Qazimit për të ardhmen, me zërin e ulët që i ngjante fëshfërimës së gjethes. Qazimi ndjeu prehje në trup, ndenji si me mendjen të kapur në leqe. Pastaj ngriti kokën, e soditi «Plakun» me dyshimin e fshatarit dhe tha:

— Qenke i ditur... Po ama vuajtjen e duruake fort.

— I ditur?... Jo, — tha «Plaku» duke ulur kokën. Atij i gëzonte zemra, i qeshnin edhe syzet tek mendonte se ky fshatar i zgjuar, i fortë e pak dinak, do të bëhej ndonjë ditë një kuadër i çiltër i Partisë.

Nga ana e Fushë-Studnit krisi një mitraloz i largët. Qazimi zbriti më tej të shihte. Një raketë jeshile kaloi ngadalë mbi honet e luginës. Kur u kthye në vend, Qazimi tundi kokën dhe tha:

— Gjermanët kanë dalë tek ahuri ku desha të pushonim. Po Komisari i Përgjithshëm nuk deshi. — Ndenji me fytyrën të thithur prej hidhërimit e habitës dhe tha: — Tani do të kishte ngjarë hataja.

«Plaku» deshi ta lehtësonte; fërkoj çantën që e mban-te mbi gjunjët dhe foli me zërin e ulët:

— Këto shkresa janë të atij, — dhe bëri me kokë nga ana e tre bredhave ku rrinte Enver Hoxha.

Enver Hoxha po shkruante, me çantën mbi gjunjë. Qazimi nuk e shihte, po mendonte se ai po shkruante, siç bënte kur rrinte veç. Atëherë nuk lëvizte kush dhe as fliste njeri me zë të lartë. Po, kur çohëj ai, kur afrohej, me trupin e lartë dhe hapin e qetë, askush nuk rrinte ulur.

— Ç'zakone ka? — pyeti Qazimi.

«Plaku» kuptoi, puliti sytë dhe prapë i foli me dorën te veshi:

— Mund të flejë edhe drejt në dysheme, gjashtë orë. I mjafton buka e thekur dhe një copë djathë. Në qytetin e tij e hanë djathin shumë.

— Si mund të mbahet ai trup me bukë e djathë e duke fjetur në dysheme? — pyeti me qortim Qazimi.

— Mbahet, — tha «Plaku», me një fije zëri.

— Dua ta ftoj në stanin tim, sipër fshatit... Vend i mbrojtur... dhe prapa është Kaptina, — tha Qazimi.

«Plaku» ia kuptoi dëshirën e madhe, ia pa ndehjen e trupit.

— Do të gjejmë rast t'ia themi. Mbase në darkë, — tha.

— Ju të gjithë e keni me të, — tha Qazimi. — Kujdeseni nga çdo anë, fshehtas. Po ai ju kupton dhe kujdeset për ju.

«Plaku» u zbardh, po e shihte Qazimin me habi. Ky i hodhi sytë tej, nënqeshi dhe tha:

— Ai e njeh vendin dhe zakonet, njeh popullin, mund t'ia hyjë çdo pune e udhëtimi. Do çajë në ndonjë anë se s'bën. Po ti ftoje në stanin tim, të pushojë pak. Në ma bën këtë nder, të kam mik përjetë.

Sytë e «Plakut» që prapa syzeve u frynë si me lot, u gëlltit dhe foli fare ngadalë:

— Të jap fjalën se do të gjej rast t'ia them. Veç të dish se ai nuk rri pa shkuar aty ku duhet të jetë, pa u lidhur me qarkorët e me ushtrinë.

Në udhëzën aty para po kalonte gjenerali Dejvis, i ndjekur prej përkthyesit. «Çdo gjë ka marrë fund, çdo lëvizje është marrëzi e plotë», — thoshte hapi i rëndë i gjeneralit. Ai shkoi te tre bredhat dhe që andej erdhi biseda e tij me Enver Hoxhën. Njerëzit mbajtën vesh, në qetësinë e thellë të pyllit. Pas pak u dëgjua zëri i njohur i Enver Hoxhës. Kishte tallje e zemërim në atë zë. Qazimi pa fytyrat e zbardhura të partizanëve. Askush s'e kishte dëgjuar ndonjëherë Komisararin e Shta-

bit të Përgjithshëm të fliste ashtu. Pastaj zëri u bë më i thellë, sikur të fliste për diçka që shkonte përtej vdekjes, u përhap si një oshëtimë që e rrëqethi Qazimin krejt.

— Ai kodosh po e mërzit Komisararin, — tha Qazimi dhe bëri të çohëj. «Plaku» e mbajti nga krahu me dorën të dredhur.

Gjenerali u kthye prapë në të njëjtën udhëz, si një pirg i verdhë me qyrkun e madh, dhe ndali një hop te shtegu i pyllit, si i goditur prej dritës që binte aty. Pa partizanët dhe ngriti më kot dy gishtërinjtë të tëmthi si për t'i lënë lamtumirën dikujt, u mbështoll më mirë me qyrkun dhe vijoi rrugën me një si hije të fshehtë në të ecurit e tij, me një mendim të prerë në kokën rrumbullake.

— Këtij nuk i zihet besë më tej, do të bëjë diçka, — tha Qazimi.

«Plaku» qeshi heshtur, desh u mbyt dhe tha se gjenerali s'mund të bënte kurrgjë. S'kishte bindje në atë që tha. Pas pak nëpër udhëzën ku u zhduk gjenerali, erdhi koloneli Nikols, i gjatë, pak i përkulur, me fytyrën e parruar si qiriç. Çalonte lehtas, sikur të kishte filluar t'i dilte sipër një plagë e fshehtë, e si duke dashur të ndreqte diçka nga ajo që ngjau aty më parë, pa ditur se nga mund të niste. Shikoi rrotull e qëndroi para «Plakut» e Qazimit, ngriti dorën në strehën e kapelës. «Plaku» lëvizi me shqetësim, tepër i sjellshëm, u çua si për t'i liruar vend. Anglezi u ul te trangu me një rënkim të lehtë, buzëqeshi, i urtë e si i hutuar, dhe tha:

— Ta dinte mbretëresha se ku gjendet koloneli i saj, do të habitej mjaft.

— Ju jeni një kolonel i veçantë i mbretëreshës? — pyeti «Plaku» si duke kërkuar ndjesë.

— Jam adjutant i madhërisë së saj.

— Ky qenka me të vërtetë një privilegj.

Anglezi buzëqeshi, si me një kujtim të largët, dhe tha:

— Dymbëdhjetë kolonelë me gjatësi mbi 1.90 cm janë adjutantët e saj.

«Plaku» mblodhi buzët, nënqeshi me habi dhe tha:

— Kujtoja se vetëm rojat e oborreve... Kurse edhe kolonelët... për gjatësinë dua të them.

Në sytë e anglezit kishte një si lutje, ndërsa dukej se një pikëllim i vazhduar e treste nga brenda dhe ia bënte më të theksuara eshtrat në fytyrën si prej qi-riçi. Nënqeshi dhe tha:

— Sot janë krishtlindjet. Një dandon¹⁾ do ta paguaja me të shtrenjtë... Megjithëse këtu termat shtrenjtë ose lirë...

«Plaku» kuptoi. Ndonjëherë përpiqej të kuptonte frëngjishten e vështirë të anglezit me shenjat. Besoi se ai kërkonte një kampanë dhe mblodhi supet i hutuar.

— Dandon, dandon, — tha koloneli duke ngritur dorën mbi tokën në lartësinë e një krijese, duke e bërë këtë krijesë të ecë me dy këmbë.

— Ah, dëndon, — tha «Plaku».

— Po, po, — tha koloneli.

«Plaku» u çua për t'i dhënë fund bisedës. Shikoi lart nga gryka e fshatit Okshtun dhe tha:

— Nuk besoj se ka gjela deti nga këto anë. Apo jo, shoku Qazim? Sido që të bëhet, një pulë do t'jua gjej, — i tha kolonelit.

XI

Më 8 janar gjenerali Idmond Dejvis u nis prej stanit të Met Sheshit, t'i kthente vizitën baba Mërxhanit te sta-

1) Shtrembërimi i fjalës frëngjisht, gjeldeti

ni i Jahe Sheshit. Gjenerali duhej të zbriste një për-
rrua e të ngjitej në të njëjtën lartësi në bregun tjetër,
njëzet minuta rrugë në dëborë. Përtej stanit të baba
Merxhanit e në të njëjtën largësi ishte stani i Qazim Sa-
lës. Këto tri stane verore ishin ngritur në tri kodra
sipër fshatit Korenë, rrëzë malit me pishë e ah, vende
të prehjes e freskisë verore, po askujt nuk do t'i shkon-
te ndër mend të ngjitej aty lart në dimër.

Gjenerali kaloi përruan me lisat e rrallë të krasi-
tur, i përcjellë prej qenit, majorit Smith, nënoficerit
dhe përkthyesit. Frynte erë e Alpeve dhe ai shpejtoi
hapin, gati i gëzuar, me bindjen se po ecte drejt një
strehe të ngrohtë, ku do të bëhej bisedë e këndshme,
prej së cilës do të sqaronte disa ide. Ai po shihte ven-
din me kujdes.

Vjen një çast në jetë kur njeriu i vë të gjitha në
një kartë të vetme. Kjo u ndodh sidomos njerëzve që
duhet të thonë diçka në këtë botë. Ky mendim i jepte
zemër gjeneralit dhe ai kishte rifituar qetësinë, flinte
top, që në çastin kur e mori vendimin. Veçse, ende
nuk po shihte shtegun e rrëshqitjes, megjithëse ia
ndjente në çdo orë afrimin.

Nga ahuri katror i baba Merxhanit erdhi era e bukës
së misrit të porsapjekur. Dy njerëz po hiqnin dëborën
nga çatia me dërrasa, rregullonin ndonjë vend që pi-
konte. Babai doli ta priste gjeneralin dhe e përqafoi,
ndofta e puthi.

Gjenerali u habit, i vërshoi gjaku.

— Asnjeri në Shqipëri s'më ka përqaftuar në më-
nyrë të tillë! — i tha ai përkthyesit.

— Tani zoti gjeneral po vuan bashkë me ne. Të
kemi të shtëpisë, — tha babai.

Gjenerali pa fytyrën leshtore me sytë e ndritur.
Ky baba, me kurajon, humorin e trupin e rëndë, ush-

tronte edhe aty në stanet një ndikim, prej të cilit s'mund të mbroheshe.

Në ahur u desh të rrinin kërrusur, sa të përhapej tymi që bënë drutë. Dy anglezët e tjerë ndenjën pranë derës. Ishin të mbështjellë me qyrqet e mëdha, të verdha me lesh nga brenda. Togeri Traihorn, ai që dinte gjuhët e botës, kishte ikur ditë më parë, që dorëzuar te gjermanët.

Babai e gostiti gjeneralin me çaj mali, duke tretur në të një lugë mjaltë. E gostiti me raki. Nuk merrej vesh se nga i nxirrte këto njeriu i heshtur që shërben-te.

— Nikolsi dhe Smithi ju falënderojnë fort. Atyre u kaloi sëmundja e syve, — tha gjenerali.

Dy oficerëve u lotonin sytë pareshtur. «Larje me ujë të nxehtë», — kishte thënë babai. Ishte provuar si një mjekim i mirë.

— Ndofta një baba duhet të jetë edhe mjek i komunitetit. Kjo e vështirëson detyrën time për të hapur një teqe në Angli kur të dal në pension, — tha gjenerali, me seriozitet të shtirë.

— Lëngjet e fshehta, si edhe shkrimet e fshehta, do t'ia mësojmë zotërisë para se të hapet teqeja, — tha babai me të njëjtin ton.

Ata qeshën dhe babai priti pyetjet. I dukej se nuk do të shpëtonte ndonjëherë nga ky gjeneral. Kur u nis Shtabi i Përgjithshëm për herë të tretë të çante rrethimin, gjenerali s'kishte dashur të shkonte më tej. «Ta ruash me çdo kusht», — i kishte thënë Enver Hoxha babait, duke i lënë në ndihmë edhe një pjesë të kompanisë partizane të Shtabit.

— Në fshat janë turrur disa herë forcat armike, — tha gjenerali.

— Më shumë turren «nacionalistët e ndershëm», — tha babai. — Lehin si kulishi para bushtres. — Ndezi

çibukun dhe tha: — Rojat i kemi të forta. Fshati nuk na tradhton kurrë. Po edhe ju duhet të rrini gati në çdo kohë.

— Gati për çfarë?

— Në operacion jemi, nuk i dihet.

Zjarri shkëlqente me bujari. Tymi që zhdukur. Gjenerali vuri buzën në gaz. Në sytë e tij ndriçonte një plan, disa llogari që kishte bërë, me një siguri të qetë e me bindje. Çfarë pikërisht? «Po të dish të shohësh në sytë e njeriut, ke parë brenda tij», — mendoi babai. Veçse këtij anglezi ishte vështirë t'ia kapje shikimin.

Gjenerali pinte çajin e ngrohtë me erë të mirë, ngadalë e me mirënjohje.

— Çfarë do të bëjë baba Markeshi sikur armiku të rrethojë stanet me forca të shumta? — tha. Prapë që rruar me kujdes, po nuk e kishte më atë lëkurën e bardhë e të butë. Fytyra i që nxirë dhe ashpërsuar. «Ndofta e pa edhe ky luftën tonë», — mendoi babai dhe tha:

— Do të luftojmë. Pastaj mund të tërhiqemi në malet prapa.

— A mund të kalohet në pyjet dhe malet me kaq tepër dëborë?

— Një shteg për njeriun që ka pushkën në dorë gjendet në çdo rast.

Gjenerali pyeti për rrugët e mundshme të tërheqjes, duke i fërkuar zverkun qenit që nuk lihte kurrë, me turirin e madh të shtypur e të vrenjtur. Qeni ngri-ti sytë me përtim, i dobësuar dhe i uritur, dukej sikur në çastin tjetër do t'i kërcente të zotit sipër.

— Koloneli Nikols vuan nga një sëmundje e rëndë e këmbës, — tha. — Ju atij s'mund t'i bëni gjë.

— Kemi urdhër nga Shtabi i Përgjithshëm ta çoj-

më për mjekim në një fshat afër Tiranës, — tha babai, duke fërkuar padashur gjurin e vet.

Gjenerali nuk e dëgjoi përgjigjen. Qe tërhequr në botën e tij të largët e të huaj, fytyra e ngrohur në zjarr i ndriti si nga një kënaqësi pa shkak.

Babai po e vërente. «Jo, ky s'ka parë gjë. Dhe as do të shohë kurrë», — mendoi. S'kishte zjarr, as akull e dëborë që t'ia ndryshonte mendjen atij. Babai trazoi urët në vatër duke ngritur shkëndija dhe tha:

— Po të pinim një faqore raki, tani do t'i mësoja zotit gjeneral një këngë të bukur dyshe të Markeshit.

Gjenerali u përmend, buzëqeshi ftohtë dhe babai pa edhe një herë, si atë ditë në Markesh, fytyrën e një rrufjani të zënë në punë e sipër.

— Pra, tërheqja në malet, — tha gjenerali duke shikuar rrotull ahurit të ngrohtë.

— Ose zbritja poshtë, — tha babai, duke ngritur krahun drejt Korenës, siç bëjnë fshatarët kur tregojnë rrugën. Po i prishej gjaku. Shihte gjithnjë më fort se gjenerali do t'i punonte diçka të rëndë, nga ato që nuk shlyhen. «Mbase edhe sheh ato hijet që e sulmojnë me thika», — mendoi për të qetësuar veten. Do të pyeste përkthyesin më pas.

— Ah, poshtë! — tha gjenerali, dhe humbi mendjen prapë. Poshtë ishin korijet e lisave me dëborë, shtëpitë e vogla si lodra fëmijësh. Mjaftonte një zbritje në muzg deri atje. Po kjo s'mund të bëhej... Duhej pritur pështjellimi, lufta, plagosja, ndofta vdekja. E gjithë kjo për të inskenuar dramën.

— Nuk ndryshon bota duke ëndërruar njeriu me sytë hapur, — tha babai. — Këtu do t'i dalim zot vetes sonë. — Tani donte që gjenerali të fliste më tepër, të bënte pyetje të tjera dhe i shtiu prapë çaj me ibrik. Gjenerali e pa me vëmendje, po nuk foli. Ndo-

fta ky baba kishte ushtruar spiritizmin, hipnozën, ose diçka tjetër të fshehtë që lexonte mendimet. Pastaj qeshi me këtë ide. Babai ishte një fshatar me zgjuarsin e kurajë të madhe. Vetëm kaq. Ndofta ishte i krisur.

— Më duket zotit gjeneral i pëlqen më fort stani im, — tha babai.

— Nga e di baba Markeshi këtë gjë?

— Zotëria e tij lëvdoi ahurin tim.

— Kjo do të më jepte kënaqësi.

— Mund të sillni plaçkat që tani. Konaku më i mirë i jepet mysafirrit, — tha babai, i kënaqur që do ta vinte gjeneralin ndërmjet dy staneve.

* * *

Stani i Qazimit ishte e vetmja shtëpi dykatëshe ndër stanet, ose me dy dhoma lart dhe «burgjet» e dhive poshtë. E shoqja, Emineja, kishte lyer me gëlqere gurët e murrme anës dritareve, gjë që e habiste babanë, sepse nuk përdorej gëlqere në Markesh e në luginën e Vallit. Në dy anët e derës ishin mbledhur togjet me dëborë të ngrirë. Që prapa shtëpisë doli Emineja, duke lidhur shaminë rreth flokëve të verdhë. Ishte tridhjetë vjeçe, me trupin e shëndetshëm plot hijeshi, me fytyrën e skuqur dhe me hundën të kërcyer. Sytë në trajtë bajameje i kishte të kaltër në të bardhë, si drita e yjeve, që rrezatonin qetësi, shpirt të pastër e gëzim.

— Po shkoja te Nabija të gatujmë diçka, — tha ajo.

— Po, po, — tha babai, duke tundur kokën. Kjo ishte një grua e fortë, e rritur në malësi, nga ato që e nxjerrin ushqimin poshtë dëborës. Këto gjithnjë nxjerrin diçka nga ndonjë anë e fshehtë. Babai mendoi se

Qazim Sala kishte grua shumë të mirë. Veçse ishte krejt e paditur, e padalë kurrë nga fshati.

Babai u ngjit në dhomën lart, i ndjekur prej Emine-së. Aty po flinin rëndë të mbuluar me plafe Qazimi e Jashari. Qenë kthyer afër mëngjesit, të ndryshuar, me mendjen te ditët që kishin jetuar, te njeriu që kishin përcjellë. Babai ndezi çibukun dhe shikoi rrotull dhomës. Operacioni armik po rritej duke e sjellë ujët te gryka. Babai mendoi vdekjen qetë dhe u habit me qetësinë e vet. Vdekja nuk ishte kurrsesi një zgjidhje.

Emineja po e tundte lehtë të shoqin nga supi, që hapì sytë dhe u çua ndenjurr. Babai i la kohë të kuptonte ku ndodhej dhe i tha.

— Jemi miq në stanin tënd, or gugash, dhe s'po na jep asgjë për të ngrënë prej njëzet e katër orësh.

Qazimi vetë kishte edhe më tepër pa ngrënë. Kur ishin ndalur te Shpella e Gurit, Qazimi kishte dremitur, i qenë shfaqur me sytë hapët bukë të verdha, të ngrohta, që silleshin si disqe në t'errët. Atëherë qe ngritur, duke menduar se njeriut mund t'i ngjajë ndonjë lajthitje prej urisë së madhe të vazhduar.

— Dërgo në fshat të marrin diçka, — tha babai.

Prapa Qazimit rrinte në gjunjë Emineja, me trupin e bukur drejt. Fytyra i mori një pamje habie të nxehtë, sikur të ishte kujtuar befaz për diçka të gëzueshme që nuk e kishte menduar më parë.

— Kemi viçin te Hyseni, — tha ajo.

XII

Në fshat nuk i panë kolonat armike që kaluan fshehtas, njëra nga ana e brigjeve të Vallit dhe tjetra

në krahun e Nezhës. Të dy kolonat do të takoheshin te Qafa e Lemit dhe atëherë kryhej rrethimi i plotë i staneve verore dhe, Shtabi i Përgjithshëm, anglezët dhe kushdo që të ishte me ta, duhej të zbrisnin në Korenë të dorëzonin armët, ose të linin kokat aty te stanet. Në fshat nuk dinin asgjë nga këto. As lart në stanet nuk dinin. Vëllai i Qazimit që u kthye me vënin tha se në fshat bëhej trazirë, dukej se ballistët do të shkonin. Në të vërtetë ata po vinin. Në fillim u shfaqën në Përruan e Çetës, të zez e të vegjël, si zogjtë e një kllçoqe që duhej të ishte diku prapa. Në të njëjtën kohë po ngjiteshin edhe nga Përroi i Maçit, në krahun e stanit ku ishin anglezët. Kërcenin në dëborë, sikur hidheshin pupthi, si në ëndërr, kur do të ngjitesh e nuk mundesh. Po ama ngjiteshin, përherë më lart, duke sjellë rrezikun. Veçse ky kërcënim dukej disi i zbutur. Ishin të qetë e të sigurt në punën e tyre, apo s'kishin bindje se do të gjenin dikë te stanet?

Babai mendoj se këta ballistë mund t'i ndalte lehtë duke u mbrojtur rreth tri staneve, sa të binte nata. Nuk dinte për dy kolonat e mëdha që po i bënë rrethimin në krahët dhe prapa. Dërgoi një partizan të Shtabit të merrte anglezët, që t'i kishte për çdo rast me vete, dhe zbriti poshtë, ndenji mbështetur te qoshja e murit duke shikuar me dylibi.

Shtëpitë e fshatit, të hapura në brigje, tymosnin ngadalë, me një qetësi të patrazuar. Tymi zbardhej prej të ftohtit porsa dilte nga çatitë dhe tretej. Armi-ku nuk e kishte djegur Korenën. E donte për strehimin e vet. Ky ishte një armik i duruar, që mendon diçka. Prej nga ta kishin marrë informatën? Më lart, në pllajën e gërryer me dëborë, dukeshin vetëm lisat e krasitur rëndë, që kthenin kërcëpat drejt qiellit të ngushtë. Njeriu nuk sheh më tepër qiell në Korenë. Diku fluturonte ndonjë sorrë nga një lis në tjetrin. Ba-

bai i shikonte këto si për të fundit herë dhe kërkoi me dylbi nga afër. Asnjë hije nuk lëvizte në rrëpirat, në arat e zbardhura, të vetmuara. Dukej sikur armikun ta kishte përpirë dheu. Pastaj i pa. Kishin qëndruar prapa lisave, rrëzë pirgjeve, në rrëketë, prapa mureve të vathave. Dhe veshjet nuk ishin të zeza, po të kuqërreme, të murrme. Prisinin, me fytyrat nga të tri kodrat, sikur prej andej do t'u binin stanet drejt në prehër. Babait iu rrëqeth trupi, sikur në çdo lis e prapa çdo guri të qenë ngjitur nepërka që nxirrinin gjuhët e kuqe. Ky armik dinte se ç'do të gjente stanet, ndofta shpresonte shumë më tepër nga sa do të gjente. Dhe priste diçka. Atëherë babai ndjeu rrethimin, zuri t'i digjte lëkura poshtë mjekrës e t'i djersitnin duart. Këtu nuk ishte fjala për një turmë ballistësh të ardhur nga Korena. Babai u kthye ngadalë nga muri i blertë i pyjeve të kredhura në dëborë dhe kërkoi me ngulm me dylbi. E dinte se ishte e kotë të kërkonte.

Erdhi Qazimi dhe tha se partizanët ishin nëpër vende, me fishekë të mjaftë. Nuk e ktheu kokën nga pyjet prapa, veçse në sytë e tij dukej i njëjti dyshim.

— Nxirre Feridin me mitraloz te shkëmbi i Jahe Sheshit, — dha babai.

Nga poshtë, nga përroi i Maçit, krisën befas disa pushkë. U dëgjua një thirrje e largët e zgjatur «Aha-ha-haaaa, ku je, o mjekërcjap». Thirrjet u përhapën lart, të përcjella nga dy-tri të tjera, si thirrja e fshatarëve që u grahin kuajve në lëmë. Askush nuk u përgjigj nga stanet.

«Mbase dinë vetëm për mua», — mendoi babai.

U kthye partizani i Shtabit dhe tha se gjenerali nuk donte të lëvizte nga stani i tij. Babait i flakërinë sytë, i tha Qazimit.

— Shko vetë i tretë. Ta sjellësh qoftë edhe me forcë. Ama kujdes, mbaje për krahu.

Babai shkoi te muri i vathës prej nga mund të shihte luginën e Korenës dhe ndofta një pjesë të pyllit prapa. Mbajti vesh dhe iu bë se dëgjoji thirrje të egra fitoreje të mbytura e të largëta që vinin nga fshati. U zgjat të shihte me dylbi, po kishte nisur dëbora e pritur që e kufizonte pamjen poshtë tek arat. Megjithatë, pa se ballistët po zbrisnin drejt fshatit me nxitim, sikur gjahu i tyre të qe kthyer befaz nga ajo anë.

Ballistët u turrën të gjithë në Lagjen e Drerit. Brenda në mulli po merrnin në pyetje dervish Lalën e vjetër. Ky u përgjigjej i inatosur se nuk ishte baba Merxhani, thoshte se baba Merxhani ishte tjetër njeri. U sollën disa fshatarë për dëshmi e vërtetim. Këta qeshën, thanë se dervishi i ngjante baba Merxhanit si laraska pëllumbit. Ballistët nuk bindeshin, e zhveshën lakuriq dervishin që të shihnin se mos nën rrobat e tij dilte njeriu që kërkonin, baba Merxhani i veshur tebdil. Kishin thirrur e zbrazur armët për hare se kapën baba Merxhanin dhe tani s'mund të pranonin që kishin gabuar. Hodhën litarin në tra dhe e ngritën në ajër dervish Lalën të lidhur me duart prapa. Zunë ta rrihnin. Ky po fliste me vete, ndërsa i dukej se po i këputeshin gjymtyrët dhe dridhej nga turpi e të ftohtët, mendonte me zemërim për baba Merxhanin. Se nga shkakku i tij po i ndodhnin gjëra që s'mund t'i ndodhnin një dervishi. E patën arrestuar në kohë të Italisë dhe prapë tani, duke e shtruar në dajak të rëndë. Për shkak të baba Merxhanit u dogjën dy teqetë dhe dervish Lala po bridhte fshatrave duke kërkuar strehë te myhibët e vjetër. Por prapë s'i bënte zemra të thoshte një fjalë të keqe për babanë dhe aq më pak të tregonte se ku ishte. Më mirë të jepte shpirtin si shehitët e

lashtë në duart e mavijesë. Mblodhi fuqitë dhe thirri fort, u duk sikur u ndriçua i tëri kur thirri: «Nuk jam baba Merxhani, or të mallkuar, nuk jam as gishti i këmbës së tij.» Kjo thirrje e ky ndriçim që i vinin nga brenda vendosën heshtjen, po vetëm për disa çaste. Filluan ta rrihnin prapë, edhe pse i binte të fikët, donin ta rripnin të gjallë. Dervishi hapte sytë, shihte fytyrat e kallaballëkut të çmendur që dyndej në mulli e jash-të tij dhe nuk nxori më asnjë klithmë, uli kokën si për të mbuluar një pjesë të lakuriqësisë së vet dhe zuri të qeshte, ndërsa po i mavijosej trupit. Kur pa thikat para fytyrës, pështyu. Te dera krisi një kobure dhe një zë thirri fort: «Dilni jashtë, mor hajvanë!» Atëherë të gjithë kujtuan se qenë mashtruar keqas dhe se duhej të shkonin përsëri në dëborë, «të mbanin front» para staneve. E lanë dervishin duke dhënë shpirt dhe u turrën prapë lart, më të egërsuar se më parë.

* * *

Nga Qafa e Lemit u ngritën tri raketa të kuqe. Në krejt anën e pyllit filluan të shtinin me pushkë dhe me dy mitralozë të lehtë, njëri «Breda» dhe tjetri «Shars». Që nga shkëmbi i Jahe Sheshit u përgjigj me të shtëna të ndërprera mitralozit i Feridit. Partizanët e tjerë, të hapur nëpër muret e vathave e me fytyrat nga pylli nuk shtinë. Ndërmjet dy staneve dhe pyllit, ishin ca lëndina plot dëborë, aty-këtu me ndonjë prozhm. Çdo lëvizje e armikut nga kjo anë do të diktohej lehtë. Kurse në të majtë ishin shkrepat e lartë, të hirtë. Këta dy stane mund të mbroheshin nga prapa po aq mirë sa edhe përpara.

Baba Merxhani shkoi te Feridi dhe e pa të ndehur pas armës, me këmbët e shkurtra të forta të mbër-

thyera në tokë. Ndihmësi i tij rrinte galiç pas gurit.
— Lëvizën më poshtë. Janë strukur ndanë lëndina-
ve, — tha Feridi.

— A mund t'i ndalësh sa të erret? — pyeti babai.

Feridi provoi me dorë tytën e nxehtë të mitralozit, i uli shqekëzën njëqind metra më poshtë. Lëvizjet i bënte të matura, me dashuri e kujdes. Po mendohej, ktheu syrin nga qielli si për të kuptuar kohën, prej mustaqeve të dendura të lagura me dëborë i rrëshqitën pika uji anës gojës, u lëpi, nënqeshi dhe tha:

— Nga ana ime i mbaj. Fishekë kam boll.

— Po dërgoj këtu edhe dy partizanë. Vendi është mjaft i mirë, — tha babai.

Krisën pushkët nga stani i anglezëve dhe pas pak disa automatikë. Babai mendoi se filloi përpjekja e hapët, së cilës i qe shmangur me mundim gjatë njëzet ditësh. Tani po i dukej se në të vërtetë këtë ia kishte dashur zemra. Kjo nuk ishte gjë e mirë. Kjo tregonte lodhje. Ai po qortonte veten kur pa të dilnin nga stani i anglezëve disa njerëz ultas, njëri pas tjetrit, dhe të kërcenin në shpatin e përroit sikur t'i shtynte dikush me forcë nga brenda ahurit.

— Qazimi po sjell gjeneralin, — tha babai.

Babai po kthehej te stani i vet duke dëgjuar vërshëllimën e plumbave që vinin nga ana e pyllit dhe nga poshtë. Krismat ishin të mbytura, pa jehonë, për shkak të dëborës. Babai mendoi se po ngjiste diçka që do të shkonte gjatë dhe nga e cila nuk do të dilte ndonjë përfundim për armikun. Ky mendim e bëri të nënqeshte me vete. Shikoi qiellin. Nuk binte më dëborë. Drita e qiellit ishte e njëjtë, e hirtë. E tillë kishte buruar që prej agimit dhe nuk do të ndryshonte deri në mbrëmje. Ishte e kotë të kërkoje diellin në një qiell të tillë. Ai pa orën. Ishte dymbëdhjetë e pak. Po ditët në janar janë të shkurtra. Edhe pesë orë dhe

vinte mbrëmja. Atëherë do të çante në ndonjë anë. Veç të hiqte qafe anglezët. Rreth stanit partizanët rrinin pas mureve duke duruar të ftohtët, të shumtët partizanë të Shtabit. «Janë më të sigurt se shkëmbi», — mendoj babai me gëzim dhe u ngjit lart. Nëpër shkallë e shurdhuan krismat e rënda që erdhën nga dhomat, ra blozë nga trarët. Çupi i vjetër po shtinte në njëërën dritare me pushkën turke. Nga dritarja tjetër shtinte Nabija.

— Mos shtini, — tha babai. Që nga ana e tejme e përroit të Vallit po shtinin disa pushkë njëherësh, duke synuar dy dhomat e katit të sipërm të stanit të Qazimit. Shtinin keq. Në pesëqind metra nuk arrinin të shënonin në dritaret. Babai ndenji pranë Çupit dhe të dy ndezën çibukët në heshtje. Emineja zuri të vinte pllaka guri te dritarja e Nabijes duke lënë një vend të hapët në mes për pushkën. Këtë punë e kryente me merak, me lëvizje të shkathëta, me vetullat puqur dhe pastaj rrinte në gjunjë me trupin të hedhur lart, duke shikuar nëse e kishte dhomën mirë. Hera-herës i pëshpëriste diçka Nabijes. Babai nënqeshi, mendoj se gratë miqësohen lehtë, në çdo vend e në çdo kohë, si të lindura binjake. Kurse me burrat kjo ngjet rrallë.

— S'kam parë rrethim asnjëherë. Qysh do të jetë, o Nabije? — pyeti Emineja duke u përkulur mbi të.

— Ja pra, ky është rrethimi, — tha Nabija.

Emineja ngriti kokën. Iu bë se rrihnin çekiçë të largët të panumërt, duke e mbërthyer shtëpinë me gozhdë nga të gjitha anët. Ky ishte rrethimi. Po shtëpia që e gurtë dhe çikat që ngrinin plumbat nuk i bënin dëm. Ajo krenohet me shtëpinë e saj të fortë që i mbronte të gjithë.

Nëpër shkallët u dëgjuan këmbë, njerëz të rëndë, që nuk sillnin lajme të mira. Babai u kthye dhe priti të hynte gjenerali. Hyri Qazimi me dy partizanë të shta-

bit dhe tha se gjenerali kishte ikur. Babai u çua dhe eci i hutuar drejt Qazimit, që rrinte te dera. Nën hapin e babait krisën dërrasat dhe ai u përmbajt, ndenji në mesin e dhomës, duke pritur të pushonte së krisuri dyshemeja.

Gjenerali kishte ikur. S'kishte dashur të vinte. Ndërsa Qazimi po mendohej si ta merrte me forcë, kishin sulmuar ballistët. Partizanët po prapsnin sulmin. Edhe anglezët e tjerë kishin nisur të shtinin me automatikë nga dritaret. Në atë trazirë të shkurtër asnjëri s'e kishte parë gjeneralin, që iku nëpër derën e ahurit. E kishin parë vetëm kur zbriti poshtë, me adjutantit përpara, dhe u duk i plagosur. U duk se nuk pyeste për armikun që mund të shkarkonte armët mbi të, u duk se qe çmendur krejt. Koloneli Nikols doli t'i fliste. Ata folën fjalë të shkurtra, me ngut e duke thirrur fort. Mbase koloneli tha: «Fare mirë, zotëri» dhe u kthye brenda në ahur me mjekrën të varur. Kurse gjenerali eci poshtë dhe u pengua, u rrokullis. Adjutanti u hodh ta ndihmonte, ndofta t'i lidhte plagën, nëse plagë kishte marrë, gjenerali i thirri të mos ndalonte, i tregoi diçka me dorë. Ndofta i tha «nxirr shaminë, ec në atë drejtim, mos ndalo asnjë hap», se adjutanti zbriti më tej, me shaminë e bardhë lart, pa armë. Aty Qazimi e pa gjeneralin për herë të fundit, pa shapkë, me kokën e bardhë rrumbullake dhe kurorën e flokëve të verdhë rreth tëmthave dhe mendoi se gjenerali gëzohej për plagën; nëse e kishte, dhe se ky gjeneral ishte një burracak që do të krenohej me dezertimin e tij. Qazimi kishte ngritur pushkën, me një dëshirë shumë të fortë për t'ia plasur radaken si kungull. Po koloneli foli diçka, ndofta tha «bjeri», ose «mos», dhe vetë Qazimi mendoi se s'kishte urdhër të vriste gjeneralin.

— Ku janë anglezët e tjerë? — pyeti babai.

— Poshtë, — tha Qazimi. — Koloneli çalon, çehren e ka të vrarë.

«Të ruhet me çdo kusht gjenerali.» Babai mbajti vesh nëse era do të sillte përsëri thirrje të egra të fitores e triumfit. Dëgjoheshin vetëm pushkët nga stani i Jahes dhe ca më afër përgjigjet e shkurtra, të sakta të Feridit.

Babai shkoi te dritarja dhe u mbështet me dy duart në parvazet, uli qafën dhe kërkoi me sy hapësirën e jugut. «Të ruhet me çdo kusht gjenerali.» Tani Enver Hoxha, udhëheqësi i kësaj lufte të madhe e të vështirë, çante në dëborë përmes armikut, me bindjen e patundur se do të gjente zjarr, një copë bukë e një copë djathë në çdo kasolle fshatari, derisa të arrinte aty ku «duhej të ishte». Babait iu bë se ia pa trupin e lartë. Aty më parë kishte menduar se, duke tërhequr mbi vete fuqinë armike, i lehtësonte kalimin Enver Hoxhës. Hidhërimi e turpi po ia errësonin sytë babait. U kthye nga Qazimi dhe e shikoi gjatë, si për t'i thënë «ç'na bëre, or mik»; kush do ta merrte vesh në luftë e sipër se nga i plasi radakja? Po pastaj mendoi se, sikur ta kishte bërë vërtet Qazimi, mbase do të ishte edhe më keq.

— Kush mbeti te stani i Jahes? — pyeti babai me zërin akull.

— Selman Gërvishta me partizanë të Shtabit, — tha Qazimi.

— Thirre Selmanin.

Nabija po shihte me ngulm përtej dritares, sikur të qe sipër një gardhi, dhe foli me druajtje, tha se ata po ngjiteshin. Babai i pa ballistët të kapërcenin arat e vogla me ledhe rrëzë stanit. Iu duk se pa fytyrat e tyre të ndezura nga rakia e ankthi për të mbaruar punë, që të ktheheshin sa më parë në shtëpitë e ngroh-

ta, të sigurta. Edhe pak e do të afroheshin aq sa të mos shiheshin nga kati i dytë.

— Zbresim poshtë, — tha. Këtu të rrijë Çupi.

Nga muri i dytë prapa shtëpisë që e kishte ngritur Emineja për vathë të kecape, mund të pritej më mirë armiku. Babai u ul prapa këtij muri dhe i pa fare pranë. Po kapërcenin me shpejtësi në krye të përroit, aty ku uji kishte larë dëborën, duke nxjerrë në shesh gurët e hirtë. Babai shtiu me ngut pesë fishekë. Njëri mbeti shtrirë. Të tjerët u prapsën, kërcyen anash të kapur në befasi sikur t'i fshikullonte dikush me një kamxhik përvëlues. Po shtinin edhe partizanët e Shtabit. «S'keni ku shkoni, qena!» — tha babai me dhëmbët shtrënguar dhe u ngrit në gjunjë kur pa të rrëzoheshin dy ballistë të tjerë.

XIII

Ahmeti, djali tetë vjeç i Qazimit, rrinte në korije i mbështjellë me gunën e vogël të ashpër, duke u lutur që dhitë të mos lëviznin, duke i folur secilës në emër ngadalë. E kishte lënë aty e ëma, që të shpëtonte dhitë, duke i thënë se një çun të vogël si ai nuk do ta trazonte armiku edhe po ta gjente në korijen e fshehtë.

Ballistët e gjetën çunin dhe tufën e dhive, menjëherë veçuan çapin, kurse njëri prej tyre nxori thikën dhe e kërcënoi çunin se do t'i priste një herë veshët, pastaj gjuhën po të mos tregonte se biri i kujt ishte dhe ç'dinte për ata në stanet. Ballisti e mbante djalin të shtrënguar fort ndërmjet gjunjëve dhe mprehte thikën e madhe në pëllëmbën e dorës, kur ia behu aty xhaxhai që kërkonte çunin. Ballistët e lidhën xhaxhanë pas një

druri dhe filluan ta rrihnin fort, me durim, që të tregonte se ku ishte «mjekërcjapi»; sa forca kishte dhe gjëra të tjera që çuni nuk i kuptonte. S'kishte keqardhje, pendim, a mëshirë në sytë e tyre të mjegulluar nga gjaku ose rakia. Këta njerëz mund të bënin çdo gjë. Çuni pa se xhaxhait po i shkonte gjak nga fytyra, duke u ndryshuar sa herë binte huri mbi të dhe kur i shkulnin mustaqet, i përplasnin kokën pas trungut. Çuni u tremb fort, iu ngjit zemra në grykë për xhaxhanë që po tretej aq shpejt, që qeshi duke pështyrë dhëmbët e vet dhe tha: «Ahmet, mos u tut, or çun i xhajës.» Atë çast xhaxhanë e mbuloi trupi i burrit, në dorën e të cilit shndriti thika me kërcënimin e një vetëtime. Ai i mbajti thikën te fyti i thirri «të rrjep lëkurën, qen i qenit». Kurse xhaxhai po e shihte ballistin në sy duke nënqeshur, sikur aty e prapa do të bëhej një lojë. «Hajt, ta bëjmë atë që duhet, — thoshte shikimi i xhaxhait, — ju të më rripni lëkurën dhe unë t'ju ndih të ma rripni, meqë e lashë veten të bija në duart tuaja.» Djali mendoj se më parë xhaxhait do t'i prisnin kokën, si cjamin në ditën e Novruzit, pastaj do ta frynin nga këmbët për ta rrjepur, gjithnjë duke nënqeshur xhaxhai. Kjo s'mund të durohej, xhaxhai më mirë të thërriste, djalit po i çahet zemra, iu duk se do të vdiste në vend ai vetë, po të mos bënte diçka për të shpëtuar xhaxhanë. Djali rrëshqiti ngadalë, pa e vënë re ai që e mbante për supi, as të tjerët që merreshin me dhitë e me xhaxhanë, dhe u hodh poshtë drejt përroit. Po ngjitej në faqen tjetër kur dëgjoi thirrjet: «Hej, kopili, na iku çuni i vogël. Kapeni, kapeni!» Këmbët e tyre po afroreshin, shkundoj me forcë dëborë nga drurët, po tani djali kishte arritur në majë të kodrës, ai do të shkonte tek i ati t'i tregonte, gunën e kishte hedhur dhe zuri të kërcente teposhtë, pa parë as tokën, as drurët dhe, kur arriti

sipër rrëkesë së madhe te shkrepat, i thirri fort të atit. Pushkët u shkrehën në afërsi dhe plumbat kërkonin diçka verbërisht nëpër pyll, djali mendoi se i ati nuk po dëgjonte, shkrepat poshtë iu dukën të butë prej dëborës dhe kërceu aty me rrokullisje.

Baba Merxhani doli nga muri. Qazimi e mbajti nga krahu, i tha të ulej, tha se çunin nuk e gjente gjë, do të dalë vetë shejtani, tha. Partizanët e Shtabit që ishin te gurët buzë kodrës, panë ballistët të lëviznin në zabelet, shkrehën pushkët njëherësh. Dy nga partizanët u turrën poshtë dhe pastaj u ngjitën lart, duke u hedhur në dëborë drejt çunit që mund të ishte dërrmuar. I pari që arriti e ngriti çunin në krahë dhe thirri si i marrë: «Ja tek është djali!»

• • •

Nga pylli lart hodhën bomba, që ushtuan si nga nëntoka. Nga ana e fshatit krisën dy mitraloza, u duk sikur shkundën dëborën nga kërcejtë e lisave. U derdh poshtë me rrokullimë krisma e mitralozit të Feridit te shkëmbi. Rrethimi mbetej në vend, po ishte më kërcënues.

Babai ndihej i qetë. Në dy vjetët e fundit kishte jetuar buzë rrezikut aq shpesh, sa kjo të bëhej gjendja e tij e zakonshme. Po kësaj here s'kishte më tërheqje prapa, as sulm përpara. Duhej të mbrohej në rrethim në dy stanet dhe te shkëmbi i Feridit. Këto tri pika krijonin një rreth që s'mund të kalohej prej armikut pa e larë ai dëborën me gjak. Dukej se armiku s'kishte ndërmend të bënte një gjë të tillë. Hëpërhë dukej se qe kënaqur së tepërmi me gjeneralin dhe me marrjen e stanit të Met Sheshit, ku ishin në fillim anglezët.

Mbeteshin edhe tri orë gjersa të errej. Babai kishte pritur gjuajtjen me mortaja që do ta bënte mbrojtjen shumë të vështirë. Po ndofta ky armik i madh në numër nuk donte t'i vriste ata në stanet. Donte t'i kapte të gjallë. Atëherë do të ishte e plotë fitorja. Kur mendoi këtë, babai u çua të zbriste poshtë. Në krye të shkallëve qëndroi, shtyu ngadalë derën e dhomës përballë. Tre anglezët dhe përkthyesi që rrinin anës mureve deshën të çoheshin. Babai u bëri shenjë me dorë të rrinin qetë. Zbriti në oborr. Po sillej në dhomat e rreth vathave siç bënte nganjëherë në teqe. Kishte ndër sy radaken e gjeneralit. I dukej sikur shihte kokën e tij pa trup, krejt të gjallë, të ngërdheshur, tek shkonte nëpër arat me dëborë si një toptë që vërtitej në ajër. Babait i dukej sikur do të çmendej prej zemërimit, prej kësaj pamjeje të fandakurur të kokës pa trup. Ndënë murit të vathës rrinte ulur Nabija. I shkëlqente për çudi fytyra. Babai u afrua, u përkul mbi të, pa tiparet e dashura e të buta, që ishin bërë edhe më të theksuara prej urisë e mundimit, i vuri dorën në sup dhe e pyeti çfarë mendonte. Prej zërit të tij të ngrohtë dhe prej dorës në sup, vajza u drodh si zogu në fole, u mblodh edhe më tepër rrëzë murit. Ndjeu sa fort e donte ai, Në të njëjtën kohë mendoi se ai asnjëherë nuk do të ishte i gjithi i saj, se u përkiste edhe të tjerëve. Kjo nuk i ngjalli smirë, po krenari të thellë.

— S'kam asgjë, po mendoja për ty, — tha. Kishte menduar aty më parë se më shumë nga çdo gjë në botë vlente një burrë si ai, që do të nxirrte shokët nga rreziku e rrethimi. A kishte gjë tjetër që të vlente më shumë se një burrë i tillë?

Babai ndjeu një ligështim në zemër. Duhej të hiqte nga mendja gjeneralin. Duhej të mendonte për kë-

të vajzë që i jepte dritë shpirtit të tij, për shokët dhe për tre anglezët që i mbeteshin.

— Ku është Emineja? — pyeti, sa për të thënë diçka.

— Shkoi të ziejë mishin.

Babai kaloi ultazi dhe ndenji ndanë murit që ruante anën e pyllit, duke pritur çastin kur e gjithë drita do të binte prej qiellit. Ky çast po afrohej. Hijet e natës zgjateshin mbi malet me dëborë. Pak më tej ishin dy partizanë të Shtabit.

Plumbat vinin me vërshëllimë të hollë, të shkur-tër dhe të prerë, pothuajse të pandjeshëm, dhe binin butë mbi mur. Por shkëputnin çika prej gurëve si me goditje stralli, me ndriçime të verdha, të gjelbra. Babai ndenji galiç, kaloi dorën mbi fytyrë, i habitur që shpëtoi pa u prekur, shikoi rrotull në mjegullën e ngjyer me errësirën dhe u ndie si mbi një urë të fortë sipër greminës. Mbase tani armiku po afrohej fshehtas, duke kaluar në lëndinat e pas gëmushave. Ngushtimin e rrethimit po e ndiente në lëkurë. Në të njëjtën kohë ndiente edhe sigurinë se do të kalonte me gjithë shokë, ishte gati të qeshte me këtë rrezik dhe ngriti kokën të shihte nga ana e pyllit që çohet si mur i errët. Prej andej foli një njeri me ton të ulët, por që të dëgjohej larg: «Aty je, o mjekërcjap!» Ky zë i papritur, që erdhi drejt mbi stan, i rëndë, i vjetër, mospërfillës, përmbante qortimin për ato që po ndodhnin, si edhe një kërcënim për fundin e afërt.

Babai fërkoj mjekrën, prej së cilës dëshironte të kapej armiku. Për herë të parë mjekra iu duk në vendin e vet, pjesë e trupit të tij. Po e pushtonte një urrejtje, e qetë, e mbledhur përherë nga pak, që nga dita kur lindi, prej tridhjetë e katër vjetësh. Ngriti kokën pas murit t'i përgjigjej atij njeriu, t'i thoshte të zbriste poshtë. Iu duk se dëgjoji lëvizje, sikur nëpër

pyll të kalonte ndonjë egërsirë e rëndë, nëpër drurët e shkurret, prapa dëborës, diçka që nuk kuptohet çfarë është e ku shkon, deri në çastin kur të bie sipër. Babai ndenji gati dhe zgjati qafën të shihte në rrafshin e dëborës. Urrejta e ftohtë, e paanë që e mbante galic pas murit, po i kthehej në një ndjenjë që nuk e kishte provuar kurrë, në dëshirën e fortë për ta shikuar këtë armik ndër sy, për ta prekur me dorë. Tashiti kishte rënë errësira, po ai nuk donte më të shkëputej prej armikut dhe përgjonte pas murit, duke marrë frymë ngadalë. I bëhej se që prapa shkurreve e dru-rëve të errët po i shihte vërtet fytyrat e tyre të ngërdheshura, të pabesa, të helmuara.

Flakët e pushkëve u ndezën buzë pyllit me një rridhim ngjyrë portokalli. Plumbat vërshellenin lart dhe anash. Babai nënqeshi, duke menduar se plumbat ndërronin drejtim kur i afroreshin trupit të tij. E dinte se s'kishte ardhur ora. Ngriti pushkën dhe priti të ndizeshin flakët dhe shtiu dy herë, duke shënuar brenda në to. Shtinë edhe dy partizanët. Babait iu bë se dëgjoi një rënkim, një pëshpëritje të armikut dhe u ndeh i tëri, u kap me duar pas gurëve. «Kështu, po», — tha me vete. Mbushi «malisherin» e bukur dhe priti pas murit, rregulloi «goltin» në ije. Këto armë nuk do ta linin kurrë në baltë. Ngriti kokën përgjysmë mbi gur dhe mendoi se do t'u dilte atyre nga një anë tjetër ku nuk e prisnin dhe do t'i shihte më mirë. Kjo s'kishte të bënte me atë që do të ndodhte atë natë, po me ngjarjet që do të vinin më pas. Kjo do të zgjaste një javë, një muaj, dhe do të vinte dita e madhe e shpërgimit, kur t'u dilte befasisht nga ana që s'e prisnin.

Që nga shkëmbi krisi mitralozi i Feridit, me kursim, duke derdhur plumb të zgjedhur, që përhapnin në ajër tinguj të ngrohtë, të bukur. Babai mendoi se një njeri si Feridi takohet rrallë në jetë dhe po habitej me ve-

ten që nuk e kishte ditur këtë më parë. Përgjatë murit po shtinin partizanët e tjerë. Nga ana e pyllit nuk u ndien më. Babai mbajti vesh krismat rreth stanit të Jahes Sheshit prej nga kishte ikur gjenerali. Ndofta ballistët po bënin sulm edhe aty, se shpërthyen disa bomba që hapën flakët e kuqe mbi dëborën e bardhë, deri lart në rrëpirat shkëmbore.

* * *

Partizanët që kishin mbrojtur stanin tjetër erdhën në të errët. Erdhi edhe Feridi. Babai i priti te dera e stanit të Qazimit. Kishte mbetur i vrarë te stani i Jahes një partizan i shtabit. Nja dy kishin plagë të lehta. Të tjerët ishin shëndoshë.

— Plumbi ka më tepër qejf frikacakët, — tha babai me zë të lartë. — Kushedi sa kufoma qensh shtrihen në dëborë. Tani do të hani darkë.

Armiku ngurroi një copë herë para se të besonte që stani i Jahes dhe shkëmbi i Feridit ishin liruar. Kur armiku e kuptoi këtë u dynd rreth e qark stanit të Qazimit dhe filloi sulmin, me thirrje për dorëzim e me sharje. Po tani te stani bëheshin gati tridhjetë pushkë, me vende të mbrojtura rreth mureve e brenda në shtëpi dhe sulmi u ndal. Babai rrinte pas derës dhe dëgjonte krismat, shihte flakët. Për disa çaste u duk sikur shtëpia po brehej prej plumbit. Po stani i Qazimit ishte një kullë e fortë. Një burrë me përvojë si ai e ndërton shtëpinë në vendin ku mund të mbrohet prej erës, prej ortekut, po edhe prej armikut.

Nga dera e «burgut» vinte era e mishit të zier. «Lajmëro shokët. Sill enën e babait», — pëshpëriti Emineja. Babai ndjeu përsëri urinë ta gërryente si bishë, donte medoemos të përtypte diçka dhe vuri do-

rën në gojë. «Turp, — tha me vete, — të tjerët kanë uri edhe më të fort.» Ai ngjiti shkallët. Bënin dritë prushi në «burg» dhe flakët e pushkëve. Qëndroi në krye të shkallëve si duke menduar se ç'duhej bërë më tej. Eci me kujdes në hajatin me dërrasa të shtrembra duke shikuar ku vinte këmbën dhe hyri në dhomë, ndenji këmbëkryq në minderin prej kashte, sa më rehat, që gjaku t'i vërshonte lirshëm prej zemrës. Ndezi çibukun, që tymosi në errësirë, dhe priti t'i sillnin lëngun e ngrohët jetëdhënës me copën e mishit. Edhe pak dhe do të kërcente jashtë me gjithë shokët dhe ai merrte frymë ngadalë, hapte sytë si njeriu që mbledh forcat e mat largësinë para hendekut.

Erdhi Qazimi dhe tha se kishte zbritur deri në mesin e Përroit të Vardarit. Tha se ishte i sigurt që ata s'mund të kishin zënë pritë nga kjo anë me shkrepë.

— Nuk po sulmojnë më, — tha babai.

— E dinë se edhe kafsha më e dobët të hidhet sipër po ta shtrëngosh pas murit, — tha Qazimi.

Babai mendoi se Qazimi tha një të vërtetë. Veçse pas murit nuk qenë vënë ata, po armiku dhe kjo do të provohej së shpejti. Babai mendohej për atë që kishte parë gjatë shtatë orëve dhe që nuk do ta harronte kurrë. Ai shikoi nga dritarja përmes pllakave që kishte vënë Emineja. Lugina me fshatin në fund ishin si një pus i errët. Vezullonin aty-këtu drita të vogla në brigjet e Korenës. Që nga dreka njerëzit aty mbanin frymën për atë që do të ngjante lart në stane. Babait i kaluan rrëqethje. Nga dritarja frynte erë e ftohtë trazuar me grimca dëbore, si e ardhur nga larg. Nga ana e pyllit u ndez një zjarr që hodhi dritë mbi pishat me dëborë. Kaloi një kohë dhe u ndezën zjarre në vende të mbrojtura rreth e qark stanit të Qazimit. Në errësirën e thellë ngjanin si qirinj rreth një varri të

lartë. Armiku do të mbante rrethimin duke pritur mëngjesin.

Në dhomë hynë Selman Gërvishta me Jasharin dhe ata të katër ndenjën një copë herë në heshtje. Rreth tyre po mblidhej ajo frymë kokëfortësie e zemërimi të qetë, që mund të pushtojë njerëzit buzë humnerës, kur e dinë se jeta do të luhet në një kërcim të vetëm. Atëherë njeriu bëhet i rrezikshëm. Tani nuk donin të iknin prej stanit. Për shtatë orë kishin qenë tepër kokëfortë, tepër të duruar. Durimi më i madh është të numërosh fishekët, t'i kursesh plumbin armikut, edhe kur ai bëhet guximtar e i rrezikshëm.

— Do të shkosh me anglezët, o Selman, — tha babai. — Merr këtë letër. Si të hani darkë, do të strukesh me ta te rrëpirat ku u hodh djali. Ne do të çajmë nga Përroi i Vardarit. Kur të dalim, do të shtiem pushkë. Ata do të turren këtu. Atëherë ti merr rrugën e Balit prej nga erdhe. Çoi anglezët te Rahmani dhe ai t'i përcjellë për në bazën afër Tiranës me letrën.

Babai ishte i kënaqur për shtegun e ngushtë e të shpejtë nga do të kalonin anglezët dhe tha se kjo ishte puna më e vështirë. Selmani nuk foli. Kërkoi në të errët sytë e babait. Për disa çaste ndenjën duke marrë frymë pranë njëri-tjetrit. Babai zuri të inatosej. Selmanit do t'i takonte gjithnjë pjesa më e rëndë, pa u shpërblyer kurrë, pa një fjalë të mirë. Se ai nuk jepte rast të bëje diçka për të, as t'i thoshe një lavdërim, zinte e kthente në tallje.

— Zgjidh edhe tre partizanë, — tha babai. — Këta anglezë duhet të venë në vend se s'bën.

— Kismet, — tha Selmani. Donte të thoshte se anglezët do të venin, jo po në mos...

Babai pa orën me akrepat e fosforit, sikur ora të shënonte diçka, kohën e caktuar. Tundi kokën si për t'u përsëndetur dhe zbriti shkallët. Poshtë Emineja po lidhte një deng në dritën e zjarrit. Foli me atë habinë e nxehtë që i hipte në fytyrë, tha se ajo me çunin do të strukeshin te korija të mbuluar me velenxat, sa të kalonte nata. Në agim do të zbrisnin si prej malit për të gjetur dhitë, si duke shkuar te mulliri, si duke shkuar te dera e babës. Me të folurit e shpejtë e të gëzuar donte të tregonte se ashtu do të ngjante patjetër. Babai ndenji duke e shikuar, me grykën të zënë. Aty më parë, duke menduar për anglezët, e kishte harruar Eminenë dhe djalin. Po ajo kishte menduar për veten, se qysh t'ua bënte burrave nisjen të lehtë.

—Deri këtu, o Qazim. Ti të rrish, — tha babai.

— Punë që s'bëhet, — u hodh e tha Emineja. — Ai s'ka si ndahet nga shokët. Le që është edhe më keq, — tha duke zgjatur zërin e gëzuar, për të treguar se sa keq do të ishte vërtet.

Ata filluan të dilnin njëri pas tjetrit, të hyjnë në errësirën e thellë të ftohtë, duke u përpjekur secili të shkelte pa u ndier në gjurmën e shokut. Zjarret e afërta të rrethimit diku merrnin vrull, hidhnin ndriçim të lehtë në qiellin e ulët. Tre korenasit, Qazimi, Jashari e Nabija, zbritën të parët në Përruan e Vardarit dhe filluan të ngjiteshin në bregun Polic. Kjo zbritje e ngjitje dyqind metra, në errësirë të plotë e me lëvizje të pandjeshme, zgjati treçerek ore. Babai, që vinte i katërti, rrëshqiste hera-herës, duke gërvishtur duart e fytyrën në pllakat e gurit poshtë dëborës. S'po kuptonte nëse ecte më shumë përparë apo mbrapsht. Nuk do t'ia kishte dalë të ngjitej, pa ndihmën e fuqishme të Jasharit. Te bregu panë rrugën e hapur në dëborën e madhe nga kolona armike e

krahut të Vallit. Ishin ngjitur dhjetëra njerëz, ndofta qindra. Zjarret nga pyjet dhe sipër bregut Polic ndriçuan më shumë dhe Qazimi i nxiti të tjerët duke i prekur me dorë të kalonin shpejt.

Ata kishin ecur mjaft, pa ndier lodhje, duke menduar me gëzim se i rrëshqitën çarkut më shpejt dhe më mirë nga sa kishin besuar. Po zjarret dukeshin ende të afërta dhe Qazimi prapë i nxiti të ecnin në dëborën që arrinte te gjuri, në errësirë të plotë. Diku, në një qafë, ku ndofta kryqëzoheshin dy rrugë, çeta u nda. Njëra pjesë u nis me Qazimin në anën e bregut të quajtur Kolgrek, pjesa tjetër ndoqi Jasharin në krahun e Zallderit, pa ditur kush se çfarë ishin këto vende, veç atyre të dyve që hiqnin udhën. Kishte nisur një stuhi dëbore e imët që të priste lëkurën. Pjesa e çetës që shkoi me babanë dhe Qazimin nga ana e Kolgrekut, ndali në qafë, rrethimi armik ishte lënë prapa dhe njerëzit u shtrinë në dëborë, me rrobat të lagura. S'kishin më fuqi as të preknin gjymtyrët ku u qe zhvokshur lëkura gjatë kalimit të përroit. Dikush tha të ndiznin zjarr.

— Nuk ndizet zjarr këtu, as ndalohet. Po të ndalojmë, asnjëri s'do të çohet i gjallë, do të ngrijmë brenda rrobave. — Ky ishte zëri i fortë e kërcënues i Qazimit. Babai ngriti pushkën dhe shtiu tri herë në drejtim të pyllit të Kreshtës, ku shquheshin zjarret e mekura. Shtinë të gjithë nga një fishek. Kaluan disa çaste dhe u dëgjuan pushkët e grupit që ishte nisur nga ana e Zallderit.

I

Mbi lagjen «Qytezë» kalonte mjegulla e agimit të ftohtë. Aty afër ishte kulla e Gërvishtajve, ku kishte banuar misioni, e djegur dhe e shkatërruar me dinamit. Ky shkatërrim shtrihej edhe në shtëpitë poshtë dhe tërë lagjja i ngjante një skeleti me zgavra në mes të dëborës së ngrirë.

Koloneli Nikols zgjidhi këpucën me qafë dhe pa se plaga kishte zënë një kore të zezë. Rreth plagës mi-shi ishte zbutur dhe po merrte ngjyrë blu me njolla të kuqe. Po të ishte fillimi i një gangrene, këmba du-hej prerë sipër gjurit. Kur e mendoi këtë, në sytë e tij humbi drita dhe i ranë djersë të ftohta.

— Nuk ndiheni mirë, kolonel? — pyeti përkthyesi.

— Duhet të arrij sa më parë te një kirurg, — tha koloneli, duke shtrënguar dhëmbët.

— Po përpiqemi të gjejmë një kafshë. S'ka mbe-tur gjëkund kafshë e gjallë, — tha përkthyesi, duke shi-kuar rrotull.

Koloneli fshiu djersën dhe hëngri dëborë. S'mund t'u dorëzohej gjermanëve, si gjenerali e Traihorni, se Gestapoja nuk do ta falte, për shkak të ca llogarive të vjetra. Duhet të arrinte te një kirurg. Po të shpëtonte këmbën, do të mbetej komandant i misionit e do të gra-dohej gjeneral. Po t'i pritej këmba, mund të kthehej në Angli si një hero. Për sa kohë do ta shihnin si një hero? Kujt do t'i hynte në punë një burrë 40 vjeç, me një këmbë? Ai qau heshtur, pa lot, pa lëvizur një muskul të fytyrës.

Më keq se me kolonelin puna dukej me majorin Smith. Ky rrinte mbi një gur, sikur të qe ngulur aty përjetë, me trupin drejt, dhe shikonte luginën pa parë asgjë. Një rob italian ia lante fytyrën çdo mëngjes. Robi nuk ishte më dhe majori s'e kishte larë fytyrën prej tri ditësh. Atij i dukej se nuk ishte larë prej shu-më kohësh. Sidomos në dy javët e fundit kishte humbur aftësinë për të ndarë e kuptuar kohën, ato që ngjisnin rreth tij i dukeshin punë të një bote të egër e të pa-njohur, në të cilën kishte rënë për shkak të disa rretha-nave që tani nuk po mundej t'i kujtonte. Pak më poshtë rrinte nënoficeri, me arkën në çantën e shpinës, një arkë me rrathë hekuri. «Mund të marrësh sa të duash», — i kishte thënë Smithi përkthyesit në Labinot dy muaj më parë. Ai kishte ngritur lart grushtin me monedha, në arkën e mbushur në treçerek. Drita e tyre e verdhë në të kuqe kishte rënë si flakë në fytyrën e përkthyesit. Ari do t'i jepte dritën e vet edhe fytyrës së një të vdekuri. Këtë thoshte nënqeshja e Smithit. Pastaj ai kishte dalë nga dhoma duke vërshëlyer, duke e lënë

arkën hapët. «Kjo do të raportohet, sër», — i kishte thënë përkthyesi në korridor. «E kisha fjalën për furnizimet», — qe përgjigjur Smithi.

Secili nga të tre anglezët dukej se bënte shkakhtar tjetrin për gjendjen ku kishin rënë, po ama dinin edhe se duhej të mbeteshin të bashkuar. Përkthyesi mendonte me habi të vjetër e me shqetësim dhe priste që ndërmjet këtyre njerëzve krenarë e të qetë në dukje, po të dërrmuar në trup e në shpirt, të shpërthente më në fund diçka e keqe që s'mund të ndalej, as të parashikohet. Përkthyesi i trembej fort kësaj. Selman Gërvishta që kishte shkuar për bukë e për kafshë ende s'po vinte.

Koloneli Nikols vishte këpucën, shtrembëronte fytyrën dhe rënkonte. Ky rënkim i hynte majorit Smith si një gërvishtje nga brenda. Prej ditësh, ai s'mund ta duronte mënyrën si fliste koloneli, si hante, si rrinte.

— Mos rënkoni, mos rënkoni, pra, — i tha ai kolonelit, pa lëvizur në qëndrimin e tij të ngrirë. Sytë e skuqur i kishte të mbushur me egërsi, mjekra i qe tendosur, gjoksi i hidhej si një të marri, gjithnjë duke ndenjuri si një gjysmë statuje. Po në çastin tjetër ai do të bënte diçka me duar, do t'i hidhej diku në grykë. Dukej se tani asgjë s'mund ta ndalte shpërthimin e Smithit, as përdorimi i disiplinës, as dhuna fizike. Dhe më afër duarve të tij ishte në atë çast fyti i kolonelit, që shihte me vëmendje çdo lëvizje të Smithit, si një vërtetim i gjallë i rasteve të përmendura në literaturën sekrete të psikologjisë ushtarake. Agresiviteti rritej befas në një rreth ushtarësh të veçuar në shkretëtirë, ose në pikat e vrojtimit rreth polit. Një ushtarak, deri aty më parë krejt paqësor, mund të vriste të afërmin mbi të cilin kishte mbërthyer sytë. Koloneli mendoi se ndofta tani Smithi po lëvizte duart dhe bënte mirë të merrte njëfarë largësie prej tij, pa i rënë kjo në sy Smithit, që mund të nxitej nga një lëvizje çfa-

rëdo. As të tjerëve nuk duhej t'u binte në sy. Sepse në raste të tilla të gjithë ndiejnë, vërejnë. Frymëmarrrja e Smithit nuk po binte, iu zverdhën edhe sytë, ku luhatej ajo drita e errët e tërbimit, po edhe e lodhjes më të madhe. Ai do të binte në gjumë si gur, apo do të tërbohej? Kjo e dyta duhej më e mundshme, rreziku duhej vërtet i afërt. Koloneli mendoi se po rrinte aty si një qen i lagur që pret goditjen, budallallëk krejt i panevojshëm, dhe vendosi të çohet sido të bëhej, doli disa hapa më tej; ndenji kundrejt të gjithëve me trupin dy metra të lartë dhe tha:

— Zotërinj, ndofta shumë shpejt majori Smith do të marrë komandën e misionit në vendin tim.

— Ju do të shëroheni, zoti kolonel, — tha përkthyesi, duke menduar se çasti kritik kishte ardhur më në fund dhe kjo do të binte në kokën e tij.

— Për çdo rast vendimi im mbetet në fuqi, — tha koloneli me të njëjtin zë pajtimi e të pasigurt, duke i bërë shenjë nënoficerit të rrinte gati. Koloneli po mendonte se bëri atë që mundej, sjelljen e tij mund ta dëshmonin të tjerët dhe tani majori Smith duhej të ndihmonte veten, në rast të kundërt, duhej lidhur dhe, po të ngulte këmbë, të pushkatohej në rregull. Komandan-ti i një misioni ushtarak në luftë ka të njëjtat të drejta të kapitenit të anijes në det. Koloneli Nikols priti duke mbajtur frymën.

Majori ktheu kokën si për ta mbështetur në supin e djathtë, me rrudhat e një hidhërimi të thellë në fytyrë, sikur të kërkonte fillin e diçkaje të vështirë. Gjoksi nuk i hidhej më si aty më parë. Shikoi kolonelin si pa e njohur dhe u çua, shkoi më tej, si me boshitin e kurrizit të ngrirë, sikur trupi i tij të ecte vetë, në një drejtim të pacaktuar. Qëndroi te gurët majë bregut ku kalonte mjegull, duke shikuar hapësirën e thellë të Markeshit dhe lumin Dron. U përku! ngada-

lë, mori dëborë dhe zuri të fërkonte fytyrën. Koloneli u ul prapë te gurët. Përkthyesi mori frymë i lehtësuar.

* * *

Që prapa mureve të djegura zgjatën kokat dy djem të vegjël. Këtë e përsëritën nja dy herë dhe rrinin fshehur.

— Janë egërsuar fëmijët, — tha njëri nga partizanët e Shtabit. — Mbase janë zemëruar me ne, — tha me pikëllim.

Tjetri ktheu trupin e madh siç ishte ndenjtur, pa fëmijët i menduar dhe u çua, thirri «vdekje fashizmit», me zërin e thellë, që donte të dukej i gëzuar. Djemtë dolën që prapa mureve dhe ecën me druajtje, u afruan. Se nga dolën edhe dy djem të tjerë dhe një vajzë. Këta nuk shquheshin mirë prej mjegullës, po dëgjohej afrimi i tyre mbij dëborën e ngrirë. Ndenjën të gjithë tok disa hapa më tej, pa folur, mendoreshin për diçka, të thithur krejt prej asaj që mendonin. Ishin të zbehtë e të thatë, me gjymtyrët mavi prej të ftohtit.

— Seç kanë pësuar fëmijët, — tha partizani i parë me grykën e zënë, me mjekrën e parruar të zgjatur.

Djali më i vogël eci duke u penguar drejt partizanit trupmadh që rrinte më këmbë. Ky e mori në krahtë. Djali i lidhi duart rreth qafës.

— Kështu po, — tha partizani, duke u gëlltitur.

Fëmijët e tjerë erdhën pranë. Njëri prej tyre tregoi kolonelin Nikols dhe tha:

— Ky na përzinte. Mbante kamxhikun në dorë.

Koloneli kuptoi. Dinjiteti i fëmijëve, gati të lecko-sur, të pandjeshëm ndaj të ftohtit, e bëri të harronte dhimbjen e vet. Zuri të kërkonte diçka në xhepat dhe si nuk gjeti asgjë, ktheu kokën gjatë.

— Mos e trazoni se është i sëmurë, — tha përkthyesi.

Fëmijët panë anglezët me vëmendje. Tani ishin gati të qeshnin, t'i falnin të huajt të rënë në një fat të keq, ishin gati t'u ndihmonin dhe shkuan e i panë nga afër, pa ditur se ç'mund të bënin për ta.

— Po hë, o djem, si e keni kaluar, ku janë njerëzit? — pyeti partizani me djalin në duar.

Fëmijët zunë të përgjigjeshin me fjalët varg. Treguan edhe më tej, duke përmbajtur hovin e shpirtit, se qysh u thoshte armiku: «Ku i keni shoqet dhe shokët partizanë? Ku është baba Merxhani që ta shkojmë pak në hell? Pa hë, i bini pak kokës me grusht, thërrisni atë parrullën «Liri popullit». «Këto fjalë, «Liri popullit», «shoqet» e të tjera, ata, ballistët, i shqiptonin me tjetër zë, sikur të ishin fjalë të turpshme e me shije të veçantë, duke u therur fëmijëve në zemër, se u prekeshin gjërat e shenjta, ashtu si dinë t'i shenjtërojnë gjërat fëmijët.

Fëmijët kishin mbajtur lotët në inatin e tyre të heshatur, kishin fjetur pa bukë dhe qenë çuar çdo ditë me shpresë. Kjo kishte zgjatur njëzet ditë, që janë një jetë e tërë për një fëmijë. Po tani vendin e hidhërimit të fëmijës, që është i tërëfuqishëm, po e zinte gëzimi i ndritur, që kthyer e vërteta dhe ata flisnin tani më fort, duke i treguar vetes partizanët të gjallë, duke u prekur yjet e kuqe dhe armët. Dhe prapë rrinin seriozë, në krenarinë e tyre të madhe përzier me ndjenjën e hakmarrjes.

— S'kanë gjë fëmijët, jo, — tha partizani i parë. — Ishin të egërsuar se u vonuam shumë. — Partizani tjetër u kthye mënjanë të mbulonte ngashërimin.

Fëmijët biseduan ndërmjet tyre, duke tërhequr hundët, duke mbuluar gjymtyrët, deshën të bënin diçka më tepër për t'i treguar vetes se e vërteta që kthyer me gjithë mend, ndenjën pranë njëri-tjetrit dhe kënduan:

«Bota është mbushur me lot e mjerime.»

Këndonin njëherësh, fort dhe pa gabime, duke thënë secili fjalët e tij, duke ndihmuar shokun. Në sytë e ndritur kishin triumfin dhe u mbajtën drejt e palëvizur, deri në fund të këngës. Partizanit të dytë, atij trupmadhit, që qante, i shkonin lotët heshtur; me gojën gjysmë të hapur shtrembër. Ai tjetri shikonte sytë e fëmijëve.

Toka pinte gjakun e luftës dhe era shpërndante hirërat e saj. Fëmijët rriteshin me këngë, me gjurmët e luftës në sytë e bukure të ndritur. Pas disa vjetësh këto gjurmë do të zhdukeshin prej syve të tyre dhe ata do të kujtonin me habi ato që kishin hequr. Partizani u hoq mënjanë të qetësonte veten, u kërrus mbi bllok dhe shënoi: «Ora 7.00 e mëngjesit, datë 10 janar 1944, lagjja «Qytezë» e Markeshit të djegur. Kënduan fëmijët këngën e fitores. T'i dëgjosh, të kullon zemra gjak.»

Erdhi një fshatar me gruan e re dhe prapa tyre Selman Gërvishta, duke tërhequr një mushkë. Fshatari hapi trastën në heshtje dhe zuri të priste me biçak një bukë misri që nxirrte avull. Nusja e tij rrinte me gishtin në tëmtha, kokulur, pa shikuar asgjë, ndërsa i shihete të gjitha, siç dinë vetëm gratë. Fshatari ia dha copën e parë kolonelit. Ky kishte ndenjtur i mbështjellë me qyrkun e madh të verdhë, me kokën ndërmjet supëve, si një ka i goditur në ballë që nuk di nëse duhet të shtrohet të ngordhë, apo të çohet edhe një herë më këmbë. Kur i dhanë bukën që avullonte, iu kthye gjallëria, filloi ta hante ngadalë, sikur do të nxirrte prej saj tërë fuqinë që i duhej dhe shihte me vëmendje krundet, përtypte dhe kashtrat që gjendeshin në të.

Fshatari i bënte lëvizjet të qeta e të ngadalta dhe në ngathtësinë e tij ndihej ngutja e shqetësimi.

— Paski ardhur për gjithë natën në këtë dëborë? — pyeti ai me habi Selmanin.

Selmani ndenji mbi një gur, i lodhur për vdekje dhe i uritur, po në pajtim të plotë me qëllimin e vet, me detyrën për t'i dorëzuar të gjallë anglezët. Po mendonte se ishte i vetmi që mund të nxirrte këtë punë në krye dhe, për besë, do ta bënte, edhe sikur t'i çonte anglezët në krahë përpjetë tetëdhjetë e dy shkallëve të Balit, se këtu ishte fjala për politikë, për një urdhër të prerë të Shtabit të Përgjithshëm. Tani niste pjesa e fundit dhe më e vështirë e udhëtimit, rrëpirat dhe pastaj ngjitja. Ai po shikonte fshatarin. Ky futi biçakun në brez dhe tha:

— Deri te Kocajt ju përcjellim na. — Po priste me durim që partizanët të gëlltisinin bukën. Gruaja e tij e re rrinte më këmbë pa lëvizur, duke shikuar me vetullat puqur se sa shpejt po zhdukeshin copat e bukës.

— Duhet të shkojmë, — i tha fshatari Selmanit, — sa kohë është dëbora e ngrirë dhe ecën mjegull.

Partizani i parë u çua, shikoi rrotull, duke dashur të shihte diçka përmes mjegullës së lehtë, të dëgjonte një tingull. Mbi Markesh sundonte qetësia, si në një varr të zbrazët.

Majori Smith erdhi e ndenji para përkthyesit, i foli nëpër dhëmbë, po qartë:

— Unë duhet të arrij Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare.

— Tani kjo nuk është e mundur, — tha përkthyesi.

— Po qe se nuk më çoni te Shtabi, pranoj pushkëtimin, — tha majori.

Përkthyesi u bind se majori e kishte me gjithë mend. Ky paskësh qenë çasti i vërtetë i krizës, së cilës i qe trembur tërë kohën. Donte të kuptonte shkakun e përçarjes së beftë të majorit, dhe e pa në sytë e tij, ku lëvizte një dritë e fshehtë, të cilën s'ia kishte parë

kurrë. Ky ishte rasti për majorin të bëhej shef i misionit, të arrinte Shtabin, kur të tjerët dështuan.

— Çfarë po thotë ai? — pyeti Selmani.

— Kërkon Shtabin, ose plumbin, — tha përkthyesi.

Selmani e pa majorin nga afër e me kujdes dhe tha:

— E kërkon plumbin vërtet.

— Ju, major, ende s'e keni marrë komandën, — tha Nikolsi duke drejtuar trupin e gjatë. Në sytë i shkrepinte një urretje e paanë dhe ktheu kokën që të fshihte shikimin nga Smithi dhe të tjerët.

Një copë herë ata të dy këmbyen fjalë të shpejta, të ashpra. U duk sikur koloneli do të prekte armën, ose do t'i jepte një urdhër nënoficerit, që rrinte më tej si i huaj, po edhe i gatshëm. Selmani po mendonte se këta anglezët, të vetmuar, të heshtur, të zorshëm për t'u kuptuar, nuk ndryshonin nga gjermanët, për aq sa i njihnte gjermanët Selmani. Mbase edhe këta silleshin si nazistët në vendet e botës që mbanin pushtuar. Përse ishin bërë kaq armiq të fortë? Komunikatat e tyre flisnin për mijëra aeroplanë që bombardonin Londrën dhe mijëra të tjerë që bombardonin Gjermaninë. Po këta një afrim të fshehtë duhej ta kishin, edhe pse nuk ia kursenin bombat njëri-tjetrit. Kjo ishte një punë dreqi, një si det i madh ku humbet mendjen njeriu. Selmani shkoi te majori, i vuri dorën në sup dhe i tha me të butë:

— Orke¹⁾, vemi në Bal të gjithë bashkë. Aty mund të gjejmë drejtimin e Shtabit.

1) Strembërimi i fjalës anglisht «Okej».

II.

Në pllajën e madhe të Golikut shkrinte dëbora, duke nxjerrë për pak kohë në diell kodrat me blerim të errët, përrenjtë dhe luginat e thella. Vetëm për pak kohë, se ngjiteshin retë përsëri, nisnin shirat me stuhi e gjëmime, kërciste e tërë hapësira, sikur po vinte fundi i dheut, prapë binte dëborë deri buzë lumit dhe urtësohej qielli i Golikut.

Për fshatarin ishte edhe më keq kur hapte moti. Në ditë të tilla dukej sikur hapeshin vathat nga ana e lumit dhe ngjiteshin lart kope të tjera balliste, me fantazi të ndezur e të përtërirë, duke kërkuar edhe në skutat më të fshehta. Mund të gjenin befas Shtabin e Përgjithshëm, një gjeneral anglez plot me flori, një depo me armë e ushqime, një damixhan me raki sa për t'i dhënë zemër vetes në atë dimër të ashpër. Njeriu që kërkon do të gjejë diçka. Nuk gjenin asgjë në fshatrat e varfra e të shkretuara dhe niste huri, arrestimet, kërcënimet për pushkatim. Sido që të ishte, një gjë duhej bërë: të shkulej nga ato anë komunizmi, të nxirrej prej kokës së fshatarit çdo ide e kundërshtimit.

Vala balliste, që vërshonte nga pika të ndryshme dhe rregullohej sipas motit, përhapej me të njëjtat synime në krahinat fqinje dhe s'kishte shenjë se do të binte me kalimin e kohës. Po ardhja e një vale të re gjithnjë lajmërohej, duke ecur lajmi më shpejt se çdo kolonë e shpejtë, dhe fshatari kishte kohë të tërhiqte dhinë në pyll, të fshihte kafshët dhe atë pak drithë e bulmet që i kishte mbetur, për të dalë me sa më pak humbje prej sulmit të ri që po vinte.

Në fshatin Ofshan, vala armike arrinte rrallë e me furi të pakësuar. Vinte nga ana e Merqanit, nga lagjja

«Kolla e Madhe» dhe arrinte deri te shtëpia e Ademit në lagjen «Kolla e Vogël», ku rrinte mbyllur vetë i katërt baba Merxhani. Prej dhjetë ditësh babai shikonte pjerrtas qepenin ku do të zbriste për të kaluar në bodrumin e fshehtë. Bodrumi i dukej si një pellg i errët me ujë të ftohtë, me ajrin mbyhtës. Kjo ndjenjë iu bë më e fortë me kalimin e kohës dhe, kur ecte nëpër dhomë, kalonte larg qepenit, kur ulej në postiqe, rrinte si njeriu që ka pranë vetes gropën. Rrinte në pritje të orës kur do t'i duhej të zbriste aty dhe njerëzia do të thoshin pastaj, baba Merxhanit u fsheh në bodrumin e Ademit.

Më 20 janar, në kohën e drekës, erdhi duke rendur Lumja, nusja e re e Seferit, me fytyrën të zbardhur prej vrapit që nga pylli i Shkozës. Nuk shihte rrugën dhe e kaloi oborrin me pllaka në udhëzën e pastruar prej dëborës si e këputur në mes. Ngjiti shkallët, duke u mbajtur aty-këtu me duar, pa i folur asnjëriut. Në krye të shkallëve u ndal një çast si për të gjetur drejtimin, për t'u kujtuar dhe nisi vrapin përsëri në hatatin rrumbullak, zbriti tri shkallët që mbaronin te dera e dhomës pas qoshes së fshehtë. Kjo dhomë kishte dhomën e miqve mbi vete dhe poshtë «burgun» e dhive, duke qëndruar në mes të dy kateve, si e ndërtuar enkas për të fshehur njerëz. Kur shtyu derën me dru të vjetër të gdhendur dhe u gjet para burrave, hapi sytë e kaltër, kuptoi se më në fund kishte arritur ku duhej, se s'kishte nevojë të vraponte më tej, bëri shenjë me dorë që të prishnin, të dëgjonin, me dorën tjetër fërkonte fytnin. Më në fund tha:

— Një kallaballëk po vjen me shpejtësi nga Kolla e Madhe.

Ata nuk po vinin me shpejtësi. Kaloi një gjysmë ore, gjatë së cilës shtëpia e Ademit, me shumë të ndara e me tridhjetë e pesë frymë, ra në heshtje të thellë.

Qenë zhdukur fëmijët. Në dhomën që rrinte pezull midis kateve, baba Merxhani mbante vesh me durim, me «malisherin» mbi gjunjë. Jashari i kishte vënë derës shulin e madh dhe rrinte më këmbë i kërrusur, edhe ai duke përgjuar. Rregulloi bombat, koburen, thikën, që nuk dihej nga i nxirrte dhe ku i vinte, por ndihej se ai burrë i gjatë me sytë e butë ngjyrë kafe, ishte gjithnjë i ngarkuar me armë. Nabija dridhte cigare për babanë dhe rrëqethej. Qazimi shihte duart e Nabijes. Asnjeri nuk shihte tjetrin në sy, as qepenin e hapur. Nga lagjja përtej zallit, që i thoshin «Katundi», erdhi krisma e gjatë e një «Sharsi». Dukej sikur ky mitraloz po çonte dëborën lart dhe kërkonte diçka nëpër qiellin e ngushtë të Ofshanit. Baba Merxhani mori frymë thellë, tundi kokën, priti krisma të tjera.

Kur erdhi babai aty, dhjetë ditë më parë, kryetari i këshillit shkoi në të katër lagjet, trokiti në çdo derë dhe tha:

«Te shtëpia e Adem Ollmuçës gjendet baba Merxhani i Markeshit. Ta thashë me gojën time. Jeta e tij rëndon mbi gjithë fshatin. Mendoje vetë se çdo të bësh.» Kryetari i Këshillit thoshte vetëm këto fjalë të qarta, pa e ulur zërin, ku ndihej një qortim për të zotin e shtëpisë, një paralajmërim për një faj të rëndë që nuk e kishte bërë, por që mund ta bënte në të ardhmen. Pastaj ikte më tej, si një hije e madhe, me fytyrën dinake të zbuluar në dëborë, trokiste në derën tjetër. Fshatari rrinte te pragu, mendonte me habi se krejt papritur i kishin marrë peng besën dhe nderin, vetë shpirtin, për të dhe për fëmijët, për të shkuarën, të tashmen e të ardhmen. Çdo gabim në këtë punë paguhej me kokën e robve të tij, me shtëpinë e me gjënë, me tërë fisin. Pastaj ulej në vatër, duke ndierë kënaqësi që ishte edhe ai një hallkë e zinxhirit me të cilin po e lidhte kryetari i këshillit krejt Ofshanin. Ky ishte një

kryetar dinak deri në fund, që e pa veten ngushtë, se për mikun që i erdhi i përgjigjej rëndë armikut, po nuk do ta kishte më të lehtë edhe me anën tjetër, dhe atëherë sajoi këtë dredhi, e përhap, e ndau në masë të barabartë të fshehtë, se vetëm kështu mund të mbe- tej vërtet e fshehtë; bëri një ngatërresë që rëndon- te mbi fshatin, duke shikuar çdo njeri se çfarë mund të bëjë e të thotë, ku mund të shkojë ose jo, për të lar- guar nga vetja dyshimin dhe në të njëjtën kohë të përgjojë të tjerët.

Tani kjo punë rëndonte më shumë se mbi çdo nje- ri mbi baba Merxhanin që e shkaktoi. Ai mendohej për fshatin. Besonte me gjithë shpirt se fshati do të shpëtonte veten, nderin, emrin.

Ata erdhën më në fund, Nuk merrej vesh përse thë- rrisnin. Oborri duhej të ishte mbushur plot. Zërat e tyre vinin edhe nga dritaret e mbyllura, sikur po u ngjiteshin mureve nga jashtë. Pastaj disa u larguan, kaluan më tej, nuk u ndienë më pas mureve. Të tjerët hynë brenda, të prirë nga i zoti i shtëpisë. Pesë të parët ishin gjermanë, flisnin me zë të lartë, si të ina- tosur, si qiraxhinj që u ka mbetur barra në rrugë. Nja dy prej tyre qeshën, ndërsa kërcisnin shkallët, dyshe- meja, e gjithë shtëpia. Pas gjermanëve po ngjiteshin mercenarët,

Gjatë katër orëve, të zotët e shtëpisë i ngjitën e i zbritën shkallët pa pushim. U therën dy dhi e u gatuan bukë, groshë, byrekë. Gjermanët donin vezë, shumë vezë dhe gjalpë. Kur flisnin ata në gjuhën e ty- re bëhej heshtje në dhomë. Pastaj flisnin mercenarët, duke sharë Buzin e Madh, duke gjykuar keq e më keq

tërë Shqipërinë e Mesme, çdo gjë që lidhej me baba Merxhanin. Nuk ishte e mundur të mos ia përmendnin emrin, sikur mendjet e tyre të ishin ngulur në një pikë të vetme, sikur secili të qeshte e të shante me gojën mbi dysheme, sikur ta dinte se ai po i dëgjonte fjalët një për një, nën qilim e poshtë dërrasave. Ikën në orën 3.40. Një copë herë babait i jehuan në kokë hapat e rëndë të gjermanëve, sharjet e ballistëve. Kishin shkarkuar aty një pjesë të mllefrit, për të kaluar më tej, me një shpresë të egër. Donin sidomos krerët, për t'i provuar vetes dhe të tjerëve se arritën diçka në këtë operacion të madh. Babai nënqeshi me krenari. Edhe pse i sëmurë e i mbyllur, ai prapë po i hapte telashe armikut, që bridhte edhe pas tij. U ngjit me mundim në dhomën lart dhe i pa tek dilnin nga fshati, të kredhur në dëborë, duke ndjekur diçka që s'mund të arrijnë kurrë, sado të bridhnin.

* * *

Babai fërkonte gjunjët ngadalë. Në qetësinë dhe heshtjen e thellë të dhomës jehonin tingujt, thirrja e një fëmije në rrugë, blegërima e një deleje. Jehonte edhe rënia e dëborës nga çatia, që kishte mbuluar përgjysmë shtëpitë, duke anuar ose zhdukur gardhet. Nganjëherë vinte mbrëmja pa ikur mirë mëngjesi. Nganjëherë, në dhjetë minuta babai shikonte orën tri herë, e mbante te veshi dhe dëgjonte tiktakun e ftohtë që rrihte sekondat. Koha ka një të fshehtë. Në ditët e para koha i dukej e gjatë, se kishte me se të merrej. Dërgonte letra në Markesh, në Merqan e gjetkë. Pastaj vinte pritja e rëndë, ditët bosh, koha pa kohë. Sa më tepër zgjateshin ditë të tilla, aq më shpejt e pa kuptuar kalonin. Si dervish e si baba, e kishte ditur

si ecën koha pa lëvizje. Po prej dy vjetësh kishte qënë në lëvizje të pandalur. Tani kishte rënë befas në mungesën e lëvizjes së plotë e të dhimbshme dhe i duhej një përpjekje e madhe për t'i bërë ballë. Përpiqej të mblidhte lajme nga çdo burim, për të krijuar një pamje sa më të qartë të asaj që ndodhte. Bota jashtë lëvizte ngadalë, kurse ai mbetej i mbërthyer në vend, me këmbët që po i ënjteshin, a thua se po hidhte rrënjë në dysheme, i rrethuar prej armikut e dëborës.

Lajmet vinin të rënda, disi të pabesura.

Si kaloi furia gjermane, në Markeshin e shkretuar sundonte pushteti i vjetër. Bajraktarët rreth e qark s'ia kursenin mercenarët komandës në Ndërfushë. Partia çshtë shuar. Baba Merxhani ka vdekur në dëborë, ka ikur në Londër, e mori një aeroplan në Kreshhtë i dërguar prej shehut të Dibrës, e panë të dorëzohet në Qafën e Murrizit tek shkonte për në Tiranë. Këto lajme i solli edhe Selman Gërvishta. Tregoi duke qeshur çdo hollësi që dinte për sa u ndodhte disa bashkëfshatarëve, pa u dhënë këtyre ndonjë rëndësi, si gjëra që ashtu do të ndodhnin, e që duheshin pranuar si të pashmangshme e kalimtare nga çdo njeri që i njihte këta markeshas.

Babai e dëgjoi me kujdes e vëmendje të thellë, heraherës duke tundur kokën, si për të vërtetuar se ato që dëgjonte i kishte parandier brenda vetes, vinin nga burimet e dhimbjes që i mbante mbuluar. Uli qafën për ta parë më mirë Selmanin, si për të ditur nëse e kishin lëkundur sadopak atë vetë lajmet që sillte, ato që kishte parë e dëgjuar. Në lëkurën e plasaritur të babait u thelluan vijat, iu errësua e iu shtrembërua fytyra. Selmani hapi sytë, pa dëmin që kishte bërë me të folurën e lehtë, u turbullua fort që tregoi për shpifjet e gënjeshttrat dhe lëvizi poshtë lart mustaqet e shpu-purishura.

Babait i shkrepnin sytë dhe tha:

— Kjo e gjitha s'mund të jetë kështu.

— S'është aspak, — tha Selmani.

— Atëherë?

Selmani tundi kokën si kali para tagjisë, u ngazëllye me sytë si të përlotur dhe tha:

— Populli e di se Partisë s'ka ç't'i bëjë asnjë rrethim. Veç të ulet pak kjo dëborë që s'mbahet mend një brez njeriu.

Ata ndenjën në heshtje dhe Selmani mendoi edhe një herë për sa kishte parë në pesë ditët e shkuara. Po kënaqej, se fjalët që tha përputheshin në çdo pikë me atë që kishte ndodhur e po ndodhte në Markesh. Po prapë diçka mbetej pa thënë, që kishte të bënte me thelbin e mendimit, me atë të fshehtë që e ndien njeriun dhe që e ka të vështirë ta kthejë në fjalë, sepse ajo ndodhet gjithkund dhe në asnjë vend. Si hëngri drekë, Selmani foli prapë, duke zgjedhur fjalët, duke pyetur veten aty-këtu:

Armiku që dogji të katër lagjet deri në rrënjë, e kishte humbur luftën. Këtë s'e kishte thënë me fjalë të tilla asnjë shpallje, po kjo tashmë dihej nga të gjithë, edhe prej atyre që i shërbenin armikut, qe njoftuar kudo, nëpër rrugët e panjohura të zjarrit dhe hirit. Ky armik s'kishte ç'të bënte më tepër, pasi e përdori tërë fuqinë e vet pa arritur asgjë. Toka dhe njerëzit mbetën. Tani armiku do të thyhej e do të humbiste përfundimisht. Koha e tij kaloi. Kjo ide, e sajuar në shpirtin e fshatarit, pasqyrohej edhe në fytyrën që i tregonte armikut, një fytyrë e palëvizshme, e panështruar, duke i thënë në heshtje se ndërmjet tyre qëndronte vdekja, duke shikuar ky fshatar përtej kokës së armikut. Disa njerëz kishin filluar të ktheheshin në lagjet, sillëshin rreth shtëpive të djegura të habitur me ndryshimet e thella të kryera prej zjarrit. Ndonjë grua ose ndonjë plak prekte muret, trarët e djegur, i fliste një

vegje të thyer, një tenxhereje të shtypur, duke i pëshpëritur si një miku që e ka pësuar keq. Dikur këto sende kishin qenë tepër të çmuara, mbaheshin në krye të shtëpisë, po tani nuk vlenin më. Megjithatë, njeriu e vërtiste sendin në duar me shpresë se diçka mund të nxirrej prej tij dhe e vinte mënjanë. Po mbi çdo ndjenjë tjetër të humbjes e shkatërrimit, sundonte uria. Burrat dhe gratë e Markeshit po shkonin për bukë në fshatrat e largëta. Kësaj here s'mbanin asgjë në kurriz, s'kishin gjë për të shitur, ecnin shpejt e lehtë. Markeshasi kërkon bukë, që do ta lajë në vjeshtë. Po me çfarë do ta lajë? Këtë ai nuk e di, bagëtia është dëmtuar rëndë, shtëpia është djegur. Po burri s'e humb shpresën dhe markeshasi s'e ha fjalën, veç t'i jepet tani një thes drithë, se po i fiken pleqtë e kalamajtë në shpellën e dreqit.

Babai e kishte dëgjuar deri në fund, duke dashur të kuptonte për cilat gjërat heshte Selmani dhe cilat shpikte për t'i bërë qejfin. Selmaçi kishte thënë tërë të vërtetën, me të mirat e të këqijat. Kuptohej nga zëri i tij, nga fytyra dhe nga sytë e përlotur. Gënjeshtër kalonte mbi popullin si era në pyll. Sa për Selmanin babai zuri të qortonte veten, se në shpirtin e këtij s'kishte kaluar kurrë dhe për asnjë çast dyshimi.

— Është koha më e keqe për popullin. Tani duhet t'i vihemi punës më fort, — tha babai.

— Në punë e sipër jemi, o babë. Veç të shërohesh, veç të ulet pak kjo dëborë e madhe, — tha Selmani, me zërin e butë, ledhatues.

III

«Çfarë i keni dhënë për të ngrënë. Mish? T'i jepni presh dhe gjizë. Mjaft ka ngrënë mish në teqe.»

Ky ishte Galip Nuri, që ecte me hap të gjatë në ha-

jatin me dërrasë dhe njerëzit bridhnin pas tij duke qeshur. Zëri afrohej si bubullimë:

«Çfarë?... Raki babait?... Asnjë pikë. Të pijë ujë deri në fund të jetës, që të lajë një pjesë të rakisë.»

Ai po vinte që nga stanet e Merqanit, ku vërtitej me një pjesë të kompanisë. Kishte sjellë një radio me bateri, kafe dhe sheqer.

— Si bën për t'i gjetur këto? — e pyeti babai me habi të vërtetë.

Galipi ngrohte duart në zjarr, dukej sikur avullon; te trupi i tij i madh, në ballë iu mbloodhën rrudhat:

— Kur dua të gjej një cjad të humbur, rri e mendoj si cjad, pastaj çohem dhe ecë me të njëjtën mendje të cjadit, në rrugët e në shtigjet ku mund të ecë ai. Ja, kështu. — Qeshi me vete, se ditë më parë ashtu i kishte ndodhur vërtet, jo me radion, po me cjadin. Po u sillej staneve të braktisura, me dëborën e ngrirë, duke parë degët e pishave. Asgjë s'mund të gjeje aty për të ngrënë. Befas pa rrëzë pyllit gjurmët e dhive që mbaronin po aty. Më poshtë ishte rrëpira, shkëmbi. Dukej sikur dhitë të ishin sjellë rreth vetes dhe të qenë zhdukur nën tokë. Ndenji të mendohej dhe lodhja e ditëve e netëve të bredhjes në pyje, sikur i kullonte nga brenda, i jepte qetësi. I dukej se erdhi fundi. S'kishte më shpresë. Po tamam pse i dukej ashtu, nuk ishte e mundur të mos dilte diçka. Priti një orë me njëren nga skuadrat, i pazoti të lëvizte më tej. Dhe dëgjoi blegërimën. Fshatari me fëmijët e me dhitë rrinte poshtë, në shpellë. I nënshkroi një dëftesë për peshën dhe vleftën që do të paguhej pas luftës dhe mori cjadin.

Baba Merxhani mbante dorën mbi kutinë e radios dhe rrinte heshtur. Vetëm Galip Nuri mund të kishte menduar një dhuratë të tillë, një radio në Ofshan, në dhomën e një njeriu të mbyllur e të rrethuar prej dë-

borës e armikut dhe të cilit i rëndohet fryma në gjoks, «digjet i tëri», po të mos marrë lajme.

— Kësaj here paske menduar me mendjen e radios, — tha babai.

— Ç'të bëja? Ti nuk më beson. Dëgjo vetë atëherë, — tha Galipi.

— E ke bërë me kohë veten të mos të besojnë, — qeshi babai.

Një copë herë radioja bëri zhurmë, foli e këndoi në gjuhë të ndryshme. Galipi i rrinte sipër me trupin e madh, mallkonte, dëshpërohej si për një krijesë të tijën që kishte harruar gjuhën dhe ia rrotullonte burmat pa pushim, që të rreshtej, të kujtohej. Pas darke, kur zjarri në vatër kishte bërë një prush të madh dhe llamba ndriste dhomën fort, kur ata po pinin kafe, radioja foli shqip, zuri të jepte lajmet Tirana. Profili i Galipit, si i një shpendi rrëmbyes, që i rrinte sipër xhamit të ndezur, u çel e mori flakë. Ktheu sytë e shpejtë dhe tha:

— Dëgjo.

Foli një grua me zë të mekur, të largët: «lajmet nga balli i Lindjes», pastaj nga «balli i Perëndimit», më pas «lajme nga vendi», «suksese të operacionit gjermano-nacionalist», «një deklaratë e një komunisti të dorëzuar, të penduar, që gjen rrugën e vërtetë». Brenda kutisë së ndezur ishte çuar përgjysmë dhe fliste nepërka, sikur një nepërkë të mund të të fliste fjalë. Heraherës dukej sikur kërkonte ndihmë me atë zërin e largët të mekur, sikur t'i kishin futur një gjilpërë në zemër dhe ajo u bënte motrave nepërka një thirrje të fundit për ndihmë, duke folur në gjuhën e njeriut.

Babai zuri të merrte frymë rrallë e rëndë, i tërhequr nën hijen e oxhakut. U kujtua se po mbante filxhanin në dorë dhe e uli në vatër. Selmani tundi kokën, ngriti sytë mbi Galipin dhe i tha:

— Pthu, të marrtë dreqi! Na solle gjë të bukur. Si nuk e bëre kurrë një punë me mend!

Galipi ia plasi gazit, si djall. Me të qeshurit e tij të fortë detyronte edhe të tjerët të qeshnin, ose njeriu s'dinte ç'të bënte.

— S'ka gjë. Marrim vesh, — tha babai. — Sido që të përdridhet, ajo s'mund t'i fshehë frontet, as luftën tonë.

Ata ranë për të fjetur, se Galipi do të ikte para agimit, në pyjet e Merqanit. Do të ikte ashtu siç erdhi. Tërë pyjet dhe katundet ishin pronë e tij, ish-sekretar i teqesë dhe tani komandant kompanie në batalionin e Markeshit. Batalioni do të mblidhej pas një jave në Bal dhe atëherë do të shiheshin humbjet, mungesat.

• • •

Në mëngjes, kur djemtë dhe burrat hapnin dëborën për të shkuar te «burgjet» e bagëtisë, Lumja, nusja e re e Seferit, pastronte enët, i fërkonte me hi derisa të ndrisnin, i vinte në radhë dhe kënaqej duke i parë. Nën rrobat e trasha lëvizte trupi i saj i gjatë e i bukur, sikur s'kishte punë me rrobat që mbante. Ish-te shtatëmbëdhjetë vjeçe dhe duhej të fërkonte enë pa pushim që të shtypte atë dëshirën për të shkuar partizane. Nabija i vinte dorën te tëmthat, te flokët e verdhë, për ta qetësuar. Atëherë Lumja lëshonte një thirrje të mbytur, një klithmë gëzimi.

— Atë ditë kur erdhën gjermanët, më iku mendja për ju, — tha. — Nuk di se ç'kam bërë. Qava edhe natën. Po ju mos kini gajle. Është lidhur Ofshani me besë. Edhe fëmijët t'i therin, askush nuk tregon.

Fshati Ofshan, të tri lagjet, hapnin dëborën, për të shkuar në mulli, për të dalë në pyll për dushk, shkundnin çatitë. Hej, s'mbahet mend e tillë dëborë.

Mbytet njeriu në të. Të kap në grykë. Kur çeli moti, ata erdhën prapë, gjermanë e mercenarë. Prapë therën dy dhi vëllezërit e Ademit. Fshati Ofshan s'kishte asgjë për të thënë, s'kishte parë asgjë, s'kishte kaluar asnjëri. Ky ishte një fshat i kredhur në dëborë e në varfëri. Shiko e kalo.

Baba Merxhani pi duhan i kërrusur. Para tij rri në gjunjë Naimja, gjashtë vjeçe, fshin hundën me pëllëmbë dhe qesh, me sytë dinakë.

I thotë babai vajzës:

— Pra ti nuk ditke se ne jemi partizanë.

Vajza mendohet, ngre flokët me një lëvizje të shpejtë të dorës dhe del në dritë fytyra e saj e plasaritur prej erës dhe dëborës.

— Te ne nuk rri askush, — përgjigjet me seriozitet. Hap sytë e shkruar ku lëviz drita. Qesh me dhëmbët si rruaza, përpjek buzët. — Ncuk, ncuk.

— Po qysh s'paske parë e dëgjuar asgjë? — i thotë babai, duke ndërruar zërin, siç bëhet me fëmijën kur do t'i nxjerrësh fjalën.

— Ato që dëgjoj unë i djeg zjarri, — thotë vajza, duke fshirë pëllëmbët me forcë drejt zjarrit, për të treguar se çdo gjë e parë dhe e dëgjuar është zhdukur.

Ka ditë të gënjeshtërtë kur duket sikur vjen pranvera. Aty-këtu shkundet dëborë, përhapet si pluhur dhe ikën me flladin. Po nga dritarja duket kumbulla e ngrirë në akull, si një lule e madhe kristali e rritur gjatë natës. Kur dielli bie mbi të, zverdhin kërcëjtë e degëve, sikur po digjet akulli nga brenda. Babai fërkon këmbët, që të mpijë dhimbjen. Çohet e sillet rrotull dhomës, duke u mbajtur në muret, i merrren mendtë e i bien djersë, i duket sikur po i këputen damarët në pulpat dhe bie në gjunjë si i shkurtuar. Ka ditë pa asnjë lajm dhe ai rri mbështetur pas murit, si në një dremitje që asgjëson kufijtë e kohës. Pa-

staj vjen befas lajmi se në jug, në kulmin e operacionit, janë krijuar dy brigada të reja, të plota, një-mijëvetëshe, të forta. Babai rri me bërrylat mbi gju-një, qan nga brenda prej gëzimit, kthen mënjane sytë e njomur dhe mban vesh hapin e brigadave, dëgjon krismën e fuqishme të armëve të tyre, anije lufte që çajnë përmes dallgëve të dëborës. Atëherë zë e këndon nën zë këngën e shehut që u vra në luftë me shtatë çunat.

* * *

Cipa e bardhë që mbulonte tokën po lagështohet. Kumbulla te dritarja po lirohet prej akullit, djersinte lëkurra e saj ngjyrë vishnje, degët e njoma tundeshin lehtas prej erës së ngrohtë që erdhi nga jugu. Korrierët që vinin gati çdo ditë te babai, sillnin lajme për grupet e partizanëve që po shkonin drejt Balit. Disa prej tyre paskëshin qenë aty rrotull dhe ai habitej që gjatë njëzet ditëve s'kishte ditur gjë për ta. Po babai u habit e u gëzua edhe më fort, u ngrit më këmbë kur zbuloi se «shkrimtari», mik i veti dhe anëtar i Këshillit të Përgjithshëm Nacionalshkrimtar, mbodhej brenda në Ofshan, në një shtëpi të vogël në fund të fshatit.

«Shkrimtari» ishte veshur tebdil, me rroba shajaku të kuqërreme, mbante shkop e qylaf, ecte e fliste sipas veshjes që kishte përvetësuar, qe shndërruar aq sa të mos e njihte i ati, nga e kaluara i kishin mbe-tur vetëm sytë, që asnjëherë s'ka ç't'u bëjë njeriu. Baba Merxhani ia plasi gazit, e puthi, ia preku supet, e mbajti nga krahët, që të bindej se miku ishte i tëri.

Më vonë si hëngrën kaçamakun me djathë sipër, që e gatoi me bujari e zonja e shtëpisë, «shkrimtarit» iu kthye gjallëria, qeshte si një çunak i lëshuar në liva-

dhe, ecte poshtë e lart dhomës duke treguar ngjarje dhe nën peshën e tij të lehtë u thyen dërrasat e qepenit. «Shkrimtari» ra në bodrumin e cekët, nxori kokën mbi dysheme dhe pyeti:

— Pse unë?

— Po kush? — pyeti Nabija.

— Të kishte rënë baba Merxhani. Për të mbahej qepeni.

— Ehe, nuk shkel në dërrasë të kalbur unë, — tha babai.

Ia plasën gazit të gjithë, ndërsa i zoti i shtëpisë po ndihte «shkrimtarin» të dilte, fshinte lotët, tundte gishtin para fytyrës së vet dhe thoshte «eh, jo, or mik, or shok, baba Merxhani nuk shkel në dërrasë të kalbur».

IV

Hysen Gjata, kryetar i këshillit të lagjes «Denë», ecte nëpër dushk, po shkonte në shtëpi pak më herët, përditë më herët. Nuk kujdesej më të fshihte gjurmët e veta nëpër dëborën e hollë dhe pushkën e mbante në sup. Mendonte me ëndje se në mbrëmje, kur të mblidhej këshilli, do të padiste «dezertorët», do të niste «organizimi», sipas letrës së fundit të baba Merxhanit. Pak më tej Hyseni zuri të mendonte më mirë për njerëzit. Ishte pesëdhjetë e pesë vjeç e me një vatrë fëmijë, në moshën e në gjendjen kur burri mendon më qetë për bashkëfshatarët, aq më tepër kur mbi ta ka pllakosur një fatkeqësi e madhe, kanë humbur gjënë e shtëpisë, rrinë në shpella e kasolle, të uritur. Ç'kishte bërë ai vetë si kryetar këshilli që i jepte të drejtë të gzykonte njerëzit? A nuk po rrinte më fort duke u fshehur?

Po ftohej moti dhe dëborë e hollë, e lagësht, forco-

hej, kërciste nën këmbë. Kalonin re në një qiell me dritë. Hyseni pa nxitimin e reve duke i përcjellë me sy. «Ne rrimë fshehur e të shpërndarë, po në të vërtetë përparojmë. Kurse armiku duket se përparon, po ai tërhiqet», — tha me vete, me zemrën të lehtësuar. Më tej zuri të mendonte prapë për muajin e rëndë, për ditët kur rrinte fshehur në pyll. Hidhërimi e mundimi i gjatë i kishte prishur gjakun. Nganjëherë kishte dashur të gjente armikun te shtëpia dhe të merrte fund fshehja, ta shihnin njerëzit flakën e pushkës së tij.

Hyseni u ndal te Bregu i Thatë, prej nga shihej çatia e hirtë e shtëpisë së vet me dy kthina. Ajo shtëpi e vetmuar rrëzë Kreshtës, një orë larg fshatit, i shpëtoi syrit të armikut në ditët e zjarrit. Nuk e dogjën as më pas, kur patrullat vinin deri lart. «Mirë që shpëtoi, se do t'u shërbejë luftës dhe këshillit», — i thoshte vetes Hyseni. Po më pas shtëpia i qe dukur përherë e më e errët, si një mall i vjedhur. «Ti edhe mund të flasësh, o shoku kryetar, se shtëpinë e ke, rrinë ngrohtë kalamanët», — i kishte thënë ditë më parë Avdi Bala. I ati, Bala plak, kishte shtrembëruar mjekrën, ia veshi me shkop kurrizit të birit. Avdiut: «Shih punën tënde, qen bir qeni.» Avdiu i kishte qeshur të atit në fytyrë pa luajtur vendit. Sa më tepër kalonin ditët, aq më shumë i qe rënduar ajo shtëpi në shpirt Hysenit. I dukej sikur armiku po e linte enkas pa e djegur, për ta veçuar nga fshati e si për të thënë se ai, Hysen Gjata dhe armiku, e kishin një lidhje të pafolë. Dy ditë më parë Hyseni kishte dashur t'ia vinte vetë zjarrin shtëpisë, fshehtas, të merrte fund mundimi, të dilte ballëhapët në njerëzit.

Ai zbriti në përrua dhe piu ujë me grykën të tharë. Kur u ngjit në anën tjetër, pa të dilte tym prej çatisë, një vijë tymi që ndërronte ngjyrë. Kjo e habiti, sepse zjarr ditën nuk ndiznin asnjëherë. Kur u

ngjit pak më lart, pa njerëz me pushkë te dera e shtëpisë. Pastaj iu bë se dëgjoji trazirë lart në pyll. Prej andej po zbriste një varg i gjatë me njerëz. «Paska ardhur batalioni», — mendoj i mbërthyer në vend e duke mbajtur frymën. Pastaj u kujtua se batalioni i mbledhur në Bal qe nisur me ngut për një aksion përtej Latit. Ky mund të ishte një batalion tjetër. Ose armiku.

* * *

Komandanti i batalionit, Zambaku, pa gëzimin, po edhe druajtjen në fytyrat e njerëzve të shtëpisë. «Hija ime, — tha me vete. — Kjo hije mbart një karakter të paepur dhe drejtohet nga një mendje e shpejtë dhe e rëndë.» Kur vërente te njerëzit hutimin dhe druajtjen që shkaktonte prania e tij, ndiente një kënaqësi që i përhapej në trup si një lëng i nxehtë. Po kjo gjë kurrsesi nuk duhej të shfaqej. Fytyra e tij duhet të mbetej kurdoherë e palexueshme. Në këtë qëndronte më tepër forca e tij nënshtruese. Si edhe te trupi i bukur, tek armatimi dhe sidomos te fjala e shkurtër, e qartë: «të pushkatohet, të falet», te sulmi i befasishtëm që i bënte mendjes së viktimës, duke e trullësuar krejt. Asnjëri s'mund të parashihte lëvizjen tjetër të komandantit. Ky ishte çasti kur në damarët i qarkullonte më fort ai lëngu i nxehtë. Ky karakter i tij i sajuar që në fëmijëri, po shfaqej sheshit në kohën e luftës e të shtrëngimit, koha kur shfaqet kushdo. Zambaku po rrinte në mesin e dhomës, qëndronte fort mbi këmbët, me kokën pak të përkulur mbi fytyrën e të zotit të shtëpisë, duke e parë ngultas, sikur do t'i caktonte çmimin, ose masën e shërbimit që mund të kryen-

te, i bindur që më parë se gjëra krejt pa rëndësi mund të priteshin prej këtij fshatari.

Megjithëse rrallë kalonin miq nga shtëpia e tij rrëzë Kreshtës, Hysen Gjata kishte njohur shumë njerëz. Po një komandant të tillë s'e kishte parë kurrë. Hyseni kishte dashur të puthej me të, po që ndalur në lëvizje e sipër nga ndjesia e çuditshme se ky mund të të puthte, ose të të vriste. Po më shumë të vriste, se, për të puthur, këtë mund ta bënte vetëm për veten. Këtij duhej t'i bindeshe në heshtje dhe të gjeje vetë se çfarë i pëlqente dhe çfarë nuk i pëlqente. Nën shikimin e komandantit Hyseni zuri të mendonte edhe vetë se ishte i vogël, i pazoti, i pafuqi. Asnjëherë s'kishte menduar kështu për veten dhe shikoi rrotull i hutuar.

— Shokët duhet të hanë, të thajnë rrobat, të flenë,
— tha Zambaku.

Hyseni i nxori fëmijët në kasollen e dhive, kurse vetë me gruan ndenji me Zambakun dhe nja dy të tjerë. Dhoma përballë u mbush me partizanë, kurse pjesa e madhe e batalionit ndenji jashtë, ndezën zjarrë, për të pjekur ose zier pesë dhitë që u dha Hyseni. Ai bëri më tepër zjarr në vatër dhe u ngroh e ndriçoi dhoma, në mbrëmjen që afrohej. Donte të dukej i gëzuar karshi miqve dhe gruas së vet, po i thahej buzëqeshja e i mbetej fjala në gojë tek shihte Zambakun. Hyseni mendonte me pikëllim se ndofta komandanti e merrte për bashkëpunëtor të armikut, për shkak të shtëpisë së padjegur dhe të dhive në kasolle. Hapi gojën përgjysmë t'i thoshte këtij komandanti se kush ishte, po ndeshi në shikimin dyshues e të ftohtë të syve të kaltër dhe heshti. Dy shokët e tjerë, që duhej të ishin anëtarë të shtabit të batalionit, thanin teshat e dremisnin anës zjarrit. Njëri tundi kokën, nënqeshi fshehtas, i shkeli syrin shokut, duke i treguar Zamba-

kun. Tjetri ktheu kurrizin dhe pas pak tha diçka nëpër gjumë.

Komandant Zambaku po shkruante me çantën te gjuri e si duke kafshuar gjuhën. Batalioni që endur në luftë e në dëborë, si në një pyll me mjegull, pa dalje në asnjë anë. Batalioni kishte luftuar edhe në rrethime, që ushqyer pa ushqim. Njerëzit ishin nxirë, egërsuar e rraskapitur. Po batalionit i printe shpërirti i vet heroik. Asnjë mal me dëborë, asnjë rrethim s'mund ta ndalte batalionin, që linte prapa vragët e gjakut të vet, duke çarë në drejtimet më të papritura. Këto po shkruante Zambaku në raportin që do të bënte në dy kopje, njërën për qarkorin dhe tjetrën për Shtabin e Përgjithshëm. Këto episode kishin ngjarë vërtet, po jo me batalionin në tërësi dhe as me komandant Zambakun në krye. Batalioni që shpërndarë në grupe dhe secili grup i kishte bërë ballë luftës si kishte mundur, kurse Zambaku që në tre muajt e fundit kishte qenë edhe komandant edhe komisar i batalionit, që fshehur aty ku nuk do ta kërkonte kush, te bejlerët e vegjël të Çernikës. Tek shkruante ashtu si ia kishte ënda, Zambaku mendonte se askush nuk do të merrej me «hollësitrat» e dy muajve të kaluar. Mjafton që batalioni tani ishte i plotë dhe po çante rrugën drejt Pezës ku e kishin thirrur. Balli i Zambakut zë e lirohet, kalon gjuhën në nofullën tjetër, shikon zjarrin në vatër sikur kërkon aty diçka me ngulm. «Fiton gjithnjë ai që ka një ide të caktuar në kohën e duhur», — thotë me vete dhe këtë e ndien aq fort, sa lëviz buzët, sikur t'ia shqiptonte këto një krijese përtej flakëve të zjarrit. Ideja kyçe e mbyllur tani në mendjen e tij ishte kjo: të bënte sikur batalioni po vijonte edhe aty e prapa të kalonte në një tokë armike, me prita e rreziqe, duke i thyer këto «batalioni me shpirtin e tij heroik». Fjalët e nënvizuara do ta detyronin lexuesin

e raportit të mendonte se çdo shpirt e ka një trup dhe çdo trup ka një tru. Pra batalioni kalon në zona të reaksionit, e ndëshkon këtë reaksion, pushkaton tradhtarët dhe lë pas vetes një tokë të qetë e të shtruar, në një kohë kur shumëkush e ka humbur mendjen. Këtë mund ta bënte vetëm një batalion i drejtuar prej njeriut me karakter të paepur, me shikim prej komandanti. Fjalët e fundit s'mund të shkruhen, po duhen nënkuptuar. Po a do t'i nënkuptojnë vallë në Shtabin e Përgjithshëm, në Komitetin Qendror? Zambaku shtrëngon grushtet, mjekra i mbërthehet. Për një kohë tepër të gjatë e kanë lënë komandant batalioni, ndërsa krijohen njëra pas tjetrës brigadat.

— Shoku komandant! — i tha Hysen Gjata. Ai s'mund të rrinte më gjatë pa folur. — Duhet të dish si është puna. Armiku me qendër në Ndërfushë ka forcat e veta në Gjin, prej nga shikon lëvizjet përgjatë lumit. Diku dërgojnë patrulla edhe në Qytezë.

Në dhomën si ahur lëvizën dritat e pishës sillej tym. Veç trupi i Zambakut mbeti i palëvizur. Fytyra e tij e verdhë u duk e zbardhur.

— Pse nuk fole më parë? — tha.

— Ti as që pyete, nuk deshe vetë të flisje.

— Unë të lidh.

— S'ke si më lidh në shtëpinë time. Nuk lidhet krytari i këshillit.

Pas mesit të natës batalioni u vu në rrugën përgjatë lumit Dron. Hyseni ecte përpara dhe nënqeshte me hidhërim. Ishte si një i arrestuar me pushkë në sup, sepse, ndërsa i hiqte rrugën batalionit, pararoja ruante lëvizjet e tij me dyshim. Ai zuri të qetësonte veten, duke ecur në errësirë të plotë në udhëzën e njohur. Sa ta çonte Zambakun te Shkallët e Balit, pastaj do të mendohej për të. Veç të mos i diktonin nga ana e Gjinit. Por që andej erdhën plumbat e një mitralozi të

rëndë që vijosën errësirën me të kuq. Krismat jehuan të mbytura e kërcënuese. Hyseni dyshoi për ndonjë pritë tek ura dhe i tha komandantit të kompanisë se ishte më mirë të ngjiteshin lart në Qytezë. Kaloi njëfarë kohe derisa komandanti i kompanisë të merrej vesh me Zambakun, kurse mitralozi nga Gjini shtinte si një njeri që shikon në të errët dhe krahas tij filluan të shtinin edhe disa pushkë.

Batalioni u ngjit lart, nëpër shtigjet që dinte Hyseni, kaloi anash lagjes «Denë» dhe hyri në udhëzën që çonte në Qytezë. Hyseni po ecte i lehtësuar, mendonte se zgjodhi rrugën e duhur, kur dëgjoi se qenkësh vrarë një partizan. Hyseni u habit e u pikëllua. Në luftë ngjasin çudira. As që i shkonte ndër mend se mund të ishte vrarë dikush nga të shtënat e largëta e të verbra prej Gjinit. Hysenit po i dukej sikur ky partizan të ishte vrarë në duart e veta e në shtëpinë e vet.

Açimi i turbullt e gjeti batalionin ndanë Qytezës. Po shquheshin shtëpitë e djegura, muret e rrënuara, ndër të cilat secili fshatar që përpiqej të ngrinte një strehë. Befas që nga sheshi «Belik» u shkrehën disa pushkë, të shpërndara, njerëz që shtinin sa për të shtë-në. Kompania e pararojës u përgjigj me zjarr të fortë. Ata në sheshin «Belik» duhej të ishin ndonjë patrolle armike, se nuk u ndien më, humbën si trumcakët në erë.

— Kushedi kush shtiu, — tha Hyseni.

Pak më lart kishte qëndruar Zambaku, duke parë Qytezën. Vjen një çast kur duhet të hapësh lojën, për shkak të një rrethane të papritur. Po ky është fati, rruga drejt fuqisë. Dëshira për të arritur fuqinë që djegur brenda tij si një zjarr i përjetshëm në rritje, që duhej fshehur në çdo rrethanë. Kjo është e gjitha. Të mbash mbuluar një zjarr të madh të tmerrshëm deri në ditën e arritjes. Atëherë do të vijë shpërthimi i lirë,

hakmarrja e plotë për muajt, vitet e gjata të durimit, një hakmarrje me shkëlqim të madh, të përqendruar, për të cilën e vlen të jetosh duke rrezikuar. Këto po mendonte ai. Lagjen «Qytezë» e kishte në dorë, si edhe shkakun për ta ndëshkuar. Do të vinte mbi lagjen vulën e vet, duke jehuar ndëshkimi larg, duke u bërë një nga shkallët e ngjitjes. Aq më mirë që kjo po niste në Markeshin e baba Merxhanit, komandant i Shtabit të qarkut.

— Do të ketë qenë ndonjë patrullë, — tha prapë Hyseni, me shpresë të dëgjonte Zambaku e duke kërkuar me ngut me mendje të thoshte diçka tjetër për të mënjeluar hatanë që dukej se do të binte mbi Qytezën e djegur dy herë.

— Të vijnë komandantët e kompanive, — tha Zambaku. — Edhe italianit të vijë.

Kur erdhën ata, Zambaku eci disa hapa poshtë lart dhe foli me duart prapa, thirri që të dëgjohej edhe më tej.

— Të rrethohet kjo çerdhe e armikut. Të pushkatohet në vend çdo njeri që gjendet me armë në dorë. Të merret dhjetëfish gjaku i shokut tonë. — Si tha këto, i bëri shenjë italianit, i cili i ra borisë me thirrjet e mpërhta të alarmit dhe sulmit.

— Shoku komandant! — thirri Hysen Gjata.

— Të lidhet ky gjoja kryetar këshilli, — urdhëroi Zambaku.

E çarmatosën dhe e lidhën Hysenin, që nuk kundërshtoi, duke i ndihur ta lidhnin, duke i thënë vetes se tani do ta priste me kënaqësi edhe pushkatimin. Komandanti i kompanisë zbriti poshtë, duke u penguar nëpër gurë, sikur t'i kishte hyrë bleta në kokë. I tërë batalioni u hap në brigje, nga Shkëmbi i Plakës deri tek Ahuri i Jevgut dhe ecën përpara me armët në duar, ndërsa po hapej drita e ftohtë e agimit. Që nga stre-

hët e tyre dolën disa fshatarë, të habitur e të gëzuar. Ditët e fundit kishte ngjarë që në mëngjes të kalonte një kompani partizane dhe në drekë të piqte mishra një tabor i armikut. Në trazirën e ditëve të tilla çdo gjë mund të ndodhte. Fshatarët shihnin yjet e kuqe të atyre që po hynin në fshat duke i rënë borisë dhe donin t'u flisnin, t'i nderonin me grusht. Po këta qenkëshin ca partizanë të egërsuar fort, që thërrisnin urdhra, të gatshëm të shtinin po të mos bindeshe, dhe fshatarët mbetën të hutuar në rrugë, ose para strehëve me gurë që kishin ngritur, ndërsa partizanët po çonin drejt sheshit «Belik» bashkëfshatarët e gjetur me armë. Më tej kërciste pushka. «Prit, ky fshatar këtu s'di gjë.» «Vazhdo, urdhër i komandantit. Këta na pritën me pushkë, vranë shokun Astrit.» «Vazhdo të them.» «Ah, ky i poshtri paska qenë edhe partizan dhe tani na del mercenar, zjarr!» Po më tej tre partizanë ngrenë armët me duar të dredhura, me mjegullën në sy, me një pyetje që të ndrydh zemrën e nuk do të shpjegohet kurrë: deri ku është armik ky fshatari tjetër? Dhe është sadopak armik? Në një gjysmë ore u pushkatuan në Qytezë njëmbëdhjetë fshatarë, nga të cilët vetëm katër kishin qenë në shërbim të armikut, qenë armatosur prej tij. Një valë e gjatë habie dhe turpi ra mbi Markeshin.

* * *

Në lëndinat e vogla përtej shkallëve të Balit, fshatarët dhe këshilli kishin dalë të prisnin batalionin, duke sjellë bukën, djathin dhe mishrat që mundën të mbli-dhnin. Kishin pritur batalionin e tyre, po, ani, edhe ky batalion i tyre ishte. Mund të merrnin frymë, të gëzoheshin e të këndonin me këtë batalion, pas një lëngimi të pashembullt që kishte zgjatur dy muaj, gja-

të të cilëve secili e pa vdekjen me sy me gjithë fëmijët, për shkak të armikut, dëborës dhe urisë. Po erdhi lajmi për njëmbëdhjetë pushkatimet në Qytezë dhe fshatarët u tronditën fort, ndenjën të veçuar duke biseduar në grupe.

Komandant Zambaku kaloi para fshatarëve të Balit, duke shikuar nga afër fytyrat e tyre të zvogëluara e të kyçura, një pjesë të armatosur. Nga ana e tyre fshatarët po shihnin se ky komandant i habitshëm, i pashëm e mustaqeverdhë, me fytyrën e bardhë si të ngrirë, me sytë e kaltër depërtues, që kishte pushkatuar lagjen «Qytezë» me dy fjalë të vetme, ky komandant, pra, i lodhur e i zemëruar thellë, por i fortë shkëmb, do të mbaronte punë edhe me ta shpejt e saktë, siç bëhet me një turmë të paditur frikacakësh. Po, ndërsa ecte poshtë lart para tyre, fshatarët zunë të ndienin se ky komandant mund të ishte vetë frikacak, i shembur nga brenda, duke e mbuluar këtë me pushkatime, me fjalë e me sjellje që s'ishin parë e dëgjuar. Fshatarët po turpëroheshin për këtë komandant dhe zunë të inatoseshin nga ana e tyre, po edhe duke menduar se një njeri në gjendjen e tij mund të bëhej tepër i rrezikshëm, duke pasur ai edhe fuqinë në dorë, fuqi që s'mund ta kundërshtonin në asnjë mënyrë, çfarëdo që të bënte, për shkak të Partisë, të yjeve të kuqe, prandaj fshatarët rrinin aty pa lëvizur, zemërvrarë e mjaft të hutuar, se tjetër prisnin e tjetër doli.

Komandant Zambaku shkoi e ndenji buzë gurëve, prej nga mund të shihej Qyteza dhe krejt lugina e Markeshit, dhe ngriti dylbinë. Tri orë më parë kishte kaluar një nga çastet e rrezikut, buzë të cilit, sipas përfytyrimeve të tij, jetonte tërë kohën. Rreziku kishte qenë kur dha urdhrin për pushkatimet, se batalioni mund të mos bindej. Po ai kishte menduar se një batalion i rraskapitur nga mundimet, i egërsuar në

kulm me armikun dhe me shokun e vrrarë pabesisht, do t'i bindej urdhrit të hakmarrjes. Kështu kishte ngjarë dhe Zambaku rrinte duke menduar hapin tjetër, që do të ishte me të vërtetë i pashembullt në historinë e Luftës Nacionalçlirimtare, ngjarja më e rëndë në vargun e ngjarjeve dhe që do ta ngrinte figurën e tij në legjendë. U kthye në gjurmët e veta dhe qëndroi para fshatarëve:

— Pra, ti qenke kryetar i këshillit, — i tha një burri të moshuar, të gjatë e pak të kërrusur, me pamje serioze, por që edhe mund të qeshte në çastin tjetër.

Kryetari i këshillit e shikoi pa folur, pa i prapsur sytë. Zambaku nuk duronte mbi vete sy të ngulitur që nuk prapsen, qofshin këta edhe të një admiruesi.

— Kurse ti, i tha një tjetri, — na qenke si komandant i çetës territoriale. — E tërë fraza ishte e hidhur, po përçmimi ndihej sidomos në fjalët «komandant i çetës territoriale».

Komandanti i çetës, me fytyrën e kuqe e flokët e zbardhur, me trupin e paktë, ish-partizan, që kishte mbetur në fshat prej një viti për shkak të një plage që i sakatoi këmbën, gjithnjë e bënte veten fajtor. Tani filloi të ndihej si një këlysh që e di se ka bërë keq dhe që do të ndëshkohet. Në të vërtetë nuk dinte se ç'kishte bërë keq, veç që kishte ndenjtur ca kohë i fshehur në shpella. U hodh mbi këmbën e çalë, deshi të buzëqeshte dhe tha:

— Tani çetën e kemi gati, po mblidhen shokët.

Zambaku as që e dëgjo, shikonte turmën e fshatarëve, me mendjen gjeti.

Disa gjëra mbeten përjetë në shpirtin e njeriut, sipas prirjeve të tij, kohës dhe vendit ku i ka jetuar. Ai, Zambaku, ishte në vitin e tretë të shkollës teknike në Tiranë, kur bëri hartimin për veprën e Redjard Kiplingut, që u lexua nga profesori edhe në klasat e katër-

ta, duke pasur në krah në çdo lexim edhe autorin. Ishin ditët kur djalosh Zambakut i merrej fryma prej lumturisë...

...Bolla e madhe e pyllit kishte kërcyer befaz në rrethin e majmunëve. Bolla lëvizte ngadalë trupin e fuqishëm të ndritur, që shkëlqente edhe më tepër nën dritën e hënës, aty te sheshi i rrënojave të tempullit të vjetër, ndërsa majmunët rrinin në rreth, të paafte të bënin një lëvizje. Bolla vijonte të ngrihej lart, si një shtëllungë drite, sillej rreth vetes, zgjaste kokën për të parë majmunët me radhë, nga afër. Atëherë ata ngrinin e zvogëloheshin edhe më tepër. Sikur të ktheheshin e t'ia mbathnin drejt pyllit, të zhdukeshin në degët e drurëve, me atë shkathësinë e tyre prej majmuni, bolla e madhe do të mbetej aty në një gjendje qesharake. Po kjo nuk do të ngjiste, sepse magnetizmi që prodhonte trupi i saj kishte pushtuar mendjet e majmunëve, u kishte ngrirë gjakun krejt. Kjo ishte llogaria e qartë dhe e saktë e mendjes së gjarprit më të madh të pyllit, çasti sublim. Bolla mund t'i mbante majmunët përpjetë të ngrirë, sikur të donte të bënte një gjë të tillë...

Zambaku ngriti gishtin dhe u foli fshatarëve me zë të ulët, duke ditur se prapë do të dëgjohej larg, Tha:

— Kjo ishte vetëm një goditje e lehtë, — dhe bëri me kokë nga ana e Qytezës. — Kushdo që na pret rrugën e na vret pas shpine do të shfaroset. — U tha se lufta ishte sakrificë, po sidomos konspiracion. Fshatarët e dëgjonin në heshtje të thellë, pa kuptuar se ç'kërkohej prej tyre. Ndofta kërkohej që vetëm të rrinin pa lëvizur. U ndienë edhe më të fyer kur komandanti u tha të prisnin aty te lëndina, duke i lënë të mendonin për konspiracionin dhe fjalët e tjera të kërcënimit, asnjë fshatar nuk luajti vendit dhe as ngriti sytë të shihte fqinj, ndërsa komandanti hyri në ahurin e

rrënuar të Fetah Gjinit, pasi u bëri shenjë kryetarit të këshillit dhe komandantit të çetës t'i venin prapa. Ky i dyti mendoi se erdhi koha e ndëshkimit që për fat do të binte vetëm mbi të, pa u shtrirë mbi çetën. Gjithsesi, kjo ishte më e mirë se heshtja dhe përçmimi i komandantit dhe ndjeu një kënaqësi trupore, sikur do të fërkohej ndaj diçkaje të ngrohtë e të dashur.

Zambaku u ul në gurin e vatrës ku kishin ndezur zjarr për të dhe foli me zërin e rëndë depërtues:

— Do t'i biem shkurt. Kemi dy partizanë të plagosur prej ditësh dhe një të sëmurë, që i ngjitëm në krahë në shkallët e Balit. — U zbardh edhe më fort në fytyrë, u bë më i pakuptueshëm, ndërsa në sytë e akullt i digjej flaka. Do të shkruante një raport të dytë ku të thuhej se në kushtet e terrenit dhe të luftimeve më të ashpra, ai mori vendimin të pushkatohen tre partizanë që s'mund të mbarteshin më tej dhe që përhapnin panik. Kjo do të tregonte se në ç'pika rreziku të paparë kishte kaluar batalioni dhe masat e jash-tëzakonshme që ishin marrë për të siguruar këtë kalim. U gëlltit dhe tha: — Ata duhet të pushkatohen, janë bërë edhe grindavecë, ulin moralin.

Kryetari dhe komandanti i çetës po e shikonin gojëhapur, pa e kuptuar se kush duhej pushkatuar. Zambaku i shikoi ngultas dhe tha:

— Ka raste kur duhet prerë maja e gishtit për shpëtimin e krahut e të trupit, — dhe bëri shenjën e prerjes së majës së gishtit.

Kryetari kuptoi, po prapë iu mjegullua truri, dhe shihte Zambakun i shastisur krejt e duke dashur t'ia përsëriste fjalët. Zambaku e ndihmoi të kuptonte edhe më mirë, duke i tundur kokën. Atëherë kryetari s'pati më dyshim. Hodhi trupin lart dhe fërkoj mjekrën që i kishte shkuar shtrembër. Tej humnerës së shkallëve në lagjen «Qytezë», ishin pushkatuar njëmbëdhjetë fsha-

tarë për një partizan të vrarë. Dhe këta fshatarë as që hynin në atë punë, se partizani ishte vrarë nga mitra-lozi dhe pushkët e armikut në Gjin. Kurse tani komandanti linte porosi të pushkatoheshin tre partizanë të sëmurë. Kryetarit po i kalonin djersë të ftohta. Ky komandant duhej të ishte i çmendur. Edhe komandanti i çetës kishte kuptuar dhe rënkoi e u zvogëlua edhe më fort prej dhimbjes, hapi sytë e shtrëngoi duart, si për të ndaluar diçka të kobshme që mund të ngjante në çastin tjetër.

— Këtë do ta bëni ju të dy, sa të largohet batalioni. Tregohuni burra, revolucionarë, — tha komandant Zambaku. Ai ngutej, tërë kohën shikonte rrotull dhe donte të çohet.

Kryetari prapsi kokën, në sy i flakërinte një zemërim i thellë, po foli ngadalë sikur të bluante dhëmbët e tij.

— Këto nuk bëhen kurrë në tokën e Markeshit.

— Shokët e sëmurë i mbajmë ne, i shëndoshim. Na lini edhe të tjerë po të doni, — tha komandanti i çetës. I mbahej fryma dhe u çua në këmbë. U çua edhe kryetari dhe dukej se ata të dy do të dilnin. Zambaku u zbardh i tëri, po rrinte me shikimin në zbrazëtirë. Lart në Shtab mund të mos e pranonin pushkatimin e tre partizanëve si një heroizëm. Atëherë, në vend të lavdërimeve mund të vinte gjyqi, vënia pas murit. Ka rrethana kur një fjalë e ndan njërin nga tjetra. Po çuditej edhe vetë se sa lehtë e kishte menduar punën.

— Uluni, — u tha atyre të dyve. Çoi kokën dhe i pyeti: — Nuk jeni ulur ende?

Ata të dy vijuan të rrinin më këmbë. Kryetari tundi kokën si për të thënë se nuk do të uleshin më.

— Ne dimë se, në këtë luftë, për të shpëtuar shokun e plagosur, mund të lërë kokën një skuadër e tërë... kurse ju...

U çua edhe Zambaku dhe u ndenji përpara. Kryetari vijoi ta shihte pa luajtur qepallat, si i ngurrosur. Zambaku nënqeshi, krejt i zbardhur. Po mendohej nëse kishte pësuar një dështim, apo kishte hedhur një hendek. Gjithsesi, kishte kaluar buzë një humnere, marrëzisht, si në ëndërr. Përpoqi gjuhën në qiellzën e tharë, u gëlltit dhe tha:

— I mbani. Desha vetëm t'ju provoj mendjet. Veç po të bien në dorë të armikut dhe dekonspirohet batalioni, përgjigjeni me jetën tuaj. Në litar. — Mezi e përmbante vrerin, ndërsa shikonte edhe një herë ata të dy, si për të ngulitur përgjithnjë në kujtesë fytyrat e tyre. Kryetari i këshillit murmuriti diçka dhe doli. Doli edhe Zambaku, kurse komandanti i çetës me fytyrën e re ngjyrë tulle dhe me flokët më të bardhë se më parë, vijoi të rrinte me kokën mënjanë. Nuk e kishte më atë presën e thikës në zemër, i dukej se po i çohet të vjellët. Aty jashtë, në batalion, ishin tre shokët e shpëtuar, por ata prapë mbeteshin si të pushkatuar, si të mbështjellë me një hije turpi që nuk do t'u ndahej përjetë. Dhe i vetmi faj i tyre ishte se qenë të sëmurë, të plagosur.

Batalioni po largohej nga lugina e Balit e kredhur në dëborë, duke lënë aty tre partizanët që s'mund të ecnin më tej. Kryetari i këshillit dhe komandanti i çetës u vunë t'i shkruanin baba Merxhanit, duke e pyetur për shëndetin dhe duke i bërë të ditur për sa ndodhte në Markesh.

Në fillim të marsit Markeshi ishte i zhveshur nga dëbora deri rrëzë maleve, i larë prej shirave. Një dritë e fortë, e qartë dhe e tejdukshme sundonte mbi tokë, kurse në Kreshtën e Madhe endej një mjegull që krihej në pyllin me pisha.

— Erdhi pranvera, — tha Rahmani, që ecte përpara.

Nikolla mendoj se kjo ishte e vërtetë dhe zuri të merrte frymë thellë. Afrimi i pranverës dukej në gjallërinë e zogjve që kërkonin me sqep një ushqim çfarëdo, në lëvizjen e insekteve, në barin e druajtur, në ndryshimin e ngjyrave të tokës. Dëgjohej zhurma e ujërave, që zvogëlonin përditë rrëketë e dëborës në pllaja, kërciste ndonjë sëpatë në pyll. Nikolla ishte holluar në trup, rrobat i rrinin lirshëm, po ai mund t'i vinte shpejt në vend fuqitë e humbura. I dukej se nuk i mjaftonin vendi e hapësira, donte të ecte gjithnjë më tej, duke pasur përpara Rahmanin, që ecte me ato lëvizjet e rënda, gjithnjë i barabartë e i drejtë. Te shesht e Demit u ndalën që të dy, si të goditur nga pamja e lagjes «Bal».

— Punët do të nisin nga e para, — tha Rahmani.

Çdo ditë ndërtohej diçka. Aty ku më parë ishte një shtëpi, tani shihej një dhomë e mbuluar me dërrasa, me fier a lëndë tjetër. Secili ngrinte një strehë mbi kokë, rregullonte një gardh, ndërtonte «burgun» e bagëtisë. Nga kjo lëvizje e përgjithshme, ritmike, që kryhej në Markesh, po dilnin lagjet e reja të ngritura mbi themelet e vjetra, në një përpjekje të gëzueshme e nganjëherë qesharake për t'i ngjarë sa më tepër asaj që ishte. Dikush synonte edhe më tej, të ndreqte me këtë rast ndonjë gjë që kishte qenë shtrembër dhe e tepërt. Mendime të tilla as që do të kishin lindur pa

ndikimin e zjarrit. Mund të thoshe se zjarri kishte djegur edhe anën e zymtë të karakterit të markeshasve, sepse tani njerëzit ishin më të gatshëm për të nisur një bisedë e një këngë dhe, ndonëse një dimër i tërë pa bukë i kishte tharë më tepër, dukeshin edhe më të fortë, për t'u vënë nga e para në rrugën e jetës.

Kishte edhe diçka tjetër që krijonte një nxitim të përgjithshëm e në të njëjtën kohë një pritje të qetë: qenë mbledhur në Ndërfushë e në Gjin Mëdyshajt me fisin e tyre e me mercenarët dhe bënin pozicione, duke thënë se do t'i thyenin hundët kujtdo që do të kalonte lumin Dron. Pritej që batalioni të ngjitej aty me sulm, t'i digjte e t'i varte nëpër lisa, duke i dhënë fund ngatërresës së gjatë, mundimit që po hiqte Marke-shi prej tyre gati prej dyzet vjetësh.

Rahmani rrinte nën shkëmb, me mustaqet e verdha rreth gojës. Fytyra eshtake u duk e ngurtësuar. Brenda kokës së tij të madhe truri i qetë ishte vënë në lëvizje për të zbuluar e për të kthyer në fjalë diçka që e kërkonte prej kohe. Përtej shkatërrimit do të fillonte jeta. Dhe nuk do të nisinin punë të veçanta, po e tërë puna. Këtë po e mendonte me vështirësi, me djer-sën në ballë, sepse asnjëherë s'e kishte ndier të tillë. Lëvizi buzët dhe tha:

— Do të ndryshojë jeta... Erdhi koha e njeriut.

Këto ishin fjalë të rënda, që merrnin shpejtësi dhe depërtonin tej në të ardhmen, në zona të panjohura.

Nikolla e pa mikun me habi dhe filloi t'i rrihte zemra fort. I dukej sikur fytyra e Rahmanit me rru-dhat e thella qe bërë një me shkëmbin, një shkëmb që vuan e mendon dhe që po çelej ngadalë. Rahmani donte të thoshte se njeriu do të ecte mbi tokë me gjak të ndryshuar, me një mendje të re dhe në një kohë tjetër. Një ndryshim të tillë të njeriut mund ta mendonte vetëm një burrë si Rahmani, me atë diturinë pa gojë që

shpesh e trondiste thellë Nikollën. Një burrë si Rahmani nuk do t'i qe shtruar jetës kurrë, pa e gjetur të vërtetën. Tani e kishte gjetur dhe i gëzohej heshtur e ngadalë, me fuqinë e tij të madhe dhe nuk do t'i ndahej kurrë. Nikolla nuk guxonte të lëvizte dhe po priste me zemrën te gryka që Rahmani të fliste prapë. Dhe po të fliste do të bënte ndonjë pyetje për atë njeriun e përfytyruar prej tij, për të cilin Nikolla nuk dinte se ç'mund të thoshte. Ai vetë i gëzohej sa edhe jetës ndryshimit që do të vinte. Veçse nuk dinte si do të bëhej ndryshimi, ai që do të vinte më pas, kur të linin armët. Nuk dinte, nuk mund të shihte qartë lëvizjen e njerëzve, të sendeve, të tregonte hollësisht, ashtu si mund t'i kërkonte Rahmani, me atë kureshtjen dhe këmbënguljen prej fshatari. Po Rahmani s'bëri pyetje. I vuri dorën Nikollës në sup, e pa gjatë në sy me mallëngjim dhe tha:

— Po vonohemi.

* * *

Kompania e dytë qe hapur në strehët e para të lagjels «Bal». Më poshtë, te sheshi, ngrohte vendin flamuri i batalionit. Aty ishin katër mitralozët e rëndë dhe mortaja. Rahmani e Nikolla mbajtën vesh zërat e gëzuar që vinin nga streha e Haxhi Sulës, prej nga dilte një tym i kaltër, dhe shtynë derën me dërrasa të mbërthyera. Galip Nuri qeshte e mbushte ahurin me shamatë, pinte raki me të zotin e shtëpisë nga e njëjta faqore. Lami, nënkomandant i kompanisë, djaloqsh i pashëm, me balluket në sy, me atë nënqeshjen e çiltër e krenare të trimit, i tregonte diçka një djali katërmëdhjetëvjeçar, që rrinte në gjunjë ndanë tij me sytë e shpejtë e gojën gjysmë hapët. Një par-

tizan i përgjumur e i lodhur, i porsakthyer nga vendroja, shikonte avullin që nxirrte tenxherja, nën kapakun e së cilës zienin gjëra të mira.

Nikolla ndenji pranë Galipit. Ky pa me sytë e mprehtë që sipër hundës së kërcyer Topolakun njëzetetrevjeçar dhe i tha:

— E di që je bërë i tëri markeshas?

— Shokun Nikollë do ta mbajmë këtu edhe pas Çlirimit, — tha Lami.

— Atëherë u dashka t'i gjejmë nuse, një gocë të urtë prej Markeshi, — tha Galipi duke qeshur, pa ia ndarë sytë Nikollës. — Kushedi, — tha, — mbase e ka gjetur vetë dhe po rrahim ujë në havan.

Rahmani, që kishte ndenjur në vendin e të zotit të shtëpisë, u kthye me trupin e rëndë ndaj Galipit dhe i tha:

— Kur do të flasësh për të tjerët, mendo për veten.

Rahmani pa me habi se Galipi u skuq lehtas. Kushedi si kishte jetuar Galipi gjatë dimrit rreth pyjeve të Merqanit. Në tregimet e tij sigurisht kapërdinte ato mëkatet e vogla të ushqimit, veshmbathjes e strehës, si edhe ndonjë gjë më tej. Një mendje si ajo e Galipit nxirrte diçka edhe aty ku prapseshin gjithë të tjerët. Rahmanit i erdhi ligsht që iu përgjigj rëndë, po nuk duronte dot që dikush të ngacmonte Nikollën. Se djali s'kishte kthyer kurrë kokën të shihte një çupë, veç për t'i folur si vëlla, për ta sqaruar e për ta bindur. Kurse Galip Nuri, me ata sytë e hirtë që qeshin me gjithkënd, kërkojnë kudo, duke qenë ai vetë pus i thellë, hapte biseda të tilla në një kohë kur, për një ngacmim me duar të një gruaje, ashtu si edhe për vjedhjen e dy kallinjve misër, njeriu hante plumbin. Pasdite, kur të mblidhej batalioni në Luadhin e Arrave për kritikë e autokritikë, mund të dilte befasisht ndonjë telash i tillë. Për disa çaste ndenjën të gjithë he-shtur.

— E kemi parë shokun Nikollë gjatë dimrit, — tha i zoti i shtëpisë. — Ky vërtet është bërë krejt markeshas. Po do të ishte bërë njëlloj edhe kosovar, ose lab, sikur Partia ta kishte dërguar nga ato anë.

Rahmani u kënaq fort me fjalët e vërteta të këtij burri të zgjuar. Tashmë Rahmani e njihte Nikollën më mirë se djalin e vet. Ishin mbuluar me të njëjtën mushama të ngrirë në rrëpirat e Mërdhetës, kishin ngrënë thërrimet e bukës në duart e njëri-tjetrit. Rahmani fërkoj tëmthin, si për të qartësuar edhe më mirë disa pamje të muajve të shkuar. Pasdite, edhe ai, Rahman Dena, duhej të lironte veten, duke i vënë punët e tij nën gjykimin e të gjithëve.

— Po të tregojë çdo njeri ato që ka jetuar natë-ditë, ka për të qenë një mbledhje tepër e gjatë, — tha ngadalë e si me vete Galipi. Në fjalët e tij ndihej një si thirrje për urtësi e pajtim.

Nga jashtë thirri një zë, që lajmëronte diçka të gëzuar, ndofta arritjen e një njeriu që mungonte prej kohe. Rahmani doli të shihte dhe pa në krye të rrugës Selman Gërvishtën, që ecte me atë hapin e madh e të butë, i kërrusur, si i prirë nga mustaqet e veta. Prapa tij vinte një partizan që tërhiqte një mushkë ngarkuar me dy arka, mbuluar me batanije. Rahmani qeshi e u gëzua. Selmani kishte shkuar në minierën e vjetër të gjente dinamit për kullën e Mëdyshajve. Rahmani po pyeste veten si do të bënte Selmani për t'ia vënë dinamitin kullës dhe pse doemos me dinamit.

* * *

Partizani rrinte ndanë kazanit. Tymi shkonte në drejtim të tij, po ai nuk lëvizte. Dukej sikur tashmë të qe vënë në plumb dhe prapë të kishte mbetur gja-

llë, si një i vdekur këmbëkryq. Dy orë më parë kishte goditur me grusht të fortë togkomandantin për shkak të një ylli që po qëndiste infermierja e kompanisë. Qazim Sala, burrë i pjekur e i matur, që tërbuar prej zemërimit. E kishte lidhur partizanin, duke thirrur se do ta vinte në plumb. Gjyqi i kompanisë, i mbledhur aty për aty, kishte vendosur ta çarmatoste, ta linte në shërbim kuzhine dhe të dilte para batalionit.

Nikolla po e shihte partizanin që prapa kurrizit, nga larg, me zemrën shtrënguar. Ishte e para herë që dikush godiste me grusht në batalion dhe, në një ditë prehjeje e gëzimi. Nikolla nuk dinte si të bënte. Kohë mbetej pak, vendimi duhej të merrej atë pasdreke, te Livadhi i Arrave. Nikolla ndjeu djersën në duar e rreth qafës. Shkoi e i ndenji partizanit mbi krye. Ky ktheu sytë me tym, vetullat dhe flokët me hi. U duk se nuk njohu zëvendëskomisararin, pastaj u çua si me përtim, me kokën mënjanë.

Nikolla i foli me zërin e ulët, me gojën të tharë:

— Si të ngjau, mor Halil, ç'na bëre!

Partizani hapi sytë, iu hodh gjoksi si prej ngashërimit, u gëlltit e deshi të thoshte diçka, po ndërroi mendje, një nënqeshje e hollë iu vizatua rreth gojës dhe hodhi sytë gjetiu. Ajo nënqeshje iu duk Nikollës kryeneçe dhe e ligë. Dhe ishte i bëshëm, nga ata që kanë dëshirë ta tregojnë fuqinë.

— Ke bërë poshtërsi, turp, fajin më të rëndë, — zuri t'i thoshte Nikolla. Deshi t'i fliste edhe më, po nuk e zotëronte gjuhën. Partizanit iu egërsua shikimi. Dukej se ishte ende i nxehtë dhe ashtu do të dilte edhe para batalionit. Kur mendoi se ç'mund të ndodhte në mbledhje, Nikolla zuri të kërkonte me ngut ndonjë shteg dhe i foli me të butë si në fshehtësi, gati me lutje:

— Tregohu me mend, dëgjon. Bëj autokritikë, fol tamam si të ngjau.— Ndërsa i thoshte kështu, pikë-

risht asaj i trembej, që partizani të fliste për shkakun e vërtetë, i cili duhej mbajtur me çdo kusht mbuluar.

Nikolla eci nëpër rrugën e fshatit me zemër të ndrydhur e duke bërë fytyrën të qeshur. Donte të shihte si e mendonin të tjerët. Kompanitë rrinin në bahçet, prej nga ngriheshin tymra. Çdo togë do të piqte cjamin e vet. Nga dilnin cjeptë për batalionin në një fshat ku dukej se armiku s'kishte lënë këmbë bagëtie? Nikolla po shihte luginën e stërgjatë e të habitshme të Balit, ku të mernte sytë blerimi, pa rrjedhur gjëkund një rrëke uji. Në udhëzën me zall të kuq kalonte ndonjë shok. Nikolla po vinte re njëfarë kujdesi të tepërt në fjalët dhe përhëndetjet e tyre. Kjo lidhej me rritjen e fortë të autoritetit të Partisë në batalion kohët e fundit, po ndofta edhe me njëfarë shqetësimi për mbledhjen e pasdites. Në sytë e Nikollës zuri të mblidhej e tërë masa e batalionit dhe në të njëjtën kohë secila fytyrë dilte më vete, e zeshkët, e regjur. Do të bëhej kritikë e autokritikë. Pas çdo mbledhjeje të tillë batalioni zinte e ecte me tjetër hap, nuk grindej, as ankohej kush, secili ndihte shokun, si vëllezër në shpirt e në gjak. Po kësaj here mbledhja do të ishte më e nxehtë se kurrë. Se në muajt e shpërndarjes secili kishte mbledhur në vete ngjarje e ndodhi të shumta. Do ta niste Nikolla; sipas pikave në bllok, të vërteta deri në fund, të qarta. Fillimi kishte qenë si një kllapi dëbore. Po në mesin e janarit ai kishte arritur të mblidhte tetë komunistë te stani i Bratit. Çfarë po ndodhte dhe deri kur? S'paskësh pasur asgjë për t'u habitur. Ndoshta ajo që pati thënë dikur baba Merxhani. Markeshasi që e zë stuhia në pyll, struket në një zgavër sa të çelë moti e të vihet prapë në rrugë. Nga ajo ditë e prapa qenë mëkëmbur celulat, grupet.

Cilat nga këto do të thoshte Nikolla në batalion dhe cilat në Parti? Dhe deri ku mund të shtrihej autokri-

tika në një batalion me markeshas? Kush do të ndëshkohej dhe si? Fjalën e fundit për çdo gjë duhej ta thoshte Nikolla, si edhe për atë Halilin. Do të ishte më lehtë, krejt ndryshe, po të ndodhej aty baba Merxhani, i cili e zgjidhte çdo ngatërresë në pajtim me moralin e Partisë po edhe me zakonin e Markeshit. Babai do të vinte pas dy ditëve. Kurse batalioni duhej vënë sa më shpejt në rregull. Si të shfaroste armikun në Ndërfushë, batalioni do të nisej për të hyrë në brigadën e re.

Në kompaninë e parë një skuadër lozte biz, ia veshnin me pëllëmbë sa u hante krahu atij që kishte radhën dhe qeshnin fort. Skuadrat e tjera shihnin lojën. Nikolla u ul në njërin nga skuadrat dhe ngröhu duart në zjarr. E ftuan për drekë. Po tej fjalëve ndihej njëfarë ngathtësie. Atëherë Nikolla pa edhe më mirë ndryshimin që kishte ndodhur në tre muajt e fundit. Batalioni nuk i ngjante vetes. Ndryshimi kishte ngjarë në secilin dhe kështu sajohej ndryshimi i plotë i batalionit. Ishin bërë të gjithë më të bindur, më të heshtur. Kishin mësuar të njihnin më mirë veten dhe sidomos armikun, cilindo armik. Dhe nëse pasdite ndonjëri do të fshihte diçka nga shokët, këtë do ta shlyente nesër në luftërat e ardhshme, në marshimet e brigadës. Sa për atë Halilin, dukej se batalioni do ta falte, duke e lënë ca kohë në kuxhinë, pa armë. Po ç'gjëra të tjera do të nxirrte mbledhja? Një lodhje e lehtë e pushtoi Nikollën dhe zuri të kotej ndanë zjarrit, duke dëgjuar si në ëndërr lojën plot zhurmë të atyre nën pemët. Iu bë sikur dikush goditi befas dikë me grusht, duke ia plasur gjakun nga goja e nga hundët ndërsa pak më tej ishte fytyra e zbardhur, e llahatarisur e një shoqeje. Nikolla u drodh e hapi sytë. Në ajrin e pranverës sillej një shqetësim pa emër. Kjo lidhej me një tjetër ndryshim në batalion. «Dashqria, — tha me vete, — po kërkon shtigjet të hyjë,» — dhe

mbeti pa gojë, me trupin të ftohtë, ndërsa thellë në shpirt ndiente një kënaqësi të turbullt, për të cilën nuk po mundohej të qortonte veten.

VI

Baba Merxhani po e shihte «shkrimtarin» me njëfarë mërie, sikur ai të ishte shkaktar i vuajtjeve të natës së shkuar.

— Ka ditë që më dhembin sytë prej dëborës, — tha «shkrimtari», duke fshirë lotët.

Dëbora, e mbetur prapa, ishte shkak i lehtë për të shpjeguar lotët. «Shkrimtari» lotonte ngaqë s'i kishte mbetur më fuqi. I tronditur thellë, babai tha:

— E sheh, duhet të shtrohesh në spitalin e qarkut edhe për sytë. Ti mezi merr frymë.

«Shkrimtari» shikoi rrotull grykës së lumit ku ishin ndalur. I ndriti edhe më fort kërcelli i hundës, fytyra e bardhë, kurse trupi i gjatë i drobitur po i për-kundej. Iu përthanë sytë dhe, pas pak, zuri të shënonte në fletoren e trashë me kapakë të zinj. Ndalej dhe vinte në buzë bishtin e stilografit, sikur të thithte në-për të palcën e mendimit.

Ata ishin nisur bashkë nga Ofshani për të kaluar në jug, të thirrur nga Këshilli i Përgjithshëm Nacionalirimitar. Te vau i lumit, kur u krodhën deri në gjoks, «shkrimtari» kishte thirrur me frymën të zënë se nuk mundej më. Nga njëri krah e mbante Jashari dhe nga krah tjetër babai. «Shkrimtari» ishte aq i lehtë sa dukej sikur po e merrte rryma e paktë, e ftohtë e vaut. Babait i qe dukur se kishte parë sytë e çakërritur të «shkrimtarit» të pasqyruar në dritën e yjeve që binte

mbi lumë. Edhe vetë babait po i shkiste zalli nën këmbë. Qenë kthyer mbrapsht. Në breg kishin arritur gjysmë të ngrirë, të habitur që shpëtuan, qeshën e morën frymë. Jashari u kishte ndezur zjarr në mes të shkëmbinjve.

— Çfarë po shkruan? — pyeti babai.

— Udhëtimin tonë dhe ndarjen e shpejtë, — tha «shkrimtari».

E mbulonte stërmundimin si njeri i mësuar prej kole me sëmundjet.

— Ne gjithnjë takohemi sa për t'u ndarë, — tha babai. Po i shtohet turbullimi, se po përdorte si shkak lumin ujëplotë, për t'u ndarë nga «shkrimtari» për t'u kthyer edhe një herë në Markesh, para se të niste udhëtimin për në Jug.

* * *

Babanë po e zinte nata në Qafën e Mërrizit, i therrnin fort këmbët e ënjtura dhe u kthye në shtëpinë e mikut të tij, Myftarit, me Jasharin. Myftari nuk ishte. Ishte hoxha i Gurbardhit, që kishte shkuar mik më parë. Po falte akshamin, një hoxhë i paktë, i thatë e kryeneç, që i ndjeu mysafirët dhe vijoi të falej. «Mos hyni ndërmjet meje dhe zotit», — thanë supet e tij nervoze. Babait iu duk se po bënte një kërcim prapa, si në një shpellë të errët. I rrihte zemra. Kur u përmend, i shkeli syrin Jasharit, u ul në qoshen tjetër dhe priti, duke nuhatur erën e hoxhës. Ishte e njëjta erë e faltoreve kudo që ishin, që tani i prishte gjakun dhe që donte ta fshihte nga njerëzit, të mos e nuhasnin kurrë.

Hoxha ulej e çohëj, ulej e çohëj, murmuriste fjalë, me sytë përdhe, ose në qiell, lyente veten dhe lëpinte njerëzinë përtej mureve. Refleksët e prushit të madh

binin mbi duart, fytyrën dhe çallmën e tij dhe, mund të thoshe se ai donte të piqej, të pastronte mëkatet që s'i kishte bërë, që mbartte për të tjerët, duke qenë ata të lodhur nga jeta në gjysmën e rrugës. Babait iu rikthye mendimi i vjetër se në këtë kishte pasur pjesën e tij edhe vetë. Zuri ta urrente hoxhën ngadalë e me durim, ta gjykonte gjithnjë më keq. Jeta e këtij hoxhe ishte krejt e kotë. Të gjithë lindin e vdesin, duke u mbyllur rrethi sipas hapit të secilit. Po jeta e këtij hoxhe lëvizte brenda rrethit më të vogël e më të mbyllur. Si do të rregullohej ky aty e prapa me njerëzit? Dhe ç'do të bëhej ai vetë, Merxhan Dalipi? Ja ku ndodhej befasisht para pyetjes që ishte shtyrë gjatë tre vjetëve të luftës, si një çështje që do të zgjidhej në fund. Ky fund po vinte. I kishte thënë e përsëritur vetes, me një përбетim pas të cilit mbante shpirtin lidhur, se ditën e çlirimit do ta digjte taçin. Po këtu nuk ishte vetëm puna e tij. Ky hoxhë, dhe të tjerët si ky, do ta kapërcenin pragun siç ishin, si lëmshe të mbështjella në rrobat e tyre. Këta ishin qindra, mijëra hoxhallarë, baballarë, priftërinj. Ca më tepër ishin ndihmësit e tyre. Sa më rëndë mendohej babai, aq më tepër fryhej bota në sytë e tij. Për herë të parë po shihte të vërtetën siç ishte. Asgjë nuk do të ngjante. Ditën e çlirimit do të gdhiheshin të gjithë njëlloj, besimtarë e jobesimtarë.

Më në fund hoxha mbaroi, u ul në qoshe, një grusht burrë, me fytyrën e mprehtë rrethuar me mjekër majuce. Rregulloi xhyben e dalë boje mbi gjunjët që duhej t'i kishte me kallo, u rrëqeth dhe shikoi babanë me qortimin e vjetër e të rëndë të syniut kundër bektashizmit. Vuri me lëvizje të shpejta syzet me skelet teli të fortë, që i mbante më tepër si stoli, dhe sytë e tij të vegjël e të verdhë u dukën si dy njolla kërcënuese. Ishte i gatshëm të shpërthente po të ngacmohej.

Babai desh ia plasi të qeshurit me mllef, po u përmbajt dhe tha:

— U fale mirë, zotrote. Edhe unë jam fetar, po tani është koha e armëve. Feja kërkon prej nesh të japim edhe jetën për atdheun.

— Feja ka punën e vet, ka punën e vet, — tha hoxha, — duke shikuar sipër syzeve. E folura e tij erdhi si një e lehur qeni. Ky hoxhë i vockël e kishte helmin në shpirt. I ngjante gjithnjë më fort një gjinkalle që do të këndoje këngën e vet brejtëse mbi degë sa të ketë frymë.

Babai u mblodh me grushtet në prehër. «Feja ka punën e vet, ka punën e vet.» Hidhërimi i vjetër, i zi, po i kullonte nga brenda si qëmoti, në ditët e teqesë. Hoxha po fërkonte kërcellin e hundës, ku i qe bërë një rreth i kuq prej skeletit të syzeve. Babai mendoi se ai, Merxhan Dalipi, e kishte fituar të drejtën me armë në dorë ta digjte taçin, të ndryshonte jetën e vet. Po ama, në çastin e fundit, mund t'i vinin dorën në sup. Dhe ja tek mbetet prapë brenda kafazit. Atëherë si do të vinte filli i tij dhe ca më tepër i Nabijes? Ai duhej të mendohej, po, që të mendohej, më parë duhej të dëbonte hoxhën. I dukej se do të çmendej po të rrinte tërë natën përballë tij. Po kërkonte me ngut një shkak për ta dëbuar, kur hyri Myftari, i zoti i shtëpisë, u përshëndet me fytyrën të çelur prej gëzimit dhe tha:

— Na fal, o babë, se s'mbajmë raki.

— Raki ka Jashari, po ti na sill pak meze, — tha babai.

Myftari solli një kade me shëllirë turshie që babai të vinte në të këmbët e ënjtura. Kishte therur kecin dhe solli mëlçi të fërguara. Babai u ndie më mirë. Do ta përzinte hoxhën me anë të rakisë e të këngës. I mbushi një filxhan dhe i thirri fort:

— Pije për Luftën Nacionalçlirimtare, me fund.

Po hoxha s'mund të pinte, mund të shkulte mje-

krën ose të bënte çdo gjë tjetër, po jo të pinte dhe zuri të rrotullonte sytë mbi filxhan, si i tërbuari mbi tasin e ujit.

— Atëherë rri aty dhe falu më vete, — tha babai dhe zuri të këndonte fort me Jasharin. Hoxha u tmerrua. Aty do të ngjanin prapësi të rënda bektashiane. Zuri të hiqej rrëzë murit, përherë nga pak, drejt këpucëve dhe trastës, me synim nga dera. Gjeti rast dhe rrëshqiti me marifet në oborr. Babai vijoi të pinte, siç nuk kishte bërë prej kohe, duke prapsur hijet.

VII

Baba Merxhani i zbriti mushkës në sheshin «Belik» Erdhën fshatarët ta përshëndesnin. Myhibët e vjetër fshinin lotët. Nga shikimi i babait dhe disa fjalë që tha, kuptohej se s'kishte ardhur për të ndenjtur, po sa për të mbaruar një punë me rëndësi e do të shkonte prapë. Dukej mirë me shëndet, veçse bënte kujdes në të ecur, si një njeri që porsa ka mësuar të hedhë këmbët. Ai shkoi të pushonte në shtëpinë e Bejto Hamzës aty afër. Bejtoja ishte i vetmi që kishte arritur të hidhte një çati bredhi. E priti babanë në oborr, duke përpjekur pëllëmbët e me ca lëvizje sikur po hiqte një valle të vogël.

Pasdite babai, i përcjellë prej Rahmanit, bëri disa vizita në familjet pranë, duke pirë një gotë të vogël raki nën strehët e përkohshme. U ndal edhe në dy nga familjet e të pushkatuarve prej batalionit të Çernikës. Nuk bëri ngushëllime, as i qortoi, veçse i pyeti si po rregulloheshin, siç kishte bërë edhe me familjet e tjera. Këto vizita u folën në lagjet, duke kaluar lajmi me shpejtësi, duke kuptuar secili se babai do ta thoshte më

në fund një fjalë për atë ngjarje të rëndë që nuk e zinte kush në gojë. Dhe jo vetëm për atë. Ajo natë dhe e nesërmja do të ishin fundi i diçkaje që lidhej me historinë e zgjatur të Markeshit, me të tashmen dhe të ardhmen. Këtë e ndiente gjithkush në lëkurën e vet dhe secili ruante atë pamjen hijerëndë e të heshtur markeshase, ndërsa e brente kureshtja dhe, pak më tej, hiqej të bisedonte në fshehtësi me fqinjin. Se tani, për të parën herë, do të dilte haptas markeshasi kundër markeshasit me armë në dorë. Kishte ardhur koha. Në mbrëmje, kur u mbloodh në shtëpinë e Bejto Hamzës këshilli krahinor, secili fshatar ndenji duke pritur në strehën e vet se mos po e thërrisnin befaz edhe atë në këshill a në batalion.

Baba Merxhani foli në këshill me atë të folmen që ia njihte gjithkush. Markeshi ishte djegur krejt dhe duhej ndërtuar gjatë verës, që dimri të mos i gjente fëmijët e pleqtë pa një strehë mbi krye. Bagëtia ishin gjysmuar, ndërsa po kalonte koha e punimit të tokës. Për situatën tha se ky ishte viti i çlirimit. Po nuk duhej kujtuar se lufta do të mbaronte nesër. Armiku që shihte humbjen e vet do të bëhej edhe më i egër. Ata që e dëgjonin, pesëmbëdhjetë burra, e falënderonin me zemër. Se ai po u binte si anash ngjarjeve të muajve të kaluar, nuk po i pyeste se ç'kishin bërë secili dhe as të gjithë bashkë, nga kishin shkuar, për sa kohë ishin fshehur. Ama ai do të dilte disi në këtë shteg dhe këshilli priste duke mbajtur frymën. Po babai veçse i shikonte ndër sy, nuk u bënte pyetje, kjo ndofta lidhej me njëfarë mallëngjimi për mungesën e tij të gjatë dhe për ikjen e shpejtë. Ai foli për sulmin që i duhej bërë armikut në krahun tjetër të lumit, që mbelej si një kufi i çastit, duke e ndarë Markeshin në tri pjesë nga ana e Partisë dhe pjesën e katërt nga ana e armikut. Po kufiri i vërtetë që ndante Marke-

shin s'kishte të bënte me lumin dhe as me gardhe e shenja mbi tokë. Ky ishte një kufi që gjarpëronte për drej në lagjet, i vështirë për t'u ndjekur edhe me mendje, këtu ngatërroheshin fiset e krushqitë, armiqësitë e lashta dhe gjakësitë e reja, një pjesë të kryera nën sytë e të gjithëve po pjesa më e madhe duke ndenjtur fshehur në vite. Këtu ishte rrezik të digjëj i njomi me të thatin, punë që kërkonte një sqarim të mirë, para se të binte boria e sulmit. Babai drejtoi trupin kur tha se i tillë ishte fati i veçantë i Markeshit.

— Këtu kanë ngjarë disa pushkatime, — tha. Ngri-ti kokën si për të shikuar përtej ahurit dhe tha: — I kisha shkruar qarkorit dhe Shtabit të Përgjithshëm. — Nxori një letër dhe e tundi në dorë. — Para se të mbërrinin letrat e mia, më vjen kjo letër nga qarkori. Në datën 15 shkurt Zambaku dhe një komandant kompanie janë gjykuar për tradhti dhe pushkatuar para batalionit.

— Të qofshim falë, o babë, — tha Hysen Gjata, kryetar i këshillit të lagjes «Denë».

— I qofshim falë Partisë, — tha babai.

— Atëherë, ata që u pushkatuan?... — pyeti me zë fare të ulët komandanti i çetës territoriale të Balit.

Babai u hoq se nuk e dëgjoi, vijoi mendimin e vet, foli sikur të hiqte prej vetes diçka të keqe e tha:

— Armiku në Markesh ka qenë edhe më dinak se gjetiu. Mëdyshajt dhe të tjerët dolën me armë në dorë vetëm kur ia behën gjermanët. Po edhe atëherë prapë duke ecur në shtegun e vjetër. Vrasjet e katër partizanëve i bënë fshehur. Kurse ditën hiqeshin se përkrahnin fshatarët, dorëzënë për ta ndaj të huajit e mbrojtës të zakonit. Po më në fund i kemi përballë. Megjithatë prapë s'është e lehtë. Ka ardhur koha t'i thërrasim me emër. — Mori frymë dhe kaloi dorën në mjekër, duke u kthyer për disa çaste në vitet kur bënte li-

gje si baba i teqesë, ndërsa ishte i tëri komandant e komunist. Ngriti gishtin dhe tha:

— Armiq të Partisë në Markesh janë Mëdyshajt, tetëmbëdhjetë vjeç e lart. Këta ky këshill duhet t'i dënojë me vdekje. Armiq janë Man Leka, Sakiq Ziguri dhe Mehmet Koçi. Edhe këta me vdekje. Njerëzit e tjerë që kanë shkuar pas këtyre janë gabuar, falen po të hedhin armët.

U duk sikur po mbushej dhoma me hijet e shumta të njerëzve të dënuar. Këshilli ndenji si me frymën të zënë, me fytyrat të përhumbura. Po në heshtjen që pasoi fytyrat zunë të marrin trajtat e tyre. Secili numëroi me mendje të dënuarit dhe dikujt po i dukeshin pak. Ky vendim, i rëndë po i domosdoshëm, ishte sajuar në shpirtin e babait dhe i kulluar mirë brenda tij në muajt e vetmisë së dimrit. Tani ai po rrinte heshtur, duke thënë me shikimin e tij se s'mund të ndodhte ndryshe. Këtë vendim, të shqiptuar prej tij, që ndilte diçka të lashtë dhe ndriçonte të vërtetën për të sotmen, këshilli e pranonte me zemër. Sadi Pejza, që rrinte në krah të babait, u koll, si për të thënë se ashtu duhej vendosur. Drejtoi trupin e imët e të thatë dhe prapë ndenji i përkulur mbi veten. Asnjëherë s'mund të dije se ç'mendonte ky njeri dhe as të shihje në shpirtin e tij të thellë. Më në fund foli, me një si mallëngjim në zërin e bukur. Tha se si kryetar i këshillit i pëlqente fort fjalët e babait, që bënin një drejtësi të kërkuar prej kohe nga fshatari markeshas. Po, ndërsa thoshte kështu, ndërsa fliste ca më gjatë për fshatarin, dukej se ia kishte ënda të shtohet në vendim edhe ndonjë emër tjetër. Po këtë Sadiu nuk do ta thoshte kurrë me gojën e vet dhe ftoi të tjerët të shfaqnin mendimin. Askush nuk shtoi ndonjë emër dhe as tha fjalë të kundërt.

Në mëngjes shkëlqente dielli mbi luginë e mbi malet. Dukej sikur të ishte pushim e pritje, nuk bëhej asgjë, ngjante sikur të dy anët e lumit të ishin zbrazur për zhvillimin e diçkaje të rëndë e të bukur. Batalioni i dalë nga lagjja «Qytezë» zbriti buzë lumit dhe u duk një batalion tri herë më i madh, që do të niste punën e vet porsa të kapërcente lumin, ose duke hyrë në lumë. Fshatarët që kishin dalë nga shtëpitë, lëvizën sipas vendit, që të shihnin poshtë, por pa humbur nga sytë brigjet e tejme, duke ndier secili kënaqësi të madhe. Armiku, me qendrën në pllajën e Ndërfushës, kishte thënë se do të skuqte prej gjakut lumi Dron. Këto kërcënime nuk i besonte kush, do të sulmonte batalioni e do të thyhej armiku dhe ku gjen rast më të mirë të shohësh me sytë e tu e pa rrezik luftën që do të fshinte të keqen nga toka e Markeshit?

Në kohën kur batalioni do të kapërcente Droin dhe ndërsa nga brigjet përballë nuk ndihej kush, u ndryshua urdhri, u përcoll fjala: «Të mos hyjnë shokët në lumin me ujë dëbore. Të kalojë batalioni në urë.» Ky urdhër u dha prej vetë baba Merxhanit, që po rrinte me aisa fshatarë të rrënojat e komunës në sheshin «Belik», me dylbinë në qafë. Poshtë, te bregorja e Ahurit të Jevgut, që ngritur mortaja, me dy italianët në pritje. Batalioni u mblodh për aq kohë sa të kalonte në urën e drunjtë, u hap përsëri në anën tjetër dhe filloi ngjitjen e brigjeve të thepisura, nën sytë e fshatarëve të lagjeve «Qytezë» e «Denë», ndërsa pritej të vinin edhe ata të «Balit». Kalimi për dy në urë dhe ngjitja në brigje tregonin se batalioni nuk po ngutej, ruante frymën, ecte si markeshasi kur vihet në rrugë dhe ka matur me mendje largësinë dhe kohën. Por puna zuri të merrte shpejtësi, kur nga majat e Ndërfushës që nuk

shihej krisën dy mitralozë të rëndë. Një kompani e batalionit po hynte në lagjen «Gjin», kur nga kalaja e vjetër kriste një tjetër mitraloz i rëndë. Zunë vend e krisën me gëzim edhe mitralozët e batalionit, që tani duhej të kishte mbi krye pozicionet e gurta të Ndërfushës, ku komandonte mercenarët një kapiten i vjetër prej Planit të Kuq. Ndërsa nga ana e kalasë dukej se do të luftonin ballas dhe sheshit dhe për herë të parë markeshasi me markeshasin. Kaloi një kohë, gjatë së cilës u dëgjuan vetëm luftimet me mitralozë dhe me krisma pushkësh të rralla. Pritej shpërthimi me dinamit i kullës së Mëdyshajve, që tashmë duhej të ishte pushtuar, po shpërthim nuk pati. Që andej u ngrit një fjollë tymi, që erdhi e u rrit dhe shumë shpejt flakët e përpinë kullën. Ky ishte i pari zjarr i kundërt që digjte diçka në Markesh, i shikuar prej popullit, në heshtje, ashtu si shihet një zjarr i mirë. Krismat e pushkëve që shkonin lart dukeshin tani si shkëndija të përhapura prej këtij zjarri. Shpërthimi me dinamit erdhi kur nuk e priste kush, në dy kohë, i fortë e i rëndë, duke ngritur lart shtëllunga tymi trazuar me pluhur. Kur u hap tymi, kulla nuk ishte më, qenë zhdukur edhe muret. Si kaloi habia e këtij shpërthimi, u pa se qe ndezur lufta, prej gështenjave të Ndërfushës deri te kalaja e vjetër. Në disa pika shpërthenin bombat e dorës. Dukej se aty vriteshin njerëz e rridhte gjak, kjo nuk ishte më një luftë që mund të shihej duke u kënaqur, ndonjë grua që kishte në batalion burrin a djalin ra në gjunjë, ose vrapoi poshtë te shtegu, megjithëse nuk po kthehej njeri i vrarë a i plagosur. Dukej se lufta shtyhej hera-herës përpara, pa kuptuar kush kohën dhe ca më pak atë që ndodhte. Më në fund ra heshtja nga ana e kalasë dhe pak më vonë u dëgjuan bombat përtej luginës së Ndërfushës.

Baba Merxhani do të nisej. Ndofta merrte ndonjë detyrë në Shtabin e Përgjithshëm prej nga drejtohej e gjithë lufta. Ndofta edhe në qeveri, e cila sigurisht po merrte formë diku, në rrugën e saj drejt Tiranës. «Patjetër edhe kryegjysh botëror do të bëhet», — tha dikush. Fshatarët menduan kështu: nga pozitat e larta që sigurisht do t'i jepeshin babait, përfitonte në shpirtin e vet çdo markeshas. E kishin ditur edhe më parë se shtati i bëshëm i babait ngrihej përtej Markeshit, po tani që kjo ishte bërë, ndienin një gëzim të shqetësuar. Duhej parë si do t'ia dilte në krye kur të ikte përtej maleve. Ai do t'ia dilte, po vallë a do t'i përkiste Markeshit si edhe më parë?

Hera-herës ai ndalej në mes të bisedës, të shihte rrotull me njëfarë hutimi, si njeriu që do të shkëputet në çastin tjetër. Kjo i sillte një si dhimbje të trupit. E shihte se tani në Markesh bënin edhe pa të, siç kishin bërë në dy muajt e fundit dhe krenohej që ndodhte kështu. Po thellë në shpirt i mblidhej njëfarë mërzie pa drejtim dhe çonte faqoren. Tani që po afrohej koha të përshëndetej me njerëzit e me sendet, pjesë të jetës së tij, shihte se sa e vështirë paskësh qenë të ndahej prej tyre. Nganjëherë kjo i dukej e pamundur. Po më në fund do të nisej, nëpër të njëjtën rrugë prej nga erdhi njëmbëdhjetë vjet të shkuar. Ai vetë, dhe fshatarët që i rrinin pranë tërë kohës me një kujdes të shtuar, mblidhnin buzët me habi kur thoshin «njëmbëdhjetë vjet». Dukej sikur ai sapo kishte ardhur, ca muaj më parë, dhe, dukej sikur kishte qenë aty gjithnjë. «Po ikën babai i katërt», — u pëshpëriti disa myhibëve Sadi Pejza.

EPILOGU

U S G O V

Një sekretar i Kryeministrit i çoi kolonel baba Merxhanit në shtëpi një zarf me fotografi. Ishte një natë e qetë, pa miq, përveç Selman Gërvishtës, që pinte nga pak raki në dhomën tjetër dhe bisedonte me Nabijen.

Babai pa fotografitë ku kishte dalë me Enver Hoxhën. I mbetën sytë te fotografia në Tiranë, ditën e hyrjes së qeverisë. Babai i veshur me një pardësy të mbërthyer deri lart, si një shkollar, me taçin në kokë, me fytyrën rrethuar me mjekër të kthyer pak mënjanë, si për të parë më mirë lirinë. Në bulevardin e madh të Tiranës, i qe dukur se ra në një det betoni, me qiellin sipër, ndërsa brohoritjet e zgjatura po ktheheshin në shkëndija, në një valë të nxehtë që e çonte diku, duke pasur anash dhjetëra mijëra fytyra në lëvizje. Pak më tej kishte menduar se ky turbullim i vinte nga zemra dhe ai duhej të qetësohej, të gëzonte atë ditë që arrihej vetëm një herë në jetë. Po ja që s'mund të qetësohej, të shkëputej asnjë çast prej rrjedhës, haresë që përhapej si oshëtimë, a thua se do të zinte qiellin. Por çdo festë ka një mbarim, sidomos kur hareja e brohoritja duhet të marrin një drejtim të ri, sepse populli kthehet e sheh plagët e vendit të dalë nga një luftë e egër, e gjatë dhe duhet t'i

përvishet punës, të ecë më tej, në hapësirat e reja të panjohura.

Duke qenë ende kolonel, ai ishte emëruar kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Qarkut. Tani edhe mund të vishej civil, po ama, me taçin në kokë, pra me dollomanë dhe me qyrkun. Këtë s'do ta bënte kurrë, nuk do të kthehej tek ajo veshje as i vdekur, prandaj më mirë po rrinte ushtarak deri në fytyrë. Nga fytyri e lart do të mbante mjekrën dhe taçin.

Në udhëtimin e parë në Markesh babai e gjeli teqenë të rindërtuar. Për gjashtë muaj kishte qenë tepër i zënë me punë, natë ditë, prandaj s'kishte mundur të shkonte në Markesh. Ai po dëgjonte kryetarin e këshillit dhe sekretarin e celulës që i ankoheshin për babanë e ri të teqesë, një ish-mekanik prej Shkodrës. Ky kishte ndërtuar një hidrocentral të vogël që i jepte dritë teqesë, kishte sjellë një piano nëpër male, i binte edhe kitarës. Me këto tërhiqte rininë në teqe, duke u mësuar tangon. Ndërsa organizata e rinisë s'mund t'i bënte dritë vetes veç me bishtukë, të merrte jevgun me dauille dhe ndonjëri t'i binte tamrës. Po këto nuk e tërhiqnin rininë, që bridhte lart nga teqeja, ku llamburisnin drita të habitshme të papara, jehonin tinguj e melodi të padëgjua. A mund të lejohej që teqeja të tërhiqte rininë?

Baba Merxhani qeshi me ish-mekanikun e krisur, tha se së shpejti Markeshi do të kishte dritat e veta dhe muzikën e vet. Ai do ta kufizonte teqenë, po duhej të bënin edhe ata vetë diçka për bukën, dritat dhe muzikën. Duke u kthyer në qark babai po mendonte se kishte ardhur koha e ballafaqimit. Institucionet fetare

në Shqipëri do të përkrahnin pushtetin e popullit, të zgjedhur prej këtij populli? Dhe, nëse jo, a do të rrinin së paku në punën e tyre? Kjo pyetje ende nuk bëhej haptas, po prapë bëhej, sepse disa nga këto institucione pengonin besimtarët. Mund të qeshje duke u talluar me përpjekjet e tyre për të ndalur popullin sadopak, po, pasi të qeshje, të hipte edhe zemërimi, sepse ndodhte që edhe të merreshin me veprimtari të fshehtë në krah të armikut.

Babai krenohet me punët në Komitetin Ekzekutiv të Qarkut. Shëndetin e kishte me të tepërt, i mjaftonin gjashtë orë gjumë, dilte nga shtëpia herët dhe kthehej natën, nganjëherë afër mëngjesit. Shpesh nuk dinte si t'i jepte rrugë një çështjeje. Puna u rëndua sidomos kur filloi të flitej për planin ekonomik dyvjeçar. Po edhe të tjerët nuk dinin. «Aq më mirë, se e nisim çdo gjë nga e para», — thoshte me të qeshur. Shpesh nuk dinin as ministrinë, ndërsa hiqeshin se i dinin të gjitha. Diku nuk jepnin përgjigje për çështje të ngutshme, diku tregonin ngut të tepërt për një gjë fare të vogël. Ja tek vjen në zyrë një nëntoger i ri nga Ministria e Brendshme, hyn pa trokitur, gatitet e nderon me dyshim para tri yjeve të kolonelit, nxjerr një zarf tepër sekret mbi të cilin shkruhet: «Të hapet në orën 8.00 të datës 1 nëntor 1946». Zarfi mban një urdhër për sekuestrimin e motoçikletave. Në çdo dy rreshta të urdhrit shkruhej fjala «kujdes», a thua se do të kryhet ndonjë operacion i madh. Gjithë-gjithë në qark mund të ishin nja pesë motoçikleta, babai mezi e mban të qeshurën, kurse nëntogeri ka ndër sy atë dyshimin e vazhduar e të gjithanshëm për të tjerët dhe sigurinë e besimin për veten se i përket një kategorie të re në

ngritje që e vë jashtë çdo kontrolli dhe i jep çdo të drejtë. Babait zë t'i shuhet buzëqeshja. Shikon firmën e urdhrin. Ky është zëvendësministri me fytyrën e vogël, me sytë e shpejtë me dritë të keqe. Prapa rri fytyra tjetër rrumbullake, ku i vete shpesh mendja babait, siç vete gjuha te dhëmballa e prishur. Tre muaj më parë Koçi Xoxja i kishte thënë: «Rri, more, se nuk di gjë ti!» «Si nuk ditkam gjë?» Babai kishte hequr taçin, kishte shtyrë prapa padashur këllëfin e kobures. «Deri tani paskam ditur.» Ndofta Koçi e pa atë shtyrjen e kobures, ndofta e panë edhe të tjerët. Koçi kishte vënë buzën në gaz, me një premtim ogurzi për t'u takuar prapë. Nga ajo ditë babai kishte filluar të ndiente një si ftohtësi rreth vetes, që nuk kuptohej nga vinte e ku drejtohej. Ai kishte zënë të shkonte më dendur në mitingjet e në aksionet, të vente gati çdo muaj në Markesh. Rri një ditë në Qytezë, fli një natë në Bal. Në mendje i kthehet e kaluara e rëndë. Ai nuk ndien keqardhje që vuajti atë jetë, sepse gjërat e rënda të nxjerrin diku, arrijnë diçka. Ai vetë vuri tërë fuqitë që jeta të ndryshonte në themel dhe tani asgjë nuk do të kthehej më siç kishte qenë. Veçse ndryshimi nuk po ndodh aq shpejt. Ka vështirësi për bukën. «Ani, se do të kalojë», — thotë markeshasi. «Sa të fillojë plani dyvjeçar», — i përgjigjet babai.

* * *

Erdhi Rahmani nga Korça. Kishte ardhur edhe gjashtë muaj më parë, duke shikuar me habi gradat e veta të majorit në mëngët e xhaketës. Kësaj here nuk i shikonte më dhe tha:

— Or babë, duhet të dal prej ushtrie.

— Pse? Kush do ta mbajë ushtrinë po të dalim ne?
— e pyeti babai.

— Çova djalin në shkollën e kadetëve, kurse vetë nuk mundem, — tha Rahmani, — Mezi i lexoj shkresat.

Babai mendoi se Rahmani kishte të drejtë. Ishte caktuar komandant i një regjimenti artilerie. Kërkohej shkollë e dituri. Rahmani po shihte në fundin e gotës së rakisë, me fytyrën eshtake të madhe e të rëndë. Vuante mjaft aty në komandë, duke lexuar shkresat e shumta, duke shtrënguar trurin të kuptonte, nën sytë e shefit të shtabit, një ish-oficer i vjetër.

— Lirimin veç Komandanti i Përgjithshëm mund ta urdhërojë, — tha babai.

— Për atë kam ardhur. Më ndihmo ti, — tha Rahmani.

Babai po shihte se ajo që kërkonte Rahmani që peshuar prej tij nga të gjitha anët dhe që vendosur një herë e përgjithmonë.

— Shokët e tjerë venë mirë, — tha babai.

Rahmani ngriti fytyrën dhe buzëqeshi. Shokët verin mirë, që të gjithë oficerë, me shtëpinë e familjet në qytet, Galipi, Qazimi, Jashari... Veç Selman Gërvi-shtës, Ky, duke ndenjtur prapa babait, kishte mbetur pa asnjë gradë.

Natën vonë babai po mendohej në shtrat për Rahmanin. Nabija rrinte pa u ndier në anën e vet të shtrattit. Edhe ajo kishte hallin e saj të madh. Bënte punët e shtëpisë me barkun te goja, priste e përcillte gjysmën e Markeshit, nuk dilte më në rrugë. A do të kishte një mbiemër djali që po vinte? Se ajo ishte grua e një burri që s'mund të martohej. Nabija e kalonte një pjesë të natës me sytë hapët, pa folur, me atë pyetjen e ngulitur në mendje. Kur e harronte një copë herë, çelej e bënte muhabet, po kjo zgjaste aq sa pushimi i qukapikut për të cicëruar.

— Mos ki gajle, Nabije, — tha befas babai. — Djali do të ketë një emër e mbiemër si gjithë bota, si unë, si ti, që të quajnë Nabije Kamber Sheshi, e shoqja e Merxhan Dalipit.

Prej kohe Nabija s'e kishte dëgjuar atë zë të thellë ledhatues që ia turbullonte shpirtin në çdo kohë. Futi fytyrën nën jorgan dhe qau nga lumturia. Pastaj e pyeti:

— A do t'i thuash shokut Enver për Rahmanin?

— Po, — u përgjigj babai. Kohët e fundit e shihte më rrallë Enver Hoxhën. Babait i dukej se Enver Hoxha fshihte një brengë. Gjallëria e tij e jashtëm, që babai ia njihte mirë, dukej se nuk buronte më prej shpirtit dhe shpesh ai drejtonte trupin e madh si për të prapsur një hije. Babai nuk guxonte ta kthente këtë mendim në fjalë, do të përpiqej të shihte më mirë kur ta takonte prapë. Ai ndenji i ngurosur në shtrat. Mërzia e vet dhe e Nabijes, lindja e një fëmije pa emër, po i dukeshin një ndjenjë e vockël përpara hallit që mund të kishte shteti.

* * *

Kolonel baba Merxhani ecte në bulevardin «Shqipëria e Re» të Tiranës, për të shkuar në konferencën bektashiane, duke pasur në krah major baba Fevrinë. Majorët ishin ende të paktë në fillimin e vitit 1947 dhe ca më të rrallë kolonelët. Po këta të dy binin në sy sidomos me shëndetin e tepruar, si edhe me veshjet, sepse ishin ushtarakë gjer në fyt dhe prej fytit e lart baballarë teqeje. Këta e nxitën mbajtjen e konferencës. Ndërkohë, që nga rruga «Ali Demi», po zbriste një procesion i gjatë leshtor, me baballarë, sekretarë e dervishë, hipur në pajtonë e vetura. Aty ku po ngrihej

busti i Qemal Stafës u detyruan të bënin një copë rrugë në këmbë. Këta jetonin në teqetë e tyre të shpërndara në çdo nyjë të vendit dhe qytetarët habiteshin se sa shumë paskëshin qenë, qindra veta. Ishte dëgjuar diçka rreth kacafytjeve të tyre të brendshme. Gjysmëbaballarët, krahu i Partisë, kërkonin reforma: të kufizoheshin teqetë në Jug për të qenë baraz me teqetë në Veri, në shkollën bektashiane t'u mësohej dervishëve të rinj patriotizmi dhe e vërteta, teqetë të ndihmonin rindërtimin e vendit... të hynin në bashkëpunim me pushtetin demokratik. Për këto ishin ndezur sytë e tyre në mbledhjet e fshehta, qenë kërleshur mjekrat me egërsi. Se ajo pala tjetër, e ndihmuar prej një koloneli jo baba, një ish-komiti të bërë partizan, dhe me strumbullar kryegjyshin, pala tjetër, pra, nuk i donte reformat, kufizimet, donte lulëzimin e mëtejshëm të teqeve... Pa kishte edhe një pikë tjetër të fshehtë, rreth së cilës ngrihej armiqësia në tehet e thikave. Të rinjtë donin martesën e lirë. Dhe s'mund të kundërshtoheshin në këtë pikë, sepse vetë themeluesi, Haxhi Beklash Veliu, kishte qenë i martuar dhe bir i tij ishte Çelebi Ahmet Xheladini i shenjtë. Dhe a ishte më e mirë martesa faqe njerëzve, apo ato që ndodhnin në teqetë dhe, le të mos hiqej kapaku, të mos ngitej më tej biseda, sepse këtu sytë e ndezur fillojnë e shuhën dhe baballarëve të shenjtë u kalon në trup drithërima.

* * *

Baba Merxhani doli nga hotel «Dajti» dhe eci pa drejtim, me shpirtin të rënduar. Te sahati pa hotel «Elbasanin» të djegur. Punëtorët po pastrojnë vendin, hapnin themelet e një ndërtese të re. Në Rrugën e Barrikadave», në oborrin e prapmë të një dyqani të kthyer në kafë-lulishte, piu ngadalë dy gota raki.

Prej andej shkoi në shtëpinë e një shoku të vet ministër. Para derës ishte makina dhe oficeri shoqërues. Ministri bëhej gati të shkonte me gruan në një shfaqje ku do të merrte pjesë edhe qeveria.

— Më falni, se erdha pa kohë, — tha babai. — Ju paskeni për të dalë.

Ministri u ul përballë në kolltuk dhe tha:

— S'ka gjë. Mund të mos shkojmë në shfaqje.

— Punë që s'bëhet.

— Jo, ne s'do të shkojmë. Mirë që erdhe, — tha ministri. Nga mënyra si e tha, kuptohej se nuk do të luante vendit pa e marrë vesh punën. Kishte parë që te dera turbullimin e thellë të mikut, luftën e brendshme të njeriut për jetë a vdekje. E shoqja hoqi kostumin dhe erdhi me përparëse, solli konjakun.

«Njerëz të mirë», — tha me vete babai.

— A ka raki? — pyeti.

— Kam një shishe për ty, — u përgjigj ministri.

Babai piu një gjysmë kile në një kohë të shkurtër, ndërsa këmbente ndonjë fjalë më tym me ministrin. Ky priti me durim, më në fund pyeti:

— Si është puna, shoku Merxhan?

Babai i vuri tapën shishes, nënqeshi dhe tha:

— Nuk jam mirë. Më duket vetja i tepërt. Ja, kështu është puna.

— Pse vallë? — pyeti ministri duke u përkulur që ta kapte tingullin e vërtetë të fjalës. Shumëkush kishite problemet e veta të rënda në fillim të vitit 1947. Po ministri nuk e gjente dot se ç'mund të kishte baba Merxhani.

— Në rrugë na shohin si karagjozë, qeshin, mbase edhe pështyjnë me vete, — tha babai.

— Jo, — tha ministri. — Ashtu e mendon ti.

— Taçi m'i mban trutë të nxehtë. Dua të zhvishem, — tha babai duke shikuar andej-këndej si i zë-

në në lak. — Kam edhe hallin e fëmijës. Kryegjyshata nuk do ta lejojë martesën.

— Duhet menduar kjo punë, — tha ministri. Tani që kuptoi shkakun e hidhërimit të babait, mori frymë i lehtësuar. — Ti nuk je vetëm baba.

— Aty të kam, që nuk jam as ashtu, as kështu, — Babai nënqeshi me hidhërim. Tha duke prekur mjekrën dhe çallmën: — Sa kohë të mbaj këto, do të jem si delja, që rri brenda lëkurës kudo të shkojë. Vitet ikin, kurse jetohet vetëm një herë.

— Pse, s'ka jetë tjetër? — pyeti si duke qeshur ministri. Porsa e tha, u pendua. Nuk ishte rasti për shakara.

Babai e shikoi e nuk foli. Ministri piu një gllënjë raki, që të fitonte kohë, tha:

— Nuk duhet t'i lëmë rast reaksionit të bërtasë se komunistët po e flakin fenë. Gjithsesi, kjo duhet biseduar me Komandantin.

— Mbase është më mirë të bisedosh ti, — tha babai. Ministri pohoi me kokë. — Veç sa më shpejt, — tha prapë babai.

* * *

Baba Merxhani u kthye në qark, në punët e shumta që e prisnin. Ai u zgjat mbi gazetën «Bashkimi» dhe e lexoi lajmin prapë. Banda e Rrezikshme e Rat Mëdyshit qe asgjësuar në pyjet e Librazhdit. Ishte vrarë Rati. Të tjerët qenë kapur, do t'i jepeshin gjyqit. Babai e rrethoi lajmin me laps të kuq. Erdhi sekretari me dosjen. Babai i tregon gazetën me gisht. Sekretari i vjetër, me fytyrën e vrarë nga lodhja, zuri të tërhiqte hundët, sikur po thithte lajmin.

— Njeriu më i lig që kam parë në jetë, — tha babai.

— Armik personal?

— Armik i popullit.

— Ordinancën tuaj e thirrën në Tiranë për uniformën e re.

Babai ndenji një çast i menduar. Javët e fundit po i ndodhnin gjëra që nuk i kuptonte, sikur tregohesh për të një kujdes i tepërt. Edhe ky sekretar i vjetër ulte sytë kur ndeshte shikimin e babait, ishte bërë i zymtë e i trembur lëvizte sikur përgjonte diçka në dhomat ngjitur. «Kushedi si do ta ketë hallin në shtëpi», — mendoi babai.

Në orën një të mesditës babai hipi në «Mileçenton» e zezë dhe u nis për në Teqenë e Madhe. E kishte thirrur për drekë dedei, me lutje, duke lënë të kuptohesh se kishte diçka me rëndësi për të biseduar. Duke u rehatuar në ndenjësën prej meshini të veturës, babai mendonte se ndofta kryegjyshi e kishte ulur kokën kryeneçe, e kishte pranuar «programin» dhe kërkonte afrim me anë të këtij dedei të Teqesë së Madhe, dinak e i ditur në punët e bektashizmit. Po të ishte ashtu, babai do t'i fuste krahun kryegjyshit dhe gjithë të tjerëve, do t'u ndihte ta hidhnin hendekun. Ai zbriti nga vetura para portës së teqesë me gdhendje të vjetra, të porsalyer me bojë kafe të errët. Ngriti çokun e rëndë të trokiste dhe vuri buzën në gaz, me një turbullim të lehtë në shpirt. Në atë portë kishte trokitur për herë të parë njëzet e shtatë vjet të shkuar, fëmijë i uritur, që e mori dervishi në krahë se po i binte të fikët...

«Zogu i vogël që ke rënë nga dega...»

A ishte ajo një rastësi që i dha drejtimin jetës së tij? A janë rastësitë vendimtare, apo thjesht një shoqërim, një shkak nxitës i asaj që është nisur të bëjë njeriu? Ai nuk pati kohë të trokiste, se një dervish hapi por-

tën e vajisur, duke fshehur fytyrën si poshtë sqetullës. Prapa priste një dervish tjetër, që hoqi udhën.

Babai eci nëpër korridorin e gjatë të ndriçuar nga dritarja në ballë me xhamat me ngjyra, përtej së cilës shkëlqente dielli, duke futur ngrohtësinë si në një rrymë ylberi. Babai pyeti veten se ç'ishte ajo heshtje e thellë. Edhe dervishi që e përcillte qe zhdukur diku. Dedei s'kishte dalë ta priste në oborr si herë të tjera. Babai tundi kokën pa ditur përse, ndërsa dëgjonte hapin e vet të rëndë në qilimin e butë.

Dedei priste në krye të shkallëve me duart mbi bark. Ngjante si një parg jeshil i ngrirë. Po lëvizti pak, u përkul lehtë, si për t'u siguruar se mysafiri i madh që priste po vinte më në fund. Babai ngjiti dy shkallë dhe u ndal një hop, si i goditur nga ndryshimi që kishte pësuar dedei në pak ditë. Ngjante më i vjetër, si i rrjepur krejt, ndofta i qenë dobësuar sytë, se po e shikonte babanë si pa e njohur, zgjati edhe kokën dhe sikur lëvizti buzët, nënqeshi.

«Zog që re në udhën e gjarprit! Haxhi Bektashi...!»

Sytë si me ujë të dedeit u errësuan e u ngulitën fort, a thua se përpiqej të shihte brenda një njolle të errët në një rrafsh të bardhë. Ai trazoi padashur gurin jeshil në bark. Babait iu duk se pa në ndriçimin e gurit një sy të njohur që hapej e mbyllej me gëzim djallëzor, iu bë se po dëgjonte një të folur të largët, të zymtë e kërcënuese. Guri u përmbys dhe në dorën me nyja të dedeit ndriti koburja «karabinierë». Para se ta shkrehte, trupi i dedeit u drodh nën dollomanë e gjatë, si i zënë prej ngërçit, sytë e tij të shqyer u rrotulluan, krismat shurdhuese shpërthyen njëra pas tjetrës, si një burim i fortë plumbi e zjarri që s'ka të mbaruar.

— Ç'është?! Ç'po bën?! — thirri baba Merxhani. Ai deshi të ngjiste shkallët, por u ndal. Brenda tij

po digjej e po shkatërrohej çdo gjë e gjallë dhe e mirë. Atij i erdhi keq për veten, për punët që duheshin bërë e që po shkriheshin pa kuptim nga zjarri e nga plumbi i dedeit të çmendur e të urryer. Sepse dedei s'kishte arsye ta bënte këtë, ata mund të merreshin vesh me fjalë. Pastaj baba Merxhani mendoi me qartësi këtë: dedei ishte dora që derdhte plumb e zjarr, kurse prapa tij qëndronte një armik me formë të pacaktuar e me fuqi të madhe. Kjo i theri në zemër, i preu krahët, sepse nuk do të kishte kohë ta shihte këtë armik, t'i fliste. «Tani do të jap frymën», — mendoi, — sa keq që u bë, kushedi ç'do të thonë shokët.» U kthye prapa si i rrotulluar me dorë prej dikujt dhe pa në shkallët gjakun e vet. Atëherë u përmblodh, u kap me forcë pas parmakëve, që të ngjitej, të ndalte dorën e armikut, t'ia shihte doemos fytyrën. Në sytë e tij po mbli dhej një mjegull e errët, si një lëmsh dhe në mesin e këtij lëmshi qëndronte e keqja. Ai zgjati duart, i pushtuar nga një dëshirë e tmerrshme për të parë, për të arritur. Po mjegulla e rëndë shtohet, duke e tërhequr poshtë me forcë. Për një çast të vetëm pa dedein të përkulur, me trupin të dridhur, tek mundohej të shihte. Në çastin tjetër dedei u tërhoq lart, u bë i paarritshëm dhe u zgjat një heshtje që baba Merxhani s'e kishte njohur kurrë.

F u n d .

Godo, Sabri

Koha e njeriut: Roman/ Sabri Godo;
Red.: A. Kallulli, — T.: Naim Frashëri;

— 496 f.: 28 cm

891: 983-31

Ⓒ 59

Tirazhi 15.000 kopje Formati 78x109/32 Stash 2204-82

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re
Tiranë, 1990